

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**dhe**

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI**

---

**SEMINARI XXXIII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË  
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

---

**33/1**

**Materialet e punimeve të Seminarit XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën,  
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare  
Prishtinë, 18-30.08.2014**



FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE

---

THE XXXIII INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,  
LITERATURE AND CULTURE

PRISHTINË, 2015

Fakulteti i Filologjisë – Prishtinë  
Fakulteti Histori-Filologji – Tiranë

SEMINARI XXXIII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE

Prishtinë, 18-30.08.2014

THE XXXIII INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,  
LITERATURE AND CULTURE

**Kryeredaktor:** Bardh Rugova

**Redaksia:** Bardh Rugova (Prishtinë), Nysret Krasniqi (Prishtinë), Rrahman Paçarizi (Prishtinë), Anton Berishaj (Prishtinë), Bajram Kosumi (Prishtinë), Muhamet Hamiti (Prishtinë), Teuta Abrashi (Prishtinë), Suzana Canhasi (Prishtinë), Valbona Gashi (Prishtinë), Shezai Rrokaj (Tiranë), Aljula Jubani (Tiranë), Persida Asllani (Tiranë), Ymer Çiraku (Tiranë), Floresha Dado (Tiranë), Dhurata Shehri (Tiranë), Mimoza Kore (Tiranë), Bardhyl Demiraj (Munich), Doris Kyriazis (Selanik), Aleksandar Novik (Shën Peterburg), Rusana Hristova (Sofje), Premysl Vins (Pragë), Rexhep Ismajli (Prishtinë), Gjorgje Bozhoviq (Beograd), Avdi Visoka (Prishtinë), Artur Karasiński (Torun), Matt Curtis (SHBA), Julie Kolgjini (Prishtinë)

**Drejtor:** Bardh Rugova

**Bashkëdrejtor:** Aljula Jubani

**Sekretar:** Nysret Krasniqi

**Bashkësekretar:** Persida Asllani

**Sekretar profesional:** Blertë Ismajli

**Drejtor nderi:** Akademik Idriz Ajeti

**Përgjegjëse për kurset e gjuhës:** Sala Ahmetaj

**Redaktor teknik:** Besfort Krasniqi

**Botues:** Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë





**Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë**

**FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE TË  
SEMINARIT XXXIII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,  
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

I nderuari drejtor nderi i Seminarit, akademik Idriz Ajeti,  
I nderuari ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë, z. Ramë Buja,  
I nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,  
akademik Hivzi Islami,

I nderuari dekan i Fakultetit Histori-Filologji te Universitetit te Tiranës prof.  
Shezai Rrokaj

E nderuara kryetare e Këshillit Drejtues te UP-se prof. Shefkije Islamaj

I nderuari kryetar i Komunës së Prishtinës z. Shpend Ahmeti

E nderuara prorektore Hasnije Ilazi,

I nderuari drejtor i Seminarit, profesor Bardh Rugova,

Të nderuar dekanë, anëtarë të Këshillit Drejtues, senatorë, seminaristë,  
mysafirë, zonja dhe zotërinj.

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që si dekan i Fakultetit të Filologjisë, t'ju uroj nismë dhe vazhdim të  
mbarë të Seminarit XXXIII Ndërkombëtar të Gjuhës, të Letërsisë dhe të Kulturës  
Shqiptare.

Ky Seminar, në dyzetvjetorin e themelimit të tij, mbetet një ngjarje shumë e  
rëndësishme e kulturës shqiptare, mbetet aktiviteti më i qëndrueshëm kulturor në  
Kosovë, aktiviteti me traditën më të madhe; një institucion që mbledh bashkë  
albanologë nga e mbarë bota, një shkollë e albanologëve të ardhshëm dhe një vegëz e  
lidhjes së albanologjisë me botën.

I themeluar më 1974, Seminari kishte synim t'i ndihmonte studiuesit e huaj të  
shqipes që kishin interes për albanologjinë, për gjuhën, letërsinë dhe kulturën  
shqiptare. Mijëra studiues të huaj kanë kaluar në këto dyzet vite nëpër këtë Seminar  
dhe shumë prej tyre e kanë zhvilluar albanologjinë si profesion dhe pasion. Disa prej  
tyre janë bërë studiues me nam.

Në kushte e rrethana shpeshherë të rënda, Seminari është zhvilluar plot 16 herë

në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë në Kosovë, derisa është mbyllur dhunshëm më 1990, siç qenë mbyllur të gjitha institucionet e tjera të kulturës shqiptare në Kosovë. Seminari e ka përtëritur punën më 1995 dhe 1996 në Tiranë, për t'u rikthyer në shtëpi në vitin 2001 tashmë në kushte e rrethana të tjera.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Seminari ka shërbyer si një shkollë për mësimin e shqipes, si një tubim shkencor albanologësh dhe si organizëm integrimi i kulturës shqiptare në botë.

Sivjet, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i tridhjetë e treti me radhë, do të zhvillojë një veprimtari të shumanshme. Do të organizohen kurset e shqipes në tri nivele, do të mbahen referime e ligjërata shkencore, do të ketë një tryezë shkencore kushtuar jetës së shqiptarëve në komunizëm, do të shënohet 200-vjetori i lindjes së De Radës, do të zhvillohen sesionet shkencore të gjuhësisë dhe të letërsisë, ndërsa do të ketë edhe ekskursione nëpër Kosovë. Sesioni i gjuhësisë do t'i kushtohet ndikimit të ideologjisë në gjuhësinë shqiptare, ndërsa sesioni i letërsisë do të trajtojë lidhjen e letërsisë shqipe me kodet e mëdha.

Uroj që ligjëratat, kumtesat e referimet e studiuesve nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe vende të ndryshme të botës të sjellin, si përherë, rezultate të reja në fusha të ndryshme të albanologjisë.

Të nderuar mysafirë, të dashur miq,

Më lejoni që në emër të profesorëve dhe të punonjësve të Fakultetit të Filologjisë, institucionit amë të Seminarit, t'ju uroj edhe një herë me dëshirën që programi i sivjemë t'i përmbushë kërkesat tuaja mësimore e shkencore, të sjellë risi për albanologjinë dhe të ofrojë strehë të sigurt për të gjithë ata që i duan studimet e shqipes si profesion jetësor.

Të dashur miq,

Më lejoni ta falënderoj drejtorinë e Seminarit për punën e kryer. Njeherësh falënderoj Ministrinë e Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe të Pejës që kanë treguar gatishmëri për ta mbështetur, si gjithmonë, aktivitetin e Seminarit. Më lejoni të falënderoj bashkëdrejtorinë e Seminarit në Tiranë për korrektesën dhe kontributin e palodhshëm.

Seminaristëve nga vendet e ndryshme të botës, miq dhe dashamirë të popullit shqiptar, u dëshiroj qëndrim të këndshëm në Kosovë.

Punë të mbarë dhe suksese.

Ju faleminderit.



## LIGJËRATA



**Dalina KALLULLI**

## **ASPEKTE TË SINTAKSËS SË SHQIPES DHE RËNDËSIA E TYRE PËR GJUHËSINË TEORIKE**

### **1. Hyrje: Gjuhësia teorike dhe themelet e saj**

Gjuhësia teorike është e lidhur pandashmërisht me gjuhëtarin amerikan Noam Çomski, i cili e konsideron gjuhën njerëzore një dritare për të studiuar mendjen njerëzore, dhe më konkretisht, e përkufizon objektin e studimit të gjuhësisë teorike si të përcaktuarit e dijes apo njohurisë që kanë folësit amtarë të një gjuhe, e cila u mundëson këtyre folësve të folurit dhe të kuptuarit e gjuhës së tyre. Me fjalë të tjera, të studiuarit e gjuhës është pjesë e shkencave kognitive.<sup>1</sup> Sipas Çomskit, folësit amtarë të një gjuhe zotërojnë kompetencë gramatikore të gjuhës së tyre, kompetencë kjo që për më tepër është krejtësisht pasive, apo e pandërgjegjshme, sepse domosdoshmërisht çdo njeri me një fiziologji normale arrin ta përvetësojë gjuhën amtare në mënyrë automatike, pavarësisht (forcës së) vullnetit të lirë.

Të studiosh kompetencën gramatikore të një folësi apo folëseje të një gjuhe amtare si për shembull shqipja, do të thotë të studiosh një sistem kognitiv të brendësuar brenda trurit, apo më saktë, brenda mendjes së folësve të shqipes; synimi është të karakterizuarit e natyrës së këtij sistemi të brendësuar gjuhësor, që u mundëson folësve amtarë të shqipes zotërimin e kësaj gjuhe.<sup>2</sup> Objektivi përfundimtar i gjuhësisë teorike është zhvillimi i një teorie që është në gjendje të përgjithësojë nga gramatika e gjuhëve të veçanta të brendësuar (apo të brendshme) në gramatikën e gjithë gjuhëve natyrore (d.m.th. njerëzore).<sup>3</sup> Me fjalë të tjera, gramatika universale (pra e ashtuquajtura “Universal Grammar” që shpesh shkurtrohet në emërtimin UG) është një teori mbi natyrën e gramatikave të mundshme të gjuhëve njerëzore. Rrjedhimisht,

---

<sup>1</sup> Sigurisht fjala është vetëm për diturinë e gjuhës amtare të secilit prej nesh.

<sup>2</sup> Sipas Çomskit, një gramatikë e një gjuhe është “një teori e gjuhës së brendësuar [...] nën vrotim” (“a theory of the I-language [...] under investigation”); Chomsky (1986: 22).

<sup>3</sup> Sipas Çomskit: “the theory of human I-languages [...] that identifies the I-languages that are humanly accessible under normal conditions” (Chomsky 1986:23); pra: “teoria e gjuhëve të brendësuar njerëzore [...] që identifikon gjuhët e brendësuar që janë të përvetësueshme në rrethana normale.”

një teori e gramatikës universale i përgjigjet pyetjes: cilat janë karakteristikat e gramatikave të gjuhëve të brendshme njerëzore? Disa nga kriteret e përshtatshmërisë janë si vijon. Së pari, universaliteti, ose përgjithshmëria, që do të thotë se një teori e përshtatshme e gramatikës universale duhet të vërë në dizpozicion veglat që nevojiten për një përshkrim adekuat të gramatikës së çdo gjuhe dhe të të gjitha gjuhëve njerëzore (d.m.th., një gramatikë që përshkruan saktësisht se si janë të ndërtuara dhe çfarë kuptimi semantik kanë shprehjet gramatikore të një gjuhe).<sup>4</sup> Kjo është e rëndësishme sepse në fund të fundit, një teori e gramatikës universale nuk do të ishte shumë interesante nëse do të na bënte të mundur – të themi – përshkrimin e gjuhës angleze apo gjermane, por jo atë të shqipësisë apo të gjuhës kineze etj. Pikërisht ky kriter përshtatshmërie është ajo që Çomski e quan “descriptive adequacy”. Së dyti, një teori e gramatikës universale duhet jo vetëm t’i përshkruajë në mënyrë adekuate, por edhe t’i shpjegojë, karakteristikat në fjalë të një gjuhe njerëzore. Pra, saktësia, apo përshtatshmëria shpjeguese (“explanatory adequacy”) është gjithashtu një kriter i domosdoshëm. Së treti, teoria e gjuhës, pra gramatika universale, duhet të jetë në gjendje të shpjegojë karakteristikat e gjuhëve njerëzore që i dallojnë këto gjuhë nga sisteme të tjera komunikimi (si p.sh. nga gjuhët formale apo programuese që përdoren në sisteme të inteligjencës artificiale, nga vallja e bletëve, kënga e zogjve, etj.). Domethënë, teoria e gramatikës universale duhet të jetë e përkufizuar në mënyrë maksimale, sepse vetëm kështu do të mund të shpjegojmë se pse disa lloj strukturash dhe operacionesh sintaksore nuk gjenden, apo nuk evidentohen, në gjuhët njerëzore. Në të njëjtën kohë, një teori e gramatikës universale duhet të jetë sa më e thjeshtë nga pikëpamja teknike (d.m.th. aparati mekanik që përdor). Pikërisht kjo është arsyeja pse në punimet e tij më aktuale shkencore, Çomski (1995-2010) sugjeron se gjuha është një sistem i përsosur i një dizenjoje (apo projektimi) optimal, në sensin që gramatikat e gjuhëve natyrore krijojnë struktura të dizenuara për të komunikuar përsosmërisht me komponente të tjera të mendjes, dhe në veçanti me sistemet e të menduarit (“thought”) dhe të folurit (“speech”), në mënyrë të tillë që gjuha rrjedhimisht është një mënyrë optimale e lidhjes mes formës dhe kuptimit (“sound and meaning”). Së fundi, një kusht i domosdoshëm që duhet përmbushur nga teoria e gjuhës është se gramatika e gjuhëve njerëzore duhet të jetë e mësueshme brenda një kohe të shkurtër, sepse nëse themi se objekti i studimit të gjuhësisë teorike është të modeluarit e diturisë gjuhësore të secilit prej nesh, pra të njeriut si qenie e tillë, një nga çështjet themelore është se si përvetësohet gjuha nga fëmijët.

<sup>4</sup> Gramatika universale në këtë sens quhet edhe gramatikë gjenerative, sepse ajo duhet të gjenerojë vetëm shprehje gramatikore dhe të filtrojë jashtë saj shprehjet jo-gramatikore të një gjuhe.

Përmendja e mësueshmërisë së gjuhës çon në synimin që ka lidhje me të, domethënë zhvillimin e një teorie të përvetësimit të gjuhës. Si e përvetësojnë fëmijët gramatikën e gjuhës së tyre amtare? Për sa i përket kësaj problematike, edhe pse sigurisht egzistojnë diferenca individuale, panorama e mëposhtme është reprezentative pavarësisht gjuhës së veçantë. Fëmijët prodhojnë fjalën e tyre të parë (p.sh. mama, dada, etj.) rreth moshës 12-mujore. Rreth moshës 18-mujore fëmijët dinë gjithsej rreth 30 fjalë (d.m.th., nga mosha 12-mujore mësojnë rreth 5 fjalë në muaj). Në moshën 30-mujore, fëmijët mund të përdorin shumicën e strukturave të gjuhës së tyre. Pra, fenomeni qëndror që duhet shpjeguar është uniformiteti, apo njësueshmëria, dhe shpejtësia e përvetësimit të gjuhës. Shpjegimi racional më i mundshëm i këtij fenomeni sipas Çomskit është si vijon: Proçesi i përvetësimit të gjuhës është i përcaktuar nëpërmjet një aftësie gjuhësore biologjike të lindur brenda trurit njerëzor, që u jep fëmijëve një algoritëm (d.m.th. një bashkësi proçedurash) të trashëguar gjenetik, i cili u mundëson atyre zhvillimin e një gramatike, sigurisht gjithnjë mbi bazën e përvojës së tyre gjuhësore.

Në qoftë se njerëzit janë të pajisur me një aftësi të lindur biologjike gjuhësore, lind pyetja cilat janë tiparet e kësaj aftësie. Sigurisht kjo aftësi duhet të përmbajë një teori të gramatikës universale që u mundëson fëmijëve të zhvilluarit e gramatikës së cilësdo gjuhe njerëzore mbi bazën e përvojës së tyre gjuhësore. Rrjedhimisht, disa aspekte të kompetencës gjuhësore (si të fëmijëve ashtu edhe të të rriturve) duhet të jenë të njohura, apo të ditura, edhe pa përvojë gjuhësore (d.m.th., janë pjesë e informacionit gjenetik të lindur gjuhësor); këto aspekte duhet pra të jenë universale. Pikërisht përpjekja për të zbuluar natyrën e aftësisë gjuhësore do të thotë përpjekje për të zbuluar parimet e gramatikës universale të cilat e përcaktojnë këtë natyrë. Por si mund të zbulohen këto parime? Meqë parimet në fjalë janë universale, ato prekin zbatimin e çdo lloj operacioni gramatikor në çdo gjuhë. Në fakt, parimet e kufizojnë gramatikën. Si shembull parimi të tillë, mund të marrim fenomenin e rekursivitetit, apo në mënyrë paksa më informale atë të nënrenditjes, një parim që vërehet në çdo gjuhë njerëzore. Por sigurisht jo të gjitha aspektet e gramatikës së një gjuhe janë universale; egzistojnë edhe aspekte gramatikore që janë specifike për një gjuhë, aspekte të cilat fëmijët duhet t'i mësojnë si pjesë e të mësuarit të gjuhës së tyre. Këto aspekte në zhargonin teorik njihen edhe si parametra. Në fakt, nuk është e rastit që teoria gjuhësore në këtë kuadër quhet teoria e Parimeve dhe Parametrave ("Principles and Parameters"). Të mësuarit e gramatikës, përkundrejt të mësuarit të leksikut, apo fjalëve) i referohet çdo parametri (d.m.th., çdo dimension i ose aspekti) që i nënshtrohet variacionit fono-morfo-sintaksor në gjuhë të ndryshme. Disa nga këta parametra janë për shembull: (i) bjerja e kryefjalës në shqip, italisht, rumanisht,

spanjisht etj., por jo në anglisht, frengjisht, gjermanisht etj.; (ii) egzistenca e trajtave të shkurtra në shqip, italisht, frengjisht etj., por jo në anglisht; (iii) egzistenca e dy zgjedhimeve të ndryshme si për shembull zgjedhimi vepror përkundrejt zgjedhimit jovepror në shqip, greqisht, apo latinisht, por jo në anglisht, gjermanisht etj. Në sa vijon, ky artikull ndalet në dy prej parametrave të lartpërmendur, pikërisht në egzistencën e trajtave të shkurtra, dhe të dy zgjedhimeve në shqip, dhe rëndësinë e tyre për gjuhësinë teorike.

## 2. Problemi i trajtave të shkurtra në gjuhësinë teorike

Çështja kryesore e modelimit të trajtave të shkurtra ka të bëjë me shpjegimin e shpërndarjes së tyre sintaksore. Për shembull, siç duket qartë në fjalitë e mëposhtme në (1), trajta e shkurtër *le* në frengjisht ka një shpërndarje sintaksore krejt të ndryshme nga emri *Jean*, me të cilin është në shpërndarje plotësuese (“distributional complementary”). Në analogji me trajtat e shkurtra në shqip, trajta e shkurtër *le* në fjalitë dëftore si (1b) mund të qëndrojë vetëm përpara foljes por jo pas saj, si kundrinori i shprehur me një emër (d.m.th. *Jean* në (1a)). Për më tepër, ndryshe nga ç’ndodh në shqip, frengjishtja nuk e lejon dublimin e kundrinorit nga një trajtë e shkurtër, (1d).<sup>5</sup>

- (1) a. *Je vois Jean.*  
unë shoh Zhanin
- b. *Je le vois.*  
unë e shoh
- c. *\*Je vois le.*  
unë shoh e
- d. *\*Je le vois Jean.*  
unë e shoh Zhanin

Në gjuhësinë gjenerative, një ndër analizat e para të këtij fenomeni është e ashtuquajtura ‘analiza e lëvizjes’ (“movement analysis”) propozuar nga gjuhëtari amerikan Riçërd Keijn (Kayne 1975). Sipas kësaj analize, trajta e shkurtër është kundrina e vërtetë, dhe pozicioni i saj strukturor përpara foljes është pasojë e ‘lëvizjes’ nga vendi bazë i kundrinës, që supozohet të jetë pas foljes, si për shembull *Jean* në fjalinë (1a) më sipër. Pra, sipas kësaj analize, rendi i fjalëve në (1b) ku trajta e shkurtër i paraprën foljes përftohet nga lëvizja lokale e trajtës së shkurtër nga pozicioni pasfoljor

<sup>5</sup> Sipas një konvencionit të njohur, shenja \* në këtë artikull përdoret për të sinjalizuar fjalitë jo-gramatikore.

në atë parafoljor. Fakti që (ndryshe nga shqipja dhe gjuhë të tjera) të dubluarit e kundrinorit nëpërmjet një trajte të shkurtër është e pamundur në frengjisht, siç përmendëm më sipër dhe siç shihet qartaz në (1d), përbën një të dhënë empirike për të cilën kjo analizë është ideale. Por shumë shpejt u pa se ky argument mbi bazën e gjuhës frënge nuk mund të ishte një aspekt universal, sepse në gjuhë të tjera madje edhe të familjes romane, si për shembull në gjuhën rumune apo spanjolle, dublimi i kundrinorit nëpërmjet një trajte të shkurtër është i mundshëm, siç duket në shembujt e mëposhtëm (2) dhe (3).

(2) Rumanisht: *Il văd pe Ion.*  
e shoh PE Jonin

(3) Spanjisht: *Lo veo a Juan.*  
e shoh A Huanin

Siç shihet në shembujt e lartpërmendur në (2) dhe (3), si në rumanisht ashtu edhe në spanjisht kundrinori i dubluar nga një trajtë e shkurtër paraqitet gjithmonë me një element parafjalor, përkatësisht *pe* në rumanisht dhe *a* në spanjisht, elemente këto të cilat janë bosh, apo ‘të zbrazura’, nga pikëpamja kuptimore semantike.<sup>6</sup> Pikërisht kjo veçori e rumanishtes dhe spanjishtes e çuan Kejnin edhe në zgjidhjen e problemit që rrezikonte analizën e tij të lëvizjes, e cila siç pamë më lart funksiononte për frengjishten. Sipas Kejnit, një kundrinë mund të dublohet nga një trajtë e shkurtër por vetëm në qoftë se kjo kundrinë është e pajisur me një element që cakton rasën, si për shembull me një parafjalë; siç dihet, rasat (me përjashtim të emërores) caktohen nga

---

<sup>6</sup> Studimet e hershme gjenerative (dhe jo-gjenerative) e përshkruanin fenomenin e dublimit nëpërmjet trajtave të shkurtra si sensitiv ndaj tiparit *njeri* (“human”) në rumanisht dhe *me shpirt* (“animate”) në spanjisht Spanish (Jaeggli 1986, Borer 1984, Dobrovie-Sorin 1990), një perspektivë kjo që nuk mund të mbrohej për varietete të ndryshme (jo-standarde) të gjuhëve romane duke patur parasysh egzistencën e të dhënave si ato më poshtë (nga Suñer 1988).

i. *Yo lo voy a comprar el diario justo antes de subir.*  
(Porteño Spanish)

unë e shkoj të blej gazetën sapo para të ardhurit  
‘Do ta blej gazetën para se të vij.’

ii. *Yo la tenía prevista esta muerte.*  
unë e kisha parashikuar këtë vdekje  
‘E kisha parashikuar këtë vdekje.’

iii. *Ahora tiene que seguir usándolo el apellido.*  
atëhere duhet që të vazhdojë ta përdori mbiemrin  
‘Tani I duhet që të vazhdojë ta përdori mbiemrin.’

folje ose parafjalë, si për shembull: *lexoj librin, prej mallit, me studenten*, etj.<sup>7</sup> Kjo zgjidhje u epitemizua nga gjuhëtari Osvaldo Jegli (Jaeggli 1982) në të ashtuquajturin Përgjithësimi i Kejnit (“Kayne’s Generalization”). Por është e qartë se edhe kjo zgjidhje nuk funksionon për shqipen, sepse shqipja nuk përdor elemente të tilla si parafjalët në kontekstet nën shqyrtim, siç tregojnë shembujt e mëposhtëm:

- (4) a. (E) pashë Jonin / filmin.  
 b. \*(Më) pa mua. / \*(Të) pa ty. / \*(Na) pa ne. / \*(Ju) pa ju.  
 c. \*(I) fola Jonit.

Për më tepër, teksa kundrina e drejtë *Jonin* në (4a) mund por nuk duhet patjetër të dublohet, kundrinorët e drejtë të shprehur me përemra vetorë lokale (d.m.th. veta e dytë dhe e tretë), si dhe kundrinat e zhdrejta, duhen dubluar nga trajtat e shkurtra përkatëse. Është pra e qartë se trajtat e shkurtra janë deri diku si elemente përshtatjeje vetore me kundrinën në gjuhë të tilla si p.sh. Çiçeva (angl: Chichewa), shih shembullin (5) më poshtë, ku këto elemente përshtatjeje janë nga pikëpamja morfologjike afikse dhe jo trajta të shkurtra, ashtu si dhe elementet e përshtatjes me kryefjalën në gjuhët indo-europiane.

- (5) Çiçeva: *Njúchi zji-ná-wá-lum-a*                      *alenje*.  
                   bletët sm-p-om-kafshuan-indic    gjuetarët

Sigurisht trajtimi i trajtave të shkurtra si elemente përshtatjeje vetore është më se i qartë në rastet kur trajtat e shkurtra janë të domosdoshme, si për shembull në rastin e kundrinave të zhdrejta dhe kundrinave të drejta të shprehura me përemra të vetës së parë dhe të dytë. Por çfarë mund të themi në lidhje me trajtat e shkurtra që dublojnë një kundrinor të drejtë të vetës së tretë? Pse nuk janë këto gjithnjë të domosdoshme, por opsionale, si në shembullin (4a) më lart? Për më tepër, si mund të shpjegohet fakti se teksa si kundrinorët e shprehur me emra të shquar ashtu edhe të pashquar por që kanë artikull mund të dublohen nga trajtat e shkurtra (p.sh. (6a,b)), kundrinorët e shprehur me emra të pashquar pa artikuj nuk mund të dublohen kurse si (p.sh. (6c))? Fakti që kundrinori në të dyja fjalitë (6b) dhe (6c) nuk mbart rasë kallëzore morfologjike (sepse kallëzorja në shqip është identike me emëroren për emrat në

<sup>7</sup> Emërorja në teorinë e Parimeve dhe Parametrave caktohet nga mbaresa. Fakti që rasa emërore në shqip mund të caktohet nga kryefjala (p.sh. *Ishte te shtëpia e prindërve*) është një karakteristikë e shqipes që nuk njihet nga gjuhë të tjera Indo-Evropiane, por kjo nuk do të thotë që emërorja nuk mund të caktohet edhe nga një element tjetër funksional si p.sh. mbaresa.



trajtën e pashquar) e dobëson argumentimin se Përgjithësimi i Kejnit ka lidhje me markimin, apo dallimin, morfologjik rasor.<sup>8</sup>

- (6) a. (E) botoi **librin**.  
b. (E) botoi **një libër** (më në fund).  
c. (\*E) botoi **libër** (më në fund).

Sidoqoftë, paradigma në (6) bën të qartë faktin se të dubluarit e kundrinës nga trajtat e shkurtra është i lidhur ngushtë me egzistencën e elementit morfo-sintaksor të artikullit, që në gjuhësinë generative shënohet me D (shkurtim i fjalës “determiner”, që në anglisht do të thotë artikull). Kjo mbështetet edhe nga fakti tjetër, që kundrinat e zhdrejta, që në shqip bartin rasën dhanore dhe siç u tha më lart janë gjithnjë të dubluara nga trajtat e shkurtra, nuk mund të shprehen me anë të emrave të pashquar pa artikuj. Me fjalë të tjera, paradigma e paraqitur në (6) nuk mund të replikohet për kundrinat e zhdrejta, çka shihet në shembujt e mëposhtëm në (7).

- (7) a. I fola vajzës.  
b. I fola një vajze.  
c. \*I fola vajze.

Pra, roli i elementit morfo-sintaksor D është kyç për egzistencën e fenomenit të dublimit të kundrinës nga trajtat e shkurtra. Në të njëjtën kohë, fakti që kundrinorët e shprehur me përmera vetorë mund të dublohen nga trajta të shkurtra është gjithashtu një sinjal i rëndësisë së D-së, sepse siç është argumentuar ka herët nga Postal (1969) dhe më vonë nga Abney (1987), përmerat janë elemente tipike D. Sigurisht kjo nuk shpjegon se pse kundrinorët e shprehur me përmera vetorë lokalë duhen dubluar nga trajtat e shkurtra domosdoshmërisht, ndërsa kundrinorët e shprehur me përmera vetorë jo-lokalë (d.m.th., të vetës së tretë) nuk shfaqen gjithnjë të dubluar. Gjithashtu, lind pyetja çfarë lidhje ka elementi D dhe varësia e dublimit të kundrinës së drejtë të shprehur me një emër/përëmër të vetës së tretë nëpërmjet trajtave të shkurtra me elementin D? Para se t’i kthehemi kësaj pyetjeje, të shohim disa fakte të tjera.

---

<sup>8</sup> Dobrovie-Sorin (1994) duke u përpjekur ta ruajë Përgjithësimin e Kejnit për rumanishten, ku ndryshe nga kundrinorët e drejtë kundrinorët e zhdrejtë nuk paraprihen nga parafjala *pe* që pamë më lart, argumenton se markimi morfologjik rasor është analog i parafjalës. Me fjalë të tjera, në qoftë se rasa dallohet morfologjikisht, atëhere ky dallim është njëlloj si parafjala. Pra, Përgjithësimi i Kejnit e ruan vlerën e tij në këto raste.

Siç dihet, duke filluar nga Lopašov (1978), shprehur në mënyrë informale, dublimi i kundrinorit të drejtë në vetën e tretë nëpërmjet një trajte të shkurtër shërben për të shprehur funksionin tematik (përkundrejt funksionit rematik) të kundrinës, çka mund të shihet qartë në kontekstet e dhëna në shembujt e mëposhtëm (8) deri (11). Më saktësisht, kur kundrina është pjesë e theksit logjik të fjalisë, atëhere ajo nuk mund të dublohet kursesi nga një trajtë e shkurtër, siç e bëjnë të qartë shembujt (8) dhe (9). Në të kundërt, kur kundrina nuk është pjesë e theksit logjik të fjalisë, atëhere ajo duhet të dublohet domosdoshmërisht, (10) dhe (11).<sup>9</sup>

- (8) A: Çfarë bëri Ana? B: Ana (\*e) lexoi librin.
- (9) A: Çfarë lexoi Ana? B: Ana (\*e) lexoi librin.
- (10) A: Kush e lexoi librin? B: Ana \*(e) lexoi librin.
- (11) A: Çfarë bëri Ana me librin? B: Ana \*(e) lexoi librin.  
(ose: Çfarë i bëri Ana librit)?

Është e rëndësishme të vihet re se shqarësia e emrit që shpreh kundrinorin në shembujt e mësipërm nuk mjafton për të shkasuar dublim të saj nga trajta e shkurtër përkatëse, siç duket fare mirë në shembujt (10) dhe (11).

Që dublimi i një kundrine të drejtë në vetën e tretë nëpërmjet trajtës së shkurtër përkatëse shërben si shenjë dallimi se kjo kundrinë nuk mund të jetë rematike evidentohet edhe nga fakti që në një fjali pyetëse mbi kundrinën, kjo e fundit nuk mund të dublohet:

- (12) Kë/çfarë (\*e) pe?

Në të kundërt, kundrina e një pyetjeje mbi kryefjalën, që është pjesë e asaj që presupozohet si fakt, apo si e vërtetë, duhet patjetër të dublohet në shqip.

---

<sup>9</sup> Lopashov (në Lopašov 1978), i cili e përcakton fenomenin e dublinit nga trajtat e shkurtra si një karakteristikë të gjuhëve ballkanike, e konsideron pozicionin para-foljor të kundrinës shkas të fenomenit të dublinit nga trajtat e shkurtra, një situatë kjo që në gjuhësinë teorike moderne përbën një fenomen të veçantë, që quhet “clitic left dislocation”. Së dyti, Lopashovi e lidh dublimin e kundrinës nga trajtat e shkurtra me shqarësinë (d.m.th., me trajtën e shquar) të emrit, duke pranuar megjithatë se dublimi i një përmeri të plotë është më i përhapur se sa dublimi i një kundrinori të shprehur me emër (dhe jo përmer). Së fundmi, ai thekson pamundësinë e dublinit të kundrinave që bartin theksin logjik, në terminologjinë e tij.


(13) Kush \*(e) pa fëmijën?

E rëndësishme është gjithashtu të vihet re se dublimi i një kundrine të shprehur me një emër të trajtës së pashquar, por gjithnjë me artikull (krahaso (6b) dhe (6c)), është i domosdoshëm apo i pamundshëm në të njëjtat rrethana si *librin* në shembujt (8) deri (11) më sipër. Për shembull, fjalia (14a), ku kundrinori i drejtë *një birrë* është i dubluar, mund të jetë përgjigje e vlefshme e një pyetjeje si ‘Çfarë do të bëje me një birrë?’ apo ‘Do të doje (të pi)je një birrë?’, por jo e një pyetjeje si ‘Çfarë do të doje të pi?’ apo ‘Çfarë do të doje të bëje?’, për të cilat përgjigja e saktë do të ishte fjalia (14b), ku kundrinori i drejtë nuk është i dubluar, dhe e cila nuk do të mund të funksiononte si përgjigje e saktë e dy pyetjeve të para.

- (14) a. Do ta pija me kënaqësi një birrë.  
b. Do të pija me kënaqësi një birrë.

Përmendja e faktit se dublimi i kundrinës së drejtë nga trajtat e shkurtra nuk varet nga (pa)shquarësia e kundrinës e vështirëson disi argumentimin se funksioni i trajtës së shkurtër në këto raste është shprehja e tematicitetit (përkundrejt rematicitetit) të kundrinës në qoftë se supozohet, siç është tashmë traditë, se emrat në trajtën e pashquar shprehin informacion të ri, apo prezantojnë pjesëtarë të rinj, apo njësi të reja, në diskurs. Pra, ose duhet të heqim dorë nga ky supozim, ose duhet të kërkojmë një zgjidhje tjetër. Fatmirsisht, zgjidhja egziston në literaturën aktuale. Për shembull Kiparski (në Kiparsky 2008), flet për një parim universal, që ai e quan hierarkia e D-së (“the D-hierarchy”), që e bën veten të dukshëm në një sërë fenomenesh të ndryshme në gjuhë të ndryshme.

(15) The D-hierarchy:



Është e rëndësishme të vihet re se Kiparski, duke iu referuar Wierzbickës (Wierzbicka 1981), hierarkia në (15) nuk ka të bëjë vërtet as me “(pa-)shpirtësinë” (“animacy”) dhe as me “agjentivitetin” (“agentivity”) e elementeve të përfshira në këtë hierarkia, që e bën joplauzibël një shpjegim funksional, dhe se një kategori deri diku e

lidhur me shquarësinë, si për shembull “diferencimi” (“individuation”) apo “të qënit temë” (“topic-worthiness”) është një kandidat disi më i mundshëm. Është e lehtë të vihet re të paktën në mënyrë të përgjithshme lidhja e dublimit të kundrinës nga trajtat e shkurtra me faktet e shqipes për këtë fenomen: përemrat lokalë janë ata që qëndrojnë më së larti në këtë hierarki, dhe si të tillë natyrisht janë gjithnjë më të diferencuar në diskurs.

Seksioni vijues i dedikohet një fenomeni tjetër të shqipes dhe rëndësisë së tij për gjuhësinë teorike – egzistencës së dy zgjedhimeve, atij vepror dhe atij jovepror.

### 3. Zgjedhimi jovepror

Gjuha shqipe, ashtu si dhe për shembull latinishtja dhe greqishtja, ka dy zgjedhime të ndryshme, që tradicionalisht në gramatikat e shqipes quhen zgjedhimi vepror dhe ai jovepror, ilustruar nëpërmjet shembujve nën (16).

(16)	<u>Zgjedhimi vepror</u>	<u>Zgjedhimi jovepror</u>
	a. mëso-j	mëso-hem
	b. shkatërro-j	shkatërro-hem
	c. kurse-j	kurse-hem
	d. bë-j	bë-hem

Këto dy zgjedhime të ndryshme përdoren për të shprehur kategorinë e diatezës së foljes. Kështu, teksa zgjedhimi vepror shpreh diatezën veprorë, zgjedhimi jovepror shpreh diatezën pësore, vetvetore dhe mesore, si në shembujt e mëposhtëm.

(17)	a. Armiku shkatërroi qytetin.	→ diateza veprorë
	b. Qyteti u shkatërrua (prej armikut).	→ diateza pësore
(18)	a. Lava fëmijën.	→ diateza veprorë
	b. Fëmija u la (nga nëna / vetë).	→ diateza pësore /vetvetore
(19)	a. E hodha kockën në plehra.	→ diateza veprorë
	b. Qeni u hodh të kapte kockën.	→ diateza mesore

Në veçanti, shqipja, ashtu si dhe gjuhë të tjera që e kanë këtë ndryshim morfologjik (pra formal), si për shembull latinishtja apo greqishtja, ka një grup foljesh të zgjedhimit jovepror që nuk kanë homologe në formën veprorë. Këto folje, që në gramatikat e latinishtes quhen folje deponente, karakterizohen në botimin e vitit 1995

të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë *Gramatika e Gjuhës Shqipe* si “folje të diatezës mesore që nuk kanë forma përgjegjëse të diatezës veprorë” (faqja 272), dhe ilustrohen në këtë botim nga: *besatohem, dergjem, dukem, kacavarem, kacavirrem, kollem, kollitem, krenohem, kujdesem, mërdbezem, mërebem, motohem, mrekullohem, muget, muzget, mykem, pendohem, përlytem, përgjigjem, përleshem, përvesem, përvesohem, sulem, vërsulem, zotohem*. Këto folje, të cilave unë do t’u referohem si ‘folje deponente’, kanë qenë problem në gjuhësinë teorike moderne (ashtu si dhe atë tradicionale të latinishtes), sepse sipas analizave teorike, zgjedhimi jovepror në përgjithësi absorbon aftësinë e foljes për të caktuar rasën kallëzore, gjë që çon në ‘ngritjen’ e kundrinës në pozicionin sintaksor të kryefjalës, e cila nuk kërkon rasë kallëzore por emërore. Por sigurisht në qoftë se pozicioni bazë i kryefjalës është i zënë, kundrina nuk mund të lëvizë në këtë pozicion. Prandaj foljet joveprorë supozohen jo vetëm të kenë humbur aftësinë për të caktuar rasën kallëzore, por edhe për të patur një kryefjalë. Për të ilustruar sado pak këtë analizë, le të krahasojmë fjalitë (17a) dhe (17b). Në njëfarë mënyre, (17b) duket si e prejardhur nga (17a), sepse kundrina e drejtë e kësaj të fundit shfaqet si kryefjalë e fjalisë (17b), ndërsa kryefjala e (17a) shfaqet vetëm në mënyrë opsionale në një frazë parafjalore. Por foljet deponente të lartpërmendura të shqipes nuk mund të marrin kurrë një kundrinor, çka gjen shprehjen edhe në botimin e lartpërmendur të Akademisë së Shkencave që i përkufizon këto folje si folje të diatezës mesore, dhe sipas të cilit “[p]ër nga kuptimi, foljet e diatezës mesore janë të afërta me foljet jokalimtare” (faqja 271). Atëhere si mund ta shpjegojmë formën e njëjtë morfologjike që kanë këto folje me foljet e diatezës pësore, analiza e të cilave u dha shkurtimisht si më sipër? Sigurisht një analizë uniforme e të gjitha foljeve që kanë të njëjtën formë morfologjike (pra zgjedhim jovepror) do të ishte e preferueshme nga pikëpamja konceptuale. Pikërisht këtu shqipja na jep disa të dhëna mjaft interesante. Së pari, të gjitha këto folje janë të prejardhura nga emra ose mbiemra. Kjo nuk mund të jetë një rastësi për dy arsye: (i) të dhëna të ngjashme egzistojnë edhe për latinishten (cf. Xu, Aronoff and Anshen 2007); (ii) tamam ashtu siç supozohet për foljet e diatezës pësore (detajuar më sipër), emrat dhe mbiemrat nuk kanë kryefjalë por mund të marrin argumente të brendshme që ngjajnë me kundrinën e foljes. Së dyti, të dhëna nga foljet deponente në shqip evidentojnë një proces tranzitiviteti nga folje jokalimtare në folje kalimtare, gjë që ka shumë vlerë për gjuhësinë teorike. Për shembull, më lart u tha se folja *dukem* është një folje deponente (pra që nuk ka një formë përkatëse në diatezën veprorë); krahaso fjalitë (20a) dhe (20b).

- (20) a. U dukën gjurmët.  
b. \*Duka gjurmët.

Edhe pse kemi këtë dallim nga pikëpamja gramatikore, një folje deponente si *zhdukem*, që si antonim i saj është përftuar qartësisht nga folja *dukem* me anë të parashtesës *zhd-*, mund të hyjë në marrëdhënie kalimtare, pra të ketë një kundrinë të drejtë, siç shihet në (21).

- (21) a. U zhdukën gjurmët.  
b. Zhduka gjurmët.

Ky detaj është tejet i rëndësishëm për gjuhësinë teorike, sepse shpreh në mënyrë mëse të qartë egzistencën e një procesi tranzitivizues (pra përfitim e një foljeje kalimtare nga një folje jokalimtare), proces ky që është vënë jo rallë në dyshim nga proponentë që supozojnë vetëm një proces de-transitivizues (pra përfitim e një folje jokalimtare nga një folje kalimtare).

#### 4. Konkluzione

Ky artikull parashtrori disa aspekte të morfo-sintaksës dhe semantikës së shqipes që janë provuar tepër të dobishme për gjuhësinë teorike universale. Së pari, edhe pse fenomeni i dublimit të kundrinës nëpërmjet trajtave të shkurtra është një përgjithësim tipologjik dhe jo një aspekt universal, lidhja e këtij fenomeni me një parim universal si “D-hierarchy” është e drejtëpërdrejtë. Gjithashtu, edhe pse zgjedhimi jovepror është më së shumti një karakteristikë tipologjike, lidhja e këtij fenomeni me një parim hypotetikusht universal siç është ai i natyrës së prejardhur të kryefjalës së foljeve të diatezës pësore, është gjithashtu e drejtëpërdrejtë.

#### Bibliografia:

1. Abney, Steven. 1987. *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*. Doctoral Dissertation, MIT.
2. Borer, Hagit. 1984. *Parametric Syntax: Case Studies in Semitic and Romance Languages*. Dordrecht: Foris.
3. Chomsky, Noam. 1986. *Knowledge of Language: its nature, origins and use*. New York: Praeger.
4. Dobrovie-Sorin, C. 1990. Clitic doubling, wh-movement and quantification in Romanian. *Linguistic Inquiry* 21: 351–397.
5. Dobrovie-Sorin, Carmen. 1994. *The Syntax of Romanian*. Berlin: Mouton de Gruyter.

6. Jaeggli, Oswaldo. 1982. *Topics in Romance Syntax*. Dordrecht: Foris.
7. Jaeggli, Oswaldo. 1986. Three issues in the theory of clitics: Case, doubled NPs, and extraction. In H. Borer (ed.) *Syntax and Semantics 19: The Syntax of Pronominal Clitics* 15–42. New York: Academic Press.
8. Kayne, Richard. 1975. *French Syntax*. Cambridge MA: The MIT Press.
9. Kiparsky, Paul. 2008. Universals constrain change, change results in typological generalizations. In J. Good (ed.) *Linguistic universals and language change*. Oxford: Oxford University Press.
10. Lopašov, J. 1978. *Mestoimennye povtory dopolnenija v balkanskib jazykah*. Leningrad: Nauka.
11. Postal, Paul. 1969. On so-called pronouns in English. In *Modern Studies in English. Regional Meeting Chicago Linguistic Society* 350–360.
12. Suñer, M. 1988. The role of agreement in clitic-doubled constructions. *Natural Language and Linguistic Theory* 6: 391–434.
13. Wierzbicka, Anna. 1981. Case marking and human nature. *Australian Journal of Linguistics* 1: 43–81.
14. Xu, Zheng, Aronoff, Mark and Anshen. 2007. Deponency in Latin. In Beerman, Corbett, Brown, and Hippisley (eds.) *Deponency and Morphological Mismatches*. 127–144. Oxford: Oxford University Press.





Shkumbin MUNISHI

## ZHDUKJA E DYGJUHËSISË SHQIP-SERBISHT NË KOSOVË

### Hyrje

Treva e Kosovës për shekujt me radhë ka qenë vendi i takimit midis shqipes dhe serbishtes si dy gjuhë indoevropiane, të cilat u takojnë familjeve të ndryshme. Në trungun e gjuhëve indoevropiane që fliten në Evropë shqipja del si gjuhë e veçantë, ndërkaq serbishtja hyn në grupin e gjuhëve sllave. Më saktësisht në nën-grupin e gjuhëve sllave jugore. Për shekujt me radhë banorët e Kosovës, kryesisht shqiptarët dhe serbët etnikë, kanë jetuar dhe ndërvepruar me njëri tjetrin, pothuajse në të gjitha domenet e komunikimit. Në masë të madhe, folësit e shqipes dhe të serbishtes në Kosovë kanë qenë bilinë, ndërkaq raportet midis gjuhëve të tyre janë ndikuar drejtpërdrejt nga raportet e përgjithshme shoqërore, politike e kulturore.

Pa u ndalur në historinë e mëhershme të kontakteve të shqipes dhe serbishtes në shekujt e kaluar, është me rëndësi që qysh në fillim të thuhet se dygjuhësia shqip-serbisht në Kosovë, gjatë shekullit XX, shfaqet si dukuri e bilinguizmit asimetrik dhe si rrjedhojë e kontaktit dhe konfliktit gjuhësor (Munishi, 2010). Në të kaluarën, sidomos nga viti 1945 e tëhu, ky bilinguizëm ka qenë subjekt i ndërhyrjes planifikuese, e cila ka pasur për qëllim, përcaktimin e statusit të shqipes dhe të serbishtes, por edhe planifikimin e funksioneve të tyre, sidomos në rrafshin zyrtar dhe administrativ. Sa i përket planifikimit të statusit të shqipes dhe serbishtes në Kosovë gjatë viteve 1945-1990, mund të thuhet se përkundër avancimit gradual të pozitës së shqipes pas vitit 1945, sidomos pas vitit 1974, kur u përcaktua statusi i barabartë për shqipen dhe serbishten në Kosovë, megjithatë serbishtja ishte në pozitë më të favorshme për faktin se në kontekstin e përgjithshëm të ish-Jugosllavisë, si gjuhë e shumicës (bashkë me kroatishten dhe bosanishten përbënin të ashtuquajturën serbo-kroatishte apo kroato-serbishte), shërbente edhe si *lingua franca* e federatës së atëhershme jugosllave. Vlen të përmendet fakti se shqiptarët dhe serbët në Kosovë në atë kohë, ndonëse ishin bashkësi folëse të ndryshme, përbënin një bashkësi komunikuese, sepse kishin ndërveprim dhe ndërkomunikim të përditshëm me njëri tjetrin, me ç'rast komunikimi zhvillohej kryesisht në kodin dominant që ishte serbishtja. Pas vitit 1990 gjuha shqipe,

praktikisht, u bë gjuhë e ndaluar dhe përdorimi i saj u kufizua vetëm në domenet e familjes, në rrethin shoqëror që përbëhej kryesisht prej shqiptarëve, në ato punë me të cilat merreshin shqiptarët nën okupimin serb dhe në ato pak media që kishin mbetur në gjuhën shqipe. Në një situatë të tillë, statusi i shqipes u degradua deri në pikën më të ulët (Munishi, 2006, 2013).

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe largimit të pushtetit serb (1999) u krijuan rrethana të reja politike, ekonomike e kulturore, të cilat patën ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvillimit të dygjuhësisë shqip-serbisht. Evoluimi i statusit të shqipes dhe të serbishtes në Kosovë pas vendosjes së Misionit të OKB-së është trajtuar nga Ismajli (Ismajli, 2002, 2003) dhe Munishi (2006, 2009, 2010). Kohë më parë, në dy raste jemi përpjekur të trajtojmë statusin e shqipes në kontekstin rajonal dhe europian (Munishi, 2009) dhe, konkretisht, statusin e shqipes në Kosovë (2010). Sa i përket planifikimit të statusit të gjuhëve në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë kemi theksuar se ky planifikim është bërë në përputhje me politikat gjuhësore të BE-së, të cilat e promovojnë diversitetin gjuhësor si vlerë, dhe në përputhje me normat aktuale ndërkombëtare të përshkruara në ***Kartën Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Minoriteteve***<sup>1</sup>, si dhe në dokumente të tjera ndërkombëtare, siç është ***Deklarata Universale Mbi të Drejtat Gjuhësore e Barcelonës***, e miratuar në qershor 1996, nga institucionet dhe organizatat joqeveritare nën mbështetjen e UNESCO-s (Munishi, 2009 dhe 2010). Në Kushtetutën e Kosovës<sup>2</sup>, e cila bazohet në rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, si gjuhë zyrtare përcaktohen shqipja dhe serbishtja (neni 5, pika 1), ndërsa gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj (neni 5, pika 2). Megjithatë, përkundër përcaktimit të statusit zyrtar për shqipen dhe serbishten, ka probleme të shumta dhe vështirë të kalueshme për zbatimin e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. Në një raport të hartuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë<sup>3</sup> janë identifikuar disa probleme ligjore, buxhetore e teknike sa i përket zbatimit të dygjuhësisë në komunat e Kosovës (Munishi, 2009). Problemet e tjera janë të natyrës, politike, demografike e kulturore.

---

<sup>1</sup> Shih në Internet: <http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/148.htm>, qasja për herë të fundit më 8 nëntor 2011.

<sup>2</sup> Shih në Internet: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf), qasja për herë të fundit më 8 nëntor 2011.

<sup>3</sup> “Raportin për përdorimin e gjuhëve minoritare në komunat e Kosovës”, shih në Internet: [http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22607\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22607_en.pdf), qasja për herë të fundit më 23 mars 2009.

Përfundimi i luftës në Kosovë pati ndikim edhe në fushën e gjuhëve. Duke qenë se shqiptarët përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë së Kosovës, ata e kanë fjalën kryesore në institucionet e Kosovës dhe duke qenë shumicë kanë mundësi ta favorizojnë gjuhën e tyre (Munishi, 2009). Pra, kriteri demografik, luan rol kryesor në raportet midis shqipes dhe serbishtes në Kosovë. Në anën tjetër, si pasojë e luftës, marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve janë ftohur në masë të madhe dhe kjo ka çuar pothuaj në ndarjen fizike të tyre. Sot, serbët jetojnë kryesisht në disa qytete e fshatra të Kosovës në bashkësi kompakte, të cilat kryesisht janë të ndara jo vetëm nga popullsia shqiptare, por edhe nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Me fjalë të tjera, domenet e kontakteve midis shqipes dhe serbishtes janë kufizuar ndjeshëm. Kontaktet e përditshme, sidomos ato joformale, midis shqiptarëve dhe serbëve janë reduktuar në masë të madhe dhe kjo është reflektuar edhe në komunikimin gjuhësor reciprok. Nëse dikur shqiptarët dhe serbët në Kosovë përbënin bashkësi komunikuese, sot shqiptarët dhe serbët janë bashkësi pothuajse të ndara gjuhësore. Ndërkomunikimi i reduktuar gjithashtu ka ndikim të drejtpërdrejtë zbatimin e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. Institucionet e Kosovës janë duke bërë përpjekje që t'i integrojnë pakicat në Kosovë dhe mund të ndodhë që kjo situatë të ndryshohet në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ndarja fizike ka bërë që brezat e rinj të mos jenë në gjendje ta mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit. Njohja e gjuhës paraqet problem fundamental për zbatimin e dygjuhësisë shqip-serbisht. Derisa shqiptarët më nuk janë të detyruar ta mësojnë serbishten, pasi që prestigji i saj që e kishte dikur është zhdukur, serbët ende kanë paragjykimet negative ndaj gjuhës shqipe dhe ende nuk janë në gjendje ta pranojnë faktin se pas luftës në Kosovë rrethanat dhe raportet politike e shoqërore kanë ndryshuar. Edhe pse për shkak të epërsisë që kishte dikur serbishtja shqiptarët e Kosovës, brezat e mesëm dhe të vjetër, në masë të madhe ishin bilingjë, sot ata hezitojnë të flasin serbisht në rastet kur duhet të komunikojnë me serbët. Në anën tjetër, edhe brezat e mesëm dhe të vjetër të serbëve, duke jetuar në fqinjësi me shqiptarët e kuptojnë dhe e flasin shqipen, por hezitojnë ta flasin kur komunikojnë me shqiptarët, mbase për shkak të sedrës së tyre. Qëndrimet reciproke ndaj gjuhës serbe, respektivisht shqipe, janë gjithashtu një element i rëndësishëm që ndikon në dygjuhësinë shqip-serbisht. Një tjetër zhvillim ka të bëjë me mësimin e gjuhëve dhe dy gjuhët zyrtare të Kosovës më nuk mësohen as në sistemin arsimor. Nxënësit shqiptarë në shkollat e tyre e mësojnë anglishten dhe jo më serbishten, ndërsa as nxënësit serbë nuk e mësojnë shqipen.

Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që ndonëse në Kosovë kemi dygjuhësi zyrtare të deklaruar dhe të vendosur në kushtetutë, megjithatë, në realitet, dygjuhësia është e reduktuar vetëm në funksione e domene formale, por edhe në këto funksione

epërsia e shqipes për shkak të kriterit demografik është domethënëse. Këto janë vetëm disa nga problemet më evidente të dygjuhësisë zyrtar shqip-serbisht.

Për ta pasqyruar gjendjen e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë dhe problemet e zbatimit të dygjuhësisë, në tetor dhe nëntor të vitit 2011 patëm kryer një anketim me respondentë nga vise të ndryshme të Kosovës, të të dy gjinive dhe moshave nga 18 deri në 55 vjeç. Në atë anketim patëm intervistuar gjithsej 154 persona (79 meshkuj dhe 75 femra). Anketimi ka pasur për qëllim të na jap një pasqyrë sado të vogël lidhur me nivelin e nxënies së gjuhës serbe nga qytetarët shqiptarë. Më tej, kemi dashur të shohim se sa e shpeshte është denduria e komunikimit të folësve të shqipes me folës të serbishtes. Po ashtu, jemi përpjekur të kuptojmë se cilat janë domenet aktuale të kontaktit midis folësve të shqipes me folës të serbishtes. Qëllimi tjetër ka qenë që të kuptojmë se në rastet kur ndodh, apo nëse do të kishte komunikim eventual midis folësve të shqipes dhe serbishtes, cilin kod preferojnë ta përdorin folësit e shqipes. Në fund, jemi përpjekur të kuptojmë se cili është qëndrimi i folësve të shqipes ndaj serbishtes si gjuhë dhe sa kanë dëshirë ta flasin, apo ta mësojnë serbishten folësit burimorë të shqipes. Të dhënat e këtij anketimi i kemi publikuar në një rast tjetër (Munishi, 2011), por këtu po i përmendim shkurtimisht gjetjet kryesore, pasi që pastaj, në bazë të këtij anketimi, është kryer edhe hulumtimi tjetër, rezultatet e të cilit do t'i japim në këtë punim dhe do t'i krahasojmë me rezultatet e anketimit të vitit 2011.

Hulumtimi i vitit 2011 kishte vërtetuar disa hipoteza kryesore të cilat i kishim ndërtuar qoftë si rezultat i vëzhgimeve josistematike, qoftë i përshtypjeve të fituara nga jeta e përditshme në këtë ambient. Të dhënat kishin dëshmuar se niveli i atyre që e flasin gjuhën serbe ka rënë ndjeshëm, sidomos te brezat e rinj. Edhe denduria e kontaktit dhe ndërkomunikimit ka rënë ndjeshëm, pothuajse në të gjitha vatrat e kontaktit. Të dhënat e anketimit kishin treguar po ashtu se shqiptarët nuk do t'i ikin komunikimit me serbë, por në rastet e tilla do të parapëlqenin ta përdorin ose gjuhën e tyre, ose anglishten si *lingua franca*. Edhe motivi për ta mësuar gjuhën serbe ka rënë plotësisht. Ndonëse paragjykimet krejtësisht negative për gjuhën serbe nuk janë shprehur në mënyrë aq të theksuar, nxitja për ta mësuar atë nuk ekziston më.

Si përfundim, hulumtimi që kemi kryer më 2011 ka dëshmuar se, ndonëse politika gjuhësore nga lart-poshtë promovon dygjuhësinë, praktika gjuhësore në terren e vështirëson zbatimin

## **1. Gjendja e sotme e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë**

Hulumtimi i vitit 2011, për të cilin bëme fjalë pak më parë, na ka nxitur që të kryejmë edhe një hulumtim tjetër, për të rivlerësuar se cila është gjendja e dygjuhësisë

shqip-serbisht në Kosovë, në mënyrë që të jemi në gjendje për ta parë procesin e zhvillimit të tanishëm të kësaj dukurie. Të dhënat që i kemi marrë, në një pjesë të konsiderueshme përkojnë me të dhënat e hulumtimit paraprak, por këtë radhë kemi synuar grupe të tjera shoqërore për t'i përfshirë në hulumtim dhe jemi përpjekur t'i gjejmë vatrat kryesore të kontaktit aktual midis folësve të shqipes dhe të serbishte, si dhe të hulumtojmë se cilat janë format dhe kodet e ndërkomunikimit në ato vatra të kontaktit.

### **1.1. Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit**

Sikurse edhe në anketimin e kryer më 2011, edhe në anketimin që kemi kryer më 2014, qëllimi i parë ka qenë të hulumtojmë se sa e njohin dhe flasin aktualisht gjuhën serbe folësit e shqipes në Kosovë. Po ashtu, qëllimi tjetër ka qenë t'i shohim domenet eventuale të ndërkomunikimit, kodet me të cilat komunikohet në situatat e ndërkomunikimit midis folësve të shqipes dhe serbishtes, si dhe qëndrimet e përgjithshme ndaj gjuhës serbe. Për këtë qëllim, kemi zhvilluar në fakt dy anketa dhe intervista me grupe shoqërore të ndryshme.

Anketa e parë është zhvilluar në fund të muajit maj dhe në fillim të qershorit (2014), në Prishtinë, me studentë të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në këtë kuadër, kemi kryer anketim me studentë të vitit të dytë, të tretë dhe të katër të Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe të Gjuhës Angleze, studentë të nivelit master të gjuhës shqipe dhe me studentë të doktoratës të gjuhësisë. Arsyeya kryesore që grupi shoqëror, të cilin e kemi marrë për hulumtim kanë qenë studentët qëndron në faktin se pjesa dërmuese e tyre janë të moshës së re dhe janë studentë që studiojnë në drejtimet e gjuhësisë, pra interesimi i tyre janë gjuhët. Këtyre studentëve u janë shpërndarë pyetësorë përkatës, në të cilët janë parashtruar 4 pyetje dhe u është dhënë një fjali në gjuhën serbe për ta përkthyer. Gjithsej janë anketuar 112 studentë, nga të cilët 18 kanë qenë meshkuj dhe 94 femra. Pjesa dërmuese e të anketuarve kanë qenë të moshës 18-25 vjeç dhe vetëm në grupin e studentëve të doktoratës ka pasur studentë të moshës mbi 25 deri në 45 vjeç, por numri i tyre ka qenë më i vogël. Sa i përket gjinisë, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë qenë femra, ndërkaq numri i meshkujve të anketuar ka qenë më i vogël. Studentët është dashur që kryesisht të përgjigjen në pyetje të mbyllura, duke rrumbullakuar opsionet përkatëse, por në fund u është dhënë mundësia t'i japin komentet e tyre eventuale lidhur me temat për të cilat është zhvilluar anketa. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë komentuar, por ato pak komente, të cilat i kemi marrë kanë qenë mjaft të dobishme, sepse kanë dhënë sqarim për pikëpamjet e shprehura në anketë.

Anketa tjetër ka pasur për qëllim t'i hetojë vatrat e kontaktit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes, situatat ndërkomunikuese të cilat ndërtohen në këto vatra dhe kodet komunikuese që përfshihen në ndërkomunikim. Kjo anketë e dytë është kombinuar edhe me intervista në vendin e anketimit, me qëllim që të dhënat e mbledhura nga anketa të plotësohen me diskutimet me të anketuarit lidhur me temat e anketimit. Edhe në anketën e dytë, në fillim, janë marrë informata për nivelin e njohjes së gjuhës serbe, por pastaj theksi është vënë te kontakti dhe ndërkomunikimi. Duke u bazuar në të dhënat e hulumtimit të vitit 2011, i cili përjashtonte në masë të madhe rrethin dhe vendin e punës si domene të kontaktit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes, kemi qenë të detyruar që domenet e kontaktit t'i kërkojmë diku tjetër. Duke ndjekur modelin e William Labovit, i cili kishte vërejtur se qendrat tregtare dhe dyqanet mund të jenë hapësira të përshtatshme për hulumtime sociolinguistike dhe për marrjen e të dhënave përkatëse, edhe ne kemi menduar që qendrat tregtare (shopping mall) në qytetin e Prishtinës mund të jenë ambiente të përshtatshme për kryerjen e hulumtimeve sociolinguistike. Përtej qëllimeve tregtare e komerciale, qendrat tregtare moderne sot janë shndërruar edhe në hapësirat të ndërveprimit shoqërore dhe në vende argëtimi, ku njerëzit e kalojnë një pjesë të kohës së lirë. Në bazë të këtyre karakteristikave, qendrat tregtare janë ambiente të përshtatshme për krijimin e situatave komunikuese midis folësve të ndryshëm. Përzgjedhja e mallrave dhe shitblerja e tyre, detyrimisht sjellin situata të kontaktit dhe të ndërkomunikimit. Arsyet që i përmendëm kanë qenë indikative për ne që situatat komunikuese midis folësve të shqipes dhe të serbishtes t'i kërkojmë pikërisht në qendra tregtare. Për këtë arsye, hulumtimin tonë e kemi shtrirë në dy qendra të mëdha tregtare në qytetin e Prishtinës. Qendra e parë tregtare, në të cilën kemi bërë anketime dhe intervista ishte qendra tregtare “Albi Mall”, e cila gjendet në lagjen veterrik të Prishtinës.

Arsyeja që kemi përzgjedhur këtë qendër tregtare, përveç faktit se është qendra tregtare më e frekuentuar në Prishtinë, është edhe vendndodhja e saj. Kjo qendër është po ashtu në afërsi të komunës së Graçanicës, komunë kjo e krijuar në procesin e decentralizimit, e cila përfshin disa fshatra si: Çagllavicë, Preoc, Llapje Sellë etj. në të cilat jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë serbe. Distanca nga “Albi Mall” deri në Graçanicë është 5.5 kilometra. Kjo distancë është e ilustruar në hartën e mëposhtme. Pikërisht, afërsia e “Albi Mall” me Graçanicën dhe fshatrat e tjera me popullsi serbe në afërsi kanë qenë arsyeja që na ka shtyrë të mendojmë se kjo qendër tregtare mund të jetë një vatër e përshtatshme kontakti midis folësve të shqipes dhe të serbishtes, sepse frekuentohet edhe nga shqiptarët, por edhe nga serbët. Respondentët të cilët i kemi anketuar në këtë qendër tregtare kanë qenë kryesisht shitëset dhe shitësit në dyqanet që gjenden aty. Në “Albi Mall” kemi bërë anketime dhe intervista në 28 dyqane, ndërkaq dyqanet në të cilat i kemi kryer anketat dhe intervistat janë: *Sport*

*Fashion, Optika Daci, Orsay, Lacoste, Celio, Nota, Top-Shop, Mayoral, Bostangroup, Golden Rose, Shoe Art, LTB Graffiti, Puma, Tamaris, Sport Fashion Kids, Tom Taylor, Parfois, Geox, Oliver Weber, Golden Point, Oltre, Grace, Fashion Ave, Özdilek, Magma Haus, Neptun, Triumph, Trio Casa.* Gjithsej, i kemi anketuar 39 respondentë, nga të cilët 32 kanë qenë shitëse femra dhe 7 meshkuj. Këtu të shtojmë se në dy raste, shitëset kanë refuzuar të anketohen me arsyetimin se janë në orar të punës dhe janë nën vëzhgimin e kamerave.

Anketimi tjetër është kryer në një vendndodhje tjetër në qendër të Prishtinës. Pikërisht, duke marrë për bazë vendndodhjen dhe distancën më të largët me komunën e Graçanicës dhe me fshatrat në të cilat jeton popullata serbe përreth, kemi vendosur të bëjmë anketa dhe intervista me shitëset dhe shitësit në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë. Pallati i Rinisë dhe Sporteve është një qendër tregtare, sportive e kulturore që gjendet në qendër të qytetit të Prishtinës. Arsyeja që na ka shtyrë të bëjmë anketa dhe intervista edhe në këtë lokacion ka largësi e këtij objekti me “Albi Mall” dhe me Graçanicën dhe sa ka ndikuar kjo largësi në dëndurinë eventuale të kontakteve dhe të ndërkomunikimit. Po ta shihni hartën më poshtë, do të vëreni se distanca midis Pallatit të Rinisë dhe “Albi Mall” është 5.9 km. Në anën tjetër, distanca nga Pallati i Rinisë deri në Graçanicë është 10 km. Pra, për dallim nga “Albi Mall”, pallati i Rinisë gjendet më në qendër të qytetit të Prishtinës dhe në distancë më të largët me Graçanicën.

Në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve kemi bërë anketime dhe intervista në 18 dyqane, ndërkaq dyqanet në të cilat i kemi kryer anketat dhe intervistat janë: *Elite, Silver, Mega, Bella, Ylli, Riça Company, Fashion Network, Lord, Sport Fashion, On Off, La Moda, No End, Runners, Arta, Nike Shop, Tissot, Impression.* Në Pallatin e Rinisë janë anketuar dhe intervistuar 22 respondentë, nga të cilët 5 kanë qenë meshkuj dhe 17 shitëse femra.

Anketimi i kryer në këto dy qendra tregtare është bërë jo vetëm me qëllim të marrjes së mostrave për hulumtim në dy vendndodhje të ndryshme, por edhe me qëllim të krahasimit të të dhënave dhe rezultateve nga këto dy vendndodhje, si dhe ndikimit që mund të ketë distanca gjeografike në rezultatet e hulumtimit.

Hulumtimi që kemi kryer me studentë dhe në dy qendra tregtare që u përmendën, ndonëse në elementet kryesore mund të quhet hulumtim sasior, ka edhe shumë elemente të hulumtimit cilësor, prandaj, me fjalë të tjera, mund të konsiderohet si i kombinuar. Në vazhdim po japim të dhënat dhe rezultatet kryesore, si dhe përfundimet përkatëse lidhur çështjet të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit.

## **1.2. Rezultatet dhe gjetjet**

Pyetja e parë e cila u është parashtruar të gjithë të anketuarve ka pasur për


qëllim të na japë një pasqyrë se sa e njohin dhe flasin serbishten të anketuarit. Kjo pyetje u është bërë edhe studentëve të anketuar, edhe shitësve në qendrat tregtare. Kështu, në pyetjen **“A e flitni gjuhën serbe”**, nga numri i përgjithshëm prej 173 të anketuarve, studentë dhe shitës në qendra tregtare kemi marrë këto përgjigje: 10 prej tyre apo 5.78% janë deklaruar se e flasin serbishten shumë mirë, 11 apo 6.35% kanë deklaruar se e flasin mirë, 8 të anketuar apo 4.62% kanë deklaruar se e flasin serbishten por kanë filluar ta harrojnë, 21 apo 12.13% janë shprehur se nuk e flasin mirë dhe 123 apo 71.09% të të anketuarve janë deklaruar se nuk e flasin fare. Këto të dhëna janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

STRUKTURA	Po, e flas shumë mirë	E flas mirë	E flas, por kam filluar ta harroj	Nuk e flas mirë	Jo, nuk e flas fare
Meshkujt	5	3	2	7	13
Femrat	5	8	6	14	110
<b>Totali</b>	10	11	8	21	123
<b>Përqindja</b>	5.78%	6.35%	4.62%	12.13%	71.09%

**Tabela 1**

Të dhënat flasin qartë se nga numri i përgjithshëm i të anketuarve shumica absolute e tyre janë deklaruar se ose nuk e flasin fare, ose nuk e flasin mirë. Numri i të anketuarve që janë deklaruar se e flasin shumë mirë gjuhën serbe është jashtëzakonisht i vogël dhe në këtë grup bëjnë pjesë kryesisht persona mbi moshën 30 vjeçare. Kur merret parasysh fakti se shumica e të anketuarve janë të rinj, atëherë është krejtësisht e qartë që te brezat e rinj të shqiptarëve të Kosovës me nuk mund të gjenden folës dygjuhësh që flasin edhe shqipen, edhe serbishten. Këto të dhëna janë një dëshmi e qartë se dygjuhësia në të folur shqip-serbisht në Kosovë është në zhdukje e sipër. Në grafikun e më poshtëm janë të pasqyruara rezultatet sipas përgjigjeve që kemi marrë, të cilat ilustrojnë më së miri konstatimet që u bënë pak më parë.





**Grafiku 7**


Në anketën me studentë në këtë pyetje i kemi marrë këto rezultate. Nga 112 të anketuar, vetëm 4 ose 3.54% janë deklaruar se e flasin shumë mirë dhe 9 të anketuar apo 8% janë shprehur se e flasin mirë serbishten. Të anketuarit e tjerë janë deklaruar në këtë mënyrë: 4 apo 3.5% janë deklaruar se e flasin, por kanë filluar ta harrojnë, ndërkaq 13 ose 11.60% dhe 82 73.2% janë deklaruar se nuk e flasin mirë ose nuk e flasin fare. Këto të dhëna janë të pasqyruara në tabelën në vijim.

STRUKTURA	Po, e flas shumë mirë	E flas mirë	E flas, por kam filluar ta harroj	Nuk e flas mirë	Jo, nuk e flas fare
Meshkujt	2	3	0	6	7
Femrat	2	6	4	7	75
<b>Totali</b>	4	9	4	13	82
<b>Përqindja</b>	3.5%	8.0%	3.5%%	11.60%	73.2%

**Tabela 2**

Këto të dhëna flasin qartë se numri i atyre studentëve që flasin gjuhën serbe është jashtëzakonisht i vogël dhe këtu bëjnë pjesë kryesisht studentë të nivelit të

studimeve të doktoratës dhe që janë më të vjetër se 15 vjeç. Të tjerët, pothuaj 85%, janë deklaruar se në përgjithësi nuk e flasin gjuhën serbe. Grafiku i në vijim paraqet këto rezultate.



**Grafiku 8**

Me qëllim që t'i krahasojmë deklaratimet e studentëve me nivelin e zotërimit të serbishtes nga ta, atyre u është dhënë një fjali që ta përkthejnë në gjuhën shqipe. Kështu, nga studentët është kërkuar ta përkthejnë këtë fjali të përbërë:

***Znanje je izvor radosti i blagostanja u životu i zato svako mora da se potruđi i da uči što više.***

Nga të gjithë të anketuarit, vetëm 7 prej tyre ose 6.25% e kanë përkthyer saktë fjalinë, 4 ose 3.5% kanë bërë përkthim deri diku të saktë, ndërkaq 101 të anketuar ose 90.1% nuk e kanë përkthyer fare. Këto rezultate janë të pasqyruara në vijim.

Struktura	Përkthim i saktë	Deri diku i saktë	Nuk është përkthyer
Meshkujt	2	3	13
Femrat	5	1	88
<b>Totali</b>	7	4	101
<b>Përqindja</b>	6.25%	3.5%	90.1%

**Tabela 3**



Grafiku 9

Nga të dhënat që u paraqitën këtu vërehet se ka një përkim të madh midis deklarimeve të të anketuarve lidhur me zotërimin e gjuhës serbe dhe zotërimit praktik të tyre. Shifra prej 90% e të anketuarve që nuk kanë arritur ta përkthejnë fjalinë që u është dhënë përkton në masë të madhe me shifrat e atyre që janë deklaruar se nuk e flasin serbishten, se nuk e flasin mirë ose që kanë filluar ta harrojnë. Edhe këto të dhëna janë një dëshmi shtesë se serbishtja zotërohet shumë pak, për të mos thënë aspak, nga të rinjtë.

Pyetja tjetër e drejtpërdrejtë që u është bërë studentëve ka qenë lidhur me vatrën e kontaktit eventual me folës të serbishtes. Studentët janë pyetur se ***Në cilat vende (hapësira) ju ka rastisur që eventualisht të komunikoni me folës të serbishtes?*** Shumica absolute e të intervistuarve, sidomos studentët e rinj, janë deklaruar se nuk ju ka rastisur të kenë kontakte ndërkomunikuese me folës të serbishtes. Një pjesë e tyre janë deklaruar se kanë dëgjuar njerëz të flasin serbishte në qytetet e Kosovës, si: në zonat e Prizrenit, në Kamenicë në rrugë dhe institucione shkollore ku frekuentojnë serbë vendas, në pushime jashtë Kosovës (Ulqin, Podgoricë), Prishtinë, Obiliq, Mitrovicë, Graçanicë, Rahovec, Klinë, në supermarkete dhe në rrjetet sociale. Ata pak studentë që janë deklaruar se kanë pasur dhe kanë herë pas herë kontakte ndërkomunikuese kanë qenë studentë që janë të punësuar dhe se këto kontakte i kanë kryesisht në vendin e tyre të punës, si p.sh. një studentë i doktoratës që punon si polic, ka deklaruar se ka kontakte me serbë në mbledhje, kur marrin pjesë policë serbë të Kosovës. Sikurse në anketimin e vitit 2011, nuk kemi marrë asnjë përgjigje që do të

dëshmonte se domenet si fqinjësia dhe shkolla janë vatra të kontaktit midis folësve të shqipes dhe serbishtes.


Pyetja tjetër që u është bërë studentëve ka qenë pyetje më tepër hipotetike. Pyetja ka pasur për qëllim të kuptonte se në rast të ndonjë situatë, në të cilën do të mund të kishte ndërkomunikim eventual midis të anketuarve dhe folësve të serbishtes, cili kod do të përdorej për komunikim nga të anketuarit. Kështu, në pyetjen: ***Nëse do të takoheshit me ndonjë person që e ka gjuhë amtare serbishten, me çfarë gjuhe do të komunikonit me të?***, kemi marrë këto përgjigje: 8 të anketuar studentë ose 7.1% janë shprehur se do të komunikonin ose do të përpiqeshin të komunikonin në gjuhën serbe. 41 të anketuar ose 36.6% janë deklaruar se do të komunikonin në gjuhën shqipe dhe presin që edhe bashkëbiseduesi të flasë shqip, ndërkaq 58 ose 51.7% janë shprehur se do të komunikonin në gjuhën angleze, apo në ndonjë gjuhë tjetër të huaj. Vetëm 5 studentë të anketuar ose 4.4% janë deklaruar se nuk do të komunikonin fare me folës të serbishtes.

Struktura	Do të (përpiqesha) komunikoj në gjuhën serbe	Do të komunikoj në gjuhën shqipe, pres që edhe bashkëbiseduesi të flasë shqip	Do të komunikoj në gjuhën angleze apo në ndonjë gjuhë tjetër të huaj	Nuk do të komunikoj fare
Meshkujt	3	10	5	0
Femrat	5	31	53	5
<b>Totali</b>	8	41	58	5
<b>Përqindja</b>	7.1%	36.6%	51.7%	4.4%

**Tabela 4**

Ata të cilët janë deklaruar se në rastet e kontaktit eventual me folës të serbishtes do të flitnin apo përpiqeshin të flitnin në gjuhën serbe janë kryesisht të anketuarit të cilët janë deklaruar se e njohin gjuhën serbe. Por, të dhënat e bëjnë të qartë se në rastet e kontaktit eventual midis folësve të rinj të shqipes nuk mund të pritët që folësit e shqipes të komunikojnë apo të përpiqen të komunikojnë në serbishte. Pavarësisht arsyeve të tjera, komunikimi në serbishte nuk mund të ndodh për një arsye të thjeshtë – folësit e rinj të shqipes nuk e flasin serbishten. Është e qartë që ndonjë pjesa dërmuese nuk do ta refuzonin komunikimin, kodi i cili do të përdorej për komunikim

do të ishte eventualisht anglishtja si *lingua franca*. Këto të dhëna janë të ilustruara në grafikun e mposhtëm.




Grafiku 10

Pyetja e fundit në anketën me studentë ka pasur për qëllim ta shohë interesimin e tyre për ta mësuar serbishten. Në pyetjen: ***A keni dëshirë ta mësoni gjuhën serbe?***, përgjigjet e të anketuarve kanë qenë të ndara. 24 studentë ose 21.4% janë deklaruar se kanë shumë dëshirë ta mësojnë dhe 22 ose 19.6% janë shprehur se kanë deri diku dëshirë ta mësojnë gjuhën serbe. Në anën tjetër, 22 ose 19.6% janë shprehur se kanë pak dëshirë ta mësojnë dhe 33 prej tyre ose 29.4% kanë deklaruar se nuk kanë aspak dëshirë ta mësojnë serbishten. 11 të anketuar ose 9.8% nuk janë deklaruar dhe këta janë kryesisht ata studentë që kanë deklaruar se e flasin gjuhën serbe. Më poshtë po japim tabelën dhe grafikun përkatës me të dhënat që i kemi marrë.

Struktura	Kam shumë dëshirë ta mësoj	Deri diku kam dëshirë ta mësoj	Kam pak dëshirë ta mësoj	Nuk kam aspak dëshirë ta mësoj	Pa përgjigje
Meshkuj	6	4	4	1	3
Femra	18	18	18	32	8
<b>Totali</b>	24	22	22	33	11
<b>Përqindja</b>	21.4%	19.6%	19.6%	29.4%	9.8%

Tabela 4



Grafiku 11


Rezultate që dalin nga anketimi me studentë hedhin në pah disa konstatime themelore. Së pari, është e qartë që brezat e rinj të studentëve nuk e njohin dhe nuk e flasin gjuhën shqipe. Së dyti, të rinjtë shqipfolës e kanë krejtësisht të reduktuar kontaktin me folës të serbishtes dhe u mungon krejtësisht ndërkomunikimi. Sigurisht, kjo mungesë e kontaktit është duke ndodhur si pasojë e zhdukjes së domeneve të qëndrueshme të komunikimit, siç mund të jenë fqinjësia dhe shkolla. Vatrat potenciale të kontaktit që mund të krijohen janë kryesisht sporadike dhe të çastit. Me fjalë të tjera, zhdukja e domeneve të qëndrueshme të komunikimit midis folësve të shqipes dhe të serbishte, siç kemi thënë më herët, ka pasur si rezultat shthurjen e bashkësive komunikuese shqiptaro-serbe, të cilat kanë ekzistuar në të kaluarën. Së treti, si pasojë e mungesës së komunikimit, por edhe për shkak të ndikimit të faktorëve politikë, ekonomikë e kulturorë, të shqiptarët janë rritur prirjet për vetëvlerësimin e shqipes dhe ka ndodhur humbja e prestigjit të dikurshëm të serbishtes. Kjo vërehet më së miri nga të dhënat që i kemi marrë lidhur me kodet që do të përdoreshin në situata hipotetike të komunikimit dhe nga dëshira që kanë studentët e rinj ta mësojnë gjuhën serbe. Shumica e atyre që kanë deklaruar se do të kishin dëshirë ta mësonin serbishten janë arsyetuar me thënien “sa më shumë gjuhë që flet, aq më shumë vlen”, por nuk konsiderojnë se serbishtja është një gjuhë që u nevojitet.

Anketa tjetër me shitës në dy qendra tregtare të Prishtinës ka nxjerrë në pah të dhëna edhe më interesante. Në qendrën tregtare “Albi Mall”, në pyetjen standarde për

të gjitha anketat *A e flitni gjuhën serbe?*, nga 39 të anketuar shitës në dyqanet e ndryshme, kemi marrë përgjigjet në vijim. 3 shitës ose 7.6% janë deklaruar se e flasin serbishten shumë mirë. Nga këta tre, një shitës dhe një shitëse kanë qenë të moshës mbi 40 vjeçare dhe një shitëse tjetër e anketuar ka pasur lidhje familjare me boshnjakë. Një i anketuar ose 2.5% është deklaruar se e flet mirë dhe një tjetër që e flet por që ka filluar ta harrojë. Pjesa tjetër e të anketuarve, kryesisht vajza të reja të moshës nga 20-30 vjeç janë deklaruar që ose nuk e flasin mirë (5 ose 12.8%), ose nuk e flasin fare (29 ose 74.3%). Në përgjithësi, mbi 87% të të anketuarve, në fakt i takojnë grupit që nuk e flasin serbishten. Të dhënat janë të pasqyruara në tabelën dhe grafikun e mposhtëm.

STRUKTURA	Po, e flas shumë mirë	E flas mirë	E flas, por kam filluar ta harroj	Nuk e flas mirë	Jo, nuk e flas fare
Meshkujt	1	0	0	0	6
Femrat	2	1	1	5	23
<b>Totali</b>	3	1	1	5	29
<b>Përqindja</b>	7.6%	2.5%	2.5%	12.8%	74.3%

Tabela 5




Grafiku 12

Ndërkaq, nga 22 shitës të anketuar në Pallatin e Rinisë, në pyetjen e njëjtë kemi marrë këto rezultate: 3 të anketuar ose 13.6% janë deklaruar se e flasin serbishten

shumë mirë, 1 (4.5%) është deklaruar se e flet mirë, 3 (13.6%) janë deklaruar se e flasin, por kanë filluar ta harrojnë, 3 të tjerë (15.6%) janë deklaruar se nuk e flasin mirë dhe më shumë se gjysma e tyre (12 ose 54.4%) janë deklaruar se nuk e flasin fare serbishten). Të dhënat janë pasqyruar në tabelën dhe grafikun në vijim.

STRUKTURA	Po, e flas shumë mirë	E flas mirë	E flas, por kam filluar ta harroj	Nuk e flas mirë	Jo, nuk e flas fare
Meshkujt	2	0	2	1	0
Femrat	1	1	1	2	12
<b>Totali</b>	3	1	3	3	12
<b>Përqindja</b>	13.6%	4.5%	13.6%	13.6%	54.5%

Tabela 6




Grafiku 13

Është e qartë se edhe në mesin e të anketuarve në Pallatin e Rinisë, shumica janë shprehur se nuk e flasin gjuhën serbe. Mosnjohja e serbishtes nga të anketuarit në të të gjitha anketat dëshmon qartë se dygjuhësia në të folur shqip-serbishte te shqiptarët në Kosovë është në zhdukje e sipër. Në tabelën e mëposhtme po japim



grafikun i cili pasqyron rezultatet e të gjithë të anketuarve sipas lokacionit lidhur me pyetjen se sa e njohin serbishten të anketuarit.




### A e flitni gjuhën serbe?

Më tej, duke u nisur nga hipoteza se qendrat tregtare janë vatra potenciale të kontaktit, për shkak të frekuentimit të madh të qytetarëve në to, të anketuarit në dy qendra tregtare i kemi pyetur lidhur me dendurinë e kontakteve eventuale me myshterinj që flasin serbisht. Këtu kemi supozuar se në këtë kategori mund të përfshihen edhe folësit e boshnjakishtes, por në këtë studim nuk kemi bërë dallimin midis këtyre dy gjuhëve sllavojugore. Në pyetjen ***A keni shpesh kontakt me folës të serbishtes në vendin tuaj të punës (folës serbë që vijnë për të blerë gjësende)?***, në “Albi Mall” kemi marrë këto përgjigje. 20 të anketuar ose 51.2% janë shprehur se kanë kontakte pothuaj të përditshëm me myshterinj serbë që u vijnë në dyqan. 9 (23%) të anketuar janë përgjigjur se kanë kontakte së paku 2-3 herë në javë, 9 të tjerë, po ashtu 23%, janë shprehur se kanë kontakte të herëpashershme me folës të serbishtes që vijnë në dyqan dhe vetëm 1 (2.5%) është deklaruar se ka kontakt të rrallë me folës të serbishtes. I anketuari që ka deklaruar se ka kontakte të rralla në dyqan, në fakt ka qenë një mashkull i moshës mbi 40 vjeç, i cili për shkak të natyrës së tij nuk qëndronte gjithmonë në dyqan. Të dhënat që na dalin këtu dëshmojnë qartë se kjo qendër tregtare është e frekuentuar mjaft nga serbët dhe situatat e kontaktit janë mjaft të

shpeshta. Këto rezultate kanë vërtetuar hipotezën se afërsia e “Albi Mall” me Graçanicën e bën këtë qendër të frekuentuar nga serbët.

Struktura	Kemi kontakt të përditshëm	Kemi kontakt së paku 2-3 herë në javë	Kemi kontakt herë pas here	Kemi kontakt rrallë
Meshkujt	2	2	3	0
Femrat	18	7	6	1
<b>Totali</b>	20	9	9	1
<b>Përqindja</b>	51.2%	23.0%	23.0%	2.5%

Tabela 7




Grafiku 14

Të dhënat që i kemi marrë për pyetjen e njëjtë nga të anketuarit në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë dalin më ndryshe. Nga të anketuarit në Pallatin e Rinisë 4 prej tyre ose 18.1% janë shprehur se kanë kontakt pothuajse të përditshëm me folës të serbishtes, 2 (9%) janë përgjigjur se ndodh të kenë kontakt së paku 2-3 herë në javë, 8 (36.3%) të anketuar janë shprehur se kanë kontakt herë pas here dhe 8 të tjerë (po ashtu 36.3%) janë deklaruar se rrallë u ndodh të kenë kontakt me

myshterinj që flasin serbisht në dyqanin e tyre. Të dhënat në tabelë dhe paraqitja grafike ilustronë këto rezultate.

Struktura	Kemi kontakt të përditshëm	Kemi kontakt së paku 2-3 herë në javë	Kemi kontakt herë pas here	Kemi kontakt rrallë
Meshkujt	1		2	2
Femrat	3	2	6	6
<b>Totali</b>	4	2	8	8
<b>Përqindja</b>	18.1%	9.0%	36.3%	36.3%


Tabela 8



Grafiku 15

Nëse i krahasojmë të dhënat nga “Albi Mall” me ato të Pallatit të Rinisë lidhur me dendurinë e kontakteve midis shitësve shqipfolës dhe myshterinjve që flasin serbisht vërehet që denduria e kontakteve është me e shpeshtë në “Albi Mall” sesa në Pallatin e Rinisë. Pas përfundimit të luftës një pjesë e madhe e serbëve janë larguar nga

Prishtina dhe tani janë të përqendruar në komunën e Graçanicës dhe fshatrat përreth Prishtinës. Në brendi të qytetit të Prishtinës prania e serbëve është dukshëm më e vogël dhe kjo mbase arsyeton faktin që denduria e kontaktit në Pallatin e Rinisë del më e vogël. Në anën tjetër, për shkak të afërsisë së “Albi Mall” me Graçanicën, duket që denduria e kontaktit të jetë dukshëm më e madhe. Grafiku në vijim jep në mënyrë të krahasuar dendurinë e kontakteve midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes në këto dy qendra tregtare.



**A keni shpesh kontakt me folës të serbishtes në vendin tuaj të punës (folës serbë që vijnë për të blerë gjësende)?**

Më tej, të anketuari në të dy qendrat tregtare janë pyetur se përveç në vendin e punës, a u ka ndodhur të kenë kontakt me folës të serbishtes gjetkë. Nga 39 të anketuar, shitës/e në shitoret në “Albi Mall”, 34 kanë deklaruar se përveç në vendin e punës, pra në shitoret ku punojnë, nuk kanë pasur kontakt komunikues me folës të serbishtes në ndonjë vend tjetër. Vendi i punës mbetet ekskluzivisht vendi i vetëm i kontaktit me folës të serbishtes dhe mundësia e vetme për interaksion komunikues. Vetëm 5 persona kanë deklaruar se ju ka ndodhur rrallë të kenë kontakte jashtë vendit të punës. Njëri prej tyre, i anketuar i gjinisë mashkullore 43 vjeçar, tha që zakonisht kur kthehet nga Prishtina në Gjilan, ndodh që në Graçanicë të hipin në autobus serbë

dhe aty ndodh kontakti i kufizuar. Një person tjetër i anketuar, i gjinisë mashkullore, 23 vjeçar, deklaroi se ka pasur kontakt vetëm me policë serbë të Kosovës kur është ndalur ne trafik nga ta. Tri të anketuara të gjinisë femërore kanë deklaruar se kanë kontakte familjare për faktin se në familjet e tyre kanë pjesëtarë boshnjakë. Ndërkaq, nga 22 të anketuar, shitës/e në shitoret në Pallatin e Rinisë, 20 prej tyre janë deklaruar se përveç në vendin e punës, nuk u ndodh të kenë kontakt me folës të serbishtes gjetiu. Vetëm një respondente është deklaruar se i ka rastisur që në qytet ta ndalin folës të serbishtes për ta pyetur lidhur me vendndodhjen e një rruge të caktuar dhe një tjetër që ka pohuar se ka pasur kontakt me policë serbë të Kosovës.


Po t'i krahasojmë të dhënat lidhur me domenet e tjera të kontaktit, nga anketa me studentë dhe në qendra tregtare, mund të konstatojmë se domeni i punës mbetet domeni i vetëm i kontaktit midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes. Domenet e tjera, siç janë, fqinjësia, shkolla etj. ose janë shuar, ose janë në shuarje e sipër. Këtu duhet shtuar se kontakti midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes, ndonëse është duke u zhdukur nga domenet kryesore klasike të përcaktuara nga Joshua Fishman, mbase mund të shfaqet në një domen tjetër, ta quajmë virtual, siç janë rrjetet sociale, domen ky i cili duhet t'u shtohet domeneve të tjera të përcaktuara nga Fishman-i.

Duke u nisur nga fakti se në këto qendra tregtare situatat e kontaktit ndodhin me një denduri të konsiderueshme, interesimi tjetër yni ka pasur të bëjë me kodin gjuhësor, i cili përdoret në ato situata të ndërkomunikimit. Në këtë kuptim, të anketuari janë pyetur: ***Kur ndodh të keni kontakt me ndonjë person që flet serbisht (që vjen në dyqan), me çfarë gjuhe do të komunikoni me të?*** Përgjigjet të cilat i kemi marrë nga të anketuarit në “Albi Mall” janë këto: 5 të anketuar ose 12.8% janë shprehur se komunikojnë në gjuhën serbe; 2 ose 5.1% janë shprehur se komunikojnë vetëm shqip dhe se nuk u intereson se a kuptohen apo jo; 3 (7.6%) prej tyre janë deklaruar se flasin shqip, ndërkohë që myshterinjtë flasin serbisht dhe pasta komunikojnë edhe me gjeste dhe 29 të anketuar ose 74.3% janë shprehur se komunikojnë në gjuhën angleze, apo duke i përzier gjuhët dhe duke përfshirë edhe komunikimin joverbal me gjeste.

<b>Struktura</b>	<b>Komunikoj në gjuhën serbe</b>	<b>Komunikoj në gjuhën shqipe</b>	<b>Unë flas shqip, ai/ajo flet serbisht</b>	<b>Komunikoj në gjuhën angleze apo duke i përzier gjuhët</b>
<b>Meshkujt</b>	1	0	0	6
<b>Femrat</b>	4	2	3	23
<b>Totali</b>	5	2	3	29
<b>Përqindja</b>	12.8%	5.1%	7.6%	74.3%

**Tabela 9**

Më tej, këto forma të komunikimit i kemi diskutuar me të anketuarit për ta parë se si ec procesi i komunikimit. Disa të anketuar janë shprehur se, duke qenë se zakonisht kur vijnë myshterinj serbë në dyqan, ata pyesin për mallra dhe për çmime në gjuhën serbe ose angleze. Ka edhe prej tyre që pyesin me fjali të thjeshta në gjuhën shqipe, p.sh. “*sa kushton*”. Në këtë situatë shitëset përgjigjen ose në gjuhën angleze, ose duke marrë kalkulatorin, duke shtypur çmimin me ose pa ulje, dhe duke ua treguar myshterinjve. Pra, intensiteti i kontaktit duket të jetë mjaft i limituar. Ndryshe, shumica e të anketuarve, janë shprehur se serbët që vijnë të blejnë në dyqan ose e dinë shqipen, ose e kuptojnë, sidomos brezat më të vjetër. Kur i kemi pyetur se nga e kanë fituar këtë përshtypje, të anketuarit janë shprehur se kur ua tregojnë çmimet ose kur u thonë diçka në gjuhën shqipe lidhur me mallin, ata nuk bëjnë pyetje tjera, por lënë përshtypjen se e kanë kuptuar. Nga dy shitëse të anketuara, në dy dyqane të ndryshme, kemi marrë edhe një vëzhgim mjaft interesant. Ato kanë deklaruar se zakonisht kur u vijnë myshterinj serbë në dyqan, vijnë nga 2 ose 3 dhe asnjëherë nuk u ka ndodhur të vijë një i vetëm. Nga këta dy-tre myshterinj që vijnë gjithmonë ndodh që njëri të flasë, apo të kuptojë shqip dhe komunikimi pastaj bëhet nëpërmjet tij.




**Grafiku 16**

Nga të dhënat që kemi marrë, kemi vërejtur që ata të cilët e flasin serbishten nuk kanë hezituar të shprehen se do të komunikonin serbisht me myshterinj serbë. Të tjerët që nuk e flasin serbishten dhe që kanë qenë në numër më të madh, janë shprehur se kryesisht komunikojnë në anglishte, aq sa e njohin, por edhe nëpërmjet formave të ndryshme ndihmëse të komunikimit joverbal me gjeste. Në këtë mes, anglishtja del si *lingua franca* e komunikimit midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes. Më tej, sa i përket sasisë së informatave të shkëmbyera në procesin e komunikimit, kemi konstatuar se shkëmbimi verbal i informatave del mjaft i kufizuar. Zakonisht komunikimi fillon me një pyetje dhe përfundon me përgjigjen përkatëse. Të anketuarit janë shprehur se rrallë u ndodh që myshterinjtë serbë, pasi të kenë pyetur për çmim, apo nëse çmimi është në ulje, të pyesin më tepër për ndonjë gjë tjetër dhe çdo gjë përfundon me një “*faleminderit*” nga ana e tyre.

Në Pallatin e Rinisë, në pyetjen e njëjtë kemi marrë këto rezultate: 4 ose 18.1% të anketuar kanë deklaruar se komunikojnë në gjuhën serbe (të gjithë ata që kanë thënë se dinë të flasin serbisht), 3 (13.6%) janë shprehur se komunikojnë në gjuhën shqipe, duke sqaruar si në rastin e “Albi Mall” se nuk çajnë kokën se a kuptohen apo jo, 3 të anketuar (16.6%) dhe një tjetër (4.5%) janë shprehur se komunikojnë duke folur në shqipe gjersa, myshterinjtë flasin serbisht dhe duke përzier shqipen me serbishten aty-këtu, dhe 11 të anketuar ose 50% kanë deklaruar se komunikojnë në anglishte, duke përzier gjuhët dhe me gjeste si forma të komunikimit joverbal.

Struktura	Komunikoj në gjuhën serbe	Komunikoj në gjuhën shqipe	Unë flas shqip, ai/ajo flet serbisht	Komunikoj duke përzier herë shqipen, herë serbishten	Komunikoj në gjuhën angleze apo duke i përzier gjuhët
Meshkujt	2	0	1	0	1
Femrat	2	3	2	1	10
<b>Totali</b>	4	3	3	1	11
<b>Përqindja</b>	18.1%	13.6%	16.6%	4.5%	50.0%

Tabela 10



Grafiku 17

Të dhënat nga këto grupe të të anketuarve flasin qartë që komunikimi i folur midis folësve të shqipes dhe të serbishtes në Kosovë ka filluar të bëhet gjithnjë e më i vështirë për të mos thënë i pamundur. Sa u përket shqiptarëve, ky komunikim është duke u vështirësuar kryesisht për shkak të mosnjohjes së serbishtes nga brezat e rinj. Të dhënat nga të gjitha anketat që kemi kryer (2011,2014) tregojnë qartë se folësit e shqipes që e dinë serbishten, kryesisht brezat e mesëm dhe të vjetër, nuk do të hezitonin ta përdornin në komunikim me folës të serbishtes. Por, në anën tjetër, të




rinjtë, të cilët në shumicë nuk e flasin serbishten tregojnë indiferencë ndaj saj dhe më tepër janë të prirë ta përdorin anglishten si *lingua franca*, sikurse që do të vepronin në rastet e kontaktit edhe me folës të gjuhëve të tjera.

Në anketimet me shitës/e në dy qendrat tregtare të Prishtinës jemi përpjekur të shohim gjithashtu se cilat janë qëndrimet ndaj folësve të serbishtes. Ballafaqimi gjuhësor nuk është thjesht vetëm një akt komunikues, por në shumë raste është edhe ballafaqim identitetesh të ndryshme. Në rastin tonë, kemi qenë të interesuar se çfarë pikëpamjesh kanë shitësit e dyqaneve në këto dy qendra tregtare ndaj myshterinjve që u shkojnë në dyqan dhe flasin serbisht. Të anketuarve në “Albi Mall” dhe në Pallatin e Rinisë u është bërë pyetja se **“çfarë përshtypje kanë për folësit e serbishtes që ju vijnë si myshterinj në dyqan”**. Në “Albi Mall” kemi marrë përgjigjet në vijim: 7 prej tyre ose 17.9% kanë deklaruar se për myshterinjtë që flasin serbisht që u vijnë në dyqan kanë përshtypje shumë të mirë dhe se janë të sjellshëm, 2 të anketuar (5.1%) janë shprehur se për disa kanë përshtypje të mirë, për disa jo, ndërkaq 25 të anketuar ose 64.1% kanë shprehur qëndrim indiferent duke u deklaruar se nuk kanë ndonjë mendim për ta dhe se interesimi i tyre i vetëm për ta është t’i shohin si myshterinj, të cilëve u shesin mall. Në anën tjetër, 5 të anketuar (12.8%) kanë shprehur qëndrim negativ, duke u shprehur se këta myshterinj nuk u pëlqejnë aspak dhe me dëshirë nuk do të donin t’i takonin. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë këto pikëpamje.

Struktura	Kam përshtypje shumë të mira, janë të sjellshëm	Për disa kam përshtypje të mira, për disa të tjerë jo	Nuk mendoj shumë për ta, më interesojnë vetëm si myshterinj t’ju shes mall	Nuk më pëlqejnë aspak, me dëshirë nuk do të kisha dashur t’i takoj
Meshkujt	1	0	4	2
Femrat	6	2	21	3
<b>Totali</b>	7	2	25	5
<b>Përqindja</b>	17.9%	5.1%	64.1%	12.8%

Tabela 11




Grafiku 18

Në anën tjetër, në Pallatin e Rinisë kemi marrë këto përgjigje: 4 të anketuar ose 18.1% kanë deklaruar se kanë përshtypje shumë të mirë për myshterinjtë serbë dhe se janë të sjellshëm, po ashtu 4 të anketuar të tjerë (18.1%) janë shprehur se për disa kanë përshtypje të mira, për disa jo, ndërkaq 13 të anketuar ose 59.0% janë shprehur indiferentë duke deklaruar se nuk kanë ndonjë mendim, por thjeshtë i shohin si myshterinj. Në Pallatin e Rinisë vetëm një i anketuar (4.5%) është shprehur se nuk i pëlqejnë myshterinjtë që flasin serbishte. Edhe këto rezultate janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun përkatës.


Struktura	Kam përshtypje shumë të mira, janë të sjellshëm	Për disa kam përshtypje të mira, për disa të tjerë jo	Nuk mendoj shumë për ta, më interesojnë vetëm si myshterinj t'ju shes mall	Nuk më pëlqejnë aspak, me dëshirë nuk do të kisha dashur t'i takoj
Meshkujt	3	1	1	0
Femrat	1	3	12	1
<b>Totali</b>	4	4	13	1
<b>Përqindja</b>	18.1%	18.1%	59.0%	4.5%

Tabela 12



**Grafiku 19**

Rezultatet tregojnë qartë se në të dy qendrat tregtare shumica e të anketuarve kanë shprehur qëndrim indiferent ndaj folësve të serbishtes dhe qëndrimi i tyre ka qenë më tepër i motivuar nga motivet komerciale. Në të dy anketat nuk është i vogël as vlerësimi pozitiv, pasi që edhe në “Albi Mall”, edhe në Pallatin e Rinisë 18% e të anketuarve kanë shprehur qëndrim pozitiv ndaj serbishtfolësve si myshterinj. Grafiku i mëposhtëm pasqyron në mënyrë të krahasuar qëndrimet dhe pikëpamjet që të anketuarit në “Albi Mall” dhe në Pallatin e Rinisë kanë shprehur lidhur me folësit serbë që i takojnë si myshterinj në dyqane.



### Çfarë përshtypje keni për folësit e serbishtes që ju vijnë si myshterinj në dyqan?

Në përgjithësi, anketat në qendra tregtare kanë dhënë një pasqyrë indikativë të zhvillimeve aktuale në fushën e kontakteve dhe të ndërkomunikimit midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes. Në këto hapësira ndodhin kontaktet e natyrshme ndërkomunikuese midis folësve të shqipes dhe të serbishtes dhe për këtë arsye kanë qenë me interes për t'u studiuar. Hulumtimi në këto qendra ka nxjerrë në pah disa fakte tashmë të konstatuara, por edhe fakte të tjera lidhur me dygjuhësinë e folur shqip-serbisht. Sikurse edhe në hulumtimin e vitit 2011 dhe në anketimin me studentë, edhe në anketimet me shitës dhe shitëse në “Albi Mall” dhe në Pallatin e Rinisë kemi konstatuar se dygjuhësia shqip-serbisht te brezat e rinj shqiptarë tashmë nuk ekziston. Duket që vitet 1983-1985 paraqesin përgjithësisht një kufi ndarës midis atyre që sadopak e flasin serbishten dhe aty që nuk e njohin fare. Në mesin e të lindurve para viteve '83-'85, sa më poshtë që shkohet ndër vite, shtohet numri i atyre që e kuptojnë dhe flasin serbishten, ndërkaq në mesin e të lindurve pas këtyre viteve numri i atyre që flasin serbisht është krejtësisht i paktë. Në këto rrethana aktuale politike, shoqërore e kulturore numri i atyre që nuk do të flasin serbisht do të rritet me ndërrimin e brezave.

Anketimet dhe intervistat në qendrat tregtare kanë dëshmuar se në rastet e kontaktit midis shitësve, kryesisht femra të reja, dhe folësve të serbishtes, për këta folës të shqipes kontakti paraqet një ballafaqim me një gjuhë, e cila është krejtësisht e huaj për ta, sikurse që do të ishte p.sh. gjermanishtja apo frëngjishtja. Për këtë kategori, vatra e vetme e kontaktit me folës të serbishtes është qendra tregtare dhe

dyqani në të cilin punojnë. Në këto situata, kur kontakti krijohet me ardhjen e myshterinjve serbë në dyqane, përshtypja e përgjithshme që kemi fituar nga të anketuarit ka qenë që pjesa dërmuese nuk hezitojnë të kontaktojnë me. Në përgjithësi, të anketuarit nuk kanë shprehur paragjykime negative ndaj tyre. Më tej, vendndodhja e këtyre dy qendrave tregtare na del jetë e rëndësishme për sa i përket dendurisë së kontakteve midis folësve të shqipes dhe të serbishtes. Sigurisht, në këtë pikë janë pasqyruar në mënyrë indikativë zhvillimet e fundit demografike pas vitit 1999 dhe përqendrimit e reja të popullsisë. Kontaktet midis folësve të shqipes dhe të serbishte në “Albi Mall” janë më të shpeshta dhe më të zakonshme. Edhe në Pallatin e rinisë dhe të Sporteve kontaktet midis folësve të shqipes dhe të serbishtes janë të zakonshme, por janë më të rralla. Kjo dukuri mund të shpjegohet me distancën që kanë këto dy qendra nga vendbanimet serbe përreth Prishtinës. Në bazë të vëzhgimeve josistematike kemi vërejtur që kontaktet e tilla nuk mungojnë as në qendrat e tjera tregtare në Prishtinë, shumica e të cilave gjenden në periferi. Fakti që distanca midis “Albi Mall” dhe komunës së Graçanicës është vetëm 5.5 kilometra, ndërkaq distanca midis Pallatit të Rinisë dhe Graçanicës është 10 kilometra, ka mbase rol vendimtar në dendurinë e kontaktit.

Sa i përket kodit që përzgjidhet për komunikim midis folësve të shqipes dhe të serbishtes në situatat e tilla të kontaktit, është krejtësisht e qartë që ky kod nuk është as serbishtja, as shqipja. Mosnjohja e gjuhës serbe ka ndikim të drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e një kodi tjetër. Në këto raste, anglishtja del si kodi kryesor, por që komunikimi shoqërohet në masë të madhe edhe me forma joverbale komunikuese dhe me gjepte. Hulumtimi ka dëshmuar se te të anketuarit ka mbizotëruar një përshtypje e përgjithshme se folësit e serbishtes e njohin, ose së paku e kuptojnë shqipen, sidomos brezat më të vjetër, por që nuk duan ta flasin. Duket që kjo qasje e tyre has në reagime refuzuese edhe tek ata folës të shqipes që e njohin serbishten që edhe ata të refuzojnë të flasin serbisht. Këtë përshtypje e kemi fituar nga intervistat me dy nga të anketuarit që janë shprehur se e njohin gjuhën serbe. Përgjigja që kemi marrë nga ta mund të përmbledhet në këto fjalë: “*ata boll mirë po kuptojnë shqip po s’po dojnë me fol, kështu që as na s’po ju flasim serbisht*”. Së këndejmi, mosnjohja e gjuhës, në radhë të parë, por edhe reflektimet refuzuese, bëjnë që anglishtja të dalë si *lingua franca* për komunikim.

Së fundi, anketimi dhe intervistat në qendrat tregtare kanë dëshmuar se të anketuarit nuk është se kanë shprehur paragjykime negative ndaj folësve të serbishte me të cilët ndodh të kenë ndërkomunikim. Shumica janë shprehur indiferentë dhe këtë indiferencë e kanë mbështetur me arsyetime komerciale se folësit e serbishtes i shohin si çdo myshteri tjetër. Në përgjithësi, qëndrimet negative ndaj folësve të serbishtes, së paku gjatë anketimeve dhe intervistave, kanë qenë të shprehura shumë pak nga të anketuarit.

Duke përmbledhur gjetjet gjatë anketimeve në këto dy vatra të kontaktit mund të konstatohet se në këto vatra ndodh komunikimi midis folësve të shqipësisë dhe të serbishtes. Ky komunikim është më i shpeshtë në zonat që janë në afërsi me vendbanimet serbe, por nuk mungon as në brendësi të qendrave që banohen në shumicë të madhe nga shqiptarët. Mosnjohja e gjuhës nga brezat e rinj shqipfolës bën që komunikimi midis folësve të shqipësisë dhe folësve të serbishtes të zhvillohet qoftë nëpërmjet një *lingua franca* (anglishtja), qoftë duke u shoqëruar me forma joverbale komunikuese dhe me gjeeste. Së fundi, gjatë këtij hulumtimi nuk kemi mundur të konstatojmë se te folësit e shqipësisë, të këtyre kategorive të anketuara, të gjejmë qëndrime negative ndaj serbishtfolësve, ose së paku këto qëndrime nuk janë shprehur hapas.

### **Përfundime**

Po bëhen gati tri dekada që kur ka filluar një proces gradual i zhdukjes së dygjuhësisë së folur shqip-serbisht te brezat e rinj të shqiptarëve të Kosovës. Ky proces i reduktimit të dygjuhësisë, i cili e ka zanafillën aty nga mesi i viteve '80 të shekullit të kaluar, është përshpejtuar ndjeshëm pas viteve 1999. Në këtë proces ndikimin vendimtar e kanë zhvillimet politike, të cilat kanë ndodhur në Kosovë në tri dekadat e fundit. Konflikti politik, pastaj ai ushtarak, i shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb, ka pasur për pasojë ndarjen etnike midis shqiptarëve dhe serbëve, sidomos në qendrat më të mëdha urbane të Kosovës. Më tej, zhvillimet politike kanë ndikuar edhe në ndryshimin e raporteve të fuqisë dhe të pushtetit, në kuptimin që fuqia e pushtetit politik ka kaluar nga serbët te shqiptarët dhe kjo ka ndodhur kryesisht për arsye demografike, sepse shqiptarët përbëjnë një shumicë absolute në Kosovë. Po ashtu, ka ndryshuar edhe kahu i komunikimit politik dhe kulturor, por jo edhe ekonomik. Përderisa Serbia vazhdon të jetë partneri kryesor ekonomik i Kosovës, komunikimi politik dhe kulturor i Kosovës ka ndërruar kahun dhe tash bëhet në pjesën dërmuese me Shqipërinë. Këto zhvillime kanë pasur ndikimin e vet të fuqishëm në raportet gjuhësore. Zhvillimet politike kanë ndikuar që serbishtja ta humbë prestigjin, të cilin e ka pasur në kohën e ish-Jugosllavisë, ndërkaq shqipja ka forcuar prestigjin e saj në Kosovë. Politika zyrtare gjuhësore në Kosovë promovon diskriminimin pozitiv për serbët dhe favorizon dygjuhësinë, e cila është përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës dhe e cila zbatohet në masë të konsiderueshme në institucionet qeverisëse. Problemet e caktuara në zbatimin e dygjuhësisë në institucione janë probleme të natyrës teknike e financiare. Megjithatë, përkundër kësaj politike zyrtare që promovon dygjuhësinë, realiteti gjuhësor në Kosovë, sidomos sa i

përket të folurit del të jetë tjetër. Të dhënat e anketimeve që kemi kryer më 2011 dhe 2014 japin disa indikacione të qarta. E para, dygjuhësia e folur shqip-serbisht në Kosovë te brezat e rinj tashmë është zhdukur. E dyta, disa domene të komunikimit, siç janë fqinjësia dhe shkolla, po ashtu janë zhdukur. Sa i përket vatrave aktuale të kontaktit, në to kanë vepruar forcat centrifugale duke e zhvendosur kontaktin nga qendrat e mëdha urbane, në zonat që gjenden në kufij të pikëtakimeve midis zonave të banuara me shqiptarë dhe zonave të banuara me serbë. Por, edhe në këto zona, ndonëse denduria e kontakteve të zakonshme dhe spontane del të jetë më e shpeshtë, intervalet e kontakteve midis folësve të shqipes dhe të serbishtes duket të jenë të shkurtra, po ashtu me shkëmbime gjuhësore të kufizuara. Në raste të tilla, për shkak të mosnjohjes së gjuhës, ndërkomunikimi bëhet kryesisht nëpërmjet anglishtes, por edhe me forma tjera të përzierjes së gjuhëve dhe me forma të komunikimit joverbal e me gjeste.

Në fund, mund të konstatohet se, ndonëse te folësit e shqipes nuk dominojnë paragjykimet negative për folësit e serbishtes, ose së paku paragjykimet e tilla nuk shprehen haptas, megjithatë te të rinjtë shqipfolës nuk vërehet ndonjë interesim për ta mësuar serbishten. Arsyeja për këtë konstatim duhet të kërkohet në disa faktorë. Faktorët demografikë, ndryshimi i raporteve të fuqisë politike dhe humbja e prestigjitetit e bëjnë serbishten të panevojshme për shqiptarët në Kosovë. Ish-Jugosllavia me 6 republika dhe dy krahina autonome nuk ekziston më dhe sot shqiptarët e Kosovës komunikimin rajonal e zhvillojnë kryesisht me barshkumbësat e tyre në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi.

Në përmbyllje, mund të konstatojmë se në bazë të këtyre zhvillimeve të sotme, brenda dy-tri dekadave të ardhshme, me ndërrimin e brezave shqipfolës, serbishtja në Kosovë do të jetë sikurse çdo gjuhë tjetër e huaj dhe numri i atyre që do ta kuptojnë dhe flasin atë do të jetë gjithnjë e më i vogël. Ky zhvillim do të jetë i ngjashëm me zhdukjen e dygjuhësisë së dikurshme shqip-turqishte e vjetër, e cila ka ekzistuar dikur në Kosovë, sidomos në qytete, por që me ndryshimin e rrethanave politike, ekonomike e kulturore është në reduktuar plotësisht, për të mos thënë që është në fazën e fundit të zhdukjes së plotë.

## **Bibliografia:**

1. Bloomfield, Leonard. *Të huazuarit intim*, në Nuhiu, Vesel (1990). *Ndikimet ndër gjuhëbësore*, Rilindja, Prishtinë.
2. Fishman, Joshua (1971). *Raporti në mes mikrosociolinguistikës dhe makrosociolinguistikës në studimin kusht flet cilën gjubë me kënd dhe kur, në:*

- Sociolinguistics*, Edited by J.B. Pride and J. Holmes, Penguin Books, First Published 1972; shih edhe te Vesel Nuhiu, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 181-209.
3. Fishman, Joshua (1973). *Language and Nationalism, Nationalism in Europe, 1815 to Present*, Edited by: Stuart Woolf, Routledge, London and New York, First published in 1996, this edition published in the Taylor & Francis e-Library, 2003.
  4. Freudenstein, Reinhold (1999). *Bilingualism, language policy, and the European Union*, Content made available by Georgetown University Press, Digital Georgetown, and the Department of Languages and Linguistics, në Internet: [http://digital.georgetown.edu/gurt/1999/gurt\\_1999\\_26.pdf](http://digital.georgetown.edu/gurt/1999/gurt_1999_26.pdf), qasja për herë të fundit më 19 mars 2009.
  5. Friedman, Victor A. (2007). *Language Politics and Language Policies in the Contemporary Western Balkans: Infinitives, Turkisms and EUrolinguistics*, EES Noon Discussion on April 18, 2007. The following is a summary of his presentation. Meeting Report 337, në Internet: [www.wilsoncenter.org/topics/pubs/MR337Friedman.doc](http://www.wilsoncenter.org/topics/pubs/MR337Friedman.doc), qasja për herë të fundit 20 mars 2009.
  6. Gal, Susan (2006) *Migration, Minorities and Multilingualism: Language Ideologies in Europe, Language Ideologies, Policies and Practices*, Edited, by Clair Mar-Molinero and Patrick Stevenson, First Published by Palgrave Macmillian, Houndmills, Basingstoke.
  7. Ismajli, Rexhep (1989). *Albanski jezik u Jugosllaviji, Zbornik - Kosovo - Srbija - Jugoslavija*, Ljubljana, Maj.
  8. Ismajli, Rexhep (1991), *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë.
  9. Ismajli, Rexhep (1994), *Etni e modernitet*, Dukagjini, Pejë.
  10. Ismajli, Rexhep (1998). *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, Dukagjini, Pejë.
  11. Ismajli, Rexhep (2003). *Standarde dhe identitete*, Dukagjini, Pejë.
  12. Kostallari Androkli (1984). *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984)*, Tiranë 1988.
  13. Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Rilindja, Prishtinë, 1974.
  14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2005), Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ASHAK, Prishtinë.
  15. Mac Giolla Chríost, Diarmait (2003), *Language, Identity and Conflict – A comparative study of language in ethnic conflict in Europe and Eurasia*, Routledge, London and New York.



16. Mackey, William F. (1989). *Determining the Status and Function of Languages in Multinational Societies, Status and Function of Languages and Language Varieties*, Walter de Gruyter, Berlin – New York.
17. Munishi, Shkumbin (2006). *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*, ZeroPrint. Prishtinë 2013.
18. Munishi, Shkumbin (2009). *Barazja e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane*, 1 Uluslararası Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi, Bildirler Kitabı, (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), 10-16 Mayıs, 2009, Kosova, Prishtinë. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
19. Munishi, Shkumbin (2010). *Konfliktet dhe kontaktet gjuhësore*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29, Prishtinë, 2010: shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
20. Munishi, Shkumbin (2010). *Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë*, Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (sesion shkencor i organizuar më 19.12.2010 në Ulqin – Mali i Zi), Art Club, Ulqin, Mali i Zi, 2010. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
21. Nelde, Peter Hans, Language Conflict, në Internet: <http://www.univie.ac.at/europaistik/LanguageConflict.DOC>, qasja për herë të fundit 26.07.2010.
22. Nuhiu, Vesel (1990). *Ndikimet ndërgjuhësore*, Rilindja, Prishtinë.
23. Sapir, Eduard. *Si ndikojnë gjuhët mbi njëra tjetrën*, në Nuhiu, Vesel (1990). *Ndikimet ndërgjuhësore*, Rilindja, Prishtinë.
24. Thomason G., Sara (2001). *Language Contact – an Introduction*, Georgetown University Press.



Francesco ALTIMARI

## NAPOLI, VATËR E RËNDËSISHME E RILINDJES ARBËRESHE DHE SHQIPTARE (SHEK. XVIII-XIX)

*“...in Napoli ove potente beltà a sé levommi del basso mondo...”* (“...në Napoli, ku një bukuri e fuqishme më tërhoqi nga bota e ulët”) [Poesie Albanese di Girolamo De Rada, II. Scanderbeccu i pa-faan. Storie del secolo XV, Corigliano Calabro, Tipografia Albanese, 1872, f.5]

### 0. Hyrje

Venecja dhe Napoli, në sajë të veprimtarisë së dëndur ekonomike dhe ushtarake që këto kryeqendra të rëndësishme italiane dhe shtetet që ato drejtonin ushtronin në Mesdhe para dhe gjatë sundimit osman, kanë qenë ‘dyert’ kryesore të marrëdhënieve historike midis gadishullit italian dhe gadishullit ballkanik, si edhe midis viseve italiane dhe atyre shqiptare.

Do të ndalemi në këtë trajtesë sidomos mbi rolin kulturor që ka luajtur qyteti i Napolit në kuadrin e marrëdhënieve italo-shqiptare, të përkrahura dhe të nxitura drejtpërdrejt ose tërthorazi nga veprimtaria e zhvilluar në Italinë e Jugut nga institucionet arsimore dhe kishtarë arbëreshe brenda Kishës katolike të rritit bizantin, që u zhvilluan në shekujt XVIII-XVIII përgjatë boshtit Jugu i Italisë – Jugu i Shqipërisë<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Ky punim lidhet ngushtë me kumtesën që mbajta në Tiranë, në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në nëntor të vitit 2012 dhe kushtuar njëqind vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, me titull: *“Arbëreshët e Italisë për Rilindjen e Shqipërisë mes shekujve XVIII-XIX: paralelizma me diasporat e tjera të hapësirës italo-ballkanike”*. Aty trajtova rolin që kanë pasur diaspora arbëreshe dhe ajo greke në tokën italiane mes shek. XVIII-XIX për rilindjen kombëtare të vendlindjeve të lashta përkatëse ballkanike.

Kjo veprimtari e mbështetur nga Kisha katolike përmes Kongregatës «De Propaganda Fide», duke marrë shkas nga trashëgimia e përbashkët bizantine që ishte pjesë përbërëse qoftë e krishtëritim lindor ortodoks, qoftë e atij perëndimor katolik, favorizonte lidhjet dhe kontaktet midis ‘grekëve’ të Perandorisë osmane (dhe të Republikës së Venedikut) në Ballkan dhe ‘grekëve’ të Mbretërisë së Napolit, që në një pjesë të mirë ishin arbëreshët e mërguar në Itali qysh prej shekullit XV.

Duhet të kujtojmë këtu se para se të “imagjinoheshin”<sup>2</sup> si komunitete politike, si «krijesa kulturore të veçanta», kombet – latinisht *Nationes* – konceptoheshin deri në fundin e shek. XVIII kyesisht si komunitete fetare, ku përfshiheshin bashkë popuj të ndryshëm nga ana etnike, por që kishin të njëjtën «çati» fetare ose të njëjtën gjuhë liturgjike në përdorim në ritet e tyre kishtare, pavarësisht përkatësisë së tyre në kishën katolike apo në atë ortodokse.

Më së miri këtë koncept na e shpjegon mënyra sesi brenda Perandorisë Bizantine identifikoheshin popujt e ndryshëm me besim të krishterë, që sipas gjuhës së liturgjisë që përdornin mund të ishin *Ρωμαιοί*<sup>3</sup> – siç quheshin të krishterët ortodoksë në botën e brendshme «greke»<sup>4</sup>, ose *grekë* në botën e jashtme «latine», nëse ndiqnin kishën lindore ortodokse (me gjuhë liturgjike greke) – dhe *Latinoi* – arbërisht *Lëtinj* –

<sup>2</sup> Përdorimi i fjalës “e imagjinuar” (anglisht: ‘imagined’) ndjek këtu vizionin ideo-filozofik që i jep kësaj fjale në librin e tij të famshëm *Imagined Communities Reflections on the Origins of Nationalism* (London 1983) filozofi dhe mendimtari amerikan Benedict Anderson.

<sup>3</sup> Nga *Νέα Ρώμη*, që ishte emërtimi i ri që i imponoi qytetit të lashtë të Bizantit perandori Konstandini i Madh, qytet që pastaj, në kujtim të tij, u quajt *Kostantinopoli* deri në vitin 1923 dhe pastaj *Istanbul*, me përshtatjen në gjuhën turke të greqishtes “στην Πόλη” (‘Qyteti’). Nga *Νέα Ρώμη* u formua *Ρωμαίοι* me të cilin emërtoheshin qytetarët e Perandorisë Bizantine dhe, pas sundimit osman, të gjithë të krishterët lindorë që ishin nën juridiksionin e Patriarkut të Kostantinopolit. Shih: Roderick Beaton, «Antique nation? ‘Hellenes’ on the eve of Greek independence and in twelfth-century Byzantium», *Byzantine and Modern Greek Studies*, Vol. 31, No. 1 (2007), University of Birmingham, f. 76-95.

<sup>4</sup> Nuk më duket e tepërt të ngulmoj këtu në interpretimin e saktë dhe autentik që duhet t’i japim termit «grek», sipas domethënies fetare origjinale të asaj kohe dhe jo duke e dekodifikuar atë, në mënyrë anakronistike, sipas domethënies “kombëtare” të tij të sotëm: spektri i tij semantik nuk mbulonte ata që ne sot jemi mësuar të identifikojmë si pjesëtarë të një kombi, por popujt e lindjes që, nga një perspektivë “perëndimore”, pavarësisht nga përkatësia kombëtare, identifikoheshin me kishat lindore. Prandaj terma si «diaspora greke» dhe «kisha greke» në terminologjinë e përdorur asokohe nuk kishin aspak të njëjtin kuptim ‘nacional’ që ata kanë marrë sot në Ballkan. E njëjta gjë ndodh me termin “turk” me të cilin diakronikisht identifikoheshin të gjithë myslimanët, por me të cilin sot sinkronikisht identifikohen vetëm pjesëtarët e kombit turk. Po të mos kemi kujdes dhe respekt për historinë e fjalëve, rrezikojmë të përziejmë në mënyrë paradoksale jo vetëm fjalët por edhe popujt, siç ndodh me disa politikanë jashtë... historisë që arrijnë të predikojnë edhe sot në Ballkan se shqiptarët myslimanë janë turq dhe se shqiptarët ortodoksë janë grekë!

nëse ndiqnin kishën perëndimore katolike, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ose «kombëtare».

Si pasojë e kësaj ndarjeje të kryehershme fetare dhe e këtij emërtimi të lashtë të përhapur në botën e Bizantit që pasqyron vizionin e krishtërit mesjetar, na mbetën disa gjurmë gjuhësore domethënëse që gjejmë në arbërishten e Italisë, ku me termin «*lët*» (shumës: «*lëtinj*») identifikohen «italianët», domethënë «tjetri etnik». Kjo terminologji na dëfton se arbëreshët, para mërgimit të tyre në gadishullin Apenin, identifikoheshin – nga ana kishtare më shumë se fetare – si «*romein*», «*grekë*», «*ortodoksë*» brenda një kisha që karakterizohej nga gjuha e Romës së Re, domethënë nga greqishtja bizantine. Në botën e Bizantit të krishterët që ndiqnin besimin katolik identifikoheshin sipas gjuhës së Romës së vjetër, që ishte latinishtja, si «*latinoin*». Arbëreshët, për faktin se nuk ishin katolikë, përdornin dhe përdorin edhe sot këtë etnonim të kryehershëm fetar dhe jo etnik për të identifikuar italianët<sup>5</sup>.

Pas mërgimit të tyre në Itali, ruajtja e fesë së krishterë në traditën lindore ka qenë për arbëreshët “mburoja” e vetme politiko-kishtare ndaj politikave asimiluese të ipeshkëve lokalë italianë. Në këtë ndërmarrje arbëreshët arritën të siguronin edhe përkrahjen objektive të Vatikanit, i cili synonte t’i paraqiste arbëreshët si shembuj pozitivë të një kisha katolike të bashkuar e universale, për sa i përket strukturës hierarkike, por që njëkohësisht ruante karakterin ortodoks në ritet e saj të lashta.

Riti grek-bizantin përfaqësoi për arbëreshët në shekuj një element sigurisht mbivlerësues identifikimi të jashtëm dhe jo të brendshëm, çka shpjegon pse disa «horra» ose «katunde» të tyre kanë ruajtur për shekuj (dhe pjesërisht disa e mbajnë edhe sot) përcaktorin ‘grek’ në emërtimin zyrtar italian: p.sh. *Greci*, *Rota Greca*, *Piana dei Greci* që deri më 1941 ishte emri zyrtar i qytezës që quhet sot *Piana degli Albanesi*.<sup>6</sup> Ky

---

<sup>5</sup> Shih Francesco Altimari, “Alcuni etnici di origine albanese nei dialetti della Calabria” (f. 173-178), në *Beiträge zur sprachlichen, literarischen und kulturellen Vielfalt in den Philologien*. Festschrift für Rupprecht Rohr zum 70. Geburtstag, Mit einem Vorwort herausgegeben von Gabriele Birken-Silverman und Gerda Rössler, Franz Steiner Verlag, Stuttgart 1992, f. 176.

<sup>6</sup> Përmend këtu edhe faktin se në disa fshatra arbëreshe të Provincës së Katanxarit banorët e paktë ende arbërishtfolës që gjeta atje rreth gjysmës së viteve ’80 të shekullit XX, për të thënë “*parlare albanese*” përdornin shprehjen “*parlare greco*”: Kështu p.sh., në komunitetin e Xingarones (italisht: Zangarona, lagje e Komunës së sotme Lamezia Terme) informatori im Francesco Sciallis, 70 vjeç, përdorte shprehjen «*bolënjë / blazënja ngriku*» (përshtatje në arbërishten e kushtëzuar fonetkisht nga dialekti kalabrez vendas “folënj / flasënj ngriku”) për “*parlare albanese*”. Të njëjtën përgjigje pata në komunitetin e Dandallit (italisht: Andali), ku informatori Giovanni Strazzi, gjatë intervistës që i bëra, përdorte shprehjen “*fjasnjëmë ngreku*” për të thënë “*parliamo albanese*”. Në këtë mënyrë ata informatorë, dëshmitarët e fundit të albanofonisë në këto ‘katunde’ që sot nuk janë më arbërishtfolëse, vetëm se përvetësonin nga ana gjuhësore, por jo identitare, identifikimin e jashtëm të kalabrezëve ndaj tyre, por ata më thoshin qartas se

emërtim, siç thashë i jashtëm por jo i brendshëm, u shërbente atyre për të mbrojtur identitetin, i cili lidhej që në origjinë me përkatësinë e tyre fetare brenda krishtëritit ortodoks (sipas drejtimeve «unitariste» të Koncileve të Firencës dhe të Ferrarës, pas rënies së Kostantinopolit më 1453). Mirëpo ndryshe nga disa kisha lindore të tjera që u ndanë nga Patriarku i Fanarit dhe u bashkuan me Papën e Romës e prandaj u quajtën «uniatë», domethënë të bashkuara me Papën, arbëreshët nuk u shkëputën askurrë me një akt zyrtar prej Kishës ortodokse.<sup>7</sup>

Dy kanë qenë aktorët kryesorë që mbajtën të gjalla raportet italo-shqiptare dhe arbëresho-shqiptare gjatë shekujve të parë të pranisë së arbëreshëve në Itali (shek. XVII-XVIII)<sup>8</sup>:

a) Institucionet arsimore të kishës arbëreshe lindore – ku përfshihen sidomos qendrat formuese të klerikëve të komunitetit arbëresh të Italisë së jugut, që ishin Manastiri bazilian i Munxifsit (it. Mezzojuso), themeluar më 1609 në Sicili; pastaj që nga shekulli XVIII Seminari arbëresh i Palermos (1734), gjithashtu në Sicili; Kolegji Korsini në Shën Benedhit (it. San Benedetto Ullano), themeluar më 1732, që u transferua pastaj në Shën Miter (1794) (it. San Demetrio Corone) në Kalabri;

b) Famullia “greke” e Napolit që ka qenë një vatër fetare, sociale dhe ekonomike e rëndësishme e diasporës lindore ortodokse në Perëndim, si edhe një urë e rëndësishme në zhvillimin e lidhjeve kishtarë dhe intelektuale midis arbëreshëve të jugut të Italisë, sidomos të atyre të Kalabrisë dhe të Sicilisë, por edhe midis arbëreshëve dhe himarjotëve, sidomos në periudhën nga gjysma e shek. XVIII deri në gjysmën e shek. XIX.<sup>9</sup>

---

nuk ishin dhe se nuk ndiheshin aspak ‘grekë’, duke më përsëritur gjatë intervistës përcëptimin e tyre identitar si ‘arbëreshë’ (italisht: albanesi).

<sup>7</sup> Këto kisha të veçanta, siç janë Eparkitë arbëreshe të Italisë së jugut, që ruajnë edhe sot ritin e lashtë lindor, por pa qenë ‘uniatë’, quhen nga ana e së drejtës kanonike kisha ‘sui juris’, duke ruajtur në mënyrë autonome veçoritë liturgjike, kanonike dhe traditën teologjike ortodokse brenda Kishës katolike.

<sup>8</sup> Kolegu dhe miku antropolog Mario Giacomarra në fillim të viteve ‘90 të shek XX, duke marrë parasysh numrin e paktë të shkrimeve arbërisht të botuara në Itali, e quajti këtë periudhë “shekujt e heshtjes”.

<sup>9</sup> Për historinë e komunitetit ‘grek’ dhe të kësaj kisha, shih: Vincenzo Giura, “La Comunità Greca di Napoli (1534-1861), f. 119-156, në *Storie di Minoranze: Ebrei, Greci, Albanesi nel Regno di Napoli*, Napoli 1982. Kohët e fundit doli monografia e përgatitur nga Jannis Korinthios, *I Greci di Napoli e del Meridione d'Italia dal XV al XX secolo*, Editrice AM&D, Cagliari 2012, ku historia e këtij komuniteti trajtohet këtu brenda një perspektive kulturore që mund ta quajmë mononacionale greke. Në një këndvështrim më të gjerë, mund të themi ballkanik, dhe me një përqasje më transnacionale dhe transballkanike, duke theksuar karakterin transnacional që historikisht pati diaspora ortodokse në Mesdhe dhe në Perëndim – që ishte ‘greke’ nga ana kishtarë dhe jo kombëtare! – vjen kontributi i ri i Angela Falchetta-s që është një rezymë i tezës së saj të doktoranturës, me titull: “*Li Greci fuggiaschi delli luoghi d'Italia*”: *uomini, reti e comunità*

## 1. Kontaktet e para të Arbëreshëve me Himarën në shekujt XVII-XVIII: roli i Monastirit të Munxifsit në Sicili

Tejet i rëndësishëm ka qenë për raportet shqiptaro-arbëreshe roli i Manastirit i etërve bazilianë të Munxifsit (Mezzojuso) në Sicili, vendbanim i themeluar nga arabët që i vunë emrin *Manzil Yūsuf*, që pastaj u braktis dhe u ripopollua nga arbëreshët në fillim të shekullit XVI.

Manastiri bazilian, i themeluar nga Andrea Reres në vitin 1609, ka qenë e para qendër arsimore kishtarë e Arbërisë siciliane dhe ajo më e rëndësishmja deri në gjysmën e shekullit XVIII. Aty studionin dhe vepronin «grekë» të ndryshëm: shumica arbëreshë vendas, grekë “venedikas” të gadishullit të Moresë (Peloponezi i sotëm) dhe të ishullit Kandja (Kreta e sotme), si dhe ndonjë italian i kishës “italo-greke”, që mbijetonte ende në Italinë e jugut në atë periudhë si pasojë e sundimit të gjatë bizantin në ato treva. Në këtë manastir studiohej greqishtja liturgjike, por i gjallë ishte edhe interesi ndaj arbërishtes që u shërbente murgjve në misionet e tyre fetare në Shqipërinë e jugut, sidomos në Himarë, ku u duhej doemos të përdornin shqipen, krahas greqishtes. Këto misione nxiteshin dhe përkraheshin nga Vatikani në mbrojtje të krishtërimit katolik në versionin lindor bizantin, që rrezikohej nga trysnia islamizuese e pushtuesit osman<sup>10</sup>.

Një rol të rëndësishëm zhvilloi ky manastir në marrëdhëniet me Himarën dhe me Shqipërinë e jugut duke filluar nga gjysma e shek. XVII. Ndër murgjit bazilianë arbëreshë por edhe italianë, katolikë të ritit bizantin, që morën pjesë nga gjysma e shek. XVII deri në gjysmën e shek. XVIII në këto misione të përkrahura nga Kongregata «De Propaganda Fide»<sup>11</sup> mund të përmendim misionarët: Nilo Catalano,

---

*attraverso i confini politici e confessionali?* (f. 1-13). Kjo studiuese e re italiane inkuadron me një përfaqje metodologjike shumë korrekte raportin jo gjithmonë linear dhe shumë herë problematik dhe të ndërthurur, që ekziston midis helenizmit kulturor – dhe pastaj ‘nacional’, nga njëra anë, – dhe ortodoksisë fetare, nga ana tjetër, në diaporën ‘greke’ të Italisë së jugut që përbëhej nga komunitete heterogjene nga ana gjuhësore dhe etniko-kulturore, siç ishin grekët katolikë nën sundimin venedikas, grekët ortodoksë nën sundimin osman, ortodoksët jo-grekë të Lindjes, arbëreshët katolikë të ritit lindor të Mbretërisë së Napolit.

<sup>10</sup> Mbi rolin që pati manastiri bazilian i Munxifsit në raportet me Himarën dhe përgjithësisht me Ballkanin, shih Pietro Di Marco, *Il Monastero di Mezzojuso nella storia culturale arbëreshe* (pp.5-23) in «Mediaeval Sophia». Studi e ricerche sui saperi medievali. E-Review semestrale dell’Officina di Studi Medievali 2 (luglio-dicembre 2007), f. 5-23 në website [www.mediaevalsophia.it](http://www.mediaevalsophia.it).

<sup>11</sup> Me historinë e këtyre misioneve është marrë më parë C. Karalevsky, “La missione greco-cattolica della Cimarra nell’Epiro nei secoli XVI-XVIII” në *Bessarione* s. III, 8 (1910-1911), f. 440-483; 9 (1912), f. 181-199. Më gjerësisht, në të njëjtën periudhë, u interesua për Himarën

italian me origjinë nga Messina, që më pas u arbëreshizua nga ana kulturore dhe gjuhësore; Filoteo Zassi e Callinico Granà nga Munxifsi; Basilio Matranga e Giuseppe Schirò, të dy nga Hora e Arbëreshëve<sup>12</sup>.

Kanë qenë misionarët arbëreshë që vinin nga manastiri bazilian i Munxifsit ata që hapën shkollat e para shqipe në Jugun e Shqipërisë: qëllimi i këtyre shkollave në Himarë ishte kryesisht fetar – mbrojtja e besimit të krishterë sipas rritit bizantin, por brenda kishës katolike – që kërcënohej qoftë nga sundimi osman, qoftë edhe nga Kisha ortodokse greke. Shqipja, siç dëftojnë tekstet e botuara dhe dorëshkrimet që na kanë mbërritur nga disa prej misionarëve, si ato të Imzot Zef Skiroit, njihej dhe përdorej nga misionarët që vinin nga Munxifsi si gjuhë ndërmjetësimi për të lehtësuar ungjillizimin e këtyre trevave shqiptare, të lidhura ngushtë qoftë me mbretërinë e Napolit, qoftë me Republikën e Venedikut.

## 2. Rilindja e parë arbëreshe: roli i Seminareve arbëreshe

Një interes të madh ndaj komunitetit shqiptar në Ballkan dhe të atij arbëresh në Itali filloi ta sillte veprimtaria e zhvilluar nga papa Klementi XI, nga familja Albani, me origjinë shqiptare (1700-1721)<sup>13</sup>, por një kthesë të vërtetë në historinë fetare, politike,

---

edhe studiuesi i mirënjohur arbëresh Atë Nilo Borgia, i cili shkroi një sërë studimesh për misionet e murgjve bazilianë arbëreshë në Himarë: *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: “Roma e l’Oriente” 3 [1913] (5) f. 97-117, f. 159-166; *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: “Roma e l’Oriente” 3 [1913] (6) f. 209-231; *Contributo alla storia del rito greco in Italia*, në: “Roma e l’Oriente”, 4 [1914] (7) f. 272-285; f. 340-352; *I monaci basiliani d’Italia in Albania. Appunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII). Periodo secondo*, Roma 1942. Me nismën e lavderueshme të shtëpisë botuese Naimi, këto kontribute të Atë Nilo Borgia-s janë përmbledhur në një libër me titull *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Shënime mbi misionet në Himarë: shek. XVI-XVIII*. Me një parathënie nga Matteo Mandalà, Naimi, Tiranë 2014.

<sup>12</sup> Për kontributin e dhënë nga disa prej tyre, sidomos nga murgjit bazilianë arbëreshë Filoteo Zassi dhe Zef Skirò, si edhe nga apostulli i arbëreshëve të Sicilisë, Atë Gjergj Guxeta, për vlerësimin e kulturës arbëreshe dhe rreth përdorimit të gjuhës shqipe në tekstet zyrtare kishtare të kohës, shih studimet e thelluara filologjike që botoi kohët e fundit albanologu i mirënjohur Bardhyl Demiraj: “Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII”, në: *Studime* 12 [2005], f. 67- 97, Prishtinë 2006; “Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. e 18-të. Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë”, në: *Hylli i Dritës* 3 [2007] Shkodër, f. 9-37; “Një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë që duhet kërkuar”, në: *Hylli i Dritës* 1 [2007] f. 30-37, Shkodër.

<sup>13</sup> Nuk janë të rastësishme një sërë veprash, disa të botuara, disa të mbetura dorëshkrime, që i përkasin tamam kësaj periudhe: ato na dëshmojnë këtë vëmendje të ringjallur dhe të posaçme ndaj fesë por edhe ndaj gjuhës dhe kulturës së shqiptarëve të përkrahur aktivisht nga kisha katolike nën papatin e Klementit XI. Hyjnë në këtë sërë iniciativash, në mënyrë direkte ose të tërthortë, botimi *Kuvendi i Arbënit* (1706), gramatika e parë e gjuhës shqipe *Osservazioni grammaticali nella Lingua Albanese* del P.Francesco Maria da Lecce 1716), por edhe *Dittionario*



kulturore e qytetare të komunitetit arbëresh në Itali shënoi fillimisht themelimi i dy kolegjeve arbëreshe në Kalabri dhe në Sicili me interesimin e papa Klementit XII (1730-1740). Këto qendra të rëndësishme arsimore ishin Kolegji Korsini (1732) në Shën Benedhit në Kalabri, mbështetur fuqishëm nga vëllezërit Stefano e Felice Samuele Rodotà, dhe Seminari Arbëresh i Palermos në Sicili, i themeluar në vitin 1734 me nismën e Atë Gjergj Guxetës<sup>14</sup>.

Bëhet fjalë për veprimtari mjaft të rëndësishme të ndërmarra nga Selia e Shenjtë, që ishte më e ndjeshme dhe më tolerante në krahasim me klerin katolik vendas të ritit latin ndaj ruajtjes së traditës kishtare bizantine dhe identitetit fetar origjinar të kolonive arbëreshe të Jugut të Italisë. Këto dy seminare, përveç kontributit vendimtar që patën për ruajtjen e ritit fetar në traditën greke në Itali, përfaqësuan dy qendrat kryesore për formimin dhe përgatitjen teologjike dhe kulturore të një pjese të mirë të klerit dhe të intelgjencës arbëreshe deri në fund të shek. të XIX.

Prania e këtyre dy qendrave kulturore i siguroi komunitetit arbëresh të provincës së Kozencës dhe të asaj të Palermos një trashëgimi historike dhe kulturore të rëndësishme, nga u formua një drejtim i ri me një sërë detyrimesh qytetare dhe intelektuale nën kujdesin e instancave liberale dhe demokratike të shoqërisë italiane. Përveç formimit të intelektualëve dhe të klerikëve progresistë, që zhvilluan më pas një rol protagonistësh në lëvizjen e Risorxhimentos italiane, këto dy institucione favorizuan qysh në atë kohë zhvillimin e një ndërgjegjeje të gjerë kombëtare mes intelektualëve arbëreshë. Ata iu vunë kërkimit të rrënjëve të tyre të lashta kombëtare dhe tipareve qenësore identitare që shërbenin edhe për t'i dalluar para opinionit publik nga grekët, me të cilët kishin të përbashkët vetëm ritin bizantin.

Nevoja që ndjenin arbëreshët e ritit bizantin për t'u çliruar një herë e përgjithmonë prej identifikimit me grekët, inxiti interesin e fortë të intelektualëve dhe klerikëve arbëreshë, fillimisht të Sicilisë dhe pastaj të Kalabrisë, të vinin në pah veçoritë kulturore dhe gjuhësore të etnisë së tyre, duke u quajtur 'italo-albanesi', ndërkohë që grekët e Italisë filluan të quheshin edhe nga kisha 'italo-greci'.

Domosdoshmëria e kapërcimit të kësaj përzierjeje të rreme identitare etniko-fetare, si edhe e shkëputjes nga ky identifikim i jashtëm që binte ndesh haptazi me identitetin e tyre të brendshëm dhe përkatësinë etnike, i shtyu qarqet intelektuale arbëreshe t'u paraprinin, që në gjysmën e shekullit XVIII, disa çështjeve si ajo e

---

*Italiano-Albanese* (1702) gjithashtu e At Francesco Maria da Lecce, kjo e fundit e botuar në vitin 2009 me një edicion filologjikisht të përsosur nga Gëzim Gurga.

<sup>14</sup> Shih për këtë Francesco Altimari, "Gli Arbëreshë d'Italia per la rinascita dell'Albania tra XVIII e XIX secolo: parallelismi con altre diaspore di area italo-balcanica" në *Studia Albanica*, f. 129-143, Tiranë 2012.

rizbulimit të origjinës etnike, temë që do të marrë jetë në debatin kulturor evropian shumë dekada më vonë, sidomos me afirmimin e linjave të reja të mendimit të shprehura në letërsinë e romanticizmit, në filozofi nga idealizmi i shkollës gjermane dhe në politikë nga nacionalizmi i shek. XIX.

Kjo lëvizje zuri fill në Seminarin Arbëresh të Palermos, ku falë vizionit të gjerë kulturor të themeluesit të tij, atë Gjergj Guxetës, u ngrit laborator i parë ideologjik për zbulimin e rrënjëve kombëtare shqiptare në kontekstin arbëresh. Kjo veprimtari u përpunua më tej nga sivëllezërit dhe pasardhësit e tij, Pal Maria Parrino dhe Nikollë Keta.<sup>15</sup>

I pari që e përdori etnonimin ‘italo-albanese’ (arbëresh i Italisë) në një akt zyrtar të vitit 1742 ishte ipeshkvi Zef Skiroi<sup>16</sup>, ish-nxënës i atë Gjergj Guxetës, në një dokument drejtuar papës Benedikti XIV, i cili atë vit nxori bulën *Etsi pastoralis*, ku i njihej epërsi ritit latin duke ngushtuar rolin dhe hapësirën e kishës arbëreshe.

Siç thekson Matteo Mandala,<sup>17</sup> këtë dallim e kishte të qartë edhe më parë se Skiroi atë Gjergj Guxeta, që e parashtrroi në veprën e tij *De Albanensium Italiae ritibus excollandis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint*. Në gjurmët e Guxetës, nxënësi e më pas ndjekësi i tij në drejtimin e Seminarit, Pal Maria Parrino, e shtjelloi këtë dallim në disa punime që datojnë para vitit 1740, por analiza u ngrit në nivel teorik në mënyrë më të plotë gjatë viteve 1745-1764, kur ai filloi të përpunonte dy veprat e tij kryesore, ende të pabotuara: *In septem perpetuae consensionis libros Albanensis Ecclesiae cum Romana omnium Mater et Magistra* dhe *Perpetuae Albanensis Ecclesiae consensionis cum Romana omnium Matre et Magistra libri VII*. Në letërkëmbimin që Parrino pati më 1749 me një përfaqësues të lartë të kishës siciliane, ai shprehet në këtë mënyrë për identitetin e arbëreshëve: “*Albanesi tutto che volgarmente si chiamano Greci, nulladimeno di greci non ànno che solo i riti, essendo del resto d’una nazione totalmente diversa dalla Greca, perché oriundi d’Albania, che nulla avendo di greco nella lingua, e costum?*”<sup>18</sup>.

Edhe në Kalabri ky interesim ndaj origjinës së të parëve i shtyu klerikët arbëreshë të merreshin me vepra të ndryshme – historike, folklorike, teologjike – për

<sup>15</sup> Shih Matteo Mandala, “Paolo Maria Parrino e le origini dell’ideologia albanista” (f. 1-60), në Pietro Di Marco e Alessandro Musco (a cura di), *Aspetti della cultura bizantina ed albanese in Sicilia*, Officina di Studi Medievali, Palermo 2005.

<sup>16</sup> Shih dokumentin e tij “*Notizia distinta degl’italo-greci e degl’Italo-albanesi esposta da mons. Giuseppe Schirò Arcivescovo di Durazzo, già Vicario Apostolico di Cimarra nell’Epiro, in occasione di dover rispondere ad alcuni quesiti proposti da un personaggio, që u botua së pari në revistën Roma e l’Oriente. Rivista criptoferratense per l’unione delle Chiese*, viti IV, vol. VII, 1914, f. 282-285 e f. 341-352.

<sup>17</sup> I referohemi studimit të tij “*Vepra e pabotuar e atë Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII*”, në *Studime Filologjike*, vol. 1-2, Tiranë, 2006, f. 11-41.

<sup>18</sup> Matteo Mandala, *Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe*, Mirror editore, Palermo 2007, f.199.

të vënë në dukje identitetin e vet të lashtë dhe për të shënuar ‘distancën’ e tyre nga grekët, megjithëse i bashkonte me ta i njëjti rit fetar. Autorë si Pietro Pompilio Rodotà, Mikele Bellushi dhe Frangjisk Avati hyjnë në këtë rrymë intelektualësh që patën si pikë referimi dhe disa syresh si qendër formimi Kolegjin Korsini të Shën Benedhitit, që nga viti 1794 u transferua në Manastirin e Shën Adrianit, në Shën Mitër.<sup>19</sup>

Ky debat mbi përkatësinë etnike të arbëreshëve që duhej dalluar nga përkatësia fetare, prej mjedisëve sicilianë kaloi pastaj në mjediset kalabreze. Në veprën latinisht të Angelo Zavaronit, botuar në Napoli më 1750, mbi historinë e Kolegjit Korsini në Shën Benedhit, kur bëhet fjalë për ritin, përdoret termi ‘grek’ ose ‘italo-grek’, ndërsa kur bëhet fjalë për identifikimin e besimtarëve arbëreshëve që e ruajnë këtë rit, ata me një sërë sinonimesh identifikohen si: ‘*Epirotae*’, ‘*Gens Epirotica*’, ‘*Epirotica Natio*’, ‘*Italo-Alban*’, ‘*Albanenses*’, ‘*Italo-Epirotae*’<sup>20</sup>.

Në veprën e famshme për ritin grek dhe arbëreshët të Pietro Pompilio Rodotàsë (1763), besoj edhe si pasojë e debatit të mëparshëm që ky studiues kishte pasur me Paolo Maria Parrinon, për arbëreshët ai përdor termat ‘*Albanesi*’, ‘*Nazione albanese*’, ‘*Albanesi di rito greco*’, por nuk haset më ajo përzierje historike nga ana etnike me grekët që sillte emërtimi i vjetër tradicional ‘*greco*’<sup>21</sup>.

Në fund, në vitin 1771, në frontespicin e një libri me karakter fetar të shtypur në Napoli nga një prift arbëresh, Aleksandër Marini nga Shën Mitri, gjejmë dëshminë e parë të etnonimit “italo-arbëresh”: autori në frontespicin e veprës e quan veten “italoalbanese”<sup>22</sup>.

Zgjerimi dhe pjekuria e këtij procesi vetëdijësimi ndër qarqet intelektuale arbëreshe të Kalabrisë vërehet qysh në një botim të veçantë dhe të rëndësishëm që

---

<sup>19</sup> Për historinë e Manastirit të Shën Adrianit (955-1794) dhe të Kolegjit arbëresh (1794-1923) shih: Domenico Cassiano, *S.Adriano. La Badia e il Collegio italo-albanese*, volume I (955-1806), Marco editore, Lungro 1997; Domenico Cassiano, *S.Adriano, Educazione e politica*, volume II (1807-1923), Marco editore, Lungro 1999.

<sup>20</sup> Shih: Angeli Zavaroni J. C. Montaltini inter Incultos Aridaldi inter Constantes Alcippi, *Historia erectionis Pontifici Collegi Corsini Ullanensis Italo-Graeci, et Deputationis Episcopi titularis Ritus Graeci Ad Italo-Epirotas eodem Ritu instruendos, Sacrisque initiandos*, ad Benedictum XIV, Pont. Max. Neapoli Anno Salutis MDCCL, Ex Typographia Severina, Superioribus Annuentibus, f. 103).

<sup>21</sup> *Dell'origine, progresso e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi libri tre scritti da Pietro Pompilio Rodotà professore di lingua greca nella Biblioteca Vaticana*, vol. III: *Degli albanesi, chiese greche moderne, e collegio greco in Roma coll'indice di tutta l'opera*, per Giovanni Generoso Salomoni, in Roma MDCCLXIII.

<sup>22</sup> *Sistema teopolitico sopra la economia della grazia col libero arbitrio nella permissione de' mai morali del dottor Alessandro Marini italoalbanese*, In Napoli MDCCLXXI, Nella Stamperia Avellaniana, Con Licenza de' Superiori.

doli në Napoli më 1796, me titull *Risposta di Filalete*, përgatitur nga Mikel Bellushi, por të frymëzuar nga imzot Frangjiks Buljari. Aty mbrohet e drejta e arbëreshëve për të mbajtur në kishat e tyre ritin fetar 'grek', anipse ata nuk janë 'grekë', dhe shpjegohet qartë identiteti autentik i arbëreshëve të ritit lindor, që nuk mund të përziheshin asesi me grekët, pasi i përkisnin asaj bashkësie që autori quan "nazione albanese".<sup>23</sup>

Nga këto lidhje që u krijuan midis intelektualëve të formuar në të dyja qendrat e kulturore arbëreshe të Kalabrisë dhe të Sicilisë e midis tyre edhe përfaqësuesve të diasporës shqiptare, nisi një lëvizje kulturore e gjerë që prodhoi një interes të madh ndaj temës së identitetit të shqiptarëve. Megjithëse autorët nuk arritën t'i shtypnin veprat e tyre për shkak të vështirësive ekonomike, këto ide qarkulluan në formë dorëshkrimore nga brezi në brez brenda institucioneve arsimore arbëreshe dhe gjetën jehonë në një sërë shkrimesh me tematika kryesisht fetare që vetëm sot arritëm t'i njohim pjesërisht, dhe ku hasim çuditërisht ato motive "kombëtare" që në qarqet shqiptare të Ballkanit u bënë objekt diskutimi dhe trajtimi vetëm një shekull më vonë, kryesisht në periudhën romantike.

Tematika të tilla si zbulimi i rrënjëve të lashta kombëtare të shqiptarëve përmes gjuhës, historisë dhe etnografisë së Arbërit filluan të debatoheshin dhe të trajtoheshin në këto dy qendra kulturore qysh nga gjysma e shekullit XVIII, veçanërisht në atë siciliane, duke krijuar një traditë të fortë kulturore ndaj thellimit të identitetit etnik përkatës, traditë që mund ta përkufizojmë si "Rilindja" e parë arbëreshe. Rezultatet e saj zunë të ndiheshin aty nga fundi i shekullit XVIII dhe dhjetëvjeçari i parë i shekullit XIX edhe mbi elitën arbëreshe të hapësirave të tjera italo-jugore, kryesisht në Napoli dhe në Kalabri. Falë saj e sot kuptojmë më mirë rolin emancipues që patën për botën shqiptare elitat intelektuale të kishës arbëreshe të Italisë së Jugut.

### 3. Napoli për Rilindjen e dytë arbëreshe: roli i inteligjencjes arbëreshë

Me termin *shkolla sofjote*, që morëm hua nga studiuesi i mirënjohur arbëresh Domenico Cassiano, i referohemi grupit të intelektualëve me formim intelektual iluminist dhe formim politik liberal, me origjinë nga Shën Sofia (it. Santa Sofia d'Epiro) në Kalabri, që vepruan kryesisht në Napoli, por edhe në ambientin arbëresh të Kalabrisë, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII: e kemi fjalën për intelektualët e shquar: Paskal Baffi (1749-1799), që pasi mori pjesë si Ministër i kulturës në Republikën e Napolit, u dënua me vdekje nga burbonët në vitin 1799; Frangjisk

<sup>23</sup> Shih: Domenico Cassiano, "Passione e morte di Monsignor Francesco Bugliari" (f. 193-229) në librin e tij: *S. Adriano. La Badia e il Collegio italo-albanese, volume I (955-1806)*, Marco editore, Lungro 1997.

Buljari (1742-1806), i ashtuquajtur “ipeshkëv i kuq” që ra viktimë e sanfedistëve më 1806; dhe Ëngjëll Mashi (1758-1821). Këto figura të shquara të inteligjencies arbëreshe, me veprimtarinë e tyre të shumanshme kulturore që u zhvillua në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XVIII (në rastin e Mashit edhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIX) i hapën udhën një Rilindjeje më të ndërgjegjshme dhe me baza iluministe, që në fakt përbën fazën paraprake të Rilindjes romantike.

Lidhje të forta, qoftë familjare qoftë kulturore, i bashkonin këto figura intelektuale ‘sofjote’ që kishin në Napoli qendrën e veprimit të tyre profesional. Krahas figurës madhore të Paskal Baffit, që për meritat e tij njihej si një ndër helenistët më të famshëm të kohës dhe ndër figurat më elitare të inteligjencies napolitane, gjejmë jo rastësisht në gjysmën e dytë të shekullit XVIII në kryeqytetin e Mbretërisë së Dy Sicilive edhe figura të tjera, si një ungi të Ëngjëll Mashit, papas Giuseppe Bugliari, që si famullitar i kishës ‘greke’ kontribuoi në fuqizimin e këtyre lidhje të ‘kolonisë’ sofjote me ambientin napolitan, sidomos që nga vitet ’70 të shekullit XVIII<sup>24</sup>.

Natyrisht një rol vendimtar në këtë proces e luajtën lidhjet kulturore që mjediset napolitane kishin me kolegji arbëresh Korsini-Shën Adriani, që asokohe drejtohej nga ipeshkëvi Frangjisk Buljari. Falë këtij intelektualit të shquar kolegji u hap ndaj ideve iluministe, proces ky që u ndërpre me vrasjen e tij mizore nga sanfedistët më 1806, por që u rimor pastaj nga pasardhësi i tij, ipeshkëvi Dhumink Bellushi nga Frasnita. Kanë qenë këta dy prelatë me formim iluminist-xhakobin që i siguruan Kolegjit arbëresh themelet e një procesi modernizimi pedagogjik dhe një rol kulturor të ri dhe përparimtar jo vetëm në kontekstin kalabrez ku ai vepronte.

Një shtysë të mëtejme i dhanë lëvizjes kulturore arbëreshe edhe lidhjet që pati klubi sofjot në Napoli me bashkëkombësit që vinin jo vetëm nga kolonitë e tjera arbëreshe të Mbretërisë, por edhe nga Ballkani. Duhet përmendur këtu një sërë personalitetesh që kishin pozita drejtuese dhe grada të larta në hierarkinë ushtarake dhe administrative të Shtetit, sidomos oficerët shqiptarë të Regjimentit Mbretëror Maqedonas që rekrutoheshin, sikurse pjesa më e madhe e trupës së regjimentit, nga Himara dhe nga trevat e afërta të Epirit, asokohe nën sundimin osman. Megjithëse është ende herët të flasim për një lobby të mirëfilltë shqiptaro-arbëreshe, nuk mund të mohohet prania e një qarku intelektual me origjinë shqiptare dhe arbëreshe që mbledhesh dhe takohej në kishën ‘greke’ të Shën Pjetrit dhe të Shën Palit në Napoli. Këta intelektualë dhe oficerë të lartë, thuajse të gjithë me pozita dhe poste të rëndësishme, ushtronin një peshë kulturore dhe politike të padiskutueshme brenda

---

<sup>24</sup> Për Ëngjëll Mashin shih Antonino Catalano, “Angelo Masci: la sua opera e i suoi tempi” (f. 17-29) në *Risveglio-Zgjimi*, VI, n.2, Cosenza 1968.

shoqërisë napoletane.

Kontributi më i rëndësishëm që i është dhënë debatit albanologjik dhe problematikës kulturore arbëreshe nga kjo ‘shkollë’ ka qenë libërthi i Ëngjell Mashit (it. Angelo Masci), *Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della nazione Albanese* (Napoli 1807), që pati jehonë të gjerë në qarqet shkencore evropiane falë botimit të tij frëngjisht nga dijetari danez Malte-Brun<sup>25</sup>: *Essai sur l'origine, les Meures et l'Etat actuel de la Nation Albanaise par M. Ange Masci. Traduit de l'Italian, communiqué par M. Sonnini*, në serinë: *Annales des Voyages de la géographie et de l'histoire ou Collection des voyages nouveaux les plus estimes, traduites de toutes les langues européennes publiées par M. Malte-Brun*, Tome troisième, Comprenant les cahiers VII a IX, Paris 1808, botuar pastaj italisht në vitin 1828.

Me këtë pamflet mbi origjinën e shqiptarëve Mashit i dha një impuls të madh dhe jehonë evropiane debatit për prejardhjen e këtij populli, dhe në hullinë ideve që kishte hedhur më parë Lajbnici, u angazhua për të mohuar hipotezën që qarkullonte asokohe mbi prejardhjen e ‘Albanisë’ së Ballkanit nga ‘Albania’ e Kaukazit<sup>26</sup>, duke afirmuar se shqiptarët ishin autoktonë në trevat ballkanike dhe se rridhnin drejtpërdrejt nga Ilirët e moçëm.

Me fjalë të tjera, grupi intelektual “sofjot” përfaqësonte bërthamën kryesore të një lëvizjeje kulturore, por edhe politike, më të gjerë; falë ndikimit të këtij grupi intelektual Kolegji arbëresh i Shën Mirit fitoi një karakter pedagogjik më të spikatur liberal, deri edhe radikal, që i shndërroi komunitetet arbëreshe të Kalabrisë gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX në protagonistë të lëvizjes risorxhimentale në Itali.

Pesha që intelektualët arbëreshë arritën të fitonin në Napoli dhe në mjediset intelektuale jugore nga fundi i shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX lidhet me marrëdhëniet organike që ata vendosën me intelektualët napolitanë më në zë të kohës, disa prej të cilëve kishin vetë prejardhje arbëreshe, si Vincenzo Torelli dhe Emanuele

<sup>25</sup> Conrad Malte-Brun ishte pseudonimi i gjeografit danez *Conrad Bruun* (Thisted, Jütland, 1775 - Paris 1826) i cili u dëbua nga Danimarka, nga mbreti Federiku VI, për shkak të disa librave kritikë ndaj qeverisë dhe u strehua në Paris, në Francën pas Revolucionit (1799) dhe mori pastaj qytetarësinë franceze. Në vitin 1807 themeloi atje periodikun *Annales des voyages* ku gjeti vend edhe përkthimi i studimit të Mashit për shqiptarët.

<sup>26</sup> Rodotà është i pari që përmend teorinë e origjinës kaukaze të shqiptarëve: “*Fu opinione d'alcuni Scrittori, che gli Albanesi traggano l'origine dall'Albania antica, provincia dell'Albania antica, provincia dell'Asia sul mare Caspio nella parte orientale della Georgia. Narrano che aspramente travagliati dalle scorrerie e guerre lungo tempo sostenute contro a' Tartari vicini, indi si allontanarono; e venuti all'Europa per cercare più sicuro e tranquillo riposo, occuparono la parte più nobile della Macedonia, cui diedero ancor d'Albania il nome. Aggiungono che vaghi di nuove fedi, col favore delle armi dilatarono il dominio in tutta la Macedonia el'Epìro*”, në Pietro Pompilio Rodotà, *vep. e cit.*, f. 2.

Bidera<sup>27</sup>. Po përmendim një sërë figurash të shquara të botës intelektuale arbëreshe si Girolamo De Rada, Angelo Basile, Domenico Mauro, Demetrio Strigari, Pasquale Scura, Cesare Marini, Tommaso Pace etj. të cilët zhvilluan aty një veprimtari të dendur kulturore, sidomos gjatë pjesës së parë të shekullit XIX deri me krijimin e shtetit të ri italian (1861). Edhe më pas vazhdoi ky rol i Napolit si bariqendër kulturore e krejt Jugut të Italisë dhe për arbëreshët, dhe zgjati së paku deri në fillim të shekullit XX.

Disa nga intelektualët arbëreshë morën pjesë aktive edhe në zhvillimet politike dhe u bënë protagonistë të stinës liberal-risorxhimentale. Si kurorezim i këtij angazhimi vetë qeveria e përkohshme e Garibaldit në krye të Mbretërisë së çliruar nga burbonët para se t'i bashkohej Italisë së saponjërtuar përfshinte disa ministra që Garibaldi i zgjodhi jo rastësisht nga komuniteti arbëresh: përmendim këtu Francesco Crispi, Luigi Giura dhe Pasquale Scura. Ky i fundit si Ministër i Drejtësisë dekretoi zyrtarisht aneksimin e krahinave të jugut në Mbretërinë e re italiane<sup>28</sup>.

Vetë shfaqja e një fenomeni letrar si De Rada brenda këtij konteksti napolitan duhet parë si shprehje e klimës së veçantë që zotëronte në këtë qytet kosmopolit, i cili ishte jo vetëm ndër qendrat kulturore më të rëndësishme evropiane, por edhe udhëkryq i popujve të Mesdheut. Jo rastësisht Napoli u bë një pikë takimi mes shqiptarëve, arbëreshëve dhe grekëve që me gjithë dallimet etnike, njiheshin si pjesëtarë të së njëjtës bashkësie fetare, roli kulturor i së cilës deri më sot është nënvlerësuar, por që meriton të çmohet jo vetëm si djep helenizmi, sikurse është mbajtur deri më sot, por edhe si djepi i albanizmit.

Por cila ishte klima kulturore e këtij qyteti në periudhën që po analizojmë? Siç na kujton historiani i letërsisë italiane, studiuesi i mirënjohur Giulio Ferroni, Napoli ishte atëherë një qendër e gjallë kulturore ku tendencat idealiste dhe liberale, qoftë me orientim katolik, qoftë me orientim laik, bashkëjetonin me rrymat demokratike dhe radikale të kulturës iluministe napoletane, dhe ky takim traditash e bënë këtë qytet një

---

<sup>27</sup> Për rolin kyç që lajti Bidera në formimin kulturor të intelektualëve arbëreshë në Napoli dhe si ndërmjetës midis ambientit arbëresh të Sicilisë, nga i cili e kishte prejardhjen, dhe ambientit arbëresh të Kalabrisë, duke qenë ndër të tjerat edhe mentori i Jeronim De Radës, sidomos përmes veprës së tij kryesore *Quaranta secoli. Racconti su le Due Sicilie del Pelasgo Matr-eer pubblicati da Emmanuele Bidera italo-greco* (Napoli, 1846-1850), që përhapi 'mitin pelazgik' në Itali, shih Matteo Mandalà, "Alle origini del mito pelagico: Girolamo De Rada e Giovanni Emanuele Bidera" (f.9-24) në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, XI, Rubbettino editore, Soveria Mannelli 2009.

<sup>28</sup> Për Paskal Skurën shih kontributin e ri të studiuesit arbëresh Francesco Perri, *Pasquale Scura, "L'Italia una e indivisibile", la sua vita attraverso i documenti*, Lepisma, Roma 2011.


ndër vatrat kryesore të romantizmit italian.<sup>29</sup>

Nuk është e rastit se në këtë klimë, në këtë qytet janë botuar disa nga veprat më të rëndësishme për letërsinë dhe kulturën arbëreshe të asaj kohe: këtu Jeronim De Rada shtypi të gjitha veprat e fazës së parë të krijimtarisë së tij letrare – përmendim *Këngët e Millosaut* (1836, 1847), *Këngët e Serafinës Thopia* (1839, 1843), *I Numidi* (1846), *L'Albania dal 1460 al 1485* (1847), *Storie d'Albania dopo il 1460* (Rrëfimet e Arbërit) (1848) – dhe në këtë qytet janë botuar vepra të tjera të rëndësishme nga ana letrare si tragjedia *Ines de Castro* e Ëngjell Basile (1847) ose kulturore si *Su gli Albanesi, ricerche e pensieri* (Mbi Shqiptarët, kërkime dhe mendime) të Vinçenx Dorsës (1848), kushtuar në mënyrë domethënëse “**Alla mia Nazione, divisa e dispersa, ma una**” (*Mëmëdhent tim, të ndarë dhe të shpërndarë, por një*), por nuk duhet harruar se në këtë qytet doli, me iniciativë të vet De Radës, më 1848 gazeta e parë shqiptare në botë: *Arbëreshi i Italisë* (L'Albanese d'Italia).

---

<sup>29</sup> “Già negli anni Trenta e Quaranta, dopo l'avvento al trono di Ferdinando II (1830-1859), la cultura napoletana mostrava una notevole vivacità, anche per l'allentarsi del controllo politico da parte dello Stato. A Napoli si pubblicano riviste in numero superiore a qualsiasi altra città italiana, si diffondono scuole private laiche, si registra un forte sviluppo degli studi filosofici, orientati secondo prospettive di tipo idealistico e spiritualistico che hanno un forte senso del divenire storico-essenziale, essenziale da questo punto di vista, la conoscenza del pensiero di Vico e del francese Cousin- e che danno grande risonanza ai programmi politico-filosofici di Gioberti. Notevole peso assume a Napoli quello spiritualismo cattolico e intimistico che è oggetto della polemica di Leopardi (...)Ma un valore particolare essenziale vi viene ad assumere lo studio della filosofia idealistica tedesca e in particolare del pensiero di Hegel, che negli anni Quaranta infonde in molti giovani intellettuali la convinzione che la libertà e i valori nazionali si affermeranno necessariamente in virtù di una forza razionale che anima il processo storico. Un pensiero liberale moderato e laico si distingue così dal neogiofismo, sostituisce alla fede cattolica una “religione” laica che crede nel nesso tra teoria e prassi e nella necessaria realizzazione della ragione nel mondo, e arriva a svolgere un ruolo decisivo negli eventi rivoluzionari del 1848....Influenzarono inoltre la cultura napoletana tendenze democratiche e radicali, legate all'Illuminismo settecentesco e all'eredità degli intellettuali giacobini del 1799 ”, shih: Giulio Ferroni, *Storia della letteratura italiana, III. Dall'Ottocento al Novecento*, Einaudi, Torino 1991, f.300.





Një numër i gazetës L'ALBANESE D'ITALIA (viti I, nr. 4, 4 mars 1848)

#### 4. Napoli për Rilindjen e dytë arbëreshe: roli i Kishës 'greke'

Një rol të rëndësishëm katalizatori në këtë mes e luajti Kisha 'greke' e Napolit, që siç do ta shohim më poshtë, me gjithë vështrësitë dhe peripecitë e shumta që e karakterizuan, u bë një pikë referimi e rëndësishme, qoftë për 'grekët' e Ballkanit, qoftë për 'grekët' e Italisë.

Ky rol u zhvillua edhe më tej me themelimin e Regjimentit Mbretëror Maqedonas (1735), oficerët e së cilës ishin njëkohësisht anëtarë të vëllazërisë fetare, madje si rregull komandanti i regjimentit ishte edhe kryetar i vëllazërisë. Në qarqet shqiptaro-arbëreshe që vërtiteshin rreth kishës 'greke' u takuan, u ndeshën, u ballafaquan e u ndërthurën ide dhe ideale që rezononin nga njëra anë me mitet e lashtësisë pellazgo-greke e nga ana tjetër me idetë dhe idealet e lëvizjes filoheleniste, për t'u shkriër në një identitet unitar greko-shqiptar që mund ta quajmë

‘transnacional’, tipik të diasporave mesdhetare<sup>30</sup>, që nyjëtohej në dy përbërës ideologjikë kryesorë:

a) ideologjia heleniste, e cila i kishte rrënjët te rryma filoheleniste që prej shekullit të kaluar kishte në Napoli një ndër vatrat e saj kryesore, e favorizuar edhe nga një traditë e hershme fetare bizantine, ku kufijtë e katolicizmit dhe të ortodoksisë nuk ishin shumë të qartë dhe të prerë;

b) ideologjia albaniste që kishte lindur rreth gjysmës së shekullit XVIII në ata që me të drejtë mund të konsiderojmë inkubatorët e mirëfilltë të mendimit filozofiko-kulturor që frymëzoi rilindjen e parë arbëreshe (e kemi fjalën këtu për qendrat e larta arsimore kishare të themeluara nga Papa i Romës përkatësisht në Shën Benedhit (1732) dhe në Palermo (1734), megjithëse e dukshme ka qenë epërsia drejtuese që në përpunimin e ideologjisë albaniste zhvilloi në kontekstin italian gjatë këtij shekulli Seminari arbëresh palermitan në krahasim me Kolegjin Korsini në Kalabri)<sup>31</sup>.

Kemi arsye ta konsiderojmë të ashtuquajturën vëllazëri të ‘grekëve’ edhe si një vatër të re ku pjesëtarët e ortodoksisë arbërore (përfshijmë këtu arbëreshët e Italisë dhe shqiptarët e Ballkanit me traditë fetare greko-bizantine) filluan të takoheshin dhe të ballafaqoheshin mbi çështje si origjina, trashëgimia fetare, trashëgimia kulturore, përkatësia kombëtare dhe gjuha.

Brenda kësaj ideologjie të re albaniste intelektualët arbëreshë u orvatën të gjenin rrënjët e tyre të lashta dhe t’i përdornin ato si një argument për të kërkuar dhe mbështetur të drejtën e kombit shqiptar për t’u çliruar nga osmanët, ashtu siç bënin të gjithë popujt e Evropës Juglindore që gjendeshin nën sundimin osman. Në funksion të këtij qëllimi ata i gjetën rrënjët te popujt më të lashtë jo-grekë të Ballkanit, pra te pelazgët dhe ilirët.

Duke i mëshuar dy elementeve kryesore të identitetit – siç ishin gjuha dhe kultura – arbëreshët përqaftuan lëvizjen e romantizmit: në rrafshin politik ata shtruan të parët në Evropë ‘çështjen shqiptare’, ndërsa në rrafshin letrar u bënë themeluesit e letërsisë moderne shqipe. Së paku këtu u realizua ëndrra e vjetër “greke” e rilindasve arbëreshë, me në krye korifeun e saj, Jeronim De Radën: Ashtu sikurse në Greqinë e

<sup>30</sup> Shih edhe për Angela Falcetta studimin, Angela Falcetta, *Diaspora ortodossa e rinnovamento culturale: il caso dell'abate greco-veneto Antonio Catiforo (1685-1763)*, Fondazione Luigi Einaudi, Torino Cromohs, 15 (2010): f.1-24,  
<URL:[http://cromohs.unifi.it/15\\_2010/falcetta\\_catiforo.html](http://cromohs.unifi.it/15_2010/falcetta_catiforo.html) >

<sup>31</sup> Për një pasqyrë complete dhe të thelluar të rolit të Seminarit italo-greko-arbëresh të Palermos si djepi kryesor i ideologjisë albaniste, shih kapitujt kushtuar përkatësisht G.Guxetës, P.M.Parrinos dhe N.Ketës në veprën e tij nga Matteo Mandalà, *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Çabej, Tiranë 2006.

lashtë shpëtimi i mëmëdheut erdhi nga kolonitë, edhe Arbërit të lashtë shpëtimi do t'i vinte nga kolonitë e saj të Italisë, që nuk mund ta linin atë në harresë, por që do t'ia kthenin, tashmë të përtërirë, atë trashëgimi të vyer që kishin marrë prej saj kur u detyruan ta braktisnin në të dalë të mesjetës. Vetëm një Poet vizionar i jashtëzakonshëm si Jeronim De Rada mund ta realizonte këtë ëndërr dhe këtë mrekulli që nuk e ka shoqen në historinë e letërsisë dhe të kulturës së popujve të Evropës.

Kisha 'greke' u themelua në qytetin e Napolit në vitin 1518, kur Tomas Asan Paleologu, nipi i Dhimitrit, ngriti kishëzën e Apostujve, që më pas iu kushtua Shënjtoreve Pjetër dhe Pal. Kjo kishë që në krye të herës i destinohet 'grekëve' që kishin lidhje ekonomike, sidomos tregtare, por edhe ushtarake, administrative, etj. me këtë qytet, u bë në rrjedhë të shekujve pikë referimi e një bote sociale, kulturore dhe etnike shumë heterogjene dhe komplekse, ku i vetmi element i përbashkët ishte identiteti fetar ortodoks<sup>32</sup>.

Megjithatë nuk mungojnë studiuesit që përpiqen ta paraqesin panoramën identitare të këtij institucioni kishtar napolitan më të thjeshtëzuar dhe të rrafshuar nga ç'ishte në të vërtetë, duke i hequr fjalës 'greke', – version perëndimor i fjalës *Ρωμαλοι* – mëdyshjen semantike që asaj i rrjedh nga shumëkuptimësia që ka kur u referohemi shekujve të sundimit osman<sup>33</sup>. Kemi parasysh këtu sidomos periudhën që shtrihet nga vitet '70 të shekullit të XVIII, kur u shfaq i ashtuquajtur i iluminizëm grek, deri në shpalljen e pavarësisë së Greqisë (1830) – për t'i dhënë asaj vlerën patriotike por anakronistike të një etnonimi 'kombëtar' të sotëm.

Në Statutin e vëllazërisë (1764)<sup>34</sup> për të treguar anëtarët e Kishës greke të Napolit dhe të popujve ortodoksë të Lindjes ballkanike që aty përfaqësoheshin, flitej për 'la nazione greca', si një përpjekje për të përmbledhur dhe bashkuar një 'komunitet' ku bashkëjetesa ishte në të vërtetë shpesh problematike dhe e vënë në

---

<sup>32</sup> Heterogjeniteti etnik i komuniteti është pasqyruar qartas në monumentet e ndryshme dhe të bukura që ruhen në oborrin e kishës, por duhet të vërejmë se në monumentet e vjetra origjina 'arbëreshe' e disa nga figurave më të spikatura të anëtarëve të kësaj famullie është e qartë: p. sh. ajo e kapedanëve stradiotë, vëllezërit Nicolò dhe Angelo Maipesi (italisht) "nobilì capitani albanesi" (pa datë), ajo e ΙΩΑΝΝΗΣ ΜΟΥΖΑΚΗΣ (greqisht) dhe ndoshta ajo e Nikollë Drakoleo nga Korone, e vitit 1604.

<sup>33</sup> Vëren me të drejtë studiuesi anglez Mackridge se mëdyshja semantike i rrjedh fjalës *Romaïos/Romiós* ("grek" në traditën perëndimore) nga fakti se ajo shërben për të treguar njëkohësisht qoftë popullin me gjuhë romaïke, si quhej gjuha e Bizantit në trevat e Rumelisë, që përfshinte Greqinë dhe trevat e afërta me popullsi të krishtera nën perandorinë turke, qoftë të krishterët ortodoksë osmanë në përgjithësi (shih Peter Mackridge, *Language and national identity in Greece, 1766-1976*, Oxford University Press, Oxford 2009, f. 51).

<sup>34</sup> *Statuto con cui deve regolarsi la Chiesa e Confraternita de' Santi Pietro e Paolo de' Nazionali Greci in Napoli, munito di Regio exequatur del 20 Febbraio 1764*, Stamperia del Fibreno, Napoli 1861.

rrezik nga konflikte të brendshme. Dhe kjo ndodhte jo vetëm për shkak të konflikteve të brendshme midis besimtarëve për të pasur pozita drejtuese brenda kësaj vëllazërie me peshë të madhe politike dhe ekonomike në shërbim të pjesëtarëve të kishës, por edhe për shkak të larmisë etnike, kulturore dhe gjuhësore. Brenda një koncepti pseudounitar si ‘*nazione greca*’, zbulojmë kështu njerëz që ishin të lidhur midis tyre nga një faktor identitar i fortë siç ishte tradita fetare, por që nuk kishin aspak një identitet etnik homogjen<sup>35</sup>.

Me fjalën ‘greke’ gjatë shekujve të sundimit osman kuptohej qoftë prejardhja nga ‘oekumeni bizantin’ – ajo botë që Obolensky e quajti me një term shumë të goditur nga ana semantike dhe konceptuale *Byzantine Commonwealth*<sup>36</sup> – që përfshinte popuj etnikisht të ndryshëm të lidhur nga ana politike, administrative dhe ekonomike, qoftë vetëm të krishterët ortodoksë të Ballkanit pavarësisht përkatësisë së tyre etniko-kombëtare.


Duke u nisur nga një perspektivë më shumë hetero-identifikuese sesa vetëidentifikuese, kuptojmë më mirë se si konsideroheshin nga të tjerët ‘grekët’ e vëllazërisë fetare napolitane. Nën këtë fjalë ne gjejmë këtu: ‘grekët’ osmanë (katolikë ose ortodoksë, grekë ose shqiptarë ortodoksë), ‘grekët’ venecianë (katolikë ose ortodoksë, grekë ose shqiptarë ortodoksë), ‘grekët’ koronei (katolikë ose ortodoksë, grekë ose arvanitas), greko-shqiptarët e Regjimentit Mbretëror Maqedonas (katolikë ose ortodoksë, shqiptarë nga Himara ose grekë nga Korfuzi a nga ishujt e tjerë të Eptanezit), ‘grekët’ e Mbretërisë së Napolit (arbëreshë me rit lindor nga Kalabria, Sicilia, Basilikata, Abruci).

Për të na shpjeguar më mirë dhe pa hije dyshimi se ç’kuptohej asokohe me ‘grekë të Mbretërisë së Napolit’ na ndihmon ky mbishkrim zyrtar që ruhet edhe sot në oborrin e kishës, ku me fjalë të gdhendura në gur mbreti i Napolit, Ferdinandi II i Burbonëve, dekreton për të dytën herë përjashtimin e arbëreshëve të Kalabrisë nga

<sup>35</sup> Me sa duket e njëjta situatë, komplekse dhe heterogjene nga ana etnike, hasej edhe në institucionet e tjera fetare ‘greke’ të qyteteve mesdhetare të kohës ku nën çatinë e së njëjtës kisha dhe të së njëjtës tradite fetare përfshihej shpesh shumësia identitare e anëtarëve të komunitetit: shih për këtë tezën e doktoratës të Mathieu Grenet, *La fabrique communautaire: les Grecs à Venise, Livourne et Marseille, v. 1770-v. 1830*, European University Institute, Florence 2010. Gjithashtu me shumë interes edhe nga e njëjta perspektivë në trajtimin e komuniteteve të diasporës me një përqsje transnacionale, paraqitet teza e doktoratës e studiueses italiane Angela Falcetta, deri sot e pabotuar, me titull: «*Li Greci fuggiaschi delli luoghi d'Italia*» *nomini, reti e comunità attraverso i confini politici e confessionali*.

<sup>36</sup> Ideja e Bizantit si një komunitet kulturor dhe fetar, i bashkuar nga tradita e përbashkët bizantine, është shtruar për herë të parë nga studiuesi Dimitri Obolensky, në librin e tij *The Byzantine Commonwealth: Eastern Europe, 500-1453*, Praeger Publishers, New York, 1971.

vëllazëria. Dekreti, që mban datën 12 shtator 1853, mund të jetë një formë ndëshkimi politik për pjesëmarrjen masive të arbëreshëve në kryengritjet antiburbone të atyre viteve, ose edhe i nxitur nga mosmarrëveshjet e shumta që karakterizonin jetën e brendshme të kishës greke të Napolit.



*Dekreti i dëbimit të Arbëreshëve nga Kisha greke e Napolit, nga mbreti Ferdinandi II i Burbonëve  
(foto nga Atanasio Pizzì)*

## **5. Filohelenizmi dhe filoalbanizmi në ambientin shqiptaro-arbëresh napoletan**

Le të ndalemi tani, në funksion të objektit të këtyre radhëve, në atë fazë të historisë kulturore greke që mund ta vendosim në vitet '70 të shekullit XVIII dhe që njihet me termin *iluminizëm grek*. Me mbiemrin *grek* këtu natyrisht kuptohet etnosi grek brenda Perandorisë Osmane dhe jo kombi grek që si i tillë në atë periudhë ende nuk ekzistonte. Kjo lëvizje u shfaq sidomos në Kostantinopojë që asokohe ishte ende kryeqyteti 'moral' i helenizmit, si edhe në të ashtuquajturat principata danubjane, të

qeverisura nga familje fisnike greke, të cilat jo vetëm që kishin pozita të larta në administratën perandorake turke, por ishin edhe më të ndjeshme ndaj ndikimeve të jashtme të kulturës perëndimore.

Kjo fazë jo rastësisht përkon me lindjen në Evropë, fill pas luftës ruso-turke (1770), të asaj lëvizjeje që e quajmë *filohelenizëm*<sup>37</sup>. Ishte një rrymë kulturore e përkrahur nga rrethet e krishtera ortodokse të Fanarit<sup>38</sup> që kërkonte mbështetjen e popujve dhe të opinionit publik evropian, sidomos të Rusisë që kishte hyrë në luftë me Perandorinë Osmane e që mëtonte të bëhej garante e ortodoksisë dhe e lirisë për popujt ‘grekë’ të Lindjes që vuanin nën pushtimin shumëshekullor osman.<sup>39</sup>

Nismëtari i lëvizjes kulturore filoheleniste në Itali dhe në Evropë mund të konsiderohet me të drejtë himarjoti Anton Gjika (it. Antonio Gicca), i cili më 1771 botoi në gazetën e Firencës *Notizie del mondo*<sup>40</sup> një thirrje të zjarrtë për lirinë e Greqisë: *Voti dei Greci all’Europa Cristiana*, ku kërkonte rreshtimin e forcave të krishtera evropiane në krah të Rusisë dhe të careshës Katerina e Madhe, si edhe mbështetjen e tyre për kauzën greke në luftën ruso-turke<sup>41,42</sup>. Por ai njëkohësisht kërkonte edhe

<sup>37</sup> Shih Arnaldo Di Benedetto, “Le rovine d’Atene”: Letteratura filellenica in Italia tra Sette e Ottocento” (f. 335-354) në *Italica*, vol. 76, nr. 3, University of Toronto Mississauga, 1999.

<sup>38</sup> Fanar (turq. Fener), Lagje historike e Stambollit ku ndodhet selia e Patriarkanës greko-ortodokse.

<sup>39</sup> Edhe para se të lindte “filohelenizmi”, që nga dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XVIII, ndërsa Rusia po ndërtonte identitetin e vet politik dhe kulturor evropian, disa intelektualë ballkanas kërkuan në mitin e carit qytetërues një domethënie shpëtuese për vendet e tyre: gjetën kështu një mënyrë për ta përtërirë botën ortodokse dhe panë te Pjetri i Madh çlirimtarin e tyre. Krijimit të këtij miti i shërbeu edhe biografia e tij, *La Vita di Pietro il Grande (Jeta e Pjetrit të Madh)* e hartuar nga abati greko-venedikas Antonio Catiforo (1739), që e pasqyron më së miri këtë besim të madh që intelektualët më në zë të ortodoksisë kishin asokohe ndaj carëve rusë si shpëtimtarë të Lindjes së robëruar nga turqit: “...i Popoli del rito Greco, che gemono sotto il giogo dell’Ottomano, cominciato avevano a riguardare il Czar Pietro come l’Angelo mandato dal cielo per metter fine alla Tirannia dei Turchi. Anzi l’istesso Czar [...] avea concepito speranze, che il Cielo l’avesse destinato, per rovesciare la tirannia de’barbari Maomettani, e rimetter la gloria del Greco Imperio [...] onde lusingavasi che tutti i Greci sudditi del Turco alla prima occasione si sollevarebbero in suo favore”. Cituar sipas studiueses Angela Falsetta: *Diaspora ortodossa e rinnovamento culturale: il caso dell’abate greco-veneto Antonio Catiforo (1685-1763)*, Fondazione Luigi Einaudi, Torino Cromohs, 15 (2010): f. 1-24.

<sup>40</sup>Sipas studiuesit italian Franco Venturi (1914-1994), kjo thirrje e Gjikkës duhet vlerësuar si “il più importante appello filellenico apparso allora non solo in Italia, ma nella intera Europa, destinato a risuonare anche ben lontano dalle terre toscane” (shih: F. Venturi, *Settecento riformatore*, vol. 3, Einaudi, Torino 1979, f. 83).

<sup>41</sup> Thirrja e Gjikkës që i drejtohej jo vetëm shteteve evropiane, por edhe careshës Katerina dhe popullit rus, për të vazhduar luftën kundër turqve në favor të Greqisë, pati një jehonë të madhe edhe në Rusi, pasi u botua edhe rasisht më 8 gusht 1771 në nr. 656 të gazetës “Sanktpeterburgskie vedomosti” (shih: Franco Venturi, *Settecento riformatore*, vep. e cit., f.103).

<sup>42</sup> Këto ide sigurisht e frymëzuan careshën Katerina e dytë për hartimin e të ashtuquajturit projekt ‘Bizant’ ose projekt grek, siç u quajt më vonë, dhe që ishte skicuar si plan gjeo-politik

përkrahjen e careshës dhe të popullit rus për të çliruar 'Romën e re' ose 'Romën e dytë', siç quhej nga ortodoksët Stambolli. Sipas filohelenëve, trysnia ushtarake e Rusisë jo vetëm që do të mund të çlironte Greqinë nga pushtimi shumëshekullor osman, por do të rilindte edhe kulturën, filozofinë e artet në Greqi dhe në tërë Evropën.

Me origjinë nga krahina e Himarës, Anton Gjika ishte i biri i kontit Strati-Gjika, i cili në vitin 1735 me urdhër të mbretit të Napolit organizoi Regjimentin Mbretëror Maqedonas (Reggimento Real Macedone), që përbëhej nga shqiptarë dhe nga grekë që jetonin nën sundimin turk dhe venecian. Antoni, që ishte ndër ihtarët më aktivë të politikës ruse ndaj Shqipërisë dhe Greqisë, prej vitit 1777 deri në vitin 1783 shërbeu pranë legatës së Mbretërisë së Rusisë në Napoli si këshilltar i ambasadorit rus pranë Mbretërisë së dy Sicilive.

Në frymën e kësaj rryme filoheleniste që përuroi Anton Gjika gjejmë edhe disa figura të shquara të botës arbëreshe të Kalabrisë dhe të komunitetit arbëresh të qytetit të Napolit, si prifti Josif Buljari<sup>43</sup> dhe intelektual i njohur Paskal Baffi<sup>44</sup>. Edhe arbëreshi i Sicilisë Nikollë Keta, që me veprat e tij të shumta - letrare, kulturore dhe leksikografike<sup>45</sup> - duhet konsideruar pa hije dyshimi paraardhësi i mirëfilltë i Rilindjes

---

në një letër që ajo i dërgonte perandorit austriak Zef II më 21.9.1782. Obiektivi i Katerinës ishte të tërhiqte simpatinë e Evropës së tërë që ishte e ndjeshme ndaj Greqisë së vjetër dhe kulturës së saj, prandaj u quajt edhe projekti 'grek', dhe u drejtohej të gjithë popujve të krështerë të Lindjes së robëruar nga turqit, për të çliruar atë pjesë të Evropës nga pushteti osman dhe për të rikrijuar perandorinë e Bizantit, nën kontrollin rus. Në tërë Ballkanin, me Perandorinë osmane në krizë, kjo strategji i shërbente për të rritur padyshim ndikimin e saj në intelektualët e këtij rajoni.

<sup>43</sup> "Don Giuseppe Bugliari, *cappellano del Reggimento Real Macedone, costituito in massima parte da soldati ed ufficiali di origine albanese (...)* era anche un intellettuale conosciuto nell'ambiente dei letterati napoletani come cultore della lingua greca in cui la sua bravura si evidenziava per la composizione di poesie. Egli fu, infatti, autore di una poesia, dedicata alla zarina Caterina II, sottoscritta col nome di Josif Bouliarios. Si deve, pertanto, ritenere che appartenesse a quel discreto gruppo di intellettuali filo-ellenici che speravano nella rinascita della Grecia e ne vedevano uno strumento nella politica estera della zarina, ma che contestualmente costituivano anche quella intelligenza napoletana e meridionale, attestata su posizioni progressiste, anticipatrici del Risorgimento nazionale" (f. 1-20) Domenico Cassiano, "Angelo Masci (1758-1821) ed il principio di ugualianza al tramonto del feudalesimo", në

[www.arbitalia.it/cultura/interventi/2010cassiano\\_angelo\\_masci.pdf](http://www.arbitalia.it/cultura/interventi/2010cassiano_angelo_masci.pdf)

<sup>44</sup> Dimë se edhe Baffi hartoi në greqisht një ode të frymëzuar nga poezia greke e Pindarit, kushtuar perëndeshës së Rusisë Katerina e dytë, që autori la dorëshkrim dhe që ia dhuroi në vitin 1781 eruditit Angelo Maria Bandini (1726 -1803) . Ky dorëshkrim ruhet sot në Firenze, Biblioteca Marucelliana, B. I. 18, cc. 285r-287r : shih zërin 'Pasquale Baffi' në A. Petrucci, C. Francovich, *Dizionario Biografico degli Italiani*, volume 5 (1963), [www.treccani.it/enciclopedia/pasquale-baffi\\_\(Dizionario-Biografico\)/](http://www.treccani.it/enciclopedia/pasquale-baffi_(Dizionario-Biografico)/).

<sup>45</sup> Shih Matteo Mandalà, "Për botimin kritik të veprave të Nikollë Ketës" (f.171-272) në Matteo Mandalà, *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Botime Çabej, Tiranë 2006.

shqiptare, i kushtoi një vëmendje të posaçme politikës së careshës Katerina e dytë në Evropën lindore.

Nga letërkëmbimi i Ketës<sup>46</sup> me oborrin mbretëror rus në periudhën 1789-1797 dhe vetë careshën e Ruisë, por edhe me diplomatët rusë në Napoli, dalin në pah shpresat e mëdha që disa intelektualët arbëreshë, brenda rrymës filoheleniste, ushqenin ndaj politikës së Katerinës së Madhe për të çliruar tokat shqiptare, ato greke dhe në përgjithësi tokat e ‘Rumelisë’ nga sundimi turk, bashkë me Kostandinopojën, “Romën e dytë”, nga Moska që konsiderohej si “Roma e tretë”. Është për t’u vënë re se si Nikollë Keta në një ndër këto letra i prezantohet të birit të Careshës, princit Kostandin: “*io che oriundo di Macedonia, sono prete greco-albanese, Rettore di questo conazionale Seminario*” (‘unë që jam me origjinë nga Maqedonia, prift greko-arbëresh, Rektor i këtij Seminari bashkëkombëtar’)<sup>47</sup>.

Nga ky letërkëmbim me perandoreshën dhe të birin del se Nikollë Keta për të mbajtur kontaktet me oborrin perandorak rus përdorte kanalet diplomatike, kryesisht ambasadat e Ruisë në Itali, përkatësisht të Napolit gjatë viteve 1783-1785, kur me gjasa kishte atje si bashkëpunëtor të brendshëm edhe vetë Anton Gjickën, dhe të Venecies në vitin 1790. Përmes këtyre kanaleve Keta i dërgoi oborrit perandorak rus kopje në dorëshkrim të disa veprave të tij që shpresonte se mund të ngjallnin interes në Shën Pjetërburg dhe se mund të shtypeshin atje, meqenëse profetizonin çlirimin e afërt të ‘Romës së dytë’ nga ‘Roma e tretë’ nën udhëheqjen e careshës dhe të pasardhësit të saj.

Këto vepra ai i quan ‘*i miei Ellenici lavori*’ (‘punimet e mie ‘greke’) që më vonë sqaron se ishin ‘*tre intieri miei scritti Accademici*’ (‘tri shkrime të tëra akademike’) dhe se shpresonte të dilnin ‘*in Italiano o Russiano torchio*’ (‘nën shtypin italisht ose rusisht’). Në një letër që shkruan nga Napoli pa datë, por që siç shënon Matteo Mandalà, me gjasa duhet të jetë e viteve 1791-1792, Keta pohon se ia kishte dorëzuar këto tri

<sup>46</sup> Shih Matteo Mandalà, “Per un profilo bio-bibliografico di Nicolò Chetta” (f. 43-54) në *Nicolò Chetta nel bicentenario (1803-2003)* a cura di Matteo Mandalà, A.C. Mirror, Palermo 2003, f. 50-2. Falë kërkimeve të M. Mandalà-së nëpër arkivat e Sicilisë dhe në fondin dorëshkrimor të Gangales pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës, kemi sot në dispozicion një fond dokumentesh shumë të rëndësishme që hedhin dritë të plotë mbi këtë figurë madhore të kulturës arbëreshe si edhe epokën e tij.

<sup>47</sup> Nga kjo vetëdeklarata e Ketës – që përkon edhe me titullin e veprës së tij *Tesoro di notizie su de’ Macedoni* (1777) – nocioni i Arbërit përfshinte edhe atë të Maqedonisë. Edhe Pjetër Bogdani në veprën e tij të famshme *Cuneus Prophetarum* (1685) vetëquhet ‘maqedonas’ (latinisht: macedonis) dhe atdheun e tij e quan ‘Arbën’ (dhe latinisht: Epirus). Edhe në një hartë të Ballkanit që i kushtohet në vitin 1689 kardinalit me origjinë shqiptare Giovanni Francesco Albani, papës së ardhshëm Klementi XI, bëhet fjalë për Shqipërinë duke e quajtur ‘*Albania propriamente detta o superiore o Macedonia occidentale*’, ku identifikohet Maqedonia e sotme si ‘*parte di Macedonia*’ ndërsa pjesa e poshtme si ‘*Epiro o Bassa Albania*’.



dorëshkrime, bashkë me një letër për careshën, një shqiptari që sapo kishte mbërritur në Napoli, don Jani Gjika (italisht: Giovanni Gicca), i cili ishte edhe kushëriri i Anton Gjikkës që zumë ngoje më lart.

## 6. Regjimenti Mbretëror Maqedonas dhe Rilindja arbëreshe

Përmes një pllake përkujtimore që ruhet sot në oborrin e kishës së Martoranës në Palermo, por që deri në luftën e dytë botërore ishte e vendosur në kishën e Shën Kollit të Seminarit arbëresh të Palermos, që u shkatërrua nga bombardimet gjatë luftës, mësojmë se Jani Gjika ishte nga Himara – kishte lindur në Dhërmi më 1743 – dhe se vdiq në Palermo më 1812. Viti i vdekjes së Jani Gjikkës (1812) përkon me zgjidhjen - për shkak të ngushticës financiare të oborrit mbretëror - të këtij korpusi ushtark, anëtarët e të cilit u kthyen në Epir vitin e pasëm, por menjëherë mbreti Ferdinandi vendosi ta rikrijonte duke ngarkuar për këtë veprim gjeneralin anglez Richard Church, që kishte vepruar në ishujt e Eptanezit me një ushtri të tillë kundër francezëve. Ky balation ‘maqedonas’ i rindërtuar veproi deri në vitin 1820, kur u mbyll përfundimisht kjo përvojë e ushtarëve kryesisht shqiptarë epirotë në Mbretërinë e Napolit<sup>48</sup>.

Jani Gjika që kishte qënë *Tenente colonello* (nënkolonel) i Regjimentit mbretëror maqedonas, ishte i biri i Dhimitrit, vëllai i kontit Strati Gjika. Pllakën ia kushtoi i nipi, biri i së motrës, Dhimitër Leka (1779-1862), personazh shumë i njohur ndër qarqet intelektuale arbëreshe <sup>49</sup>, edhe ky me origjinë nga Dhërmiu i Himarës, ‘që nënshkruhet

---

<sup>48</sup> Por vazhduan përpjekjet e himarjotëve për të rikrijuar një ushtri të tillë në Napoli, duke i bërë mbretit një kërkesë të posaçme, që lexohet në një letër dërguar nga Himara më 2 gusht 1821: “*La nazione albanese ha sempre serbato l’attaccamento al Real Trono di Vostra Maestà. Or che si vede alquanto libera brama ognuno di servire il vostro Real Trono con quella solita fedeltà che gli Albanesi per lo corso di ottanta anni hanno prestato i loro servizi in tutte le campagne.*” (Dokumenti ruhet në Arkivin e Napolit, tek fondi i jashtëm, tek dosja Albanesi, n. 4341 (cituar nga Salvatore Panarea, “Albanesi nel Salento e Albanesi al servizio del Regno di Napoli” (f.329-343) në *Rinascenza Salentina*, Anno VII, XXVI-XXVII, Lecce 1939, f.341).

<sup>49</sup> Figura e Dhimitër Lekës ishte atëherë shumë ‘popullore’ mes arbëreshëve të Italisë. Para Jeronim De Radës edhe Cesare Marini ia kishte kushtuar Lekës një vepër deri sot pak e njohur mbi kulturën arbëreshe, me titull: *Memoria su’ riti delle nozze presso gli albanesi dedicata al sig. brigadiere D. Demetrio Lecca, commendatore del Real Ordine di S. Ferdinando, cav. dell’ordine di San Giorgio, ispettore della gendarmeria reale, dall’avvocato Cesare Marini*, Dai Torchi di Settembre, Napoli 1831. Edhe studiuesi i shquar arbëresh Vinçenz Dorsa shkruan për të: “*...Demetrio Lecca attuale Maresciallo di Campo tuttavia in servizio del nostro governo, uomo cui la Nazione albanese è per mille titoli riconoscente, di nobile famiglia della Chimera stretta in parentela col principe de’ Mirditi, e nel cui petto ferve*

*Tenente generale* (gjeneral leitnant), i cili ka qenë komandanti i fundit i regjimentit. Dhe Dhimitër Lekës Jeronim De Rada ia kushtoi veprën e tij të parë letrare *Canti di Milosao* (Këngët e Millosaut): “**A S.E. il Gen.Brigadiere Commendatore Signor Demetrio Lecca, questi canti che sien testimonianza dell’attaccamento agli antichi costumi della dispersa gente d’Epiro, Girolamo De Rada**”<sup>50</sup>. Meqënëse me këtë vepër letrare e ka zanafillën letërsia moderne shqiptare, këto lidhje na shërbejnë për të kuptuar ambientin kulturor të posaçëm që përgatiti dhe shpjegon këtë fazë të re të kulturës arbëreshe dhe shqiptare.

Lidhur me rolin që zhvilloi Regjimenti mbretëror maqedonas<sup>51</sup> në marrëdhëniet historike shqiptaro-arbëreshe, po japim disa të dhëna të përgjithshme për këtë formacion ushtarak të veçantë të Mbretërisë së Napolit. Regjimenti u formua në vitin 1734 nga mbreti Karli i Burbonëve, që u quajt pastaj Karli III mbret i të dy Sicilive, dhe kishte si referues kontin Gjergj Korafà, nga ishulli i Qefalonisë, oficer me gradën kolonel, dhe kontin Strati-Gjika, nga Himara<sup>52</sup>.

---

*potentemente l’amore nazionale*”, shih *Su gli Albanesi, ricerche e pensieri*, di Vincenzo Dorsa, Napoli, Dalla Tipografia Trani, 1847, f.113.

<sup>50</sup> Shih *Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, figlio del Despota di Scutari*, Napoli, Da’ Tipi di Guttemberg, 1836. Por mentori i vërtetë i Poetit të Maqit ka qenë Emanuele Bidera (1784-1858), arbëresh me origjinë nga Pallaci (ital. Palazzo Adriano), një ndër intelektualët më në zë në Napolin e asaj kohe, i cili e inkurajoi nxehtësisht De Radën t’i botonte sprovat e para të tij poetike që Poeti i kishte deklamuar te shkolla e tij: “*E come gli dissi de’ miei esercizi in nostra lingua ed udì qualche ode del Milosao, non lascio ragionamento che non usasse per indurmi a metterle in luce. E mi trovò ei stesso il tipografo, intanto ch’io facevami venire da casa i danari per la stampa. Si pubblicò nell’agosto del 1836 quella cantica dedicata al Maresciallo di Campo del re, Demetrio Lecca, albanese esso pure ma della Madrepatria e rimasto nel regno dopo sciolto il Reggimento Real Macedone, in cui avea militato unitamente a Marco Bòtzar?*”, në Girolamo De Rada, *Autobiologia*, primo periodo, Tipografia Municipale di F.Principe, Cosenza 1898, f. 21.

<sup>51</sup> Për një historik të këtyrë Regjimenti shih: Raoul Manselli, “Il Reggimento albanese Real Macedonia durante il regno di Carlo di Borbone” (f. 142-167) në *Archivio storico per le province napoletane*, A.71, Napoli (1950-1951) dhe Paolo Petta, *Stradioti. Soldati albanesi in Italia (sec. XV-XIX)*, Argo, Lecce 1996.

<sup>52</sup> “Il Sig.Conte Stratti Ghica era un potente signore e ricco abitante dello Epiro (Albania Meridionale). Egli fu Tenente Colonello e poi Tenente Generale nel 1784 del Real Reggimento Macedone, che nel 1734 venne ideato da Carlo di Borbone di Napoli, poi Carlo III Re delle due Sicilie, e nel 1735 venne effettuato il Reclutamento, a mezzo del Conte Stratti con elementi presi dalla bassa Albania. Allo stesso Stratti successe il Sig. Giorgio Carafà, greco dell’isola di Cefalonia, educato e domiciliato in Venezia ed impiegato al servizio militare di quella Repubblica. Fu questi Colonello e poi nel 1775 Tenente Generale del medesimo Reggimento Macedone (A. Lek, “Cenno storico dei servizi militari prestati nel Regno delle due Sicilie dai greci, epiroti, albanesi e macedoni in epoche diverse”, Corfù 1843, f.17) cit. sipas shkrimit: *Manoscritto inedito di papas Andrea Figlia (1764)*, me shënime të mëvonshme të shkuara nga papas Lorenzo Perniciario, edizione on line con trascrizione a cura di Giuseppina e Pietro Di Marco, Mezzojuso 2008, f.11.

Që fill pas marrëveshjes me mbretin e Napolit, Strati-Gjika u nis për në Shqipëri për të rekrutuar oficerët dhe ushtarët e repartit të sapoformuar. Ata duhej të ishin ‘*nazionali greci*’ – e përsërisim se me këtë term shënohet këtu përkatësia kishtarë dhe jo ajo kombëtare – dhe qytetarë nën sundimin osman dhe jo nën sundimin venecjan, si edhe duhej të ishin katolikë, siç del një dokument i ‘vëllazërisë’ së grekëve të Napolit të vitit 1764<sup>53</sup>: “*Intorno poi al sistema vien chiarito da' fatti divisati, che in detta Chiesa siavi stata una confraternita dei Greci non da molto tempo dismessa, da' quali si presceglievano li governatori, e detti greci doveano essere tutti cattolici Romani, che aveano fatto la professione di fede nella corte Arcivescovile di questa Città, dalla quale confraternita si eliggevano quei governatori, che doveano amministrare, e governare la Chiesa, onde l'espedito più proprio, che sembra alla Camera regale sarebbe di rimettersi nuovamente in piedi detta Congregazione di Greci Cattolici Romani nella maniera che fu eretta, ed indi governata*”.

Nga ky dokument del qartë edhe pozita e kontit Strati Gjika, kolonel i ushtrisë, i cili kërkonte që të merrte pjesë në qeverisjen e kongregatës: “*Compare in questa Curia il brigadiere Conte (omissis) Tenente Colonnello del reggimento regal Macedone, affin di essere inteso per la ragione, e diritto, che circa il governo di detta Chiesa spetta ad esso Conte, ed agli altri ufficiali Nazionali Greci*”.

Lidhjet që u krijuan kështu midis kishës greke dhe regjimentit ‘maqedonas’ – i përbërë kryesisht nga himarjotë, por edhe nga epirotë dhe banorë prej ishujve të Eptanezit – ishin me të vërtetë shumë të ngushta dhe kjo ushtri ishte *de facto* pjesë përbërëse e institucionit kishtar napolitan. Këto lidhje të posaçme shihen qartas po të analizohen marrëdhëniet e dendura që banorët e Badhesës (it. Villa Badessa), komunitet i ri shqiptar i themeluar më 1743<sup>54</sup>, kishin me Kishën e Shën Pjetrit dhe Shën Palit të Napolit. Avantazhet e shumta që këta banorë përfituan drejtpërdrejt nga Mbreti i Napolit për t’u sistemuar në Badhesë, lidhen me ndërhyrjet që ushtruan tek oborri mbretëror ata oficerë që erdhën dhe u vendosën aty, bashkë me ushtarët, gjithashtu himarjotë, që ishin rekrutuar nga vetë Korafai gjatë ekspeditës së tij të parë në Lindje. Oficerët himarjotë që ndërkohe ishin vendosur bashkë me garnizonin e regjimentit në Badhesë, i kërkuan mbretit të tërhiqnin aty edhe familjet e tyre<sup>55</sup> thjesht

---

<sup>53</sup> *Statuto con cui deve regolarsi la Chiesa e Confraternita de' Santi Pietro e Paolo de' Nazionali Greci in Napoli, munito di Regio exequatur del 20 Febbraio 1764*, Stamperia del Fibreno, Napoli 1861.

<sup>54</sup> Të dhëna të përditësuara për historinë e këtij fshati me origjinë shqiptare dhe jo arbëreshe në Itali shih: Gaetano Passarelli, *Le icone e le radici: le icone di Villa Badessa*, Rosciano 2006, f. 9-20.

<sup>55</sup> Këtë shpjegim mbi arsyet dhe rrethanat e vërteta të themelimit të komunitetit të Badhesës e kemi nga Gaetano Passarelli (shih *vep. e cit.*, f. 11), i cili na kujton se edhe Lino Bellizzi në librin e tij *Villa Badessa. Oasi orientale in Abruzzo*, Tracce, Pescara 1994, f. 86-91, e kishte hedhur poshtë tezën “më dramatike dhe më heroike” të Rodotà-së mbi themelimin e këtij fshati.

sepse donin t'i kishin pranë dhe jo sepse përndiqeshin për arsye fetare nga turqit myslimanë, siç shkruan Pietro Pompilio Rodotà<sup>56</sup>.

## 7. Mbyllja e pranisë arbëreshe në kishën “greke” të Napolit

Siç vë në dukje Gaetano Passarelli, “Në Napoli ashtu si në Barletta, Ankona, Leçe, Livorno, Trieste etj. *immigrantët* – që ndibeshin si anëtarë të një etnosit jo sepse ishin të lidhur me një etni në kuptimin modern të fjalës, por me ortodoksinë – përfaqësonin një lloj ngjizësi etniko-fetar kulturor anti-turk dhe anti-latin, ishin të bashkuar në vëllazëri brenda të cilave kujdeseshin për aspektet fetare, ashtu si për ato tregtare ose për karrierën e anëtarëve [...] Vëllazëria napolitane, e formuar nga epirotë (grekë, shqiptarë, maqedonas) dhe nga jonikë që vinin nga ishujt e Eptanezët, ndryshe nga të tjerat, kishte një fizionomi më shumë burokratiko-ushtarake se tregtare [...] PhratRIA graecorum kishte marrëdhënie të rregullta me vendet e origjinës së anëtarëve të vet, qoftë përmes letërkëmbimit, qoftë përmes udhëtimit që ata bënin, qoftë përmes veprave (artistike) që ato porosin në atdhe. Vëllazëria napolitane, ashtu si simotrat e saj në Itali, pësoi brenda saj çarje të thella për shkak të prejardhjes së ndryshme të anëtarëve të vet, por përplasjet më të shpeshta kishin të bënin me pozitën e ndryshme – filo-latine apo anti-latine – që merrnin ata”.<sup>57</sup>

Këto grindje historike karakterizonin raportet midis greko-venedikasve, që ishin banorët e zotërimeve të Venedikut në ishujt e Eptanezët, dhe greko-osmanëve, që ishin epirotët në sundimin turk, me arbëreshët që mbeteshin si palë e tretë. Këta të fundit si katolikë natyrisht anonin ndaj pozitave politike të ‘venedikasve’, por ndonjëherë për arsye etnike dhe si ndjekës të ritit bizantin solidarizoheshin me krahun tjetër, sidomos në rastet e krizave ndërkombëtare (p.sh. kur shpërtheu lufta ruso-turke u inkuadruan ndër radhët e epirotëve ortodoksë).

Këto pozita të luhatshme karakterizuan raportet midis anëtarëve të vëllazërisë gjatë shekullit XVIII, megjithëse statuti i miratuar në vitin 1764 sanksiononte epërsinë e pjesës greko- venedikase<sup>58</sup> mbi atë greko-osmane, duke u njohur arbëreshëve, që

<sup>56</sup> Shih: *Dell'origine, progresso, e stato presente del Rito Greco in Italia, osservato dai Greci, Monaci Basiliani, e Albanesi*, libri tre scritti da Pietro Pompilio Rodotà, libro terzo, Roma MDCCLXIII, f. 62-63: “Essendo fieramente attaccati, e aspramente soverchiati dai confinanti Maomettani, si salvarono nei contigui cantoni [...] Vennero nel regno di Napoli con tre Sacerdoti. Umanamente trattate dalla Maestà sua, furono spedite a popolare il feudo rustico della Badessa, membro della terra di Pianella [...]. Eresse ancora il Re e dotò la chiesa, in cui dovessero professare il rito greco che sotto la direzione di due Sacerdoti esattamente osservano”, f. 62-63.

<sup>57</sup> Gaetano Passarelli, *rep. e cit.*, f. 12.

<sup>58</sup> Komponenti greko-venedikas i vëllazërisë së famullisë greke të Napolit e kishte prejardhjen kryesisht nga ishujt jonikë të Eptanezët, ku kufiri midis kishës katolike dhe asaj ortodokse ishte

ishin katolikë me rit lindor, qytetari të plotë në famullinë e Shenjtorëve Pjetër dhe Pal, së paku deri në vitin 1877 kur për arsye politike u vendos që vëllazëria të kalonte nën drejtimin e grekëve ortodoksë.

Ndër priftërinjtë arbëreshë që vepruan në këtë kishë gjatë kësaj kohe, përmendim: papas Giuseppe Bugliari (Josif Buljari), nga Shën Sofia, papas Andrea Figlia<sup>59</sup> (Ndre Filja), nga Munxifsi, papas Antonio Pace (Anton Paçe), nga Shën Kostandini, papas Nicola Chetta (Nikollë Keta), papas Francesco Antonio Tamburi (Frangjisk Anton Tamburi), nga Shën Vasili, papas Demetrio Camarda (Dhimitër Kamarda) nga Hora e Arbëreshëve, papas Costantino Tamburi (Kostandin Tamburi) nga Shën Vasili, papas Giuseppe Martino (Josif Martino) nga Ungra etj.).

Me ndryshimet e skenarit gjeo-politik mesdhetar dhe evropian gjatë shekullit XIX dhe me formimin e disa shteteve kombëtare si ai grek që u shpall më 1830, bashkë me tkurrjen e vazhdueshme të sundimit të Perandorisë Osmane në Evropën juglindore, edhe në gjirin e vëllazërisë u ashpërsua konflikti mes greko-katolikëve të etnisë arbëreshe me rit lindor, nga njëra anë, dhe greko-ortodoksëve të etnisë greke, nga ana tjetër.

Në fjalë të tjera, kemi një ripozicionim të përbërësve etnikë që përfaqësonin polet tradicionale të vëllazërisë napolitane dhe një radikalizim të konfliktit i cili nuk kufizohet vetëm në raportet e forcës midis rrymave të brendshme, siç ndodhte dikur, por merrte rëndësi gjithnjë e më të madhe pesha politike e shteteve të huaja që ndërhyjnë në raportet e brendshme.

Në vitin 1870 me një vendim të Gjykatës së Napolit <sup>60</sup> që i vlerësonte si të drejta kërkesat e komunitetit katolik arbëresh të rritit grek, të përfaqësuar nga papas Kostandin Tamburi dhe Josif Martino, u bllokua përkohësisht veprimtaria e lobit të fuqishëm ortodoks vendës dhe përpjekjet e tij për të kontrolluar famullinë ‘greke’ të Napolit. Mirëpo fill pas këtij vendimi ndërhyri përsëri qeveria greke – herën e parë kishte qenë më 1860 duke i kërkuar qeverisë së kohës dorëzimin e kishës besimtarëve grekë ortodoksë - duke i bërë presion qeverisë italiane derisa u arrit në shpalljen e një

---

gjithnjë problematik dhe kjo krijonte shpesh një gjendje të nderë në planin politik dhe shoqëror, me konflikte të shpeshta brenda komunitetit.

<sup>59</sup>Shih *Manoscritto inedito di papas Andrea Figlia (1764)*, me shënime të mëvonshme të shtuara nga papas Lorenzo Perniciario, ku shkruhet për Filja: “Fu Parroco della Chiesa Parrocchiale Greca S.Pietro e Paolo di Napoli (*ku edhe qe varrosur më 22.8.1781*). Fu ancora Cappellano, per lo spazio di molti anni, del Real Reggimento Macedone a Napoli” (f.10), edizione on line con trascrizione a cura di Giuseppina e Pietro Di Marco, Mezzojuso 2008.

<sup>60</sup> Shih Mario Bellizzi, *La chiesa dei profughi. Microstorie della Calabria Citra (secc.XVII-XX). Dalla confraternita La Venerabile Cappella del Purgatorio all'utopia del Monte Frumentario di San Basilio*, Librarium Haemus, Bucarest 2014, f. 61-65.

ligji më 1877, me anë të të cilit anulohet detyrimi i mëparshëm statutor që në vëllazërinë përkatësinë fetare të bënin pjesë vetëm besimtarë katolikë të rritit bizantin. Me anë të këtij ligji në dukje liberal u arrit të realizohej synimi i vjetër i përfaqësuesve grekë ortodoksë për të përjashtuar nga komuniteti 'grek' napolitan ata që ishin 'diversamente greci' ('grekë' ndryshe), të cilët nuk ishin tjetër veçse grekët venedikas dhe arbëreshët e Italisë. Nacionalizmi grek ia doli të sigurojë hegjemoninë e grekëve 'të pastër' dhe të traditës së rreptë ortodokse mbi kishën e Shënjtoreve Pjetër dhe Pal në Napoli, mjerisht me përkrashjen e politikës italiane dhe të një arbëreshi oportunist si Francesco Krispi<sup>61</sup>.

Me këtë ndërhyrje të rëndë të nacionalizmit grek në punët e brendshme të Italisë mbyllet në mënyrën më të mjerë ajo stinë e rëndësishme kulturore që zuri fill me idealet "filoheleniste" të himarjotit Anton Gjika në mbrojtje të kauzës së popujve të Ballkanit dhe të së drejtës së tyre për liri. Duke instrumentalizuar çështjet fetare dhe duke i "kombëtarizuar" ato, nacionalizmi grek shkeli mbi vetë ato parime e ideale që e kishin frymëzuar në krye të herës, harroi përkrashjen që i kishin dhënë popujt e tjerë ballkanikë dhe u përpoq të rrafshonte dallimet në vend që t'i respektonte dhe t'i mbronte ato. Kjo politikë u eksperimentua me sukses pikërisht në komunitetin 'grek' të Napolit, ku edhe pse pa gjakderdhje, u vu praktikisht në zbatim një nga operacionet e para ballkanike të 'spastrimit etnik'.

Me këtë 'kthesë' nacionaliste mbyllet prania kishtarë arbëreshe në Napoli<sup>62</sup> dhe fatkeqsisht ndërpritej leksioni i madh transkulturore dhe transnacional që historikisht kishte karakterizuar komunitetin 'grek' napoletan, me te cilin jemi marrë në këtë

<sup>61</sup> Krispi, asokohë president i Parlamentit, bëri presion te Kryeministri italian, Depretis, dhe te Ministri i Drejtësisë, Mancini, për të mbështetur interesin e qarqeve nacionaliste greke dhe si "shpërblim" për këtë ndërhyrje të tij politike në shërbim të grekëve të Napolit, mori nga mbreti i Greqisë Gjergj i parë, Kryqin e madh të Urdhërit mbretëror të Shpëtimtarit, një ndër titujt që u jepje grekëve dhe të huajve që ishin dalluar në favor të kauzës greke (Shih Francesco Guida, "Correnti e iniziative filelleniche in Italia dopo il Congresso di Berlino (1878-1886)", f. 87-117 në *Garibaldi e il filellenismo italiano nel XIX secolo*, Istituto italiano di cultura, Atene 1985, f. 114).

<sup>62</sup> Përpykjen e fundit për t'ua kthyer arbëreshëve të rritit lindor kishën greke të Napolit e bëri deputeti arbëresh Guljelmo Toçi, i ungji i Terenc Toçit, i cili në një letër botuar në "Giornale di Calabria" më 22 prill 1904, e nxiste birin e Garibaldit, Ricciotti, të merrej me këtë çështje: "Questi aveva sollecitato sul "Giornale di Calabria" del 22 aprile 1904 da Ricciotti un impegno per la restituzione alle colonie albanesi del collegio italo-greco di San Basilio in Roma e della Chiesa Greca dei SS. Pietro e Paolo in Napoli, con annesso Patrimonio della Confraternita, beni confiscati dopo l'Unità dello Stato italiano (...në fusnotë lexojmë: *la chiesa dei SS. Pietro e Paolo, insieme con la rendita di 40.000 lire era stata ceduta agli ortodossi per 'giacobinismo'*" në Fondo Ricciotti, *Albania*, 274,35 në Muzeun Qendror të Risorxhimentos në Romë), ricevendone una risposta pubblica ricca di speranze più che di certezze". Citim i nxjerrë nga Francesco Guida, "Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese" (f.97-138), në *Archivio Storico Italiano*, anno CXXXIX, I, Firenze 1981, f. 111.

trajtesë tonë. Por në diasporat historike të Mesdheut – e kemi fjalën këtu jo vetëm për bashkësitë greke, por edhe për ato hebraike, arbëreshe, etj. - kjo trashëgimi ka qenë gjithmonë e pranishme, cilësi kjo që i dallon ato bashkësi nga kulturat mononacionale dhe jo diasporike. Falë ‘ndërmjetësimit kulturor’ ato arritën të hibridizohen dhe të ndërthuren me kultura të tjera që iu shtuan asaj origjinale, ashtu natyrshëm, pa kufizime dhe përjashtime nacionaliste, duke u bërë më të begata e më të shëndetshme.

Këto kultura të diasporës duke kapërcyer dhe rrafshuar gjerdhet– qofshin ato gjeografike, politike, etnike a fetare – që ngre nacionalizmi, kanë gjetur arsyet më të thella të shtysës së tyre identitare, historikisht dhe natyrisht hibride. Ashtu siç na kujton me urtësi James Clifford, “frytet e pastra çmenden”<sup>63</sup>: nacionalizmat e vonuar të të gjitha anëve dhe nationalistët prapanikë të të gjithë flamujve që ndjekin përherë “ideologjinë e pamend të pastërtisë”, nuk arrijnë ende sot ta rrokin këtë mësim të madh.

### **Bibliografia:**

1. Francesco Altimari, “Alcuni etnici di origine albanese nei dialetti della Calabria” në *Beiträge zur sprachlichen, literarischen und kulturellen Vielfalt in den Philologien*. Festschrift für Rupprecht Rohr zum 70.Geburtstag, Mit einem Vorwort herausgegeben von Gabriele Birken-Silverman und Gerda Rössler, Franz Steiner Verlag, Stuttgart 1992.
2. Francesco Altimari, “Gli Arbëreshë d'Italia per la rinascita dell'Albania tra XVIII e XIX secolo: parallelismi con altre diaspore di area balcanica” në *Studia Albanica*, Tiranë 2012.
3. Benedict Anderson, *Imagined Communities Reflections on the Origins of Nationalism*, London 1983.
4. Roderick Beaton, «Antique nation? ‘Hellenes’ on the eve of Greek independence and in twelfth-century Byzantium», *Byzantine and Modern Greek Studies*, Vol. 31, No. 1 (2007).
5. Mario Bellizzi, *La chiesa dei profughi. Microstorie della Calabria Citra (sec.XVII-XX). Dalla confraternita La Venerabile Cappella del Purgatorio all'utopia del Monte*

---

<sup>63</sup> Titulli origjinal në versionin anglisht: James Clifford, *The Predicament of Culture: Twentieth Century Ethnography, Literature, and Art*, Harvard University Press, Boston 1988. Përkthimi italisht nga Mario Marchetti i veprës së James Clifford doli më 1993 me titullin: *I frutti puri impazziscono*, Bollati Boringhieri, Torino 1993.

- Fruментарio di San Basilio*, Librarium Haemus, Bucarest 2014.
6. Nilo Borgia, *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Shënime mbi misionet në Himarë: shek.XVI-XVIII*. Me një parathënie nga Matteo Mandalà, Naimi, Tiranë 2014.
  7. Domenico Cassiano, *S.Adriano. La Badia e il Collegio italo-albanese, volume I (955-1806)*, Marco editore, Lungro 1997.
  8. Domenico Cassiano, “Angelo Masci (1758-1821) ed il principio di uguglianza al tramonto del feudalesimo”, në [www.arbitalia.it/cultura/interventi/2010/cassiano\\_angelo\\_masci.pdf](http://www.arbitalia.it/cultura/interventi/2010/cassiano_angelo_masci.pdf)
  9. Antonino Catalano, “Angelo Masci: la sua opera e i suoi tempi”, në *Risveglio-Zgjimi*, VI, n. 2, Cosenza 1968.
  10. James Clifford, *The Predicament of Culture: Twentieth Century Ethnography, Literature, and Art*, Harvard University Press, Boston 1988. Përkthimi italisht më 1993 me titullin *I frutti puri impazziscono*, trad. it. di Mario Marchetti, Bollati Boringhieri, Torino 1993.
  11. Bardhyl Demiraj, “Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII”, në: *Studime* 12 [2005], Prishtinë 2006; “Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. e 18-të. Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë”, në: *Hylli i Dritës* 3 [2007] Shkodër; “Një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë” që duhet kërkuar”, në: *Hylli i Dritës* 1 [2007], Shkodër.
  12. Arnaldo Di Benedetto, “Le rovine d’Atene”: Letteratura filellenica in Italia tra Sette e Ottocento’, në *Italica*, vol. 76, nr. 3, University of Toronto Mississauga, 1999.
  13. Giuseppina Di Marco e Pietro Di Marco (trascrizione a cura di), *Manoscritto inedito di papas Andrea Figlia (1764)*, me shënime të mëvonshme të shtuara nga papas Lorenzo Perniciaro, edizione on line a cura di Mezzojuso 2008.
  14. Pietro Di Marco, “Il Monastero di Mezzojuso nella storia culturale arbëreshe”, në *Mediaeval Sophia*. Studi e ricerche sui saperi medievali. E-Review semestrale dell’Officina di Studi Medievali 2 (luglio-dicembre 2007).
  15. Angela Falcetta, *Diaspora ortodossa e rinnovamento culturale: il caso dell’abate greco-veneto Antonio Catiforo (1685-1763)*, Fondazione Luigi Einaudi, Torino Cromohs, 15 (2010): 1-24,
  16. <[URL:http://cromohs.unifi.it/15\\_2010/falcetta\\_catiforo.html](http://cromohs.unifi.it/15_2010/falcetta_catiforo.html)>
  17. Giulio Ferroni, *Storia della letteratura italiana, III. Dall’Ottocento al Novecento*, Einaudi, Torino 1991.
  18. Vincenzo Giura, “La Comunità Greca di Napoli (1534-1861)” në *Storie di Minoranze: Ebrei, Greci, Albanesi nel Regno di Napoli*, Napoli 1982.
  19. Mathieu Grenet, *La fabrique communautaire: les Grecs à Venise, Livourne et*



- Marseille, v. 1770-v. 1830*, European University Institute, Florence 2010.
20. Francesco Guida, “Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese” (f.97-138), në *Archivio Storico Italiano*, anno CXXXIX, I, Firenze 1981.
  21. Francesco Guida, “Correnti e iniziative filelleniche in Italia dopo il Congresso di Berlino (1878-1886)” (f. 87-117), në *Garibaldi e il filellenismo italiano nel XIX secolo*, Istituto italiano di cultura, Atene 1985.
  22. Jannis Korinthios, *I Greci di Napoli e del Meridione d’Italia dal XV al XX secolo*, Editrice AM&D, Cagliari 2012.
  23. Peter Mackridge, *Language and national identity in Greece, 1766-1976*, Oxford University Press, Oxford 2009.
  24. Matteo Mandalà, “Per un profilo bio-bibliografico di Nicolò Chetta”, në *Nicolò Chetta nel bicentenario(1803-2003)* a cura di Matteo Mandalà, A.C. Mirror, Palermo 2003.
  25. Matteo Mandalà, “Paolo Maria Parrino e le origini dell’ideologia albanista”, në Pietro Di Marco e Alessandro Musco (a cura di), *Aspetti della cultura bizantina ed albanese in Sicilia*, Officina di Studi Medievali, Palermo 2005.
  26. Matteo Mandalà, “Vepra e pabotuar e at Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII”, në *Studime Filologjike*, vol. 1-2, Tiranë 2006.
  27. Matteo Mandalà, “Për botimin kritik të veprave të Nikollë Ketës” (f.171-272) në Matteo Mandalà, *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Botime Çabej, Tiranë 2006.
  28. Matteo Mandalà, “Alle origini del mito pelasgico: Girolamo De Rada e Giovanni Emanuele Bidera” (f.9-24) në Girolamo De Rada, *Opera Omnia*, XI, Rubbettino editore, Soveria Mannelli 2009.
  29. Raoul Manselli, “Il Reggimento albanese Real Macedonia durante il regno di Carlo di Borbone”, në *Archivio storico per le province napoletane*, A.71, Napoli (1950-1951).
  30. Alessandro Marini, *Sistema teopolitico sopra la economia della grazia col libero arbitrio nella permissione de’ mai morali del dottor Alessandro Marini italoalbanese*, Nella Stamperia Avelliniana, Con Licenza de’ Superiori, In Napoli MDCCLXXI.
  31. Dimitri Obolensky, *The Byzantine Commonwealth: Eastern Europe, 500-1453*, Praeger Publishers, New York 1971.
  32. Salvatore Panarea, “Albanesi nel Salento e Albanesi al servizio del Regno di Napoli” (fq.329-343) në *Rinascenza Salentina*, Anno VII, XXVI-XXVII, Lecce 1939.
  33. Gaetano Passarelli, *Le icone e le radici: le icone di Villa Badessa*, Rosciano 2006.

34. Paolo Petta, *Stradioti. Soldati albanesi in Italia (sec. XV-XIX)*, Argo, Lecce 1996.
35. Pietro Pompilio Rodotà, *Dell'origine, progresso e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi libri tre scritti da Pietro Pompilio Rodotà professore di lingua greca nella Biblioteca Vaticana*, vol. III: *Degli albanesi, chiese greche moderne, e collegio greco in Roma coll'indice di tutta l'opera*, per Giovanni Generoso Salomoni, in Roma MDCCLXIII.
36. Giuseppe Schirò, "Notizia distinta degl'italo-greci e degl'italo-albanesi esposta da mons. Giuseppe Schirò Arcivescovo di Durazzo, già Vicario Apostolico di Cimarra nell'Epiro, in occasione di dover rispondere ad alcuni quesiti proposti da un personaggio", në *Roma e l'Oriente. Rivista criptoferratense per l'unione delle Chiese*, f. 282-285 e f. 341-352, viti IV, vol. VII, Grottaferrata 1914.
37. *Statuto con cui deve regolarsi la Chiesa e Confraternita de' Santi Pietro e Paolo de' Nazionali Greci in Napoli, munito di Regio exequatur del 20 Febbraio 1764*, Stamperia del Fibreno, Napoli 1861.
38. Franco Venturi, *Settecento riformatore*, vol.3, Einaudi, Torino 1979.
39. Angeli Zavarroni (J.C.Montaltini inter Incultos Aridaldi inter Constantes Alcippi), *Historia erectionis Pontifici Collegi Corsini Ullanensis Italo-Graeci, et Deputationis Episcopi titularis Ritus Graeci Ad Italo-Epirotas eodem Ritu instruendos, Sacrisque initiandos, Ad Benedictum XIV, Pont.Max. , Ex Typographia Severina, Superioribus Annuentibus, Neapoli Anno Salutis MDCCL.*

## **REFERIME**



**Isak SHEMA**

## **KULTURA LETRARE BASHKËKOHORE**

Objekt studimi i këtij punimi shkencor është trajtimi i çështjeve që lidhen me zhvillimin e kulturës letrare bashkëkohore. Duke studiuar problemet e kulturës gjuhësore dhe të kulturës letrare në të kaluarën, por edhe këto në kohën e sotme, arrihet të paraqiten rrjedhat kryesore të zhvillimit të edukimit kulturor dhe artistik, evoluimet, synimet, tendencat aktuale dhe orientimet për zhvillimet e ardhshme kulturore dhe artistike. Kultivimi i kulturës letrare realizohet nëpërmjet proceseve të vazhdueshme të krijimtarisë artistike, të leximit, të shkrimit, dhe të aktiviteteve diskursive dhe të veprimtarive të tjera arsimore, kulturore dhe shkencore.

Krijuesit e vlerave letrare, shumëllojshmëria e realizimeve artistike, botimet letrare, publikimet në forma të ndryshme dhe përhapja e tyre, lexuesit e të gjithë brezave e moshave, studiuesit, institucionet kulturore, arsimore, shkencore, mediat, pajisjet dhe programet elektronike si edhe aktivitetet e tjera, ndikojnë në rrjedhat e zhvillimit të kulturës letrare dhe të formimit kulturor. Studimi shkencor i kësaj teme të rëndësishme, duke prezantuar literaturën profesionale shkencore dhe njohuritë praktike, synon kultivimin dhe zhvillimin e mirëfilltë të kulturës letrare bashkëkohore.

Termi *kulturë* në kumtimin e përgjithshëm ka karakter universal dhe shtrirje të përdorimit të gjerë gjatë shekujve në shumë fusha të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore. Fjala *Cultura* në latinisht, 1. Punim, lërim (agri), lërim toke, 2. Kulturë drithërash; 3. *kulturë, erudicion, zhvillim*; 4. nderim, adhurim. Në letërsi dhe në shkencën e letërsisë termi përdoret dendur mjaft herët në shumë gjuhë të botës dhe veçanërisht që nga koha e iluminizmit (gjermanisht: *Kultur*; frëngjisht *culture*; anglisht *cultura.-kultivim, fisnikërim*).

Në *Fjalorin e Filozofisë (Larousse)*<sup>1</sup> përfshihet ky përkufizim për nocionin *kulturë* : “... formim shoqëror dhe intelektual i një individi (*kulturë* ka të njëjtën rrënjë me fjalën *kult* dhe nënkupton një respektim fetar të traditës). Formë qytetërimi : “një kulturë”. Ka shumë lloje kulturash në kuptimin që çdo shoqëri ka institucionet e veta të veçanta që shprehin në përgjithësi të kaluarën e saj shpirtërore. Por nocioni i kulturës ruan

---

<sup>1</sup> Zhylia, Didie. *Fjalori I Filozofisë*, Larousse, Shkencat shoqërore, Shëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1994, f.216

gjithmonë një kuptim normativ dhe është sinonim i humanizmit”. *Kultura letrare* si definicion përfshin: *Tërësinë e njohurive që kanë të bëjnë me letërsinë.*

Nga enciklopedia letrare (*Encyclopedie littéraire: culture contemporaine*)<sup>2</sup> për kulturën moderne gjejmë këtë paragraf: “Culture moderne dans laquelle entrent des 'valeurs non traditionnelles.« *Kulturë moderne në të cilën hyjnë disa vlera jo tradicionale*”.

Komenti:

*“Shprehja kulturë moderne përfshin një kronologji në nocionin e kulturës. Ajo tregon se kultura është fryt i një epoke dhe e një vendi. Kultura, duke qenë e kuadrit elitist dhe konservator në të cilën ajo është mbajtur., është demokratizuar për t`u bërë «kulturë bashkëkohore” e hapur në krijimtari. Ajo tani e tutje pranon disa vlera klasike dhe tradicionale. «*

Në qendër të vëmendjes në këtë kumtesë kemi fjalët çelës: *kulturë*, , *letërsi (letrare)*, si terma specifike, që lidhet me *letërsinë* dhe posaçërisht me *kulturën letrare*. Të analizojmë me këtë rast aspektet kryesore që lidhin këto dy nocione: *kulturë* dhe *letërsi*. Duke u bazuar në Fjalorin internacional të termave të letërsisë<sup>3</sup> /"Dictionaire international des termes littéraires", L. Mouton. Publishers The Haguue, Paris, 1973/, në plan të parë kemi spikatur nocionin *letërsi*, sepse qasja e shpjegimit terminologjik përfshin: etimologjinë, studimin semantik, ekuivalentet linguistike (gjuhësore) dhe komentin historik.

Në kuadër të studimit semantik shpjegimi vijues bëhet me nocionet dhe me shprehjet:

1. Kultura
2. Kushtet e shkrimtarit
3. Letërsia art i bukur
4. Veprat letrare
5. Historia e letërsisë
6. Shkenca e letërsisë
7. Ekuivalentet gjuhësore
8. Komentet historike

Autorët R. Velek (Rene Wellek) dhe O. Voren (Austin Waren) në pjesën e parë të “Teorisë së letërsisë” *Definizione dhe distinkcione* bëjnë dallimin midis *letërsisë* dhe *studimit të letërsisë*. Ata shkruajnë: “Këto janë dy fusha të veçanta të veprimtarisë: e para është krijuese- art; e dyta, edhe pse nuk është plotësisht shkencë, përfaqëson një lloj dijeje ose të të mësuari”<sup>4</sup>.

Në këtë rast kemi tre togfjalëshat të përbërë “nga dy fjalë kuptimplota me lidhje të

<sup>2</sup> www.devoir-de-philosophie.com/dissertation-encyclopedie-litteraire... 26.07.2014

<sup>3</sup> "Dictionaire international des termes litteraires", L. Mouton. Publishers The Haguue, Paris, 1973

<sup>4</sup> Rene Wellek- Austin Waren, Teoria e letërsisë, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 29

*ngushta gramatikore e kuptimore*<sup>5</sup>. Këta janë terma letrarë dhe shkencorë të letërsisë dhe të shkencës së letërsisë. Kemi afuar këtu togfjalëshat: *kulturë letrare*, *mjeshtëria e shkrimit* (*mjeshtëria shkrimore dhe mendimi kritik*). Fjalët: *kulturë*, *mjeshtëri*, *mendim* kanë afër tyre po ashtu fjalët kuptimplota: *letrare*, *shkrim* dhe *kritik*. Sintagma *kulturë letrare* në këtë shqyrtim nuk lidhet vetëm me formimin kulturor dhe letrar gjatë leximit të veprave letrare dhe shkencore, apo me proceset e formimit të *kulturës letrare* gjatë shkollimit. Fjala është për formimin në nivelin më lartë të kulturës letrare në rrafshin e studimeve të shkencës së letërsisë. Për të argumentuar këtë objektiv studim, të kujtojmë në këtë rast disa vepra të rëndësishme të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Midis tyre veprat më kërkua dhe të përfshira në literaturë e rekomanduar në universitete më të shquara të botës. Në fillim veçojmë ato të studiuesit, Alain Viala. Shquhet sidomos vepra e tij *La Culture littéraire*<sup>6</sup> (Kultura letrare), në të cilën trajton disa tema të rëndësishme të kulturës letrare, në mënyrën se si ato studiohen sot në literaturën bashkëkohore të shkencës së letërsisë. Krahas kësaj edhe veprat e autorëve, Joseph Williams *The Craft of Research*<sup>7</sup> (Mjeshtëria e kërkimit shkencor) dhe atë Lewis Vaughn dhe "Fuqia e mendimit kritik"<sup>8</sup>. Këto botime, si edhe shumë të tjera, të cilat janë përfshirë në bibliografinë e zgjedhur të studimeve letrare shkencore në përgjithësi, kanë rëndësi të madhe për studimet integrale-monografike.

Temat e tjera të rëndësishme, me të cilat ndriçohen aspekte më të gjera të kulturës letrare në planin e përgjithshëm janë: letërsia kombëtare, letërsia e përgjithshme, letërsia krahasimtare. Në Enciklopedinë Larousse *Letërsia e shkruar* përfshin tërësinë e veprave të shkruara të cilat kemi finalizimin estetik<sup>9</sup>. (*Ensemble des oeuvres écrites auxquelles on reconnaît une finalité esthétique*)

Në *Le dictionnaire du littérature*<sup>10</sup> është paraqitur etimologjia e përdorimit të fjalës *culture* dhe e shprehjes *culture littéraire*. Kuptimi i mirëfilltë i kësaj fjale çelës lidhet me kulturën që tregon njohuri të përbashkëta të njeriut të mësuar, të ditur, të mbrujtur me dituri filozofike, letrare, dhe artistike. Ndërsa për *Creation littéraire*<sup>11</sup> kemi tekstin:

<sup>5</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 1094

<sup>6</sup> Alain Viala, *La Culture littéraire*, (Paris, Presses universitaires de France, 2009)

<sup>7</sup> Joseph M. Williams *The Craft of Research*. Chicago: University of Chicago Press (1995, 2003) with Wayne C. Booth and Gregory G. Colomb

<sup>8</sup> Lewis Vaughn dhe "Fuqia e mendimit kritik", CDE, Tiranë, 2010

<sup>9</sup> [www.larousse.fr/dictionnaires/francais/litterature/47503](http://www.larousse.fr/dictionnaires/francais/litterature/47503)

<sup>10</sup> Aron, Paul dhe Jacques, Viala. *Le dictionnaire du Littéraire*, puf, Paris, 2002, f. 129

<sup>11</sup> Po aty, f.21.

La littérature est création au sens où elle produit des textes neufs. Dans une acception stricte, « création » serait à entendre comme écriture d'un texte à tous égards original, mais dans la pratique, la création littéraire contient toujours une part de reprise de modèles antérieurs. En un sens plus large encore, la littérature est création en ce qu'elle invente des idées, des images, des personnages voire des mondes nouveaux.

Indeksi tematik i Leksikut të termave të letërsisë “Lexique des termes littéraires”<sup>12</sup> përmbledh kërkimin filologjik tematik dhe listën e termave të viti 2003. Vendet dhe institucionet : Academie française, Bibliotheque Natinale, Sorbonne.

Tërësitë e përmbajtjes janë: Litterature (*Letërsia*), Genre romanesque- narratif (*Zhanret romaneske- narrative*), Poesie- genre poetique (*Poezia- Zhenret poetike*), Theatre- genre theatral (*Teatri- zhanret teatrale*), Genre argumentatif- Literature d'idees (*Zhanri argumentativ- Letërsia e ideve*), Communication (*Komunikim*), Liguistique (*Gjuhësia*), Les figures de style (*Figurat e stilit*), Les registres (*Regjistrat*), Les forms de discours (*Format e diskursit*) e tj.

Arti poetik sipas teoricienit të shquar të letërsisë, Milivoje Sollar (Milivoje Solar), në mënyrë të natyrshme e lidh shkrimtarin me lexuesin dhe dëgjuesin.

Ai shkruan: “...Nëse kemi parasysh se shkrimtari, gjegjësisht poeti, veprat e veta i prodhon sipas ligjshmërive të posaçme, që kërkojnë të zotërojnë mjeshtërinë poetike, termi “art poetik” si dhe “letërsi artistike”, njësoj dhe fare mirë sugjerojnë që letërsia të kuptohet si veprimtari krijuese gjuhësore e llojit të veçantë. Nocioni letërsi apo art poetik në këtë rrafsh e lidh poetin gjegjësisht shkrimtarin me veprën letrare si prodhim të vetin edhe me dëgjuesit, gjegjësisht lexuesit, pa të cilët nuk ka letërsi të vërtetë. Do të thotë letërsia jeton vetëm nëse ekzistojnë ata që i kuptojnë veprat letrare si vepra artistike e pikërisht si të atilla dhe i lexojnë, gjegjësisht i dëgjojnë”.<sup>13</sup>

---

<sup>12</sup> <http://www.lettres.net/files/aaa-them.htm> (02.12.2004)

<sup>13</sup> Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1978, f. 11. (Vepra e cituar ka pasur 20 ribotime. Vërejtja e Isak Shemës)





*Kultura letrare* përfshin dituri, aftësi dhe kompetenca, p. sh. ato “ të njeriut të ndershëm”, me nivel të ngritur, që shquhet me dituri dhe me krijimtari letrare dhe artistike. Këtë temë gjerësisht e kanë trajtuar shumë autorë. Alain Viala<sup>14</sup> ka botuar librin universitar *Culture littéraire*, i cili përdoret në procesin e studimeve të letërsisë në Universitetin e Parisit III- Sorbonne Nouvelle dhe në Universitetin e Oksfordit. Aspekte të kësaj teme janë trajtuar në shumë botime të veçanta, në punime filologjike dhe në fjalorë terminologjikë dhe enciklopedikë të letërsisë dhe në enciklopedi të letërsisë.

Autori Viala në pjesën e parë të librit përfshin një organon të vogël të letërsisë, në të cilin shtron për studim çështjet e kulturës letrare. Në kuadër të përmbajtjes së librit, të cilin e përdorin lexuesit dhe studiuesit që tregojnë interesim për çështjet kulturore, për aspekte të letërsisë, sidomos studentët e letërsisë, të teatrit, të filmit, të komunikimit etj., përmbledhen temat: Letërsia dhe shkenca, Hapësira letrare, Kënaqësitë dhe dituritë: prizmi letrar, Letërsia, përse krijohet letërsia, Kanonet letrare, Korpusi i shkrimtarëve dhe i veprave letrare në gjuhën frënge (sipas shekujve), Shkrimtarët e tjerë të gjuhëve të tjera, Mendimi (Filozofia, Shkencat humane, Artet (Filmi, Muzika, Piktura), Lëvizjet, Shkollat dhe Rrymat letrare, Letërsia, gjuha dhe stili, Letërsia dhe jeta sociale, Letërsia dhe historia, Letërsia dhe dituritë, Letërsia dhe filozofia, Letërsia dhe idetë, Letërsia dhe ideologjia, Sensibilitetet: Letërsia, artet dhe imagjinaria, Leximi i librave, Shpjegimi, analiza dhe vlerësimi i letërsisë, Komentimi i teksteve letrare dhe argumentimi.

<sup>14</sup> Viala, Alain. *La culture littéraire*. Puf, Paris, 2009.

Kultura letrare gjatë epokave të ndryshme ka evoluar, ashtu siç është zhvilluar dhe ka ndryshuar edhe kultura në përgjithësi, arsimi, letërsia, artet e tjera dhe shkencat. “Il faut vivre son temps, dit le proverb..”(Duhet jetuar kohën e vet..., thotë një proverb). Duke studiuar çështjet e zhvillimit të kulturës letrare bashkëkohore gjatë shekullit XX dhe në vazhdim, kur janë publikuar punime dhe vepra të posaçme lidhur me këtë problematikë, njohuritë në fushën e shkencave filologjike, të gjuhësisë dhe të letërsisë, janë zgjeruar dhe janë thelluar si asnjëherë më parë. Kultura letrare e traditës dhe ajo bashkëkohore në vazhdimësi janë gërshtuar natyrshëm.

Pikëpamjet e shkrimtarëve të shquar, dhe sidomos ato të fituesve të Çmimit Nobel, kanë shfaqur mendime dhe vlerësime interesante për letërsinë, për vlerën e veprave të ndryshme letrare, për rëndësinë e leximit, për procesin krijues dhe për kulturën letrare. Temat dhe shprehjet: *Kultura gjubësore, Kultura letrare kombëtare, Kultura e përgjithshme letrare etj., janë të lidhura me kuptimin bazë të tyre dhe me funksionin më të gjerë të kulturës letrare.* Për kultivimin e tyre zhvillohen aktivitete të ndryshme.

Përmbajtjet mësimore për përvetësimin e gjuhës, për leximin dhe mësimin e letërsisë, përfshihen në programet mësimore, në tekstet shkollore dhe në aktivitetet e tjera të veprimtarisë arsimore, kulturore dhe shkencore. *Kultura gjubësore, edukimi artistik dhe kulturor,* ndikojnë në formimin e personalitetit të njeriut. Për këtë qëllim zhvillohen aktivitete të vazhdueshme. Të përmbledhim me këtë rast disa tema, të cilat përfshijnë përmbajtjet, siç janë: *Krijimtaria letrare, Leximi i letërsisë dhe përjetimi estetik, Kultura letrare e shkrimtarit, Kultura poetike e poetit, Kultura gjubësore dhe letrare në studimet universitare, Kultura artistike në veprimtaritë e arteve të tjera (arti skenik, arti filmik ,arti muzikor, artet pamore), Përparësitë e një kulture letrare, Jeta letrare, Revistat letrare dhe kulturore, Botimet letrare, Bibliografitë letrare, Shoqatat dhe lidhjet letrare, Lektura letrare, Kronikat letrare, Magazinat letrare, Takimet kulturore letrare, Kritika e re letrare dhe kultura letrare, Përktimet letrare, Sallonet letrare, Kafë libraritë, Ekspozitat letrare, Panairt letrare, Kafenetë letrare (Shqipëri: Një libër- një kafë), Institucionet kulturore dhe letrare, Shoqatat dhe asociacionet kulturore, Botimet teorike, kritike dhe historike letrare, Letërsia dhe interkulturiteti, Kultura dhe itertekstualiteti në tekstet letrare, Kultura letrare në radio dhe televizion, Letërsia digjitale, Websajtet letrare , Libri letrar në qendër të jetës kulturore, Aktualitetet letrare, Kërkimet letrare, Kuizet gjubësore dhe letrare, Konkursat dhe çmimet letrare, Manifestimet letrare, Vokacioni letrar, Testimi i kulturës letrare, Publikimet letrare në shtypin dhe periodikun e kohës etj.*

*Seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* gjatë dyzet viteve të veprimtarisë së tij, ka ndikuar dukshëm për zhvillimin e kulturës gjubësore dhe të kulturës letrare. Duke u bazuar në përmbajtjen e këtyre temave, pas analizës së duhur kritike, vlerësohet se në të kaluarën janë bërë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin dhe kultivimin e kulturës gjubësore dhe letrare. Megjithatë, për shkak të kushteve

historike, sociale, kulturore, arsimore, si edhe të ndikimit të faktorëve të tjerë, nuk është realizuar synimi që në shoqërinë moderne në tërësi, të arrihet edukimi artistik dhe kulturor.

Me qëllim të përmirësimit të niveli të përgjithshëm të edukimit artistik dhe kulturor, janë bërë reforma të sistemit arsimor dhe të zhvillimit kulturor në botën shqiptare dhe në shumë vende të botës. Në vitin 2011 është miratuar *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Gjuha dhe letërsia përfshihen në Fushën e komunikimit. Megjithatë nuk kanë shtrirjen e mjaftueshme për të realizuar në mënyrë sa më të plotë edukimin artistik dhe kulturor.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi u mundëson nxënësve që të zhvillojnë dhe të kultivojnë përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi në jetën e përditshme, në jetën profesionale dhe në jetën publike. Nëpërmjet kësaj fushe kurrikulare, secila lëndë duhet t'i arrijë të gjitha kompetencat e përcaktuara në Kurrikulë.

Kjo fushë kurrikulare përfshin lëndët: gjuhët amtare, gjuhën e parë të huaj (gjuha angleze), gjuhët e mjedisit si dhe gjuhët e tjera të huaja. Secila lëndë mësimore (gjuhë) në kuadër të kësaj fushe përfshin edhe letërsinë, si pjesë e veçantë e përdorimit të gjuhës në raport me vlerat estetike Gjuha amtare, mësohet nëpër të gjitha shkallët e Kurrikulës, që nga klasa parafillore e deri te klasa XII... Prej shkallës së parë e deri te përfundimi i shkallës së gjashtë të Kurrikulës, të gjitha aspektet e të mësuarit në artet shprehëse përfshijnë mundësitë për të realizuar dhe për të shfaqur punë artistike. Fusha mësimore Artet, siguron që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë perceptuese nëpërmjet formave të zhvillimit të aftësive të të kuptuarit dhe shkathtësive mendore krijuese. Të zhvillojnë aftësitë për marrjen e koncepteve në vizatim, pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, vallëzim, interpretim dhe muzikë. Kjo fushë, luan rol të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e plotë të fëmijëve dhe të rinjve, duke ndihmuar që të kuptojnë, të shprehin përvojat e tyre personale, të kultivojnë talentin e tyre krijues, të përvetësojnë konceptet themelore në përdorimin e teknikave apo burimeve të ndryshme artistike; të mësojnë të komunikojnë, të interpretojnë, të zhvillojnë shkathtësitë e tyre artistike për t'u shprehur, të japin një kontribut në ndryshimin shoqëror dhe në zhvillimin e elementeve artistike dhe të informacionit. Zhvillon aftësitë e nxënësve, duke bërë që ata ta konsiderojnë të shprehurit artistik si një nga aspektet më të rëndësishme të edukimit të tyre.

Fusha mësimore e arteve është pjesë integrale e procesit të të mësuarit dhe ka lidhje midis imagjinatës dhe inteligjencës, ku fëmijët marrin pjesë në veprimtari të ndryshme duke zhvilluar më tej krijimtarinë dhe imagjinatën e tyre.

Qëllimi i njohurive të kësaj fushe është zhvillimi i imagjinatës krijuese të figuracionit dhe muzikalitetit, reagimi ndaj shprehjes artistike, e cila konsiston në shumëllojshmërinë e veprimtarive që përfshihen në edukimin artistik.

Artet ndikojnë që nxënësit të zhvillohen në individë me vetëbesim dhe me aftësi kreative.

Pjesëmarrja e nxënësve në të gjitha format e të shprehurit artistik mundëson zhvillimin e identitetit individual, por në të njëjtën kohë zhvillon edhe identitetet e tyre grupore.

Diversiteti kulturor, në njërën anë, dhe trashëgimia kulturore kombëtare, në anën tjetër, duhet të jenë pjesë integrale të mësimin në arte» .<sup>15</sup>

Ky tekst është përfshirë me qëllimin për të treguar se edukimi artistik dhe formimi kulturor kanë rëndësi shumë të madhe si programore, jo vetëm në kuadër të sistemit arsimor, por edhe jashtë tij, për formimin e personalitetit të lexuesve në përgjithësi.

Më 2014 në Shqipëri është përgatitur Draft Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. Për edukimin gjuhësor dhe kulturor është përfshirë teksti: “...nxënësit shprehin dhe interpretojnë koncepte, ide, ndjenja, fakte e opinione me gojë e me shkrim; zhvillojnë aftësitë për të lexuar, shkruar, folur dhe dëgjuar në mënyrë kreative dhe të qëllimshme; dallojnë dhe përdorin tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare, tekste të shtypura dhe elektronike; gjejnë, krahasojnë informacione të ndryshme; zotërojnë e vlerësojnë informacione të ndryshme; zotërojnë njohuritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e duhura rreth sistemit gjuhësor, e përdorin gjuhën në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në marrëdhëniet shoqërore; kuptojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.”<sup>16</sup> Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, sepse studimi i tyre lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, emocional dhe social, kulturor të nxënësve...<sup>17</sup> Paraqitja e suksesit të arritur në arsim, në shkencat e ndryshme, në edukimin artistik dhe kulturor të nxënësve dhe të studentëve të botës në kuadër të programit Program for International Student Assessment (PISA), tregon ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit arsimor, kulturor dhe shkencor të rinisë shkollore në të gjitha vendet e anëtarësuara në këtë asociacion ndërkombëtar të rëndësishëm për zhvillimin arsimor, të kulturor dhe shkencor. Interesim të veçantë në kohën e sotme zgjon orientimi programor evropian i reformës arsimore, kulturore, edukative në fushën e arsimit dhe të edukimit. Në Francë në vitin 2013, pas shqyrtimit të gjithanshëm profesional, pedagogjik, shkencor dhe artistik, është miratuar pjesa shtesë e programit të ri të edukimit artistik dhe

---

<sup>15</sup> *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë 2011, f. 38-39

<sup>16</sup> *Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, f. 35-36

<sup>17</sup> Po aty, f. 39

kulturore (*Le parcours d'éducation artistique et culturelle*).<sup>18</sup>



Për të realizuar këtë program të përfshirë në Ligjin *Loi d'orientation et de programmation pour la refondation de l'école de la République (loi n. 2013-595 du juillet 2013)*, janë përcaktuar objektivat, udhëzimi për realizimin dhe formimin e këtij drejtimi të edukimit artistik dhe kulturore. Organizimi i testeve letrare ofron mundësi të vlerësohet përgatitja e përgjithshme dhe cilësia e formimit kulturor letrar. Çmimet për arritje të posaçme kulturore dhe letrare afirmojnë dhe nxisin veprimtarinë kulturore dhe letrare.

Udhëzimi i përgjithshëm ka 47 faqe dhe është mjaft interesant. Ministria e Edukimit Kombëtar dhe Ministria e Kulturës angazhohen së bashku për realizimin e këtij projekti të madh të edukimit artistik dhe kulturore. Këshilli i Lartë përgjegjës ka 24 anëtarë, që janë personalitete të shquara të arsimit, të kulturës dhe të shkencës.

Zhvillimi i kulturës letrare në nivelin e studimeve universitare, sidomos në ato filologjike, realizohet në procesin arsimor dhe shkencor. Programet e studimit, botimi i letërsisë, shfrytëzimi i literaturës profesionale dhe shkencore si edhe veprimtaritë e tjera të gjithanshme ndikojnë në kultivimin e suksesshëm të kulturës letrare.

Duke u bazuar në vlerësimet profesionale, pedagogjike dhe shkencore, në punimet dhe botimet e veçanta në gjuhën shqipe, por edhe në literaturën e shfrytëzuar në gjuhë të tjera ( të cituar në gjuhën frënge), vlerësojmë se për zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe letrare si edhe për edukimin estetik në tërësi, nuk janë realizuar në nivelin e duhur synimet dhe objektivat e programuar në institucionet dhe në subjektet e tjera kulturore dhe arsimore dhe nuk janë arritur rezultatet e pritura të edukimit artistik dhe kulturore. Për këtë qëllim të lartë të kultivimit të kulturës letrare, në kohën e sotme dhe në zhvillimin perspektiv, kërkohen angazhime të gjithanshme, projekte të reja, forma të llojlojshme të aktiviteteve të institucioneve të arsimit, të kulturës dhe të shkencës, të lexuesve dhe të krijuesve në mbarë hapësirën shqiptare dhe më gjerë. Edukimi artistik dhe kulturore realizohet si orientim me përparësi të veçantë për zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe të kulturës letrare bashkëkohore.

<sup>18</sup> [www.education.gouv.fr/pid25535/bulletin\\_officiel.html?cid\\_bo=71673](http://www.education.gouv.fr/pid25535/bulletin_officiel.html?cid_bo=71673) (13.08.2014)



Muhamet HAMITI

## ARDHJA DHE IKJA E BARBARËVE NË LETËRSINË E CAVAFY-T, J.M. COETZEE-S DHE HAMITIT

Emërtimi 'barbar' vjen prej antikiteti. Gjeografi, historiani e filozofi grek Straboni (63/4 p.e.s deri 24 të.e.s) shkruante në *Gjeografinë*<sup>1</sup> e vet:

“Mendoj se fjala 'barbar' është shqiptuar fillimisht onomatopeikisht duke iu referuar njerëzve që shqiptonin fjalët me vështirësi dhe flisnin me vrazhdësi dhe me zë të ngjirur, si fjalët tona 'battarizein', 'traulizein' dhe 'psellizein' [kuptimi i të cilave është, përkatësisht, 'me belbëzue', 'me thuthuqë', 'me folë ngathtë'], sepse ne jemi nga natyra shumë të prirur t'i dëftojmë tingujt simbas fjalëve që tingëllojnë ngjashëm me to, për arsye të homogjenitetit të tyre (...). Pë rrjedhojë, kur të gjithë ata që shqiptonin fjalët më vrazhdësi quheshin barbarë onomatopeikisht, dilte se shqiptimet e të gjitha racave të huaja ishin poashtu të vrazhda; e kam fjalën për ato që nuk ishin greke. Të tillët, prandaj, i quanin barbarë në kuptimin e veçantë të termit, fillimisht me përqeshje, duke nënkuptuar se ata shqiptonin fjalët trashë apo vrazhdë; dhe mëpastaj ne keqpërdorëm fjalën si term të përgjithshëm etnik, duke bërë kështu një përdallim logjik ndërmjet grekëve dhe të gjitha racave të tjera”.

Barbarë, pra, fillimisht ishin jogrekët, më vonë edhe jolatinët, domethënë të huajt përgjithësisht. Fjala ka marrë shtresimet kuptimore popullore për njerëz të prapambetur, të pagdhundur, primitivë; për njerëz shkatërrimtarë e mizorë.<sup>2</sup>

Barbarizma quhen huazimet nga gjuhë të huaja.

Do kujtuar në këtë hyrje përdorimin e konceptit të barbarisë në kohën tonë. Në pranverën e vitit 1999, Presidenti francez Jacques Chirac (Zhak Shirak), në fjalimet

---

<sup>1</sup> *The Geography of Strabo*, with an English translation by Horace Leonard Jones, PhD, LL.D, Cornell University, (in eight volumes), VI, London, William Heinemann Ltd, Cambridge Massachusetts, 1960, fq, 3030-305. Citati është nga Libri 14.2.28.

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, botim i dytë i ripunuar, Botimet Toena, Tiranë, 2002, fq.86.

radiotelevizive para kombit francez rreth luftës në Kosovë, fliste për “barbarinë” serbe, të cilës ai dhe liderë të tjerë botërorë i kundërviheshin me fushatën ajrore të NATO-s. Barbaria e terrorizmit të 11-shtatorit 2001 (Al-Qaida) dhe fushata e të ashtuquajturit ISIS (Shtetit Islamik në Siri dhe Irak) gjatë verës së vitit 2014 janë shoqëruar me riaktualizime të fjalës ‘barbar’ dhe ‘barbari’.

Kaq për barbarët si koncept socio-politik. Po çfarë është shembëlltura e tyre në letërsi?

Janë marrë në shqyrtim për këtë ese studimor vepra të Constantine C. Cavafy-t (Konstantin Kavafi, 1863-1933), poezia “Ardhja e barbarëve”, shkruar e botuar në kapërcyell të shekujve nëntëmbëdhjetë/njëzet, romani i tretë i nobelistit jugafrikan J.M. Coetzee-s (Xhon Maksuell Kucie, 1940), *Waiting for the Barbarians* (Ardhja e barbarëve), që e merr titullin prej Cavafy-t, botuar më 1980, si dhe dy poezi të Sabri Hamitit (1950), “Marshi barbar” dhe “Ikja e barbarëve”, shkruar më 1988, botuar dy vjet më vonë te përmbledhja e tij poetike *Kaosmos*. Poashtu, ribotuar te përmbledhja e tij poetike *Melankonia* (1999), si poezi nistore dhe përmbyllëse, përkatësisht.

Në poezinë e Cavafy-t “Duke pritur barbarët” i gjithë qyteti është në trazim në pritje të ardhjes së barbarëve. Poezia prej 35 vargësh ka formë dialogjike, ndërtohet si bashkëbisedim i dy folësve: i pari shtron pyetje, i dyti, që është zëri i civilizimit, jep përgjigje.

Entuziazmi paradoksal i popullit për ardhjen e barbarëve kalon nëpër habi dhe hutim, dhe mbaron në dëshprim kur merret vesh se barbarët nuk do të vijnë.

Dy vargjet e mbrama të poezisë

*Dhe tash, çka do të ndodhë me ne pa barbarët?*

*Ata njerëz ishin njëfarë zgjidhjeje.<sup>3</sup>*

shqiptohen nga folësi i parë, apo, madje një folës i tretë, i paidentifikuar, që mund të jetë poeti/vëzhguesi, simbas ndonjë interpretuesi (shih Boletsi, 2007:75, 91).

Pozita e folësit të parë te Cavafy është e habitshme. A është ai pjesë e komunitetit, qytetar? Nëse po, pse shtron atë shumë pyetje? Si mund të jetë atë i padijshëm për situatën?

Poezia e Cavafy-t në rrafsh syzheu situohet në një qytet dekadent që nuk definohet historikisht, por që i ngjan shumë Romës klasike, por në rënie (perandori,

---

<sup>3</sup> Janë marrë parasysh disa përkthime të poezisë në anglisht, nga Edmund Keeley/Philip Sherrard, Stratis Haviaras. dhe John Cavafy, të trijat në dispozicion në faqen zyrtare në internet të Arkivit të Cavafy-t: <http://www.cavafy.com/> Pika kryesore e referimit është përkthimi nga Edmund Keeley/Philip Sherrard, botuar në C.P.Cavafy, *Collected Poems*, edited by George Savidis, Princeton University Press, 1992.



konsujt, pretorët, oratorët). Në një lexim më universalist, vëndndodhja do të mund të ishte edhe Konstantinopoja. Apo, në një lexim më kontekstual dhe aktual, Egjipti i fundshekullit XIX. Shkrimtari Cavafy, pjesëtar i komunitetit grek në Aleksandri të Egjiptit, ishte nëpunës administrativ i Perandorisë Britanike në Egjipt.<sup>4</sup>

Edhe romani i J.M.Coetzee-s, *Duke pritur barbarët* (në origjinalin anglisht *Waiting for the Barbarians*; romani nuk është përkthyer në shqip), situohet në një vend dhe kohë të pacaktuar. A do të mund të ishte Afrika e Jugut e çerekut të fundit të shekullit XX? Ndoshta po, ndonëse autori J.M. Coetzee, shkrimtari jugafrikan që mori Çmimin Nobel për Letërsi në vitin 2003, bën çmos të mos e dëftojë pandërmjetshëm, sigurisht për të mos i dhënë karakter të hapur politik romanit, duke tematizuar kolonializmin dhe apartheidin, duke qenë i implikuar në të edhe vetë me heshtjen e moskundërshtimit të hapur, si i bardhë, profesor letërsie në Universitet, por jo si nëpunës shteti. Interesi hermeneutik i autorit ngjan me interesin hermeneutik të rrëfimtari, njëherësh protagonistit kryesor të veprës. Ky i dyti përpjket të kuptojë dhe të dalë nga implikimi i vet, qoftë duke bashkëndjerë me barbarët viktima, qoftë duke u përpjekë të interpretojë shkrimin në kunjat druri (wooden slips), të supozuar si shkrim barbar. Analogjitë e “Perandorisë” së romanit me Afrikën e Jugut ekzistojnë, mirëpo, duke mos e pasë identifikuar toposin, J.M.Coetzee ka prodhuar një roman të shkurtër, mjeshhtëror në punë stili, me thellësi filozofike. (Moses, 1993: 115-127).

Ka diçka kafkiane edhe beketiane në prozën e Coetzee-s jo vetëm për absurdin/absurditetin e gjendjes njerëzore që tematizojnë ky dhe pararendësit e tij.

Rrëfimtari anonim, i emërtuar thjesht si Gjykatësi (The Magistrate), pa emër dhe mbiemër, në të vërtetë është guvernator i një qyteze të parëndësishme në cep të “Perandorisë”. Ky nëpunës në moshë bën punët më të rëndomta të administrimit, ndërsa kalon kohën tjetër duke lexuar dhe me aktivitete të tjera amatore, si kërkime arekologjike, ta zëmë. Kur përhapen fjalë për një kryengritje të barbarëve, nga kryeqyteti perandorak vjen Koloneli Joll (Xholl), përfaqësues i Byrosë së Tretë (sigurimit të brendshëm të shtetit) që torturon të burgosur barbarë për të nxjerrë “të vërtetën”, pohime për kryengritjen e pandehur të popullsisë nomade barbare përtej

---

<sup>4</sup> Simbas një interpretimi (nga studiuesi Stratis Tsirkas, të cilit i jep zë studiuesja bashkëkohore Maria Boletsi, për hir argumenti dhe jo në shenjë pajtimi me të) njerëzit që presin barbarët janë populli i Egjiptit, duke përfshirë edhe komunitetin grek dhe komunitetet e tjera të huaja. Këta njerëz donin të shpëtonin nga “civilizimi”, Perandoria Britanike, që ka sunduar në Egjipt nga viti 1878. Simbas këtij leximi, zhdukja e barbarëve në poezi aludon për shtypjen nga Ushtria Britanike të kryengritjes mahdiste, një revoltë islamike që kundërshtonte pushtetin britanik. Në betejën përfundimtare të datës 2 shtator 1898, në Omdurman, mahdistët, përkundër një lufte heroike, u asgjësuan nga ushtria e komandantit Kitchener. Pësuan rreth 27.000 viktima, ndërsa anglezët numëruan 43 të vdekur. (Maria Boletsi, 2007, fq.83).

rrethinës së qytezës/Perandorisë. Gjykatësi nuk pajtohet me këto praktika të sistemit të cilit i përket dhe për çka, natyrshëm, është objektivisht bashkëfajtor. Kur ikën Koloneli, Gjykatësi merr në shtëpi një vajzë të gjymtuar barbare (të sakatosur nga dhuna e pushtetit perandorak, që i kishte mbytur edhe të atin), me të cilën ndërton një raport joshjeje, edhe intime, ndonëse ajo është e nënshtruar dhe pothuajse e pagojë. Mbas një kohe, mbas një ekspedite të mundimshme që e këput fizikisht dhe shpirtërisht, e kthen vajzën te populli i saj barbar. Në ndërkohë ushtria ka mbërritur në përgatitje të ekspeditës për të përballuar mësymjen e pandehur të barbarëve. Arrestohet dhe akuzohet për tradhti Gjykatësi, që përjeton edhe dhunë fizike në duart e oficerit Mandel. Formacioni ushtarak shpartalohet. Gjykatësi rimerr funksionet politike, teksa bashkë me një pjesë të mbetur të banorëve (të tjerët kanë ikur tashmë!) qëndron të pritje të ankthshme të ardhjes së barbarëve, që nuk vijnë kurrë. Është kjo thjesht paranojë perandorake.

Romani *Duke pritur barbarët* i Coetzee-s ndërtohet si monolog/rrefim në të tashmen i Gjykatësit, që bëhet dëshmi në mungesë të historisë, që e shkruan fituesi zakonisht. Barbarët janë të pagojë; ata janë humbës. Gjykatësi, si përfaqësues i tëhuajësuar i Perandorisë, vetëm në fund, mbasi ndahet prej vajzës barbare-dashnore, qahet për rastin e humbur që me të të mësonte gjuhën e huaj (barbare), përmes të cilës do të mund të hynte në botën dhe pikëshikimin e tyre:

Nuk e marr vesh asnjë fjalë. „Sa keq“, mendoj unë: „ajo do të mund t’i shfrytëzonte ato mbrëmje të gjata kaluar kot duke ma mësuar gjuhën e vet! Tash është tepër vonë.“<sup>5</sup>

Pozita e narratorit te romani i Coetzee-s është ambivalente: një pjesëtar i Perandorisë, por disi i tëhuajësuar. Zëri i tij është plot kontradikta, ndonëse në njëfarë mënyrë bëhet boshti moral që i mungon botës. Romani nuk përmbillet në fund – enigma dhe misteri vazhdojnë – që është shenjë se Coetzee nuk do të mbivendosë rrefimin-matricë (master narrative) në tekst duke e shpjeguar më shumë se ç’duhet. (Kossev, cituar te Boletsi, 2007:67)

Interpretimet historiciste të poezisë së Cavafy-t dhe të romanit të Coetzee-s janë të mundshme, por megjithatë të dy veprat u rezistojnë leximeve që i kornizojnë brenda një konteksti të vetëm, historik. (Shih Botesi, 2007:78-83).

Koha e rrefimit te Cavafy dhe Coetzee është e tashme. Te poezia dhe romani botëvështrimi i barbarëve është i panjohur, i pazhbirueshëm. Ekziston veçse si pasqyrim në botëvështrimin e civilizimit që e njohim ne, ndërsa pandehet se i kanosen ata, barbarët misteriozë. Dinjitarët e qytetit perandorak te poezia e Cavafy-t veshin

<sup>5</sup> I cannot make out a word. “What a waste,” I think: “she could have spent those long empty evenings teaching me her tongue! Too late now.” (Coetzee, 1999: 97)

rrobat e stolitë më të bukura, me ar, argjend, emerald, sepse këto “i lënë pa mend barbarët”, siç e thotë folësi i dytë, përfaqësuesi i civilizimit.

Situimi dhe botëvështrimi i barbarëve te poezitë e Sabri Hamitit “Marshi barbar” dhe “Ikja e barbarëve” është më i qartë, siç mëton ta dëshmojë analiza më poshtë.

Cili është toposi i poezive të Hamitit? Ku situohen ato? Autori shkrimtar shqiptar i Kosovës, që shkroi këto poezi në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar: shënimi thotë në vitin 1988. A mjafton kjo e dhënë për t'i kontekstualizuar poezitë? Për të thënë se bëhet fjalë për mësimin serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, që do të kulmonte një dekadë më vonë me luftën barbare serbe për spastrim etnik të shqiptarëve dhe të Kosovës? Po edhe jo. Po-ja prodhon një interpretim më të lehtë të poezive, por edhe një varfërim të kuptimit të tyre. Jo-ja një interpretim më të vështirë për kuptime që ndryhen filozofikisht dhe metafizikisht, për misterin. Më bëhet se kuptimi i vërtetë i të dyjave është në një lojë interpretimi që rri pezull në mes të të dyjave.

Poezia “Marshi barbar” është shkruar në vetën e parë shumës, “ne”, nga pozita e barbarëve. Ata nuk janë të pagojë, si te veprat e Cavafy-t dhe të Coetzee-s. Ata dëftojnë vetë: “Nga terri vijnë në terr shkojmë”, thotë vargu nistor. Vjersha me 12 strofa katërvargëshe është një monolog në shumës, që, si i tillë, tingëllon autentik, primitiv, i pandërmjetshëm, esencial. Gjuha e figurshme jep lëndorësinë e primitivizmit e të mizorisë si te fjalët/sendet: bori, kamxhi, shpatë, unur, eshkë, pishë, thikë, apo te fjalët/gjendjet e natyrës e të njerëzores: jeta, vdekja, nata, terri, gjumi, prijsi, fisi, gjaku.

Vjersha nis me strofën:

*Nga terri vijnë në terr shkojmë  
Jeta jonë zgjatet sa zgjat nata  
Mbi jetë shkelim në vdekje vallëzohjmë  
Më shumë se lisi kemi këmbë të gjata*

Vargu i fundit i kësaj strofe del kështu në variantin e poezisë të botuar më 1999:  
*Si pajë të fisit kemi rrenë të gjata*

Të dy poezitë mbajnë shënimin për vitin e shkrimit, 1988, në të dyja botimet, që don të thotë se të dy variantet janë të asaj kohe. Veç kësaj, tashti në përmbledhjen e vitit 1999, *Melankonia*, Hamiti e bën poezinë “Marshi barbar” hyrje të krejt veprës,

shqiptim të manifestit të dhunës që ka përllarë poetin e popullin e tij në vitin 1999, në vitin e *të ligës* (luftës) dhe *të mrekullisë* (lirisë) për shqiptarët, që ndau në dysh qershorin i atij viti. E liga përfaqësohet nga “Marshi barbar”, ndërsa mrekullia nga “Ikja e barbarëve”, që, e paprekur, ribotohet dhe rifunksionalizohet si poezi e mbramë e *Melankonisë*.

Strofa e parë e “Marshit” jep dramën e hyrjes së barbarëve, me kod të përmbysur për jetën dhe vdekjen, sepse, siç e thonë me gojën e vet: *Mbi jetë shkelim në vdekje vallëzohjëmë*, ndërsa “pajë të fisit kemi rrenë të gjata”.

Vjersha “Marshi barbar” përfundon me dy strofat:

*Me thonj e thikë kur maska pik  
Ziftobet veç mjekrra kur jemi lakuria  
Me vite me muaj na thonë të huaj  
E ne e duam botën të tërë apo hiç*

*Me kryq në dorë sillemi si horë  
Ta shkelim tokën si një gjallesë  
Në fshat në qytet të ketë tërmet  
Njerëzi e shkeretë të bjerë në harresë*

Kryqëzata e barbarëve do të fshijë njerëzinë nga faqja e dheut. Për ta bërë këtë, ata kanë synimin dhe vullnetin, egërsinë fizike dhe shpirtërore.

Poezia tjetër e Hamitit, “Ikja e barbarëve”, shqiptohet nga një zë poetik që përfaqëson njerëzinë që mëtonin ta fshinin nga faqja e dheut barbarët e “Marshit barbar”. Poezia në dhjetë strofa katërvargëshe (e fundit i ka pesë vargje) dallon për ritmin (nuk ka ritëm marshi, si tek e para) dhe figuracionin, ndonëse lëndorësia është e ngjashme: toka, nata, gurët e varreve, britmat. “Kokrra e pëlçitur e ndërgegjes” i ndjek ata që kanë “trurin e vockël”: *Po ikin barbarët po ku po shkojnë/Ndoshta kthehen në shpellën e vet*.

Strofat qëndrore të poezisë (gjashtë dhe shtatë) japin pamjen e barbarëve të mundur (nga kush? nga barbaria e vet apo nga sprapsja prej civilizimit?):

*Kur erdhën rrënuan fshatra e qytete  
Urrenin çdo gjë për ta ish e huaj  
Ngritën tempujt e fesë së tyre të re  
Që rriste drojën frikën e trishtimin*

*Po ikin barbarët se ata kush s'i do  
Me lot po qajnë e me shkarravina  
Një koqe mendje u thotë: jeni të buaj  
Po ikin ta shajnë zotin që i tradhëtoi*

Barbarët ikin te “zoti i tyre i borës”, teksa me “shpinë të kthyer” mund të shpresojnë të vrasin lugin.

Zëri poetik i njerëzisë shqipton dhembjen dhe kujtimin, por edhe shpresën në vargjet fundore të poezisë:

*Kujtohet një kobë e humbur mijëvjeçare  
Nesër do të çilet ditë e bardhë e zotit  
Ka mbetur tepër të bëhet e të thubet*

Çka ka mbetur të thuhet? Ndoshta se përballja me barbarinë është e pashmangshme: qoftë kjo brenda, qoftë jashtë.

Të dy poezitë e Hamitit “Marshi barbar” dhe “Ikja e barbarëve” bëjnë pjesë të “Purgatori”, cikli i mesëm i poezive të *Kaosmos*, që paraprihet nga cikli “Parajsa”, ndërsa pasohet nga cikli “Ferri”. Bota danteske dëfton fuqishëm pezullinë e shpirtit të “Purgatori”, atë furnaltë ku siten veset e shkrihet e liga, atë botë të dashurisë së përmbysur.

Te përmbledhja poetike *Mekankolia*, që poashtu ka një strukturë trinie të ndërtimit (“Dorëshkrimi i Prishtinës: dhjetë ankime e një lutje”; “Dorëshkrimi i Bluasë: dhjetë vajtime e një gëzim”; “Dorëshkrimi i Dumnicës: dhjetë kujtime e një ëndërr”) kemi tridhjetë e tri poezi në trupin e përmbledhjes – që gjithësesi të sjell në mend numrin (33) të këngëve të njësisive të *Komedisë Hyjnore* të Dantes, “Ferri”, “Purgatori”, “Parajsa” – dhe dy poezitë për barbarët, nistoren “Marshi barbar”, si prolog, dhe përfundimtarën, “Ikja e barbarëve”, si epilog.

Kur jemi te forma dramatike, të themi se tek i përmenduri “Dorëshkrimi i Bluasë: dhjetë vajtime e një gëzim”, ka një sinopsis të një tragjedie njerëzore, siç e përkufizon këtë krijim letrar Hamiti, të titulluar “Dialogu i gjahtarëve barbarë”. Është një dialog makabër në mes të dy personazheve, Mjekrës dhe Tullacit, që bëjnë pazar me organe njerëzish, sy e vesh, zemra e mushkëri, madje dhe organe gjenitale burrash e grash. Për çka bëhet kjo? Për kënaqësinë e tyre të makabre, sigurisht.

Constantine Cavafy te poezia e tij më e njohur i paraqet barbarët e munguar të

mahnitur nga shkëlqimi i civilizimit perëndimor, nga institucionet, veshjet, mënyra e tyre e sjelljes. Ky civilizim është në rënie e degradim dhe, prandaj, një dorë barbare është ndoshta shpresa për një energji të re, shpresë për dalje nga letargjia. Kështu mund të kuptohen vargjet përmbyllëse të poezisë: *Dbe tash, çka do të ndodhë me ne pa barbarët?/ Ata njerëz ishin njëfarë zgjidhjeje.*

Në pikëshikimin e Gjykatësit-gubernator të qytezës, J.M. Coetzee te romani *Duke pritur barbarët* i paraqet barbarët e imagjinuar armiq të Perandorisë si pastoralistë, peshkatarë, nomadë, të cilët bëhen kokë turku për idenë e marrë të Perandorisë për rrezikun që u kanoset prej tyre. Gjykatësi nuk mund të bëjë gjë kur sheh të burgosurit barbarë tek i nënshtrohen inkuizicionit, torturës. Ai vetë, në monologun e tij në të tashmen, thotë:

*Nuk mund t'i shpëtoj të burgosurit, prandaj le ta shpëtoj veten. Le të thubet të paktën, nëse vjen ndonjëherë puna të thubet, nëse ndonjëherë ndokush në një të ardhme të largët është i interesuar të dijë mënyrën se si jetuam, se në cepin më të largët të Perandorisë së dritës kishte ekzistuar një njeri që në zemër nuk ishte barbar.*<sup>6</sup>

Janë këta “barbarët e rinj” (fq.106), prej të cilëve kishte menduar se po distancohej kur e kishin arrestuar dhe torturuar. Gjykatësi pret që kujtimet e tij do t'i sjellin përligjeje historike, që gjurmët e historisë të zbulohen në praninë barbare. (Castillo, 1986: 82). Në një mënyrë, Gjykatësi e përziën dëshirën për ta shëruar veten me dëshirën për t'i shëruar viktimat, siç thotë një studiues (Urquhart, 2006: 6).

Gjykatësi lirohet më në fund, mirëpo, ironikisht shteti perandorak (oficeri Mandel) ia mohon edhe këtë status: “Si mund të jeshë i burgosur kur nuk kemi të dhëna për ty? A mendon ti se nuk mbajmë shënime? Nuk kemi të dhëna për ty. Prandaj, duhet të jeshë i lire”.<sup>7</sup>

Gjykatësi mendon për barbarët, por nuk mund të depërtojë më thellë në esencën e tyre, as të shpjegojë pse, sikur njerëzit e tjerë të qytezës dhe ushtarët, i pret të vijnë. (Castillo: 89).

Barbarët mbesin shenjues pa referent material (të shenjuar) te Cavafy dhe Coetzee, sepse ata kanë ekzistuar veçse si diskurs i civilizimit, një konstrukt i tij. (Boletsi, 2007: 89).

<sup>6</sup> I cannot save the prisoners, therefore let me save myself. Let it at the very least be said, if it ever comes to be said, if there is ever anyone in some remote future interested to know the way we lived, that in this farthest outpost of the Empire of light there existed one man who in his heart was not a barbarian. (Coetzee, 1999: 140)

<sup>7</sup> “How can you be a prisoner when we have no record of you? Do you think we don't keep record? We have no record of you. So you must be a free man”. (Coetzee, 1999: 167).

Në ëndërrat e veta, Gjykatësin e josh dhe i ngjall neveri në të njëjtën kohë një pamje fëmijësh që bëjnë një kullë bore; në fund të romanit një njeri prej bore (angl. snowman), dordolec. (Castillo, 1986:83).

Romani *Duke pritur barbarët* mbaron me këtë skenë:

Në mes të sheshit ka fëmijë që luajnë e bëjnë një dordolec bore. Në hall që të mos i trazoj, por i kapluar prej një gëzimi të pashpjegueshëm, u afrohem nëpër borë.

Ata nuk trazohen, por janë tepër të zënë të m'i hedhin sytë. E kanë mbaruar trupin e rumbullakët, ndërsa tash po rrokullisin një top bore për kokë.

“Sillni gjësende për gojë, hundë dhe sy”, thotë fëmija që është prijësi i tyre.

Më shkrep në mendje se dordolecit do t'i duhen edhe krahë, por nuk dua të ndërhyj.

E vendosin kokën mbi shpatulla dhe i fusin guralecë për sy, veshë dhe gojë. Njëri i vë kurore me kapelën e vet.

Nuk është dordolec i keq.

Kjo nuk është skena që kam ëndërruar. Si shumëçka këtyre ditëve, e lë skenën i shushatur, si dikush që ka humbur udhën moti por megjithatë vazhdon rrugës që mund të mos çojë kund.<sup>8</sup>

Sikur që poezia e Constantine Cavafy-t mbaron me një thënie të dykuptimshme se barbarët ishin “njëfarë zgjidhjeje”, që në të vërtetë nuk është zgjidhje, edhe romani i J.M. Coetzee-s mbaron me fjalët: “rrugës që mund të mos çojë kund”. Të dy veprat, pa përmbyllje, me misterin e pazgjidhur.

Poezia e Sabri Hamiti “Ikja e barbarëve” mbaron me vargjet: “Nesër do të çilet ditë e bardhë e zotit/Ka mbetur tepër të bëhet e të thuhet”, që dëftojnë përmbyllje e hapje në të njëjtën kohë, me mrekullinë e njeriut e të Zotit.

---

<sup>8</sup> In the middle of the square there are children at play building a snowman. Anxious not to alarm them, but inexplicably joyful, I approach them across the snow.

They are not alarmed, they are too busy to cast a glance. They have completed the great round body, now they are rolling a ball for the head.

“Someone fetch things for the mouth and nose and eyes,” says the child who is their leader.

It strikes me that the snowman will need arms too, but I do not want to interfere.

They settle the head on the shoulders and fill it out with pebbles for eyes, ears, nose and mouth. One of them crowns it with his cap.

It is not a bad snowman.

This is not the scene I dreamed of. Like much else nowadays I leave it feeling stupid, like a man who lost his way long ago but presses on along a road that may lead nowhere. (Coetzee, 1999:207).

Të tre shkrimtarët afirmojnë një moralitet të dëshmisë: kujtesën si medium më të afërt me letërsinë sesa historia.

Në përmbyllje të këtij kërkimi për shkrimtarët Cavafy, Coetzee dhe Hamiti, që ndryshojnë me njëri-tjetrin për shumëçka, le të afirmohet ideja se të përbashkët e kanë një gjë: letërsia e tyre është krijuar në gjirin e shoqërive kolonialiste. Si grek i Aleksandrisë (në Egjipt), Cavafy jetoi e shkroi në gjirin e Perandorisë Britanike, fuqi koloniale që në fund të shekullit XIX kishte nën kontroll çerekun e globit tokësor. Coetzee në gjirin e kolonisë së bardhë sundimtare në Afrikën Jugut. Ndërsa Hamiti në Kosovën shqiptare nën sundim kolonial serb/jugosllav.

Leximi ynë është post-kolonial, sigurisht.

### **Bibliografia:**

1. Boletsi, Maria, "Barbaric Encounters: Rethinking Barbarism in C.P. Cavafy's and J.M. Coetzee's *Waiting for the Barbarians*", in *Comparative Literature Studies*, Vol. 44, No. 1-2, 2007, pp. 67-96.
2. Cavafy, C.P, "Waiting for the Barbarians", translated by Edmund Keeley/Philip Sherrard, in C.P.Cavafy, *Collected Poems*, edited by George Savidis, Princeton University Press, 1992. Poashtu në internet në faqen zyrtare të Arkivit të Kavafit: <http://www.cavafy.com>
3. Castillo, Debra A., "The Composition of the Self in Coetzee's *Waiting for the Barbarians*", in *Critique*, Winter 86, Volume 27, Issue 2, pp. 78-90.
4. Coetzee, J.M., *Waiting for the Barbarians*, Penguin Great Books of the 20<sup>th</sup> Century, Penguin Books, 1999 (1980)
5. Hamiti, Sabri, "Marshi barbar" dhe "Ikja e barbarëve", në *Kaosmos*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 81-85. Poashtu, në *Melankonia*, Faik Konica, Prishtinë, 1999, fq.7-8 dhe 81-82.
6. Hamiti, Sabri, "Dialogu i gjahtarëve barbarë", në *Melankonia*, Faik Konica, Prishtinë, 1999, fq. 58-61.
7. Moses, Michael Valdes, "The Mark of Empire: Writing, History, and Torture in Coetzee's *Waiting for the Barbarians*", in *Kenyon Review*, Winter 93, Volume 15, Issue 1., pp. 115-127.
8. *The Geography of Strabo*, with an English translation by Horace Leonard Jones, PhD, LL.D, Cornell University, (in eight volumes), VI, London, William Heinemann Ltd, Cambridge Massachusetts, 1960, fq. 3030-305. Citati është nga Libri 14.2.28.



9. Urquhart, Troy, "Truth, Reconciliation, and the Restoration of the State: Coetzee's *Waiting for the Barbarians*", in *Twentieth-Century Literature*, Volume 52, Issue 1, Spring 2006, pp. 1-21.

C. P. Cavafy

### **Duke pritur barbarët**

Çka po presim, të mbledhur në forum?  
Barbarët duhet të vijnë sot këtu.

Pse nuk po ndodh asgjë në senat?  
Pse senatorët rrinë aty po nuk bëjnë ligje?

Sepse barbarët do të vijnë sot.  
Çfarë ligjesh mund të bëjnë senatorët tash?  
Kur të vijnë barbarët, do t'i bëjnë ligjet vetë.

Pse është zgjuar kaq herët perandori ynë sot,  
Dhe pse rri ulur në fronin e vet në portën kryesore të qytetit,  
Me hijeshi fisnike, me kurorë veshur?

Sepse barbarët do të vijnë sot  
Dhe perandori po pret ta pranojë prijësin e tyre.  
Ai madje ka përgatitur një pergamenë me tituj e ndere të larta.

Pse kanë ardhur dy konsujt tanë dhe pretorët  
Të veshur me togat e tyre të qëndisura, të kuqe?  
Pse kanë byzylykë me kaq shumë ametistë,  
Dhe unaza që shkëlqejnë nga emeraldë të mrekullueshëm?  
Pse mbajnë bastunë elegantë  
Punuar për bukuri në ar e argjend?

Sepse barbarët do të vijnë sot  
Dhe gjërat si këto ua marrin mendtë barbarëve.

Pse nuk paraqiten oratorët tanë të spikatur si zakonisht

Për të mbajtur fjalime, për të thënë fjalën e vet?

Sepse barbarët do të vijnë sot  
Dhe i kanë mërzi oratorinë dhe demagogjinë.

Pse befaz ky nervozizëm, kjo habi?  
(Sa serioze janë bërë fytyrat e njerëzve).  
Pse po boshatisen kaq shpejt rrugët dhe sheshet,  
Të gjithë po shkojnë në shtëpi të rënë në mendime?

Sepse nata ka rënë e barbarët nuk kanë ardhur.  
Dhe njerëzit tanë që sapo u kthyen nga kufiri thonë  
se nuk ka më barbarë.

Dhe tani, çka do të ndodhë me ne pa barbarët?  
Ata njerëz ishin njëfarë zgjidhjeje.

*Përkthet nga anglishtja Muhamet Hamiti*

Sipas përkthimit nga Edmund Keeley/Philip Sherrard (në radhë të parë) por duke konsultuar edhe përkthimet në anglisht nga Stratis Haviaras, John Cavafy dhe John Chioles, përkatësisht.

Arben HOXHA

## EPISTEMOLOGJIA LETRARE DHE ETIKA: TIPOLOGJIA E RAPORTIT TË TYRE

### Hyrje

Që nga gjysma e dytë e shek. XX, raporti i etikës me shkencën do të jetë në qendër të vëmendjes së filozofisë së shkencës.

Nëse, në njërën anë, themi se epistemologjia letrare<sup>1</sup> përbën një aspekt të rëndësishëm të filozofisë së shkencës nëpërmjet të cilit ne mund t'i kuptojmë dhe t'i vlerësojmë objektivat, burimet, instrumentet, veçoritë dhe mundësitë e njohjes sonë, nga ana tjetër, mund të themi se orientimet dhe caqet e epistemologjisë letrare përcaktohen dhe kushtëzohen nga përmbajtjet e etikës së qëllimeve të tyre.

Duke e konceptuar etikën e qëllimeve njohëse si instancë rregullative të sistemeve epistemike<sup>2</sup> brenda shkencës letrare shqiptare, në punimin tonë do të merremi me hartimin e një tipologjie të raportit të etikës me epistemologjinë letrare. Tipologjizimi i raportit të këtyre dy entiteteve njohëse është kusht dhe mundësi metodologjike për njohjen dhe përcaktimin e dallimeve në punë të përkufizimit të karakterit të *së vërtetës, të përgjegjësive* së punës kërkimore dhe *qëndrimit aksiologjik* – si tri virtyte bazike epistemologjike - të studiueseve shqiptarë brenda praktikave dhe doktrinaeve të ndryshme njohëse letrare shqiptare.

### Marrëdhënia e epistemologjisë letrare me etikën

Që nga antikiteti (Platoni, Aristoteli) hulumtimi i virtyteve etike (të mirës, të

---

<sup>1</sup> Epistemologjia letrare, si epistemologji aplikative dhe si metashkencë e shkencës letrare, përbën tërësinë e shpjegimeve filozofike e metodologjike të çështjeve që kanë të bëjnë me origjinën, me funksionin, me zhvillimin, me vlerën dhe me mënyrën e verifikimit të cilësisë së njohjeve të prejardhura nga fushat e veçanta të dijes letrare: të teorisë së letërsisë, të historisë së letërsisë, të kritikës letrare, të estetikës së letërsisë, në njërën anë, dhe të koncepteve, të metodave, të metodologjive dhe modeleve metodologjike të hulumtimit letrar, në anën tjetër.

<sup>2</sup> Me sintagmën terminologjike “sisteme epistemike”, kuptojmë ato njësi rregullative epistemologjike, të cilat në mënyrë autonome kanë aftësinë të kombinojnë ndërmjet vete elemente të ndryshme kognitive.

keqes, të drejtës), i natyrës dhe marrëdhënies së tyre me virtytet intelektuale (besueshmërisë, vërtetësisë, vlefshmërisë) ka qenë objekt i trajtimeve gnoseologjike<sup>3</sup>. Edhe në ditët e sotme, nevoja e njohjes së rolit të virtytit etik për zgjidhjen e problemeve njohëse dhe të sendërtimit konceptual të njohjes për të kuptuar vlerën etike të saj, vazhdon të mbete një nga çështjet me rëndësi për përcaktimin e vlefshmërisë dhe qëndrueshmërisë së njohjes<sup>4</sup>.

Objekt trajtimi në punimin tonë është marrëdhënia e dy disiplinave, të cilat i ndajnë si karakteri i objekteve të tyre ashtu edhe karakteri i zonave ku ato e kanë sendërtuar ngrehinën e ekzistencë së vet: a) të epistemologjisë letrare, si teori aplikative e filozofisë së njohjes, dhe b) etikës, në përgjithësi, si filozofi e moralit.

Cila është marrëdhënia e këtyre dy fushave të veprimtarive shpirtërore njerëzore? Cili është raporti ndërmjet tyre?

Një prej komponentëve që e përcakton marrëdhënien e këtyre dy fushave të veprimtarisë shpirtërore të njeriut është virtyti intelektual, i cili përmban motivimin dhe prirjen për të arritur një përfundim të qëndrueshem<sup>5</sup>.

Pol Fajerabend (Paul Feyerabend), duke e parë rolin që ka për jetën shoqërore ndërveprimi i njohjes konceptuale-kognitive me virtytin intelektual dhe etikën në përgjithësi, shkencën e konsideron si “njërën nga ideologjitë e shumta, e cila e vë në lëvizje shoqërinë”<sup>6</sup>. Ndërkaq, Huserli në veprën e tij “Kriza e shkencës evropiane dhe fenomenologjia transcendentale”, dështimin e fuqive racionale dhe racionalitetit shkencor e sheh në reduktimin pozitivist që do t’i bëhet idesë së ekzistencës së shkencës si aktivitet i përshkrimit të fakte të kulluara, gjë kjo që, sipas tij, shkencën do ta dërgojë në një situatë përveçimi prej “botës së jetës”<sup>7</sup>.

Për filozofët e shkencës dilemë në vete përbën çështja se si mund të ekzistojë marrëdhënia ndërmjet njohjes konceptuale-kognitive, e cila orientohet nga interesi i arsyes së kthyer nga vetvetja, me filozofinë normative morale, e cila udhëhiqet nga interesi i zotërimit të realiteti empirik sipas kategorisë modale “duhet të jetë”? Në qoftë se nisemi nga hipoteza e Poperit, sipas të cilit, qëllimi i njohjes shkencore është “shpjegimin e fakteve që e bëjnë të mundshëm përshkrimin e gjendjes së gjërave, ndërsa vetë faktet e shpjeguara e bëjnë “shpjegimin”, në kuptimin e gjerë të fjalës,

<sup>3</sup> *Intellectual Virtue: Perspectives from Ethics and Epistemology* (edited by Michael Depaul and Linda Zagzebski), Oxford University Press, 2003, fq.2.

<sup>4</sup> *Po aty*, fq.3.

<sup>5</sup> *Virtu epistemology: essays on Epistemic Virtue and Responsibility* (Edited by : Abrol Fairweather & Linda Zagzebski), Oxford University Press, 2001, fq. 69.

<sup>6</sup> Paul Feyerabend: “Si të mbrohet shoqëria nga shkenca”, në *Filozofia nauke*, Nolit, Beograd (pa vit botimi), fq. 358.

<sup>7</sup> Edmund Huserl, *Kriza evropiskih nauka i transcendentna fenomenologjia*, Decje novine, Gornji Milanovac, 1991, fq. 14-15.

expicans expicanduma<sup>8</sup>; etika, ndërkaq, e bën konfigurimin e gjendjes së gjërave në bazë të “vlerës” dhe të “mirës”, siç thotë teoricieni i etikës Xhon Dëueja (John Dewey), jo sipas asaj “çfarë dëshirojmë”, por sipas saj se “çfarë duhet të dëshirojmë”<sup>9</sup>.

Në kontekstin e shtjellimit të temës sonë, shtrohet pyetja sa dhe si ka ndikuar marrëdhënia ndërmjet njohjes shkencore letrare me etikën?

Cila është praktika e marrëdhënies së këtyre dy realiteteve njohëse në shkencën letrare shqiptare?

Sa ka ndikuar kjo marrëdhënie në karakterin dhe relievin e shkencës letrare shqiptare, në qëllimet dhe instrumente e saj njohëse?

Historia e zhvillimit të shkencës letrare shqiptare a karakterizohet nga fenomeni i përveçimit të njëres disiplinë nga tjetra apo nga fenomeni i kolonizimit të zonës së ekzistencës së njëres disiplinë prej kategorive të disiplinës tjetër?

Në praktikën e shkencës letrare shqiptare sa janë përzierë kategoritë etike të së mirës, të së keqes dhe vlerës me kategoritë e njohëse kognitive, siç është e vërteta, ligjësia, sistemi, qëndrueshmëria, vlefshmëria etj.?

Si ka ndikuar marrëdhënia e kategorive etike e kognitive në strukturën e kulturës letrare shqiptare?

Sa raporti ndërmjet tyre ka ndikuar që subjekti kulturor shqiptar të pajiset me fuqi përvojash reflektimi emancipues, dhe sa ai ka arritur që përmes kësaj fuqie të bëhet parashikues i ekzistencës së tij, e kjo do të thotë që ai të jetë subjekt i formimit të vetvetes?

Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve janë të kondicionuara, në radhë të parë, nga marrëdhënia reflektive që shkenca letrare do ta ketë me objektin e vet njohës: me prodhimin letrar.

### **Marrëdhënia e epistemologjisë me prodhimin letrar**

Prodhimi letrar, si objekt, është hapësira në të cilën objektivizohen mënyrat e të dhënave për botën të përfshira brenda përvojës së ndërgjegjes së subjektit krijues letrar. Epistemologjia letrare është subjekt vetërefleksioni, i cili vepron brenda kësaj hapësire “objektivizmi”, me ç’rast, duke e kthyer ndërgjegjen letrare të subjektit krijues nga vetvetja si qëllimësi, e konstituon kuptimin e ekzistencës të të dhënave dhe mënyrës se si ato janë objektivizuar brenda saj (ndërgjegjes). Pra, epistemologjia letrare, si fuqi e veprimit kognitiv, i përcakton mënyrat se si ndërgjegjja letrare i ka

---

<sup>8</sup> *Filozofije nauke* (përgatitur nga Neven Sesardic), Nolit, Beograd (pa vit botimi), fq. 253.

<sup>9</sup> *Savremena meta-etika*, Societas, Beograd, 1991, fq.14.

ndërtuar botërat dhe vetveten brenda saj, ashtu si edhe mundësitë për tejkalimin e trajtave të kufizuara të ekzistencës njerëzore të dhëna brenda atyre botëve. Si e tillë, epistemologjia përbën një mekanizëm prodhimi dhe lirimi energjisht emancipuese.

Praktika e shkencës sonë letrare, në pjesën e madhe të ekzistencës së saj, na provon për një orientim me kahe të kundërt me prirjet formësuese dhe emancipuese shpirtërore, intelektuale e morale. Ajo, në të shumtën e ekzistencës së vet, nuk do të jetë në shërbim të zhvillimit të aftësive të njeriut tonë për veprim dhe ndërveprim human me veten dhe me mjedisin që do ta rrethojë. Kjo për shkak, në radhë të parë, të kufizimeve ndjeore e botëkuptimore që ka prodhuara refleksioni letrar shqiptar për njeriun dhe botën e tij, i cili na shfaqet si një e dhënë parciale empirike, herë në rrafshin e realitetit gjeografikë, herë në rrafshin e realiteti kulturor, herë në rrafshin e realitetit social, herë në rrafshin e ideologjisë (religjioz, nacionale, klasore, liberale etj.), e jo si qenie totale me potencialitetin e attributeve të veta shoqërore, ideologjike, politike, historike, kulturore etj. Pra, praktika rrëgjuese e prodhimit tonë letrar, si sirefleksion për botën dhe ekzistencën njerëzore, për shkak se do të bazohet në përshkrimin e të dhënave dhe rendit të ekzistencës së tyre, por jo edhe në zotërimin e kuptimit të ekzistencës së të dhënave dhe kuptimit të rendit që ato vendosin në botë, pa dyshim se do të jetë një faktor kufizues për rolin dhe mundësitë e epistemologjisë letrare për zgjerimin e mundësive të zonave të humanitetit të qenies njerëzore.

Cili është reagimi i shkencës letrare ndaj realitetit të objektit të vet? Cilat janë shkaqet që do ta përcaktojnë orientimin e reagimit të saj njohës drejt mundësisht të kufizuara formësuese dhe emancipuese humane?

### **Etika e qëllimeve njohëse**

Njeriu fillimisht dëshiron e më pas koncepton duke e strukturuar dhe formësuar (ose përmes një etike fenomenologjike ose një etike noramtive) lëndën e asaj dëshireje në etikë të qëllimeve njohëse.

Nëse themi se epistemologjia letrare përbën një aspekt të rëndësishëm të filozofisë së shkencës nëpërmjet të cilës ne mund t'i kuptojmë dhe t'i vlerësojmë objektivat, burimet, instrumentet, veçoritë dhe mundësitë e njohjes sonë, atëherë, mund të themi se orientimet dhe caqet e epistemologjisë letrare përcaktohen dhe kushtëzohen nga përmbajtjet e etikës së qëllimeve njohëse. Varësisht se me cilën teori të filozofisë së moralit do të hyjë në marrëdhënie epistemologjia letrare, do të përcaktohet përmbajtja e etikës së qëllimeve njohëse dhe e gjykimeve vlerore.

Gjykimet dhe vlerat etike janë bazë që e sigurojnë lidhjen e ndërsjellë ndërmjet qëllimeve dhe mjeteve etike me qëllimet dhe mjetet kognitive letrare, ndërsa etika e qëllimeve njohëse, si sinkretizim i tyre, përbën orientimin themelore, i cili është i

lidhur me kushtet bazike që e mundësojnë vetëformimin dhe reproduktimin e species njerëzore përmes veprimit dhe ndërveprimit së tij me mjedisin që e rrethon.

Meqenëse përfaqëson një fuqi që e strukturon përgjegjësinë morale dhe sistemin kognitiv të subjektit njohës dhe strukturohet nga ato, etika e qëllimeve të subjektit njohës manifestohen si në rrafshin e botëkuptimit ndaj botës ashtu edhe në rrafshin e hipotezave epistemologjike dhe hipotezave metodologjike.

### **Tipologjia e marrëdhënies**

Duke e konceptuar etikën e qëllimeve njohëse si objekt të intencionalitetit të ndërgjegjes njohëse, si forcë orientuese të ndërgjegjes njohëse, mund të themi se historia e zhvillimit të shkencës letrare shqiptare do të karakterizohet prej mbizotërimi të tre tipave të marrëdhënieve midis epistemologjisë letrare dhe etikës:

a) prej tipit të marrëdhënies që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të objektivizmit empiricist kognitiv;

b) prej tipit të marrëdhënies që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të racionalizmit empiricist kognitiv; dhe

c) prej tipit të marrëdhënies që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të emotivizmit antikognitivist.

Në tipin e parë të marrëdhënies së epistemologjisë letrare me etikën, tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të objekteve njohëse i atribuohet karakteri empirik utilitar në bazë të përcaktimeve që burojnë nga fuqia e dëshirave për përmbushjen e nevojave të praktikës shoqërore (trajtimi pozitivist i objektit të njohjes letrare me përfaqësues reprezentativ Dhimiter Shuteriqin); në tipin e dytë të marrëdhënies së epistemologjisë letrare me etikën, tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të ekzistencës së objekteve njohëse i atribuohet karakteri logjik racional në bazë të përcaktimeve që burojnë nga dëshira e arsyes për përmbushjen e nevojave reflektive të subjektit të njohës dhe logjikes për emancipimin dhe formimin e qenies humane shqiptare (trajtimi integral i objektit të njohjes letrar me përfaqësuesin reprezentativ Rexhep Qosja); ndërsa në tipin e tretë të marrëdhënies së epistemologjisë letrare me etikën, tërësisë së kuptimeve dhe mënyrave të arsyetimit të ekzistencës së objekteve njohëse i atribuohet karakteri emotivist-antikognitiv, me ç'rast arsyeja i nënvendoset lëndës njohëse si objekt i perceptcionit emocional (trajtimi tematik-subjektivist i objektit njohës – përfaqësues reprezentativ i kësaj tipologjie është Sabri Hamiti.).

Marrëdhënia e epistemologjisë letrare me etikën do të përcaktojë përmbajtjen dhe karakterin e interesit të njohjes letrare; qëllimin dhe funksionin; rendësinë dhe vlerën e saj humane.

Në tipin e parë të marrëdhënies së epistemologjisë letrare me etikën - që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të objektivizmit empiricist kognitiv - interesi njohës buron dhe i drejtohet arsyes instrumentale (ideologjisë klasore, kombi etj); në tipin e dytë të marrëdhënies së epistemologjisë letrare me etikën - që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të racionalizmit empiricist kognitiv - arsyeja është mjet dhe qëllim i interesit njohës; në tipin të marrëdhënies të epistemologjisë letrare me etikën - që deduktohet nga etika e qëllimeve njohëse me prejardhje nga teoria e filozofisë së moralit të emotivizmit antikognitivist - fakulteti i emocionit është qëllimi dhe mjet i interesit njohës.

### **Bibliografia:**

1. Edmund Husserl: *“Kriza evropshkih nauka i transcendentalna fenomenologija”*, Decje novine, Gornji Milanovac, 1991.
2. Intellectual Virtue: *“Perspectives from Ethics and Epistemology”* (edited by Michael Depaul and Linda Zagzebski), Oxford University Press, 2003.
3. *“Filozofije nauke”* (përgatitur nga Neven Sesardic), Nolit, Beograd (pa vit botimi).
4. *“Savremena meta-etika”*, Societas, Beograd, 1991
5. *“Virtu epistemology: essays on Epistemic Virtue and Responsibility”* (Edited by: Abrol Fairweather & Linda Zagzebski), Oxford University Press, 2001.



**Anna KAPITANOVA**

## **NEVOJA PËR NJË GJUHË TË NJËSUAR – PIKËNISJA E BASHKIMIT KOMBËTAR TE SHQIPTARËT**

Në librin e tij “Kombet dhe nacionalizmi” filozofi anglez, antropolog social, Ernest Gellner e përkufizon konceptin e kombit kështu: “Një person i përket kombit të dhënë, kur të gjithë anëtarët e tjerë e konsiderojnë atë si të tillë.” Si identifikohet shqiptari si shqiptar? Në bazë të përkatësisë territoriale – jo. Të mos harrojmë se shteti i Shqipërisë mungonte kohë të gjatë në hartën e Evropës dhe në fillim të shekullit XX u shfaq një Shqipëri shumë e copëtuar. Në bazë të përkatësisë fetare – kategorikisht jo. Sepse feja në procesin e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare i shërbente rivendosjes së kufijve të shtetit dhe jo krijimit të shtetit. Mbetet vetëm një – në bazë të përkatësisë gjuhësore. Pra, vërehen tri elementet themelore të cilat vijojnë të përkufizojnë konceptin e kombit – integritet territorial, fe zyrtare dhe gjuhë e përbashkët. Për qëllimet e studimit feja shqyrtohet si instrument i shtetit dhe njëkohësisht ndaras nga proceset kulturore.

Gjatë Mesjetës historia e Gadishullit Ballkanik e kanë shkruar a perandorët romakë dhe bizantinë, a popujt barbarë, të cilët vazhdimisht e sundonin territorin dhe formonin shtete më vete. Në atë kohë trojet me popullsi autoktone shqiptare ishin nën dy influenca politike e kulturore – të Romës dhe të Kostandinopojës. Ky fakt ka paracaktuar historikisht “ndarjen horizontale” të shqiptarëve. Në veri ata ishin katolikë, flisnin gegërisht dhe në shkrim përdornin grafemat latine, ndërsa në jug – ortodoksë, flisnin toskërisht dhe në shkrim përdornin grafemat greke, dhe në një etapë më të vonshme u shfaq alfabeti shqiptar i adaptuar nga arabishtja. Kjo është një nga arsytet për ekzistencën e më se një alfabeti shqiptar para Kongresit të Manastirit. Në atë kohë shqiptarët nuk gëzonin integritet territorial, meqenëse historia mbante mend disa formime të tyre shtetërore, por ata ishin vetëm episodike në hartën antike dhe mesjetare të Evropës. Te shqiptarët e asaj kohe nuk dukej asnjë shenjë bashkimi.

Fat krejtësisht të ndryshëm patën bullgarët. Në fund të shekullit VII protobullgarët e ardhur nga Azia Qendrore dhe një pjesë e grupit etnik të sllavëve, të vendosur në Ballkan u bashkuan në shtetin me emrin Bullgaria (681). Njëri nga kushtet e bashkimit ishte mbrojtja e përbashkët nga oreksi territorial kryesisht i Bizantit. Por më e rëndësishmja këtu nuk ishte përse u bashkuan bullgarët, ndërsa pse

“mbijetoi” shteti bullgar. Dy janë elementet e “mbijetesës” – vendosja e gjuhës së përbashkët dhe e fesë së përbashkët. Si protobullgarët, ashtu dhe sllavët ishin paganë dhe flisnin dy gjuhë të ndryshme. Sundimtari largpamës bullgar Boris I (852-889) vendosi fenë e krishterë, fillimisht në varësi nga Kisha e Kostandinopojës dhe më pas si Kishë e Pavarur Bullgare, dhe po ashtu vendosi shkrimin sllav dhe respektivisht alfabetin bullgar<sup>1</sup>. Është për t’u përmendur fakti se dëshmi e drejtpërdrejtë për aktin e krishterimit të sundimitarit bullgar është mbishkrimi i gjetur në afërsi të fshatit shqiptar Ballshi, ku shkruhet se Borisi pranon emrin e krishterë Mihaill. Kështu që bullgarët që nga Mesjeta pa problem identifikohen në bazë të gjuhës dhe fesë zyrtarisht të aplikuar. Në një periudhë më të vonshme mungesa e fesë zyrtare do t’u ishte lejuar arkivuesve osmanë të përfshijnë bullgarët në numrin e grekëve ortodoks, siç është rasti me shqiptarët. Ata shqiptarë të cilët ishin ortodoks për nga feja regjistroheshin si grekë në arkivat osmanë. Për sa i përket integritetit territorial, bërthama e shtetit bullgar ekzistonte pavarësisht humbjeve territoriale të pasuara nga luftërat e vazhdueshme gjatë Mesjetës.

Mirëpo, në kohën e Perandorisë Osmane grupet etnike në Ballkan, të bashkuara apo jo të bashkuara si shtet më vete, ranë në gjumin pesëshekullor. Por sa gjumë ishte ajo periudhë për shqiptarët, këtu mund të hidhen shumë diskutime. Sepse shqiptarët gjendeshin nga dyja anët e barrikadës. Një herë i shohim si kundërshtarët më të fortë të pushtetit osman, herë tjetër si oborrtarët e sulltanit me ndikim të madh politik. Pohohet se në kohën e Perandorisë Osmane në trojet shqiptare nuk ka guxuar të shkelë këmba e osmanit dhe se këto kanë qenë relativisht të pavarura. Nuk është vështirë t’i besohet kësaj historie, duke pasur parasysh se shqiptarët ishin mes të parëve në rreshtat e ushtrisë osmane. Por ndërkohë i dilnin kundër pushtetit osman. Është i padiskutueshëm kontributi i madh i arvanitasve në çlirimin e Greqisë nga zgjedhja osmane (1821), kur arnautët dhe arvanitasit “flisnin shqip” në fushëbetejë. Po, në atë kohë shqiptarët së bashku as këndonin dhe lexonin, as i luteshin të njëjtit Zot. Bashkimi ende dukej goxha larg.

Le t’i drejtojmë vëmendje të veçantë fesë. Mungesa e një feje të përbashkët te shqiptarët shpjegon fatin e tyre të ndryshëm në Perandorinë Osmane. Shumë shqiptarë u konvertuan në fenë islame – disa ishin motivuar nga përfitimet politike, të tjerët – ishin detyruar me dhunë. Kishte po ashtu dhe një numër shqiptarësh, të cilët furnizonin ushtrinë osmane me ushqime pa paguar taksën që sulltani kishte vendosur mbi popullsinë jo-myslimane. Ende shqiptarët shikonin a xhaminë, a kishën dhe ndarja e tyre fetare nënkuptonte ndarjen në mendimet e tyre politike. Jo se përkatësia fetare është aq e rëndësishme, feja si instrument i shtetit është e rëndësishme, sepse

---

<sup>1</sup> Shih glagolishte dhe alfabet cirilik

ajo “modelon” sjellje politikisht të argumentuar.

Roma dhe Kostandinopoja luftonin për interesat e veta politike. Në shekullin e IX-të Bizanti dërgoi në Moravi të Madhe<sup>2</sup> dhe Panoni vëllezërit Qiril dhe Metodi, të cilët duhej të përhapnin krishterimin ndër sllavët dhe kështu këta të fundit të bëhen aleat i sigurt. Por kjo ishte vetëm qëllimi i “maskuar” i Bizantit, i cili në fakt donte të impononte politikën e vetë. Së shpejti Roma iu përgjigj synimit të Bizantit, duke filluar persekutime ndaj Qirilit dhe Metodit dhe nxënësve të tyre në këto vende, thjesht për arsye të njëjta. Nga kundërshtimi midis Romës dhe Kostandinopjës sigurisht përfitoi Bullgaria, e cila mirëpriti veprën e Qirilit dhe të Metodit në oborin e saj mbretëror, nga u vendos gurthemeli i shkrimit dhe kulturës bullgare. Edhe Perandoria Osmane luftonte për interesat e veta politike, por për të ishte më e vështirë sepse duhej të çrrënjoste tërësisht shenjat identifikuese të bullgarëve. Greqia, duke qenë forcë politikisht jo e madhe, por tashmë shtet i pavarur, gjatë shekullit të XIX-të gjithashtu bënte përpjekje përmes shkollimit greqisht të zmadhojë ndikimin e vet politik, si të bullgarët, ashtu dhe të shqiptarët. Dhe nuk është e rastit se gjatë Rilindjes pikënisja e luftërave nacional-çlirimtare bullgare ishte lufta për Kishën e Pavarur Bullgare. Pra, ndërjegjen kombëtare e zgjuan feja dhe ëndrra për integritetin e dikurshëm territorial.

Të lartpërmendurit vijnë të shpjegojnë përse feja e shqiptarit patjetër duhet të ishte “shqiptaria”. Sepse derisa popujt e tjerë ballkanikë në shekullin e XIX-të hapnin shkollë pas shkolle në gjuhë amtare, shqiptarët as flisnin “shqip” të njësuar, as ëndërronin për Shqipërinë e dikurshme, as mund të drejtonin te kisha ose xhamia. Sepse synimet e fesë në shekullin e XIX-të dukeshin më të qarta. “Kisha” qëllonte të lagej në Adriatik ose së paku të stoponte zgjerimin territorial të vendeve ballkanikë, ndërsa “xhamia” qëllonte të ruante “mbeturinat” e një perandorie, e cila po i vinte fundi. Dhe po të mos ishin mosmarrëveshjet midis të zgjuarit shqiptarë dhe turqit e rinj, ndoshta do të ishte ndryshe. Por erdhi koha për t’u zgjidhur dhe çështja kombëtare e shqiptarëve.

Siç u bë e qartë më lartë, kombit i nevojiten tre elementet – integritet territorial, fe zyrtare dhe gjuhë e përbashkët. Në fillim të shekullit të XIX-të këto tri elemente mungonin te shqiptarët. Ata kurrë më parë nuk ishin bashkuar në një shtet më vetë. Organizmat dhe shoqëritë patriotike shqiptare gjatë Rilindjes kryenin detyrën e komandantëve mesjetarë – bashkonin shqiptarët rreth idesë së krijimit të një shteti të pavarur. Akrepat e shqiptarëve duhej të lëviznin jo me sekondë, por me vite të tëra. Çështja e fesë automatikisht u eliminua si faktor i zgjimit të ndërjegjes kombëtare te shqiptarët dhe u zëvendësua me pasqyrimin e vlerave kulturore, të cilat e lejojnë

---

<sup>2</sup> Territoret e sotme të Çekisë dhe të Sllovakisë dhe një pjesë të Austrisë dhe Hungarisë

shqiptarin që të identifikohet si i tillë. Për sa i përket gjuhës – nevoja për shqipen e njësuar u duk shumë qartë në vitet pas Kongresit të Berlinit (1878) dhe viti 1908 u bë pikënisja e bashkimit kombëtar. Sepse shqiptari edhe atëherë, edhe sot identifikohet në bazë të gjuhës që flet. Kjo dukuri në zhvillimin e popujve ballkanikë duket sot e kësaj dite te shqiptarët, kur rol i rëndësishëm luan abetarja e përbashkët.

### **Bibliografia:**

1. Hjosh Edgar, *Historia e vendeve të Ballkanit*, Sofje, 1998
2. Toleva Teodora, *Ndikimi i Austro-Hungarisë në krijimin e kombit shqiptar (1896-1908)*, Sofje 2012
3. Leksione të historisë nga Universiteti i Sofjes “Shën Kliment i Ohrid”

Aleksandër NOVIK

**PERSONAZHET MITOLOGJIKE NDËR SHQIPTARËT E  
DEVOLLIT: PARALELE ME TRADITËN E SHQIPTARËVE TË  
UKRAINËS (EKSPEDITAT 2011-2014)**

Gjatë viteve 2011-2014 janë organizuar katër ekspedita etnolinguistike në Shqipërinë Juglindore (krahinat: Devolli, Korça, Kolonja) me qëllim të studimit të situatës gjuhësore dhe kulturore në këtë zonë. Pjesëmarrësit e këtij projekti janë Andrej Sobolev, Aleksandër Novik, Denis Ermolin, Maria Morozova, Aleksandra Dugushina dhe Marina Sulloeva. Nuk kemi detyrë të domosdoshme të gjejmë gjurmët e paraardhësve të shqiptarëve të sotëm të Ukrainës. Megjithatë, kemi të bëjmë me paralelet në traditat e popullsisë së Shqipërisë Juglindore dhe atë të shqiptarëve të Ukrainës.

Në fshatin Ziçisht të Devollit janë mbledhur materialet për mitologjinë popullore që dëshmojnë për vazhdimësinë e besimeve dhe të bestytnive gjatë periudhës shumëshekullore. Memoratat lidhur me demonologjinë quhen në të folmen vendase *parapërrall/ë, -a* (pl. *parapërralla, -t*). Kështu janë incizuar narativat për *lugatët* dhe *gogolat*. Imazhi i këtyre personazheve nuk është i qartë në parafytyrimet popullore. *Lugati* dhe *gogoli* janë përfaqësuesit e forcave të këqija.

Në fshatin Ziçisht është incizuar narrativi për vetëvrasjen e një plake që u mbyt në *boçkë* (dial. *boçkë/ë, -a* ‘fuçi -a’) në mullirin e ujit para disa dekadash. Gruaja e giorë u hodh në ujë “nga stresi” si thonë informantët tanë. Megjithatë, që të mos bëhej lugat njerzit e fshatit e kanë shpuar gjoksin e kufomës me një gozhdë të hekurt. Në këtë zonë nuk janë fiksuar bestytnitë që kjo punë patjetër duhet të bëhet me një shkop druri (si është në zona të tjera të Ballkanit). Në këtë procedurë kanë marrë pjesë fshatarët e moshuar. Pas procedurës së shpuarjes plaken e kanë varrosur në varrezat e fshatit pranë kishës së Shën Mërisë. Për ata që përfundojnë me vetëvrasje është përcaktuar një vend i kufizuar i varrezeve, majtas nga porta e oborrit të kishës.

**Lugat, gogol**

Për krahasim në Ukrainë gjatë ekspeditave tona janë fiksuar dhe incizuar narrativet për personazhet mitologjike: **d'all, vampirë** (në besimet e shqiptarëve të

Ballkanit *lugat, gogol*, në parafytyrimet e mëvonshme dhe në traditën e krishterë *djall*, por në Ballkan ekzistojnë dy fjalë me kuptime të ndryshme, kurse në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës fjala *d'all* ka kuptime të ndryshme semantike) [AOE: Новик 2009: Бурачко: Мифология\_1; AOE: Новик 2011: Пейчева (Литвинова)\_ВА\_мифология; AOE: Новик 2011: Шопова\_СМ\_мифология]. Personazhi *vampirë* mund të krahasohet me *lugañin* e besimeve të shqiptarëve të Ballkanit dhe nuk ka lidhje me vampirët e kulturës globale të medias (siç vërejnë vetë informantët) [АМАЭ: Новик 2009А; АМАЭ: Новик 2009Б].

### Reshetnicat

Në Devoll deri në ditët tona janë ruajtur besimet në personazhet mitologjike që i japin fat fëmijës së porsalindur. Në të folmen e Ziçishtit këto personazhe të gjinisë femërore quhen *reshetnicat* (< sllav., bullg. *rešenica*). Kjo leksemë është huazim sllav i transformuar në të folmen e Ziçishtit (krahaso: resheto ‘shosh, -i’). Natën e tretë pas lindjes tri gra vijnë në shtëpinë e lehonës për t’ia shkruar fatin foshnjës. Dita kur vijnë *reshetnicat* te shqiptarët e krishterë të Ziçishtit quhet *të tretat*, kurse shqiptarët myslimanë në këtë zonë e quajnë *vidio* (huazim tejet i qartë nga sllavishtja ‘shikimi’). Vizita për të parë djalin te shqiptarët myslimanë quhet *vidio i djalit* (‘shikimi i djalit’), *vidio i vajzës* (‘shikimi i vajzës’).

Kemi të bëjmë me besime në personazhe mitologjike që japin fat në shumë rajone të Ballkanit: në Greqi, Bullgari, Maqedoni, Shqipëri etj. [Stublla 2007; Георгиева 2013]. Ka variacione të numrit të këtyre personazheve, nga një deri në tre. Por tek shqiptarët e Ziçishtit është fiksuar tradita që ditën e tretë pas lindjes së fëmijës në shtëpinë e lehonës vinin tri gra reale të fshatit të cilat luanin rolin e personazheve mitologjike. Ky zakon vazhdonte së paku që nga fillimi i shekullit XX. Mund të supozojmë që transformimi i besimeve dhe i praktikave përkatëse ka pasur vend jo më vonë se si në shekullin XIX.

Në traditën e shqiptarëve të Ukrainës gjejmë besime të tilla: tri gra ose tre burra të zinj vijnë “për të shkruajtur fatnë” (fshati Georgievka në rajonin Priazovskoe).

### Magjistarët, shtrigat, syri i keq

Terminologjia e fushës së mitologjisë në Devoll ka paralele me terminologjinë e së folmes së shqiptarëve të Ukrainës.

Kanë vitalitet të dukshëm besimet në *syrin e keq* i cili konsiderohet ndër fshatarë vendasë si veprimi i fuqive të këqija. Në narativet e inçizuara fiksohen parafytyrimet që njeriu me fuqi të jashtzakonshme mund të marrë mësysh dikë me dashje ose pa dashje dhe shpesh kjo bëhet pa ditur dhe nga ai vetë personi [krahaso tek shqiptarët e Ukrainës: AOE: Новик 2012: Сендели\_АН\_мифология]. Si mjet mbrojtës kundër

*syrin e keq* përdoret karfica i cila quhet në të folmen e Ziçishtit *asfalk/ë, –a,që* e mbajnë në veshje. Ekziston edhe praktika që njerzit, fëmijët dhe të rriturit, i sherojnë me vaj ulliri. Për këtë në tas me ujë nëna ose dikush nga familjarët pikon 3 pika vaj ulliri. Me këtë ujë dhe vaj e lajnë fytyrën e të sëmurit.

Kripa gjithashtu konsiderohet në Dëvull si një apotropej i fortë. Me kripë nëna ose ndokush nga familjarët vizaton kryqe në buzët e fëmijës dhe pastaj e hedh këtë kripë në zjarr me një formulë verbale të veçantë. Magjia pas këtij veprimi shërues duhet pa tjetër të shkatërohet [АМАЭ: Новик 2013А; АМАЭ: Новик 2013Б].

Në rastin kur fëmija është marrë mësysh nëna mund ta ferkojë me fundin e fustanit ose të fundit të saj. Në Ballkan edhe në shumë vende të Evropës fiksohet gjithashtu praktika kur në raste të tilla nëna e fërkon fëmijën me përparësën e vet [Мифалогія 2011]. Përparësja në përgjithësi në sistemin e kostumit tradicional të popullit shqiptar ka funksion jo vetëm pragmatik por edhe simbolik dhe është apotropej i fortë kundër forcat e liga.

Në traditën e kësaj zone, dmth. në Devoll, fiksohet përdorimi i hajmalisë ([h]ajmali –ja). Hajmalija si zakon përbëhet nga një copë hudhre, lëkurë gjarpri, temjani, flokët e babait dhe të nënës së fëmijës që janë mbështjellur me një copë pëlhurë të zezë. Hajmalijën në gajtan e veshin në qafën e fëmijës. Në të folmen e Ziçishtit hajmalija quhet *shiritk/ë, –a me sy*. Në vitet e fundit në të folurit e të rinjve më shpesh përdoret termini i përbashkët shqiptar *hajmali* ([h]ajmali, –ja < turq.).

### Gjarpri i shtëpisë

Në fshatin Ziçisht në variant të reduktuar fiksohen parafytyrimet për *gjarprin e shtëpisë*, i cili është rojë i vatrës familjare [krahaso: Tirta 2004; Tirta 2007]. Në të folmen e fshatit është rruajtur shprehja *gjarpri i shtëpisë*. Informantët tanë mbajnë mend shumë mirë që pleqtë në të kaluarën tregonin se në çdo shtëpi kishte jetuar gjarperi. Në ditët tona këtë fakt e shpjegojnë në mënyrë të tillë: dyshemetë e shtëpive më parë ishin prej dheu, nuk ishin shtruar me pllaka guri ose keramike (si puna e ditëve të sotme), prandaj gjarpërinjtë hynin në shtëpi pa asnjë pengesë dhe jetonin diku në mure. Në ditët tona gjarpri konsiderohet si një qënije shumë e rrezikëshme [krahaso tek shqiptarët e Ukrainës: АОЕ: Новик 2012: Торбина(Мипт)\_АК\_мифалогія; АМАЭ: Новик 2013Б]. Çdonjeri duhet ta vrasë gjarprin lë të jetë në shtëpi, oborr ose në natyrë – në fushë, livadh ose në mal.

Sipas traditës së krishterë në këtë zonë çdo njeri kush e sheh gjarprin duhet pa tjetër ta vrasë, ndryshe ai 40 ditë do të hante bukë pa dobi. Nëse e pa gjarprin dhe nuk e vrau duhet të mbante argjerim, të mos hante bukë,

*Согласно христианской традиции, любой, увидевший змею, должен ее убить. Иначе он сорок дней напрасно ест хлеб. Увидел и не убил – не можешь есть, как все, должен на себя наложить запрет в еде, покаяться.*

[АОЕ: Тоскерия 2013: Новик: Andoni\_Thanas\_mitologjia].

Analiza e materialeve nga terreni na jep bindje në perspektivën shkencore të shtjellimeve tona të mëtejshme.

### **Burimet dhe Literatura:**

### **Arkivat:**

1. АМАЭ: Новик 2009А – Новик А.А. Традиционная культура албанцев Приазовья. Приазовский район, Запорожская область, Украина. Ксерокопия полевого дневника. 2009. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 1934. 95 л.
2. АМАЭ: Новик 2009Б – Новик А.А. Отчет об экспедиционных исследованиях в Приазовье в июле-августе 2009 года. Принтерный вывод. 2009. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 1935. 85 л.
3. АМАЭ: Новик 2013А – Новик А.А. Экспедиция в Тоскерию (Юго-Восточная Албания) к православным албанцам, албанцам-мусульманам, в места бывшего расселения арумун (пограничье Албании и Греции). Полевые записи. Автограф. 10.08. – 18.08.2013., 19.09. – 25.09.2013. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2177. 68 л.
4. АМАЭ: Новик 2013Б – Новик А.А. Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерии (Юго-Восточная Албания) в августе и сентябре 2013 г. Принтерный вывод. 10.08. – 18.08.2013., 19.09. – 25.09.2013. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2178. 15 л.
5. АМАЭ: Новик 2013В – Новик А.А. Приазовский отряд 2013 г. Изучение традиционной культуры и языка албанцев, болгар и гагаузов Приазовья, Украина. Полевые записи. Автограф. 11.07. – 25.07.2013. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2173. 146 л.



**Arkivi i Departamentit të Europeistikës të Muzeut të Antropologjisë dhe  
Etnografisë të Akademisë së Shkencave të Rusisë:**

1. AOE: Новик 2009: Бурлачко: Мифология\_1 – Новик А.А. Бурлачко: Мифология\_1. Цифровая аудиозапись. 2009 // Архив отдела европейстики МАЭ. Приазовский отряд 2009. Новик А.А.
2. AOE: Новик 2011: Пейчева (Литвинова)\_ВА\_мифология – Новик А.А. Пейчева (Литвинова)\_ВА\_мифология. Цифровая аудиозапись. 2011 // Архив отдела европейстики МАЭ. Приазовский отряд 2011. Новик.
3. AOE: Новик 2011: Шопова\_СМ\_мифология – Новик А.А. Шопова\_СМ\_мифология. Цифровая аудиозапись. 2011 // Архив отдела европейстики МАЭ. Приазовский отряд 2011. Новик.
4. AOE: Новик 2012: Сендели\_АН\_мифология – Новик А. А. Сендели\_АН\_мифология. Аудиозапись интервью. 2012.
5. AOE: Новик 2012: Торбина(Миц)\_АК\_мифология – Новик А. А. Торбина(Миц)\_АК\_мифология. Аудиозапись интервью. 2012.
6. AOE: Тоскерия 2013: Новик: Andoni\_Thanas\_mitologjia

**Bibliografia:**

1. Георгиева 2013 – *Георгиева II*. Българска народна митологија. Софија: Академично издателство «Проф. МАРИН ДРИНОВ», 2013. 402 с.
2. Мифалогія 2011 – Мифалогія беларусаў: Энцыклапедычны слоўнік / Складальнікі І. Клімковіч, В. Аўтушка; навуковыя рэдактары Т. Валодзіна, С. Санько. – Мінск: Беларусь, 2011. 607 с.
3. Stublla 2007 – *Stublla Sb. Mbijetesa (Aspekti muzeor)* / Shefki Stublla. – Prishtinë: XHAD, 2007. 600 f.
4. Tirta 2004 – *Tirta M. Mitologjia ndër shqiptarë* / Mark Tirta. – Tiranë: Shkenca, 2004. 452 f.
5. Tirta 2007 – *Tirta M. Panteoni e simbolika: doke e kode në etnokulturën shqiptare* / Mark Tirta. Tiranë: Nënë Tereza, 2007. 376 f.



**Martin SUROVČÁK**

## **AUTOBIOGRAFIA SHQIP E JAN URBAN JARNIKUT**

**Abstrakti:** Jan Urban Jarnik (1848-1923) njihet në botën shkencore si romanist i shkëlqyer me origjinë çeke dhe njëri nga themeluesit e albanologjisë në Perandorinë Austro-Hungareze. Krahas studimeve gjuhësore dhe folklorike vepra e Jarnikut përmban tregime autobiografike çekisht dhe rumanisht të publikuara nëpër revista të ndryshme, në të cilat përshkruante peripeci të jetës së vet. Në bazë të këtyre tregimeve disa vjet para se të vdiste shkroi një version shqip, i cili ruhet sot në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Në referim analizohet sidomos gjuha e dorëshkrimit të pabotuar – shkodranishtja e folur e fundit të shekullit XIX.

Në historinë e letërsisë shqipe hasen dhjetëra autorë shqiptarë, të cilët, së paku, një pjesë të veprës së vet e shkruan në ndonjë gjuhë të huaj (latinisht, greqisht, turqisht, italisht etj.), ndërsa e kundërta ndodhte shumë rrallë. Një ndër ato raste të pakta autorësh të huaj që kanë lënë ndonjë vepër shqip radhitet edhe filologu çek Jan Urban Jarnik (1848–1923), të cilin e përkujtuam gjatë seminarit të vitit të kaluar me rastin e 90-vjetorit të ndarjes nga jeta. Jarniku i vuri, në fundin e shekullit XIX, themelet e studimeve albanistike dhe rumunistike në trojet çeke. Ai e fitoi admirimin e qarqeve shkencore duke kërkuar gjithmonë kontakt të drejtpërdrejtë me folës nativë të gjuhëve ekzotike në viset e Austro-Hungarisë. Ndryshe nga gjuhëtarët e asaj kohe që bazoheshin vetëm në burimet dytësore, ai e ndiqte mendimin pozitivist që një gjuhëtar i mirëfilltë duhet ta mësojë gjuhën në mënyrë aktive. Rumanisht dinte gjoja aq mirë, sa që rumunëve në Transilvani nuk u besohej se Jarniku nuk ishte njëri prej tyre. Sa i përket shqipes, Jarniku nuk u pajtua kurrë me faktin se nuk iu dha leja që ta përsoste gjuhën duke qëndruar në mesin e shqiptarëve, meqë burokracia e institucioneve arsimore austro-hungareze ia prishi planin për të ndërmarrë një ekspeditë në Shkodër dhe në viset malore të Shqipërisë. Megjithatë, një dorëshkrim i tij pothuajse i harruar dëshmon se kundrejt mungesës së kontaktit të vazhdueshëm me gjuhën e folur, edhe në shqipën shprehej në nivel të lartë, me sintaksë të zhvilluar, me leksik të pasur dhe me frazeologjizma të qëlluara. Bëhet fjala për autobiografinë shqip prej 17 faqesh, origjinali i së cilës ruhet sot në Arkivin e Shtetit në Tiranë.

### Rrethanat e krijimit

Jarniku ishte tregimtar i talentuar që me kënaqësi të veçantë shkruante për përvojat e jetës. Madje, një numër i konsiderueshëm tregimesh dhe esesh autobiografike u publikua në gazeta, revista dhe përmbledhje letrare. Në to rrëfëhet për rininë e stigmatizuar nga varfëria, studimet në Vjenë, kontaktet e para me rumanishten në Paris dhe me shqipen në Vjenë si dhe rrugëtime nëpër Transilvani dhe Bukuresht. Ndër to mund të përmenden p.sh. *Si e mora udhën e studimeve!*, *Nga kujtimet e mia për Hradec Králové në vitet 1863–70*, *Fragmenti nga jeta e një studenti të varfër çek në Vjenë në vitet e shtatëdhjeta*<sup>1</sup>, *Rrëfimet serioze dhe zëbavitëse nga jeta ime*<sup>2</sup>, *Në gjurmë të gjubës shqipe*<sup>3</sup> dhe *Hristo Koçev*<sup>4</sup>. Më vonë këto artikuj i shërbyen Jarnikut si model për memoare rumanisht dhe shqip, madje mund të dalim në përfundim, se pasazhet e tëra janë përkthyer fjali për fjali.

Dorëshkrimi i autobiografisë shqip u zbulua në trashëgiminë e Jarnikut nga filologu shqiptar Dhimitër Pilika (1923–2003) në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, përderisa mbante postin e drejtorit të Seminarit Shqiptar në universitetin e Pragës, kurse për gjetjen e shkrimeve raportoi shkurt në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike më 1962.<sup>7</sup> Pasi mosmarrëveshjet ideologjike kishin shkaktuar prishjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik (1960), Shqipëria e përjashtoi Çekosllovakinë si satelitin sovjetik nga sfera e interesimit. Në këto rrethana dramatike shtetasit shqiptarë u detyruan ta braktisnin Çekosllovakinë. Po ashtu, vepramtarja e Seminarit Shqiptar në Pragë u ndërpre pas një dhjetëvjetori të zhvillimit të vrullshëm. Dhimitri Pilika, duke u larguar nga Çekosllovakia, mori me vete, me sa duket pa lejen e organeve përkatëse, origjinalin e autobiografisë si dhe dorëshkrimet e tjera të Jarnikut. Për fat të keq autobiografia është e vetmja vepër e tij

<sup>1</sup> JARNÍK, J. U. Jak jsem šel na studie. In: FRANTA, Ondřej –VYCPÁLEK, Josef (eds.). *Pelclův almanach z prací bývalých žáků gymnasia rychnovského a úvodního nástinu životopisného Františka Martina Pelcla od Fr. Tischbra*. Rychnov nad Kněžnou, 1893, f. 88–99.

<sup>2</sup> JARNÍK, J. U. Z mých hradeckých vzpomínek v létech 1863–70. In: *Osvěta lidu městu Hradci Králové k 28. říjnu 1922*. Hradec Králové: Osvěta lidu, 1923, f. 142–145.

<sup>3</sup> JARNÍK, J. U. Kus ze života chudého českého studenta ve Vídni v letech sedmdesátých In: KARÁSEK, J. (ed.) *Sborník Čechů dolnorakouských*. Vídeň: Národopisný odbor dolnorakouský, 1895, f. 121–124.

<sup>4</sup> JARNÍK, J. U. Vážné a žertovné z mého života. *Krásna našeho domova*, 1911 (në vazhdim).

<sup>5</sup> JARNÍK, J. U. Za jazykem albánským. Vzpomínka z let 1879–81. *Osvěta*, roč. 46/1916, n. 3, f. 185–193.

<sup>6</sup> JARNÍK, J. U. Christo Kočev. *Lidové noviny*, roč. 29, č. 530, 22. 10. 1921.

<sup>7</sup> PILIKA, Dh. Duke kërkuar “albanica” ndër arkiva dhe biblioteka të jashtme... In: *Konferenca e parë e studimeve albanologjike: Tiranë, 15–21 nëndor 1962*. Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965, f. 723.

që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë, kurse të tjerat gjenden në vend të panjohur dhe sot e kësaj dite presin të dalin në dritë.

Dorëshkrimi i autobiografisë përbëhet nga 17 faqe dhe përmban dy tregime të shkurtra *Si e mora udhën e mësimin* dhe *Si e kam filluar me msue gjubën shqyp*. Mund të supozohet se autori synonte publikimin e autobiografisë në njërin nga revistat shqiptare, por sipas të gjitha gjasave publikimi i tekstit kurrë nuk u realizua. Nga shënimi në faqen e fundit mësohet se dorëshkrimi u krijua më 1 maj 1919. Kjo do të thotë se Jarniku e shkroi autobiografinë në moshë të thyer, vetëm 4 vjet para se të ndërronte jetë. Në atë kohë ndodhej në Bukuresht me një delegacion për të lidhur marrëdhënie diplomatike në mes të shteteve të porsalindura të Çekoslovakisë dhe të Rumanisë. Ndoshta edhe vetë fakti që gjatë qëndrimit në kryeqytetin e Rumanisë vizitoi përfaqësues të diasporës shqiptare e shtyu të shkruante një autobiografi shqip.

### Gjuha e dorëshkrimit

Dorëshkrimi është shkruar me alfabetin modern shqiptar, çka tregon se Jarniku ose ishte shumë mirë informuar për përfundimet e Kongresit të Manastirit (1908), ose ishte ndikuar nga shoqëritë shkodrane Agimi dhe Bashkimi. Në tekstet e mëhershme Jarniku përdorte një alfabet të veçantë në bazë të drejtshkrimit çek të plotësuar me disa dyshkronjësia dhe shenja diakritike për të dalluar veçoritë fonetike të gegërishtes si shkalla e hapjes dhe hundorësia e zanoreve. Ai nuk u përshtat plotësisht me alfabetin e ri. Kjo vërehet qartë p.sh. te përdorimi i parregullt i shkronjës Ë.

Meqë Marko Shantoja, informatori i parë i Jarnikut me origjinë shkodrane, ka qenë i vetmi shqiptar, me të cilin mbante kontakt të vazhdueshëm, gjuha e Jarnikut mbart në përgjithësi tipare të gegërishtes veriperëndimore:

1. Grupi bashkëtingëllor *-nd-* ka dhënë nazalën retroflekse *ŋ*, e cila reflektohet në drejtshkrim si “nn”.  
*knnoshe, venni, nnali, kunnra, nner, me nnej, mennje, mrenn, prinnt*
2. Grupi i vjetër bashkëtingëllor *\*kl* ka dhënë *kej*.  
në **kjoft** se do me msue (f. 6)
3. Pjesorja e foljes *jam* del me trajtën *ken*.  
*nji copë bukë ka ken shekerleme e madhe* (f. 1)
4. Trajta e vetës së parë njëjës e dëftores së pakryer e foljeve që u mbaron tema me zanore del me mbaresën *-she*.  
*une at-ber ishe 9–10 vjetsh* (str. 1), *s’kishe zakonin me përgjue mas derës* (str. 3), *shkoshe sa dishe* (str. 10), *knnoshe librat në gjubë shqyp* (str. 15), *i dërgoshe letrat atynve edhe une* (str. 15), *dishovshe me nnej edhe trej muj në Vllahi* (str. 16)
5. Trajta e vetës së tretë njëjës e dëftores së pakryer e foljeve që u mbaron tema me zanore del me mbaresën *-te*

*shkote, rrite, punote, godite*

6. Pjesëza e përcjellores del me formën *tuj*.

*tuj ec, tuj pa, tuj thanë, tuj kujtue*

Mirëpo shkodranishtja e Jarnikut nganjëherë kontaminohet me elemente të toskërishtes, sidomos me trajtat e kushtores dhe së ardhmes.

*nuk do të kundzoshin, do të kishe me than, do të ishte mirë, do të ishte i godiçun, do msojsh*

Përveç kësaj në tekst ndeshen edhe mjaft gabime gramatikore, kryesisht në trajta të shkurtra të përemrave vetorë dhe nyjet e përparme:

*sakeristan e kishës Shëjtit Lorencit, një ortak e atyne* etj.

Në dorëshkrim vërehet tendenca për të zëvendësuar turqizmat apo greqizmat me ekuivalente shqipe, prandaj shtrohet hipoteza se Jarniku në Bukuresht këshillohej rreth leksikut me një shqiptar të arsimuar nën ndikimin e purizmit të rilindasve. Kështu bëhen korrigjimet: *adet* > *zakon*, *ala* > *ene*, *báj jasad* > *ndal*, *báj kubull* > *pajtoj*, *bezdi* > *mërzi*, *fiqir* > *mënd*, *fukara* > *vobektë*, *fukaralluk* > *vobeksi*, *gajle* > *kujdes*, *haber* > *lajm*, *heqim* > *mjekes*, *hyszmeqar* > *shërbëtor*, *izën* > *leje*, *kasaba* > *qytet*, *medet* > *për të keq*, *memqym* > *gjá qi mundet*, *ortak* > *shok*, *rigja* > *lutje*, *sabat* > *orë*, *sebeb* > *shkak*, *shebër* > *qytet*, *shybe* > *dyshim*, *tamane* > *më cak*, *vakt* > *kohë*, *zorshëm* > *vështirë*, *apofasi* > *vendos*. Në anën tjetër disa turqizma të theksuar si *çolha*, *xhade*, *shekerleme*, *kaçar* i la pa zëvendësuar, ndoshta sepse nuk gjeti ndonjë ekuivalent shqip ose thjesht për shkak se këshilltari i tij nuk ua dinte kuptimin e saktë.

Në leksikun e Jarnikut dalin në pah disa shprehje që kanë të bëjnë me emërtimet gjeografike dhe terminologjinë arsimore: *nemceli/tedeshk* (gjerman), *Beç* (Vjenë), *Vllahi* (Rumani), *gjuhät romançe* (gjuhët romanike), *gjuha taliançe* (italishtja), *regini* (mbretëri), *shkolla fylltore* (shkolla fillore), *shkolla real* (gjimnaz), *msuesi universitar* (profesor), *doçent* (docent), *shkollar vlla* (shok klase). Pra, duket se herë pas here duhej të improvizonte për të shprehur të gjitha mendimet.

## Përfundim

Si përfundim mund të them se autobiografia shënoi kulmin e veprimtarisë dyzetvjeçare të Jan Urban Jarnikut në fushën e albanologjisë, pasi që në të shfrytëzoi gjithë përvojën albanologjike. E la amanet brezave të ardhshëm që t'u kujtojë

### [str. 1] **Si e mora udhën e mësimit**

Une kam le në një *kasaba* qytet të vogël qi i thon Potştin (nemoc. Pottenstein) në 25 Mai 1848. Kjo *kasaba* ky qytet gjindet në Bohemia me anen ku del dilli nga veriut, 8 sahat lark prej *shehrit* qytetit Hradec Králové (nemoc. Königgrätz). Venni asht i bukur fort, rethe rotull veç pylla, një lum, shqiponja e egër, me uj të pastër krejt, etset

nnermjet vennit edhe mrenn vetem kopshta me pema edhe lule.

I ati im ishte një çolha i ~~fukara~~<sup>vobekët</sup>, gruja e vet ishte e ~~fukara~~<sup>vobekët</sup> edhe ajo, puna e natyrshme që jeta e atyne ishte e zorshme, maksus në një koh kur ubâ nga neve një zi e madhe. Une at-her ishte 9–10 vjetsh, por e mbaita menn mir fort deri sot. Një cop të bukës bardh ka ken at-her për mue një shekerleme e madhe. Ashtu një dit tuj pësue prej një dhimtum<sup>ni</sup> te dhamve, mema pru prej një fqis një cop buk të bardh si faqeja e Isusi Krishtit. Mue aq malli më erdh me e hangër ket bukën sa e kapshova me gjith dhimtum<sup>ni</sup>in e dhamvet edhe uçudita tui pa që paprit m' uzhdok dhimtum<sup>ni</sup> i dhamvet.

[str. 2] Pos mue prinnvet i ka le mâ para një bi por ajo motra eme vdiq kur ishte ~~ata~~<sup>ene</sup> fort e vocër. Mosneq ka le edhe një djal, vllau jem me dy vjet mâ i madhi se une që rron ~~ata~~<sup>ene</sup> në Beç edhe i masmrani kam le edhe une.

Kur ubâna 12 vjeç, nuk shkoishe mâ në shkoll, pse at-her fmijat veç deri 12 vjeç shkoishin në shkollën fylltore, vetem dy o tri her në jav shkoishe te dhaskali me mësue gjuhen e nemcelish ditënia e ciles dukete e nevojshme edhe e dobishme mâ daha për djat<sup>mt</sup>.

Në shpi me prinnt e mi at-her rrite edhe një vlla i atit, që i thoshin Gjon, çolha ishte edhe ai, të dy ishin bashka veç ashtu që i ati godite pelhura prej pamukut, unqi prej linit. Ky unqi jem mujo ishte sakristan e kishës Shëjtit Lorencit, nuk mur gruen, do me than met beqar edhe rrite me neve. Une si djal i vogël ishte në ~~hyzmet~~<sup>shërbim</sup> te prifti si djal ministrant.

Një dit, ishte në 10 Juli 1861 tuj vdek një venali në Potshtin, shkova me alajin tjetër në vennin ku udesht me e vorrue leshin, masi e vune në dhe, shkoishe në shpi tuj ec mas priftit edhe dhaskalit. Shka kan fol shoq me shoq nuk e di, pse [str. 3] as një her s kish zakonin me përgjue mas derës, por mejher paprit e digjova priftin tuj than emnin tem. Asht puna që kupëtohet ~~kollajshem~~<sup>leht</sup> që kam tandosun vesht edhe shka ndiva? Nja fjalat që i thot prifti dhaskalit: „Mue më vjen keq fort që prinnt e vogëlit Jarnik jan kaq te ~~fukara~~<sup>vorfën</sup>; duket që ky djali do të ishte i godiçun për të msuemit: asht i urt edhe i mbajt mir nër met të gjitha, por s'asht ~~memqym~~<sup>gja</sup> që mundet prej ~~fukarallukut të madh~~<sup>vobeksis së madhe</sup> të prinnve.” Ashtu u përgjegj edhe dhaskali. Shka po do të kish me than une, e ~~çilin~~<sup>të cilin më takoi</sup> mâ afër kjo puna?

Mue at-her paprit më ra në ~~fiqir~~<sup>nër mënde</sup> që kjo puna asht e vërtet. ~~Maksus~~<sup>mëndu?</sup> tuj kujtue që tre shoq të mi do të shkoin në një ~~shehër~~<sup>qytet</sup> që i thon Vysoké Mýto (nemoc. Hohenmauth) me njatin që të msoin atje, i katërti dote me shkue ne një shehër tjetër edhe i pesti në Kryeqytetin reginis Bohemis Prag. At-her sikur një shkorni të kishte me ra në një fuçi plot me barut pushkës, më zu kujtimi që do të ishte e mir fort me msue edhe une, por ~~medeti~~<sup>mjerimi</sup> im ka ken i madh tuj pa që kjo pun s'bahet prej ~~fukarallukut ton~~<sup>vobeksisë son</sup> kaq të madh<sup>e</sup>. Shka bâna pra at-her? Mejher, pa pas ~~gajle~~

përkujdes shka flasin të dy shoq me shoq, i shkova përpara të dyve, [str. 4] eca me vrap te shpia e priftit, vuna atje peklat e tij edhe uktheva në shpi. Por nuk hîna në shpi, pse kishe frik mos me qa, por hîna në kopësht edhe atje rasha mbë një sofë tuj vajtue e tuj derdh lota.

Kur erdhi mjesdita ungi shiqoi në gozhdën afër derës për me pa ne vjerr çelzi kishes atje, pse ishte zakoni që o vllau jem o une shkoshim në venn të ungit për me hek kumonen e mjezditës. Tuj pa që nuk uzhdruk, shkote vet edhe masi ukëtheu, ama goditi tavolinen si ishte zakoni. Të gjithë të shpis ishin aty pari, veç une lipseshe. Më thirte mëma, une i digjova zânin, por nuk përgjegjia as shkova, tuj më zân frika mos me mujt me më mbajt nga të qamit. I umbush at-her mennja mëmës që mue veç në ~~bahe~~ kopësht do të më gjein, shkote pra matan tuj thirr pa pra emnin tem. Une tuj pa që s'asht çajre me e prû, kam fshi syt, por mëma mezi me pa, me t shpejt e diti që une kam derdh lot edhe më pveti shak ishte se bëpi e qamjes. Une spari rasha më boh tuj than që s'asht e vërtet. Por a asht memqym që syni mëmës mos me marr vesh kur i ndodhi nonji keq fmijës të vet të dashunë? Qindroj me i diktue [str. 5] une ~~sebe~~ shkakun, at-her une tuj pa që s kam çajre i thaç: “Ani, mëmë, në qindron me e dit, une po të them se bëpin, me gjith që e di mir fort, që asht pa dobi. Une do të doishe me msue kartën, por e di mir që për fukarallukun ton kjo puna s munnet m ubâ edhe prandaj qava. – “Oh, budalla që je, veç për ato ka qa? Kan msue tjera djelm që ishin edhe mâ të ~~fukura~~ vobekt se je ti, në kjoft pra se do me msue, do msojsh, vetem s duhet me i than punen as atit as ungit, pse ata s kanë qajret edhe nuk do të kudzoshin.” Lan më veç mue me e bâ shka duhet! – Ashtu ~~ufarigoris~~ ungushellova edhe mëma eme që ishte një grue erlap, mitare, tuj pas shkue në bot, ka ndejt njadisa ~~vakt~~ kohë edhe në Beç nga motra e vet, i ndreqi të gjith që u desht.

At-her në Potshtin rrite një vajz e re që dote me marr grue një kaçar i ve që i thoshin emnin Trpkosh. Ky burri rrite taman në shehrin Vysoké Mýto, kuh, si e thasha kishin me shkue tri ortaq e mi edhe të dy grat unjoshuen bashk. Bâne ket sulen që une tuj pague një florin për mue kam me pas të ndëjtumin në shpi e vet, me njadisa të holla bleva gjith ditën tamelt [str. 6] e cilen e kishe dy her për dit, nnadje edhe të mramen, të tjerat që udasht për hangër më sjellshin prej shpis edhe ashtu kishte uzdajen me jetue mir edhe lir në ket shehër një vjet pse veç ket vakt mujta me rri atje, shkolla mâ e nalt s kishte atje. Por ma përpara u desht me mrrit atje edhe kjo puna as une as e ama s e dishim në ka me na dal mir, pse as i ati as ungi s dishën ala aspak për qilimin ton.

Erdhi dita kur ata tri shoq e mi kishin me unis në shehër. At-her une në mram përpara fola me ata tuj i bâ rigja me më marr edhe mue në karocën që e kan marr me qira me i sjell atje. Ata e gjetne mir, si m uduk punen tuj me than vennin edhe sahatin ku edhe kur kena me u nis në rrug.



Puna e natyrshme qi une ket naten s mujta me flet mir, udzgjua pra sa mâ hershëm edhe shkova te shpija ku më kan than qi umbledhim te tan. Kur mrita atje, pasha e motrën e ortakut qi rrite në ket shpi edhe e pvetë me i uçoj vllau. Uçudita pra fort tuj digjue qi nuk veç uçoj, por ka edhe nis me të dy ~~ortaq~~<sup>shokt</sup> të vet.

[str. 7] E pasha mejher si asht puna: ~~ortaq~~<sup>shokët</sup> e mi s kan marr vesh me gzim të madh qi një ortak e atyne, një djal kaq i ~~fukara~~<sup>vobektë</sup> si ishe une don edhe ai me shkue në të msuemit, ~~apofasisën~~<sup>e venduen</sup> pra me u nis me një sahat mâ hershëm edhe me më lan mue atje. Por më kot ishte uzdaja e tyne qi une ashtu do të më laj njatin, pse karakteri im ishte edhe asht deri sot ashtu: ne kjoft qi gjindja më vë në udh disa penga, at-her une sa mâshum qindroj edhe nuk më la m'utrëmp.

Ashtu edhe ather. Shkova deri në kopshtin ton, atje uafrova te një lajthi, preva një gem edhe prej kti gemit bâna një shkop si duhet. Andaj shkova në kilarin ku ~~mëma~~<sup>ama</sup> qi ka nis ditën përpara në një shehër qi i thon Žamberk (nemoc. Senftenberg) më ka godit disa kulaçe të lidh në fucolet për udh. Duhet me than qi mema eme të gjith pemat qi urritne në vennin ton edhe reth atij e sjellte në ket shehër për me e shit atje. Ket pramatën e mur miraz mas atit t vet qi tuj ~~rrë~~<sup>ndejt</sup> në jet, e bânte ket pramatën.

[str. 8] Une pra tuj mbajt në të djathtën shkopin tem, në të mâjtën bokshën me kulaçe hîna në oden ku ~~fat~~<sup>im fati</sup> im punojte me ungjin. Baba edhe ungji tuj më pa ashtu të goditun me unis në rrug, pushojshin me punue tuj dasht me pa shka do me than kjo pun.

At-her une tuj ~~rrë~~<sup>ndejt</sup> në mjes t'odës, me një zâ qi dridhte prej turbullimit i kam than babës edhe ungjit: “Ynzot të rrojni ju, pse une shkoj për me msue kartën.” – Ungji met në venn tuj ubâ si guri, por <sup>im fati</sup> fati zhdrypi prej aty edhe tuj rri <sup>ndejt</sup> me kam përpara mue, bërtiti me zâ të madh: “Ah, kjo puna asht e mëmës, si munnesht me kujtue ashtu senda, kjo puna s bâhet pse na jemi e fukara.”

Une tuj digjue kto fjala s e kam lan me fol mâ shum pse kishe frik mos me më ~~bâ-jasak~~<sup>ndali</sup> me shkue, pse ather kishte me ken ~~idiza~~<sup>nevojë</sup> me undigjue, thaç pra: “Zoty n ka me bâ qi puna të dalin e mira<sup>ë</sup>”, edhe tuj kapërdzue pragun vuna [?] me e bâ ket punen me kamen e djathtë. Thuhet qi ne qiloft qi mir niset në rrug edhe dishron qi rruga i dalin mir duhet me bâ kshtu

[str. 9] Rrugën në Vysoké Mýto kishte me ~~ken-memqym~~<sup>m'u ngut</sup> me e bâ makar me një ~~sahat~~<sup>orë</sup> mâ shpejt, por kishte me ken ~~idiza~~<sup>nevojë</sup> me i njof mir viget për mos m ulaithis. Une nuk i njof, m udesht pra me e marr rrugen dzhade <sup>e madhe</sup> edhe kshtu unisa për me msue edhe mrita me faqen e bardh atje te kaçari i em qi e mur grue vajzen prej vennit tem.

Vjetin e afërshme rrita në një shehër qi i thoshin Rychnov, por edhe ktu meta veç një vjet. Tuj ken i ~~fukara~~<sup>vobektë</sup>, kam bâ ~~rigja~~<sup>lutje</sup> me uprit në Králové Hradec në një seminar e djelmve edhe rigjaja eme tuj upëlqye në vennin qi i prek kjo pun, meta

1863–69 atje. Kur në 1870 marova msuemim tem e gimnasiumit, shkova në Beç për msue atje në universitet e atij shehrit.

Kshtu si shihet, puna shkoj mbar edhe une me të sakt due ket hiren asaj punës qi ne 1861 kur mora udhen e botës, kem pas ~~gajle~~ kujdes me e kapërdzue pragun e shpis me kamen e djatht.

[str. 10] **Si e kam fillue me msue gjuhen shqyp**

Tuj unei në 1874–75 disa muj në kryeqytetin e Francës, Paris, unjofta me një shkollor vlla, i cilit emni ishte Konstantin Gjorgjan. E pasha, qi është një djal fort i pëlqyshëm e i ditshëm edhe at-her më ra në menn, sa dobishëm do të ishte për mue, me msue ket gjuhen qi at-her e njëfshin aq pak ata burra qi ~~asi-vakti~~ asaj kohe ishin msuesa e gjuhave romanche në universiteta. I luta pra mikut em të m’apin disa msime të gjuhës mëmëdhetare të vet edhe të gzuemit em ishte i madh, kur pasha qi zotnija Gjorgjan është gadi me bâ si dishrova une.

Masi uktheva në Beç, ku uzgjedha msues i gjuhës franceli edhe tedeshk më një shkollor qi i thon real, shpesh knnoshe, qi kto të dy gjuha, e vlla<sup>h</sup> edhe e shqyp<sup>e</sup>, në disa puna jan fort të ~~barabarshme~~ gjithëngjishme. Mue pra më mur mali me e dit edhe ket gjuhen edhe mâ pak e njoftun se e vlla<sup>hut</sup>. Pa ~~shybe~~ dyshim, një gjuh e huj mësohet mâ mir e mâ ~~kolajshëm~~ lehtë, në paçim nnimin njerit, qi e di mir ket gjuhen, dishrova [str. 11] pra me gjet në Beç një Shqyphtar, një burr, i cili do të kishte të ditunin edhe dashtnin me u bâ msuesi im.

Në ket ~~vakt~~ kohë une dy hera në jav mrame shkoshë te msuesi im universitar, zotnija Mussafia. ~~Heqimi~~ Mjekesi i vet i ~~bani-jasak~~ nnali mos me knnue e shkruie mramet, une pra e bâna vet ket punen. Një dit më ra nëmenn me i kaldzue ç’far dishrimi më ka ra në menn. Ai përgjegji, qi është pak uzdajë me gjet, shka dishrova.

Disa dit mâ von ç’kur hîna në od uçudita tuj unie haberin, qi më ka gjet ate qi dishrova une. Kalzoi shka i qilloy dy dit përpara.

– “Dy dit përpara,” ashtu filloi kaldzimin e vet, “më ka thirr në gost një miku im. S kam ken atje vetem une, por umblodh një shoqni e madh edhe nnermjet të tjerve unnollit edhe një oficer, qi uktheu ~~tamane~~ më cak prej luftës të Serbevet kunnra Turqve. Ky oficeri (emni i vet ishte Winter) kaldzonte ~~bezdin~~ mërzin, qi i vjen kah ~~hyzmeçari~~ shërbëtori vet, një Shqyphtar, tuj i thon Marko Shantoja. Na [str. 12] kalldzoit të qilluemin.

Në shpin ku rrinte ai, rrinte edhe një gru e ve me dy fmi të vogla. Sa her i udeshi me ec prej shpis, i lente fmit e saj në od e ciles doren e mylli. Sot ashtu, nesër ashtu, puna shkote e mar, por një dit shka i bjen nner menn mâ të moçmit të fmise? Merr një shkrep, i ep zjarm edhe i pëlqen fort të dy djelmve me shique flaken e vogël e zjarmit.

Por mejher flaka u bâ mâ e madhe edhe filloi me i dzân teshat e shpis, oda umush me tym edhe fmit e mjer ishin afër me umyt. Gjinnja mur vesht si asht puna, por as një s ishte zemrak me hî mrenn e me i pështue fmit prej t’dekunit. ~~Taman~~ Nj’at’ ças

kur reziku u bâ mâ i madhi, uollli atje zotni Shantoja; at-čas pa umennue coptoi dzhamin e odes, hîni mrenn edhe i pru përjashta fmit. Pak mâ von erdhi edhe ama e fmivet, qi prej thellimit të zemres i fali nners pshtuesit fmivet e saj. Shpejt ~~haber~~<sup>lajmi</sup> u përhap edhe tash vjen gjinnja me e pa ket burrin kaq e trim. Ajo <sup>Kjo</sup> është ~~bezdija~~<sup>mërzitja</sup> qi më vjen kah ~~hyzmeqari~~<sup>shërbtori</sup> im”.

[str. 13] Msuesi im, zotnija Mussafia, masi maroj oficeri kaldzimin e vet, e pveti në ~~kjoft memçym~~ me i dhan ~~hyzmeqarin~~<sup>shërbtorin</sup> vet zotnis Jarnik msime shqyp, pse ai dishron fort me e dzan ket gjuhen. Oficeri upërgjegj qi kjo puna është e ~~kollajshme~~<sup>lehtë</sup>, pse ~~hyzmeqari~~<sup>shërbtori</sup> vet tjetër pun s ka, veç kte... nnade i ban gadi rrobat, mosnej i gaton një kafe turçe qi e di mir fort, ne mram i nnreq oden edhe mâ shum pun s’ka me bâ, pse ai ka ~~adete~~<sup>zakon</sup> e vjen në shpi veç për me bujt.

Ugzova fort, i fala nners msuesit tem edhe kshtu filluem me msue. Me të shpejt mora vesht qi msuesi im është një burr prej të cilit dobi e madh mun të më vin: e pasha qi e di mir fort gjuhen e tij; dite edhe gjuhen ~~taliançe~~<sup>italiane</sup>, kshtu mujta me fol me te, pse une ket gjuhen e kam dzân motit kur ishe shkollar gimnasiumit në Králové Hradec.

Shpejt kam sprovue me shkruë shqyp disa letra. Puna për mue ka ken e ~~zorshme~~<sup>vështirë</sup>, pse nuk kam pas as një fjalur shqyp. Mujta me bâ nnryshe, por shkoshe [str. 14] sa dishe; sa hera nuk dishe si i thon në gjuh shqyp një punës, vëshe atje fjalen taliançe në venn të cilit msuesi im vûni fjalen shqyp. Deri sot i kam majt kto letrat me të nnreqimit të msuesit tem.

E pveta zotnin Shantoja, në mun të më kalldzojn disa pralle prej popullit, edhe më përgjegji, qi munnet me më bâ ket punen. At-her o shkoshe une o shkote zotnija vet edhe në të maruemit vjetit shkollar 1880 shtypshkrova disa prej atyne prallave në haberin e shkollës real ku ishe msues. Dy vjet mâ von, kur ubâna msues në universitet çeh Prages, i kam shtypshkrue edhe të tjerat qi m-i ka kaldzue msuesi im bashk me një fjalur shqyp-çeh-tedeshk. Mâ von mora prej zotnis të vet edhe një prall “Hajni mâ i madhi”, qi e shtypshkrova edhe ate. Fort ukormenova qi kam pas një msues kaq e meçem e të ditshem. Të gjith ato prallat i kam nkthye në gjuh tedeshk edhe shtypshkrue në një flet tedeshk, ku kam vû edhe disa vjershe, qi i dergoj shkruesit të ksaj flete Zotnije Mitko.

[str. 15] Mâ von s kam pas mâ siran me u përpjek me një Shqyphtar e vertet, s mujta pra me bâ tjetër pun por knnoshe librat në gjuh shqyp, maksuz ata kuh ishin shtypshkrue disa pralla e vjersha populli, fjala e moçma si i shofim te zotnija Hahn, Dozon, Gustav Meyer, Pedersen. Kam knnue edhe disa gramatike e gjuhës shqyp, qi i kan shtypshkrue zotnija Pashko Vasa, Gustav Meyer, Julius Pisko[?] edhe Gustav Weigand. I kam msue të gjitha me kujdes të madh edhe kam shtypshkrue mennen tem mi ata librat në disa fleta në Gjermani.

Mora edhe disa letra shqyp prej disave burra shqyp: zotnivet Shantoja Marko edhe vllaut të vet Pal, Junk, Mitko edhe disave tjera, qi i dergoshe letrat atynve edhe une.

Gabme ishin shum në të mijat, pse une s kam mujt – edhe më vjen keq fort – me nnej disa muj nnërmjet Shqyptarve si e dishrova. Puna më vjen sa mâ keq per ate qi perpara 35 vjeç kishe uzdajen qi ka me ken ~~mennym~~<sup>me menn</sup> me unis në Shqyptari~~a~~.

Në 1887 gjinnja fliste përmi universitetin çek në Praga, qi ishte afër me utemelue pran [str. 16] tedeshkës. Une qi 1878 ubâna doçent gjuhve romançe në universitetin e Beçës, kishe uzdajën me u zgjez msues i gjuhve romançe ne këte shkoll të nalt, por mâ përpara desha me nnejt disa muj nnermjet Shqyptarve për me msue si duhet ket gjuhen qi më pëlqen aq fort.

Përpara udesht me e marr prej ministrit ~~izen~~<sup>lejen</sup> mos me msue nji vjet të tân në shkollën real ku at-her ishe msues. Dy vjet përpara m udha ~~izna~~<sup>leja</sup>, me dojshe me ugatue për msimet teme në universitet edhe dishovshe me nnej edhe tre muj në Vllahi. Para se të shkruj të lypumin izne, shkova në ministria për me pvet, në mun të kem uzdajen, me e marr ~~izen~~<sup>lejen</sup> edhé at-her.

Zotnija me e të cilin fola, tuj unie si âsht puna, më that qi njati im i pëlqen fort, qi Konsuli Hahn ka ken miku i tij edhe qi pa shybe <sup>dyschim</sup> ~~izen~~<sup>lejen</sup> do ta marr. Per nji her msuesi universitar prej Gratzes, zotnija Gustav Meyer desht edhe ai me unis në vjesht ati vjetit nnermjet Shqyptarve. Tuj u nie në ministria si âsht puna me mue, erdh te une tuj ufal me unis në rrug të dy bashk.

[str. 17] Une me gzim të madh ~~bâna kabull~~<sup>e poltisa</sup> ket qillimin por vai ~~medet~~<sup>për të keq</sup> s'mujta me e marue, pse kur uktheva vjeshten në Beç, më erdh haberi, qi ~~izna~~<sup>leja</sup> s'm udha. E pveta ket zotnin, pse s'mujta me e marr ~~izen~~<sup>lejen</sup>, por aj përgjegji qi kshilli shkollar i dheut s'ka ~~bâ kabull~~<sup>e paltoi</sup> të lypunin tem edhe ministria s'ka mujt me kunnertshtue.

Kshtu munnem me thân me vjershtarin tedeshk Scheffel: “Puna do të ishte fort e bukur, por nuk udesht me ubâ”.

Bukuresht 1. Mai 1919

**Denis ERMOLIN**

## **DUKE E LEXUAR QYTETIN SI LIBËR: GJUHA E HARTAVE DHE IDENTITETI**

Reprezentimi visual i pikave të kujtesës (*lieux de mémoire* – sipas Pierre Nora, në kushtet e panoramës kulturore të qytetit janë përmendoret, monumentët, memorialet, varrezat, toponimia etj.) në hartat dhe planet e qyteteve deri në ditët tona nuk është studiuar mirë dhe në fakt si pasojë të kësaj situatë mungojnë metodologjia dhe teoria e kërkimeve shkencore në këtë fushë.

Në këtë studim do të bazohemi në parimet teorike të së ashtuquajturës kartografi kritike. Kjo disiplinë shkencore ka si aksiomë mendimin që harta nuk reprezenton vetëm një fragment të realitetit që i përket asaj, por edhe vetë është vegla e cila vepron dhe e strukturon këtë realitet (Crampton, Krygier 2006:15). Kështu parimet tona në studimin dhe analizën e hartave të qyteteve janë në mbikëqyrjen e çdo harte si konstrukt shoqëror dhe joobjektiv (Harley 1989: 9; Crampton 2001: 242).

Shumica e hartave, e skicave dhe e planeve të qyteteve i përket kategorisë së hartave tematike të përdorimit të përbashkët d.m.th. janë bërë për orientimin e çdo njeriu në përhapjen e vendbanimit konkret (si rregull konsumatorët e këtyre hartave janë turistët dhe të porsaardhurit në qytet). Duke e shikuar planin njeriu *a priori* ka të bëjë me modelin e realitetit dhe i krijon parafytyrimet për këtë realitet: në këtë rast kupton vetëm objektet e qytetit që janë vizatuar në hartë dhe i merr vesh si “të ekzistuar në realitet”.

Ndryshe është me hartat speciale, të cilat janë vizatuar me qëllim të pasqyrojnë përbërjen e qytetit (këtu bëhet fjalë në rradhë të parë për planet urbanistike dhe hartat ushtarake) dhe të tregojnë ndonjë dukuri ose karakteristikë konkrete. Këto harta përdoren nga specialistët dhe shpesh ato ruhen në arkiva të mbyllura.

Në etapën e parë të studimit tim është zgjedhur Prishtina për shkak se është kryeqytet i Kosovës dhe qytet, i cili ka sasi të madhe të planeve të periudhave të ndryshme. Si objekt i studimit është reprezentimi visual i *pikave të kujtesës* në hartat e qytetit në kontekstin e shtjellimeve të brandingut kombëtar në Kosovë pas lufte.

Te momenti janë analizuar materialet kartografike:

- 12 skica turistike të viteve të ndryshme (1996-2013),

- Harta e Zyrës kartografike ushtarake të SHBA-së (1993),
- Planet urbanistike të qytetit (1958-1962),
- Plani i Prishtinës në monografinë e A. Urosheviqit (1951).

Në studimin e reprezentimit të *pikave të kujtesës* në harta shtjellojmë me vëmendje çështje në vijim:

- Me çfarë mjete (grafike, verbale etj.) reprezentohen pikat e kujtesës në hartat që janë përgatitur nga firmat e ndryshme dhe në vitet e ndryshme;
- Çfarë dallime fiksohen në reprezentimin e pikave të kujtesës në Prishtinë (në aspektin sinkronik dhe atë diakronik) në harta dhe si mund të shpjegohen këto dallime;
- Me çfarë saktësie imazhet e pikave të kujtesës në hartat e planet e Prishtinës pasqyrojnë specifikën e objektëve reale;
- Në çfarë mënyrë vendet e kujtesës në Prishtinë marrin pjesë në formimin e imazhit të Kosovës (brandingu kombëtar).

Në këtë kumtesë si shembull të pikave të kujtesës do t'i vështrojmë varrezat.

Karakteristika fetare e varrezave duket nga markerët grafikë dhe verbalë (emrat e varrezave). Markerët grafikë në teritorin e varrezave kanë të bëjnë me simbolet që i përkasin fejtës:

- Islami: hilali (gjysmëhëna, nganjëherë me yll), në disa raste është përdorur simboli **Y**,
- Krishterizmi: kryq me katër funde **+** (si në varrezat katolike edhe në ato ortodokse),
- Judaizmi: ylli me gjashtë kënde ose simboli **T** - tav, shkronja e fundit e alfabetit hebraik.

Varrezat që e kanë emrin moderne Varrezat e qytetit në lagjen Fushë Kosovë përbëhet nga tri porcela sipas përkatësisë fetare: trualli ortodoks (serb), trualli katolik (shqiptar) dhe trualli hebraik. Megjiathtë këto varreza deri në vitin 1998 zyrtarisht quheshin Varrezat ortodokse (Prilinčević 1985: 29; DMA 1993; Приштина 1996).

Në Prishtinë ekzistojnë edhe varrezat e vjetra hebraike (ose *Vorret e Ja(h)udive*) në lagjen *Taukëbahçe*. Varret me e vjetra janë prej mes të shekullit XIX (Prilinčević 1985:29). Vorret e Jahudive erdhen në hartat e Prishtinës veç në vitin 2008, dhe në vitin 2011 grupi i përbashkët i studentëve nga Kosova dhe ShBA-ja kanë riparuar dhe rregulluar ambientin, i cili u bë memorial. Sot e kësaj dite Vorret e Jahudive ka marrë pjesë në listen e pikave turistike të Prishtinës. (Kosovo 2.0 2012: 126; Harta kulturore 2008; OrGIS 2012).

As katolikët as hebrenjtë nuk ishin komunitet përfaqësues në Kosovë gjatë shekujve të fundit, por ekzistenca e tyre ose në menyrën reale ose në atë të imagjinuar

është një gjë shumë e rëndësishme për Kosovë, kur po bëhet fjalë për natyrën multietnike dhe multikonfesionale të Kosovës.

Kështu, përfundimisht:

Mjetet grafike dhe verbale e varrazave si pikave te kujtesës në harta varen nga situata politike e sotme dhe pasqyrojnë proceset aktuale në fushën e marrëdhënieve shoqërore dhe kulturore.

Pra, teoria e kartografisë kritike mund të aplikohet për analizën e hartave urbane dhe do të bëhet kontributi shkencor në kjo lëndë.

Në Kosovën e pasluftës hartat turistike mund të konsiderohen si pjesa e rëndësishme e brandingut kombëtar.

### **Burimet dhe referencat:**

**Arkivi Komunal i Prishtinës Fondi arkivor: Kuvendi komunal i Prishtinës. Seksioni 10 – Banesat dhe veprimtarit komunale. Viti – 1948 – 1962. Numri – 1 (1-21) 2 (1-14). Kutia – 587**

1. Ситуациони план града Приштине. Размера 1: 5000. Стање: 1959. Секретаријат за комуналне послове, Н.О.Ое, Приштина. 28.05.1958. Jug. H. Weigel
2. Priština. Glavni projekat generalnog urbanističkog plana. 1:5000. Урбанистички завод НРС. Група III. Инвестор ГНО Приштина. [s.a.].
3. Скица обележавања граница ужег грађевинског реона, састављена у смислу закона о национализацији најамних зграда и грађевинског земљишта. 1: 5000. Приштина, 1959.
4. Ситуациони план града Приштине. Размера 1: 5000. Отсек за комуналне послове, Н.О.Ое. Приштина. Април, 1960. Jug. Helmut Weigel.
5. Ситуациони план града Приштине. Размера 1: 5000. Отсек за комуналне послове, Н.О.Ое. Приштина. Април, 1961. Jug. Helmut Weigel.
6. Ситуациони план града Приштине. Размера 1: 5000. Отсек за комуналне послове, Н.О.Ое. Приштина. Март, 1962. Jug. Helmut Weigel.

### Hartat e botuara:

1. Aksion 2000 – Prishtina. Hartë Qyteti. 1 : 10000. Tiranë: Aksion, 2000. [Ergjin Samimi]
2. ARRA 2013 – Prishtina. Tourist Map. Prishtina: Studio ARRA Design, 2013.
3. DMA 1993 – Prishtina. Series M903. Edition 2-DMA. 1 : 20000. Defense Mapping Agency, 1993.
4. Harta kulturore 2008 – Harta kulturore e Prishtinës. Në kërkim të një topografie shpirtërore. Prishtinë: Biblioteka Europiane e Kosovës, 2008.
5. Harta e rrugëve [s.a.] – Harta e rrugëve të Prishtinës. [s.a.].
6. OrGIS 2009a – Prishtina. Hartë rrugore dhe turistike. 1: 8000. Prishtinë: OrGIS, 2009.
7. OrGIS 2009b – Prishtina. Hartë rrugore dhe turistike. 1: 8000. Prishtinë: OrGIS, 2009.
8. OrGIS 2012 – Prishtina. Hartë rrugore dhe turistike. 1: 10000. Prishtinë: OrGIS, 2012.
9. PVL 2002 – Harta e Prishtinës. Prishtinë: PVL, 2002.
10. Trimaks 2011 – Prishtinë. Plani i qytetit. 1 : 9000. Shkup: Trimaks, 2011.
11. Trimaks [s.a.] – Prishtinë. Plani i qytetit. 1 : 12000. Shkup: Trimaks, [s.a.].
12. Приштина 1996 – Приштина. План града. 1: 5000. Београд: Геокарта, 1996.
13. Урошевић, план 1951 – Ситуациони план Приштине // Урошевић А. Приштина – антропогеографска испитвања // Зборник радова Етнографског института Српске академије наука. Књ. 2. Београд, 1951.

### Literatura:

1. Anderson [1983] – *Anderson B.* Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism. London, [1983].
2. Andrews 1988 – *Andrews S.K.* Applications of a Cartographic Communication Model to a Tactual Map Design // *The American Cartographer*. 1988. № 15(2). P. 183–195.
3. Crampton 2001 – *Crampton J.W.* Maps as Social Constructions: Power, Communication and Visualization // *Progress in Human Geography*, 2001. Vol. 25. № 2. P. 235–252.



4. Crampton, Krygier 2006 – *Crampton J.W., Krygier J.* An Introduction to the Critical Cartography // ACME: An International E-Journal for Critical Geographies. 2006. № 4 (1). P. 11–33.
5. Čolović 2011 – *Čolović I.* The Balkans: The Terror of Culture. Essays in Political Anthropology. Baden-Baden, 2011.
6. Elsie 2004 – *Elsie R.* Historical dictionary of Kosova. Lanham, 2004.
7. Harley 1989 – *Harley J.B.* Deconstructing the map // *Cartographica*, 1989, № 26. P. 1–20.
8. Homazhe 2012 – Homazhe te varri i Presidentit historik Ibrahim Rugova // Bota Sot. 17.02.2012 <http://www.botasot.info/kosova/155783/alS52L8/> (проверено 14.01.2013)
9. Kosova 2011 – Kosova: vështrim monografik / kryered. R. Ismajli, M. Kraja. Prishtinë, 2011.
10. Kosovo 2.0 2012 – Kosovo 2.0. Religjioni. Nr. 3. Pranverë/ verë 2012.
11. Kraja 2011 – *Kraja M.* Identiteti kosovar. Prishtinë, 2011.
12. Prlinčević 1985 – *Prlinčević Č.* Jevreji na Kosovu do 1941 godine. Magistarski rad. Priština, 1985.
13. Rizaž 1987 – *Rizaž S.* Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVIII. Tiranë, 1987.
14. Robinson 1952 – *Robinson A.H.* The Look of Maps. Madison: University of Wisconsin Press, 1952.
15. Robinson, Petchenik 1977 – *Robinson A.H., Petchenik B.* The Map as Communication System // *Cartographica*. 1977. № 19. P. 92–110.
16. Schwandner-Sievers, Di Lellio 2007 – *Schwandner-Sievers S., Di Lellio A.* Udhëtimi i shenjtë drejt kombit: ndërtimi i një faltoreje në Kosovën e pasluftës // *Përpkjka*. 2007. Nr. 24. F. 32–54.
17. Stroehle 2006 – *Stroehle I.* Pristina's Martyrs' Cemetery. Conflicting Commemorations // *Südosteuropa*. №. 54. 2006. P. 404–425.
18. Урошевић 1951 – *Урошевић А.* Приштина – антропогеографска испитвања // Зборник радова Етнографског института Српске академије наука. Књ. 2. Београд, 1951.



**Iliaz REXHA**

**SHTRIRJA DHE SLLAVIZIMI I VLLAZËRIVE ALBANE  
MESJETARE, BURMAZI DHE MATARUGA NË AREALIN E  
TREKËNDËSHIT TË KUFIJVE TË BOSNJËS E HERCEGOVINËS,  
MALIT TË ZI DHE SERBISË (SIPAS DY DEFTERËVE TË  
SANXHAKUT TË HERCEGOVINËS TË SHEK. XV)**

Në këtë kumtesë, për herë të parë, do të trajtohet çështja e shtrirjes dhe njëkohësisht sllavizimi i këtyre dy vëllazërive mesjetare me prejardhje arbërore Burmazi dhe Mataruga që gjatë mesjetës jetonin në hapësirën gjeografike, brenda trekëndëshit të kufijve të Bosnjës e Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë. Ky punim është i bazuar në defterët kadastralë osmanë No. 987 dhe No. 1063, origjinali i tyre gjendet në Arkivin Qendror Osman në Stamboll, që kanë të bëjnë vetëm me regjistrimin e popullsisë vllahe-arumune që gjatë mesjetës jetonte e shpërndarë, kryesisht nëpër viset malore dhe kodrinore të Gadishullit Balkanik. Shpeshherë i ndërronte sundimtarët, nga ata të Nemanjiçve të Rashkës, të Bosnjes dhe së fundi të atyre të Balshajve shqiptarë që studiuesit sllavë tentojnë dhe bëjnë përpjekje maksimale për t'i nxjerrë me prejardhje vllahe-sllave. Në historiografinë, etnologjinë, etnografinë dhe në literaturën shkencore e narrative sllave, këto dy fise apo vëllazëri mesjetare, trajtohen dhe konsiderohen me prejardhje romane- vllahe, madje edhe me origjinë vllahe-sllave, pikërisht për qëllime politike dhe pretendime territoriale, pa asnjë bazë shkencore, “gjoja” për të dëshmuar se në këtë hapësirë gjeografike, nuk kanë jetuar fiset me origjinë arbërore para sllave. Në kohë të fundit, në mënyrë dokumentare dhe transparente po na dëshmojnë, posë atyre sllave edhe regjistrat kadastralë osmanë, se disa grupe të vllëve ishin ndarë nga katundet e fiseve –vëllazërive –arbërore: Burmazi, Mataruga, Zhuro-viçi, Zoto-viçi dhe Malesh-efci në trekëndëshin gjeografik, duke i formuar katundet e tyre, sikurse ishin: Nenkovici, Glegjevici, Vraniçi dhe Perutinovci, kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e vllëve e kishte një prejardhje me fiset mesjetare arbërore, siç ka pohuar qysh moti arkeologu kroat Alojz Benac dhe në kohë të fundit, kjo tezë po përkrahet edhe nga disa arkeologë boshnjakë të Bosnjës. Depërtimi i sllavëve në tokat e banuara me popullsi arbërore dhe vllahe shkaktoi shkatërrime dhe masakra të mëdha, duke i zhvendosur banorët autoktonë nga toka e

tyre pjellore, të cilët qenë të detyruar të strehohen me shekuj nëpër shpella dhe male të pakamueshme për të mbijetuar. Sipas ballkanologut të njohur Milan Shuflaj, historian dhe etnograf i shquar i cili thekson se vendosja sllave në Ballkanin Perëndimor kishte rënë mbi popullsinë arbërore si një sopat që i kishte prerë në veri dhe në jug disa nga degët kryesore të trungut të tij dhe i kishte ngushtuar brenda një territori më të vogël. Edhe Konstatin Jireček, medievistit i mirënjohur, me prejardhje çeke, duke folur për ilirët, ai mendonte se ilirët gjatë periudhës romake, gjysmë të romanizuar, që ishin të parët e albanëve mesjetar, që gjatë depërtimeve të popullsisë sllave, sikurse shkruante ai, ata prej territoreve ku banonin deri atëherë, midis hapësirës së Dalmacisë dhe Danubit, u shtynë ma në jug të Ujdhesës së Ballkanit. Shuflaj dhe Jireček kanë pohuar në studimet e tyre se në mesjetë të gjitha krahinat e përfshira në katërkëndëshin Ohër-Vlorë-Tivar-Prizren me disa degëzime të tyre larg në veri të Prizrenit (të Kosovës verilindore- I. R.) ishin troje të albanëve (zemlje Arbanasa). Ata kishin shkruar se albanët kishin jetuar në mesjetë dhe në qytetet e Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme, por asgjë nuk thanë për albanët që jetonin nëpër vendbanime rurale meqë nuk i posedonin regjistrat kadastralë të shekullit XV-XVI të administratës osmane. Prandaj, teza e tyre, me zbulimin e regjistrave kadastralë osmanë të shekullit XV-XVI, lidhur me vendbanimet e popullsisë arbërore nëpër fshatra të Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme është tejkaluar, qysh para 4 dekadash, meqë këto burime arkivore të dorës së parë, vërtetojnë në mënyrë bindëse se popullsia arbërore edhe para depërtimit të osmanlinjve në Ballkan, banonte në mesjetë edhe në vendbanimet rurale në tërë hapësirën gjeografike prej Nishit ( Naisus) e përtej Shtipit (Astibos), dhe Bilazorës – Velesit të Maqedonisë së sotme. Duke u bazuar në etimologjinë dhe semantikën e toponimeve dhe patronimeve të këtyre vëllezërve, që ende gjallojnë, në këtë hapësirë gjeografike, të cilat posë në dokumentet të Arkivit të Raguzës dhe të atij të Kotorit të shekullit 13 dhe 14, i kemi hasur edhe në regjistrat kadastralë osmanë të shekujve 15 dhe 16 si edhe në hartat topografike austriake të 17, që në mënyrë bindëse mund të dëshmojnë se këto fise- vëllazëri ishin autoktone në hapësirën e lartpërmendur, e jo të ardhura, (sikurse pohojnë disa autorë sllavë), nga Arbëria mesjetare dhe se ato fillimisht në etnogjenezën e tyre ishin me prejardhje ilire-arbërore, të cilat gjatë sundimit romak-bizantin pjesërisht u romanizuan, ndërsa gjatë mesjetës krejtësisht u asimiluan në sllavë. Sipas hulumtuesve të më hershëm, Jireček, Shuflaj e të tjerë, hapësira e vëllazërisë Burmazi, përfshinte vetëm 4 vendbanime në rrethinën e qytezës Stollac mbi Mostar, në anën veriore të Hercegovinës. Mirëpo në kohë të fundit i hulumtova 2 defterë për Vilajetin e Hercegovinës, në Arkivin e Qendror të Osmanlinjve, në të cilët, hetova, pos regjistrimit të bashkësive të vllëve, ishin regjistruar nahija e Burmazëve me (40) fshatra, si njësi administrative administrative osmane, në territorin e sanxhakut të Hercegovinës si edhe nahija Mataruga në kazanë e

Perijepoljës, pëfshinte (12) fshatra, prej tyre 8 vendbanime, gjendeshin në pjesën e Sanxhakut të Jeni Pazarit, ndërsa 4 fshatra në pjesën e Sanxhakut të Tashlixhes-Plevles, sot në Mal të Zi, por për këto të fundit, kësaj radhe nuk kemi të dhëna. Edhe nahija Mataruga në mesjetë përfshinte një territor mjaft të gjërë, meqë vendbanimet ishin të tipit kodrinor e malor të shpërndara njëra nga tjetra në një largësi prej 5 deri në 10 kilometra. Meqë gjatë mesjetës kishin marrë statusin shoqërorë dhe kryesisht, jetonin në vendet malore dhe merreshin me blegtori, andaj këto vëllazëri, ishin regjistruar nga administrata mesjetare sllave, së bashku me vllahët, si kategori sociale, e jo si kategori etnike, por këto në aspektin etnik, ishin me prejardhje ilire-arbërore.

Toponimet e këtyre 2 rajoneve apo nahijeve territoriale e morën emrin sipas vëllazërive me prejardhje arbërore, të cilat qysh nga mesjeta banonin në këto hapësira gjeografike. Administrata osmane, në mënyrë të saktë i regjistronte të gjitha toponimet, mikrotoponimet, oronimet të vendeve, bjeshkëve, lumenjve, të liqejeve, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, më për çështje fiskale. Andaj regjistrat osmanë e vërtetojnë gjendjen faktike të statusit qos, e deri në njëfarë shkalle strukturën fetare dhe etnike të popullsisë heterogjene, por edhe sllavizimin e popullsisë, para sllave që banonin para depërtimit të tyre në Ballkan. Disa studiues kroatë, edhe pse fillimisht, e dinin se këto vëllazëri, kishin origjinë ilire-arbërore, por meqë i takonin besimit katolik dhe e flisnin kroatishten, ata i konsideruan si popullsi të etnisë romano-kroate, ndërsa studiuesit serbë, vëllazërinë e Burmazëve, e Mataruga, që një pjesë e tyre ishte konvertuar në fenë ortodokse të rritit pravollavë e konsideronin me prejardhje vllahoserbe. Konstantin Jireček, për herë të parë, Burmazët në territorin e lartpërmendur i gjen të shënuar në dokumentet e Arkivit të Raguzës, në vitin 1300.

Ai pohonte se fisi Burmaz në gjuhën shqipe e ka kuptimin burrë i madhë e ka kuptimin vetëm në gjuhën shqipe Njëri i Madh. Burmazët përmenden në dokumentet e Republikës së Raguzës përsëri në vitin 1343, ku thuhet se ata kanë shërbyer si tregtarë në mes Hercegovinës dhe Dubrovnikut. Burmazët përmenden edhe në defterët kadastralë osmanë të viteve 1476-78, ku shihet se në këtë kohë ky territor ishte i banuar me fiset- vëllazëri të Burmazëve dhe të Matarugave.

Burmazët gjatë sundimit osman kanë pasur marrëdhënie të ndryshme tregtare me Republikën e Raguzës. Një pjesë e Burmazëve islamizohet për t'i shpëtuar bashkinat dhe pasurit e veta nga pushteti osman, ndërsa një pjesë e tyre gjatë shekullit XVI dhe XVIII, është ikur dhe vendosur në Dalmacinë e Venedikut. Pas vendosjes, më vonë, pasardhësit e tyre, kanë jetuar në këto vende: Korçula, Blata, Vela Luka, Podaça, në rrethinë të Makarskas, në Split, Kashtel, në Shibenik, (në mesjetë kzyetstonte fshati Arbanas-I.R), Ogorje, Niska dhe në Zagori. Patronimi Burmaz në territorin e Zhupes së Zminës (sot i quajtur Muçë), në librin e të lindurve të priftit, fra

Bonaventura Biloglava gjatë viteve 1679-1686, ishin regjistruar këta banorë : Andreja Burmazoviç, i lindur nga prindërit Franja dhe Beta, kumbara i tij ishte Bilobark Stojic. Në vitin 1683 prifti- fratër Biloglava e ka pagëzuar Gudenc Burmazoviçin i biri Palit dhe i Mairgaritës, kumbara i tij ishte Ilija Malesh. Në vitin 1686 ishte pagëzuar me te njëjtin emër dhe mbiemër një tjetër Burmaz, nga prindegri Mateja dhe Klara, kumara i tij ishte Ilija Malesh. Në kadastrin Venecian nga viti 1711 ne vendbanimin Ogorje, ishte regjistruar familja e Ivan Burmazovicit (Brumassovich), të cilës pushteti venecian i kishte dhënë 70 ari tokë për ta punuar. Në vendbanimin Niska, banim të përhershëm kishte edhe familja e Bozhe Burmazoviçit të ndjerit të Jures, me pesë anëtarë të cilit i kishin dhënë 60 ari tokë për ta punuar. Në Kashtell Shtafliq, në vitin 1751 përmendet gjykatësi me emrin Bozhe Burmaz. Në regjistrin e borqëlinjëve në vitin 1790, del i regjistruar edhe Ivan Burmaz. Në Kashtell në mes pesë poetëve te shekullit të XVIII, del të përmendet edhe Ante Burmaz, poet popullor.

Në vitin 1802 regjistruesit ne vendbanimin Podaça. kishin regjistruar shtatë familje me patronimin (mbiemrin) Burmazoviç.

Në kadastrin austriak nga viti 1835 në vendin e quajtur Ogorje e Epërme ishin regjistruar tri familje me mbiemrin *Burmaz Jurina* dhe dy familje tjera me *Burmaz Mateja*, ndërsa në vendbanimin Niska ishin regjistruar dy familje të Burmazve; *Antina dhe Dujina*. Sipas regjistrit të popullsisë të viti 1948 në Ogorje të Epërme ka jetuar një familje, ndërsa në vendbanimin Niska kanë jetuar tri familje me patronimin Burmaz.

Në kohë te fundit në territorin e komunës Muçë, në vendbanimin Ogorje e Epërme jeton familja dy anëtarshë me patronimin Burmaz. Sipas një informatori me emrin *Branimir Burmaz* i cili ishte me prejardhje nga vendbanimi Niska, pohon se gjatë shkollimit të tij në gjimnazin e këtij vendbanimi kishte hasur në **hartën historike** të ish Mbretërisë së Jugosllavisë së vjetër, ku në trekëndëshin *Bosnje-Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi*, ishte shënuar emërtimi *Burmaz* i cili me madhësinë e tij, për afërsisht, mbulonte hapësirën e sipërfaqes se sotme te Malit të Zi (cca 60 xc 40 cm). Ky informator para një kohe, nëpërmjet rrjetit social kërkonte nga hulumtuesit që merren me hulumtimin e etnogjenezës së familjeve me patronimin *Burmaz*, nëse rastësisht hasin në këtë hartë të vjetër historike të njëjtin ta informojnë, meqë fisi *Burmaz* mund të ketë lidhje gjene-tike me ndonjërin prej fiseve ilire. Po ashtu një informator tjetër me emrin Vesna Burmazovic, e cila edhe sot jeton në Vrnjacka Banja në Serbi dhe e cila ka prejardhje prej Hercegovinës, pohon se stërgjiyshërit e saj para 200 vjet, janë vendosur pranë Malit **Goç**, në afërsi të Vrnjacka Banjës, ku sot, jetojnë nja 30 familje me patronimin *Burmaz*.

Në vijim do të paraqesim disa të dhëna edhe për fisin - vëllazërinë mesjetare me patronimin Mataruga, e cila për herë të parë, në dokumentet historike del të



në vendin arkeologjik **Glasiñačko Polje** në rrethinë të Rogaticës në Bosnjën Lindore, postatu gjendet një toponim **Misa** ku ka edhe gjurmë të **tumulave ilire**. Patronimi **Mataruga** ende gjallon edhe te disa familje me prejardhje serbe dhe kroate.

Shumica e fiseve dhe vëllazërive autoktone, para sllave, janë me prejardhje nga popujt jo sllavë që do të thotë, se ato janë me prejardhje Ilire, romane dhe-vllahë në hapësirën e trekëndëshit gjeografik që është trajtuar në këtë punim. **Mataruga** është një ndër fiset me të vjetra që mendohet se i takonte fisit me të madh të Shpënjëve me prejardhje Ilire.

Në vijim po sjellim të dhëna onomastike dhe demografike të nxjerra nga regjistrat kadastralë osmanë të shekullit XV No. 987 dhe No. 1063. Është e rëndësishme të theksohet se në dokumentet e para të Arkivit të Raguzes , nga shekulli XIII dhe XIV, shumica e familjeve të këtyre fiseve mbanin patronimin Burmaz dhe Mataruga, ndërsa në regjistrat osmanë i gjejmë vetën 4 kryefamiljarë që kishin ruajtur patronimin Burmaz dhe 4 të tjerë që kishin ruajtur patronimin Mataruga , çka do të thotë se patronimi i tyre ishte sllavizuar, duke marrë për mbiemra të familjes se tyre emra tipikë sllavë. Po ashtu, duhet theksuar se në nahijen Burmaz i hasim 4 familje me patronimin **Bardo** të substratit ilir dhe 3 familje me patronimin **Progon** të protoshqipës mesjetare, që në mesjetë i mbanin familjet arbërore.

#### **Nahija e Burmazëve në sanxhakun e Hercegovinës:**

- Katundi Ujaska, i takonte Nahijës Burmaz, me 47 kryefamiljarë, 10 bashtina dhe 40 beqarë, antroponomia ishte e sferës së krishtere sllave ma tepër të formave kroate, por kishte edhe emra të huaj: Radic Sharla, Gurgur Sharla, Ivanish Sharlla, Ivko Sharlla, *Millko Milesha, Margjetko Marko* etj.

- Katundi Zhuriç, i takonte Nahijes Burmaz, me 12 kryefamiljarë dhe 19 beqarë.

- Katundi Rasjas, i takon Nahijes Burmaz, me 11 kryefamiljarë dhe 11 beqarë.

- Katundi Napavic, i takon Nahijes Burmaz, me 11 kryefamiljarë dhe 12 beqarë.

- Katundi Ubaska, i takon Nahijes Burmaz ,me 4 kryefamiljarë dhe 1 beqarë.

-Katundi Velik Dol, i takon Nahijes Burmaz me 10 kryefamiljarë dhe 6 beqarë.

- Katundi Lubomeshla, i takon Nahijes Burmaz, me 13 kryefamiljarë dhe 18 beqarë.

- Katundi Uporivac-(Oparivac), i takon Nahijes Burmaz, me 14 kryefamiljarë dhe 18 beqarë.

- Katundi Kapavic, i takon Nahijes Burmaz, me 24 kryefamiljarë dhe 26 beqarë.

- Katuni Perimleva(Poli), i takon Nahijes Burmaz, me 16 kryefamiljarë dhe 10 beqarë.

- Katundi Dugi Dol, i takon Nahijes Burmaz, me 13 kryefamiljarë dhe 10



beqarë.

- Katundi Keshlova-(Keshloda)?, i takon Nahijes Burmaz, me 3 kryefamiljarë dhe 4 beqarë.

- Katundi Popovishte, i takon Nahijes Burmaz, me 1 kryefamiljarë.

- Katundi Resnik, i takon Nahijes Burmaz, me 11 kryefamiljarë dhe 12 beqarë.

- Katundi Duboka, i takon Nahijes Burmaz, me 13 kryefamiljarë dhe 10 beqarë.

- Katundi Novash, i takon Nahijes Burmaz, me 8 kryefamiljarë dhe 8 beqarë.

- Katundi Stalac, i takon Nahijes Burmaz me 5 kryefamiljarë dhe 1 beqarë.

- Katundi Radim Dol, i takon Nahijes Burmaz me 3 kryefamiljarë dhe 4 beqarë.

- Katundi Goç-in Dol, i takon Nahijes Burmaz me 5 kryefamiljarë dhe 8

beqarë.

- Katundi Prasac Dol, i takon Nahijes Burmaz me 2 kryefamiljarë dhe 4 beqarë.

- Katundi Boshishta- Bushishta, i takon Nahijes Burmaz me 13 kryefamiljarë dhe 14 beqarë.

- Katundi Odori, i takon Nahijes Burmaz me 22 kryefamiljarë dhe 17 beqarë.

- Katundi Rikiniç Dol, i takon Nahijes Burmaz, me 2 kryefamiljarë dhe 3 beqarë.

- Katundi Butesh- Bunesh i takon Nahijes Burmaz me 4 kryefamiljarë dhe 5 beqarë.

- Katundi Ravenic, i takon Nahijes Burmaz, me 26 kryefamiljarë dhe 43 beqarë.

Në këtë vendbanim kishte tre kryefamiljarë me emrin Balin dhe Baliç dhe katër kryefamiljarë me patronimin Bulklu.

- Katundi Dolna Butina-Botina , i takon Nahijes Burmaz, me 15 kryefamiljarë.

- Katundi Preska-Breska, i takon Nahijes Burmaz.

- Katundi Betun-Bitun, i takon Nahijes Burmaz, me 29 kryefamiljarë dhe 40 beqarë.

- Katundi Sredna Bitun, i takon Nahijes Burmaz, me 22 kryefamiljarë dhe 16 beqarë.

- Katundi Vllanaç-Vllajaç, i takon Nahijes Burmaz, me 15 kryefamiljarë dhe 20 beqarë.

- Katundi Besdeki-Buzdeki, i takon Nahijes Burmaz me 13 kryefamiljarë dhe 14 beqarë.

- Katundi Zhirvan, i takon Nahijes Burmaz, me 30 kryefamiljarë dhe 30 beqarë.

- Katundi Kapavça, i takon Nahijes Burmaz, me 14 kryefamiljarë dhe 11 beqarë.

- Katundi Gorna Ivic, i takon Nahijes Burmaz, me 7 kryefamiljarë dhe 8 beqarë.

- Katundi Dolna Ivic, i takon Nahijes Burmaz me 19 kryefamiljarë dhe 13 beqarë.
- Katundi Mosuri-Musuri, i takon Nahijes Burmaz, me 22 kryefamiljarë dhe 18 beqarë.
- Katundi Gurlat-Kurlat, i takon Nahijes Burmaz, me 13 kryefamiljarë dhe 12 beqarë.

**Bashkësia e vllahëve në Kazanë e Prijepoljes në Nahijën e Matarugës që gjendeshin në territorin e Sanxhakut të Novi Pazarit me këto katunde:**

- Katundi Dobroja Bukur, i takon Polimlje Nahijes Mataruga.
- Katundi Brezna i takon Nahijes Mataruga.
- Katundi Gurovik, i takon Nahijes Mataruga, me 13 kryefamiljarë dhe 10 beqarë.
- Katundi Kashic-Gashic, i takon Nahijes Mataruga, me 13 kryefamiljar dhe 17 beqarë.
- Katundi Ivraça, i takon Nahijes Mataruga, me 1 kryefamiljar.
- Katundi Skuka, i takon Nahijes Mataruga, me 9 kryefamiljarë dhe 20 beqarë.
- Katundi Lutiç, i takon Nahijes Mataruga, me 30 kryefamiljarë dhe 40 beqarë.
- Katundi Gorna Luka, i takon Nahijes Mataruga, me 58 kryefamiljarë dhe 30 beqarë.
- Katundi Ostoga-Ustoga, i takon Nahijes Mataruga, me 55 kryefamiljarë dhe 85 beqarë, një kryefamiljar quhej me emrin Vojko Arbanash.
- Katundi Dorin, i takon Nahijes Kukan.
- Katundi, Gelinc Gjelinc, i takon Nahijes Kukan, me dy shtëpi dhe toka e quajtur Qarrova Bërda.
- Katundi Dorina, i takon Nahijës Kukan, Katundi Dranç dhe Katundi Dardaça-(Dardhaça- I. R.) pa banorë.

**Burimet dhe literatura:**

1. *Bashkallik Osmanli Arsivi*, Istanbul, metej, BOA.
2. BOA. *Defter-i Liva-i – i Herseg*, No. 987.
3. BOA. *Defter-i Liva-i Hersg*, No. 1063. Lu
4. Ludvicus de Thalloczy, dr. ConstatInus Jirecek, dr. Emilianus de Sufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae Mdiae aetatis ILLustrantia*, II.189.
5. Konstantin Jirecek, *Romani u gradovima Dalmacije*, Zbornik , K. Jireceka, II,

SANU, Bgd, 1962.

6. Milan Shuflaj, *Povijest sjevernih Arbanasa*, Bgd. 1925.
7. K. Jirecek, *Istorija srba*, Beograd, 1952.
8. E. Çabej, Problemi i autoktonisë së shqiptarëve. Buletini i USHT, Tiranë.
9. Ajeti, *Shqiptarët dhe gjuba e tyre*, Prishtinë, 1994
10. R. Smajli, *Disa çështje të onomastikës mesjetare*, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979.



**Isa MEMSHI**

## **GJUHA ARABE DHE KODET E MËDHA, ME THEKS TË VEÇANTË KUR'ANI**

Gadishulli Arabik ka qenë dhe ende mbetet djep i civilizimeve dhe i kulturave, vendlindje e feve, truall ku lindi shkrimi dhe alfabeti, konsiderohet vendtakim i civilizimeve që aty kanë marrë famë dhe kanë zënë fill, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e njerëzimit.

Arabishtja për gjatë gjithë historisë së studiuesve të teologjisë ka zgjuar kureshtje dhe interesim të madh. Orientalistët evropianë dhe jo vetëm ata, janë marrë me studimin e arabishtes në mënyrë serioze dhe kanë arritur suksese të lakmueshme. Arabishtja karshi peshës që kishte në studimet krahasimtare të gjuhëve semite, ajo kishte peshën e saj edhe në studimin e librave të shenjta para Kur'anit, pra të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re.

Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve të Dhiatës së Vjetër, të zbuluara në Luginën e Kumranit, ndryshe njihen si dorëshkrime të Detit të Vdekur, janë të shkruara në hebraishten antike dhe disa në aramishte, kurse një numër tejet i vogël në greqishten e vjetër. Aramishtja, gjuhë semite,<sup>1</sup> mjaft e afërt me fenikishten dhe hebraishten, ajo dhe ka disa karakteristika të arabishtes.<sup>2</sup>

Afria e gjuhëve semite me njëra tjetrën ka filluar me afrimin e aramishtes me akadishten kenanite, e që në shekullin e katërt para erës sonë, rezultoi me shkrirjen e kësaj të fundit në aramishte, kurse në fillim të shekullit të parë para erës sonë, edhe fenikishtja në Azi u shkri në aramishte. Kurse afrimi tjetër i gjuhëve semite është afrimi i arabishtes me simotrat e saja.<sup>3</sup>

Ndikimi i arabishtes karshi aramishtes, në Lindje dhe në Perëndim, ishte aq i theksuar sa që, diku në shekullin e dytë aramishtja u shkri tërësisht në arabishte, përveç në disa zona të izoluara që edhe në ditët tona flitet në ato zona.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Aramishtja i takon grupit të gjuhëve semite veriore. Në këtë grup hyjnë gjuhët: akadishtja, kenanishtja, ku bënë pjesë hebraishtja dhe fenikishtja. Kurse grupit të gjuhëve semite jugore i takojnë arabishtja, jemenishtja antike dhe gjuhët e etiopishtes.

<sup>2</sup> Henry S. Abode, Mu'ğmul-ħađarāti-s-sāmiye, Triploi, Liban, f. 17.

<sup>3</sup> Dr. Emīl Badi', Mevsū'at 'ulūmi-l-luġāti-s-āmiyeti, v. VII, f.542.

<sup>4</sup> Dr. Emīl Badi', vep. Cit. F. 542.

Duke krahasuar aramishten<sup>5</sup> me hebraishten e Dhiatës së Vjetër, sipas Henry S. Abode, shihen qartë gjurmët e zhvillimit të kësaj gjuhe. Aramishtja është shtrirë gjatë shekullit të VIII para erës sonë, falë pushtimeve të nestorianëve dhe të babilonasve dhe në të njëjtën kohë aramishtja zuri vendin e akademisë, e cila ishte gjuhë e diplomacisë së asaj kohe. Me kalimin e kohës aramishtja u bë gjuhë e komunikimit të përditshëm, qoftë në tregti, në politikë, në kulturë,<sup>6</sup>

Çfarë është trashëguar nga aramishtja deri në ditët tona? Deri në ditët tona nëpërmjet hebraishtes janë trashëguar disa tregime në aramishte që kanë të bëjnë me tregimet e Ezrës dhe libri i Nehemias. Këto janë gjurmët të vjetra të trashëguara të shkruara në vitin 166 apo 167 para erës së re. Këto shkrime fillimisht ishin shkruara në hebraisht e më pas në aramishte.

Kees Versteegh, duke parë ngjashmëritë e mëdha mes arabishtes dhe hebraishtes arkaike, është i mendimit se studimi i arabishte do të ndihmonte mjaft shumë në deshifrimin e hebraishtes arkaike së Dhiatës së Vjetër, andaj edhe gramatikanët e hebraishtes i kanë kushtuar mjaftë hapësirë marrëdhëniesve mes tri gjuhëve: arabishtes, hebraishtes arkaike dhe aramishtes.<sup>7</sup> Ai më tej shton se, edhe Jehūdā Bin Qureys, (i cili konsiderohet ndër studiuesit e parë që është marrë me studimin e gjuhëve semite, e që ka jetuar ka fundi i shekullit të nentë dhe fillimit të shekullit të dhjetë I.M), që atëherë ka vë në pah rëndësinë e arabishtes dhe aramishtes për studimin e Dhiatës së Vjetër në hebraishten arkaike.<sup>8</sup>

Studiuesit e Dhiatës së Re janë të një mendjeje, se gjuha me të cilën ka komunikuar Jezusi ka qenë sirianishtja<sup>9</sup>, një nga gjuhët semite veriore e që shpeshherë është quajtur edhe keldanishte. Ekzemplari i Dhiatës së Re në sirianishte konsiderohet të jetë origjinali i Ungjillit.<sup>10</sup> Në anën tjetër arabishtja dhe sirianishtja janë dy gjuhë

<sup>5</sup> Pas shthurjes së shtetit të hetitëve, gjatë shekullit të tetë para erës sonë, në pjesën më të madhe të atyre trojeve e mbizotëruan aramitët, kurse vendi filloi të quhet Ārāmā. Ky popull disa herë përmendet edhe në Dhiatën e Vjetër. Aramitë bashkë me hetitët popullonin Sirinë veriore, kurse Sirinë e jugut dhe të mesmen e popullonin kenanitët. Siria e asaj kohe shtrihej nga bregdeti i Detit Mesdhe deri në kufi me Mesopotaminë. Ajo zonë, pra Siria historike, përfshinte Sirinë, Libanin, Jordaninë, Palestinë me gjitha territoret e Izraelit të sotëm, një pjesë të Turqisë e cila kufizohet me Sirinë, gjithë Qipron, siujdhesën e Saniut dhe Irakun.

<sup>6</sup> Henry S. Abode, *vep.cit*, f. 18.

<sup>7</sup> Për më shumë rreth raporteve të arabishtes dhe hebraishtes arkaike shih Albert Schultenes, *Abdu-rr-Rahman Bedevi, Leksikoni i orientalistëve, Logos A*, f. 15.

<sup>8</sup> Kees Versteegh, *Al-Luġatu-l-a'arabiyatu, Tārīḥuhā ve musteviyātuhā ve te'ṭiruhā*, Kajro, 2003, f. 13.

<sup>9</sup> Sirianishtja është degë e aramishtes, e cila është folur në Lindjen e Afërt. Supozohet se djepi i sajë ka qenë në qytetin Edesse, qytet në Turqi i njohur me emrin Urfe. Me përhapjen e krishterimit është shtrirë edhe aramishtja.

<sup>10</sup> *Revista e kishës sirianite-ortodokse*, v.1. Nr. 7. maj 2007.

simotra me origjinë të përbashkët semite, bashkë janë zhvilluar, kanë plotësuar njëra tjetrën për gjatë gjithë kohës, janë bashkuar me njëra tjetrën që në lashtësi. Roli i tyre në avancimin e shkencës dhe civilizimit njerëzor ka qenë i njëkohshëm, andaj nuk është aspak për t'u habitur për ndikimin që kanë pasur ndaj njëra tjetrës, apo huazimeve të ndërsjella mes këtyre dy gjuhëve. Kjo afërsi ka bërë që aramishtja sirianite t'i ofrojë arabishtes shkrimin kufij, i cili origjinën e ka nga alfabeti aramit.<sup>11</sup>

Me depërtimin e aramitëve në shtetin nestorian, në të njëjtën kohë ua rrëmbyen edhe pushtetin, ndaj aramishtja dalëngadalë, në jetën e përditshme, zuri vendin e asirishtes.<sup>12</sup> Kur persianët kishin zaptuar vendet e nestorianëve në Azi, aramishtja ishte bërë gjuhë e komunikimit në atë rajon, dhe dalëngadalë i thithi gjitha dialektet kenanite. Sipas Brockelmanit aramishtja, atë kohë, nuk ishte gjuhë zyrtare, por ishte gjuhë e liturgjisë.<sup>13</sup> Aramishtja jo vetëm që depërtoi në Azinë e Mesme, por ajo depërtoi edhe në veri të Hixhazit<sup>14</sup>, në zonën ku flitej arabishtja. Në oazën Taima janë zbuluar disa gdhendje arkaike të periudhës para pushtimit persian.

Aramishtja përëndimore ishte gjuha që dominonte në Palestinë gjatë epokës së Jezu Krishtit. Mirëpo, sipas C. Borockelmanit, fatkeqësisht ne nuk dimë saktë për formën e sajë origjinale të asaj kohe. Në tekstin e Dhiatës së Re, në greqishten e vjetër gjithsejtë janë gjashtëmbëdhjetë fjalë nga aramishtja e asaj kohe.<sup>15</sup>

Aramishtja është mjaft e ngjashme me arabishten, andaj edhe roli i arabishtes për studimin e kopjeve origjinale të Dhiatës së Re në aramishte është i një rëndësie të jashtëzakonshme.

Përafërsisht në vitin 639 prijësi arab 'Umer bin Sa'd Ibn Ebi Veqās, nga patriku sirianit ortodoks Johan, kërkoi që bibla të përkthehet në arabisht. Pra, ky përkthim i takon periudhës paraislame. Kurse në vitin 693 çifuti Seid Fajum përktheu në arabishte pesë libra nga Dhiata e Vjetër.<sup>16</sup> Ky përkthim, sipas studiuesve të Dhiatës së Vjetër, konsiderohet përkthimi i parë i Biblës në gjuhën arabe.

I gjithë komuniteti beduin në Veri bashkëjetonin me aramitet të krishterë, të cilët i kishin banuar ato vise. Kontaktet e tregtare të Hixhazit me fiset veriore dhe misionarët e krishterë nga Palestina dhe Siujdhesa e Sinaït ndikuan thellë në Saharë për

---

[www.stmacariusmonastery.org/st\\_mark/sm090510.htm](http://www.stmacariusmonastery.org/st_mark/sm090510.htm)

<sup>11</sup> Dr. Teufik Muftic, *Arapsko pismo*, Sarajevë, 1982, f. 149. Sipas studimeve më të reja është konstatuar se alfabeti arab është me origjinë nga alfabeti *nabatij*. Gjatë shekullit të dytë ka filluar të zhvillohet alfabet i pavarur. Për më shumë shih: Murad Muhamed Lezmān, *Teṭavuru-l-luḡati-l-‘arabiya abre-t-tāriḥ*, <http://www.voiceofarabic.net/index.php>

<sup>12</sup> C. Borckelaman, *Fiḡḡu-l-luḡāi-s-sāmiye*, Ġāmi'a 'Aynu- ṣ- Ṣems, 1977, f.22.

<sup>13</sup> C. Borckelaman, *vep.cit.* f.23.

<sup>14</sup> Henry Abode, *Muḡmul-ḥaḍarāti-s-sāmiye*, Triploi, Liban, f. 20

<sup>15</sup> C. Borckelaman, *vep.cit.* 1977, f.24

<sup>16</sup> Ky përkthim i kësaj pjese të Dhiatës së vjetër është botuar në vitin 1983.

t'i njoftuar arabët me krishterimin.<sup>17</sup>

Migrimet e fiseve kenanite dhe aramite, nga Gadishulli Arabik për në Palestinë, që në lashtësi, ka ndikuar në ndryshime të mëdha dhe të shumta, si në aspektin e shoqëror ashtu edhe në atë fetare në mbarë rajonin. Këto migrimet nuk u ndalën vetëm në Palestinë dhe në Siri, por ato kaluan edhe në Egjipt. Këto fise semite depërtuan edhe në krahinat e Nilit duke e shtrirë ndikimin e vetë edhe në Egjipt. Fiset semite krijuan Sulltanatin e tyre të quajtur Hiksos.<sup>18</sup>

Roli i arabishtes të Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re është sekondar, karshi rolit që ka arabishtja sa i për ketë Kur'anit.

Roli i arabishtes të perëndimorët, përveç tjerash, ka qenë mjaft i madh edhe në vënien e lidhjeve mes kishës katolike perëndimore me të krishterët maronitë në Lindje, të cilët arabishten e kishin gjuhë amtare. Maronitët Perëndimit i ofruan mjaft të dhëna edhe për Kur'anin dhe për gjuhën arabe.<sup>19</sup> Interesimi i studiuesve perëndimorë rreth arabishtes, karshi studimeve gjeostrategjike që ka Orienti, ka qenë dhe mbetet edhe në ditët e sotme, interesimi për studime filologjike, me theks të veçantë studimi i gjuhëve semite. Semilogët janë të mendimit se ngjashmëritë mes hebraishtes së vjetër dhe arabishtes ndihmon në studimin e hebraishtes së Dhiatës së Vjetër. Pas ekspeditave të gjeografëve perëndimorë nëpër Orient, bënë me dije për ngjashmërinë mes hebraishtes dhe arabishtes.

Migrimi i fiseve arabe jashtë Gadishullit Arabik, sidomos me paraqitjen e Islamit, ka qenë në masë edhe më të madhe, duke përfshirë Azinë, Afrikën dhe një pjesë të Evropës. Meqenëse Kur'ani profetit Muhamed i është shpallur në gjuhën arabe, andaj edhe arabishtja, me përhapjen e Islamit jashtë Gadishullit Arabik, fillon të ketë ndikimi të popujt që e pranonin Islamit për fe të tyre.

Për peshën që ka arabishtja në raport me Kur'anin flet fakti se sintagma *gjuha arabe* dhe *Kur'ani në gjuhën arabe* në Kur'an përmenden dhjetë herë: "*... kurse kjo (gjuha e Kur'anit) është gjuhë e qartë arabe.*"<sup>20</sup> "*Në gjuhën e qartë arabe*";<sup>21</sup> "*... në Kur'an në gjuhën arabe, për njerëzit që dinë*".<sup>22</sup> "*Ne e zbritëm Kur'anin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju,*"<sup>23</sup> "*Ja kështu, Ne e kemi zbritur Kur'anin në gjuhën arabe ...*"<sup>24</sup> "*Ja kështu, Ne e kemi zbritur Kur'anin në*

<sup>17</sup> Cark Brockelman, *Tārīḥu-l-sh-shu'ūbi-l-islāmiye*, Bejrut, 2001, f. 31.

<sup>18</sup> *Israel Wolfensohn, Tārīḥu-l-lugāti-s-āmiye*, Kajro, 1929, f. 6.

<sup>19</sup> Kees Versteegh, *Al-Luḡatu-l-a'arabiyatu (tārīḥuhā ve musteviyātuhā ve te'ṭruhā)*, Kajro, 2003, f. 12.

<sup>20</sup> *An-Naḥl*, 103.

<sup>21</sup> *Ash-Shu'ara'*, 195.

<sup>22</sup> *Fuṣilet*, 3.

<sup>23</sup> *Jūsuf*, 2.

<sup>24</sup> *Ar-R'ad*, 37.



*gjuhën arabe dhe në te ne vërejtjet i kemi përsëritur ..." 25; "Ne e kemi shpallur Kur'anin në gjuhën arabe, dhe atë pa asnjë kundërtënie, ..." 26 "Ja kështu pra, ne të kemi shpallur ty Kur'anin në gjuhën arabe, për të paralajmëruar popullin e Mekës dhe ata rreth saj, ..." 27 "... që Ne e kemi shpallur Kur'anin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju." 28 "Para Kur'anit ishte Libri i Musasë, një udhërrëfyes dhe mëshirë. Ky është Libër (Kur'an), i shpallur gjuhën arabe, që e vërteton atë për t'i paralajmëruar ata që bëjnë vepra të këqija dhe për t'i sibiariquar ata që bëjnë vepra të mira." 29*

Arabët para Kur'anit nuk kishin ndonjë autoritet apo pozitë karshi popujve përreth, vetëm me shpalljen e Kur'anit profetit Muhamed, ata filluan të faktorizohen në zonat ku bashkëjetonin me popujt tjerë. Meqenëse Kur'ani profetit Muhamed iu shpall në gjuhën arabe dhe predikimi i lutjeve kryhej në gjuhën arabe. Tani më gjuha arabe nuk ishte më gjuhë vetëm e arabëve, por ajo filloi të mësohej edhe nga popujt jo arabë. Ku'ani në arabishten e kulluar recitohej mes adhuresve të rreshtuar pas imamit. 30

Gjuha arabe, kuptohet nëpërmjet Kur'anit, filloi të depërtojë thellë në vendet e largëta si në Indi, në Kinë, në Afganistan, Persi e ku jo tjetër. Arabishtja, te këto popuj zgjoi interesim aq të madh, sa që nga gjiri i këtyre popujve, më vonë, do të njihen edhe dijetarët më në zë, qofshin të gjuhës arabe apo të shkencave tjera. Me këtë rast mjafton të përmendet emrat si Buhariu, Muslimi, Ibn Maxhe, studiues dhe koleksionues më të njohur të traditës së profetit Muhamed, Ebū Reyhān el-Bīrūnī (973-1048), udhëpërshkrues, filozof, astronom, gjeograf, gjeolog, matematikan, historian. Mbi të gjitha përkthyes i njohur i trashëgimisë së hundësve të lashtë, konsiderohet ndër shkencëtarët më të njohur, që ka njohur civilizimi islam për gjatë gjithë historisë.

Me vdekjen e Profetit Muhamed, në vitin 632, në Medinë, përgjatë shekullit në vijim, Gadishulli Arabik zgjoi interesim te bota tjetër, e cila deri atë kohë nuk dinte se çfarë kishte ngjarë në të kaluarën brenda Gadishullit Arabik. Që nga kontaktet e para mes botës islame dhe Evropës, arabët dhe arabishtja zgjuan kureshtjen e studiuesve të huaj. 31 Hajejm Rabin, sa i përket arabishtes *fuṣḥā*, pra gjuha standarde apo gjuha letrare, është i mendimit se mbështetje kryesore ka në dialektet në jugperëndim të

<sup>25</sup> Ṭaha, 113.

<sup>26</sup> Zumer, 28.

<sup>27</sup> Ash-Shūrā, 7.

<sup>28</sup> Az-Zuḥruf, 3.

<sup>29</sup> Al-Aḥqāf, 12.

<sup>30</sup> Ebū Reyhān el-Bīrūnī, cituar sipas Titus Burchkardt, Arti i Islam, gjuha dhe kuptime, Logos A, Shkup, 2009, f.85.

<sup>31</sup> Kees Versteegh, Al-Luġatu-l-a'arabiyatu (tārīḥuhā ve musteviyātuhā ve te'tīruhā, Kajro, 2003, f. 9.

Gadishullit arabik.<sup>32</sup> As-Sujūṭī pohon se dialekti i kurejshiteve është dialekti më afër gjuhës standarde, e cila atëkohë quhej *fushā*.<sup>33</sup> Ky dialekt ka qenë edhe gjuha e poezisë arabe e periudhës paraislame,<sup>34</sup> dhe gjuhë e aristokracisë kurejshite<sup>35</sup>, e krijuar falë Mekës dhe Jethribit, dy qendra tregtare që në lashtësi.

Sipas studiuesve të dialektologjisë arabe shihet qartë se leksiku i Kur'anit përfshin të folmet e fiseve më të mëdha të Jugut të Gadishullit Arabik. Me këtë rast shumica e studiuesve janë të mendimit se Kur'ani ka pasur një rol tejet të rëndësishëm në unifikimin e arabishtes,<sup>36</sup> gjuhë e cila që atëherë është quajtur *fushā*. Dallimet që kishin ekzistuar në dialektet e Gadishullit arabik, para Kur'anit, tani më ishin unifikuar me gjuhën e Kur'anit dhe për arabishten, me Kur'anin, fillon epoka e unifikimit si gjuhë e unifikuar për gjithë arabishtfolësit.

Gjuha arabe, falë Kur'anit, zgjoi interesim jashtëzakonisht të madh edhe te studiuesit e huaj, e me theks të veçantë tek filologët evropianë. Marrë parasysh se arabishtja ishte dhe mbeti gjuhë e Kur'anit, filologët edhe orientalistët më në zë janë marrë me studimin e arabishtes. Me këtë rast po përmendim prononcimin vetëm të disa studiuesve evropianë rreth peshës dhe rolit të arabishtes që ajo ka pasur tek arabët dhe jo vetëm tek ata:

Linguisti francez Ernest Renan thotë se arabishtja është fenomeni më madhështor në historinë e njerëzimit dhe se ajo në të njëjtën kohë nuk ka fëmijërinë e sajë e as pleqërinë. Orientalisti gjerman Wilhelm Freytag pohon se "arabishtja radhitet në grupin e gjuhëve të pasura botërore", kurse filologu William Verek thotë se "arabishtja është gjuhë mjaft fleksibile dhe se mund të përshtatet në gjitha kohërat dhe t'i bëjë ballë gjitha sfidave të kohës."<sup>37</sup> Kurse orientalisti i shquar gjerman dhe një ndër studiuesit më të njohur të gjuhëve semite Carl Brockelma, për arabishten thotë: Arabishtja, falë Kur'anit, ka arritur të përhapet aq shumë sa që historia nuk njih ndonjë rast të ngjashëm të ketë ndodhur me ndonjë gjuhë tjetër". Ai më tej shton se "myslimanët janë të bindur se arabishtja është e vetmja gjuhë, me të cilën ata duhet të shërbehen gjatë lutjeve të tyre". Këtu aludohet për leximin e Kur'anit gjatë lutjeve të përditshme. Brockelma më tutje thotë se "pikërisht falë këtyre principeve arabishtja ka zënë vend të mjaft të rëndësishëm në kulturat e popujve mysliman dhe ka qenë gjuha

<sup>32</sup> Cituar sipas, ḥamza Al-Mezīni,

<sup>33</sup> As-Sujūṭī, Al-Muz'hiru fī-l-luga ve envāuhā, f. 126.

<sup>34</sup> Kees Versteegh, vep.cit. fa. 56.

<sup>35</sup> Titus Burchardt, Arti i Islam, gjuha dhe kuptime, Logos A, Shkup, 2009, f.85.

<sup>36</sup> Ibn 'Abās, Kitābu-l-lugāti fī-l-Kur'ni, Kajro, 1946, f.5.

<sup>37</sup> Cituar sipas Dr. Farhan Selim, *Al-luḡatu-l-'arabiyyetu ve mekānātuhā beḥṣe lugati*. <http://fonaam.ahlamontada.com/t7628-topic#12724>

më superiore te të gjithë popujt mysliman për gjatë gjithë historisë.<sup>38</sup> Ai për arabishten më tej shton se ajo, ndonëse ishte mjet i kulturës dhe civilizimit në hapësira mjaft të gjëra, gjithandej ku Islami u pranua për fe, duke filluar nga brigjet e Detit të Zi deri në Zanzibar, nga Fesi dhe Timbutku deri në Kashgar dhe në Malaje.<sup>39</sup> Gjatë mesjetës në arabishte janë shkruar mjaft vepra fetare dhe filozofike hebraike. Mjaft historianë të linguistikës pohojnë se arabishtja është gjuha më e vjetër, e cila deri në ditët tona ia ka dalë të ruajë pasurinë leksikore, gramatikën, fleksionin, si dhe ia ka dalë t'i bëjë ballë sfidave të kohës bashkëkohore.

Jo vetëm arabët, por gjithë bota islame, për gjatë gjithë historisë, kanë përhapur islamin gjithandej botës dhe në të njëjtën kohë kanë përhapur edhe arabishten, gjuhë e Kur'anit. Një numër i konsiderueshëm i popujve të Azisë perëndimore dhe Afrikës veriore, islamin e pranuan që në shekujt e parë të përhapjes së tij. Me përqaftimin e fesë së re ata pranuan edhe gjuhën e re, gjuhën e Kur'anit, gjë e cila dita ditës zinte vendin e gjuhëve që fliteshin deri në atë kohë.

Arabishtja falë Kur'anit dhe traditës së Profetit Muhamed, ia ka dalë të ngadhënjejë karshi gjuhëve të lashta me kulturë mjaft të lashtë.<sup>40</sup>

Dikur arabishtja ka qenë element i unitetit mbarë arab, element i zhvillimit dhe superioritetit karshi të tjerëve. Një pjesë e popujve që kishin pranuar islamin, arabishten e konsideronin pjesë të civilizimit dhe kulturës së tyre. Andaj, edhe për gjatë kohë arabishtja ka qenë gjuhë e shkencës, politikës, tregtisë, filozofisë, misticizmit, letërsisë dhe artit. Arabishtja, gjuhë e Kur'anit, nga arabët është konsideruar e mbinatyrshëm, ngase duke u konsideruar Kur'ani libër i shenjtë te myslimanët, edhe gjuhën e Kur'anit në të njëjtën kohë e konsiderojnë si të shenjtë.

Fitoret e arabëve, duke përhapur Islamin jashtë Gadishullit arabik, rezultuan me përzierjen arabëve me shumë popuj joarabë. Kështu arabishtja ra në kontakt me aramishten në Siri, në Liban dhe në Irak, me koptishten në Egjipt, me berberishten në veri të Afrikës, me persishten në Iran, me turqishten në vendet e banuara me mongol dhe me gotishten në Spanjë.<sup>41</sup>

Me krijim e shtetit islam, edhe gjuha arabe filloi të shtrihej bashkë me të. Për shekuj me radhë arabishtja, me shtirjen e shtetit islam, u bë gjuhë e politikës, e shkencës dhe e letërsisë gjithandej ku shtrihej shteti islam. Gjuha arabe, kuptohet, nëpërmjet Kur'anit, pati ndikim të madh të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në shumë gjuhë tjera. Vlen të përmendet ndikimi i saj në turqishte, persishte, amazigishte etj.

<sup>38</sup> Cark Brockelman,

<sup>39</sup> Cark Brockelman, *Tārīḥul-edebl-l-‘arabiy*, v.1. f. 4.

<sup>40</sup> Dr. ‘Alī ‘Abdu-l-Vāḥid Vāfī, *Fiqhu-l-luga*, Kajro, 2004, f. 93.

<sup>41</sup> Dr. ‘Alī Abdu-l-Vahid Vāfī, *Fikḥu-l-lugati*, (botimi i tretë) 2004, f. 102.

Arabishtja me shtrirjen e islamit në Evropë pati ndikim të dukshëm në disa gjuhë evropiane si në spanjishte, portugalishte, maltishte, bosnishte dhe në shqipe.

Arabishtja me shtrirjen e Islamit filloi të zë vendin e disa gjuhëve të cilat fliteshin te popujt që e pranuan Islamit për fe të tyre. Me këtë rast vlen të përmendet rasti i arabizimit të popullit amazig në Algjeri. Amazigishtja, njëra ndër gjuhët kryesore të berberëve në Afrikën veriore, është shkruar në arabishte me kalimin e berberëve në Islam. Amazigishtja në Algjeri sot flitet vetëm në disa zona malore nga fiset nomade.<sup>42</sup>

Arabishtja gjuhë e Kur'anit dhe e traditës së Profetit Muhamed, gjatë shtrirjes së Islamit, në kontakt me gjuhët tjera ajo ndikoi mjaft edhe në përhapjen e leksikut të sajë tek gjuhët e popujve që pranorin islamit për fe të tyre.

Kontakti i arabishtes me gjuhët tjera, përveç që rezultoi me ndikimin e sajë tek gjuhët tjera të popujve myslimanë, ajo edhe u ndikua nga gjuhët tjera.<sup>43</sup> Përhapja e gjuhës arabe, në vendet jashtë truallit të sajë, ia doli të dominojë karshi gjuhëve të atyre vendeve. Mirëpo, shtrirja e gjuhës arabe nëpër ato zona, përveç që u bë gjuhë dominuese, rezultoi që ndikohet nga gjuhët lokale.

Arabishtja vërtetë i dominoi shumë gjuhë, si gjuhët e lashta të Jemenit në zonat e Jemenit, dialektet e aramishtes në Irak dhe në Sham, koptishten, berberishten dhe gjuhët keshite në Egjipt dhe në veri të Afrikës, por që edhe u ndikua mjaft nga gjithë këto gjuhë. Andaj arabishtja e këtyre vendeve, duke qenë e ndikuar nga gjithë këto gjuhë, dallonte mjaft nga gjuha standarde *fushā*. Arabishtja e vendeve të Leventit ishte mjaft e ndikuar nga aramishtja, kurse në vendet e Magrebit nga dialektet e berberishtes.

Kontaktet e arabishtes me persishten ishin kryesisht në qytetin al-Hiret<sup>44</sup>. Këto kontakte në mes këtyre dy gjuhëve, edhe pse persishtja ishte gjuhë indoevropiane kurse arabishtja gjuhë semite, gjatë kontakteve mes këtyre dy popujve huazuan mjaft fjalë nga njëra tjetra. Persishtja më vonë, me kalimin e persianëve në islam, huazoi alfabetin arab dhe një leksik të konsiderueshëm nga arabishtja.

Duhet veçuar ndikimin e persishtes dhe i sirianishtes në arabishte karshi gjuhëve tjera. Huazimet që kanë depërtuar nga greqishtja e vjetër në arabishten e asaj kohe, kanë qenë nëpërmjet sirianishtes, siç kemi rastin me fjalët *inxhil*, *ustimānet*, *uskuf*, *nāmūs*, *isfenxh* etj. Sa i për ketë gjuhëve tjera, siç është rasti me koptishten dhe

<sup>42</sup> Për më shumë rreth arabizimit të berberëve shih: Ibn Bādīs, "Keyfe šaret Al-Ġezāiru 'arabiye", Aš-Šihāb, 1933.

<sup>43</sup> Për më shumë shih: Dr. Isa Memishi, Fjalët me prejardhje joarabe në Kur'an sipas As-Sujūti-ut, Monografia e Degës së Orientalistikës, Prishtinë, 2013.

<sup>44</sup> al-Hiret është një qytet i antik, i cili gjendet në jug të Irakut qendror. Ka qenë kryeqendër e sundesve të Irakut para Epokës islame. Gjendet shtatë kilometra në juglindje të qyteteve të Nexhefi dhe Kuffës.

berberishten, ndikimi i tyre ka qenë mjaft i zbehtë, edhe ato pak huazime që kanë depërtuar, kanë depërtuar nëpër të folmet lokale si në Irak, Siri, Egjipt, Sudan dhe vendet tera të Magrebit.<sup>45</sup>

Kontaktet mes arabishtes dhe persishtes kanë lënë gjurmë të dukshme te njëra tjetra, por që nuk ia kanë dalë që ta shuajnë njëra tjetrën. Huazimet e ndërsjella kanë qenë të shumta, sidomos në fushën e leksikut. Ndikimi i arabishtes te persishtja ka qenë i përmasave më të mëdha. Ndikimi i arabishtes te persishtja ka qenë aq i madhe sa që edhe në gjuhën e sotme perse mjaft terma janë me origjinë nga arabishtja.

Turqishtja në kontakt me arabishten aq shumë ishte ndikuar nga arabishtja dhe persishtja, sa që nga familja e gjuhëve turanike kishin mbetur vetëm rregullat, kurse leksiku në pjesën më të madhe ka qenë i huazuar nga arabishtja dhe persishtja.

Arabishtja në kontakt me turqishten, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, edhe është ndikuar nga turqishtja. Vlen të përmendet ndikimi i turqishtes në të folmen e Irakut. Ky dialekt i arabishtes ka qenë i ndikuar si në fushën e leksikut ashtu edhe në atë fonetik. Aty hasen disa bashkëtingëllore të cilat nuk janë karakteristike të arabishtes.<sup>46</sup>

Ndikimi i arabishtes tek disa gjuhë evropiane ndodhë pikërisht gjatë kryqëzatave. Mjaft gjuhë evropiane, në kontakt me arabishten, kanë huazuar një numër jo të pakt të leksikut i sajë. Ndikimi i arabishtes, në masë më të konsiderueshme, është prezente te gjuha spanjolle dhe portugeze, pra në zonat që dikur janë quajtur Andaluzi. Ky ndikim është pasojë e sundimit të perandorisë arabe në këto zona për shekuj me radhë. Huazimet e portugalishtes nga arabishtja kanë qenë aq të shumta sa që disa autorë kanë hartuar përmbledhje me huazime arabe.<sup>47</sup>

Titus Burchardt për vullin arab të shekullit të shtatë thotë se impulsin fetar islam, do të ishte vetëm një episod i historisë së Lindje së Mesme.<sup>48</sup> Mendoj se gjuha arabe pa Kur'ani, do të pësonte fatin e sirianishtes, aramishtes e disa gjuhëve tjera të lashta.

Karl Brokelman thekson se pavarësisht se gjuhët indoevropiane dhe ato semite dikur mund të kishin qenë të përafërta, por kjo ka mundur të ketë qenë shumë herët dhe nuk ka asnjë gjurmë që mund të dëshmojë këtë afërsi.<sup>49</sup>

<sup>45</sup> Dr. 'Alī Abdu-l-Vahid Vāfi, *Fikḥu-l-luġati*, (botimi i tretë) 2004, f. 154.

<sup>46</sup> Dr. 'Alī 'Abdu-l-Vāḥid Vāfi, 'Ilmu-l-luġa, f. 239, <http://ar.lib.eshia.ir/40628/1/239>.

<sup>47</sup> Dr. 'Alī 'Abdu-l-Vāḥid Vāfi, 'Ilmu-l-luġa, f. 239, <http://ar.lib.eshia.ir/40628/1/239>.

<sup>48</sup> Titus Burchardt, *Arti i Islam, gjuha dhe kuptime*, Logos A, Shkup, 2009, f.43.

<sup>49</sup> C. Borckelaman, *Fikḥu-l-luġāi-s-sāmiye*, Ğāmi'a 'Aynu- ṣ- Ṣems, 1977, f.12.



**Arsim CANOLLI**

## **AS “KUSHTETUTË” AS “PRIMITIVIZËM”: FTESË NË STUDIME ANTROPOLOGJIKE MBI KANUNIN**

Në opinionin e përgjithshëm shqiptar hetohen dy pikëpamje etiketuese mbi Kanunin: në një anë Kanuni etiketohet si “primitivizëm” e në anën tjetër emërtohet si “kushtetutë”. Kur mohohet si primitivëm, zakonisht afirmohet stereotipi se “Kanuni është burim i prapambetjes së shoqërisë shqiptare”. Ndërsa kur glorifikohet si “kushtetutë”, aludohet se kjo “kushtetutë na ka ruajtur qenësinë si komb”. Po ashtu Kanuni i Lekë Dukagjinit, pra libri, bëhet burim kryesor i studimit të sjelljes shqiptare, jo sjellja e përditshme qytetare sot. Këto pikëpamje etiketuese nuk janë vetëm në opinionin shqiptar; ato janë prezente edhe në opinionin e huaj mbi shqiptarët.

Zakonisht etiketimet e Kanunit dalin nga dikotomia: e dëshiruar dhe e turpshme. Një anë e identitetit të dëshiruar del si vazhdim i qasjes kulturaliste shqiptare, ku Kanuni interpretohet si kulturë monumentale e rendit shoqëror shqiptar. Sjellja sikur-ligjore, sikur-kushtetuese renditen si aspekte identitare të shqiptarëve në kontekstin e jetësës së tyre rezistuese, izoluese, të vetëqëndrueshme. Pra, ekziston një kthim diskursiv mbi Kanunin si relik i identitar, i cili reprezenton një frymë burimore të rendit shoqëror shqiptar pa autoritet sipëror, e cila duhet të shërbeh si bazë simbolike e rikonstruktimit identitar. Në anën tjetër, Kanuni shihet si një tirani tradicionale dhe interpretohet sikur të ishte një udhëzues mental primitiv që përshkon jetën politike, sociale, kulturore dhe ekonomike edhe sot. Kështu, edhe botëkuptimi i “Kanunit si relik” edhe botëkuptimi i “Kanunit si tirani dhe primitivizëm” ende mirren si premisa për studimin e sjelljes së sotshme shqiptare. Botëkuptimi parë i frymon një “pedagogji” të egzoticizimit dhe glorifikimit të Kanunit, ndërsa i dyti i frymon një “kritikë emancipuese” kundër Kanunit. Pra, në të dyja skajet, Kanuni lexohet, analizohet e kuptohet si kod statik i pandryshueshëm e jo si frymë konservativiste që ndryshon duke ruajtur një jehonë simbolike.

Këto pikëpamje etiketuese mbi Kanunin nuk dalin vetëm nga diskursi populist i kohës por duket se janë të ngjizura nga tradita e studimeve albanologjike. Në këtë kumtesë dua të paraqes një skicë të epistimologjisë studimore mbi Kanunin ku do të vë në pah qasjet studimore të cilat korrespondojnë me etiketimet e tilla të skajshme mbi

Kanunin. Edhe hapësira edhe qasja ime nistore në kërkimet antropologjike mbi Kanunin dhe kanunoren në përgjithësi më kufizojnë të ndalem në hollësi interpretative, të cilat do t'i artikulojmë më gjerësisht në të ardhmen. Andaj, reflektimi im do të jetë tejet përmbledhës dhe vetëm indicie e punës në vazhdim. Kjo kumtesë është një ftesë e shkurtër për t'u njohur me këtë proces studimor.

### **Epistemologjia e studimeve kanunore**

Ekzistojnë tri tipe apo frymë të përgjithshme studimore mbi Kanunin, të cilat ndërliqhen me kohë të caktuara. Studimet kanunore fillimisht i përshkon fryma romantike brenda fushës së albanologjisë, pastaj fryma ideologjike marksiste, e kultivuar kryesisht nën diktaturën komuniste dhe studimet kritike postsocialiste. Secila nga këto frymë i ka shtresëzimet, përjashtimet dhe ndërliqnitë e saja si nga ana e kohës dhe hapësirës ashtu edhe nga ana teorike dhe metodike. Sidoqoftë, në vijim dua të argumentoj se si frymë kanë premisa të dallueshme, përkundër faktit se mund të kenë edhe përputhje kahesh e metodash të përbashkëta.

### **Fryma romantike: kultura si relik**

Një ndër botëkuptimet kryesore mbi Kanunin është formësuar kryesisht nga studimet apo reflektimet që kanë konceptuar kulturën shqiptare si kulturë relikti. Sipas këtij botëkuptimi kultura shqiptare ekziston e fshehur në gërmadha; ajo duhet të hulumtohet dhe të studiohet dhe pastaj të prezantohet si “simbol reliktor” i origjinës, lashtësisë dhe qenësisë identitare. Këto studime dalin nga fryma albanologjike, ku fokus kryesor ka qenë gjetja, njohja dhe interpretimi i origjinës së shqiptarëve, gjuhës dhe kulturës së tyre të veçantë në mesin e popujëve në regjion dhe krahasimi i saj në gjuhën dhe kulturën indoevropiane. Edhe Kanuni është parë nga kjo pikëpamje.

Studimet mbi Kanunin i kanë fillet në shekullin XIX, ku edhe tradita dokesore, respektivisht institucionet juridike, qenë tema të studimeve albanologjike që nga George von Hahn-i.<sup>1</sup> Albanologët e hershëm nisën një lloj arkeologjie në sferën e gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare për të gjetur evidenca që janë burim i krahasueshëm në krahasime me popujt tjerë indoevropianë. Ata kërkonin në zona të izoluara ngase i ushqente perceptimi romantik se në këto zona ishin ruajtur tradita më të vjetra dhe më origjinale shqiptare. Shumica e këtyre kërkuesëve kishin funksione shtetërore si ambasadorë e konsuj. Padyshim se ekziston një lidhje mes lëvizjeve

---

<sup>1</sup> Von Hahn, J.G. (2013) *Studime Shqiptare*, Tiranë: IDK (originali në gjermanisht: *Albanesische Studien*, 1854)



politike shteformuese dhe dhe studimeve mbi shqiptarët në përgjithësi e të drejtën kanunore në veçanti. Nga studimet albanologjike të bëra kryesisht nga të huajt u inspiruan edhe rilindasit shqiptarë, veprat e të cilëve bëhen misionare për formimin e kombit shqiptar.

Kështu, në studimet shqiptare, “kultura relik” filloi të marrë udhën e tezës esencialiste për legjitimitetin nacional dhe kulturor dhe rrjedhimisht, për formimin e kombit dhe shtetit. Kjo shihet edhe në vetë tekstin e Kanunit të Lekë Dukagjinit, ku definohet kombi, citat i futur nga vetë Gjeçovi, por i inspiruar nga filozofia e Felice Toscano-së:

“Familjen e perbâjn gjindja e shpís; si të shtohen këta, dahren në vllazni, vllaznija në gjini, gjinija në fise, fiset në flamur e të gjith zbashkut permbliidhen në një Familje ma të hapët, e cila quhet Kóm, e kan një atme, një gjak, një giúhë, e doke” (*Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 1933, Libri 2, krye i dytë, nje i nadët, 19)

Natyrisht se studimet e tilla ishin ndërtuese dhe krijuan një traditë të ngjeshur të studimeve të para klasike në këtë fushë. Dhe duhet të theksojmë se në studimet e kulturalistëve shqiptarë si Gjeçovi, Fishta, Koliqi, etj., kultura si relik u bë objekti i tezës romantike-konservativiste “ndrysho për të ruajtur”. Kështu, në parathënien e tij të Kanunit të Lekë Dukagjinit, të botuar më 1933, Fishta e sheh Kanunin si “shprehje të shpirtit të kombit shqiptar”:

“Shifet kjartas, pra, se ligjët, per me kënë vertë të dobishme, posë se të drejta e të ndershme, do të jenë edhe të gjashme, due me thânë: të preme mas psihes e mbas nevojave të njimendta të popullit, qi do t’i majë, e se prandej fuqia ligjdhânse e një shteti, para se të pres një ligjë të ré, duhet t’a njoftë mirë shpirtin e popullit e t’i peshojë sa duhet nevojët e kohvet e të vendit, për të cillët ajo ligjë pritet. Përndryshe ligja është dhûnë e jo hullí jete. Prandej një filozof i madh thote, se ligja , para se me kenë ligjë, âsht një fakt –njí doke, zakon, „adet”, e se ligja e drejtë âsht të shprehunt e një fakti të vertetë – ligjë e kanunit populluer. Kta nuk do me thânë, se dokja, zakoni, „adeti” – kanuni të bâhet ligjë, pa kenë sanksjonue prej auktoritetit, por don me thânë se një auktoritet i drejtë do të presë ligjët, tue pasë gjithmonë para sÿsh doket, zakonet – kanunet e vendit”.<sup>2</sup>

Pra, premisat botëkuptimore të këtij konservativizmi shqiptar janë premisa që e kanë observuar kulturën si relik dhe lashtësinë e saj e kanë shndërruar në vlerë që

---

<sup>2</sup> Fishta, Gj. (1933) ‘Kanuni i Lekë Dukagjinit; Parathâne’ në Gjeçovi, Sh. *Kanuni i Lekë Dukagjinit, Vëper postume*, Shkoder: Shtypshkronja françeskane, fq. xxv-i.

duhet ndryshuar duke e ruajtur. Propozimi i Fishtës për ligjvënësit shqiptarë të kohës që t'i presin ligjet e shtetit të bazuara në traditën dokesore, nuk duket të ketë tendencë transformative utopike por intencë konservativiste. Shteti sipas tij shteti “arsye kâ *soveranin* qi e individualizon e njiheri konkreton pamvaresinë e lirin e tij: mende, kâ auktoritetin ekzekutiv; vullndesë, *auktoitetin ekzekutiv*: ndërgegje *auktoitetin judicjar*, e qi të gjithë janë të përbashkët e mbahen e veprojnë me mjete të perbashkta”.<sup>3</sup> Ai e shihte shtetin si një kolektivitet të bashkuar, por me pushtete të ndara. Ai kërkon që baza e këtij shteti të jetë *njeriu i gjytnuem*. Fishta nuk e përkrah idenë që “kanuni të bahet ligjë” por kërkon që autoriteti ligjvënës i shtetit modern të ketë parasysh doket e vendit.

Pra, kjo frymë studimore ndonëse shquhet për një perceptim romantik të Kanunit jep edhe premiset e një filozofia konservativiste në mendimin shqiptar. Këtyre studimeve iu bashkëngjiti edhe shkolla juridike italiane bërë e reprezentuar nga studiues si Castelleti, Villari, etj. Edhe këtu Kanuni barazohet kryesisht me institucionet penale si gjakmarrja, besa, nderi, etj.

Pra, premiset studimore dhe botëkuptimore të albanologëve të huaj dhe vendas, të shekullit XIX dhe fillim shekullit XX, pothuajse deri në Luftën e Dytë Botërore ishin mjaft romantike. Këto premisa u bënë edhe fille të mendimit konservativist shqiptar. Mirëpo, më vonë me avancimin e ideologjisë komuniste në Evropë, si një projekt transformativ, çlirues dhe utopik, studimet romantike u sforcuan me nuanca ideologjike, duke krijuar fundamentet e shpjegimit marksist-enverist mbi traditën e sjelljes së malësorëve të prapambetur e “zakonin” e tyre në veçanti.

### **Kanuni si tirani**

Me përqaftimin e komunizmit dhe ideologjisë marksiste shumë nga institucionet akademike të Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe Shqipërinë, u transformuan në tribuna ideologjike të cilat shndërruan impulset romantike të studimit të kulturës në strategji ideologjike të harmonizimit të kulturës tradicionale me kulturën e re socialiste. Ky harmonizim në aspektin teorik objektifikoi diskursin e njohur si nacionalizmi marksist, i cili përshkoi gjithë studimet shqiptare të epistemes komuniste. Në esencë, harmonizimi nënkuptontesë pari spastrimin e “kopshtit nga ferrat” e pastaj “zhvillimin e revolucionit kulturor”.

Kësisoj, filluan premiset e reja botëkuptimore e studimore mbi kulturën e traditën shqiptare. Kanuni vazhdoi të piketohet si kulturë statike, por qasja ndaj tij

<sup>3</sup> Fishta, Gj. (1933) ‘Kanuni i Lekë Dukagjinit; Parathâne’ në Gjeçovi, Sh. *Kanuni i Lekë Dukagjinit, Vëper postume*, Shkoder: Shtypshkronja françeskane, fq. xxx.

ndryshoi. Tani Kanuni nuk duhej të dryshohej për t'u ruajtur, por duhej të luftohej, të zhdukej, dhe të çrrënjosej, që dalin si tri fjalët kryesore të diskursit të kësaj fryme studimore. Tradita ishte “mbeturinë”, “prapambetje” dhe studimet e reja duhej të viheshin në shërbim të luftës ndaj kësaj tradite dhe ndërtimit të njeriut të ri dhe emancipimit të shoqërisë.<sup>4</sup>

Njeriu i Kanunit shihej si i pashpresë. Ai merrej si njeri që ka bindje automatike ndaj traditës kanunore. Në shembujt që dalin nga letërsia dhe arti në përgjithësi shihet se ai nuk mund të çlirohej vetë nga vargonjtë e traditës kanunore që konsiderohej si reaksionare. Pra, sipas ideologjisë komuniste ai duhej të çlirohej duke duke u transformuar tërësisht në Njeri të Ri. Kështu u krijua imazhi i njeriut të Kanunit si njeri që duhet të vdes ose si njeri që duhet të luftohet pandërpre në mënyrë që të transformohet tërësisht përmes revolucionit kulturor.

Sidoqoftë, tagri studimor iu la etnologjisë apo shkencës së traditës siç quhej ajo, gjithmonë nën mbikqyrjen e historisë.<sup>5</sup> Etnologjisë i duhej të ecte nëpër teh shpate, në një anë i duhej të balanconte pasurinë e traditës si vepër e popullit, në anën tjetër i duhej të pasqyronte se populli po emancipohej përmes udhëzimit të socializmit dhe po flakte mënyrën arkaike të të jetuarit. Pra, në një anë përfaqonte nacionalizmin marksist të ndërtuar mbi ideologjinë e traditës e kulturës popullore, e në anën tjetër rekomandonte luftën ndaj çdo ideje apo veprimi të natyrshëm kulturor që nuk përkonte me udhëzueshmërinë enveriste marksiste mbi pastërtinë e traditës. Duhej të ndërtohej “relikta” e re, e pastër, e bazuar në shkencën që aprovohet vetëm nga marksizmi, pa traditë, pa baltë, pa erë të keqe, por me traditë selektive.

Në këtë vazhdë, vërehet se sistemi totalitar kishte dhënë instruksione ideologjike cenzuruese për temat dhe qasjen teorike dhe metodologjike në etnologji. Për hir të këtij argumenti tashmë të njohur, po sjellim vetëm një shembull të literaturës etnologjike gjatë periudhës së sundimit ideologjik marksist-enverist.

Le të marrin Konferencën Kombëtare të Studimeve Etnografike të vitit 1976, kur etnografia/etnologjia, në funksion të historisë, mendohej si kishte arritur një zenit të pjekurisë si “shkencë e traditës”.<sup>6</sup> Nëse lexojmë përmbledhjen e kësaj konference vërejmë se pothuajse secili ese në atë konferencë (shumica e të cilëve qenë të shkruar

---

<sup>4</sup> Për reflektime mbi statusin e Kanunit gjatë periudhës komuniste shih Bardhoshi, N. (2012) ‘Albanian Communism and Legal Pluralism. The Question of Kanun Continuity’, in *Ethnologia Balkanica*, 16 / 2012,107-125

<sup>5</sup> Shih Kodra, A. (2010) ‘Marrëdhënia ndërmjet historisë dhe etnografisë gjatë periudhës së socializmit në Shqipëri – çfarë mund të ndryshojmë sot?’ në “*Albanologji 1*”, Nr. 1, IAP, Prishtinë: 269-288

<sup>6</sup> Shih *Konferenca kombëtare e studimeve etnografike*, ASHASH, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë, Tiranë, 1977. Përmbledhje nga konferenca e mbajtur më 28-30 Qershor 1976.

nga historianët) ndjek të njëjtin model teorik dhe ideologjik. Në përgjithësi, shkrimet nisin me lejemarrjen ideologjike duke cituar Marx-in, Enver Hoxhën, Engels-in dhe vetë Çlirimin e vendit, Revolucionin apo Partinë. Pas këtij kalibrimi me botëkuptimin teorik ideologjik, shkrimi vazhdon me temën e caktuar, duke hyrë në përshkrim të objektit të studimit. Nuk përjashtohen disa autorë punimet e të cilëve janë përshkrime të përpikëta të dokeve dhe traditave dhe lexohen si përshkrime të rrjedhshme. Po ashtu hetohen impulse të mirëfillta të cilat mëtojnë t'i ikin kornizave teorike cenzuruese. Por, pas ndonjë citati, dhe vlerësimi, shkrimi zakonisht mbyllet me rekomandimin emancipues: çka duhet të bëhet që të “luftohet” në një anë dhe “zhvillohet” në anën tjetër jeta socialiste e cila bart në vete traditën a kulturën popullore e tradicionale, e në rastete relevante Kanunin.

Për shembull, eseja e Ismet Elezit “Mbi disa tipare të së drejtës zakonore”, e dhënë në këtë konferencë, është ese arketipe në studimet kanunore të subvencionuara nga ideologjia marksiste-komuniste. Elezi bën një “shartim balancues” me tipareve të së drejtës zakonore me idenë egalitariste komuniste, duke mbrojtur ato tipare që përkojnë me pastërtinë e komunizmit, si nderi, demokracia direkte në kuvende, etj. Eseja bën apologji relativiste mbi tipare të Kanunit dhe tumirë aspekte të cilat përkojnë me “luftën socialiste” dhe në fund jep rekomandimin emancipues:

“Shkenca jonë socialiste .... hedh poshtë pikëpamjet e përfaqësuesit të klerit e të konservatorizmit shqiptar Gjergj Fishta, i cili konsideronte Kanunin e Lekë Dukagjinit si “burim kryesor” për të hartuar ligjet e shtetit shqiptar....Rendi ynë socialist dhe ideologjia marksiste-leniniste e partisë sonë janë në kundërshtim të hapët me zakonet prapanike e konservatore të kanuneve. Partia dhe shoku Enver, veçanërisht në fjalimin historik të 6 shkurtit 1967, ngritën në këmbë opinionin shoqëror kundër koncepteve patriarkore-fisnore e feudale, kundër koncepteve e mbeturinave të kanuneve, të cilat pengojnë emancipimin e plotë të gruas dhe ecjen përpara të shoqërisë sonë socialiste.”<sup>7</sup>

Pra, siç vërehet në këtë ese fryma ideologjike e trajtimit të Kanunit kishte prodhuar një model studimi dhe interpretimit të Kanuni dhe traditës në përgjithësi. Studiuesi shqiptar në përgjithësi, dhe etnologu në veçanti, duhej të jipte receta pastruese dhe shëruese duke përcaktuar atë që duhej të luftohej dhe atë që duhej të pastrohej e të ruhej si resurs burimor për tezën marksiste. Kjo lloj terapie ideologjike për traditën krijoi një model ideologjik të interpretimit të traditës. Si model paraqiste

<sup>7</sup> Shih Elezi, I. (1977) “Mbi disa tipare të së drejtës zakonore shqiptare” në *Konferenca kombëtare e Studimeve etnografike*, ASHASH, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë, Tiranë, 1977. Përmbledhje nga konferenca e mbajtur më 28-30 Qershor 1976, fq. 214

aspektin shkencor, i cili ishte vetëm marksist, aspektin nacional, që mëtonte të glorifikonte lashtësinë egalitariste dhe qëndresën stoike si analogji të komunizmit modern dhe aspektin emancipues modernist, që në emër të përmirësimit, mëtoi të transformonte radikalisht shoqërinë shqiptare.

### **Kritika postsocialiste**

Pas rënies së komunizmit, në fushën e studimeve mbi Kanunin prijnë studimet antropologjike. Disa antropologë të huaj, gjermanë, anglezë, dhe të tjerë përvjelin mëngët që të bëjnë hulumtimet e tyre në shoqërinë shqiptare, kryesisht në Shqipëri, por edhe në Kosovë, sidomos pas luftës, dhe të vëzhgojnë se si në të vërtetë gjallojnë shqiptarët pas rënies së sistemit komunist.<sup>8</sup>

Kështu lindin teza të ndryshme mbi sjelljen e shqiptarëve në periudhën postkomuniste e cila shpeshherë quhet edhe vetëm si “postsocialiste”. Në librin e saj “Mbijetesë në postkomunizëm” antropologja britaneze, Clarissa de Waal<sup>9</sup>, reflekton mbi gjendjen në Shqipërinë e viteve 90 dhe gjen se informantët e saj, shqiptarë të zakonshëm të Shqipërisë gjithnjë pëshpërisin: “s’ka shtet, s’ka lig”. Po ashtu antropologu britanez, Douglas Saltmarshe<sup>10</sup> argumenton se Shqipëria postkomuniste karakterizohet nga një “ritradicionalizim” apo një kthim i shpejtë i traditës parakomuniste, respektivisht i Kanunit në rregullimit e jetës së përditshme. Antropologu gjerman, Stephan Voel<sup>11</sup>, Kanunin dhe sjelljen kanunore e quan “habitus” duke u rreshtuar në teorinë e habitusit të argumentuar nga sociologu francez Pierre Bourdieu. Antropologja gjermane Stephanie Schwandner-Sievers<sup>12</sup>

---

<sup>8</sup> Shih një reflektim të shkurtër të Bardhoshi, N. (2011) ‘Studiuesit e huaj mbi Shqipërinë Post-socialiste’ në *Kultura Popullore*, Nr. 1–2, fq. 82–96

<sup>9</sup> De Waal, C. (2005), *Albania Today: A Portrait of Post-Communist Turbulence*, London: IB Tauris

<sup>10</sup> Saltmarshe, D. (2001), *Identity in a Post-Communist Balkan State: An Albanian Village Study*, Aldershot: Ashgate

<sup>11</sup> Voell, S. (2003) ‘The Kanun in the City: Albanian Customary Law as a Habitus and Its Persistence in the Suburb of Tirana, Bathore’ in *Anthropos* (Sankt Augustin) 98, 1: 85 -101, *Das Noralbanische Gewohnheitsrecht und seine mündliche Dimension* (Reihe Curupira, 17) Marburg, Curupira.

<sup>12</sup> Schwandner-Sievers, S. & Di Lellio, A. (2006) ‘Sacred Journey to a Nation: Site Sacralisation and ‘Political Reproduction’ of a New Shrine to the Kosovo Nation’, *Journeys: The international journal of travel and travel writing*, vol. 7, no 1 (January), pp. 27 – 49. Shih po ashtu shkrimet tjera të mëhershme të listuara në tezën e saj të doktoratës Schwandner-Sievers, S. (2012) *Invoking a Culture – Deploying a Pas Albanian Identifications and Translocal Encounters*, Department of Social Sciences, University of Roehampton.

argumenton se Kanuni apo narrativët e bazuar në traditën kanunore janë burim konceptual i identitetit politik, repsketivisht i zhvillimit të marrëdhënieve të pushtetit.

Pra, shumica nga këto studime postsocialiste, kanë një të përbashkët: frymën kritike e cila sheh krijimin e pushtetit përmes shpikjes së traditës apo ritradicionalizimit. Sipas kësaj fryme studimore, “relikti” po shfrytëzohet për pushtet. Kritika këtu bie mbi “shfrytëzimin” apo “eksploitimin” e Kanunit që e bëjnë njerzit që kërkojnë pushtet e përfaqësim publik.

Lavrimit antropologjik mbi të drejtën kanunore (kryesht atë mbi pronën) respektivisht ligjin si process brenda kosmologjisë së pluralizmit ligjor e ka nisur antropologu shqiptar Nebi Bardhoshi.<sup>13</sup> Kështu studimet shqiptare mbi Kanunin kanë filluar të marrin udhëne studimeve antropologjike të cilat fokusohen jo vetëm në relikte e simbole por në jetë sociale ku përthehen sjellja e ashtuuajtur kanunore. Kësisoj, Kanuni ka filluar të studiohet jo vetëm si e drejtë penale por edhe si përditshmëri sociale, civile e kulturore. Natyrisht se shumë nga këto studime vijnë si një freski studimore mbi Kanunin.

### Etiketimet

Antropologjia e Kanunit mund të zhvillohen si fushë interdisiplinare, pa projeksione, emancipime e glorifikime, por si udhë me aspirata normale studimore, duke dashur ta rrokë e studiojë sjelljen njerëzore civile shqiptare (brenda kontekstit të saj kulturor, social e politik). A mund të bëjmë antropologji të Kanunit pa e përmendur Kanunin fare? Mendoj se kjo është sfida e antropologjisë shqiptare sot e tutje.

Pra, po përfundoj duke cekur sesfida kryesore e antropologjisë së sotshme shqiptare por edhe studimeve shqiptare në përgjithësi është vëzhgimi i thukët i marrëdhënieve sociale, kulturore, ekonomike dhe politike në vende të caktuar të Kosovës, duke e parë të drejtën, ligjin dhe traditën dokesore në kontekstin e tyre të përditshëm. Mendoj se antropologjia e Kanunit duhet të flak eklektizmat metodologjikë dhe botëkuptimorë duke hapur shtegun e saj për të studiuar sjelljen tonë të përditshme në raport me tjetrin, shtetin, kontratën shoqërore në *polisin* shqiptar, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, si brenda jetës familjare ashtu edhe brenda asaj publike, si aspektet penale ashtu edhe ato civile, si sferën pronësore ashtu edhe atë ekonomike, burokratike, ndërmarrësore, etj. Nuk mund të njihet e as interpretohet kozmologjia kanunore vetëm nga libri i kodifikuar nga Gjecovi. Nëse libri bëhet resursi kryesor për njohjen e Kanunit atëherë kemi të bëjmë me një lexim të

<sup>13</sup> Shih Bardhoshi, N (2011) *Gurtë e kufinit*, Tiranë:UET Press

një teksti të kodifikuar e jo të një tradite sjelljeje në jetën publike dhe private të shqiptarëve të sotshëm. Kur lexohet vetëm teksti, hulumtuesi mund të bie në grackën e leximit për të gjetur vetëm shenja, strukturë dhe analogji. Ky lexim ka rrezik të bëhet si tendencë ideologjike për të “hetuar” ku janë të mirat dhe të këqijat e Kanunit, si po u shfrytëzuaka Kanuni, si po legjituaka mentaliteti “kanunor”, etj. Teskti i Gjecovit dhe sjellja jonë sot, megjithatë ndryshojnë mjaft shumë. Teksti është një kodifikim i normave dokesore që Martin Camaj i quan “maksima”, ndërsa antropologjisë i intereson edhe shtegu kulturor i krijimit dhe negociomit të këtyre maksimave në përditshmëri. Asaj i intereson praktika e përditshme dhe kreativiteti njerëzor që negocion me traditën.

Njohja e Kanunit, shtetit, ligjit, sjelljeve, kulturës, e të gjitha ndeshrashjeve mes tyre, është njohje që duhet t’i inspirojë njerëzit që, mbi të gjitha, ta respektojnë dhe ta duan, ta kultivojnë dhe ta mbrojnë lirinë. Duke e dashur, kultivuar dhe mbrojtur lirinë ata kurrë nuk do të kurthohen në “kornizat” rreth saj. Antropologjia e mirëfilltë e Kanunit nuk duhet të inspirojë studime etiketuese, dogmatike, e ideologjike por studime akademike, që bëhen për hir të dijes dhe lirisë, jo përmes apo për hir të diçkaje tjetër, por vetëm për hir të tyre.





Arian KRASNIQI

## TEATRI NË KOSOVË DHE DRAMA SHQIPE SOT

Ndryshe prej vendeve të tjera, në Kosovë, fillet, formësimi dhe zhvillimi i dramës dhe teatrit historikisht është dukshëm më i vonshëm. Kështuqë, historia e shkrimit të dramës dhe formimit të teatrit si institucion, është e re dhe si kohë shënohet me periudhën e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (1944). Mirëpo, asnjëherë nuk është përjashtuar mundësia që edhe më herët, qysh para kësaj kohe, në vise të ndryshme të Kosovës individë entuziastë me prirje të veçanta për artet skenike të jenë mbledhur në grupe dhe të kenë realizuar shfaqje dhe performanca të shumëllojta, natyrisht të karakterit joprofesional, pra të nivelit amator. Megjithatë, themelimi i Teatrit Kombëtar të Kosovës<sup>1</sup>, më 1946, shënon fillimin e organizimit institucional të jetës teatrore në vendin tonë.

Më pas, vargut të teatrove profesionistë i shtohen edhe teatrot e qyteteve: Gjakovë, Pejë, Prizren, Gjiilan, e shumë më vonë edhe në Ferizaj e Mitrovicë.

Vitet e '90-ta shënojnë periudhën e okupimit klasik të Kosovës nga regjimi serb i asaj kohe, me ç'rast jeta teatrore por edhe ajo kulturore në Kosovë, pothuajse ishte inekzistente dhe mbahej në jetë në sajë të organizimeve sporadike të aktiviteteve dhe manifetsimeve kulturore gati gjysmë-ilegale. Këtu dhe në këtë kohë përjashtim bën Teatri "Dodona"<sup>2</sup>. I vendosur në një ndërtesë në një kthinë të qytetit të Prishtinës, ky teatër, për mëse një dekadë, në rrethana okupimi e lufte, u shndërrua në një oazë të aktiviteteve teatrore dhe jashtëteatrore. Për shkak të rolit të asokohëshëm, Teatri "Dodona" identifikohet me të ashtuquajturën "rezistencë kulturore skenike" e viteve

---

<sup>1</sup>Teatri Kombëtar i Kosovës (në fillim me emrin Teatri Popullor Rajonal e pastaj Teatri Popullor Krahinor) u themelua në tetor të vitit 1946 në Prizren. Ky ishte institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Shumë shpejt, disa muaj pas themelimit, ky teatër u transferua në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Shfaqjet e para të këtij teatri janë punuar kryesisht nga artistët amatorë, entuziastë e idealistë të talentuar, të ndihmuar nga artistët profesionistë nga hapësirat tjera të ish-Jugosllavisë, ndërkohë që, në vitet '60, ansambli i tij pasurohet me kadro të reja profesioniste.

<sup>2</sup>Teatri i Qytetit të Prishtinës - "Dodona" (*më parë i njohur si Teatri i të Rinjve, Fëmijëve dhe i Kukulave - "Dodona"*), është themeluar me 12 nëntor 1986, me vendim të Bashkësisë punuese të KK të Prishtinës.

’90.

## 1. Teatri i (mbas)luftës

Ndërkohë, vitet e mbasluftës, bashkë me lirinë, i sollën Kosovës edhe kushte dhe mundësi më të mira për organizimin, zhvillimin dhe promovimin e teatrit dhe dramës. Teatri Kombëtar i Kosovës zgjodhi që në krye të kalendarit të tij artistik ta vendos një nga kryeveprat e dramaturgisë botërore; “Hamletin” të William Shakespeare, me regjisor anglezin David Gothard.

*“Hamleti” u realizua si një spektakël që ngre para publikut shqiptar dilemën për hakmarrje. Njëri nga aktorët e shfaqjes, në një mezoskenë, i rrëfen publikut ndodhinë e tij personale. Gjatë luftës ai ishte rrëmbyer nga ushtarë serbë. Ata pasi e kanë rrabur i kanë atij kërkuar të deklamojë diçka nga Shkëspiri. Aktori ka zgjedhur monologun “Të jesh apo të mos jesh” nga Hamleti, dilemë kjo, që gjithsesi në ato momente ka korresponduar me dilemën e tij: a do të vdes apo do të mbetet i gjallë?<sup>3</sup>*

Vënia në skenë e kësaj shfaqjeje, fill me të mbaruar lufta, u pa si një parashenjë e një fryme dhe një tendecë për zhvillimet e mëpastajme në teatrot e Kosovës, ku bukur shpesh, edhe sot, shfaqjet që kanë për temë luftën anojnë kah teatri dokumentar, *ku përmes patosit evokuohen kujtime nga lufta.*<sup>4</sup>

Në dhjetëvjetëshin e fundit, drama dhe teatri në Kosovë nuk janë zhvilluar jashtë kontekstit të gjithëmbarshtëm politik dhe socio-kulturor të vendit tonë. Edhe më tutje, domeni i organizimit dhe zhvillimit të jetës teatrore mbetet vija institucionale, ku përveç Teatrit Kombëtar, aktualisht edhe në gjashtë qytete tjera të Kosovës funksionojnë teatro publikë të cilëve ligjerisht iu është njohur statusi i *teatrit profesionist*.<sup>5</sup>

Në këto rrethana, veprimtaria menaxhuese dhe artistike e këtyre teatrove, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ka qenë dhe vazhdon të jetë nën ndikimin e Ministrisë së Kulturës, përkatësisht politikave të dizajnuara dhe të impleментuara në varësi të interesave dhe preferencave të partive politike që kanë udhëhequr me këtë

<sup>3</sup> Neziraj, Jeton. “Teatri në Kosovë, sfidat në shtetin e ri”. *Teatri dhe Nacionalizmi*. Prishtinë, 2011. fq.178

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Përveç Teatrit Kombëtar të Kosovës, teatro tjera me statusin e teatrit profesionist janë: Teatri i Qytetit “Dodona” në Prishtinë, Teatri i Qytetit Gjakovë, Teatri i Qytetit Gjilan, Teatri i Qytetit “Istref Begolli” në Pejë, Teatri “Adriana Abdullahu” në Ferizaj, Teatri i Qytetit në Prizren, dhe Teatri i Qytetit në Mitrovicë.

dikaster qeveritar qysh prej mbarimit të luftës e deri më sot. Kësomënyre, praktikat e shumta të ndërhyrjeve të MKRS-së, por edhe të kryetarëve të komunave, në shkarkimin dhe emërimin e drejtorëve, si dhe të Këshillave Drejtuese në teatrot publikë, lehtësisht na sjellin të konstatimi se mendësia burokratike dhe centraliste e institucioneve qendrore dhe atyre lokale në Kosovë, teatrot publikë i ka vënë në një varësi totale materiale, duke lënë hapësirë dhe mundësi minimale për nisma të pavarura teatrore. Përfundim këtu bëjnë Teatri “ODA”, Qendra “Multimedia”, Teatri Laborator “LOJA”, “ArtPlolis” etj, të cilët janë themeluar dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre skenik në hapësira performuese alternative, brenda së cilave marrin jetë veprat e tyre skenike. Për fat të keq, këta janë shembujt e pakët të mbijetesës së zorshme së ndërmarrësive të pavarura teatrore; jashtë varësisë materiale nga institucionet vendore, por krejtësisht falë njerëzve vullnetmirë e artdashës, si dhe donatorëve ndërkombëtarë.

## 2. Dramaturgjia kombëtare përballë asaj botërore

Një ndër sidat e pamohueshme që e ka shoqëruar pandashëm zhvillimin e teatrit dhe dramës në Kosovë është edhe çështja e hartimit të politikave artistike të teatrove, apo siç njihet në diskursin profesional, *repertoire teatrore*. Prandaj, debati për dramën shqipe, si pjesë e politikave artistike të teatrove publikë ka dominuar zhvillimet teatrore përgjatë dhjetëvjetëshit të fundit.

Frymëzues dhe “prijetarë” të idesë së dominimit të dramaturgjisë shqipe kundrejt asaj botërore, në skenat e teatrove tona, janë kryesisht drejtuesit dhe menaxhuesit aktualë të teatrove publikë, përkatësisht ata, që në kohëra dhe momente të caktuara, rastisën të ishin pjesë e kabineteve qeveritare, ose edhe ata krijues oportunistë që tregohen lojalë ndaj secilës garniturë qeverisëse, të cilët në mungesë të potencës krijuese dhe ideve novative në teatërbërje, trumbetojnë idenë e domosdoshmërisë për prioritetizimin e dramaturgjisë shqipe karshi asaj botërore. Zatën, këta krijues, në saje të ndikimit dhe lidhjeve të tyre me qarqet politikbërëse kanë arritur që në Ligjin për Teatrot në Kosovë<sup>6</sup> ta inkorporojnë një nen që, në mënyrë eksplicite, e sanksionon përparisënë që duhet të ketë dramaturgjia shqipe në repertorin e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Ndërkaq, ky kodifikim ligjor u kundërshtua nga ata që ishin të një mendje se *plasimi dhe promovimi i ideve dhe i mesazheve me karakter “nacional” dhe aspekte tjera të kësaj natyre, janë vetëm disa nga asociacionet më të theksuara të mendësisë e botëkuptimit për hartimin e politikave të repertorit të të ashtuquajturve teatro kombëtare, të cilat në emër të identifikimit me*

---

<sup>6</sup> Ligji për Teatrot, Nr. 04/L – 106, Neni 15, pika 1.3.

*vlerat nacionale, para se hapjen dhe konvergjimin me vlerat universale, e preferojnë hermetizimin në geton nacionale*<sup>7</sup>.

Megjithkëtë, debati rreth Ligjit të ri për Teatrot, nuk e ka ndryshuar mendësinë e konceptimit, hartimit dhe realizimit të programeve artistike në teatrot publikë. Në këtë mënyrë, teatrot publikë, me theks të veçantë Teatri Kombëtar i Kosovës në vitet e fundit ka zhvilluar një politikë repertoreshke të tipit “politikisht korrekt”. Përveç kësaj, për më shumë, *praktikisht ky teatër (Teatri Kombëtar, v.j) nuk ka pasur asnjë fuqi të krijojë opinion ose të provokojë opinionin. Për shkak të krizës së vazhdueshme të publikut, roli i tij ka qenë marginal. Përcaktimi për këtë rol “oportunist” besoj se ka qenë një prej faktorëve relevant që publiku ka refuzuar t’i vizitojë shfaqjet e këtij teatri*.<sup>8</sup>

Një veshtrim i lehtë mbi përmbajtjet e programeve artistike të teatrove publikë në Kosovën e pasluftës, na i nxjerr në pah emrat e autorëve shqiptarë, veprat e të cilëve janë vënë në skenë, emra këta që kryesisht i takojnë gjysmës së dytë të shekullit ’20, të cilët ndër vite janë identifikuar si autoritete krijuese letrare.

Veprat dramatike të autorëve: Anton Pashku, Ymer Shkreli, Azem Shkreli, Teki Dervishi, Beqir Musliu, Mehmet Kraja, Rexhep Qosja, etj, e deri te dramatizimet e romaneve të Ismal Kadarese janë inskenuar në skenat e teatrove publikë, në disa raste më shumë se dy herë. Kjo përzgjedhje e këtyre autorëve nga drejtuesit e teatrove përkon me mbizotërimin e idesë për mungesën e një dramaturgjie të re shqipe në Kosovë dhe për nevojën e orientimit programor artistik që e kthen teatrin tonë kah tradita, pra te dramaturgjia e cila në përmbajtjen e vet tematike lidhet me aspekte dhe ngjarje të veçanta të historisë sonë, duke krijuar, kështu, përfytyrimin e një tradite të dramaturgjisë shqipe që shpreh më së miri identitetin tonë kombëtar edhe kulturor.

Ndërkaq, krahas këtyre autorëve, me të cilët identifikohet edhe vet historia e shkrimit të dramës në Kosovë, nga auditorët e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës po shoh dritën edhe një brez i ri i dramatistëve, të cilët, me tekstet e tyre dramatike dita-ditës po i imponohen opinionit vendas dhe më gjerë. Megjithëse, simbas disa vlerësimeve përgjithësisht, *ky gjeneratë dramaturgësh vazhdon të krijojë mbi konturat e një tradite të formësuar, poetika e të cilës, përkundër disa prirjeve, tendencave dhe përjashtimeve individuale, kryesisht vazhdon të identifikohet me dorëshkrimin e traditës letrare të gjysmës së dytë të shekullit 20*.

Aktualisht, emrat më përfaqësues të këtij brezi dramaturgësh janë: Jeton Neziraj, Doruntina Basha, Ilir Gjocaj, Visar Krusha, Zymber Kelmendi, Mentor Haliti, Ag Apolloni, Albatros Rexhaj, Albana Muja, Arta Arifi, etj, dramet e të cilëve, përveç

<sup>7</sup> Lumi, Bekim, “Teatri, nacionalizmi dhe ‘patriotizmi artistik’”. *Teatri dhe Nacionalizmi*. Prishtinë, 2011. fq.138.

<sup>8</sup> Neziraj, Jeton. “Teatri në Kosovë, sfidat në shtetin e ri”. *Teatri dhe Nacionalizmi*. Prishtinë, 2011. fq.178.

në formë të shkruar, tashmë e kanë bërë jetën e tyre edhe në formën e inskenimeve të ndryshme brenda e, në disa raste, edhe jashtë Kosovës.

Këto individualitete *krijuese falë energjisë, përpjekjes, insistimit, provokimit dhe investimit të tyre, janë duke imponuar një diskurs të ri krijues në botën e vogël të jetës dhe të skenës teatrale të Kosovës.*

Ndryshe prej dramës, si gjini letrare por edhe si tekst i dedikuar për një medium siç është teatri, e cila edhe ashtu shkruhet pak në Kosovë, sfera e regjisë teatrale ka një traditë të pa shkëputur, e cila është ruajtur, kultivuar dhe zhvilluar edhe në vitet '90, me ç'rast asokohe disa të rinj përfunduan studimet për regji teatri në Universitetin e Arteve të Bukura në Tiranë, e disa edhe në vende tjera. Emrat si: Bekim Lumi, Ilir Bokshi, Agim Selimi, Florent Mehmeti, Fatos Berisha, etj, tashmë konsiderohen si brezi i mesëm i regjisorëve të teatrit që ka Kosova, të cilët, krahas brezit të vjetër të regjisorëve: Fadil Hysaj, Isa Qosja, Selami Taraku, Agim Sopi, etj, janë individualitetet që me kreacionet e tyre skenike u bënë pjesë e programeve të Teatrit Kombëtar por edhe teatrove tjera publike ndër këto vite. Këtu duhet përmendur edhe brezin e ri të regjisorëve që janë shkolluar dhe kanë filluar karrierën e tyre krijuese artistike mbas përfundimit të luftës: Elmaze Nura, Iliriana Arifi, Zana Hoxha-Krasniqi, Kushtrim Koliqi, Agon Myftari, Blerta Rrustemi etj., janë vetëm disa nga emrat, më të cilin në dekadën e fundit identifikohet ky brez regjisorësh teatri.

Por, nëse analizohet me kujdes puna e këtyre regjisorëve, të cilët janë më aktivë me produktet e tyre teatrale, shihet qartë se preference e tyre krijuese nuk anon kah tekstet e dramaturgjisë shqipe, por më shumë dominon prirja për përzgjedhjen e veprave të dramaturgjisë botërore, kryesisht atyre veprave që tashmë prej kohësh janë verifikuar si vlera të pakontestueshme në dramaturgjinë e përbotshme.

*Ndërsa, ata të paktit, që megjithatë, merren me dramaturgjinë shqipe, në të shumtën e rasteve s'bëjnë gjë tjetër, pos që përtypin disa kode e sbenja teatrale, që supozohet se i asocojnë publikut diçka nga "historia, kultura e tradita jonë kombëtare".<sup>9</sup>*

I pakënaqur me konceptimin, drejtimin dhe hartimin e politikave të repertorit në Teatrin Kombëtar të Kosovës por edhe në teatrot tjera, duke refuzuar çdo imponim dhe mentalitet provincial, diletantekst, e bunkerizues, regjisori më i veçantë e më kreativ që sot ka Kosova, Bekim Lumi, krijon kompaninë e vet teatrale, Teatrin

---

<sup>9</sup> Neziraj, Jeton. "Teatri në Kosovë, sfidat në shtetin e ri". *Teatri dhe Nacionalizmi*. Prishtinë, 2011. fq.182.

Laborator “LOJA”<sup>10</sup>, përmes së cilës kompani, jashtë godinave të teatroreve institucionale, krijon shfaqje të një dimensionit krejtësisht tejtër konceptual, estetik e artistik, me çka promovon edhe një brez të ri aktorësh, të cilët formësohen përmes një rruge të gjatë të punës laboratorike kërkimore në teatër.

Pasqyrat statistikore të programeve artistike të teatrove në Kosovë, të cilat i kemi nxjerr për nevoja të këtij punimi, e që përfshijnë periudhën kohore ndërmjet viteve 2000-2013, e tregojnë këtë raport të prezencës së dramaturgjisë shqipe dhe asaj botërore<sup>11</sup>:

Në teatrot publikë: Teatri Kombëtar i Kosovës në periudhën 2000-2013 ka realizuar gjithsej 86 premiera të shfaqjeve teatrore. Nga këto, 46 shfaqje kane qënë me tekste të autorëve botërorë, ndërsa 40 të atyre shqiptarë. Teatri i Gjakovës në periudhën 2000-2013 ka realizuar gjithsej 37 premiera, prej të cilava rezulton se 24 janë me tekste të dramaturgjisë shqipe dhe 13 të asaj botërore. Teatri i Qytetit në Gjiilan në 13 vjetët e fundit ka realizuar 44 shfaqje, në proporcion 24 me 18 në favor të dramaturgjisë shqipe. Ndërkaq, Teatri i Qytetit “Adriana Abdullahu” në Ferizaj ka ndjekur një politikë më baraspeshuese artistike, me ç’rast brenda kësaj periudhe ka realizuar 36 premiera, me një proporcion të barabartë të dramaturgjisë shqipe dhe asaj botërore, pra 16 shfaqje me tekste të autorëve shqiptarë dhe 16 të atyre botërorë. Të njëjtën logjikë e ka ndjekur edhe Teatri i Qytetit në Mitrovicë (*i cili në vitin 2011 e merr statusin e tetarit profesionit*), me ç’rast brenda kësaj periudhë tre vjeçare i ka realizuar gjashtë premiera, prej të cilave 3 i takojnë dramaturgjisë shqipe dhe 3 asaj botërore.

Sa i përket jetëgjatësisë së shfaqjeve në Teatrin Kombëtar të Kosovës, shfaqja që më së shumti ka qëndruar në programin artistik të këtij teatri, në periudhën e pasluftës, është shfaqja “Çifti Martin”, e bazuar në tekstin e Eugene Ionesco-s, dhe me regji të Bekim Lumit. Kjo shfaqje, e dhënë premierë më 2008, është shfaqur për publikun rregullisht deri më 2012, pra plot katër vjet, duke përfshirë këtu edhe disa pjësemarrje në Festivale Ndërkombëtare (Zvicër, Bullgari, etj.).

Ndërkaq, për teatrot e pavarura kemi këtë pasqyrë statistikore: Teatri ODA<sup>12</sup>, i cili teatër në periudhën 2003-2013 ka realizuar 25 premiera, prej tyre 14 me tekste të dramaturgjisë kombëtare dhe 11 me tekste të autorëve botërorë. Qendra “Multimedia”, prej themelimit më 2002 e deri më 2013, ka prodhuar dhe bashkë-prodhuar mbi dhjetë shfaqje dhe performanca teatrore. Pjesa më e madhe e produksionit të kësaj qendre, është ndërtuar mbi tekstet e dramaturgjisë shqipe, (*ku*

<sup>10</sup> <http://www.teatriloja.com/>,

<sup>11</sup> Këto statistika janë siguruar nga menaxhmentet e teatrove të përmendura në tekst, në periudhën korrik-gusht 2014.

<sup>12</sup> Krasniqi, Arian, *Oda artistike*, monografi. Prishtinë, ShB Oda, 2013.

*pjesa dërmuese e këtyre teksteve të inskenuara kanë për autor themeluesin dhe drejtuesin e kësaj kompanie teatrore, dramaturgun Jeton Neziraj). Teatri Laborator "LOJA", i themeluar tash së voni, ka realizuar 2 premiera që kanë pasë për bazë tekste të huaja.*

Për aq sa u tha mësipër, këto statistika mund të lexohen dhe interpretohen si rezultat i mungesës së planifikimit dhe orientimit të politikave artistike teatrore, ku repertoret e teatrove tona, veçanërisht atyre publikë, nuk janë në koherencë me trendet e programeve artistike të teatrove të rajonit e më gjerë.

Një dimension tjetër që paraqitet si sfidues për jetën teatrore në Kosovë është edhe mungesa e kritikës teatrore, si dhe botimeve të pakta të fushës teorike për dramën dhe teatrin. Përjashto këtu librat studimorë të Besim Rexhajt dhe Nebi Islamit, nuk kemi ndonjë botim tjetër për t'u veçuar. E ashtuquajtura kritikë teatrore realizohet nga gazetarët e medieve, të cilët përmes stilit përshkruar e natyrës informuese nuk vënë theksin me tone kritike te asnjë element i shfaqjes apo tekstit.

Kriza e publikut në teatër është e evidente. Arsyet janë të shumta; prej realizimit të shfaqjeve jociësore e deri të menaxhimi i dobët i këtyre teatrove. Përshkrimin më të mirë të pozicionit të tanishëm të teatrit në Kosovë ia bën shkrimtari dhe kritiku Musa Ramadani, i cili në njërin prej intervistave të tij të rralla shprehet: *"Në dhjetëvjetëshin e fundit, teatri e ka parë gjendjen e vet, pozicionin ku është: pakësimin e publikut, largimin e tij dhe ndërrimin e brezave! Shpesh këto gjendje justifikohet me fuqinë e internetit. Unë mendoj që këto s'është kërjet e vërtetë. Ai që dëshiron për të shkuar, patjetër e viziton teatrin. Edhe në kohë të sotme, ku dominon kibernetika, njeriu e ndjen nevojën për ta lexuar një libër, të mirë, të thellë, apo argëtues.*

*Duke qenë se në këto dhjetë vjetet e fundit, teatri ballafaqohet me këto kriza, sidomos me ndërrimin e brezave, hap pas hapi po shfaqet si nevojë dhe disi po krijohet një lloj teatri mikst-intermedial, ndërveprues"<sup>13</sup>.*

### 3. Përfundime

Në përfundim, duke e parë në dritën e fakteve gjendjen, pozicionin dhe zhvillimin e teatrit dhe dramës shqipe në vendin tonë, mund të themi se: për mëse një dekadë pas përfundimit të luftës, teatri ynë ende nuk po mund të organizohet, të frymojë, madje as zhvillohet dhe promovohet jashtë konjunkturave burokratike dhe mendësisë centraliste të institucioneve qeverisëse.

Mjedisi për themelimin dhe zhvillimin e teatrove të pavarura është dekurajues, prandaj çdo nismë për ndërmarrësi të pavarur teatrore është sfiduese dhe jo fort premtuese.

Teatri në Kosovë, përgjithësisht, vuan nga mungesa e vazhdueshme e publikut

<sup>13</sup> Ramadani, Musa, *intervistë. Loja, nr.5*. Prishtinë, 2012,

në ulëset e sallave për shkak të menaxhimit të dobët të tyre dhe politikave artistike jo-cilësore. Dramaturgjia e re në Kosovë, me disa përjashtime, nuk ka arritur të largohet nga ndikimi ideor, tematik dhe strukturor i dramaturgjisë së traditës, kryesisht asaj të gjymës së dytë të shekullit të kaluar, prandaj, është e besueshme se qasjet dhe shprehjet e reja ideore, tematike, stilistike në dramaturgjinë bashkëkohore shqipe janë të rralla, dhe lidhen me punën krijuese të fare pak dramatistëve të rinj.

*Tani teatri ynë është në kërkim. Madje, kështu ka qenë përherë. Në grishje të identiteti të vet.*<sup>14</sup>

Njëri ndër dramaturgët dhe burrështetasit e njohur botëror, Vaclav Havel, duke folur për raportin e teatrit me shoqërinë dhe shtetin shprehet: *“Një performancë e çmendur teatrore nga një grup i fanatikëve është pjesë e pluralizmit kulturor, dhe, si e tillë, ndihmon të zgjerojë fushën e lirisë pa paraqitur kërvënim për askënd. Një performancë e çmendur nga një politikan fanatik mund të çojë miliona njerëz drejt fatkeqësive të pafundme”*...

Derisa të gjithë ne jetojmë në këto kohëra të zhvillimeve dramatike politike, sociale, ekonomike, teknologjike etj, është më se e vërtetë se në Kosovë po na mungojnë performancat e çmendura dhe fanatikët e teatrit. Politikanë fanatikë me performancat e tyre të çmendura kemi me bollëk!

---

<sup>14</sup> Po aty.



Emilia CONFORTI, Aljula JUBANI BENGU

## SHKRIMTARË DHE STUDIUES ITALIANË PËR ROMANIN “LA SETE PIETRIFICATA” TË ANTON NIKË BERISHËS

Anton Nikë Berisha, studiuesi i letërsisë dhe profesor në Universitetin e Kalabrisë<sup>1</sup>, filloi botimet në Itali me studimet monografike “Vepra letrare e Martin Camajt” (1994) dhe “Ernes Koliqi poet dhe prozator” (1995). Më vonë ai botoi, në

---

<sup>1</sup> Anton Nikë Berisha lindi më 7 gusht 1946 në katundin Dobërdol, komuna e Klinës, Kosovë. Shkollën normale e mbaroi më 1966 në Prishtinë. Më 1971 mbaroi studimet në Fakultetin filozofik, Dega gjuhë e letërsi shqipe, të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më 1976 kreu studimet e rregullta pasuniversitare pranë Fakultetit filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe mori titullin e *magjistratit të filologjisë*. Po në këtë Universitet (më 1981) mbrojti tezën e doktoratës shkencore.

Gjatë vitit universitar 1978/79 realizoi një qëndrim studimor në RF të Gjermanisë (Universiteti i Göttingenit) si bursist i DAAD-së, ndërsa në vitet 1984/85 (në Universitetin e Göttingenit) dhe 1992/93 (në Universitetin e Münchenit) ishte bursist i *Alexander von Humboldt Stiftung*-ut.

Në Institutin albanologjik të Prishtinës punoi nga viti 1973; në fillim asistent, pastaj bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor.

Në vitin akademik 1992/93 (dy semestra) mbajti mësim në *Seminar für Allgemeine und Indogermanische Sprachwissenschaft* - në *Katedrën e albanologjisë* – Universiteti i Münchenit.

Nga nëntori i vitit 1993 punon në Katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare - Dipartimenti i linguitikës, Fakulteti i letërsisë dhe i filozofisë i Universitetit të Kalabrisë, ku tani është profesor i letërsisë shqipe.

Është anëtar i *Sindikatës të pavarur të shkrimtarëve italianë*.

Botoi një varg veprash me studime letrare dhe monografi (për Gjon Buzukun, Pjetër Budin, De Radën, Gj. Fishtë, Z. Skiroin, E. Koliqin, M. Camajn, M. Krasniqin, D. Vetmon, A. Shkreli), romane (për të rritur e për fëmijë), vëllime me materiale të letërsisë gojore, vëllime me poezi të zgjedhura të poetëve shqiptarë, punime në revista të ndryshme në shqip dhe në gjuhë të tjera, si dhe mori pjesë në shumë tubime letrare e shkencore të karakterit kombëtar e ndërkombëtar.

Nga gjermanishtja përktheu *Epin e Gilgameshit*, “Rilindja”, Prishtinë 1984, botimi i dytë dhe i tretë në Tiranë 1990, 2008; dhe këngën e parë dhe të pestë të *Këngës së Nibelungëve*, ndërsa nga italishtja poemën e Domeniko Korradinit H. Brusard *Lavdërimi i kryqëzuar*, Faik Konica, Prishtinë 2007.

Në vitin 1985 mori *Shpërblimin e dhjetorit* të KSA të Kosovës për letërsi për veprën *Teksti poetik*; më 2004 shpërblimin “Hivzi Sulejmani” për romanin *Nëna e dritës* dhe shpërblimin “Asdreni” për përkthimin poetik të *Epit të Gilgameshit* (Korçë qershor 2009) dhe më 2012 shpërblimin “Gjorge Mangone” të *Sindikatës të pavarur të shkrimtarëve italianë* për Kalabrinë dhe më 2014 shpërblimin “Azem Shkreli” të Komunës së Pejës.

gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane, një varg veprash të tjera. Nga ato në gjuhën italiane po përmend studimet *Tre saggi sull'opera di Giuseppe Schirò* (Palermo 1997), *Approccio ai canti albanesi dei prodi* (Cosenza 2010), pastaj vëllimet në dy gjuhët: *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Antologia della poesia orale arbëreshe.* (Catanzaro 1998)<sup>2</sup>, *Antologji e poezisë bashkëkohore arbëreshe. Antologia della poesia contemporanea italo-albanese* (Cosenza 1999)<sup>3</sup> dhe *Mbi veprën letrare të Dushko Vetmos. Sull'opera Letteraria di Dushko Vetmo. Studio* (2009).

Midis veprave të Anton Nikë Berishës të përkthyer në italisht që zgjuan një interesim të madh tek shkrimtarët dhe studiuesit italianë po përmend vëllimin poetik *Cascata di luce nel cuore*. Quattordici immagini sulla Grazia Divina di Agnese Gonxhe Bojaxhiu – Madre Teresa (Pellegrini Editore, Cosenza 2010, ribotuar më 2012)<sup>4</sup> dhe romanin *La sete pietrificata* (Pellegrini Editore, Cosenza 2013)<sup>5</sup>.

Në këtë kumtesë po ndalemi rreth mendimeve dhe vlerësimeve që shkrimtarë dhe studiues italianë shfaqen për romanin e tij *La sete pietrificata* (Etja e gurëzuar) me përkthim, që në të vërtetë është romani i botuar në Prishtinë në vitin 2002 “Gjin Bardhela i arbresh. Etja e gurëzuar”<sup>6</sup>. Po përmendim këtu faktin se ky roman i Berishës pati zgjuar interesimin dhe të studiuesve dhe shkrimtarëve shqiptarë, për çka dëshmon vëllimi *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar, botuar më 2006 në Prishtinë”<sup>7</sup>.

Për romanin “La sete pietrificata” deri më tani u botuan trembëdhjetë (13) punime në gjuhën italiane, pjesa më e madhe të përkthyer e të botuara edhe në gjuhën shqipe<sup>8</sup>.

Interesimi i madh dhe vlerësimet e larta që shkrimtarët dhe studiues italianë i bënë këtij romanit të Anton Nikë Berishës lidhet para së gjithash me stilin poetik dhe me mënyrën se si autori u është qasur dhe i ka shprehur dukuritë e ndryshme të botës arbëreshe dhe të botës shqiptare. Ngjarja është vendosur në katundin e lindjes së De Radës, në Maqi, ndërsa nëpërmjet kujtimeve e përsiatjeve përafrohet e bashkohet me

<sup>2</sup> Transkriptimin F. Altimari. Përkthimin V. Belmonte. Rubbettino, Soveria Mannelli, Catanzaro 1998.

<sup>3</sup> Përkthimet në italisht Vinçenc Belmonte. Centro Editoriale e Librario della Università degli Studi della Calabria, Cosenza 1999.

<sup>4</sup> *Në shqip Ujënarë drite në zemër. Katërbëdhjetë pamje të hirit hyjnor të Agneze Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze.* “Argeta – LMG”. Tiranë 2009. *Botimi i dytë nga e njëjta shtëpi botuese 2010.*

<sup>5</sup> Botimi në shqip, *Gjin Bardhela i arbëresh & Etja e gurëzuar*. Roman. “Faik Konica”, Prishtinë 2002.

<sup>6</sup> E boti shtëpia botuese “Faik Konica” e Prishtinës.

<sup>7</sup> *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”. Zgjedhi dhe përgatiti për shtyp Labinot Berisha. Botuan “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë 2006.

<sup>8</sup> Punimet i përkthyen në shqip Anton Nikë Berisha, Albana Alia dhe Griselda Doka.

botën shqiptare në përgjithësi.

Duke e njohur thellësisht letërsinë dhe botën arbëreshe dhe duke e gërshetuar atë me aspekte të ndryshme të botës gjithë shqiptare, autori ka krijuar një mozaik sa dramatik, aq dhe poetik, sa të veçantë aq edhe të vlefshëm. Elementi kryesor që e përcakton vlerën e këtij romani, siç e kanë thënë edhe autorët e punimeve kushtuar romanit, është gjuha poetike, përkatësisht stili artistikisht i ngritur, përmes të cilës është ndërtuar vepra dhe si e tillë komunikon me lexuesin.

Studiuesi dhe shkrimtari i shquar italian, Dante Maffia, duke vëzhguar botën poetike të romanit “La sete pietrificata” thekson: “Feja e të parëve, e mbrujtur me besime, besëtytni, mitologji, halucinacione, që, të gjitha së bashku krijojnë një kuadër të pasur me nuanca në përqsasjen - ballafaqimin jo gjithmonë të krahasueshëm mes tyre dhe kështu protagonistin e romanit, Gjini Bardhela i Ndrë Bua Petës, gjendet në pafundësinë e një udhëtimi metafizik që hap njëkohësisht portat e ferrit e të parajsës, që mbruhet (përftohet) hap pas hapi nga përvoja e cila i ofrohet nga kujtimet, nostalgjia, nëpërmjet përsiatjeve që shndërrohen në poezi të vërtetë. Do të shohim që në një moment të veçantë Gjini do të takojë jo rastësisht Jeronim de Radën, që do t'i mundësojë një përvojë të jashtëzakonshme duke përballur misterin e krijimit artistik”.

Duke folur për tekstin e romanit dhe të sistemit shprehës poetik që zbatohet në të, Dante Maffia shkruan: “Me aftësi të veçantë, Anton Nikë Berisha ndërlihd në kontekstin e romanit, nga njëra anë, legjendat e përrallat, si pjesë e traditave të rrënjësura të ngulimeve arbëreshe e, nga ana tjetër, edhe tërësinë e paragjykimeve që shkallë - shkallë janë shndërruar në një mënyrë të ekzistimit e të perceptimit të realitetit. Në këtë këndvështrim romani përfiton kuptime antropologjike të një efikasiteti të rrallë, edhe për faktin që vendos protagonistin në brendësi të një bote gati magjike, me pasoja që vënë në dukje shkaqe tashmë të rrënjësura e të metamorfozuara në një natyrë të dytë”. Shkrimtari Maffia thekson veçmas arkitekturën e përsosur të romanit: “Do të duhej të flitej për shumë gjëra të këtij romani, duke filluar nga kompleksiteti i tij e të përfundohet me vëzhgimet e hollësishme për botën shqiptare dhe atë arbëreshe; do të duhej të analizohej më gjatë struktura (e tekstit të romanit) që Anton Nikë Berisha e ndërton me përsosmërinë e një arkitekti e do të duhej të diskutohej më hollësisht për qëllimet dhe përfundimet në këndvështrimin ideologjik apo idealist, por ajo që më intereson më tepër është vënia në dukje e shtresëzimit poetik të krijesës së tij të lartë artistike, e artit të vetëdijshëm të vështrimit të argumenteve nëpërmjet sugjerimit poetik, por, në të njëjtën kohë, pasional e analitik. Në fund të fundit, një vepër letrare vlen më tepër për mënyrën se si paraqitet, për cilësinë e shprehjes së saj artistike”.

Edhe shkrimtari dhe studiuesi i shquar, Domenico Corradini H. Broussard, që

është edhe autor i pasthënies së romanit të përkthyer në italisht<sup>9</sup>, e vlerëson lart këtë vepër të Anton Nikë Berishës. Midis tjerash ai shkruan: “Dhe Gjini është një shtegtar i durueshëm, Odiseu i ri në kërkim të Itakës së vet. Me gjasë, së pari, takohet me natyrën: i duket dashamirëse në harmoninë mospërfillëse të formave e të ngjyrave, por, si te Leopardi, nuk vonon të zbulojë njerikën, burim i rrënojave dhe i kobeve, i vdekjes dhe i mjerimeve të tjera. Në vuajtjen e largimit nga atdheu i tij i vërtetë, Gjini i mbaron ditët e veta, dhe hija nuk vdes. Dhe nga hiri i vuajtjes së Gjinit, i pavetëdijshmi personal i Berishës, lind përsëri si feniks që tani sjell në dritën e diellit rrjetësimin e dhembjes, tehet e përzjarra, nga të cilat ndihet i shpuar tejprtej, kudhra dhe hallka që e kanë pikëlluar, por nuk e kanë ligështuar, dhe të gjitha veglat nga hekuri e zjarri që një herë i kishte dhe e kishin: një farkëtar me sy prej prushi, një që e godit veten në eshtra, në dej dhe në gjakun e tij nga frika se të tjerët do ta goditin më parë, më tepër se për frikën që t’i godasë të tjerët”.

Në vështrimin e vet Corradini thekson sidomos origjinalitetin në ndërtimin e romanit të Berishës: “Me prozë të pasur e të degëzuar, që për shkak të ndërveprimit të shumtë duket të ketë dalë nga burim i pasur i malit të lartë, Berisha ka pasur guximin të mos marrë si model të shkruarit, kryesisht të zbuluar (paratik) e të mërzitshëm [...] Ka pasur guximin ta përshkojë përsëri historinë e vuajtjeve të veta dhe të të tjerëve, të gjërave që do të ketë mundur t’i bëjë, por nuk i ka bërë e të atyre (gjërave) që do të ketë mundur t’i thotë, por nuk i ka thënë [...] Në varkën e anijembytësve, mu këtu e rimarr historinë e Gjinit, të dënuarin që e krijoi përsëri kosmogoninë. Një histori që Berisha e ka shkruar midis anktheve të furishme. Një histori e cila, pasi të lexohet, i përket njërit prej atyre romaneve, që të duket se nuk e ke pasur asnjëherë në dorë, për dëshirën që ta kesh përsëri [...] Te Berisha vendet gjeografike shndërrohen në vende të përfytyrimit (të imagjinatës), nuk e kanë një ‘ku’ e një ‘kur’, ndërsa koha, e çmuar në Perëndimin evropian si njëvijësore dhe njëdrejtimshe, copëzohet, siç ngjet njëjtë në ‘Waste Land’, ‘in a heap of broken images’, ku e sotmja bëhet e djeshme dhe e nesërme, e tashmja, e kaluara dhe e ardhshmja gërshetohen, valë të lartësuarra e shtjella, që, në të njëjtin oqean, herë ngrihen tek yjet e herë mbarojnë në përroskë. Tek ai është një kërkim gjuhësor që nuk e gjen te shkrimtarët e tjerë”.

Edhe Sergio Paolo Foresta, autor romanësh dhe përmbledhjesh me poezi dhe i një varg punimesh për letërsinë dhe dukuritë e ndryshme kulturore, i bën një vlerësim me rëndësi romanit *La sete pietrificata*: “[...] e kam përcjellë udhëtimin e Gjini Bardhelës, në druajtjet e tij të errëta. Në ankthin e kërkimit të caktit të dëshiruar e pastaj të

<sup>9</sup> Punimi i Corradini-t së pari u botua në vëllimin *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”. “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë 2006.

humbur. Deri tek thelbi i ndjesive dhe i personave që i qenë të dashur e që në njëfarë mënyre edhe u takonte, dhe me një mënyrë i kthehen në formën e kujtesës, duke mbetur pjesë e qenies, veçmas në çaste të pezullimit të ekzistencës. Në rrafshin letrar është një shtegtim homerik, virgilian, dantesk, pushkian, sipas Edgar Lee Masters. Është një përpjekje e rimarrjes (rikthimit) të indeve të jetës së atyre që na kanë paraprirë, të të parëve, të paraardhësve dhe të jetës sonë nëpërmjet të tyre. Është kërkimi i ecjes drejt tokës së premtuar, ku janë ëndrrat, dashuritë, idealet që na kanë ndihmuar të rritemi”. Në vijim të vlerësimit të tij Foresta, duke ia drejtuar autorit Berisha, thekson: “Ti shkruan: ne nuk i takojmë vetëm vetvetes, edhe atëherë kur vihemi në qendrën e këtij teatri tokësor. Po ashtu është e vërtetë që heshtja është hapi i parë drejt vdekjes. Ti shkruan edhe se fuqia (pushteti) krijoi gabime dhe gabimtarë! Duke parafrazuar: meqenëse kemi lindur e pastaj meqenëse kemi ndeshur në këtë jetë si mundësinë e vetme që na është dhënë, janë shkaktuar gabime dhe gabimtarë. Pajtohem: për ne shkrimtarët është e vërtetë e madhe: Kur të shkruarit bëhet vesi kryesor dhe kënaqësia më e madhe, vetëm vdekja mund t’i japë fund ( Ernest Hemiguj)”.

Gianni Mazzei, studiues, poet dhe prozator, vë në dukje se romani *La sete pietrificata* i Anton Nikë Berishës “Është një rrëfim i hapur, që zbulohet, që aktualizohet në kushte të reja dhe në nevoja të jetës, deri te vlerat dhe fjalët çelës (besa), sipas shenjave, romantike (nënkuptuar si individ i përfshirë në jetën e popullit e të natyrës, që nuk kënaqet me atë që ka e kërkon të pafundmen dhe absoluten) të shprehur në fillim të veprës, me mendimin e Lessing-ut, që lidhet me konceptin e kërkimit [...] Në këtë personazh Berisha ka dëshmuar aftësinë, fryt i njohjes së madhe letrare të përjetuar në ndjeshmërinë e artistit, ta rijetojë Kafkën, ‘Uliksin’ e Xhojsit, udhëtim simbolik, moral e metafizik të Dantes në ferr, po dhe ndryshimet e rëndësishme: mjafton të mendohet për këtë të fundit, risitë e gruas që shndërrohet në zërin e dhimbjes dhe, nga largësia, rrëfen në ‘rrethin’ e të burgosurve, për të pikëlluarit dhe të torturuarit politikë, duke i dhënë veprës një kuptimësi të frymës së gjerë, mjerisht, të aktualitetit të madh. *Unë* rrëfimtari, që është ndryshe nga ‘unë’, ka një shprehësi të vet lirike, ndërsa *unë* korale ka në të njëjtën kohë sintaksën e vet të ndjeshme, që u shmanget rregullave të veta të jetës reale, në një vizion ëndërrimtar në të cilin dyshimi, shprehur në personin e dytë, i zhvesh besimet dhe logjikshmërinë që në përditshmëri na japin një kthjelltësi dhe kuptim (edhe pse mashtrues) të jetesës”.

Shkrimtari Mazzei thekson se autori i romanit ia ka dalë të ndërlihtë realitetin me fiktivën dhe ëndrrën në formë të lartësuar: “Në këtë përmasë të zgjeruar dhe ëndërrimtare, shkrimtari e bashkon fjalën e lartësuar, të thuash një frymë dhe një logos, me traditën gojore, folklorin (valljet) poezinë, dashurinë, ëndrrat, bukurinë e

natyrës, nga e cili e veçanta dhe koha e ngushtë historike te secili individ duhet të marrë limfën dhe idealitetin nëse nuk do të zhduket dhe të mos bëjë që etja (jeta është kuptimi i saj i fshehtë) të bëhet më e paktë, pra të gurëzohet në shpirt, para përfundimit të saj natyror. Bukuria e kësaj vepre është në përjetimin edhe të pamjeve, e shkëlqimisë së natyrës dhe e misterit të saj, me përshkrime skajshmërisht të vlefshme e me lirizmin e fjalës, që ripërtërijnë (kjo dhe për meritën e përkthyeses) të folurit e thatë, fort të vjetruar të italishtes, i japin atij një nerv dhe vitalitet për pamjet dhe metaforat e reja [...] Te Berisha vërehet ky kujdes i devotshëm, kjo mahnitje për natyrën, qoftë për dukuritë e saj të mëdha (deti, stuhia etj.), qoftë për ato të voglat, duke bërë të kuptohet që mrekullia e të folurit është para së gjithash njësimi me jetën<sup>10</sup>”.

Edhe studiuesi dhe shkrimtari, Pasquale Maffeo e çmon lart romanin e Berishës “La sete pietrificata”, sidomos për stilin dhe për gjuhën poetike, sa të pasur aq të rrallë. Ai e quan autorin e romanit Kafka religjioz: “Mbizotërimi i llojit fantastik dhe variantet që lindin prej tij, rrëfimi lirik i rrjedhshëm, gjerësia gjeografike e pakufishme që sundon mikrokozmosin e Maqit arbëresh (Macchia), udhëtimet, imazhet, personazhet, zjarret e dashurisë dhe të pasionit, të gjitha këto elemente të romanit *La sete pietrificata* të Berishës e bëjnë këtë të jetë një vepër me përpjesëtime të gjera, e përshkruar nga një tension i veçantë që herë-herë shërben për t’i parë gjërat me kujdes, apo vetëm për t’i parë ato vagëllimthi e, herë të tjera, për të parashikuar një të vërtetë (me gjasë metaforike) të misterit të krijesës përballë krijuesit. E jo vetëm kaq, këto elemente më forcojnë bindjen për të thënë se Anton Nikë Berisha është Kafka i krishterë, ai i metamorfozave”.

Në mënyrë të veçantë Pasquale Maffeo thekson shpirtin hulumtues të autorit të romanit dhe aftësinë që t’i shprehë dukuritë e ndryshme në mënyrën poetike: “Te Berisha prozator, edhe në disa çaste poetike, bie në sy shkëndija e zanafillave perceptuese, një intuitë e jashtëzakonshme shpalos përpara syve qenie, ngjarje e mistere të largëta nëpër shekuj e mijëvjeçarë, të përhapura në një gjeografi të ndryshueshme vendesh e rajonesh të perceptuara e të transformuara në simbole të ekzistencës në mënyrë të rrufeshme *hic et nunc*, të çastit, që shpërbën kufijtë e zhbën distancat në qendërsinë e zjarrit krijues. Është mendja e veçantë hulumtuese që mbretëron sovranë duke ndjekur drejtimin e një ligji të përjetshëm dhe që shquhet në shpirtin e atij që, për shembull, ndërtoi një katedrale apo kreu një veprim të paharrueshëm, ose lundroi në zbulimin e botëve të reja [...] në romanin e tij Berisha u

<sup>10</sup> Punimi i prof. Mazzeit u lexua në promovimin e romanit mbajtur në Strigar (San Cosmo Albanese), vendlindja e poetit arbëresh, Zef Serembes, më 16 nëntor 2013, ku folën dhe prof. Françesko Altimari dhe kryetari i Bashkisë së Strigarit, Cosmo Azzinari (Kozmo Axinari).

jep kuptim dëshmime të një hulumtimi që, duke përmbysur rrafshet e realitetit empirik, të ngre peshë për të kundruar nga lart, për të mirëpritur, për të interpretuar imazhe, personazhe dhe ngjarje historikisht të largëta mes tyre, por të grumbulluara prej tij nën diellin e një të sotmeje të qëndrueshme që sanksionon shenjtërinë e enciklopedisë në udhëtim të mendimit njerëzor”.

Duke analizuar botën poetike të romanit të Berishës ligjëruesja në Universitetin e Kalabrisë, Fiorella De Rosa, shkruan: “Romani *Etja e gurëzuar* i Anton Nikë Berishës është shumë i veçantë, i ndërlikuar, i përpunuar mirë dhe i thellë, sepse gërmon në thellësi të shpirtit njerëzor për të mbledhur dridhmat më të fshehta dhe më të parrëfyeshme. Në qenësi, romani përmban në vete përvojën letrare të thellë dhe të pasur të autorit, e njëzuar me njohjen e mirëfilltë të teknikave të rrëfimit, që përkthimi shumë i kujdesshëm dhe i kërkuar i Albana Alisë e ka sjellë në një italishte të përkryer”.

Në përimitimin e mëtejshëm të këtij romani Fierella De Rosa thekson: “Mjeti kryesor i këtij pikëvështrimi të brendshëm të personazhit, është përdorimi i ligjëritit të tërthortë të lirë, që i mundëson autorit të dëshmojë shkathtësi dhe zhdërvjelltësi të madhe gjatë ndërtimit të bisedave dhe të mendimeve të personazhit në rrjedhshmërinë e rrëfimit, pa zgjidhje të dukshme të vazhdimësisë. Nga brendësia ‘flet’ gjithmonë zëri i rrëfimitarit, ndërsa personazhi ‘sheh’, ose kupton më mirë këndvështrimin e brendshëm, komplekset dhe rrjedhat e pakapshme të psikikës: në ligjërimin e rrëfimitarit ndërmjetëson monologu i tërthortë i personazhit. Pra, kemi të bëjmë me një analizë të hollësishme dhe të gjerë të ndijimeve të brendshme të personazhit, në të cilin procesi psikologjik, qoftë në lëkundjet dhe kthesat e tij, ruan një logjikë të qartë dhe koherente, që ndiqet në mënyrë lineare. Ndërgjegjja shndërrohet në një labirint me nyje të pazgjidhshme, ku gërshetohen ëndrra, çaste kthjelltësie, vlefshmëri të dyfishta<sup>11</sup>”.

Duke vështruar romanin e Anton Nikë Berishës, Nicola Morletti, autore e disa veprave në poezi dhe në prozë, shkruan në *Blog degli autori*: “Derisa nata në katund përhapet mes gurgullimës së pandërprerë të ujit të Lumit të Madh të Maqit dhe hijet zbresin lehtë dhe përngajnë në shtojzovalle të brishta, që ringjallen në ndërrime stinësh, mendimet ia mbushin plot kokën Gjin Bardhelës të Ndré Bua Petës, protagonistit të këtij libri shembullor, në të cilin fjala e shkruar e merr forcën nga rrënjët dhe nga zemra. Deti Jon është atje, përtej dritares, në një vjeshtë të vonë, i pafund dhe i errët. Flaka e bishtikut po shuhej dalëngadalë mbi tryezë. Kështu nis një

---

<sup>11</sup> Punimi i Fiorella De Rosa po ashtu u lexua në promovimin e romanit mbajtur më 16 nëntor 2013 në Strigar (San Cosmo Albanese), vendlindjen e poetit arbëresh, Zef Serembes.

roman i jetës dhe i dashurisë, i gëzimit dhe i dhembjes. Faqe të dendura të përmallimit e të *pathos*-it, të kujtimeve e të nostalgjive për origjinën. Një histori e rrënjëve të vyshkura, po jo të thara, siç e shpjegon Domenico Corradini H. Broussard, të rrënjëve të njoma nën peshën e dheut. Autori, me aftësinë eksplicite rrëfimore na shpie (tërheq) në një lexim pa kohë: e kaluara dhe e tashmja përftohen dhe e ardhmja është aty pranë, e heshtur. Duket sikur, nga oqeani i pafund, ngrihet në yje. Te Berisha është një hulumtim gjuhësor i jashtëzakonshëm, thujse proza dhe poezia të jenë një gjë e vetme. Dhe të njëjshme janë mendja dhe zemra. Një roman që të bën për vete, të pushton dhe të trondit, i përshkuar nga një forcë magjike, ashtu si ajo e dashurisë”.

Në një letër dërguar autorit, shkrimtarja Nicla Morletti, thotë ndër të tjera: “I ndershimi Anton Berisha, më lumturon shumë fakti se romani yt shumë i bukur është vlerësuar (nga Dante Maffia dhe disa shkrimtarë të tjerë italianë) ashtu siç e kam vlerësuar unë. Ju shkruani hyjnisht (Lei scrivo divinamente). Është i bukur recensionin i Dante Maffia-s”.

Poetja, Rossella Fusco, e vlerëson romanin “La sete pietrificata” të Berishës si një grishje të arketipit kolektiv për rizgjimim e ndërgjegjes. Autorja vë në dukje se romani “Është një grishje që vjen nga arketipi kolektiv për rizgjimim e ndërgjegjes, për ta bërë të ndjehet dhembja e të gjitha etjeve tona të pathënshme dhe të pashprehshme. Lindim me epshin e atij ëmbëlsimi dhe asaj ngrohtësie të qumështit të nënës që ushqen përtej masës, po herë – herë edhe helmon. Për çdo ditë vdesim nga pak, të shkrirë nga uria e etja e përkëdheljeve, për gjithë atë që mund të ishte e që s’ka ngjarë. Pastaj, befasisht, pa prituri, gjendemi brenda një jete të lodhur dhe të prishur, të dërrmuar, por ende të ndritshme, që lutet të jetë e deshifruar dhe e zgjuar, për të mos pësuar. Për të mos e bartur me kot mbi shpatullat tona, mbi kryqin, mbi pluhurizën e gjithësisë [...] Anton Nikë Berisha shkruan për ne një histori jashtë kohës dhe për të gjitha kohët. Një rrëfim që i përket Krishtit të varfër që është secili prej nesh. Krishtit të vërshuar nga hidhërimi dhe malli, që banon përvuajtërisht (brenda nesh)”.

Poetja Fusco e përfundon punimin e vet me vlerësimin se Berisha është “Shkrimtar pa bujë, që nuk shkruan aspak për të fituar famë e lavdi, por për t’i shërbyer famës dhe lavdisë<sup>12</sup>”.

Giuseppe Napolitano, autor i disa përmbledhjeve me poezi dhe i disa studimeve, i ka bërë një lexim të thellë romanit të Berishës “La sete pietrificata”. Ai shkruan: “Historia e Gjinit duket një protestë, që evokon dhe ëndërron, imagjinon dhe rijeton shumë përvoja të një jete të ëndërruar nga dashuritë e ndryshme; duket se në këto veprime synohet para së gjithash të rrëfëhet historia e një populli (ajo e

<sup>12</sup> Punimi i autores u lexua në promovimin e romanit mbajtur në qytetin Formia më 12 tetor 2013.



arbëreshëve të Italisë). Këtë e thekson sinteza kritike apasionante e Corradinit në *Pasthënie* [...] Të gjitha takimet, të cilat Gjinit i kujtohen, i japin nga pak forcë për të qëndruar edhe më tej, për ta larguar çastin në të cilin – duke mos qenë e mundshme për të shuar etjen (edhe etjen për njohje) – do të gurëzohet vetë ekzistenca<sup>13</sup>”.

Edhe intelektuali dhe studiuesi nga Ravena, njohës dhe dashamirës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, Matteo Pulizzi, i bën një vlerësim interesant romanit të Anton Nikë Berishës. Pasi përmend disa veçanti të ndërlidhjes së mitologjisë e të veprimit konkrete të personazhit Gjini Bardhela, ai thekson: “Romani i Anton Nikë Berishës është një rrëfim kompleks, me shtresa të ndryshme të leximit; elementet kulturore dhe antropologjike gërshetohen me aspekte psikologjike dhe filozofike. Këtu admiruesi i etnografisë ballkanike dhe i albanologjisë gjen ushqim të mirë për të, po edhe lexuesi italian, që i afrohet për herën e parë këtyre trojeve / popujve e ndjen magjinë dhe universalitetin e kushtëzimit njerëzor që është bërë gjithmonë dhe kudo nga kërkimet, shtegtimet e shpresat / dëshpërimet. Frika nga vdekja shndërrohet në faqet e “Etjes së gurëzuar” në etjen e dëshirës jetësore, dashurisë dhe ndërlidhjes (ngjitjes) gjinore me trupin (bukuria e tablove, bukuria e të të rinjve arbëreshë që shkojnë të vallëzojnë në ditën e Pashkëve)”.

Për romanin e Berishës kanë shkruar edhe tre shkrimtarë dhe studiues arbëreshë: Vincenzo Belmonte, Giuseppe Schirò di Modica dhe Vincenzo Bruno, duke e vështruar atë në mënyra e në aspekte të ndryshme.

Vincenzo Belmonte thekson se autori i romanit “La sete pietrificata” ka shprehur në mënyrë përmbledhëse përvojën e tij artistike të prozatorit: “Intriga e paktë, e ambientuar në Maqi, zhvillohet brenda pak orësh, në vend të një realiteti të verifikueshëm, më tepër në mendjen e Gjini Bardhelës, i cili megjithatë *nuk është protagonist, por monagonisti*, nën petkun e të cilit nuk është vështirë të shquhet profili i autorit. Në realitet, vepra nuk i nënshtrohet një përcaktimi (katalogizimi), për arsye se në të A. Berisha ka dëshiruar të ngërthejë (të fusë), si në një përmbledhje ideale, gjitha përvojën e tij jetësore e kulturore. Nëse vepra do të lexohet pa paragjykime letrare, nuk është vështirë të vërtetohet një përshkrim i vijueshëm i poezisë së pastër, gjë që, në të vërtetë, e bën atë një poemë moderne mbi fatin e Arbrit e mbi tragjiken e ekzistencës njerëzore. Të dy rrafshet nuk janë të kundërvëna, por të njësuar thellësisht, për arsye se temat universale janë vështruar e janë përjetuar nën thjerrëzën e kulturës kombëtare. Përsiatja e thellë për njeriun shqiptohet nëpërmjet një varg vizionesh të mrekullueshme, ku, poetikisht të ripunuara, shfaqen argumentet, me të cilët me

---

<sup>13</sup> Edhe punimi i G. Napolitano-s u lexua në promovimin e mbajtur në qytetin Formia më 12 tetor 2013.

dhjetëra vite lidhet puna e autorit si pedagog. Njohja e thellë e kulturës gojore shqiptare i bën të mundur atij përdorimin e pafund të miteve, të besimeve, të fjalëve të urta, që e shpijnë lexuesin në një botë, në të cilën mrekullisht shfaqet një urti e lashtë, e aftë t'i veçojë e t'i zbulojë, në mënyrë befasuese origjinale, aspektet më të fshehta të realitetit. Pra, rijetësohen legjendat që rrezatojnë një dritë të re mbi ekzistencën, ndërsa përsiatja ndërliidhet, para së gjithash, me temat e përhershme të dashurisë dhe të vdekjes, të përshkuara thellësisht nga të dhëna të pasura e origjinale. Gjuha e zhdërvjelltë dhe thëniet e ndryshme nxjerrin plotësisht në dritë thesarin shprehës të mësuar (nga librat) dhe atë popullor, që cilësohet nga shprehje të panumërta, ku del në shesh në mënyrë tipike shpirti i veçantë i shqiptarit. Si rrjedhojë e kësaj, krijohet një atmosferë unike, në të cilën, nëpërmjet magjisë së fjalës, ndriçohet shpirti i një populli dhe i një kulture. Filozofia, fantazia dhe zhdërvjelltësia gjuhësore, që shtjellohen në këtë vepër, e bëjnë atë sigurisht provën letrare më të mirë të A. Berishës dhe pa dyshim njërën nga më të realizueshmet e letërsisë shqiptare<sup>14</sup>.

Shkrimtari nga Hora e Arbëreshëve, Giuseppe Schirò di Modica, romanin “La sete pietrificata” e vështron si një metaforë të një shtegtimi në kujtesë; një mozaik poetik i stisur nga elemente të ndryshme të fatit dhe të fatkeqësisë së arbëreshëve dhe shqiptarëve në rrjedhë të kohëve: “Gjin Bardhela është metaforë e një shtegtimi në kujtesë, e një gërmimi në zemër, ku fshihet, e herë – herë del në sipërfaqe një kujtim, i cili shpejt shndërrohet në tablo si në një dioramë [...] Leximi i romanit është intrigues, pushtues, zotërues. Në shtresat e kujtesës janë të gjitha sekuencat e historisë sonë dhe është lehtë të ridallohen në nyje të ndryshme të romanit si në një libër, ku njëra dorë e padukshme e shfleton në një atmosferë të ëndrrës. Pra, shtegtimi në kujtesë, na kthen në kohë të shkuar, na rikthen në vende të këndshme të rrënjëve të përbashkëta, po kujtimet tashmë janë zbehur të thuash në kufijtë e pakthim. Vjeshta përcjell këmbë – këmbës, nata me hijet e veta kërcënohet në horizontin tonë. Duhet të pritët dimri i akullt? Autori i romanit duket se jep shenja të kundërta, në të vërtetë, në fund ravijëzohet një mbarim më i kthjelltë dhe më i hapur: qetësia e territ. Duket se agimi i ditës së re ka nevojë për optimizmin tonë e për dëshirën tonë të jetojmë. Pa dyshim *rrëfejzat janë të brejtura*, po ende ka mundësi të ripërtëritjes”.

Prozatori i shquar arbëresh, Vincenzo Bruno, veçon disa nga karakteristikat dhe vlerat e romanit të Berishës: “Të marrësh një dhuratë të papritur është gjë e bukur, të marrësh dhuratë një libër, sa më përket mua, është ngazëlluese, të marrësh dhuratë nga vetë autori frytën e përpjekjes së tij letrare është, në të njëjtën kohë, gjë e bukur dhe

<sup>14</sup> Punimi i Belmontes u botua në vëllimin *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”. “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë 2006.

ngazëlluese. Ta shijosh, pra, një dhuratë të tillë, domethënë ta lexosh romanin e Anton Nikë Berishës, ku është lartësuar një përvojë krejt befasuese: për arsye se shpesh, gjatë leximit, kam provuar ndijimin e fortë të mbes i ‘gurëzuar’ nga dridhmat e emocioneve, që të shtrëngojnë zemrën dhe mendjen [...] pos shijes së këndshme të fjalëve e të pamjeve, shkrimtari nxit në të vërtetë, ndjenja vërtet të forta, tronditëse dhe ndërlikuese. ‘Etja e gurëzuar’ nuk është vetëm një roman. Në të njëjtën kohë është ditar intim i një personi të ndjeshëm, shprehje lirike e një shpirti të thellë, këngë epike e një popullit të lashtë. Gjini, personazhi kryesor i një ‘historie’ ngarkuar përplot me ndodhi, ofrohet si metaforë e udhëtimit të përjetshëm e të vështirë, të jetës njerëzore pa kohë e pa hapësirë. Në të njëjtën kohë, ai paraqet dhe përmbledh në vetvete tiparet burimore të popullit të vogël e të madh arbëresh. Veprojnë një individ dhe një kolektivitet, që kanë role të ndryshme, po që shpesh rolet e tilla këmbehen e ndërthuren ndërsjelltas në rrjedhën e rrëfimit. Një njeri dhe një popull, që vetëm për sy e faqe, duket se humbasin në ankthe, që vetëm sipërfaqësisht duken të çrënjësor ose pa rrënjë [...] Së fundi Berisha dëshmon për një origjinalitet të shtjellimit e të frymëzimit, që ka kushtëzuar qoftë krijimin e një stili origjinal të shkrimit, qoftë të përfytyrimit të një ambient ideal si sfond për ndodhitë përkatëse. Maqi Arbëresh i Kalabrisë bëhet caku gjeografik konkret, po njëherit mitik, i cili përmbyll në vete edhe vendet e të parëve që migruan shumë kohë më parë nga ana tjetër e detit Jon”.

Në fund po them se këto janë vetëm disa nga mendimet dhe vlerësimet e 13 shkrimtarëve dhe studiuesve italian për romanin e Anton Nikë Berisha “La sete pietrificata”, që ndriçojnë disa nga çështjet kryesore të këtij romani.

### **Bibliografia:**

1. N. Berisha, *Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar*, “Faik Konica” & “Shpresa, Prishtinë, 2006.
2. L. Berisha (zgjodhi dhe përgatiti për shtyp), *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë, 2006.
3. D. Corradini, në vëllimin *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”. “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë 2006.
4. Belmontes u botua në vëllimin *Roman i bukurisë së pamort dhe i trishtimit të pashuar*. Rreth romanit “Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar”. “Faik Konica” & “Shpresa”, Prishtinë, 2006.



**Anton PANÇEV**

## **GJUHA SHQIPE DHE IDENTITETI SHQIPTAR NË FILLIM TË SHEKULLIT XX SIPAS BURIMEVE BULLGARE**

### **Hyrje**

Kjo kumtesë ka për qëllim paraqitjen e disa veçorive të gjuhës dhe të identitetit të shqiptarëve në dekadat e para të shekullit të XX. Për këtë temë në arkivat dhe bibliotekat bullgare ka shumë burime, libra dhe dokumente. Në kumtesë bëhen dy gjëra: së pari, një vështrim i shkurtër mbi burimet arkivore dhe literaturën shkencore të cilat janë të hulumtuara dhe, së dyti, prezantohen vetëm përfundimet kryesore të dala nga analizat e studimeve dhe vështrimeve të disa shkencëtarëve bullgarë, të bëra në dekadat e para të shekullit XX, në drejtim të identitetit shqiptar dhe për gjuhën shqipe dhe veçoritë e saj. Në këtë periudhë, në Bullgari janë mbledhur të dhëna të shumta për zhvillimet e gjithanshme të shqiptarët. Informata ka ardhur në Bullgari nga burime të tilla:

1) Konsujt dhe përfaqësuesit bullgarë, kryesisht në disa qytete në Maqedoninë e sotme, kanë dërguar në Sofje shumë raporte për proceset ndër shqiptarët<sup>1</sup>;

2) Kryesuesit e organizatave revolucionare bullgare gjithashtu kanë marrë në konsideratë shtimin e veprimtarisë së lëvizjes çlirimtare shqiptare dhe kanë kontaktuar me liderët shqiptarë në të dyja dekadat e para të shekullit XX. Dokumentet e VMORO-s dhe kujtimet e kryetarëve të saj janë një burim i çmueshëm për historinë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare shqiptare;

3) Shumë fakte interesante paraqiten nga shkencëtarët bullgarë, të cilët i kanë hulumtuar trojet lindore shqiptare në këtë periudhë<sup>2</sup>;

4) Me shumë rëndësi janë dokumentet dhe arkivat e Ekzarhisë Bullgare, e cila e

---

<sup>1</sup> Statistika e Agjencisë tregtare bullgare në Selanik për 1899–1902 г., Cartes ethnographiques des vilayets Salonique, Monastir et Cossovo, T. 1(texte), Sophia, 1902 (Harta etnografike të Vilajeteve Selanik, Manastir dhe Kosovë); Шопов, А. Българското културно дело в Македония в цифри – Българска сбирка, 1911, кн. 5, 310–311.

<sup>2</sup> Кънчов, В. Македония. Етнография и статистика. С., 1900; Маренин, Н. Албания и албанците. С., 1902.

ka shtruar ndikimin e saj në fillim të shekullit XX edhe në disa troje shqiptare<sup>3</sup>. Në këtë lidhje duhet të përmendim edhe raportet e mësuesve, inspektorëve të shkollave, priftërinjve etj.;

5) Përfaqësuesit e kolonisë shqiptare në Sofje dhe në vendbanime të tjera bullgare gjithashtu kanë lënë materiale të çmueshme për historinë e shqiptarëve<sup>4</sup>.

Prandaj, në arkivat dhe bibliotekat bullgare ka shumë dokumente, të cilat mund të kontribuojnë për ndriçimin e disa aspekteve të historisë së trevave lindore shqiptare në fund të shekullit XIX dhe në dekadat e para të shekullit XX.

Shkencëtarë si Vasil Këncëv, Nedjalko Kolushev (N. Marenin), Dimitër Mishev (Brankov), Vasil Zlatarski, Anastas Ishirkov, Ljubomir Miletiç, Jordan Ivanov, Stefan Mladenov, Dimitër Gadzhanov e disa të tjerë, kanë qenë jo vetëm midis profesorëve më të famshëm bullgarë, të cilët kanë lënë gjurma të shumta në fusha të ndryshme si historia, gjeografia, arkeologjia, ekonomia, etnografia, gjuhësia etj, por kanë shkruar edhe disa libra dhe shumë artikuj shkencorë në të cilët kanë përshkruar dhe kanë hulumtuar viset lindore shqiptare. Ata kanë udhëtuar në Maqedoni dhe në Kosovë dhe përshypjet e tyre bashkë me një analizë të shkëlqyer ka sjellë rezultate të larta shkencore. Nga punimet e tyre mund të marrim të dhëna dhe fakte të hollësishme për gjendjen në viset lindore shqiptare për disa dekada me radhë. Hulumtimet e këtyre profesorëve janë burim i çmueshëm për numrin e popullsisë shqiptare në Maqedoni, por edhe në Kosovë në fillim të shekullit XX, për gjendjen sociale, për ekonominë, tregtinë, gjuhën, situatën fetare, etnografinë, arkitekturën, kolonizimin serb pas Luftërave ballkanike, për arsimin dhe organizimin shoqëror, për kishat dhe xhamitë e për shumë aspekte të tjera nga jeta e shqiptarëve.

Vëmendje të veçantë meritojnë vështrimet dhe analizat e studiuesve bullgarë mbi identitetin shqiptar dhe mbi aspekte të ndryshme të gjuhës shqipe.

## Identiteti

Sipas vështrimeve dhe analizave të hulumtuesve bullgarë, në fillim të shekullit të XX identiteti shqiptar është karakterizuar me këto tipare kryesore:

1) Dallimet dhe bashkimi mes toskëve dhe gegëve

Të gjithë hulumtues bullgarë i kanë vërejtur dallimet krahinore mes shqiptarëve.

---

<sup>3</sup> Statistika e Ekzarhisë Bullgare nga viti 1902. Në: ЦДА, ф. 246К, оп.,1 а.е. 204, л. 56; Стойчева, С. Българската екзархия за етнодемографския облик на Македония (1908–1912). – Независимостта на България 1908 г. – поглед от XX век. Сборник доклади от международната конференция, проведена в София на 19–20 септември 2008. С., 2010, 290–300.

<sup>4</sup> Shihni p.sh.: Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. С., 1979.

Në fillim të shekullit XX ende ka pasur vend për shfaqjen e dallimeve mes toskëve dhe gegëve jo vetëm në dialektet e tyre, por edhe në orientimet politike, por të gjithë stidues kanë shënuar me një zë se dallimet krahinore dhe fisnore harroheshin kur bëhej fjalë për interesat kombëtare.

#### 2) Propagandat e huaja

Për formimin e identitetit kombëtar rol i madhë kanë luajtur propagandat e huaja mes shqiptarëve. Ndikim negativ kanë pasur propagandat greke dhe turke, por me pozivitet ka qenë propaganda austro-hungareze. Sipas Mareninit p.sh., në fillim të shekullit XX propaganda greke ka pasur sukses me greqizimin e mbi 100 000 shqiptarë<sup>5</sup>. “Gjatë regjimit serb shqiptarët nuk kanë pasur liri kombëtare, shkollore ose fetare. Ata janë trajtuar si “serbë me fe myslimane”.”<sup>6</sup>

#### 3) Turqizimi

Në disa troje kanë shënuar procesin e turqizimit të disave prej shqiptarëve. Akoma Vasil Kënçov ka shkruar në fund të shekullit të XIX se popullisia e Shkupit përbëhej kryesisht nga shqiptarë të turqizuar dhe kanë qenë pothuajse gjysma e popullatës<sup>7</sup>.

Edhe një citat: “Nuk mund të bëhej dallim të qartë mes shqiptarëve myslimanë dhe turqve dhe shumica prej turqve në Prizren kanë qenë shqiptarë të turqizuar”<sup>8</sup>. Situata e njëjtë edhe në Tetovë<sup>9</sup>.

#### 4) Roli i dobët i fesë

Stiduesit bullgarë kanë arritur deri përfundimin se feja nuk ka pasur një rol të rëndësishëm për formimin e identitetin kombëtar te shqiptarët. Për dallim prej turqve, te shqiptarët ka qenë zhvilluar më fortë ndenja kombëtare sesa ajo fetare. Të gjithë shqiptarë preferonin të përdornin emrin shqiptar me krenari<sup>10</sup>.

#### 5) Roli i gjuhës shqipe për bashkimin e shqiptarëve

Gjuha shqipe ka qenë shenjë kryesore për identitetin e shqiptarëve në të gjitha viset dhe nga të gjitha fetë.

---

<sup>5</sup> Д-ръ Н. Маренинъ (София, Печатница “Воененъ Журналь”, Приложение на “Военния Журналь”, год. XIV, 1902), с. 28.

<sup>6</sup> Димитров, Стефан. Северозападна Македония, с. 92.

<sup>7</sup> Васил Кънчов (Избрани произведения, т. II, Издателство Наука и изкуство, София 1970). Град Скопие. Бележки за неговото настояще и минало, с. 30.

<sup>8</sup> Иширков, Анастас. Пътуване в Македония и Поморавия, с. 108.

<sup>9</sup> По ату, f. 111.

<sup>10</sup> Гаджанов, Димитър. Мюсюлманското население в новоосвободените земи, с. 273.

## Gjuha

Interesimi i shkencëtarëve bullgarë për gjuhën shqipe ka filluar vetëm në fund të shekullit të XIX. Si shembull mund të tregohen përrallat e Kuzman Shapkarevit, një shkrimtar dhe intelektual bullgar nga Maqedonia<sup>11</sup>. Ai ka shkruar gjashtë përralla dhe një këngë shqiptare me shkronja bullgare bashkë me përkthimin e tyre në bullgarisht<sup>12</sup>.

Në vitet e Luftës së Parë Botërore, gjuhëtarët bullgarë kanë zhvilluar ekspedita shkencore në rajonet e Shkupit, Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, në luginën e Drinit drejt Lumës dhe në vise të tjera.

1) Kontributi i parë i ekspeditave është lidhur me ndriçimin e disa aspekteve të dialekteve shqiptare. Dialektet gege ishin të panjohura në krahasim me dialektet toske dhe shkencëtarët bullgarë kanë plotësuar deri diku këtë zbrazëti.

2) Faktet e mbledhura u kanë lejuar gjuhëtarëve bullgarë të ndërtonin hipoteza mbi origjinën e gjuhës shqipe. Sipas Mladenovit p.sh, gjuha shqipe i takon dialektit trakoilir. Me disa prej veçorive të saj ajo është më afër deri gjuhët sllave, armene, irane dhe indiane.

3) Përfundim tjetër ka qenë se në sistemin e saj leksikor gjuha e shqiptarëve paraqit një përzierje jashtëzakonisht interesante, në të cilin sistem në mënyrë të qartë ndryshohen fjalët e vjetra indoeuropiane nga huazimet mëvonshme<sup>13</sup>.

Fjalë të vetra indoeuropiane në gjuhën shqipe, sipas Mladenovit, janë përsëmbull natë, ditë, gju, gjuhë, krimb, mize, mish, miell, dru, derë etj. Krahas fjalëve të vjetra indoeuropiane, t'u nënshtruara rregullave të veçanta trakoilire, në gjuhën e sotme shqipe ka edhe shumë fjalë të huazuara përmes ndërmjetësimit latin, grek, bullgar, turk (fjalë perse dhe arabe).

4) Fjalët e shumta, të huazuara nga latinishtja, nuk e kanë ndryshuar karakterin e gjuhës shqipe dhe ajo e ka ruajtur mëvetësinë e saj. Mladenov ka hulumtuar edhe huazimet bullgare në gjuhën shqipe: oborr, stan, strehe, gard „орада” „плет”, patkue „подкова”, stol, čas, „минута” (срав. бълг. *завчас*), kose „коца” за косене, dobí „полза”, „придобивка”, vozís, čudís и под<sup>14</sup>.

5) Në fushën e sintaksës, të folmet shqiptare u afrohen sidomos gjuhës bullgare,

---

<sup>11</sup> Кузман Шапкарев (1892, 1894; 1973) Български приказки и верования съ прибавление на неколку Македоновашки и Албански Простонародна българска философия или Български народни приказки, вѣрвания, пословици, гатанки, игри и пр. Събралъ и издава К. А. Шапкаревъ.

<sup>12</sup> Ato janë botuar edhe në Shqipëri, në serinë “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar” (vëll. III, Tiranë 1962, f. 435-446).

<sup>13</sup> Младенов, Стефан. Пътешествие из Македония и Поморавието, с. 173.

<sup>14</sup> По ату, f. 174.



por edhe gjuhëve të tjera sllave. Mohimi i dyfishtë është tipik edhe për shqipen, edhe për bullgarishten.

6) Autorët bullgarë kanë shënuar afërsinë të frazeologjizmat dhe fjalët e urta në gjuhët ballkanike.

- shqip. Uk'u i pk'ak maskara i shënvēt = „Стар вълк на кучетата маскара”,

- Pešku pi krē i ven era „Рибата от главата мирише”;

- bull. „имат кабаат магарето, удри го самарот”, „удряй самара, да се сеща магарето” = shqip. Ka faj gomari, bier i samarit и под.

- shqip. Ujku k'ūmen e ndron, hujin (tabietin) nuk e ndron, bull. „Вълкът козината си менява, търсата (обичая, нрава) си не менява” (П. Р. Славейков, Български притчи, I, 85),

- shqip. Mā e amel' āšt ufla pa pare se mjalti me pare = „Без пари оцет посладък от мед”, turqisht. Badheva sirke baldan tatly (Славейков, пос. кн I, 39),

- shqip. Ma mir tēt del'seni se tēt del'emni, bull. „По-добре е на човек очите (око) му да излегат, та име да му не излегне” (П. Р. Славейков, пос. кн. II, 58),

- shqip. pešku n det, skara n zjař, bull. „Рибата в морето, ни туряме котлето” (П. Р. Славейков, пос. кн. II, 99, ka variante bullgare dhe shqiptare „тиган”, „тава”, „скара”, „менче” и под.),

- shqip. „Para e bardē peř ditē tē zeze = bull. „Бели пари за черни дни” (П. Р. Славейков, пос. кн. I, 61 edhe shumë të tjera), të cilat kanë përshtatshmëri edhe në turqisht: Ak akçe gün için dyr<sup>15</sup>.

7) Vëmendje të veçantë meritojnë hulumtimet e Mladenovit mbi të folmen e shqiptarëve në rajonin e Ohrit dhe të Manastirit. Sipas tij, pothuajse të gjithë shqiptarët nga këto vise kanë qenë toskë dhe vetëm e folmja në rrethinën e Dibrës dhe në luginën e Drinit deri Strugën, i takon gegnishtes<sup>16</sup>.

## Përfundim

Si përfundim, mund të theksohet se hulumtimet bullgare në periudhën e paraqitur sjellin informatë të çmueshme mbi zhvillimet politike, kulturore dhe sociale të shqiptarët. Në veçanti, përmbledhjet dhe analizat e gjuhtarëve bullgarë mbi fonetikën, morfologjinë, leksikun, frazeologjinë etj., mund ta ndihmojnë hulumtimin e zhvillimeve historike të gjuhës shqipe. Këto studime kanë krijuar bazën e albanologjisë bullgare dhe u kanë shërbyer gjuhtarëve nga periudhat më të vonshme për përpunimin

---

<sup>15</sup> Po aty, f. 175.

<sup>16</sup> Po aty, f. 187.

e teorive të tyre mbi origjinën e gjuhës shqipe dhe për kontaktet e saj me gjuhët e tjera në Ballkan.

### **Abstrakt**

Shqiptarët nga trojet e tyre lindore gjithmonë kanë qenë në kontakt të ngushtë me bullgarët. Për këtë arsye, ka shumë dëshmi dhe dokumente bullgare të cilat tregojnë për gjendjen politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore etj. te shqiptarët, kryesisht në dekadat e para të shekullit të XX. Hulumtuesit bullgarë nga kjo periudhë kanë treguar interes të veçantë edhe për veçoritë e gjuhës shqipe si dhe për karakteristikat e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Shkencëtarët më të famshëm nga Bullgaria kanë bërë studime në terren për të zbuluar karatekristikat e gjuhës shqipe. Përmbledhjet dhe analizat e tyre mbi fonetikën, morfologjinë, leksikun, frazeologjinë etj., mund ta ndihmojnë hulumtimin e zhvillimeve historike të gjuhës shqipe. Këto studime kanë krijuar bazën e albanologjisë bullgare dhe u kanë shërbyer gjuhtarëve nga periudhat më të vonshme për përpunimin e teorive të tyre mbi origjinën e gjuhës shqipe. Kumtesa do të përqendrohet mbi arritjet dhe përfundimet kryesore të këtyre studiuesve.

### **Bibliografia:**

1. Иванов, Й. Българите в Македония. С., 1915.
2. Кънчов, В. Македония. Етнография и статистика. С., 1900.
3. Македония и Одринско. Статистика на населението от 1873 г., С. 1995.
4. Маренин, Н. Албания и албанците. С., 1902.
5. Младенов, Стефан. Принос към изучаване на българско-албанските езикови отношения. В: Годишник на Софийския университет. Историко-филологически факултет, с. 1-32, София, 1927.
6. Петров, П. Научна експедиция в Македония и Поморавието. С., 1993:
7. Петров, П. Научна експедиция в Македония и Поморавието 1916. – Д. Гаджанов. Мюсюлманското население в новоосвободените земи. С., 1993
8. Петров, П. Научна експедиция в Македония и Поморавието 1916. – Младенов, Стефан. Пътуване из Македония и Поморавия.
9. Петров, П. Научна експедиция в Македония и Поморавието 1916. – Иширков, Анастас. Пътуване в Македония и Поморавия.

10. Ростковский, А. Распределение жителей Битольскаго Виляета по народностям и вероисповеданиям в 1897 году, Санкт Петербург, 1899.
11. Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. С., 1979.
12. Стойчева, С. Българската екзархия за етнодемографския облик на Македония (1908–1912). – Независимостта на България 1908 г. – поглед от XX век. Сборник доклади от международната конференция, проведена в София на 19–20 септември 2008. С., 2010, 290–300.
13. Томоски, Т. Населението на Битолскиот санџак во 1897 година според статистичкиот преглед на австро-унгарскиот вицеконсул А. Крал. – Историја, 1969, г. V, кн. 1, Скопие, 45–71.
14. Кузман Шапкарев (1892, 1894; 1973) Български приказки и верования съ прибавление на неколку Македоновлашки и Албански Простонародна българска философия или Български народни приказки, вѣрования, пословици, гатанки, игри и пр. Събралъ и издава К. А. Шапкаревъ.
15. Шопов, А. Българското културно дело в Македония в цифри – Българска сбирка, 1911, кн. 5.
16. Brancoff, D.M. "La Macédoine et sa Population Chrétienne. Avec deux cartes ethnographiques", Paris, 1905.
17. Cartes ethnographiques des vilayets Salonique, Monastir et Cossovo, T. 1(texte), Sophia, 1902.



**Sala AHMETAJ**

## **FUNKSIONI SINTAKSOR**

Fjala funksion sintaksor në përdorimin gjuhësor i përshtatet një game të gjerë kuptimesh. Ekzistojnë disa fusha të përdorimit të fjalës funksion. Ajo tregon marrëdhënie në mes të veshjes gjuhësore dhe funksioneve në të cilat ajo përdoret. Në gramatikë, për shembull, sintagma emërore mund të “funksionalizohet” në klauzolën e strukturës si kryefjalë, kundrinor, plotës etj., për faktin se këto role përkufizohen në mënyrë distribucionale.

Tërësia e fjalisë a e frazës nuk është një grumbull fjalësh të hedhura dosido. Përkundrazi, elementet në mes vete dhe secili element me frazën shprehin marrëdhënie të caktuara sintaksore. Frazja e marrë si tërësi ka një finalitet ku secili përbërës dallon nga të tjerët për nga roli që luan në përmbushjen e këtij finaliteti. Dhe në këtë mënyrë çdo anëtar i frazës duhet të japë ndihmesën e vet specifike për realizimin e qëllimit të përbashkët<sup>1</sup>. Rolin e njërit anëtar nuk mund ta përmbushë anëtari tjetër. Për shembull funksionin e kallëzuesit mund ta kryejë një folje, një mbiemër, një emër etj. Këto të dhëna dëshmojnë për pavarësinë e funksionit sintaksor. Funksionet sintaksore ose marrëdhëniet sintaksore të kësaj natyre të rëndësishme, janë pjesë e disa modeleve të analizës gjuhësore, duke u ndërlidhur me teori të ndryshme gramatikore si me teorinë e pranisë, gramatikës së relacioneve dhe gramatikës leksikore – funksionale. Termi analizë funksionale dhe gjuhësi funksionale janë shfrytëzuar për t’i specifikuar teoritë në të cilat kuptimi funksion trajtohet si themelori, më i rëndësishmi. “Në teorinë e drejtimit dhe të lidhjes dhe të gramatikës të strukturës së frazës funksionet gramatikore janë kuptimet që përkufizohen në bazë të pozitës në klauzulën e përbërësve. Termi funksional përdoret për elementin i cili në kuadër të ndonjë sistemi gjuhësor është dallues ose kontrastiv”<sup>2</sup>.

Roli që luan gjuha në kontekstin shoqëror ose të individit gjithashtu quhet “funksion” (funksion social). Për shembull, gjuha përdoret për të plasuar mendimet, për t’i shprehur qëndrimet etj. Gjithashtu, mund të përdoret për identifikimin e situatave specifike sociolinguistike, siç është përdorimi joformal, varietetet gjuhësore,

---

<sup>1</sup> O. Dykro, S. Todorov, Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit, Prishtinë, 1984, f. 295

<sup>2</sup> Dejvid Kricital – Enciklopedijski re~nik moderne lingvistike, NOLIT, Beograd, 1998, f. 107

siç është gjuha e shkencës dhe e drejtësisë. Në raste të tilla themi se gjuha ka një përdorim të veçantë dhe funksion të rëndësishëm. Për fjalinë pohohet se “funksioni” i saj është të kumtojë, të pyesë, të urdhërojë etj.

Përkufizimi për termat e përgjithshëm si subjekt, predikat, objekt, ndajfolje, përdorimi i të cilave është i kushtëzuar në varësi nga përdorimi në teoritë e veçanta apo nga tipi i gjuhës. Për gjuhët si, gjermanishtja, shqipja të cilat kanë një sistem të zhvilluar morfologjik, funksionet sintaksore përcaktohen kryesisht nga rasia. Në këto gjuhë subjekti identifikohet me përbërësit emërorë të kallëzuesit. Në disa gjuhë, si anglishtja për shembull, në të cilat rasia shfaqet rrallë, funksionet sintaksore përkufizohen nga marrëdhëniet e tyre strukturore dhe topologjike. Funksionet sintaksore, po ashtu asociohen me role semantike që ndërtojnë me nocionet e tjera semantike apo pragmatike. Kryefjala shoqërohet me agjentin e një veprimi (rasa gramatikore), subjektin logjik apo si tema e fjalisë (tema kundrejt komentit, tema kundrejt remës). “Përkufizimet shumëfunktionale sikurse edhe përpjekjet për të veçuar disa lloje të funksioneve sintaksore janë bërë për shkak se kriteret e vëna më lart shpeshherë kundërshtojnë njëri me tjetri. Për këtë arsye funksionet sintaksore nuk janë gjerësisht të përkufizuara por janë të marra si nocione (nga tradita) në kornizën e relacioneve gramatikore dhe gramatikës leksikore funksionale. Funksionet sintaksore të shënuara i referohen shumicës së gjuhëve flektive”<sup>3</sup>.

Në teorinë e gjuhësisë së përgjithshme me orientime nga gjuhësia strukturore funksionale<sup>4</sup> kallëzuesin e gjejmë të vlerësuar si gjymtyrë kryesore, si gjymtyra ndërtuese. Kryefjala dhe kundrinori trajtohen dhe vlerësohen si gjymtyrë të domosdoshme, rrethanori si gjymtyrë fakultative, kurse përcaktori të shumtën e herës quhet modifikues i gjymtyrëve të tjera.

Funksioni sintaksor në gramatikat e gjuhës shqipe është parë në marrëdhënie me rasat, me parafjalët, në raport me mënyrat dhe diatezat e foljes po edhe me kategoritë leksikore. Për shembull, emri dhe kryefjala janë parë të lidhura dhe të kushtëzuara me rasën. Po kështu është parë edhe kundrinori. Plotësit janë vështruar nga kushtëzimet me parafjalët (përveç rasës). Kjo nënkupton se funksioni sintaksor del si prodhim i kategorive leksikore që, në teorinë e gjuhësisë së përgjithshme, quhen kategori parësore dhe i kategorive gramatikore (si rasia, numri, aspekti, koha) që quhen kategori dytësore. Pra, bashkimi i kategorive parësore dhe i kategorive dytësore krijon dhe prodhon funksionin sintaksor (kryefjalë, kallëzues etj.).

<sup>3</sup> Dictionary of Language and Linguistics, Hadumod Bussman, Munich, 1995, f. 1156.

<sup>4</sup> L. Tesnière, Elements de cyntaxe structurale, Paris, 1965, kap. 49; A. Martine, Njësitë shënjuese, Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, Prishtinë, 1983, f. 143-174; J. Lyons, Funksionet sintaksore, Hyrje në gjuhësinë teorike, Dituria, Prishtinë, 2001, f. 311-324

Funksioni sintaksor<sup>5</sup> do të mund të përkufizohet si ekuivalent gjuhësor i marrëdhënieve në mes të një elementi të përvojës dhe të tërësisë. Për funksionin mund të diskutohet edhe për të gjitha rastet e elementeve që dalin si marginale. Por jo për funksionin predikativ. Në raste të tilla funksioni i kallëzuesit nuk do të mund të quhet funksion real. Kjo është çështje konvencionale. Sepse, në shumicën e gjuhëve (sipas nesh edhe në gjuhën shqipe) kallëzuesit do të duhet t'i përshkruheshin funksione të ndryshme varësisht nga forma aktive ose pasive e tij. Por kallëzuesi do të mund të quhet tip special me të cilin lidhen funksionet parësore të cilat kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me të, sepse për një gjuhë të caktuar ekziston një inventar i caktuar i funksioneve sintaksore. Por funksioni i një elementi nuk është gjithmonë i përcaktuar nga natyra e tij<sup>6</sup>. Dy elemente të natyrave të ndryshme mund të kryejnë të njëjtin funksion. Ose përbërës të së njëjtës paradigme mund të kryejnë funksione të ndryshme. Këto fakte dëshmojnë për pavarësinë e funksionit sintaksor.

Fjalët në mes vete lidhen në mënyra të ndryshme shpeshherë të kufizuara dhe të kushtëzuara me mundësi kombinatorike. Mundësitë e kombinimeve të tilla të një fjale ose të një strukture me fjalë të tjera ose struktura të tjera në të njëjtën fjalë do të mund të quheshin si potenciale. Për shembull funksioni më i rëndomtë i emërores është kryefjala, i gjinore është prona. Disa prej tyre do të mund të quheshin si funksione themelore të këtyre rasave kur dalin pa parafjalë. Sepse emrat shpeshherë mund të kryejnë edhe funksione të tjera që kushtëzohen me kuptimin e tyre leksikor sic është predikati semantik që përfaqëson ndonjë pronësi proces, relacion etj, ndërsa argumentet (kryefjala, kundrinori) përfaqësojnë titullarin e pronës, llojin e marrëdhënieve etj dhe me parafjalët që shoqërohen ose edhe me strukturën e fjalisë në të cilën bëjnë pjesë.

Shembuj:

*Vajza doli nga shtëpia / kjo vajzë doli nga shtëpia.*

Pra, për “ndërtimin” e funksionit sintaksor janë të nevojshme mjetet leksikore dhe gramatikore. Për gjuhën shqipe si mjet më i rëndësishëm është fleksioni (lakimi dhe zgjedhimi)..Për të treguar funksionet parësore sintaksore në gjuhën shqipe si mjet përdoret fleksioni, kurse mjet tjetër i rëndësishëm për të dhënë funksione dytësore sintaksore janë parafjalët, pjesëzat, rendi i gjymtyrëve, ndajfoljet etj.

Një fakt i rëndësishëm për teorinë sintaksore do të ishte përkufizimi i kryefjalës ose i gjymtyrëve të tjera. Përkufizimet që i kemi parë në gramatikën e gjuhës shqipe nuk e shtjellojnë e as shpjegojnë aq shterueshëm çështjen se kryefjala përveç faktit se

<sup>5</sup> A. Martine, Ka funkcionalnoy sintaksi, Jezik i funkcija, Sarajevo, 1973, f. 63.

<sup>6</sup> O. Dykro, C. Todorov, Funksione sintaksore, Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit, Prishtinë, 1984, f. 295-304

del në emërore pa parafjalë ajo kur është e pashquar përcillet me disa kushtëzime të tjera dhe domosdoshmërisht duhet të shoqërohet me disa elemente (të shumtën e herës përemrat e pacaktuar ose dëftorë. Në teorinë e gjuhësisë së përgjithshme, Lljajons<sup>7</sup>, Robins<sup>8</sup> etj., ndryshimet në mes të formave eptimore dhe formave parafjalore (të emrave nëpër rasë) nuk janë parë si të rëndësishme për shumë gjuhë. Por, në gjuhën shqipe janë të rëndësishme dhe paraqesin diferencim funksional.

Sipas Sapirit<sup>9</sup> në shumë gjuhë fjalëpërbërja përcaktohet me atë që mund ta quajmë funksion përkufizues, domethënë njërit nga dy ose më shumë elementet e përbëra i jepet rëndësi cilësuese që nuk ndihmon në formimin formal të fjalisë. Disa gjuhë i shprehin raportet me anë ndryshimesh brenda fjalës. Disa gjuhë të tjera barrën formale e mbështesin tek folja, kurse tek disa gjuhë të tjera rendi i fjalëve merr vlerë të vërtetë të funksionit. Por, shumica e gjuhëve janë diku në mes të këtyre dy skajeve. Në këtë grup bën pjesë edhe shqipja.

Vlera e funksionit është rendi tek gjuhët si anglishtja. Prandaj, dallimi në mes kryefjalës dhe kallëzuesit në këto gjuhë varet nga vendosja e fjalëve në fjali.

Shembull

*Djali sheh qenin dhe*

*Qeni sheh djalin*

Por një dallim i vogël në renditje tek shumica e gjuhëve ndikon në modalitetin e fjalisë.

Për shembull

*Ai është këtu dhe* si fjali dëftore

*A është ai këtu?* si fjali pyetëse

Kurse në disa gjuhë të tjera e edhe në shqipen, përdorimi i ndajshesave domethënë i mbaresave rasore, parafjalëve, pjesëzave, nyjave etj., është mjeti më i rëndësishëm për përcaktimin e funksionit sintaksor. Por kjo nuk do të thotë se një gjuhë ka varfëri funksionale në qoftë se del me mjete të caktuara (siç është rendi i fjalëve) ose me mjete të tjera (siç është fleksioni), por kjo ka të bëjë më shumë me ekonominë gjuhësore dhe me përdorimet formale të kontekstit.

Kujtojmë se gjuha shqipe sjell të dhëna të mjaftueshme se funksioni sintaksor i

<sup>7</sup> J. Lyons, Hyrje në gjuhësinë teorike, Dituria, 2001

<sup>8</sup> R.H. Robins, Historia e gjuhësisë, Dituria, 2007

<sup>9</sup> E. Sapir, Forma në gjuhë – proceset gramatikore, Gjuha – hyrje në studimin e ligjërimit, Prishtinë, 1980. 76-79



rasave në këtë gjuhë paraqitet me kushtëzime pikërisht për arsye të daljes së një emri me parafjalë ose pa parafjalë. Dhe pikërisht funksionet e ashtuquajtura parësore të cilat në gjuhën shqipe dalin me eptim, janë zakonisht të lidhura drejtpërdrejt me foljen dhe dalin të shumtën e herës si aktantë të obligueshëm. Por në gjuhën shqipe edhe rendi i fjalëve, në disa raste, ka edhe kushtëzime funksionale, por së pari do të duhej të qartësohej diferencimi në mes të rendit të fjalëve dhe rendit të gjymtyrëve, e vetëm pastaj të dilet me pohime të caktuara.

Këto janë mjetet më të rëndësishme gramatikore që shërbejnë për të ndërtuar sintaksën normale dhe funksionet sintaksore. Sintaksa normale në teorinë e gjuhësisë bashkëkohore<sup>10</sup> mund të përkufizohet duke u thirrur vetëm në përdorimin e gjuhës jashtësituative. Kjo nënkupton që komunikimi realizohet vetëm me mjete gjuhësore që shërbejnë për të përmbushur një funksion. Ky kriter i normalitetit sintaksor, përveç tjerash, përputhet edhe me pikëpamjet e gramatikanëve tradicionalë për të cilët normalitet sintaksor dhe funksional sintaksor konsiderohet thënia që përmban sintagmën kryefjalë plus kallëzues.

Por, sot, normaliteti sintaksor dhe funksional nuk konsiderohet si i tillë vetëm me këtë kushtëzim të pranisë së kallëzuesit dhe kryefjalës. Normaliteti sintaksor del me mjete gjuhësore në fjali modelesh të ndryshme (jo kushtëzimisht vetëm me kryefjalë dhe kallëzues). Natyrisht, kufijtë në mes normalitetit (kur një njësi del me mjete gjuhësore) dhe kontekstualitetit, kur njësia mund të kuptohet me mjete gjuhësore, por edhe me mjete tjera ndonjëherë, është vështirë të vihen. Për kontekstin sot diskutohet si për një çështje që përfshin dhe tejkalon analizën e fjalisë, prandaj **konteksti shihet edhe si veçori ose si kategori e tekstit dhe si mjet funksional**. Ndonjë autor pohon<sup>11</sup> se konteksti që paraqet një aspekt të jashtëm të përfshirjes së faktorëve dhe të rrethanave të një situatë ideale të komunikimit në të cilën teksti del në formë të thënieve gojore apo të atyre të shkruara. Dhe pikërisht kjo kategori e shënon kufirin midis asaj që është gjuhësore në tekst dhe asaj që do të duhej konsideruar si jashtëgjuhësore.

Por, gjymtyra, si funksion sintaksor edhe në rrethana të normalitetit sintaksor edhe në rrethana të kontekstualitetit e ka qartësisht të dallueshëm funksionin sintaksor. Për shembull, në dialogje, në monologje etj., ose edhe në rrethana situative të ndërlikuara përdoret gjymtyra që është bartëse e mesazhit ose që është rema.

Shembuj:

*I ke shkruar letër nënës! – I kam shkruar.*

*Bora ka punën e saj, ne tonën. – Nguli këmbë babai.*

<sup>10</sup> A. Martine, Ka funksionalnoj sintaksi, Jezik i funkcija, Sarajevo, 1973, f. 75

<sup>11</sup> W. Egon, A text Grammar of English, Quelle und Meyer, Heidelberg, 1983, f. 14

Në sintaksat e gjuhës shqipe, sidomos ato të botuara në gjysmën e dytë të shekullit XX e këtej, gjejmë shpjegime për normalitetin sintaksor dhe për kontekstualitetin (Sintaksa e Akademisë<sup>12</sup>, e Domit<sup>13</sup> etj.). Shpjegimet për gjymtyrët e veçuara për fjalitë e paplota dhe të pagjymtyrëzueshme janë një mënyrë e thellimit në sintaksën komplekse ku i gjejmë ndonjëherë të ndërvarur dhe të kushtëzuar normalitetin sintaksor me kontekstualitetin sintaksor dhe situacionin gjatë prodhimit të fjalive dhe të gjymtyrëve. Siç është pohuar edhe në disa sintaksa (ajo e Priftit<sup>14</sup>, e Akademisë, e Dhimës<sup>15</sup> etj.) funksioni sintaksor i fjalëve përcaktohet edhe nga lloji i marrëdhënieve kuptimore midis përbërësve të sintagmës ose fjalisë. Në disa studime teorike<sup>16</sup>, madje pohohet se kryefjala edhe kur është e shprehur në ndonjë rast më i rëndësishëm është plotësi për atë që kërkohet të thuhet me foljen se sa kryefjala.

Për shembull

*Ajo ka marrë pjesë/ në ekspozitë/ në luftë/ në orën letrare.*

Plotësit në këtë fjali për foljen janë më të rëndësishme se kryefjala, ata janë të domosdoshëm, kryefjala jo. Shpjegime të tilla për funksionin e gjymtyrëve nuk gjejmë në gramatikat shqipe. Shpjegime që fjalia duhet të ketë kryefjalën dhe kallëzuesin i gjejmë në tekstet më të hershme, kurse më vonë duke filluar me Domin<sup>17</sup> gjejmë edhe pohime se fjalia mund të jetë edhe pa kryefjalën, edhe pa kallëzuesin (si gjymtyrë gramatikore), për shembull, *me cilin tren udhëtuat (me të natës)*.

Monemat funksionale e sigurojnë pavarësinë sintaksore (me, për, në) për dallim nga monemat modale që tregojnë një element të brendshëm (një, disa) që tregojnë modalitetet. Zgjedhja e elementit funksional në masë të madhe është e kushtëzuar me zgjedhjen e foljes në fjali<sup>18</sup>. Kurse zgjedhja e modaliteteve është e lirë (trajta e caktuar, e pacaktuar, shumësi, njëjësi etj.). Në disa raste përdorimi i kufizuar i modaliteteve është i lidhur edhe me natyrën e njëjësive, për shembull në gjuhën shqipe ka fjalë që përdoren vetëm në njëjës ose vetëm në shumës. Në gramatikat tona nuk është bërë në mënyrë të qartë dallimi në mes të elementeve funksionale dhe elementeve modale në fjali për të parë më qartë diferencimin e tyre. Diferencimi funksional për shembull në mes të rasës dhe numrit është vështirë të bëhet, sepse funksionalet dhe modalitetet

<sup>12</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Sintaksa, Tiranë, 2002, Fjalitë e paplota, f. 395-404

<sup>13</sup> M. Domi, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1970.

<sup>14</sup> S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1970.

<sup>15</sup> Th. Dhima, Gjuha shqipe – sintaksa, Tiranë, 2005, f. 30-31.

<sup>16</sup> M. Ri~anovi}, Od rije~i do re~enice, Sintaksa, Jezik i njevoja struktura, Sarajevo, 1975, f. 226.

<sup>17</sup> M. Domi, Sintaksa, Tiranë, 1957.

<sup>18</sup> R. Kati~i~, Sintakti~ke studije, Jezikoslovni ogleđi, Zagreb, 1971, f. 65-100.

shpesh përzihen ose shkrihen, prandaj është vështirë për të parë se cili është funksioni i mirëfilltë. Në raste të caktuara e njëjta shenjë kryen të dyja funksionet.

Ndonjëherë duhet të diskutohet për pajtueshmërinë në mes të njëjësive ose edhe për redundancë në informim (për shembull kohën ndonjëherë e përcakton folja ose edhe ndonjë monemë e pavarur, për shembull *dje* dhe *kishte*). Në raste të tilla bëhet fjalë për redundancë në informim por edhe për marrëdhëniet në mes të pjesëve të ndryshme të thënies të cilat krijojnë një pajtueshmëri në mes veti, prandaj jo rastësisht Sapiri<sup>19</sup> do të pohonte se të gjitha njësitë gramatikore janë si njësi të relacioneve.

Redundanca është e rëndësishme si ajo leksikore, as ajo gramatikore. Ajo paraqitet dhe përfaqëson elementet e rëndësishme të komunikimit dhe në ndonjë rast mund të mbështetemi në të për të specifikuar funksionin e ndonjë segmenti. Por, nëse i abstarcojmë pozitat e monemave si indikatorë të funksioneve, mund të pohojmë ose të konstatojmë se cilat janë ato elemente që sigurojnë pavarësinë sintaksore<sup>20</sup>. Është e parëndësishme se a shfrytëzohet ajo pavarësi më shpesh a më rrallë, për shembull *me* si parafjalë mund të tregojë edhe një tip relacioni edhe një funksion, për shembull, *me shokun*, *me lopatë*. Rreth natyrës së njësisë më të vogël ose thënies më të vogël, Martine nuk pajtohet me Sapirin për çiftin subjekt predikat se duhet të ekzistojë diçka për t'u folur dhe diçka për t'u thënë. Duke shprehur dilemën se ç'është thënia minimale, cilat janë mundësitë e formimit të një thënieje të tillë, cilat janë kushtëzimet për formimin e një thënieje të tillë, cilat janë mundësitë dhe mënyrat se si ajo thënie mund të zgjerohet. Çështja më e vështirë që duhet të zgjidhet është se a duhet të bëhet dallimi në mes të thënieve normale që të shumtën e herës kanë kryefjalë dhe kallëzues me thëniet e tjera të situatës ose kontekstit si: *Atje. Ndale vrasësin! Zjarr! Eja* etj. Si të bëhet dallimi funksional i gjymtyrëve dhe si të shihet ajo që është thjesht gjuhësore, thjesht thënie normale, thënie kontekstuale gjuhësore dhe thënie me mjete minimale gjuhësore.

<sup>19</sup> E. Sapir, Forma në gjuhë – proceset gramatikore, Gjuha – Hyrje në studimin e ligjërimit, Prishtinë, 1980, f. 70-97.

<sup>20</sup> A. Martine, Ka funkcionalnoj sintaksi, jezik i funkcija, Sarajevo, 1973, f. 71



Flutura ÇITAKU

## MOTIVIMI I TERMAVE TË GRAMATIKËS TRADICIONALE

Në letërsinë tonë gjuhësore studimi i parë për motivim të termave duke u nisur nga aspekte konceptologjike u bë në vitet 90 nga Dervishi<sup>1</sup> kur prejardhja konceptore u shikua në përqsasje me prejardhjen semantike. Kështu zuri fill emërtimi **termformim** që do të merrej me proceset e motivimit të termave, krahas emërtimit të mëparshëm **fjalëformim** që përdorej për motivimin e të gjitha njësive të leksikut pa përjashtim. Dallimi kryesor midis këtyre dy emërtimeve qëndron në faktin që fjalëformimi merret vetëm me njësitë njëfjalëshe ndërsa termformimi merret edhe me njësitë që i kalojnë kufijtë e fjalës<sup>2</sup>.

Në këtë referim do të paraqesim rrëgët e motivimit të termave njëfjalësh të terminologjisë së gramatikës tradicionale. Kjo punë është bërë duke u nisur nga dy studime për termformimin: njëri për terminologjinë e mekanikës i bërë nga Dervishi (artikulli i cituar) dhe tjetri për terminologjinë e agronomisë i bërë nga autorët Jazexhiu dhe Duro<sup>3</sup>. Ndërkaq, studiuesja V. Bello<sup>4</sup> në punimin e saj merret vetëm me termat togfjalësha të terminologjisë së gjuhësisë. Ajo që i bashkon jo vetëm këto terminologji që u zunë në gojë, por të gjitha terminologjitë e të gjitha fushave të dijes është numri i madh i njësive të pathjeshta që konsiderohet të jetë mbi 80 përqind. Ajo që i dallon është se këto dy terminologji (mekanikë, agronomi) emërtojnë koncepte edhe abstrakte edhe konkrete, kurse termat e gramatikës emërtojnë vetëm koncepte abstrakte. Rrjedhimisht, edhe motivimi i termave të fushës së gramatikës ka disa specifika që mund të mos i kenë fushat e tjera të dijes.

Rrugët e motivimit të termave të gramatikës janë:

---

<sup>1</sup> V. Dervishi, *Termtat e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor*, Studime Filologjike nr. 1, 1991

<sup>2</sup> Te ne studiuesit nuk janë të një mendjeje nëse njësitë e pathjeshta (togfjalëshat) mund të konsiderohen si një rrugë e formimit të njësive të leksikut të përgjithshëm. Shumica nuk e pranojnë si të tillë.

<sup>3</sup> A. Duro, V. Jazexhiu, *Motivimi në terminologjinë e agronomisë në rrafshin e termformimit*, Studime Filologjike, nr. 1-2, 2006

<sup>4</sup> V. Bello, *Termtat emra-bazë e formimit të terminologjisë së gjuhësisë*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr.26, Prishtinë, 2006

1. Rruga sintaksore: njësitë e pathjeshta dhe konversioni.
2. Huazimi
3. Rruga morfologjike: ndajshesimi dhe kompozimi
4. Tejbartja konceptore si dhe modifikimi i përmbajtjes konceptore të njohura edhe si terminologjizim dhe riterminologjizim, varësisht nga autorët.

1. Njësitë dy e më shumë fjalëshe i kemi trajtuar më herët<sup>5</sup> ndërsa konversioni, përkatësisht emërimi ndodh për shkak të ekonomisë së gjuhës dhe mospërsëritjes së njërive të njëjta në kontekste të caktuara. Termat si **emërorja** ose **e tashmja**, e shumë të tjera si këto konsiderohen formime me konversionin.<sup>6</sup> Është për t'u cekur se Në tekstin e Gramatikës përdorimet e tilla janë të shpeshta. Kryesisht kemi të bëjmë me emërim kontekstual. Kjo mënyrë e formimit të njërive terminologjike bashkë me njësitë e pathjeshta (togfjalëshat e qëndrueshëm ) konsiderohen formime me rrugën sintaksore.

2. Huazimi është njëra nga mënyrat e pasurimit të leksikut të çdo terminologjie prandaj edhe gramatika ka një shtresë të këtyre termave që dalin me prejardhje nga gjuhët klasike dhe që janë kryesisht ndërkombëtarizma. Akhmanova<sup>7</sup> ka theksuar se “*fjalët ndërkombëtare (me origjinë latine ose greke) që na kethejnë në retorikën e lashtë, nuk sigurojnë transmetim direkt dhe të tërësishtëm të informatës, por në të njëjtën kohë sigurojnë korrespondencën më të plotë të mundshme ndërmjet shprehjes origjinale dhe asaj metalinguistike të përkthyer*” Në tërë rrugën e zhvillimit të gramatografisë, prania e kësaj shtrese të termave haset jo vetëm në përvojën tonë. Në traditën tonë, ajo ka qenë jo e njëtrajtshme. Kështu, kemi parë një ngjashmëri midis “Shkronjëtores” së Samiut me një terminologji të pastër shqipe nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, “Gramatikën e Akademisë” gjithashtu me terminologji shqipe, por jo në masën e Shkronjëtores. Të dy këto gramatika janë udhëhequr nga parime të purizmit, të njohura jo vetëm në traditën e gjuhës shqipe. Midis këtyre dy skajeve kemi autorë gramatikash që e përfillin përdorimin e dy terminologjive: njëra shqip e tjetra në gjuhë të huaj. Autor si Xanoni, Sheperi, Rrota, Cipo, Xhuvani, Riza, Demiraj, krahas termave shqip, përdorin edhe emërtime të huazuara-ndërkombëtarizma. Sidoqoftë, terminologjia e sotme gramatikore, e

<sup>5</sup> F. Çitaku, *Togfjalëshat e qëndrueshëm në terminologjinë gramatikore*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr.29, Prishtinë, 2010

<sup>6</sup> Shembuj të njërive të formuara me konversion: *poborja, krabasorja, sipërorja, thirrvoja, emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja, rrjedhorja; emërtimet e kohëve si e tashmja, e kryera etj.; emërtimet e llojeve të përmrave si vetorët, pronorët etj; pjesorja, paskajorja, përcjellorja, mohorja...*

<sup>7</sup> Akhmanova, O.S. *A dictionary of linguistic terms*, Sovjetskaja enciklopedija, Moskow, 1966, f.91; cituar sipas Rr. Paçarizi, *Qasja kognitive në terminologji-mediet e reja dhe teknologjia*, Seminari 32..., 2013, f.69

pasqyruar në GA, ka një shtresë do të thoshim të vogël të ndërkombëtarizmave<sup>8</sup> si fjalë të mëvetësishme por edhe si pjesë e emërtimeve të pathjeshta<sup>9</sup> si dhe togfjalësha me të dy gjymtyrët fjalë të huazuara<sup>10</sup>. Të gjithë ndërkombëtarizmat e gramatikës mund të klasifikoheshin në terma të përgjithshëm, terma të morfologjisë dhe terma të sintaksës.

Në gramatikat e tjera, si ajo e Çelikut, hasen çifte të përdorimit të termit shqip dhe termit të huazuar si *objekt* dhe *kundrinor*, *subjekt* dhe *kryefjalë*, *afiks*, *prefiks*, *sufiks* dhe *ndajshitesë*, *parashitesë*, *prapashitesë*, *kompozita* dhe *fjalë të përbëra*, etj. Megjithatë, Çeliku i jep përparësi variantit shqip, sepse variantin e huazuar kryesisht (ka përjashtime) e vë brenda kllapave.

Përtej gramatikave, studiues të ndryshëm kanë ndjekur dhe ndjekin një rrugë të ndërmjetme, pra nuk janë idhtarë të përdorimit vetëm të termave shqip<sup>11</sup>.

**3.1.** Krahasuar me termat e pathjeshtë (togfjalësha terminologjikë) termat njëfjalësh janë të paktë<sup>12</sup> Si njësi njëfjalëshe, termat e formuar me ndajshitesim e përbëjnë pjesën dërmuese të terminologjisë gramatikore. Veçori e tyre është se përbëhen vetëm nga një gjymtyrë që është mbigjymtyra së cilës i bashkohet një ndashtesë që modifikon konceptin e saj duke krijuar një njësi të re terminologjike që përfaqëson një përmbajtje konceptore të re. Depërtimi në prejardhjen konceptore të çdo termi parakupton zbulimin e lidhjes që ekziston midis konceptit fillestar dhe konceptit të prejardhur.

Baza e termave të çdo terminologjie janë emrat por ata zakonisht shërbejnë për të formuar togfjalësha. Emrat e prejardhur me ndajshitesa në terminologjinë gramatikore janë kalkime nga termat e gjuhëve klasike. Në krye të herës, para se të kishim një terminologji me fytyrën e sotme, ka pasur përpjekje të shumta nga gjuhëtarët për t'i shqipëruar termat e huaj. Termat e sotëm nuk janë po ata që përdorehin dikur. Secili term ka pasur një histori. Ka ndodhur që termi i huaj të

<sup>8</sup> Shembuj të ndërkombëtarizmave: *gramatikë*, *morfologji*, *sintaksë*, *morfemë*, *morf*, *alomorf*, *lokucion*, *diatezë*, *formë*, *afiksoide*, *modalitet*, *modal*, *aspekt*, *metafoni*, *apofoni*, *supletivizëm*, *klasë*, *formant*, *konversion*, *diatezë*, *paradigmë*, *sinkretizëm*, *afektiv-e*, *sintetike-analitike*...

<sup>9</sup> Si: *(rend) afektiv*, *ekspresiv*, *(fjalë) asindetike*, *afektive*, *(gjuhë) flektive*, *(kuptim) antonimik*, *abstrakt (fjalë) polisemantik-e*, *monosemantik-e*, *supletive*, *tip (i fjalisë)*; *(tregues) grafik*, *(fjalë) pyetëse* retorike, *eliptike*, *(ngjyrim) afektiv*, *(kallëzues) homogjenë*...

<sup>10</sup> *Raporte paralele*, *raporte analoge*, *faktor semantik*, *singularia tantum*, *pluralia tantum*...

<sup>11</sup> Vlen për t'u përmendur këtu një citim nga diskutimi i F. Lekës bërë në Konferencën I të studimeve albanologjike lidhur me kumtesën e L. Dodbibajt "Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri në ditët e sotme" i cili ka të bëjë me një mendim të shprehur nga Sosyri se "me rëndësi është të emërtohen e përkufizohen nocionet pa shikuar se cilat fjalë përdoren". Nga këndvështrimi i sotëm na duket intersant se si në vitin e largët 1962 gjuhëtarë si Leka kishin njohuri për Sosyrin.

<sup>12</sup> Sipas përlloraritjeve tona në GA 1 gjenden rreth 140 terma njëfjalësh.

përkthehet me variante të ndryshme nga gjuhëtarë të ndryshëm. Sa për ilustrim po japim një shembull. Termi **konsonante** është shqipëruar me 5 variante: e **pazëshme, bashkëzantore, e përzëshme, ndërzane, përzantore** derisa ka marrë formën e sotme **bashkëtingëllore**. Ky punim nuk mëton të merret me aspektin diakronik të termave, por me termat e standardizuar.

Termtat emra me ndajshtesa, nuk cilësohen për shumësi ndajshtesash. Mund të veçonim prapashtesën –ore( **fundore, paskajore, etj**); pastaj –or (**rrethanor, thirror, përcaktor, etj**); –im (**qielzorëzim, emërzim, njëfjalëzim etj.**); –esë (**mbaresë, shkurtesë, etj.**), –z (**lidhëz, pjesëz, etj.**); –s (**kallëzues, thyes, etj.**); –ëri (**dygjijnishmëri, shumëkuptueshmëri, etj.**)<sup>13</sup>. Një pjesë e vogël e emrave formohen me parashtesa si: para- (**parashtesë, parafjalë**); prapa- (**prapashtesë**); për-(**përemër, përcaktor**), si- (**sindajshtesë**); nën- (**nënklasë**); pas-(**pasthirmë**), etj.

Termtat mbiemra e zënë vendin e parë për nga sasia dhe mjetet e formimit. Ata nuk dalin si njësi të mëvetësishme por vetëm në kuadër të njëjësive dy e më shumëfjalëshe. Në klasën e mbiemrave prapashtesa-or (e) zë vendin në krye. Si shembull mund të cekim emërtimet e rasave (**emërore...**) dhe të mënyrave (**dëftore...**) por edhe njësi si: **gjuhësor, sintaksor...**; shumica e llojeve të fjalive si **thirrmore...**; –(ë)s(e) si (fjalë) **shërbyese...** Tri janë parashtesat me të cilat formohen terma me kuptim antonimik: parashtesa: jo- si (fjalë) **jopyetëse**, (shkencë) **jogjuhësore...**) pa- si (fjalë) e **paplotë, e pagjymtyrëzueshme**, ;, zh- si (kundrinor) i **zhdrejtë**, etj.

Në klasën e mbiemrave vepron edhe nyjëzimi **si** (fjalë) e **ngurosur, e emërzuar, etj.**, madje dhe mënyrat e përziera si (mbiemër) **i nyjshëm**, (fjalë) e **ndryshueshme, e lakueshme, e zgjedhueshme**, (kundrinor) **i drejtë**, që bashkë me ndajshtesimin dhe kompozimin përfshihen në mënyrën morfologjike.

Klasa e ndajfoljeve dhe e foljeve është më e varfër. Kështu, foljet janë formuar kryesisht me prapashtesën –zo (**emërzoj, mbiemërzoj, etj.**) e ndajfoljet me prapashtesën –isht ( **sintakso-riht, morfologjikisht, gramatikisht, etj.**).

**3.2.** Në leksikon e gramatikës ka edhe terma kompozita mbiemra që kryesisht dalin si pjesë e togfjalëshave, ndërkaq kompozita emra ka pak<sup>14</sup>. Vlen të theksohet se te termtat kompozita gjenden dy gjymtyrë, nga të cilat njëra mbigjymtyrë e tjetra nëngjymtyrë. Midis këtyre gjymtyrëve qëndrojnë raporte barazie ose varësie. Pavarësisht nga raportet midis gjymtyrëve, fjala e përbërë gjithherë emërton një

---

Të gjitha këto ndajshtesa shërbejnë për të formuar emra abstraktë edhe të leksikut joterminologjik, por këtu numri i përgjithshëm i prapashtesave është i vogël krahasuar me numrin e prapashtesave që formojnë emra të leksikut të përgjithshëm.

<sup>14</sup> Shembuj të kompozitave emra: *pikëpyetje, pikëçuditje, pikëpresje, trajtëformim, fjalëformim, formëformim, fjalëformë, kryefjalë*



koncept të ri. Shumica e termave kompozita të terminologjisë gramatikore janë mbiemra me marrëdhënie bashkërenditëse ku “*koncepti rezultues paraqitet si mbledhje e shkrirjeve të koncepteve që lidhen*”<sup>15</sup>: (pjesëza) **përcaktuese-përforcuese, përforcuese-shtuese, përforcuese-theksuese, emocionale-shprehëse**; (kuptim) **kundërshtor-shtesor**; (marrëdhënie) **përqsore-kundërshtore, krahasore-mënyrore**; (ana-lizë) **etimologjike-historike**, kategori (**leksiko-gramatikore**) etj. Midis gjymtyrëve mund të vihet lidhëza **dhe**.

Te kompozitat emra me marrëdhënie përcaktore mbigjymtyra paravendoset, ndërsa nëngjymtyra është një emër foljor me prapashtesën –je si: **pikëpyetje**, pastaj kompozita me nëngjymtyrë të paravendosur, kurse mbigjymtyra është një emër foljor me prapashtesën –im si: **fjalëformim**. Disa kompozita kanë pjesë të parë nëngjymtyrën të shprehur me ndajfolje<sup>16</sup> si: kundër (**kundërvënie**), bashkë (**bashkëpërshtatje, bashkërenditje**), nën (**nënrenditje**); ndaj, (**ndajshtesim**), pranë (**pranëvënie**), para (**paravendosje**); pas (**pasvendosje**), etj.

4. Tejbartja konceptore si rrugë e formimit të termave ka vepruar dhe vepron në të gjitha terminologjitë. Koncepti i prejardhur del me veshje të njëjtë tingullore sikur edhe koncepti fillestar, përbërja tingullore ruhet e paprekur, “*pra, koncepti i prejardhur shërben si tejbartës i së njëjtës formë tingullore dhe ky proces është quajtur tejbartje konceptor*”<sup>17</sup> Procesi është i krahasueshëm me prejardhjen kuptimore që vepron te njësitë joterminologjike kur një kuptim i ri del nga një kuptim i mëparshëm brenda përmbajtjes kuptimore të së njëjtës shenjë gjuhësore që njihet si polisemi. Në terminologjinë gramatikore është një shtresë e tillë e njësisive terminologjike njëfjalëshe të motivuara nga leksiku i përgjithshëm pa ndërrim shenje si: **gjini, numër, periudhë, përshtatje, bashkim, drejtim, trajtë, lako, kuptim**, etj. por edhe njësi të pathjeshta si **kohë e tashme, kohë e shkuar, kohë e ardhme**, si dhe pjesë e njësisive të pathjeshta si (gjini) **mashkullore**, (fjalë) **e pavarur, kryesore, e varur**, (modalitet) **i domosdoshmërisë**, (mohim) **i pjesshëm, i plotë**, (fjalë) **e pandryshueshme, e ndryshueshme** etj.

Nga pikëpamja e prejardhjes konceptore, midis konceptit fillestar dhe konceptit të prejardhur ekzistojnë marrëdhënie të llojeve të ndryshme. Terma si **gjuhë, rrënjë, nyjë, pikë**, etj, që në leksikon e përgjithshëm shenjonë realie konkrete, në terminologjinë gramatikore shenjojnë koncepte abstrakte. Përveç kësaj, mund të ngrihen në terma edhe fjalë të leksikut të përgjithshëm me kuptim abstrakt si **emër, fjalë, kuptim, kohë, mënyrë**, etj,

<sup>15</sup> V. Dervishi, *artikull i cituar*, f. 82

<sup>16</sup> Në letërsinë gjuhësore këto janë trajtuar si sindajshtesa (Gramatika e Akademisë) dhe si pjesë e parë e kompozitave (Dervishi, Fjalorët e gjuhës shqipe-1980, 1984, 2006)

<sup>17</sup> V. Dervishi, po aty, f.85

Në terminologji është e pranishme dukuria kur një term i takon disa fushave të dijes. Pra, kur tejbartja konceptore ndodh nga një fushë e dijes në një fushë tjetër dhe ekziston një përbërës konceptor i cili i bashkon dhe ruan lidhjen me fushën përkatëse që termi të bëhet i tejdkushëm brenda fushës përkatëse. Kështu, bie fjala, termi **rrënjë** që u takon disa fushave të dijes, duke marrë përcaktorët përkatës si **rrënjë e bimës** për botanikë, **rrënjë e dhëmbit** për mjekësi, **rrënjë katrore** për matematikë, **rrënjë e fjalës** për gramatikë, ndonëse me veshje të njëjtë, është plotësisht i qartë brenda fushës ku përdoret. Të tilla mund të konsideroheshin edhe njësitë si: **lako** (metal.), **rizbërthim** (kim.), **trajtë** (fiz.) **kohë** (astr.), **thjeshtim** (mat.), **shkallë** (muz.) që janë pjesë e leksikut të fushave të tjera të dijes, përveç gramatikës.

### Përfundime

Në këtë referim jemi përpjekur t'i paraqesim rrugët e motivimit të termave njëfjalësh të gramatikës tradicionale që janë njësi të qëndrueshme dhe të rrënjësura gjuhësore Mjetet dhe prodhimtaria e tyre del e kufizuar në krahasim me njësitë e leksikut joterminologjik.

Sa u përket termave të gramatikës tradicionale rrugët e motivimit tyre janë po ato të njësive të fushave të tjera të dijes.

Së pari, ajo që i bashkon të gjitha terminologjitë pa përjashtim është numri i madh i njësive të pathjeshta, prandaj me të drejtë kjo rrugë është quajtur nga studiuesit si kryesorja. Ndonëse motivohen nga dy gjymtyrë, gjithherë kemi një koncept të ri si koncept rezultat. Këto njësi i kemi trajtuar në një punim tjetër.

Së dyti, termat fjalë të prejardhura motivohen nga një mbigjymtyrë dhe një ndajshitesë që modifikon konceptin bazë për të emërtuar një koncept të ri. Terminologjia gramatikore nuk shquhet me këtë mënyrë motivimi të termave, as për shumësi të ndajshitesave, rrjedhimisht as për shumësi të njësive. Ndajshitesat më prodhimtare janë –ore dhe –or për klasën e mbiemrave dhe të emrave. Klasa e foljeve dhe e ndajfoljeve del e varfër.

Së treti njësitë kompozita motivohen nga dy gjymtyrë, njëra mbigjymtyrë e tjetra nëngjymtyrë dhe raporti midis tyre është bashkërenditës (kopozita këpujore) ose nënrenditës (kompozita përcaktore) duke rezultuar me një koncept të ri. Terminologjia gramatikore ka pak kompozita krahasuar me fushat e tjera të dijes.

Së katërti, mund të motivohen terma pa e ndryshuar përbërjen tingullore të njësisë gjuhësore. Ajo që në leksikun e përgjithshëm njihet me termin polisemi, në leksikun e specializuar quhet tejbartje konceptore ose modifikim i përmbajtjes konceptore pa ndryshim shenje. Fjalë të leksikut të përgjithshëm marrin vlerë

terminologjike duke u përdorur brenda fushës së caktuar të dijes. Madje e njëjta shenjë mund të shërbejë si term i disa fushave të dijes, midis të cilave gramatika.

Së fundi mund të thoshim se terminologjia gramatikore te ne ka një traditë mbi dyshekullore. Është ndër terminologjitë e para që ka filluar të përpunohet. Termat e gramatikës tradicionale janë njësi të qëndrueshme dhe të rrënjosura gjuhësore, ani pse edhe në këtë terminologji hasen dukuri që e dëmtojnë dhe çenojnë njëkuptimësinë e tyre

Studimi i terminologjisë gramatikore tradicionale sipas Teorisë së Terminologjisë së Përgjithshme na del të jetë i vetëmjaftueshëm për arsye së kemi të bëjmë me një sistem terminologjik të qëndrueshëm, të standardizuar, ku prurjet janë të pakëta, për të mos thënë të panevojshme. Ndryshe qëndron puna me termat e gjuhësisë passosyriane ku prurjet janë më se normale dhe poashtu termat janë në proces stabilizimi e standardizimi.

### **Bibliografia:**

1. Grup autorësh (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë
2. Grup autorësh (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë
3. Çeliku, M., Karapinjalli, M., Stringa, R., (1999), *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë
4. Dervishi, V., (1991), *Termt e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor*, Studime Filologjike nr. 1, Tiranë
5. Duro, A.-Jazexhiu, V., (2006), *Motivimi në terminologjinë e agronomisë në rrafshin e termformimit*, Studime Filologjike, nr. 1-2, Tiranë
6. Bello, V., (2006), *Termt emra-bazë e formimit të terminologjisë së gjuhësisë*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare nr.26, Prishtinë.
7. Çitaku, F., (2009), *Togfjalëshat e qëndrueshëm në terminologjinë gramatikore*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare nr.29, Prishtinë.
8. Paçarizi, Rr., (2013), *Qasja kognitive në terminologji-mediet e reja dhe teknologjia*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr. 32, Prishtinë.



## Hava QYQALLA

### PJESORJA (PARTICIPI), TEZAT RRETH TIPAVE TË PJESOREVE I.E. NË SHQIPEN E LASHTË (PROTOSHQIPEN) DHE RUAJTJES SË GJURMËVE NË SHQIPEN E SOTME

Pjesorja sot hyn në grupin e formave të pashtjelluara foljore sintetike dhe është formë e trashëguar i.e. Mirëpo nga termi gramatikor i saj si te S. Frashëri (përgjysmore), te Xanoni (përgjysmuer) si dhe ai i sotmi nga latinishtja participium, dëshmon se kjo formë kishte dhe ka tipare karakteristike edhe foljore edhe emërore përkatësisht mbiemërore.

Në gjuhë të ndryshme i.e. si në latinishten, pjesore ishte edhe ajo e tipit *laudans~laudant-is*, e cila lakohej si një emër, por kishte kuptim vepror dhe mund të merrte kundrinë, edhe ajo e tipit *laudatus*, e cila shërbente për të formuar të kryerën analitike joveprore të tipit *laudatus sum*, e cila përshtatej në gjini, numër e rasë me emrin ashtu si mbiemri (*laudat-us,-a,-um,-i,-ae,-a*).

Sipas shumicës së gramatikave historike të shqipes, është pranuar se nga materialet e gjuhëve të dokumentuara herët me shkrim është arritur perfundimi që indueropianishtja ka pasur disa tipa pjesoresh që ndërtoheshin me prapashtesat *-\*nt*, dhe *-\*ues,-uos,-us*, përkatësisht me *-\*meno/-mo*.

Format e pjesoreve me *-\*nt* ,ndërtoheshin nga të gjitha kohët me përjashtim të së kryerës dhe kishin kuptim vepror. Ato me më *-ues, uos -us* ishin pjesore të së kryerës me kuptim vepror, kurse ato me prapashtesën *-meno/-mo*, ishin pjesore të së kryerës me kuptim pësor si në greqishte *pheromenos* “bartur” etj.

Përveç këtyre, të sistemit parcipor i.e dëshmoheshin edhe prapashtesat *-\*to , -\*no*, të cilat përdoreshin kryesisht te mbiemrat foljorë me kuptim përgjithësisht pësor dhe me vlerë pjesoreje.

Për t`iu përmbajtur titullit të kumtesës do te ndalem vetëm në pjesoren e shqipes dhe reflekset e prapashtesave i.e. në të, konkretisht në ruajtjen apo në gjurmët e tipave të sistemit parcipor të protoshqipes i.e. në shqipen e sotme.

Dimë qe pjesorja sot hyn në sistemin foljor e cila ka kuptim kryesisht jovepror që tregon një veprim si tipar që e ka kryer kryefjala në një kohë para se të flasim, dhe përmes paranyzimit bën pjesë edhe në sistemin mbiemëror,por siç mendojnë disa

studiues ,në vertikalen diakronike edhe shqipja kishte pjesore me tipare emërore/mbiemërore ,të cilat janë reflektuar edhe në shqipen e sotme.Pjesorja e shqipes së dokumentuar rezulton me këto prapashtesa:-r, -ur,-në,-rë dhe -ë, të cilat sipas disa studiuesve janë reflekte të drejtpërdrejta nga prapashtesat e përmendura i.e.,por jo të gjithë studiuesit pranojnë se prapashtesat e shqipes së sotme janë reflekte të prapashtesave të përmendura i.e. dhe se në shqipen është ruajtur vetëm pjesorja e shkuar joveprore(participi pasiv i perfektit).

Për këto çështje mendimet janë shumë të diskutueshme dhe të ndara ,por këtu do t'i trajtojmë vetëm mendimet dhe tezat për tipat e pjesoreve në protoshqipen i.e. dhe reflektet e tyre në shqipen e sotme. Sipas shumicës së studiuesve mendohet se në shqipen është ruajtur vetëm pjesorja e së shkuarës pjesore pra pjesorja e sotme, por që nga F. Bopp-i, G. Majer-i, Xanoni e kohën e fundit B. Bokshi, pranojnë mendimin se në shqipen ndeshen gjurmë edhe të pjesores së tashme veprare me prapashtesën **-\*nt**, madje Bokshi shkon edhe më tej, ku siç do të shohim, vërteton se edhe protoshqipja i.e. kishte disa tipa pjesorësh, të cilët përmes gjurmëve dëshmojnë edhe në shqipen e sotme.Pra sipas lagjes së dytë të studiuesve të përmendur në shqipen janë ruajtur gjurmë edhe të pjesores së tashme veprare me prapashtesën **-nt** tek emrat e vepruesit mësues, krijues etj. Për këto gjurmë dhe në mbështetje të kësaj teze kemi edhe materialet e sjella nga E. Paço të nxjerrë nga vepra e P. Bogdanit:ntrets, përpins, dalës (që ka dalë) etj.

Argumentet, të cilat na çojnë në perkrahjen e një teze të tillë, janë shterruese dhe të sakta karshi atyre që nuk e kanë perkrahur një teze të tillë. Këto argumente në mënyrë shterruese i ka trajtuar dhe avancuar prof. Bokshi në monografinë kushtuar pjesores në vështrim historik.

Për këtë çështje ai pajtohet me mendimin e Boppit se shqipja do ta ketë pasur këtë particip, por jo me deformim të drejtpërdrejtë të-**t**-ës në **-s** ,siç mendoi fillimisht Boppi, por me mendimin tjetër të tij, përmes alternimit të **-t**-ës në **s**- nga prania e një **i**-je (**-\*ntia**) .Pra për Bokshin participi aktiv i prezentit është i ardhur nga dy pjesë **-\*ti** që është i zgjerruar me **-\*on**(**-\*tion**)

Dhe për Bokshin prapashtesa **-\*ti** në formën e gjinisë mashkullore krijonte “nomina agentis,kurse në formën femërore nomina actionis”Pastaj Bokshi sqaron se si nis polarizimi i gjinisë në” protoshqipen që ishte process shumë i lashtë ,kur të gjitha temat emërore në -o të shkurtër hynin në gjininë mashkullore ,kurse ato më –a të gjatë në gjininë femërore dhe protoshqipja edhe këtë formë do ta kishte **\*-tio** për gjininë mashkullore ,kurse **\*-tia** për gjininë femërore edhe tek emrat e gjallesave për të shënuar opozicionin e seksit edhe te mbiemrat e paleksikalizuar në perdorim me emra gjenerikë ku opozicioni i gjinisë shënohej me kalim nga njëra temë në tjetrën”.Emra të tillë sipas Bokshit janë edhe emrat e prejardhur me prapashtesën –ës/-s që dalin te

Xhuvani e Çabej si *mbajës gërresë, shtysë* etj . të krijuar me leksikalizim të formës femërore të emrave të vepruesit, njësoj si janë leksikalizuar emrat *kapsë, fshisë, grisë* etj. krahas leksikalizimit të formës së tyre mashkullore *shtypës, çelës* etj.

Dhe në fund Bokshi sqaron se nga kjo fazë mund të rezultojë se forma e mashkullores me temë në o të shkurtër do të rezultojë në shqipen e dokumentuar me –s kurse forma femërore me temë në a te gjatë do të rezultojë me emra në së e cila gjatë zhvillimeve të gjuhës është transformuar në e (mësues-ë –e pastruesë ~pastruese etj.)

-Si refleks pjesoreje i.e. të protoshqipes Bokshi me të drejtë i konsideron edhe mbiemrat e sotëm që dalin me prapashtesën –shëm/-shme. Këtë prapashtesë Bokshi e sjell te formuar nga dy pjesë ;\*-sio(-sia),prapashtesë e së ardhmes (futurit ) dhe -\*mo(-ma),prapashtesë e mediopasivit të njëkohësisë. **\*-sio+mo=shëm**. Me këtë prapashtesë sipas Bokshit është krijuar participi pasiv i futurit që tregohet edhe per nga aspekti kuptimor që kanë mbiemrat me këtë prapashtesë: *i thyeshëm =që mund të thyhet ;i përdorshëm =që mund të përdoret a do të përdoret e tj.*

Kjo prapashtesë që është e mbarë shqipes nuk del në relacion me temë foljore në funksion foljor që nga dokumentet e para të shqipes ,por ekziston vetëm në funksion mbiemëror dhe ndajfoljor në relacion me temë foljore dhe jofoljore.

- Pjesore të protoshqipes i.e. Bokshi e konsideron edhe atë me prapashtesën -*\*lo~\*la(-l-lë)*,e cila sipas studimeve dialektore perdoret në në çamërishte (vajtëlë, mbledhëlë), në të folmet e Gjirokastrës (lejlë~lindje etj.). Këtë e pranon si një emërzim të pjesores me ç`rast arsyetohet edhe mungesa e emrave të veprimit në gjininë mashkullore.Pra me këtë formant sot formohen disa emra të veprimit si vajtje, mbledhje lindje etj.

- Sipas Bokshit, pjesore në protoshqipen ishte forma me prapashtesën -*\*mo~ma*, e cila ishte pjesore mesore e së tashmes (participi medial prezentit që na jep m~më në shqipen e sotme.

Nga ky tip pjesoreje rezultojnë emrat e tipit bimë, mjelm, shkelm etj. në të cilët dallohet kuptimi participor edhe sot d.m.th.bimë =që mbin, mjelmë =që milet etj. Këta emra, sipas Bokshit, janë 'leksikalizime të formave të gjinisë mashkullore (-*\*mo~m*) dhe të gjinisë femërore (-*\*ma~më* ) në kohën kur nuk ishte krijuar ende nyja. Në këtë vlerësim, Bokshi pajtohet me E.Hempin, i cili këtë prapashtesë të shqipes e barazon me prapashtesën –m te baltoslavishtes ku ka vlerë të participit pasiv të prezentit si në shqipen.

Dhe si formë të participit i.e.të protoshqipes, e cila në shqipen e sotme reflekton pjesoren e së kryerës pjesore domethënë pjesoren e sotme, Bokshi konsideron vetëm format me prapashtesën -*\*no~\*na* që kanë dhënë -n dhe –në në

shqipen e sotme. Nga këto variante prapashtesash forma me **-no** të shkurtër ishte për gjininë mashkullore, kurse ajo - **na** me a të gjatë për gjininë femërore. Nga keto variante gjatë zhvillimit historik të shqipes forma e mashkullores u bë formë e vetme në përdorim foljor, kurse në përdorim mbiemëror u ruajt kundërvënia e gjinisë -n~në.

Bokshi në monografinë e tij për pjesoren përveç këtyre të dhënave shtrerruese për tipat e pjesoreve i.e. në protoshqipen dhe reflekset e tyre në shqipen e sotme, qartësoi edhe shumë çështje të lidhura me tipin e pjesores së sotme dhe relacioneve të saj qoftë me prapashtesat i.e. qoftë me lidhjen e saj me tipin e hershëm të participit i.e..si dhe me gjendjen përdorimin dhe distribucionin e prapashtesave të pjesores në relacione qoftë foljore ,emërore apo mbiemërore.

### **Përfundim**

Nga sa u tha mund të konkludohet se shqipja (protoshqipja i.e.) kishte një sistem të begatë participor, njësoj si gjuhët e tjera i.e. me një histori të gjatë shkrimore. Por u desht kohë për t'i ndriçuar këto veçori si edhe shumë të tjera, për shkak të rrethanave tani më të njohura historike, sidomos për strukturën e saj. Merita kryesore në ditët tona i bie prof. Bokshit, tani i ndjerë, i cili në gjithë krijimtarinë e tij shkencore për historinë e strukturës së shqipes ishte shumë kritik ndaj tezave jo vetëm të diskutueshme, por herë herë edhe të pranuar shkencore, duke i afruar lexuesit të dhëna shkencore, argumentuese dhe bindëse për t'i përkrahur tezat e tij. Prandaj, do të ishte një interes i veçantë për historinë e strukturës së shqipes të rilindej një shkencëtar i tillë.

Qoftë i ndritshëm shpirti i tij, ashtu siç ai ndriçoi historinë e strukturës së shqipes!

### **Bibliografia:**

1. Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik*, Prishtinë 1998
2. Besim Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë 2005 (ribotim)
3. Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipes*, Prishtinë 1988



Merima KRIJEZI

## KONSTRUKSIONI I RRJEDHORES ME PARAFJALËN *SIPËR* NË GJUHËN SHQIPE DHE NUANCA E TIJ SEMANTIKE TE BARASVLERËSIT NË SERBISHT

### Abstrakt

Punimi merret me analizën e kuptimit dhe të funksioneve të konstruksionit parafjalor-rasor në rrjedhore me parafjalën *sipër* në gjuhën shqipe dhe atyre që përfaqësojnë barasvlerësit e tij në serbisht. Shqipja dhe serbishtja u takojnë dy grupeve të ndryshme të familjes së gjuhëve indoevropiane dhe karakterizohen nga sisteme rasore të ndryshme. Gjuha shqipe ka pesë rase, midis të cilave radhitet edhe rrjedhorja, si rasë me vete. Serbishtja ka shtatë rase, midis të cilave nuk llogaritet rrjedhorja (ekziston vetëm si gjinore ablativ: *ablativni genitiv*). Ndryshimet që i referohen sistemit rasor të këtyre dy gjuhëve, reflektohen dhe transferohen në vetë sintagmat e tyre. Në gjuhën shqipe, kuptimi i konstruksionit parafjalor-rasor në rrjedhore, në numrin më të madh të rasteve, përfaqëson ekuivalentin e tij në lokativin me parafjalën *na, po* dhe akuzativin me parafjalën *na* në gjuhën serbe. Gjatë përkthimit të disa fjalëve nga shqipja në serbisht ndeshim me vështirësi, që lidhen me konstruksionet që tregojnë vendin a hapësirën mbi të cilën një entitet është mbështetur ose futur apo mbi të cilën është shtrirë dhe që kanë kuptim sinonimik. Në gjuhën shqipe këto janë konstruksione me parafjalën *mbi* dhe *sipër*.

Qëllimi i punimit është të tregojë ngjashmërinë lidhur me kuptimin dhe funksionet e këtyre sintagmave në këto dy gjuhë.

**Fjalë kyç:** konstruksione parafjalore-rasore, parafjala *sipër*, semantika, analizë kontrastive, gjuhë shqipe, serbisht.

Edhe pse në të gjitha gjuhët indoevropiane parafjalët përcaktohen si fjalë të pandryshueshme, që nuk kanë kuptim leksikor të pavarur, ato kurrë nuk janë krejtësisht të privuara nga kuptimi i tyre i mirëfilltë leksikor. Ato posedojnë një dozë të vlerës së tyre kuptimore, që konkretizohet në një tërësi, më të madhe, domethënë në një konstruksion ose, në kuptimin më të ngushtë, sintagmë rasore (shih te Stevanović:

159). Shumë funksione të rasave, posaçërisht rasave të drejta, pasqyrohen në sintagma. Me fjalë të tjera, sintaksa e rasave në serbisht dhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane pasqyrohet në sintagma (në terminologjinë serbe dallohen me emrin sintagmë rasore e në terminologjinë e gjuhës shqipe me emrin sintagmë parafjalore). Gjuha shqipe dhe gjuha serbe u takojnë dy grupeve të ndryshme të familjes indoevropiane dhe karakterizohen nga sisteme rasore të ndryshme. Një shqyrtimi më i hollësishëm i sistemit rasor të këtyre dy gjuhëve tregon se ky ndryshim vërehet jo vetëm te numri i rasave<sup>1</sup>, por edhe te konstruksionet rasore, te kuptimi dhe funksionet e tyre. Përveç divergjencave, dallohen edhe ekuivalencat (barasvlerësimet) në kuptimin e disa konstruksioneve rasore në këto dy gjuhë (krahaso M. Stevanović; Agalliu F., Angoni E. et al.). Shumë rrallë mund të flasim për përkim të plotë të këtyre konstruksioneve që do të nënkuptonte përkimin e formës rasore të emrit dhe të parafjalës që i paraprin dhe kuptimeve të tyre. Në punimin tonë jemi përqendruar te shqyrtimi i kuptimeve të konstruksionit në rrjedhore me parafjalën *sipër* në gjuhën shqipe dhe barasvlerësit e tij në serbisht<sup>2</sup>.

Parafjala *sipër* do të thotë në serbisht: *nad, iznad, (po)više, na*, varësisht nga konteksti edhe: *po, preko*. Konstruksioni në rrjedhore me parafjalën *sipër* mund të tregojë:

1. Sipërfaqen e një objekti ose vendi mbi të cilin një entitet është mbështetur, është vënë, mbi të cilin lëviz ose mbi të cilin kryhet një veprim. Kuptimi i këtij konstruksioni është i barasvlerëshëm me kuptimin e konstruksionit në lokativin me parafjalën *na, po*, por gjithashtu me kuptimin e konstruksionit në kallëzore me parafjalën *na* në serbisht, kur me të tregohet vendi. Ja disa shembuj:

a.) Mbajtja e një çante apo e një valixheje pune *sipër tryezës*, do të ishte e papërshtatshme dhe të krijonte një lloj barriere midis jush dhe intervistuesit (RM)<sup>3</sup>. - Držanje torbe ili aktntašne *na stolu*, bi bilo neprilično i stvorilo bi neku vrstu barijere između Vas i onih koji obavljaju intervju.

<sup>1</sup> Gjuha shqipe ka pesë rasa, kurse serbishtja ka shtatë. Në sistemin rasor të gjuhës serbe është përfshirë edhe thirrora, ndërsa në gjuhën shqipe thirrora është përjashtuar nga sistemi rasor, thirrora ka të njejtën formë me emëroren në trajtën e pashquar.

<sup>2</sup> Duke punuar si pedagoge e gjuhës shqipe në Beograd kam vërejtur se studentët tanë, që e mësojnë shqipen si gjuhë e huaj, ballafaqohen me ca vështirësi dhe pengesa lidhura me kuptimet e këtyre parafjalëve. Gabimet e tyre në procesin e përkthimit nga serbishtja në shqip dhe anasjelltas më kanë motivuar të shkruaj një kumtesë që mundësisht do t'ua lehtësojë përvetësimin e gjuhës shqipe dhe do t'u sqarojë disa paqartësi të lidhura me kuptimin e këtyre parafjalëve.

<sup>3</sup> Shkurtim për revistën *Mapo*. Meqenëse në punim janë përdorur vetëm dy fjali marrë nga teksti i botuar në këtë revistë, gjatë vitit 2012, nuk dëshirojmë të rëndojmë punimin me citimin e linqeve.

b.) Flija *sipër tryezës*. - Spavao sam *na stolu*.

c.) Kur erdha në shtëpi kam parë vetëm vajzën e vogël *sipër krevatit* (RM). - Kada sam stigla kući videla sam samo mlađu ćerku *na krevetu*.

2. Hapësirën mbi një entitet, ku kryhet një veprim, por ku nuk ka kontakte me entitetin (entitetet). Ky konstruksion në rrjedhore në shqip me kuptimin e tij është ekuivalent me kuptimin e konstruksionit në gjinore me parafjalën *iznad* në serbisht:

a.) Fluturonte *sipër kokave* tona. - Leteo je *iznad* naših *glava* (FGJSH 1981: 1756).

b.) *Sipër goditjeve* ngrihej zëri i Profesorit dhe në veshët e mi mbërrinte një zhurmë e mbytur... -*Preko udaraca* uzdizao se glas Profesora i do mojih ušiju dopirala je prigušena buka... (Kongoli 2003: 41).

c.) Banonin *sipër nesh*. - Stanovali su *iznad nas*.

3. Gjendje ose sasi që është mbi të priturit, normal, të zakonshëm:

a.) *Sipër mesatares* evropiane. - *Iznad* evropskog *proseka*.

b.) *Sipër planit*. - Preko plana (Preko planiranog). (fjalë për fjalë- *Iznad plana*) (FGJSH 1981: 1756).

c.) *Sipër mundësive* të saj. - *Izvan* njenih *mogućnosti*.

4. Vepruesit e një veprimi, që edhe fizikisht është mbi objektin. Me këtë konstruksion tregohet një send, që njëkohësisht është edhe objekti i veprimit ose vështrimit (vëzhgimit). Ky konstruksion është i barasvlershëm me konstruksionin në instrumental me parafjalën *nad* në serbisht. Ja disa shembuj:

a.) Rri gjithë ditën *sipër librave*. - Ceo dan je *nad knjigama* (FGJSH 1981: 1756).

b.) Për ditë me radhë rri ulur *sipër atyre letrave* të tij dhe nuk del nga zyra. - Vec dani sedu *nad* onim svojim *papirima* i ne izlazi iz kancelarije. (*bised*)

Duke bërë analizën e kuptimeve të konstruksionit në rrjedhore me parafjalën *sipër* në gjuhën shqipe dalluam edhe një përjasje. Kuptimi i konstruksionit me parafjalën *sipër* së pari është tregimi i vendit, më konkret tregimi i sipërfaqes mbi të cilën është mbështetur, është vënë një entitet ose mbi të cilën është shtrirë. Pikërisht ky kuptim na jep përshtypjen që parafjalët *sipër* dhe *mbi* kanë kuptimin sinonimik (shih te Samara: 73, FGJSH 2006:604). Do të thoshim që midis tyre ekziston një nuancë shumë e vogël semantike që në shumicën e rasteve është edhe e pakapshme. Do të krahasojmë këto fjali:

1. U shtri *mbi rërë*.

2. U shtri *sipër rërës*.

Të dyja fjalitë mund t'i përkthejmë në serbisht si: Legao je *na* pesak, e secilën fjali si:

1. Opružio se *na pesku*.

2. Opružio se *po pesku*.

Ose:

3. *Sipër tryezës* prej druri palos faqet e librit të tejdukshëm. - *Po* drvenom *stolu*


slažem stranice providne knjige.

4. *Mbi tryezë* prej druri palos faqet e librit të tejdukshëm. - *Na* drveni *sto* slažem stranice providne knjige.

Është interesant fakti që pikërisht shembujt e lartpërmendur na japin përshtypjen që parafjala *sipër* tregon jo vetëm sipërfaqen, mbi të cilën një entitet është mbështetur, është vënë, lëviz ose mbi të cilën kryhet një veprim, por që në disa raste bëhet fjalë edhe për sipërfaqen e tërë ose për pjesën shumë të madhe të sipërfaqes mbi të cilën entiteti shtrihet. Në këtë aspekt parafjala *sipër* e ka barasvlerësin në parafjalën *preko* dhe *po* në serbisht.

Për serbishtfolësit kjo nuancë bëhet e dukshme dhe vërehet në procesin e përkthimit. Të dy variantet janë në përputhje me normën letraro-gramatikore dhe janë ekuivalente me kuptimin e tyre. Shembujt 3 dhe 4 mund të përkthehen edhe si: *Po* drvenom *stolu* slažem stranice providne knjige, por edhe si: *Na* drveni *sto* slažem stranice providne knjige. Se për cilin variant do të vendosë personi që përkthen një tekst varet nga zgjedhja e tij personale. Megjithatë, gjatë përkthimit nga serbishtja në shqip, nën ndikimin e gjuhës së tij amtare, shumica e serbfolësve me siguri do të përdorë parafjalën *mbi* në vend të parafjalës *sipër*.

Parafjalët *mbi* dhe *sipër* tregojnë marrëdhënie hapësinore. Duke shikuar sistemin koordinativ bëhet fjalë për pikat që gjenden në boshtin vertikal, mbi një pikë tjetër referente në hapësirë. Megjithatë, edhe pse flasim për parafjalë që kanë kuptim sinonimik, kur vjen fjala për marrëdhëniet hapësinore parafjala *sipër* cakton pikën që është pozicionuar pak më lart në boshtin vertikal në krahasim me pikën që cakton parafjala *mbi*. Parafjala *mbi* do të thotë - *na*, *nad* në serbisht, e më pas *iznad*, ndërsa parafjala *sipër* – do të thotë *iznad*. Situata konkrete më mirë mund të ilustruhet me grafikun e mëposhtëm:




Grafiku tregon sinonimin midis parafjalëve *në* dhe *mbi* dhe parafjalëve *mbi* dhe

*sipër*. Elementi kopulativ i gjithë sistemit përfaqëson parafjala *mbi*. Pika më e ulët në hapësirë është caktuar me parafjalën *në*, ndërsa më e larta me parafjalën *sipër*. Për shembull:

1. Librat janë *në* tryezë. = Librat janë *mbi* tryezë.
2. Zogjtë fluturonin *mbi* kokat tona. = Zogjtë fluturonin *sipër* kokave tona.
3. Banon *sipër* nesh. (FGJSH 1981: 1756)

Nuk mund të themi: a.) Banonin *mbi* ne. Vetëm: b.) Banonin në katin *mbi* banesën tonë.

Në serbisht sinonimia semantike ekziston midis parafjalëve *nad* dhe *iznad*, dhe kjo nuk e përfshin parafjalën *na*. Parafjala *iznad* përfaqëson parafjalën e parregullt (e motivuar) që është e prejardhur nga parafjala *nad*, dhe kjo do të mund të jetë arsyeja kryesore e sinonimisë të kuptimit të tyre<sup>4</sup>. Në sistemin koordinativ e gjuhës serbe parafjala që cakton pikën më të ulët është parafjala *na*. Parafjala *nad* është pika e pozicionuar pak më lart, kurse parafjala *iznad* përfaqëson pikën më të lartë në sistem. Pra, grafiku që tregon situatën në serbisht duket kështu:



Për shembull:

1. Knjige su *na* stolu.
2. Knjige su *nad* stolom. = Knjige su *iznad* stola.
3. Leteli smo *iznad* oblaka.

Në serbisht nuk mund të themi: Leteli smo *nad* oblacima. Vetëm: b.) Leteli smo *iznad* oblaka ose Leteli smo *na* oblacima.

Përshtypja e përgjithshme është se në shqip parafjala *sipër*, ka një ndryshim cilësisht të dallueshëm nga parafjala *mbi*, ka perimetër më të madh jo vetëm në boshtin

---

<sup>4</sup> M. Stevanović, Savremeni srpskohrvatski jezik II, Beograd, 1991, f. 424.

vertikal, por edhe në atë horizontal. Duket se kjo vlen edhe për parafrjalën *iznad* në serbisht.

### **Bibliografia:**

1. Agalliu Fatmir, Angoni Engjëll, Demiraj Shaban, Dhrimo Ali, Hysa Enver, Lafe Emil, Likaj Ethem (2005). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
2. Samara, Miço (1999). *Parafrjalët në shqipën e sotme (Vështrim leksiko-semantik)*, Tiranë: Panteon.
3. Stevanović, Mihajlo (1991). *Savremeni srpskohrvatski jezik II*. Beograd: Naučna knjiga.
4. Xhuvani, Aleksandër (1985). *Vëpra I*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH.
1. FGJSH 1981: Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë, Akademia e Shkencave të RPSSH/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
2. FGJSH 2006: Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

### **Letërsi e vjelë:**

Kongoli, Fatos (2003). *Lëkura e qenit*, Botimet Toena, Tiranë.

**Ariane EISSEN**

## **UN LECTEUR FRANÇAIS PEUT-IL COMPRENDRE KADARÉ ?**

Quiconque se penche sur la bibliographie en français de et sur Kadaré relèvera une concentration de titres au tout début des années 1990 — à l'époque, donc, où l'auteur demande et obtient l'asile dans ce pays. Paraissent ce que Robert Elsie appelle sa « trilogie politico-littéraire<sup>1</sup> » (*Printemps albanais* ; *Invitation à l'atelier de l'écrivain* ; *Poids de la Croix*)<sup>2</sup>, mais aussi deux livres d'entretien (*Entretiens avec Eric Faye* et *Dialogue avec Alain Bosquet*)<sup>3</sup>, et les premières monographies critiques<sup>4</sup>. Parallèlement, les éditions Fayard publient coup sur coup *Le Palais des rêves* (1990), *Le Monstre* (1991), *La Pyramide* (1992), *La Grande Muraille*, suivi de *Le Firman aveugle, récits* (1993), *Clair de lune* (1993) et *L'Ombre* (1994). C'est donc un temps particulièrement fort de la réception de Kadaré en France qui associe les œuvres, des autobiographies de l'auteur et un discours critique qui tend à dominer depuis lors.

Or il est fort possible que nous ayons affaire là à l'émergence d'une construction discursive qui, tout en assurant à Kadaré l'audience qu'il mérite sans conteste, détourne le lectorat français (et d'autres publics encore) d'une compréhension sensible aux mutations historiques, fine et complexe, de son œuvre. En un mot, la reconnaissance de Kadaré n'irait pas sans une forme de méconnaissance.

---

<sup>1</sup> Robert Elsie : *Studies in modern Albanian literature and culture*, Boulder (Colorado), East European Monographs ; distribué par : New York, Columbia University Press, 1996, p. 119 (« a sort of politico-literary trilogy »).

<sup>2</sup> Ismail Kadaré : *Printemps albanais*, Paris, Fayard, 1991 ; *Invitation à l'atelier de l'écrivain* suivi de *Le Poids de la Croix*, Paris, Fayard, 1991.

<sup>3</sup> Ismail Kadaré : *Entretiens avec Eric Faye*, Paris, José Corti, 1991 ; *Dialogue avec Alain Bosquet*, Paris, Fayard, 1995.

<sup>4</sup> Anne-Marie Mitchell : *Un rhapsode albanais : Ismail Kadaré*, Marseille, Le Temps parallèle éditions, 1990 ; Eric Faye : *Ismail Kadaré. Prométhée porte-feu*, Paris, José Corti, 1991 ; Fabien Terpan : *Ismail Kadaré*, Paris, Editions universitaires, 1992 ; *Ismail Kadaré, gardien de mémoire (actes du 2<sup>e</sup> Colloque international francophone du Canton de Payrac, 11 au 13 septembre 1992, organisé par l'Association des écrivains de langue française)*, présentation d'Ismail Kadaré par Maurice Druon, sous la direction de Jacques Augarde, Simone Dreyfus et Edmond Jouve, Paris, Sepeg international, 1993.

Je vou

drais donc cerner les contours de ce discours critique largement partagé qui conditionne les modalités de lecture des lecteurs français ; puis montrer ce qui prouve qu'il faut sortir de cette vulgate interprétative, afin de poser de nouvelles questions à l'œuvre de Kadaré en se donnant de nouveaux moyens intellectuels à cette fin.

### Principaux éléments de la réception actuelle de Kadaré en France

Kadaré a assuré en partie lui-même la réception de son œuvre dans *Le Poids de la Croix*, où il livre à la fois un récit biographique sur son parcours d'écrivain, une image de son éthos d'auteur et un art poétique. Il présente ses débuts comme poète, sous le signe d'une dissidence esthétique qui lui vaut à Moscou, en 1959, à la fois l'estime de David Samoilov et une mise en garde de celui-ci<sup>5</sup>; puis il évoque son succès de romancier grâce au *Général de l'armée morte* (1961, puis 1963), avant que les audaces formelles du *Monstre*, publié dans le numéro de décembre 1965 de *Nëntori*, n'en interdisent la parution en tant que roman, et que la révolution culturelle n'impose une adhésion forcée aux règles du réalisme socialiste dans *Noces* en 1967. Enfin, se serait mis en place un compromis avec le Guide : protégé par la préparation de *l'Hiver de la grande solitude*, Kadaré peut écrire *Les Tambours de la pluie*<sup>6</sup> et *Chronique de la ville de pierre*<sup>7</sup> et lorsqu'une première version de l'œuvre lui vaut une salve de critiques, c'est Hoxha lui-même qui y mettra fin, comme si le roman devenait pour son auteur un « talisman<sup>8</sup> », qu'il faut toutefois garantir par une deuxième version du roman, *Le Grand Hiver*. Le parcours biographique est donc décrit en termes de ruse, de stratégie, et a pour corollaire un autoportrait de l'auteur en être double, qui s'oppose en se protégeant, et allie sauvegarde et soumission. Cette stratégie, lui permet de poursuivre son œuvre dans une sorte de tension permanente entre ses véritables élans créateurs, qui le menaient vers « l'épique, la distance du regard, l'impartialité vis-à-vis des personnages et des événements<sup>9</sup> », et la nécessité de payer régulièrement un tribut, de

<sup>5</sup> Shaban Sinani : *Le Dossier Kadaré*. Suivi de *La Vérité des souterrains*, Ismaïl Kadaré avec Stéphane Courtois, Paris, Odile Jacob, 2006, p. 159.

<sup>6</sup> Ismaïl Kadaré : *Les Tambours de la pluie*, Paris, Hachette, 1972.

<sup>7</sup> Ismaïl Kadaré : *Chronique de la ville de pierre*, Paris, Hachette, 1973.

<sup>8</sup> L'expression appartient à Eric Faye (préface au sixième tome des *Œuvres*, Fayard, 1998, p. 12). Elle ne me semble pas trahir des formulations de Kadaré lui-même, comme celles que l'on trouve page 329 du *Poids de la Croix* (*op. cit.*) : « Sans le roman *Le Grand Hiver*, quatre-vingts pour cent de mon œuvre n'auraient pu être écrits. »

<sup>9</sup> Shaban Sinani, *Le Dossier Kadaré*, *op. cit.*, p. 147. Ismaïl Kadaré formule une idée proche dans *Le Poids de la Croix* (*op. cit.*, p. 348) à propos du *Général de l'armée morte* et des *Tambours de la pluie*,



donner des gages au régime. Ce double jeu avec le pouvoir se retrouverait dans l'esthétique des textes, qui usent de l'obscureté, de l'allusion et de l'allégorie pour faire passer des messages dissidents, l'évocation de l'empire ottoman permettant par exemple une critique à mots couverts des mécanismes d'oppression du communisme albanais.

Cet autoportrait (ici rapidement repris, bien sûr) présente le geste créateur comme relevant de la sphère intime, de la rêverie, voire du rêve. Il est significatif que le volume français du *Poids de la Croix* s'ouvre sur l'*Invitation à l'atelier de l'écrivain*, qui livre, précisément, plus d'un récit onirique. Dans son autobiographie, Kadaré insiste sur sa double vie, en quelque sorte : les heures passées dans son bureau, à son domicile, où il est dans son élément, dans le hors temps des visions poétiques et du dialogue avec les grands textes ; et les moments d'apparition et de travail dans la sphère socio-politique, qui sont autant de menaces, pour son œuvre voire, selon les périodes, pour sa personne. Est-ce pour cela que les douze tomes des *Œuvres*, parus chez Fayard entre 1993 et 2004, ne suivent pas l'ordre chronologique des premières parutions, organisant ainsi une réception en quelque sorte anhistorique des textes par le lecteur, avant tout plongé dans l'univers imaginaire d'une œuvre exceptionnelle ?

Il arrive toutefois que ce discours sur soi et sur les textes, qui articule biographie, autoportrait et incitation à lire les œuvres sous un angle bien précis, se heurte au réel ; et que le lecteur, qui y avait adhéré pour commencer, éprouve la nécessité de se détacher du commentaire de l'auteur sur son parcours et sur ses textes. Ce lecteur<sup>10</sup> va alors de découvertes en questions !

### Des interrogations nouvelles

Si, par réflexe scientifique, on cherche à lire les œuvres de Kadaré dans l'ordre de leur parution et dans les éditions d'origine, on se trouve tout d'abord face à un mode de circulation et de réception tout à fait différent de celui qui domine à partir des années 90. Je résume ici la communication que j'ai donnée à ce sujet à Venise en mai 2011<sup>11</sup>. En 1970, la préface de Robert Escarpit au *Général de l'armée morte*<sup>12</sup>,

---

en faisant valoir son « attitude de neutralité » et son « absence totale de subjectivité » vis-à-vis des deux protagonistes, pourtant ennemis (un général italien et un pacha turc).

<sup>10</sup> Qui peut être une lectrice ! Est-il nécessaire de préciser que les pages que je livre ici sont nourries d'expériences réelles, d'interrogations et de perplexités qui ont été et sont encore largement les miennes ?

<sup>11</sup> Ariane Eissen : « La réception d'Ismail Kadaré en France dans les années soixante-dix », in *La Scrittura obliqua di Ismail Kadare/L'écriture oblique d'Ismail Kadare. Balcanistica e comparatistica*, Venise, Granviale editori, 2012, p. 13-30.

<sup>12</sup> Ismail Kadaré : *Le Général de l'armée morte*, Paris, Albin Michel, 1970.

symboliquement datée du 28 novembre [1969], instaure habilement un double éclairage sur le roman, en vantant sa « stature mondiale » autant que sur « l'austère langage de son communisme ». En 1972, la postface d'Aleks Buda à l'édition Hachette des *Tambours de la pluie* propose beaucoup plus nettement un type de lecture politiquement engagé, qui y voit la célébration d'une « conscience de la lutte [du peuple albanais] forgée dans la lutte » (268) et la manifestation d'une « lutte des classes » (262). Quant à l'anthologie sur *Ismail Kadaré et la nouvelle poésie albanais*, que procure Michel Métais pour le compte des éditions P.J. Oswald, en 1973, elle prend un sens militant par la collection dans laquelle elle paraît<sup>13</sup> et elle rappelle le double piège dans lequel l'Albanie a évité de tomber : celui tendu par la Yougoslavie (p. 8) et celui de la mise au pas par les Soviétiques (ibidem). Autrement dit, ce qui est mis en avant ici est une réception politisée et actualisée de l'œuvre de Kadaré, éloignée de celle qui prévaudra à partir des années 90 et qui insistera sur l'atemporalité des valeurs défendues par l'auteur.

Une image s'imposera auprès du public occidental pour faire valoir cette dimension de l'œuvre de Kadaré : celle de Prométhée<sup>14</sup>, peut-être inspirée par l'assimilation de Soljenitsyne à Prométhée que propose le colloque de Cerisy consacré au dissident soviétique<sup>15</sup>. Mais là encore, si l'on recherche toutes les apparitions de la figure de Prométhée dans l'œuvre de Kadaré, et qu'on les replace dans l'ordre chronologique, pour y cerner les prémices de cette image sacrificielle à laquelle l'auteur s'identifiera dans « Prométhée-Trilogie<sup>16</sup> », on va de surprise en surprise. Le premier « Prométhée » qu'un Français peut croiser dans l'œuvre de Kadaré est l'un des noms de code d'un communiste de *La Ville du Sud* (« le Militant »<sup>17</sup>), le personnage utilisant

<sup>13</sup> Cette collection s'intitule « J'exige la parole ». Sur la ligne éditoriale des éditions P. J. Oswald et les liens avec la revue *Action Poétique* (qui publia des poèmes de Kadaré dans un numéro de septembre 1970 consacré au réalisme socialiste), lire Pascal Boulanger : *Une « Action poétique » de 1950 à aujourd'hui*, Paris, Flammarion, 1998.

<sup>14</sup> Cette figure identificatoire est mise en vedette dans le titre de deux essais : celui d'Eric Faye (*Ismail Kadaré. Prométhée porte-feu*, Paris, José Corti, 1991) et celui de Mariam M'Raihi (*Ismail Kadaré ou l'inspiration prométhéenne*, Paris, L'Harmattan, 2004).

<sup>15</sup> Ornela Todorushi signale ce rapprochement dans sa thèse de littérature comparée sur « *La réception de la littérature albanaise en France : de la vulgate réductrice à la réception créatrice (1970-2011)* », sous la direction de Jean Bessière, Université Sorbonne Nouvelle-Paris 3, 2014, p. 112 (non publié).

<sup>16</sup> Ismail Kadaré : « Prométhée. Trilogie », in *Récits d'outre-tombe*, Paris, Stock, 1995. Il s'agit d'une version, amplifiée dans le premier et le dernier volet, de « Prometeu. Trilogji », paru dans *Ëndrra masbtruese. Tregjime dhe novela* [Songe trompeur. Récits et nouvelles], Tirana, Naim Frashëri, 1991.

<sup>17</sup> Ismail Kadaré : *La Ville du Sud*, Paris, Publications orientalistes de France, 1985. Après une réédition chez Presses Pocket en 1991, le volume est devenu introuvable.

de nombreux pseudonymes pour mieux rester dans la clandestinité. Prométhée, surnom révolutionnaire : l'association fait sens. Un partisan se réclame d'un révolté. Mais la révolte peut être nécessaire à l'intérieur même du camp révolutionnaire, afin de le prémunir contre les dangers du révisionnisme. Telle est du moins, dans *Le Grand Hiver*, l'idée de Besnik Struga visitant les hauts fourneaux pour y recueillir la « voix des ouvriers » à l'annonce des tensions politiques avec le reste du bloc de l'Est. Il s'insurge contre le blocus des Soviétiques : « [...] ils espèrent réussir à éteindre nos fourneaux. [...] Le feu dérobé aux dieux. La foudre frappant Prométhée<sup>18</sup>. »

A ce stade de la réflexion, on peut tirer deux conclusions. La première est qu'une étude historique de la réception de Kadaré fait émerger des textes désormais oubliés du lectorat français, comme les nouvelles réunies sous le titre de *La Ville du Sud*. De cet ouvrage, qui n'est pas réédité ni entièrement repris dans les *Œuvres*, on pourrait mener une analyse visant à établir qu'il relève à de nombreux titres de l'esthétique du réalisme socialiste, ce qui n'a rien d'étonnant, vue sa date de parution, 1967<sup>19</sup>. La deuxième conclusion est que le Français actuel a tendance à lire l'œuvre de Kadaré sur le mode lyrique et non épique : il y voit l'expression d'un sujet solitaire, en proie à des réflexions tourmentées, en lutte avec un réel opaque et menaçant qu'il tente de déchiffrer, en dénonçant les ruses et les détours qui permettent au pouvoir de susciter un tel monde de terreur et d'aliénation. Ce type d'interprétation convient parfaitement à des romans comme *Le Palais des rêves*, *L'Ombre* ou *Clair de lune*. Mais, d'après moi, cette modalité de lecture ne s'applique pas à d'autres textes, comme *Le Grand Hiver*, pour reprendre un exemple déjà cité. Et pas non plus, probablement, au *Monstre*. L'édition dont nous disposons en France<sup>20</sup> précise qu'il s'agit là d'une édition « conforme au manuscrit » que Kadaré « avait en vain cherché à faire publier à maintes reprises à la suite de l'interdiction du livre en 1965 ». Admettons. Le lecteur, par définition, ne dispose pas du manuscrit pour vérifier. Mais s'il se reporte aux pages de la version parue dans la revue *Nëntori*, il découvre un texte où le personnage de Gent n'a pas autant d'importance : celui-ci n'est pas encore le chercheur dont les enquêtes mythographiques donnent un tour métanarratif au roman, et invitent à y voir un autoreprésentation de l'auteur. Pour le dire de manière abrupte, la version dont nous disposons nous éloigne d'une lecture épique du *Monstre* et suggère au contraire de le lire de façon lyrique.

Cette hypothèse d'un contresens possible du lecteur français devant certains textes de Kadaré me semble trouver confirmation ici ou là. Notons d'abord que

<sup>18</sup> Ismail Kadaré : *Le Grand Hiver*, Paris, Fayard, 1987, p. 287.

<sup>19</sup> Ismail Kadare : *Qyteti i Jugut : tregime dhe reportazhe* [La Ville du Sud : récits et reportages], Tirana, Naim Frashëri, 1967.

<sup>20</sup> Ismail Kadaré : *Le Monstre*, Paris, Fayard, 1991.

certain paratextes favorisent cette interprétation contestable, voire fautive. Je songe aux commentaires d'Eric Faye qui, toujours à propos de Prométhée, précise : « Qui était Prométhée du côté oriental du rideau de fer ? Si les mouvements révolutionnaires en lutte pour le pouvoir voyaient en lui le libérateur des hommes, les régimes communistes nourrissent envers lui une certaine méfiance, car il incarnait l'esprit de rébellion ; on lui préférerait certainement Spartacus, qui ne libéra pas l'ensemble des hommes, mais seulement sa propre classe : celle des esclaves »<sup>21</sup>. Voilà qui écarte nettement toute assimilation entre Prométhée et le peuple albanais, toute utilisation communiste de la figure, toute projection épique si l'on veut. Et pourtant... Pourquoi, en ce cas, trouve-t-on ces vers dans « Mon Parti », un poème de Koha : « Grâce au système des cœurs unis / Dont toi, Parti, nous a [sic] munis / Le plus simple des communistes s'élève / Sur des centaines de Prométhée »<sup>22</sup> ? Et surtout, comme lire avec justesse le texte situé en ouverture d'*Invitation à un concert officiel et autres récits*<sup>23</sup> intitulé : « Prométhée. A tous les vrais révolutionnaires du monde » ? Faut-il le lire à la lumière des propos d'Eric Faye, et dans la perspective de l'intimisme de certains passages de « Prométhée-trilogie », c'est-à-dire de manière lyrique, en y voyant l'évocation des tortures d'un Kadaré-Prométhée ? Ou faut-il historiciser la lecture, se rappeler qu'au départ le texte faisait partie lui aussi du recueil de *La Ville du Sud*, et qu'on peut parfaitement lire une allégorie du peuple albanais, qui se maintient dans l'ardeur des véritables révolutionnaires, sous les blessures infligées par le Zeus soviétique ?

On mesure donc à quel point les deux conclusions auxquelles je suis provisoirement arrivée sont solidaires : les commentaires actuels de l'œuvre de Kadaré dépendent évidemment du corpus et de sa reconstitution au fil des années, avec l'ajout de nouveaux textes et la disparition de certains, non traduits, plus publiés ou retouchés sans que l'on puisse toujours savoir comment. Les contresens possibles ou, plus modestement, les cécités partielles, les pistes interprétatives non repérées, découlent bien souvent de cet accès tronqué du lectorat français aux textes de Kadaré. Je pense notamment à sa poésie, largement non traduite, et à l'occasion publiée avec des coupes<sup>24</sup>. Par exemple, on ne trouve nulle trace en français du poème « Albanie et les trois Romes » dont la connaissance permet pourtant d'enrichir la lecture du *Grand*

<sup>21</sup> Ismail Kadaré : *Œuvres*, tome XI, Paris, Fayard, 2002, p. 212.

<sup>22</sup> Ismail Kadare : *Poésies*, Tirana, 8 Nëntori, 1981, p. 8.

<sup>23</sup> Ismail Kadaré : *Invitation à un concert officiel et autres récits*, Paris, Fayard, 1985.

<sup>24</sup> Eric Faye note ce point à la fin d'*Ismail Kadaré. Prométhée porte-feu* (*op. cit.*, p. 169) : « il arrive que certains poèmes, entre la première version établie par Michel Métails au début des années 1970 et une deuxième publiée chez Fayard en 1989, aient été passés à travers un "tamis" dans lequel l'engagement kadaréen a été emprisonné. »

*Hiver*, où sont orchestrés finement les thèmes du poème et le renversement que celui-ci opère de la prophétie de Philothée<sup>25</sup>. Je pourrais aussi citer « Les Années soixante » qui invite à une lecture épique de « Laocoon ». Le lecteur français ne dispose que d'une médiocre traduction publiée dans le volume *Poésies* de 1981, oublié sur les rayonnages de quelques rares bibliothèques !

On l'aura compris, c'est la lecture des textes, sous toutes les formes qu'ils ont historiquement et culturellement prises, qui m'intéresse (et devrait intéresser plus d'un lecteur passionné de Kadaré). Mais cette démarche de lectrice se heurte à plus d'un obstacle, dont certains ne sont pas faciles à lever.

### Un chantier scientifique

Mettons de côté la difficulté de l'apprentissage de l'albanais puisqu'elle n'a rien d'absolu et que l'apport de l'école des philologues italiens, au premier rang desquels je nommerai Elio Miracco, encourage à persévérer ! En effet, plusieurs travaux montrent déjà tout l'intérêt qu'il y a à comparer différentes versions d'une même œuvre<sup>26</sup>, ou à examiner de près la lettre et la phraséologie, ou encore à prendre en considération les réactions des critiques de l'époque<sup>27</sup>.

Encore faudrait-il disposer d'un accès à tous les textes, en version originale, dans tous les aspects qu'ils ont pu prendre. Or, à ma connaissance, une bibliographie sérieuse et exhaustive des différents textes de Kadaré en albanais n'existe pas. Je l'appelle vivement de mes vœux, si tel est bien le cas (et réclame d'être détrompée, dans le cas contraire).

L'enjeu est non seulement de pouvoir lire chaque texte dans la perspective d'un dialogue interne à l'œuvre puisqu'un élément de plus ou de moins, ou réécrit, modifie la perception des relations de sens à l'intérieur du corpus et affecte donc la lecture singulière d'un passage ; mais aussi de comprendre plusieurs points capitaux de l'histoire politique et culturelle.

En effet, par un autre paradoxe, le discours de Kadaré sur lui-même, qui insiste

---

<sup>25</sup> Voir Ariane Eissen : « L'Albanie et les trois Romes dans *Le Grand Hiver* d'Ismail Kadaré », *Recherches et Travaux* n°80, *La Chute de l'URSS. Une fin d'empire*, Université Stendhal. Grenoble 3, 2012, p. 57-71.

<sup>26</sup> Elio Miracco : *Storia del testo del romanzo « Piramida » di Ismail Kadare*, Grumo Nevano, Oxiana, 1999. Le critique italien y étudie les différentes versions publiées, en Albanie et en France, de *La Pyramide*.

<sup>27</sup> Je songe là encore à une étude d'Elio Miracco : *Analisi del romanzo "Kështjella" di Ismail Kadare*, Rome, Don Guanella, 2007.

sur la préservation de sa liberté créatrice<sup>28</sup>, ne permet pas de saisir son quotidien d'auteur salarié par le régime et soumis à des obligations de toutes sortes (réunions, textes de circonstances, mots d'ordre à suivre, infléchissement de la ligne politique, etc). Là aussi, l'historicisation de la genèse d'un texte est malaisée, mais elle influe nécessairement sur l'interprétation (sans la réduire) et il importe de chercher à l'établir. Bien souvent, la représentation que donnent Ismaïl puis Helena Kadaré du moment où naît un projet littéraire ou l'idée d'une traduction, conforte cette idée d'un auteur totalement pris dans son monde intérieur, sans comptes à rendre à l'extérieur. Il me semble que cette reconstitution biographique doit être complétée car elle biaise l'accès aux textes et ne permet pas d'y repérer ce qui s'y joue précisément de l'acceptation ET du refus des injonctions du moment. Par exemple, à propos de la traduction du *Général de l'armée morte* par Jusuf Vrioni, Helena Kadaré parle d'une « initiative du traducteur<sup>29</sup> ». Il n'est quand même pas indifférent de savoir, grâce à Luan Rama, que « le lendemain de sa sortie de prison, dans un article que [Vrioni] lisait sur le roman *Le Général de l'armée morte*, on disait que ce roman méritait d'être traduit<sup>30</sup> ». Voilà qui éclaire la décision de se mettre à traduire, et la réception du roman, qui est aussi plus contrastée que ce que dit Kadaré<sup>31</sup>. Autrement informé, le lecteur peut devenir plus sensible aux aspects du *Général* qui correspondent à certaines des attentes collectives du moment. De même, Helena Kadaré éclaire la genèse des *Tambours de la pluie* de façon intimiste, par le hasard d'une lecture lors d'un séjour familial, tout en rappelant incidemment le contexte du cinq centième anniversaire de la mort de Skanderbeg<sup>32</sup>, alors qu'il s'agit en réalité de penser l'articulation des deux aspects de l'œuvre, en tant que geste partiellement libre dans un contexte mémoriel invitant à la célébration nationale.

Car le fait est là : Kadaré a su plaire à une succession de publics radicalement

<sup>28</sup> Ismaïl Kadaré : *Le Poids de la Croix*, *op. cit.*, p. 302 (« avec cette espèce d'ardeur fébrile qu'on met à son travail pour oublier le monde alentour »). Helena Kadaré affirme dans ses mémoires que « quand il écrivait, Is [Kadaré] ne pensait jamais à la publication » (*Le temps qui manque. Mémoires*, Paris, Fayard, 2010, p. 161).

<sup>29</sup> Helena Kadaré : *Le temps qui manque*, *op. cit.*, p. 223. La version est donc la même que dans *Dialogue avec Alain Bosquet* (Paris, Fayard, 1995, p. 216) où Kadaré parle de « traduction de son [Vrioni] propre chef ».

<sup>30</sup> Luan Rama : *Pont entre deux rives*, Paris, SDE, 2005, p. 376. Ornela Todorushi précise dans sa thèse (*op. cit.*, p. 46) que Javer Malo appela de ses vœux une traduction du roman dans un article de *Zëri i popullit*, en date du 29 mars 1964.

<sup>31</sup> Kadaré préfère ne se souvenir que des critiques, « supportables, même si parfois acerbes » (*Le Poids de la Croix*, *op. cit.*, p. 304).

<sup>32</sup> Helena Kadaré : *Le temps qui manque*, *op. cit.*, p. 249-251. Helena Kadaré présente la naissance des *Tambours de la pluie* comme la conséquence d'un accident domestique, obligeant Kadaré à garder la chambre et lui faisant découvrir alors de vieilles chroniques ottomanes.

différents, d'abord clivés par les oppositions idéologiques de la guerre froide, puis par le déplacement des horizons d'attente, au fur et à mesure que s'oubliait la perspective utopique. Et il ne suffit pas de dire que l'immensité de son talent, indéniable au demeurant, explique à elle seule le phénomène. Deux autres éléments au moins sont à prendre en compte. D'une part, la transformation de la même œuvre par les yeux de nouveaux lecteurs, ne lisant pas le même texte, car leurs grilles de lecture, leur expérience littéraire, leurs associations d'idées ont changé au gré des mutations de la vie politique, culturelle et littéraire. D'autre part, la réécriture des textes par l'auteur, qui n'aime pas qu'on lui rappelle la chose, pourtant indéniable dans bien des occasions. Je prendrai l'exemple de l'essai sur Eschyle, actuellement disponible en français sous le titre *d'Eschyle ou le grand perdant* (1995) : il succède à une version de 1988 intitulée *Eschyle ou l'éternel perdant*, laquelle n'est pas réellement une traduction de la préface aux tragédies d'Eschyle, publiée chez Naim Frashëri en 1986<sup>33</sup>. Il serait passionnant de cerner, d'une version à l'autre, le déplacement du propos, en fonction du genre littéraire (les contraintes d'une préface ne sont pas exactement les mêmes que celles d'un essai, forme plus libre) et des publics visés (albanophone ou étranger). Ce serait matière à éclairer plusieurs points capitaux en histoire culturelle et en littérature générale et comparée ; et l'on pourrait aussi examiner la manière dont la puissance créatrice de Kadaré prend la forme d'une capacité d'adaptation et de mutation.

Les questions qui me préoccupent ne concernent pas au premier chef la personnalité intellectuelle et politique d'Ismail Kadaré. Je crois que beaucoup d'énergies passionnelles ont été gaspillées en attaques ou en hagiographies et ce n'est certainement pas mon intention que de prendre le relais. Aucune pulsion de jugement ne m'anime, pour toutes sortes de raisons dans lesquelles je n'entrerais pas. Le seul jugement que je m'autorise concerne l'œuvre, immense, et qui m'a donné l'envie d'en comprendre les multiples aspects, dont ceux qui échappent a priori au lecteur occidental (français notamment puisque la France est la plaque tournante à partir de laquelle l'œuvre de Kadaré prend son essor vers d'autres cieux encore).

Envisagée dans cette perspective, c'est la confrontation de publics différents, dans le temps et dans l'espace, avec une œuvre elle-même en mouvement, par l'ajout de nouveaux textes, mais aussi par la réécriture et les oblitérations, qui fait question.

Cette question se développe au moins dans trois directions. Elle a d'abord trait à l'histoire de la littérature albanaise, aux différents stades de son développement, à ce qui s'est joué aussi des relations entre les écrivains et le pouvoir, sous le régime

<sup>33</sup> Ismail Kadaré : « Tragjeditë e Eskilit », *Eskili : Tragjeditë*, Tirana, Naim Frashëri, 1986.

d'Enver Hoxha ; à ce que nous pouvons nous représenter de tous ces points, maintenant que les repères historiques et idéologiques se sont tellement modifiés. Un second pan de la réflexion concerne la vie créatrice de Kadaré, telle que les textes mêmes, leurs variantes et leur refonte, permettraient de la reconstituer ; cela supposerait entre autres que l'on comprenne comment l'œuvre se modifie de manière à entrer en contact avec des publics successifs, puisque l'auteur évolue dans un monde lui-même en mutation ; il me paraît par exemple simpliste de considérer que l'opposition entre passé communiste et présent capitaliste se traduirait, au plan de l'écriture, par le passage de la contrainte à la liberté, comme si les normes pesant sur les écrivains n'existaient pas aussi dans le monde occidental et comme si l'acclimatation à une nouvelle donne n'était pas allé sans pertes, imaginaires et intimes, ni sans contradictions. Enfin —et cette question invite à une nécessaire et salutaire prudence intellectuelle !— que lisons-nous de l'œuvre de Kadaré, que pensons-nous y trouver, nous qui avons un tout autre « horizon d'attente » que le lectorat premier ? Pouvons-nous nous défaire de fausses évidences, faire acte de réflexivité critique, renouveler nos interprétations, proposer de nouveaux chantiers herméneutiques ? Il y a donc là matière à réflexion, une réflexion qui gagnerait, selon moi, à être menée de manière collective et croisée, entre chercheurs et lecteurs de générations et de cultures différentes, notamment.



Avdi VISOKA

## PËRKTHIMET NGA SHQIPJA NË FRËNGJISHT

### Abstrakt

Në studimet shqipe nuk ekziston deri më sot një studim sistematik, e aq më pak një Histori e përkthimit ose Histori e përkthimeve, për përkthimet në shqip dhe nga shqipja; e në këtë kontekst, as nga frëngjishtja në shqip dhe *vice-versa*.

Ky referim pretendon të hap një diskutim mbi përkthimet nga shqipja në frëngjisht duke u fokusuar në evidentimin, gjendjen dhe receptimin e tyre si dhe faktorët sociolinguistikë dhe sociokulturor që e kushtëzojnë shtrirjen, intensitetin dhe receptimin e tyre në kulturën dhe letërsinë frënge e frankofone. Do të analizohet statusi i autorëve e teksteve shqipe, përkthyesve, përkthimeve dhe botuesve në arealin frankofon. Objekt shqyrtimi do të jenë edhe institucionet kulturore e universitare (katedrat e përkthimit) dhe asociative (shoqatat e përkthyesve), veprimtaritë dhe rezultatet e tyre. Në fund do të merremi edhe me politikat tona të përkthimit dhe botimit si dhe perspektivën e tyre.

**Fjalët qelës:** përkthim, përkthim letrar, përkthim nga shqipja në frëngjisht, Kadare, Jusuf Vrioni.

-----

Letërsia shqipe është e pranishme në Francë duke filluar që nga shekulli 19, ndonëse në një formë apo në tjetrën letërsia shqipe aty ishte mjaft e pranishme shumë më herët<sup>1</sup>. Venerojmë me këtë rast një fenomen të veçantë që rrallë ndonjë kulturë tjetër mund të krahasohet me shqipen, e që e nxjerr përkthimin në plan të parë si një gjenerator të rëndësishëm të krijimit të identitetit kulturor nacional. Përkthimi nga frëngjishtja në shqip nuk ka të bëjë vetëm me përkthimin në shqip të një vepre të kulturës frënge por edhe të përkthimit të veprave të vetë kulturës shqiptare. Le të kujtojmë me këtë rast autorë të shumtë që veprat e tyre i shkruan në frëngjisht apo njëkohësisht në frëngjisht dhe shqip, si Pashko Vasa, Sami Frashëri, Elena Gjika,

---

<sup>1</sup> Veli Veliu, *Ndikime letrare frënge-shqiptare*, Vatra, Shkup, 2005, f.18.

Andon Zako Çajupi, Faik Konica etj. sepse frëngjishtja ishte gjuhë e formimit të tyre intelektual.

Por kur bëhet fjalë për përkthimet nga shqipja në gjuhët tjera, gjendja ndërron tërësisht. Robert Elsi, njëri ndër studiuesit dhe përkthyesit më eminent të letërsisë shqipe konstaton se krahasuar me letërsinë në gjuhët tjera të Ballkanit, shumë pak shkrime shqipe janë përkthyer në anglisht deri më tash. Ka shumë arsye për këtë gjendje. Letërsia bullgare, serbe, kroate, boshnjake, sllovene dhe maqedone kanë pasur interesimin e disa të pasionuarve dhe ekspertëve të studimeve sllave. Letërsia greke moderne ka qenë trajtuar nga shumë akademikë dhe specialistë të studimeve klasike dhe bizantine, kurse sa i përket letërsisë rumune, ajo ka qenë përkthyer nga eruditët dhe të pasionuarit për gjuhët dhe kulturat romane. I njëjti konstatim qëndron pak a shumë edhe me gjendjen e përkthimeve letrare nga shqipja në frëngjisht, ndonëse gjendja është më e volitshme për arsyet e cekura tashmë.

### **Tradita e përkthimeve nga shqipja në frëngjisht**

Përkthimi nga shqipja në frëngjisht është relativisht i vonshëm, ndonëse siç u konstatua tashmë, kultura dhe letërsia shqipe në arealin frankofon në një formë apo në një tjetër, është e pranishme shumë më parë. Për përkthimin nga shqipja në frëngjisht mund të flitet vetëm në periudhën ndërmjet formimit të shtetit shqiptar e deri te Lufta e Dytë botërore, që është periudha e themelimit dhe zhvillimit të institucioneve kulturore e letrare. Megjithëkëtë ende nuk shënohet ndonjë progres në fushën e përkthimit të letërsisë shqipe në gjuhët e huaja, rrjedhimisht as në frëngjisht. Një moment i rëndësishëm në evoluimin e produksionit përkthimor nga shqipja në frëngjisht është themelimi i Liceut të Korçës më 1917 njërit ndër institucionet më të larta arsimore në atë kohë. Ky institucion i dijes gjithsesi për nga rëndësia kulturore e letare i tejkalon suazat e fushës së përkthimit duke u bërë vatrë e orientimit evropian të kulturës shqiptare. Nga kjo shkollë dolën përkthyesit më eminentë shqiptarë. Në këtë kohë ende nuk njihet ndonjë përkthyes francez i letërsisë shqipe. Vetëm themelimi i shtetit të pavarur shqiptar e shtroi nevojën para institucioneve kulturore e letrare franceze për përkthyes të mirëfilltë nga shqipja në frëngjisht dhe vice-versa. Ndërsa INALCO (Instituti Kombëtar për Gjuhët dhe Kulturat Orientale) vetëm më 1905 e kishte themeluar katedrën e gjuhës shqipe.

Periudha e evoluimit më të shpejtë të përkthimeve nga shqipja në frëngjisht vjen vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo periudhë zhvillohet paralelisht në dy çendra kulturore pothuaj të pavarura, të shtrënguara nga faktorë politikë e ideologjikë, në Shqipëri dhe Kosovë.

Izolimi i Shqipërisë ndaj botës dhe vendeve fqinje ishte faktori kryesor që

gjeneroi këtë mosinteresim të të tjerëve për kulturën shqiptare dhe veçanërisht për letërsisë shqipe. Shumë pak të huaj lejoheshin që të hynin në Shqipëri e edhe më pak shqiptarë lejoheshin të dilnin jashtë vendit. Në këtë periudhë ndihet fuqishëm ndikimi fatkeq i politikës dhe i ideologjisë mbi kulturën, sidomos mbi letërsinë; ky fenomen nuk e kurseu as fushën e përkthimeve shqipe. E ballafaquar me mosinteresimin e vazhdueshëm dhe kritikën e vendosur të të tjerëve për “kulturën e re” shqiptare, Tirana zyrtare vendosi që vetë ta bëj promovimin e saj. ”Pas një izolimi të gjatë dhe pas kritikave të vazhdueshme nga Perëndimi, për ortodoksinë marksiste e stalinizmin, udhëheqja shqiptare vendosi, që një pjesë e mirë e veprave të ‘realizmit socialist’ të përkthehej në gjuhën frënge dhe të propagandohej jashtë shtetit, si ‘arritje të vërteta të një kulture proletare’. Kështu, nga vitet ’70 e në vazhdim, shtëpia botuese ‘Naim Frashëri’ nisi botimin e një sërë shkrimtarëve, të cilësuar në atë kohë si ‘besnik të partisë në edukimin komunist të masave’. Shtëpia botuese ‘8 nëntori’ botoi romanin e Dritëro Agollit ‘Commisaire Memo’, më 1978, librin e Sotir Andonit ‘Quand on prennait sa volée’, 1973, ‘Au quartier des artisans’ të shkrimtarit Dalan Shaplo, ‘Recits’ dhe ‘Le pont’ të Anastas Kondos, ‘Les anciennes’ e Zija Çelës, apo ‘Histoire de la littérature albanaise’, 1980, ‘Anthologie de la poesie albanaise’, etj. Krahas tyre u tentua që të botoheshin veprat e autorëve shqiptarë në Perëndim, veçanërisht në Francë. Talenti i Kadaresë dhe romanet e tij të para në gjuhën frënge, ishin një sensacion i vërtetë për letërsinë shqiptare e njëkohësisht dhe për kritikën franceze e frankofone në tërësi.”<sup>2</sup>

Një ndërmarrje e tillë, ndonëse në thelb e kotë dhe pa rezultat, megjithatë i solli edhe dobi kolaterale kulturës shqipe. Në këtë kohë u botuan studimet dhe përmbledhjet *Chansonnier épique albanais*, përkthyer nga Kolë Luka dhe *Chansonnier des Preux Albanais*, në një botim të UNESCO-s, njërës prej ndërmarrjeve më serioze të realizuara deri më sot në këtë fushë.

Krahas konsolidimit të institucioneve kulturore letrare edhe produksioni përkthimor hyn në fazën e konsolidimit. Janë dy institucione që patën rëndësi vendimtare për këtë konsolidim: themelimi i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës dhe themelimi i redaksisë së përkthimeve në Shtëpinë e Botimeve “8 Nëntori” në Tiranë. Nga ky Hidrocentral Përkthimesh<sup>3</sup>, siç preferon ta quaj Kokona, doli një plejadë përkthyesish si: Vedat Kokona, Halit Selfo, Edmond Tupja etj.

Edhe një herë Shqipëria del vend paradoksesh. Fokusin e krijimtarisë përkthimore më cilësore nuk duhet kërkuar, siç mund të krijohet përshtypja, në

<sup>2</sup> Luan Rama, *Shqipëria frankofone*, Onufri, Tiranë, 2001, ff. 93-94.

<sup>3</sup> Vedat Kokona, *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, Botimet Kokona, Tiranë, 2003, f.10.

institucionet akademike e publicistike të përmendura më parë por nëpër kampet e Spaqit dhe Burrelit. Ironikisht kjo shpreh edhe fatin e përkthimit dhe përkthyesit tonë në këtë periudhë. Përkthyesi ynë më eminent Jusuf Vrioni është shembulli më ilustrativ i këtij fenomeni fatkeq shqiptar.

Në Kosovë situata qëndron më e nuancuar. Kosova, atëbotë pjesë e Federatës jugosllave; nuk ishte hermetikisht e izoluar sikurse Shqipëria por regjimi serb që i frikësohej humbjes së dominimit të tij mbi Kosovën e kishte kthyer atë në një farë getoje të cilën mendohej ta mbante sa më larg kontakteve kulturore e letrare me të huajtë. Në këtë periudhë nuk ka gjurmë të përkthimit letrar nga shqipja në gjuhë të huaja, e as atij në frëngjisht. Apo ai gjindet në fillet e tij te Anton Çetta e ndonjë tjetri.

Edhe në Kosovë janë dy institucione që patën rëndësi vendimtare për konsolidimin e aktivitetit përkthimor, në këtë rast të atij nga shqipja në frëngjisht: themelimi i Fakultetit Filozofik, më vonë i Filologjisë, në Universitetin e Kosovës dhe themelimi i redaksisë së përkthimeve në Shtëpinë botuese “Rilindja” në Prishtinë. Nga këtu dolën një brez përkthyesish si: Murat Bejta, Halit Halimi, Skënder Sherifi, etj. Përveç këtyre, në Kosovë është edhe një institucion tjetër që i dha impuls kësaj veprimtarie - Shoqata e përkthyesve shqiptarë. Ajo ishte e matshme me shoqatat e ngjashme në Jugosllavi qoftë për repertoarin, qoftë për cilësinë e përkthimeve. Duhet nënvizuar me këtë rast se fokusi i përkthimeve nga shqipja në frëngjisht ishte drejtuar më shumë nga projekte studimore sesa nga krijimtaria letrare. Duhet nënvizuar me këtë rast botimin e *La solitude d'une branche*<sup>4</sup>, antologji e poezisë shqipe në Kosovë, e botuar njëkohësisht edhe në anglisht.

Në këtë periudhë paraqiten edhe përkthyesit francezë të cilët përkthimin nga shqipja në frëngjisht e ngrisin në nivelin evropian. Tanimë edhe në rrafshin metodologjik edhe në atë cilësor e stilistik përkthimi në shqip e zë hapin me përkthimin evropian e botëror. Përkthyesit më të dalluar të këtij brezi janë Alexandre Zoto, Christian Gut, Christianne Montécot, Anne-Marie Autissier, Odette Marquet, Isabelle Joudrain-Musa, André Clevel, Elisabeth Chabuel etj.

Në fillim të viteve '90 me ndryshimet sociale e politike ndryshoi edhe konteksti kulturor dhe letrar në mbarë arealin shqiptar. Që atëherë peizazhi letrar shqiptar nuk dominohet më nga doktrina strikte, më shumë ideologjike sesa estetike, dhe pretendohet të realizohet njëfarë ekuilibri në konfiguracionin letrar postideologjik shqiptar. Një erë e re filloi në produksionin tonë letrar e përkthimor. Kjo është erë e depërtimeve të shpejta letrare në Shqipëri në zgjerimin e gamës së përkthimeve që deri atëherë ishte shumë selektiv. Në këtë periudhë definitivisht kemi proliferacion përkthimesh. Përkthehet gjithçka, gjithqysh dhe nga gjithkush. Një gjë e tillë

<sup>4</sup> *La solitude d'une branche*, Rilindja, Prishtinë, 1979, e përkthyer nga Skënder Sherifi.

domosdoshmërisht sjell edhe rënie të cilësisë së përkthimeve madje kemi përkthime skandaloze<sup>5</sup>. Përkundrazi, te produktioni letrar në Kosovë sikur hetohet një stagnim edhe në rrafshin cilësor edhe në atë sasior.

Kohëve të fundit vërehet një përmirësim i dukshëm i këtyre tendencave në Shqipëri dhe në Kosovë. Themelimi i Katedrave të përkthimit dhe interpretimit para disa vitesh në Shqipëri dhe tash së fundi edhe në Kosovë shënon progres të pakontestueshën në këtë drejtim. Edhe aplikimi i teknologjisë së sofistikuar informatike në këto katedra është indikator i profesionalizimit të avacuar të veprimtarisë së përkthimit në shqip. Poashtu institucionet qeveritare me themelimin e çmimeve letrare, veçanërisht të çmimit vjetor për përkthimin, dëshmon për mbështetjen institucionale që ka filluar t'i jepet kësaj veprimtarie.

### **Tipologji e përkthimit të letrave shqipe në frëngjisht**

Robert Elsi me të drejtë nxirrte në pah deficitet e materjes letrare në arealin kulturor ndërkombëtare sidomos në atë angleze. Frëngjishtja me gjithë deficitet të caktuara shpesh herë ka shërbyer si pistë e difuzimit të letërsisë shqipe edhe në gjuhët tjera. Letërsia shqipe është e pranishme në të gjitha mediumet franceze, sidomos në ato të shkruarat. Letërsia shqipe prezantohet edhe në manifestime të rëndësishme kulturore franceze. Kështu manifestimi më i rëndësishëm letrar *Les Belles Etrangères* në vitin 1998 iu kushtua tërësisht letërsisë shqipe; në këtë ngjarje të rëndësishme letrare morën pjesë mbi njëzet shkrimtarë elitare shqipëtar. Ajo është e pranishme edhe në manifestime të përvitshme kulturore ndërkombëtare e mesdhetare. Ajo është objekt trajtimi edhe në ngjarje të specializuara si Seminaret ndërkombëtare apo konferenca shkencore.

Deficiti kryesor i pranisë së letërsisë shqipe në frëngjisht është përkthimi i letërsisë tonë të traditës. Përkthehen kryesisht autorët tonë bashkëkohorë. Përzgjedhja e këtyre autorëve është tejet selektiv dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre shpesh mund të jenë edhe të dyshimta. Përkthehen kryesisht autorë që propozohen nga autorët tonë tashmë të konfirmuar nga publiku francez por rrallë ndodh që mandej këta të fundit të ribotohen. Përkthehen edhe autorë që kanë relacione private me përkthyes shqipëtar e sidomos me ata francez por përsëri ndodh që lexueshmëria e tyre të mos e tejkalojë një klub miqsh. Përkthehen edhe autorë me iniciativë dhe me shpenzime personale por rëndom botimet e tyre mbesin të pavërejtura nga lexuesi dhe kritika.

Përkthimet nga shqipja në frëngjisht në arealin francez do të mund të klasifikoheshin në katër kategori që e përcaktojnë edhe nivelin dhe intensitetin e

---

<sup>5</sup> Edmond Tupja, *Kështilla një përkthyesi të ri*, Onufri, 2007, f.78.

receptimit të tyre nga lexuesi dhe kritika franceze:

- veprat e shkrimtarëve që jetojnë në vendet frankofone dhe veprën e tyre e shkruajnë në frëngjisht. Vepra e tyre në të vërtetë shtron një problematikë tjetër: atë të situimit të saj ndërmjet letërsisë shqipe dhe asaj frankone. Të tillë janë Cizia Zykë, autor dhjetëra romanesh policore, me një lexueshmëri imponante në Francë por tërësisht i panjohur dhe i papërkthyer ende për publikun shqiptar; Skënder Sherifi, poet dhe fitues çmimesh letrare frankofone, deri vonë i panjohur dhe i papërkthyer në Shqipëri, dhe ndonjë autor tjetër.

- veprat që përkthehen nga botues francezë dhe difuzohen prej tyre tek një publik i gjerë frankofon. Kjo është kategoria më e rrallë dhe receptimi i saj është më relevanti tek publiku francez. Përpos kontratës së shtëpisë botuese Fayard me Ismail Kadarenë për botimin e përvitshëm të një vepre të tij, rastet tjera janë sporadike kur shtëpitë botuese franceze ndërmarrin iniciativa për përkthimin e ndonjë autori shqiptar: Fatos Kongoli, (*Le paumé, Le Dragon d'ivoire, L'ombre de l'autre, Le rêve de Democlès, Peau de Chien, Tirana blues, Le boléro dans la villa des vieux*), Besnik Mustafaj (*La Tambour de papier, Un été sans retour, Les cigales de la canicule, Le vide, Petite saga carcérale*), Luan Starova (*Le temps des chèvres, Les livres de mon père, Le musée de l'athéisme, Le rivage de l'exile, Le chemin des anguilles*).

Janë përkthyer edhe vepra të Dritëro Agollit, Bashkim Shehut, Ali Podrimjes, Sabri Hamitit, Anton Pashkut, Eqrem Bashës, Mimoza Ahmetit, Ylljet Aliçkajt, Fatos Arapit, Neshat Tozajt, Rexhep Qosjes, Din Mehmetit, Teki Dervishit, Jusuf Buxhovit, Sali Bashotës, Kasëm Trebeshinës, Jeton Nezirajt, Ilirian Bezhanit e ndonjë tjetër.

Këtu hyjnë edhe antologjitë: Anthologie de la poésie albanaise (Alexandre Zotos), Anthologie de la prose albanaise (Alexandre Zotos), *Kosovo dans la nuit* (Anne-Marie Autissier, Christiane Montécot et Alexandre Zotos) dhe disa antologji tjera më pak të rëndësishme.

- veprat që përkthehen dhe botohen nga botues shqiptarë dhe difuzohen prej tyre tek një publik frankofon. Kjo ishte kategori tejet e përhapur sidomos në Shqipëri në vitet '70-'80 (me lart u dha një repertoar joshterues i letërsisë së realizmit socialist) por edhe në Kosovën e po asaj periudhë<sup>6</sup>. Receptimi i saj tek publiku francez varion mes dy ekstremeve: nga ai i injorimit total e deri tek kontributi i veçantë (përkthimet e këngëve kreshnike nga Kolë Luka) varësisht nga karakteri dhe cilësia e botimit.

- vepra që përkthehen me iniciativë të vetë autorëve shqiptarë, botohen dhe difuzohen me mjete vetanake. Rëndom cilësia e tyre lë për të dëshiruar andaj edhe receptimi i tyre tek publiku francez nuk ka ndonjë relevancë.

<sup>6</sup> *La solitude d'une branche*, Rilindja, Prishtinë, 1979, e përkthyer nga Skënder Sherifi.

Niveli dhe intensiteti i receptimit të veprës së tyre tek lexuesi dhe kritika franceze varion varësisht se për cilin shkrimtar bëhet fjalë. Ka të atillë që vetëm se janë të regjistruar në repertoarin e librave të përkthyer në frëngjisht. Por ka edhe të këtillë që vepra e tyre botohet komplete me përgatitje teknike prestigjioze dhe njëkohësisht edhe si *Livre de poche* me tirazh mijra ekzemplarësh për publikun e gjërë siq është rasti me Ismail Kadaren i cili tashmë po trajtohet edhe si shkrimtar frankofon.

### **Perspektiva dhe ekzigjenca**

Për prezantimin dhe receptimin e një shkrimtari, po edhe të një kulture, faktor kyq është edhe kualiteti i përkthimit. Ka edhe të tillë që mendojnë se Kadare ka bërë këso depërtimesh falë përkthyesit të tij gjenial Jusuf Vrionit. Ky vështrim i shkurtër i letrave shqipe të përkthyer në frëngjisht nxjerr konstatimin se ky aktivitet i rëndësishëm i kulturës shqipe kryesisht ka pasë rrjedhën e saj stihike, pa një strategji të qëlluar, pa planifikim të menduar mirë dhe pa mekanizma të duhur për ta realizuar atë. Përzgjedhja, cilësia e autorëve dhe veprave, përkthimi dhe botimi i tyre shpesh lënë për të dëshiruar.

Franca zhvillon strategji në fushën e përkthimit dhe politikat e difuzimit të kulturës i orienton në bazë të këtyre strategjive. Kur flitet për letërsinë shqiptare të përkthyer në frëngjisht duhet kuptuar se Franca interesohet për ata autorë që shkojnë konform atyre strategjive. Për institucionet tona politike e kulturore nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Prandaj bëhet nevojë imediate krijimi i strategjive dhe orientimi i politikave tona kulturore kah difuzioni i kulturës, letërsisë dhe autorëve e veprave tona me vlerë nacionale nëpër qendrat e mëdha kulturore, pra edhe në sferën frankofone. Pa përkthimin e monumenteve të kulturës së identitetit shqiptar<sup>7</sup> publiku joshqipfolës nuk do të mund të ketë qasje në to dhe për rrjedhojë edhe nuk do t'i njoh ato. Dhe nuk do të ketë dialogim të kulturës frankofone me kulturën shqiptare. Deri atëherë presin të përkthehen në frëngjisht vepra monumentale si *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, *Labuta e Malcís*, vepra e Naimit, Mjedjes dhe të shumë autorëve madhorë të kulturës tonë.

---

<sup>7</sup> Sabri Hamiti, “Monumentet e kulturës së identitetit shqiptar“ në *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003, f.731-742.

**Bibliografi:**

1. VELIU Veli, *Ndikime letrare frënge-shqiptare*, Vatra, Shkup, 2005.
2. VRIONI Jusuf, *Mondes effacés: Souvenirs d'un Européen*, J.-C. Lattes, Paris, 1998
3. KOKONA Vedat, *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, Botimet Kokona, Tiranë, 2003
4. HAMITI Sabri, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003.
5. TUPJA Edmond, *Souvenirs d'un traducteur*, L'Harmattan, Paris, 2003.
6. TUPJA Edmond, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2007
7. RAMA Luan, *Shqipëria frankofone*, Onufri, Tiranë, 2001



**Naser MRASORI**

**CVAJGU DHE SPASE  
MIDIS NDIKIMEVE, DALLIMEVE DHE NGJASHMËRIVE ...**

Në kuptimin e ngushtë të fjalës, ndikimet mund të përcaktohen si një lloj mekanizmi, sipas të cilit një vepër krijon një vepër tjetër. Sipas T. S. Eliotit, një shkrimtar mund të marrë shtysë nga një shkrimtar tjetër kur mahnitet me veprën e tij. Ndonjëherë ndikimi shfaqet edhe si ndjenjë e ngjashmërisë, e kureshtjes ose e admirimit ndaj këtij shkrimtari.

Sipas të gjitha gjasave, ka mënyra, lloje dhe nivele të ndryshme ndikimesh, duke nisur që nga imitimi i vetëdijshëm e deri te ndikimi i pavetëdijshëm i vargjeve të lexuara e të rilexuara. Ndikimet mund të shfaqen ndonjëherë si imitime të fabulës, të personazheve ose edhe të formës së një vepre letrare.<sup>1</sup>

Zakonisht, ndikimet vijnë si pasojë e përkthimeve ose e përshtatjeve, por ndonjëherë edhe nga leximi i ndonjë vepre të parapëlqyer në origjinal. Ndonjëherë ndikimet mund të shfaqen edhe si ndonjë katalizator, sepse shkaktojnë ose shpejtojnë lindjen e ndonjë dukurie në letërsi, duke sjellë edhe novatorizma. Sipas studiuesve të letërsisë së krahasuar Ruso dhe Pishua, studimi sistematik i ndikimeve dhe i burimeve mbase do të na jepnin mundësi të rishqyrtonim e të modifikonim pikëpamjen tonë për disa çështje letarare. Fati dhe sukcesi i një vepre mund të jetë si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Zakonisht, sukcesi i një vepre në letërsinë kombëtare mund të vazhdojë edhe në letërsitë e tjera, por duhet të shihet më parë se çfarë jehone ka pasur në vendin e saj, e më pas edhe në vende të tjera.<sup>2</sup> Fatin e një vepre jashtë kufijve të një vendi mund ta krahasojmë “me valët në formë rrrathësh bashkëqendrorë”. Mirëpo ka raste kur një shkrimtar ka më shumë lexues jashtë, sesa në vendin e vet, siç ndodh me Cvajgun. Kështu, për shembull, disa krijues janë të mendimit se ekzistojnë ndikime rastësore dhe ndikime të qëllimshme që shërbejnë si frymëzim e nxitje për krijimtari të mëtejme ose edhe për imitim. Studiuesit e letërsisë së krahasuar mendojnë se gjurmimi i ndikimeve është jo vetëm diçka e lejueshme,

---

<sup>1</sup> Pichois, Cl. dhe Rousseau, A. M.: “La Littérature Comparée”, Paris 1967, përkthyer në gjuhën kroate nga Jerka Belan dhe botuar në Zagreb më 1973, f. 76

<sup>2</sup> Ibid., f. 77-78

por edhe e dobishme. Kështu, ekzistojnë studime të rëndësishme të këtij lloji, si për shembull: “Gëtja në Francë”, një studim i F. Baldensperzhesë, i cili merret me ndikimin e tërë veprës së Gëtes në Francë; pastaj edhe studimi i J. M. Karesë “Gëtja në Angli”, ku autori ka studiuar ndikimin e veprës së Gëtes në letërsinë angleze. Mirëpo, ndonjëherë mund të studiohet edhe ndikimi i një vepre letrare në një ose në disa letërsi, madje edhe ndikimi i një gjinie letrare në një ose në disa letërsi. Sipas studiuesve të letërsisë së krahasuar, Pishua dhe Ruso, asnjë letërsi nuk do të kishte nivelin që ka po të mos kishte kontakte, lidhje dhe ndikime nga letërsitë e tjera. Në fillim të çdolloj studimi të letërsisë së krahasuar që i kushtohet ndikimit të përgjithshëm të një shkrimtari, të një vepre, të një gjinie letrare ose të një letërsie të tërë në rrafsh të huaj, duhet pasur parasysh, në radhë të parë, çështja e fatit ose e përhapjes së veprës së përkthyer në gjuhën përkatëse. Meqë veprën në origjinal mund ta lexojnë vetëm një grup i caktuar njerëzish të një gjuhe dhe letërsie tjetër, atëherë një libër, në më të shumtën e rasteve, fiton përmes përkthimit. Në rrethana të tilla, një vepër mund të ketë sukses si përkthim kur pritet me dashamirësi, interesim e respekt jo vetëm nga kritika e ekspertëve, por edhe nga publiku me shije e kulturë letrare, më në fund edhe nga masa e gjerë e lexuesve. Suksesi i një vepre të përkthyer shihet nga ribotimet e saj në një mjedis të ri. Në raste të tjera, kur kemi të bëjmë me një dramë të përkthyer, sukseksi i saj shihet nga numri i shfaqjeve; kur kemi të bëjmë me prozë ose me poezi të përkthyer, sukseksi i tyre shihet nga numri i artikujve, i recensioneve, i mbresave të lexuesve, si edhe nga mendimet e studiuesve, etj. Ngandonjëherë, një vepër e përkthyer mund të hasë edhe në reagime negative, ose të shkaktojë polemika në mjedisin e ri. Mirëpo duhet thënë se vepra letrare e përkthyer mund të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në krijimtarinë e ndonjë shkrimtari ose mund të bëhet shkas për imitime, huazime dhe eksperimentime nga krijuesit letrarë të asaj gjuhe ku është përkthyer, kurse ndonjëherë mund të jetë edhe burim frymëzimesh të suksesshme. Veç kësaj, ka raste kur edhe sukseksi modest ose i kufizuar i ndonjë vepre letrare mund të ketë si pasojë huazimet e vogla të shprehjeve, frazave, mendimeve, aforizmave, situatave, skenave dhe ideve. Në më të shumtën e rasteve, ndikimi del në pah nga huazimet, të cilat mund të jenë huazime në përgjithësi të gjinive letrare, të strukturës artistike, të subjektit, të stilit, të personazhit, të fabulës, kurse herë të tjera mund të jenë huazime të temës, të motivit, të mendimit, të ndjenjës, por ka edhe raste kur vepra e përkthyer bëhet model për shkrimtarin e ri. Duke dashur që të meremi kryesisht me ndikimin e veprës së Cvajgut tek autorët tanë, në këtë kontekst mund të konkludojmë se nuk është aspak e thjeshtë dhe se fijet lidhëse të tyre duhet të vërehen me kujdes. Falë metodës krahasimtare, ne mund të u referohemi niveleve të ndryshme të analizës, si në nivel temash dhe motivesh, teknika stilistikore, ashtu edhe me thellë, në nivel konceptimesh e teorish

që lidhen me mendimet e tyre mbi personazhet dhe botën e tyre, mbi stilin e të shkruarit dhe formën krijuese.

Për këtë qëllim është bërë përpjekje për një lexim dhe studim të frutshëm të veprave, në mënyrë që të kemi mundësi të afrohemi sa më mirë mendimit dhe kuptimit të teksteve dhe, nga ana tjetër të njohim pikëtakimet, të njohim rrugën e tyre, në mënyrë që të dijmë të argumentojmë dhe të zbulojmë dallimet, të përbashkëtat dhe ngjashmëritë e krijimeve të dy autorëve të dy letërsive të ndryshme.

### **Shembuj ngjashmërisht, ndikimesh dhe dallimesh të veprës së Cvajgut të shkrimtari shqiptar S. Spase**

Për sa i takon ndikimit të veprave të Cvajgut në letërsinë shqipe, kjo temë ose ky problem do të preket në njëfarë mase në këtë studim, i cili mund të shërbente si pikënisje për studime më të gjera dhe shteruese në të ardhmen. Këtu e shohim të udhës të bëjmë një përpjekje modeste për të hetuar disa forma të ndikimit, të ngjashmërisë së qëllimshme apo të rastësishme, të imitimit e të frymëzimit prej veprash të Cvajgut në krijimet letrare të shkrimtarëve shqiptarë. Gjatë hulumtimit të kësaj fushe më ka rastisur që të vërej ngjashmëri tek disa shkrimtarë shqiptarë që, në një mënyrë a në një tjetër, kanë të përbashkëta ose edhe kanë pësuar ndikime nga jehona e veprës së Cvajgut në kulturën e në letërsinë shqipe. Me theks të veçantë në këtë punim do të trajtohen përmes shembujve, ngjashmëri, ndikime dhe dallime në dy veprat letrare të dy autorëve, Cvajgut dhe Spases.

#### ***“Letra e një të panjohure” (Stefan Cvajg) - “Neta” (Sterjo Spasse)***

Në tregimin me titull “Neta” të Sterjo Spases, sipas krahasimeve që kemi bërë, del se autori është ndikuar ose është frymëzuar në njëfarë mase nga novela e Cvajgut “Letra e një të panjohure”. Këto dy tregime e kanë temën pak a shumë të njëjtë, subjektin po ashtu mjaft të ngjashëm, por edhe formën artistike e kanë përafërsisht të njëjlojtë. Edhe në këndvështrimin e tregimitarit kemi një ngjashmëri të theksuar.

Kështu, në fillim të novelës së Cvajgut, romancieri R. kthehet herët në mëngjes në Vjenë nga një pushim i shkurtër; duke lexuar gazetën, i kujtohet ditëlindja, dita kur mbush 41 vjeç; me të arritur në shtëpi, shërbëtori e njofton se kishin ardhur disa vizitorë që t’i uronin ditëlindjen, kurse disa të tjerë e kishin kërkuar në telefon. Ndër letrat që i kishin ardhur, shkrimtarit i bie në sy një letër me shkrim dhe adresë të panjohur. Pikërisht kjo letër i zgjoi kureshtjen romancierit, sepse kishte 30 faqe të shkruara me nxitim dhe me një përmbajtje mjaft prekëse. Për çudi, letra nuk e

kishte adresën e dërguesit, por kishte, në vend të titullit, këto fjalë: “Ty që s’më ke njohur kurrë.” Romancierin e kaploi mëdyshja, nuk dinte nëse letra i drejtohej atij, apo ndonjë njeriu imagjinar. Pikërisht për këto arsye iu zgjua kureshtja dhe nisi ta lexonte letrën. Në tregimin “Neta” të Spasses, një ditë plaku i thinjur Pal Gjinoshi, duke rregulluar bibliotekën e vet, gjen një letër të pluhurosur në fletët e një romani të zverdhur nga koha. E hap letrën me njëfarë kërsërie dhe e kupton se qe shkruar para shumë vjetësh, në vitet e tij rinore. Në atë çast iu kujtua ngjarja “fije e për pe”. Tre paragrafë të shkurtër ia rikujtojnë atë ngjarje të jetës së tij, që kishte ndodhur dy-tri ditë para martesës. Pas tri ditësh motra i kishte dhënë disa telegrame urimi dhe një letër të veçantë të ardhur me postë. Pal Gjinoshit iu duk atëherë si zarf të rinjsh, një letër e zgjedhur, me nga një vijë të kuqe, të verdhë e të kaltër anash. Letrës i vinte një erë e mirë parfumi. Nusja e tij e re mbështet dorën mbi supin e Palit dhe afron ngadalë fytyrën për ta shikuar

letrën, por nuk kupton asgjë. Pali fillon ta lexojë pa zë dhe me kureshtje. Sikurse duket, në këto dy krijime letrare ka ngjashmëri të përgjithshme, por edhe dallime të mëdha. Të dy këto ngjarje kanë qëllim e funksion pothuajse të njëjtë: të tërheqin vëmendjen e lexuesit me rrëfimin e tregimtarit-autor në vetën e parë. Lidhur me fabulat dhe me strukturën tregimtare mund të thuhet pa pikë dyshimi se në të dy ngjarjet ekziston një ngjashmëri e theksuar, por më tepër kemi dallime e ndryshime, që janë në masë të madhe. Ndërsa novela e Cvajgut ka 50 faqe, tregimi i Spasses ka 9 faqe; dinamika e zhvillimit të ngjarjeve është shumë më e fuqishme, më e organizuar e më komplekse në novelën e autorit austriak, kurse në tregimin e Spasses kemi një subjekt me një strukturë më të përgjithshme tregimtare dhe të varfër në ngjarje. Ngjarjet dhe konfliktet, episodet dhe situatat dramatike në novelën e Cvajgut janë të tendosura, të ngjeshura e tronditëse, kurse te Spassja kemi një rrëfim pothuajse në formën e një kujtimi të hidhur. Ç’është e vërteta, edhe pse personazhet e dy autorëve kanë pak ngjashmëri në dashurinë fatkeqe dhe në ëndrrat e tyre, mes novelës së Cvajgut dhe tregimit të Spasses ka shumë dallime sasiore dhe cilësore. Heroina e panjohur e Cvajgut ndryshon mjaft nga Neta e Spasses, sepse e panjohura e Cvajgut është një heroinë me përvojë të pasur jetësore. Ndërkaq, Neta është tip romantik e sentimental. Fabula e novelës së Cvajgut përbehet nga një varg i madh ngjarjesh, ku bartëse kryesore e ngjarjeve është gruaja e panjohur, që disa herë kishte pasur lidhje intime me romancierin R., i cili nuk di asgjë për dashurinë e saj, madje as për lindjen e një fëmije nga ajo dashuri e çuditshme dhe e pashpjegueshme. Këto i merr vesh nga letra e asaj gruaje të panjohur, personazhit kryesor të novelës. Kurse Neta, sipas autorit nuk përshkruhet në asnjë moment që ka pasur lidhje intime me Pal Gjinoshin, personazhin e tregimit të Spasses. Ai ka qenë vetëm objekt i adhurimit në heshtje. Në një masë të madhe kuptohet mjaftë mire se jeta e dy

personazheve femra në të dy rastet është e dominuar nga zhgënjimi, mossauesi në dashuri, dështimi, pritja në vëzhgim nga dyer dhe dritare, takime të rastësishme, mosnjohje të dashurisë, e sfida të tjera të jetës. Aty zhvillohet gjithçka kundër çdo lloj pritshmerie a logjike të mundshme dhe asnjëherë nuk arrijnë të bëjnë atë që duhet apo më mire t'themë atë që duan. Mund të gjenden edhe mjaft ngjashmeri dhe dallime mes subjekteve të këtyre dy rrëfimeve. Ndërkaq, krijohet përshtypja se ndikimet e novelës së Cvajgut në tregimin e Spases njëjtësohen dhe vërehen më së miri në motivin e ngjarjes.

Më poshtë po shkëpusim disa pjesë dhe japim motivin e ardhjes dhe të njohjes nga novela e Cvajgut:

*“Dua të ta zbuloj të gjithë jetën time, këtë jetë që në të vërtetë filloi atë ditë kur të njoha ty. ...Kur erdhe ti, unë isha 13 vjeçe dhe banoja në po atë shtëpi ku ti tani po mban në duar këtë letër, frymën e fundit të jetës sime; unë banoja në të njëjtin korridor, mu përballë derës së apartamentit tënd.”<sup>3</sup>*

Ja edhe motivi i ardhjes dhe i njohjes në tregimin “Neta” të Sterjo Spases:

*“Dëgjo, se po t'i kujtoj të gjitha një nga një: a e mban mend ditën e shtatorit të vitit të kaluar, kur zure shtëpinë e fqinjës me qira? Ti erdhe i shoqëruar nga një zotëri, unë isha në dritaren e shtëpisë sime. ...Sapo të pashë, m'u duke mjaft tërheqës.”<sup>4</sup>*

Pothuajse i njëjtë është edhe motivi i përshkrimit të personazhit që dashuron e panjohura te Cvajgu:

*“Gjithë natën mendova për ty, pa të njohur akoma... Të nesërmen erdhe, por, megjithëse të përgjova, s'të pashë dot kjo ma shtoi edhe më tepër keureshtjen. Më në fund, ditën e tretë, të pashë; dhe u habita, u trondita shumë që m'ushfaqe krejt ndryshe, që nuk i ngjasojë fare asaj ikonës së përëndishme! Kisha ëndërruar një plak babaxhan me syze, kurse erdhe ti, ashtu i tëri, siç je edhe sot, o ti i pandryshueshëm, mbi të cilin vitet përplasen e rreshtqasin pa forcë!... Kishe veshur kostumin e lezetshëm sportiv, bojëkafë të hapur dhe, me atë ecjen tënde të lehtë djaloshare, ngjite shkallët, duke i marrë dy e nga dy njëherësh. Kapelën e mbaje në dorë, dhe unë, e mahnitur sa s'bëhet, ta pashë fytyrën e çiltër e të gjallë me ata flokë të dendur. Vërtet që u tremba e u habita kur të pashë aq të ri, plot hir e të bukur, me atë shtat të derdhur, elegant. Dhe a nuk është çudi: që në këtë çast të parë e ndjeva fare qartë atë që unë dhe gjithë të tjerat ndiejnë posaçërisht dhe mjaft shpesh tek ti: që ti je njëfarëlloj njeriu i dyfishtë, një djalosh i zjarrtë, i lehtë, i dhënë i tëri pas zërvanëve dhe aventurave dhe njëkohësisht, në artin tënd, një burrë serioz, i patundur, i ndërgjegjshëm, i ditur e i mësuar sa s'ka më!”<sup>5</sup>*

Në tregimin “Neta” kemi një motiv të përshkrimit thujse të ngjashëm:

<sup>3</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh (Letra e një të panjohure)”, përkthyer nga Robert Shvarc dhe botuar nga Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë 1998, f. 74

<sup>4</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 95

<sup>5</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, f. 78

*“Sapo të pashë, m’u duke mjaft tërbeqës: nga fytyra pak i bequr e i hollë, i bardhë, i vijosur me dy vetulla të zezë, me dy sy shumë depërtues e pak të thellë, me një ballë të gjerë e me dy buzë pak të trasha. Kur qeshje, të shfaqeshin shumë bukur dhëmbët e bardhë e të dendur, dhe aq të rregullt dukeshin, sa tjetri kujtonte se ishin rrafshuar me ndonjë limë. Mandej kishe një trup të gjatë e shumë të hijshëm, mbaje një këmbisë të bardhë, me një fjongo si dy pendë zogu, një pallto bojë qielli të mbyllur dhe pantallona të bardha... Aq tërbeqës dhe aq i dashur m’u duke, sa s’ngopësia duke të parë nga fletët e dritares.”<sup>6</sup>*

Mjaft interesant është edhe çasti i përshëndetjes, ku vërehet se ky motiv i novelës së Cvajgut duket se ka ndikuar në mënyrë të theksuar te Spasse, ky çast te Cvajgu na paraqitet në këtë mënyrë :

*“...pa e ditur shkaku, e ndjeva veten të detyruar të të hapja portën dhe kështu të zura rrugën, saqë për pak u përplasëm me njëri-tjetrin. Ti më vështrove me atë shikim të ngrohtë e të butë që më përpiu dhe që ishte si një ledhatim; me nënqeshe - po, nuk mund ta them ndryshe: më nënqeshe, më përkëdhele dhe më the me një zë fare të ulët e pothuajse të ëmbël: Shumë faleminderit, zonjushë! Kjo ishte e tëra, i dashur; dhe që nga ai çast, që kur e ndjeva atë vështrim të butë e përkëdhelës, u bëra jotja ... Pandejja se ajo përkëdhelje më përkiste vetëm mua, vetëm e vetëm mua, dhe në këtë çast të parë në shpirtin tim, në shpirtin e një vajze të paarrirë, u zgjua diçka ... e quajta veten grua dhe t’u dorëzova përgjithmonë.”<sup>7</sup>*

Në tregimin “Neta” këtë motiv e kemi pothuajse të njëjtë:

*“Ishte një mëngjes shumë i këndshëm i muajit maj. Unë rrija si ngaherë te pragu i portës së jashtme bashkë me nënën. Ti dole papandebur nga shtëpia e fqinjës, i hodhe sytë nga dera jonë dhe, porsa na pa, na the Mirëmëngjesi! duke vënë buzën në gaz; mandej ike tatëpjetë qytetit. Megjithëqë ishte edhe mamaja, këtë përshëndetje më dukej sikur ma bëre vetëm mua. Sa të lumtur e ndieja veten atë ditë! Mirëmëngjesi yt më tingëllonte gjithnjë si fjalë hyjnore mu në telat më të hollë të zemrës. Dhe pse jo? Kjo ishte përshëndetja e parë që më bëre mbas kaq kohësh; ky ishte vështrimi i parë e më tërbeqës që më hodhe mbas kaq muajsh. Kisha të drejtë, pra, ta quaja veten të lumtur.”<sup>8</sup>*

Një motiv tjetër që përsëritet shpesh në raste e trajta të ndryshme është edhe motivi i përgjimit, vëzhgimit, e i pritjes me tronditje dhe shpresë për t’u kthyer romancieri R. dhe shkrimtari Pal Gjinoshi. Te Cvajgu, motivi dinamik i pritjes përsëritet shpesh që nga fillimi e deri në fund të novelës. E panjohura e pret më shpesh dhe më me ngulm të dashurin e admiruar:

*“Të nesërmen ti erdhe, por, megjithëse të përgjova, s’të pashë dot - kjo ma shtoi edhe më tepër*

<sup>6</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 95

<sup>7</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, f. 79-80

<sup>8</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 99

*kureshbjen. Më në fund, ditën e tretë, të pashë; dhe u habita, u trondita shumë.”<sup>9</sup>*

*“Unë të përgjoja ty, përgjoja zakonet e tua, përgjoja njerëzit që vinin tek ti, dhe të gjitha këto, në vend që të ma pakë- sonin, ma shtonin edhe më tepër kureshbjen për ty.”<sup>10</sup>*

*“Por unë e mbaj mend fort mirë, i dashur, ditën dhe orën kur u bëra e tëra dhe përgjithmonë pas teje: sapo isha kthyer nga shëtitja me një shoqe shkolle dhe po qëndroja me të duke bërë muhabet përpara portës. Atëherë erdhi një veturë, qëndroi dhe përnjëherësh ti kërceve jashtë në atë mënyrën tënde të rëmbyer e të zhdëryjellët, e cila edhe sot më tërbeq aq shumë.”<sup>11</sup>*

Në tregimin e Spases kemi po kështu disa motive të ngjashme:

*“Aq tërbeqës dhe aq i dashur m’u duke, sa s’ngopesha duke të parë nga fletët e dritares. Mbarove punën e qirasë e dole në qytet pa më vënë re fare. Ishta shumë kërshërimitare për ty, prandaj renda te fqinja për të marrë hollësira.”<sup>12</sup>*

*“Mandej të përgjova tërë vitin: flija në dhomë, aty përkundrejt, larg teje. Shuaja dritën dhe mbi një karrige rrija pranë dritares e të shikoja brenda në dhomë. Ti kethebeshe në dhomë në orën 7 mbas dreke. Këtë rregull e mbajte tërë vitin.”<sup>13</sup>*

*“Dita-ditës vuaja më tepër për ty; rrija orë me radhë duke të përgjuar nga dritarja. Shpeshherë ditën, kur nuk ishte ti, hyja në dhomën tënde.”<sup>14</sup>*

Motivi i hyrjes në dhomë, etja për të vëzhguar nga mbrenda dhe motivi i luleve është paraqitur po ashtu në krijimin e të dy autorëve, por edhe ky motiv është më i shpeshtë në novelën e Cvajgut sesa në tregimin e Spases. Për shembull, te Cvajgu kemi:

*“Në mëngjes u ngrita herët e u përgatita të ikja. Më duhej të ndodhesha në punë dhe s’desha të më gjente atje shërbëtori yt. Kur qëndrova e veshur përpara teje, ti më more ndër krabë e më vështrove gjatë thellë në sy; mos ishte vallë një shkëndijëz kujtimi të largët në errësirë, apo vetëm se të dukeshja e bukur, e lumtur, ashtu siç isha? Pastaj më puthe në buzë. Unë u shkëputa ngadalë nga përqaqimi yt dhe u mata të ikja. Atëherë ti më pyete: S’do të marrësh ca lule me vete? Të thashë po. Ti more katër trëndafilat e bardhë nga vazoja prej kristali të kaltër që kishe mbi tryezë ... dhe m’i zgjate. Ditë me radhë i puthta pastaj ato lule.”<sup>15</sup>*

*“Rrallë, shumë rrallë më fluturonin mendimet drejt shtëpisë sate. Vetëm një gjë bëja gjatë kësaj kobe: gjithmonë për ditëlindjen tënde të dërgoja një buqetë trëndafilash të bardhë, si ata që m’i fale atëherë, pas natës sonë të parë dashurore. Vallë, gjatë këtyre dhjetë-njëmbëdhjetë vjetëve, a e ke pyetur ndonjëherë veten se kush t’i dërgonte? A e ke kujtuar atë që ia pate dburuar trëndafilat e*

<sup>9</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, fq. 77

<sup>10</sup> Ibid., f. 77-79

<sup>11</sup> Ibid., f. 79

<sup>12</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 95-96

<sup>13</sup> Ibid., f. 97

<sup>14</sup> Ibid., f. 98

<sup>15</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, f. 98

*bardhë?”<sup>16</sup>*

*“Në dhomën tënde kishte shumë pak ndryshime: disa piktura më tepër dhe më shumë libra, aty-këtu ndonjë orendi e re, por të gjitha më dukeshin të njohura. Dhe mbi tryezë qëndronte vazjoja me trëndafilat e mi, që t’i pata dërguar një ditë më parë për ditëlindjen tënde ... si kujtim i asaj që ti nuk e mbaje mend ... e megjithatë më vinte mirë që përkujdeseshe për ato lule: sepse kështu ekzistonte, pra, rreth teje një frymë e qenies sime, një aromë e dashurisë sime...”<sup>17</sup>*

Kurse te Spassja, motivi i hyrjes në dhomë dhe motivi i luleve paraqitet më rrallë:

*“Hyja në dhomën tënde, e ndreqja edhe më mirë shtratin, vija pak në rregull grumbullin e librave që mbaje në tryezë dhe ikja. Një ditë m’u tek që të vija lule, dhe e bëra: i mora fqinjës një gotë, e mbusha me lulet më të bukura të kopshtit dhe t’i vura mbi tryezë. Nuk e di se ç’mbresë të lanë lulet e para. Por, sidoqoftë, ti kujtoje se t’i sillte zonja e shtëpisë, megjithatë unë ditë për ditë bëja punën time.”<sup>18</sup>*

*“Një ditë u preka shumë porsa shkela në dhomë: shtratin e kishe lënë të pandrequr: çarçafët ishin të hedhur, nënkresën e kishe luajtur nga vendi dhe në atë parregullim të shtratit sikur kishe lënë diçka: një gjurmë permallimi! Një ëndërr e gjallë që më doli përpara: të parafytyroja aty, edhe aty ashtu si doja unë ... atëherë nuk u përmbajta, rrëmbeva ca lule nga gota e t’i vura nën jastëk shumë e permalluar! Këtë gjë ti quaje si të duash: marrëzi e budallallëk, mua aq më bën! Kur i ke gjetur lulet nën jastëk, ndoshta me zemër e ke falënderuar zonjën e shtëpisë, megjithatë, unë ndieja kënaqësi.”<sup>19</sup>*

Motivi i librit paraqitet po kështu shpesh te novela e Cvajgut, por në disa raste paraqitet edhe në tregimin “Neta” të Spasses. Te Cvajgu paraqitet në këtë mënyrë:

*“Qëndrova te porta për t’i soditur të gjitha sendet, sepse të gjitha sendet e tua ishin çuditërisht të ndryshme; si ato nuk kisha parë kurrë ndonjëherë tjetër: kishte midis tyre idhuj indianë, skulptura italiane, piktura të mëdha e të larme, dhe më në fund vinin librat, aq të shumtë dhe aq të bukur, sa s’mund t’i kisha përfytyruar kurrë ... ndjeva njëfarë admirimi mbinjerëzor, që m’u shtua edhe më tepër nga ata libra të panumërt.”<sup>20</sup>*

*“Ti ishe për mua gjithçka, e gjithë jeta ime. Çdo gjë ekzistonte vetëm atëherë kur kishte lidhje me ty ... ti ma ndryshove të gjithë jetën. Unë, që në shkollë isha mospërfullëse dhe mesatare, tani u bëra përnjëherësh e para e klasës; lexoja qindra libra ... gjer natën vonë, sepse e dija që ti i doje librat.”<sup>21</sup>*

*“Vetëm për ty jetoja atëherë, i blija të gjithë librat e tu; kur dilte emri yt në gazetë, për mua*

<sup>16</sup> Ibid., f. 98

<sup>17</sup> Ibid., f. 104-105

<sup>18</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 97

<sup>19</sup> Ibid., f. 113

<sup>20</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, f. 66-67

<sup>21</sup> Ibid., f. 81



*ishte dûtë feste. A do të ma besosh se unë e di përmendsh çdo rresht të librave të tu - aq shpesh i kam lexuar?!<sup>22</sup>*

Kurse në tregimin “Neta” të Spasses kemi një motiv të ngjashëm:

*“Ulesbe pranë një tryeze dhe filloje të lëcisje volume librash. Ja, sikur të kam në sy: vije librin përpara dhe një fletore e një laps pranë tij; mandej mbështesje kokën mbi njëren dorë dhe filloje nga leximi; orë të tëra rrije ashtu i kërrusur, duke shfletuar librin, e aty-këtu duke shkruar shënime mbi fletoren që kishe pranë.”<sup>23</sup>*

*“... e ndreqja edhe më mirë shtratin, vija pak në rregull grumbullin e librave që mbaje në tryezë, dhe ikja.”<sup>24</sup>*

Motivi i dashurisë haset pothuaj mjaft shpesh dhe është motiv dinamik, që e çon ngjarjen përpara, natyrisht më shpesh paraqitet në novelën e Cvajgut, por disa herë edhe në tregimin e Spasses.

Cvajgu këtë motiv e peshkruan në këtë formë:

*“A ke nisur ta kuptosh tani, i dashur, se ç’mrekulli, se ç’fshehtësi joshëse ke qenë ti për mua fëmijën? Një njeri që e nderonin, sepse shkruante libra, sepse ishte i famshëm në një botë tjetër të madhe, të huaj për mua! Dhe këtë njeri ta zbulojë papritmas si një burrë të ri njëzetepesëvjeçar, elegant e plot hare djaloshare! A duhet të ta them akoma se që nga ajo dûtë në shtëpinë tonë, në gjithë botën time të varfër fëmijërore, s’më interesonte gjë tjetër veç teje, se unë, me tërë atë kryeneçësinë dhe me tërë atë durimin këmbëngulës të moshës sime, endesha vetëm rreth jetës sate, rreth qenies sate.”<sup>25</sup>*

*“Ishte butësia jote ndaj grave ajo që ta bënte vështrimin aq të ëmbël e të ngrohtë pa e ditur as ti vetë. Kurse unë, vashëzja trembëdhjetëvjeçare, nuk e shkoja ndër mend këtë. Unë isha si e zhytur në zjarr. Pandejja se kjo përkëdhelje më përkiste vetëm mua, vetëm e vetëm mua ... Më ishte e pamundur të përmendja emrin tënd: që në këtë çast të parë e të vetëm ai m’u bë i shenjtë, u bë sekreti im.”<sup>26</sup>*

*“Pasioni im për ty mbeti po ai: vetëm se filloi të rritej me trupin tim, me shqisat e mia të zgjuara nga dremitja, filloi të bëhej më i zjarrtë, më trupor, më fëmijëror. Dhe ajo që s’mundi ta përfytyronte atëherë fëmija me vullnetin e saj të shtypur e të pamësuar kur i ra ziles në derën tënde, tani m’u bë ideja ime e vetme: të të falesha ty, të të jepesha ty.”<sup>27</sup>*

*“Ndodhi rastësisht që një kamion, i cili po shkarkohej, na zuri rrugën dhe ti duhej të më kalojë medoemos fare pranë. Padashur më zuri vështrimi yt i shkujdesur dhe përnjëherësh, porsa e takoi shikimin tim gjithë vëmendje, u bë përsëri ai vështrimi yt i butë e përkëdhelës që e mbulonte e njëkobësisht e zbulonte tjetrin, ai vështrim që më përfshinte e më tërbiqte menjëherë ... për*

<sup>22</sup> Ibid., f. 89

<sup>23</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 97

<sup>24</sup> Ibid., f. 98

<sup>25</sup> Cvajg, Stefan: “Dy novela dhe një homazh”, f. 78

<sup>26</sup> Ibid., f. 80

<sup>27</sup> Ibid., f. 90

herë të parë zgjoi femrën tek unë dhe më mësoi të dashuroja.”<sup>28</sup>

“Dy muaj të tërë prisja çdo ditë ... por jo, përse të t’ipërsbkeruaj ato vuajtje skëterre të pritjes e të dëshpërimit? Unë nuk të akuzoj, unë të dashuroj, ashtu siç je, vetëm ashtu siç ke qenë gjithmonë dhe siç je akoma edhe sot.”<sup>29</sup>

“Dëgjomë, i dashur, po të lutem ... është lutja ime e parë dhe e fundit që po të drejtoj ... bëma këtë të mirë, bëje për mua: për çdo ditëlindje - që është një ditë kur njeriu e kujton veten e vet - merr ca trëndafila dhe vëri në vazon tënde. Bëje, i dashur, bëje, ashtu siç bëjnë të tjerët një herë në vit, kur mbajnë një meshë për një të vdekur të dashur e të shtrenjtë. Por unë s’besoj më në Perëndinë dhe s’dua meshë. Unë besoj vetëm në ty ... vetëm ty të dashuroj dhe vazhdoj të jetoj vetëm brenda teje ... ah, vetëm për një ditë në vit, krejt, krejt e heshtur, ashtu siç kam jetuar gjithmonë pranë teje ... të lutem, bëje këtë, i dashur ... është e para dhe e fundmja lutje që po të drejtoj ... të falënderoj ... të dashuroj, të dashuroj ... lamtumirë!”<sup>30</sup>

Ndërsa te Spassja kemi një përshkrim afërsisht të ngjashëm:

“Isha shumë kërsbërimitare për ty, prandaj renda te sqinja për të marrë hollësira - qubet Pal Gjinoshi e është nga fsbatrat ... sa tërbeqës! - Këto më tha sqinja. Nuk e di pse u gëzova kur më tregoi emrin tënd dhe kur më siguroi se zure me qira dhomën e saj. U largova nga ajo duke pëshpëritur emrin tënd ... Pal ... Pal. Emër i bukur, emër shumë i bukur! Isha bërë tetëmbëdhjetë vjeçe dhe kisha parë e njobur shumë të rinj të qytetit: më kanë dashur shumë, por unë ... s’përfillja asnjë, se asnjë s’më hynte në zemër. Nuk më interesonin lajkat e tyre ... mirëpo për çudi: vështrimi yt më tronditi e më ngjethi mishë. A thua ndonjë enigmë po thuret e po rubet në sytë e tu e në të folurit tënd.”<sup>31</sup>

“Po! Tronditës ka qenë çasti kur të pashë: dashuria nuk të pushtuaka ngadalë; ajo qenka e shpejtë si rrufeja e të pushtuaka pa mëshirë e pa menduar. Një luftë të rreptë ndjenjash kisha në vetvete: asgjë s’më qetësonte, asgjë, po them asgjë. Shumë herë hyja në dhomën time, bëja sikur këndoja ndonjë pjesë dashurie në prozë e poezi, mandej shkoja afër pasqyrës, shikoja fytyrën time: herë qeshja, herë vrenjtesha, herë zbardhja dhëmbët dhe herë rrija si zonjë e madhe ... këto janë marrëzi, mirëpo për mua ishin ashtu siç ishin: veprime fare me mend.”<sup>32</sup>

“Një ditë, letrat e shkruara në mbrëmje t’i gjeta të shpërndara pa rregull mbi tryezën e punës dhe disa kishin rënë në dysbeme. I mblodha shpejt e shpejt dhe mandej i hodha sytë mbi një dorëshkrim, ku lëçita këto radhë të nënvizuara: “Dashuria është një iluzion. Që të jetë kjo e gjallë përgjithnjë, duhet të jetë një iluzion i vijueshëm. - Si e shastisur zbrita poshtë. - Dashuria s’qenka e vërtetë, por qenka iluzion! Sa keq! - mendoja pastaj. - Si iluzion qenkan veprimet e mia? Iluzion qenka dashuria ime? Nga iluzioni dua të hiqem që ta dua këtë njeri kaq fort? Oh, kurrë s’e kisha menduar! As dëgjuar dhe as kënduar! Virgili, Dantja, Hygoi, Gëjja, oh, një botë e tërë

<sup>28</sup> Ibid., f. 92

<sup>29</sup> Ibid., f. 99

<sup>30</sup> Ibid., f. 119

<sup>31</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 96

<sup>32</sup> Ibid., f. 97

*shkrimtarësh e poetësh me që kanë shkruar volume për të lavdëruar dashurinë, duke e quajtur si një gjë hyjnore ... - Pali, idili i vetëm i jetës sime, e rrëzon, e poshtëron dashurinë, e quan iluzion, gënjeshtër, të paqenë! Zot! Do të jetë njeri që s'ka ndërë "Dashurinë", që s'e ka besuar, që s'e ka kuptuar ... më duhet të besoj, po, t'i besoj idilit tim; të besoj se dashuria është një iluzion, por jo dashuria ime, se kjo imja është e vërtetë, është hyjnore."*<sup>33</sup>

*"Më pikëlloi lajmi i martesës sate! Krejt e zbehtë u largova nga fqinja e shkova në dhomën time. Kësaj here qava shumë, sepse e varrosa edhe shpresën e fundit ... asnjë ngushëllim nuk gjeja ... katër ditë me radhë as baba, as pija, as flija. Sytë gjithnjë i kisha me lot. Thashë se martesa jote më zhdoku shpresën e fundit, po nuk më shuajti asnjë shkëndijë të dashurisë. Ajo më vlon keq përbrenda. Martesa jote me një tjetër nuk qenka aspak gardh për dashurinë time. Por ... fjalët e dorëshkrimit tënd: Dashuria është një iluzion, përsëri më trondisin shumë. Nuk e gjej dot pse të jetë iluzion dashuria ime kundrejt teje."*<sup>34</sup>

*"S'kam më fuqi të të shkruaj: çurgë më shkojnë lotët e dora më dridhet, kurse zemra më rreh fort. Tani vetëm një gjë kërkoj prej teje! Nuk dua të më duash, mbase dashuria për ty është një iluzion, por dua vetëm të më kujtosh, të më kesh ndër mend. Vetëm këtë theror kërkoj prej teje. Edhe kur vitet të të kërrusin kurriçin dhe hallet të të zbardhin flokët, të jesh i sigurt se dashuria ime nuk do të jetë shuar, mbasi unë të dua jo për një tjetër, por pse dua të të dua! Lamtumirë përjetë! Kujtomë!"*<sup>35</sup>

Në epilogun e vepres së Cvajgut paraqitet përsëri tregimtari-autor në veten e tretë; pasi lexon letrën, e lëshon me dorën që i dridhet, pastaj i ngjallen kujtimet e ngatërruara, vogëlushja fqinje, një vajzë, dashnorja në lokalin e vallëzimit. Por kujtimet e tij nuk janë të kthjellëta, nganjëherë i duken si përjetime ëndrrash. Mirëpo, pa pritur e pa kujtuar, vështrimi i tregimtarit, i romancierit R., ngulitet mbi vazon prej kristali të kaltër që ishte vendosur mbi tryezë, ajo ishte e zbrazët në ditëlindjen e tij. Në atë çast iu drodh shpirti dhe trupi, iu duk se një erë e ftohtë fryu nga një botë tjetër, dhe autori e mbyll kështu:

*"Ai ndjeu një vdekje, ndjeu dashurinë e pavdekshme; në thellësinë e shpirtit të tij u shpalos diçka, dhe pa e ndier trupin e vet, por i mbushur plot e përplot me ndjenja të zjarra, e kujtoi të Padukshmen, siç kujtoben tingujt e një muzike të largët e të mekur."*<sup>36</sup>

Në tregimin "Neta" të Spasses, tregimtarit-autor i rrokullisen lot nga sytë pasi lexon letrën. Edhe atij i shpalosen kujtime të dashura, dhoma e studimit, shtrati, lulet e ve- çanërisht Neta, vajza që e kishte dashur aq fort. E shoqja, e cila e kishte vënë re pikëllimin dhe ngashërimin e ba- shkëshortit, e pyet për letrën që kishte lexuar. Kurse Pali i thotë:

<sup>33</sup> Ibid., f. 99

<sup>34</sup> Ibid., f. 101

<sup>35</sup> Ibid., f. 102

<sup>36</sup> Cvajg, Stefan: "Dy novela dhe një homazh", f. 119

*“Një sboqe më paska vdekur!” dhe shton i përmalluar: “Kujtimi e ngushëlloftë Netkën e pafajshme!” Kështu, autori e përfundon tregimin me një epilog prekës e plot fisnikëri: “Ky kujtim i përmallshëm e mallëngjeu shumë plakun e thinjur: fërkoj sytë dhe rënkoi. E lëçiti dhe e lëçiti shumë herë me radhë letrën e pluburosur dhe më së fundi pëshpëriti: - Kushedi se me cilin do të jetë martuar! Kushedi se sa fëmijë do të ketë! Kushedi nëse rron ende me iluzionin e dasburisë, Netka kaq e thjeshtë, kaq shpirtmadhe.”<sup>37</sup>*

---

<sup>37</sup> Spasse, Sterjo: “Vepra letrare I”, f. 102-103

Albulena BLAKAJ-GASHI

## PROMETEU, HIMN GJENIUT TË STURM UND DRANG-UT

“Prometeu” është një ndër poezitë më të njohura dhe më të fuqishme të Johann Wolfgang Goethes. Është shkruar rreth vitit 1774, në kohën e krijimit të himneve të tjera të njohura të Goethes si *Ganimedi* dhe *Kënga e Mubamedit*. Prometheu njëkohësisht përbën edhe kulminacionin e krijimeve të tij me rimë të lirë. E gjithë kjo për shkak se poezia “Prometeu” është e periudhës së *Sturm und Drang-ut, me individin që është në qendër të një bote të gjykuar subjektivisht, dhe botëkuptimi i tyre për autoritetin dhe hierarkitë shërbejnë si skena për realizimin e subjektit*<sup>1</sup>, dhe me figura mitologjike të cilat mund të shihen si përfaqësuese të gjenive të kësaj epoke letrare.

Duke qenë se ndër qëllimet kryesore të *Sturm und Drang-ut, që është pararendës i Romantizmit gjerman dhe nxitës i romantizmit evropian, e botëror* është tejkalimi i autoriteteve tradicionale, lirisht mund të thuhet se kjo poezi bart mesazhin kryesor të tij. Pastaj, edhe për sa i përket formës, kjo poezi është tipike për *Sturm und Drang-un*. Ajo është përkthyer në shqip nga disa përkthyes të ndryshëm, por unë, në këtë punim do të marr për analizë dy prej tyre: atë të Robert Shvarc dhe të Skënder Luarasi.

Poezia e Goethes “Prometeu” është e përbërë nga shtatë strofa me gjatësi të ndryshme dhe e shkruar me vargje me gjatësi të ndryshme, me rimë të lirë e me numër jo të barabartë rrokjesh. Kjo formë e të shkruarit të poezisë është tipike për Goethen, sidomos në periudhën e *Sturm und Drang*, ndërsa siç u tha, pikërisht poezia *Prometeu* merret si shembull tipik. Forma e saj njëkohësisht e vë në pah edhe më shumë porosinë e poezisë. Parregullsitë e shumta në formë mund të shihen si shprehje e emocionalitetit, por edhe guximit të heroit. Për shembull, strofa e parë përbëhet nga njëmbëdhjetë vargje në të cilat shpesh përdoret imperativi dhe theksohen përemrat pronorë në vetën e parë e të dytë. Pastaj, strofat 4, 5 e 6 ku Prometheu i drejtohet zotërave, janë në formë pyetjesh, si dhe çdo varg fillon me shkronjë të madhe.

Për sa i përket formës, që të dy shqipëruesit, i kanë mbetur besnik origjinalit, duke e ndarë në shtatë strofa, por jo gjithnjë ato kanë vargje po aq sa strofat në gjermanisht. P. sh.: përderisa strofa e parë në origjinalin gjermanisht ka 11 vargje e te Luarasi ka 12, ajo te shqipërimi i Shvarcit arrin në 13 vargje. Pastaj çdo varg me

---

<sup>1</sup> Krahaso: Metzlers Literaturlexikon, Weimar, 1990, Fq. 448.

shkronjë të madhe e fillon Luarasi, por kësaj skeme nuk i përmbahet Shvarci.

Himni zakonisht është një këngë që shpreh falënderim dhe lavd, por te kjo poezi e Goethes këtë parim e gjejmë të përmbysur, sepse në vend të lavdërimit të perëndive, kemi Prometeun i cili, *nga të gjitha perënditë greke, është ai i cili është më i afërt me njerëzit dhe ngjitet kundër perëndive*<sup>2</sup>, madje edhe i akuzon, por ajo që e bën këtë poezi më të fuqishme është ironia që përdorë autori e që madje arrin shkallën e talljes së zotrave nga Prometeu.

Zhvillimi tematik brenda poezisë do të mund të përmbledhet kështu: zemërimi për dështimin e perëndive në të tashmen (strofat I dhe II) për shkak të adhurimit të tyre në të kaluarën (strofat III-VI) shkakton mosrespektimin e tyre në të tashmen e rikthyer (strofa VII). Goethe ka përdorur një gjuhë shumë ekspresive dhe këmbëngulëse në një dialog të njëanshëm të Prometeut drejtuar Zeusit. Këtë e vërejmë qysh në vargun e parë, kur Prometeu i flet Zeusit me një ton përbuzës, madje i drejtohet me një “TI” rebeluese. Poezia fillon me një fjali në urdhërore, e cila hierarkinë ekzistuese e kthen me kokë poshtë dhe kryezotin e kthen në pranues të urdhërave:

*Bedecke deinen Himmel, Zeus,*

Ai kërkon nga zotërat, por para së gjithash nga Zeusi, të largohen nga njerëzit. Kjo ndarje e dy botërave, pra hyjnore e toksore nga njëra-tjetra vërehen qysh në strofën e parë. Goethe e arrinë ta bëjë të qartë këtë përmes përdorimit të përemrave pronorë në togfjalëshat “*deinen Himmel*” dhe “*meine Erde*” (strofa I, Vargu 1 dhe V.6), pra në shqip “Qieillin tënd” dhe “Tokën time”. Këtë varg në shqip R. Shvarc e ka përkthyer kështu:

*Mbuloje qiellin tënd, o Zeus,*

Edhe këtu, për shkak të përdorimit të përemrit pronorë në vetën e dytë, si dhe urdhërtores, në të vërejmë po të njëjtin mllef që lëshohet mbi Zeusin. Ndërsa Luarasi në vend të fjalës Zeus, përdorë atë Zot dhe shkruan:

*Mbuloje qiellin tënd, o Zot,*

Zeusi krahasohet me një fëmijë, ndërsa Prometeu është krenar për “kasollen” e tij dhe zjarrin për të cilin Zeusi ia ka zili dhe i cili mllefin e tij e shfryen mbi botën si fëmija mbi drizat (murrizat):

*nd übe, dem Knaben gleich,*

*Der Disteln köpft,*

*An Eichen dich und Bergeshöhn;*

<sup>2</sup>Krahaso: C. Kerényi: *Prometheus: Archetypal Image of Human Existence*, Bollingen Foundation, New York, 1963, fq. 3.

Këto vargje nga Luarasi janë shqipëruar kështu:

*Dhe si fëmija,  
Që i pret gjembaçit kokën,  
Qëllo mbi lisa e maja malesh;*

Te Shvarci, këto vargje janë kështu:

*dhe, si ai çunaku  
që drizat i shkurton,  
zëbavitu edhe ti  
duke shkullur lisa  
e kreshta malesh duke rrokullyer-*

Te shqipërimi i Luarasis, nga tri vargje të Goethes na dalin tri, dhe përshtatja është bërë shumë më mirë se sa te Shvarci, sepse te Goethe askund nuk kemi: *zëbavitje*, *shkulje* e *rrokullima*. Goethe shkruan vetëm ‘ashtu si çunaku’ dhe e lidh me gjembaç a driza, por e lë të hapur për lexuesin ta përfytyrojë veprimin, pa dhënë shumë përshkrime a detaje. Shohim pra, se Luarasi edhe për sa i përket formës, por edhe kuptimit ka arritur t’i përkthejë më mirë këto vargje.

Pastaj krenarinë e Prometeut dhe *epërsinë* e tij ndaj Zeusit e vërejmë edhe në vargjet në vijim kur ai ngritet kundër tij dhe mbron tokën e vet e shtepinë- të cilën nuk ia ndërtuan zotërat, por ai vet. Dhe sigurisht zjarrin e kësaj vatre, për të cilin e kanë zili!

*Mußt mir meine Erde  
Doch lassen stehn  
Und meine Hütte, die du nicht gebaut,  
Und meinen Herd,  
Um dessen Glut  
Du mich beneidest.*

Ky polaritet i fortë i dy botëve gjen shprehje edhe në gjuhë, përmes përdorimit shumë të shpeshtë të përemrave vetorë, vetvetorë dhe pronorë. Veta e dytë e cila paraqitet katër herë, gjendet përballë vetës së parë e cila përdoret pesë herë. Është gjithashtu e rëndësishme që përemri pronor vetëm një herë i atribohet Zeusit (vargu1), dhe tri herë Prometeut (vargu 6, 8 dhe 9).

Kështu i ka përkthyer Skënder Luarasi këto vargje:

*Po dheun tim,*

*Mos ma trazo,  
Mos ma trazo kasollen,  
Që nuk ma ngrite ti,  
As vatrën time,  
Për prushin e së cilës  
Më ke zili.*

Ndërsa Shvarc i përktheu në këtë mënyrë:

*por tokën time  
dot nuk ma cënon,  
dhe as kolibën time  
që nuk ma ngrite ti,  
dhe as vatrën time,  
për prushin e së cilës  
më ke aq fort zili.*

Nëse i krahasojmë këto shqipërime me vargjet e originalit, vërejmë se përemrat pronorë paraqiten po aq shpesh, ndërsa vërehet qartë ironia në vargun “që nuk ma ngrite ti”, i cili është identik në të dyja përkthimet. Ndërsa, sa i përket vargut të gjashtë (te Luarasi), respektivisht të tetit (tek Shvarc), mendoj se përkthimi i Shvarc-it ‘*por tokën time*’, është më i qëlluar se sa ‘*po dheun tim*’, sepse e bën më të qartë atë që dëshiron të vëjë në pah edhe Goethe- ndarjen mes qiellit e tokës. Vargu vijues ‘mos ma trazo’ është më i qëlluar, sepse tingëllon më shumë si urdhër a kërcënim, se sa ‘dot nuk ma cënon’ në dëftore. Pastaj me përsëritjen e dyfishtë të pjesës ‘Mos ma trazo’ krijon një rimë e cila tërheq vëmendjen tek fjala e fundit ‘kasollen’ që i jep edhe më shumë rëndësi vargut. Në këto vargje në origjinalin në gjermanisht vërejmë të jetë përdorur edhe aliteracioni, varg tipik gjermanik, për të krijuar kontrastin e përmendur mes tokës e qiellit. Goethe përdorë: **H**ütte (kasolle) dhe **H**erd (vatër) kundrejt **H**immel (qiell) dhe **B**ergeshöhn (kreshta/maja malesh). Katër vargjet e fundit të kësaj strofe janë goxha të ngjajshëm, dhe tek të dy shqipërimet trajtat e shkurtra të përemrit krijojnë pak a shumë të njëjtën ndjenjë. Pastaj, që të dy përkthyesit te këto vargje kanë krijuar një rimë ABCA me fjalët **ti** dhe **zili** që e forcon më shumë lidhjen kuptimore mes tyre. Megjithëse, duhet të thuhet se duke i shtuar ‘aq fort’ vargut të fundit, Shvarci nuk e forcon, por përkundrazi e zbeh kuptimin.

Edhe strofa tjetër ka intonacion të ngjajshëm dhe këtë rradhë nuk i drejtohet vetëm Zeusit, por të gjithë zotrave, të cilëve u mvësh ‘cilësi’ të cilat nuk korrespondojnë me atributet hyjnore. Perënditë këtu paraqiten me cilësi gati se



njerëzore, sepse janë të varur nga të tjerët, ushqehen nga shpresat e lutjet e të mjerëve, fëmijëve e lypsëve, përderisa “të mjerë” janë vet Zotërat, madje “nuk njih gjë më të mjerë nën këtë diell”:

*Ich kenne nichts Ärmeres  
Unter der Sonn als euch, Götter!  
Ihr nähret kümmerlich  
Von Opfersteuern  
Und Gebetshauch  
Eure Majestät  
Und darbtet, wären  
Nicht Kinder und Bettler  
Hoffungsvolle Toren.*

Kjo strofë në versionin e Luarasit tingëllon kështu:

*Nuk njoh nën diell asgjë  
Më të mjerë se ju, perëndira!  
Madhërinë tuaj  
Mezji e ushqeni  
Me copra kurhani  
Dhe me frymë uratash:  
Dhe do vdisnit urie  
Sikur foshnjat e hysat  
Të mos varnin mbi ju  
Shpresat e tyre të marra.*

Ndërsa në versionin e Shvarcit:

*Në këtë diell nuk njoh vërtet  
gjë më të mjerë se ju, o perëndi! Madhësitinë tuaj e ushqeni varfërisht  
me haraçe kurbanësh  
e bërbelisje lutjesh  
dhe do të merrnit fund, sikur  
naivët dhe lipsarët  
të mos ishin aq budallenj  
sa të shpresonin jetë e mot.*

Në këto vargje gjejmë sërish ato që u thanë mësipër, për *Prometeun* dhe *Sturm*

*und Drang-un*. Ai e ndjen veten gati sa zotrat, por jo për nga madhështia, sepse siç mund të shohim perënditë të përshkruan me ‘*arm dhe kümmerlich*’, por për nga ndjenja që bartin figurat e gjenive të kësaj epoke. Te shqipërimi i Luarasi vërejmë se ka një varg më shumë se sa te origjinali, pastaj, përderisa te Goethe foshnjat e lypsarët janë të marrë, ashtu siç e përkthen edhe Shvarci, Luarasi e bartë marrinë të shpresat e tyre, por nuk tingëllon keq. Përkundrazi. Mandej, te Luarasi ruhet më mirë struktura ritmike e origjinalit, ndërsa Shvarci përkthen më lirshëm, duke shtuar madje fjalë si: *vërtetë* në vargun e parë, pastaj fjalën *Kinder* (fëmijët) e ndërron me *naivët*. Ai madje në fund shton një varg të tërë: ‘*sa të shpresonin jetë e mot*’.

E gjithë kjo tallje me zotrat vetëm sa forcohet me vargjet e strofat në vijim:

*Da ich ein Kind war,  
Nicht wußte, wo aus noch ein,  
Kehrt ich mein verirrtes Auge  
Zur Sonne, als wenn drüber wär  
Ein Obr, zu hören meine Klage,  
Ein Herz wie meins,  
Sich des Bedrängten zu erbarmen.*

*Se isha vetëm fëmijë,  
nuk dija nga t'ia mbaja  
ktheva sy të përhumbur  
drejt diellit, sikur andej të ishte  
një vesh, ankëimin të ma degjojë  
një zemër si e imja,  
të shtypurin ta mëshirojë. (A.B)*

Kjo strofë në përkthimin e Luarasi është kështu:

*Kur isha kalama,  
Dhe s'dija nga t'ia mbaja,  
E ktheva syrin e gabuar  
Drejt diellit, sikur t'ish atje  
Një vesh, që ta dëgjonte ankesën time,  
Një zemër, si imja,  
Që ndjen mëshirë për të shtypurit.*

Ndërsa nga Shvarci u shqipërua kështu:

*Kur isha ende fëmijë  
dhe s'dija nga t'ia mbaja,  
i ktheja sytë e butuar  
nga dielli, a thua se përtej  
do gjendej ndonjë vesh  
ankëimin tim për ta dëgjuar,  
a ndonjë zemër, si e imja,*

*nevojtarin për ta ndihmuar ...*

Vargu i parë në origjinalin fillon me ‘*Da ich...*’ që ka kuptimin e ‘*se; sepse; ngaqë isha...*’, me të cilin Prometeu e arsyeton veten për besimin e kotë që kishte ke zotrat me të qenit fëmijë, ndërsa në asnjërin nga shqipërimet e marra për analizë nuk e kemi këtë. Që të dy e fillojnë me ‘*Kur isha...*’. Pastaj Goethe, besoj ta ketë fjalën për kthimin e ‘*syrin të përhumbar*’ të Prometeut, dhe as *syrin e gabuar* e as *sytë*. Strofa sërish është e mbushur me përemra pronorë, që vëjnë theksin te njeriu që qëndron i vetëm, pa ndihmën e zotërave. Strofa në shqip, sidomos ajo e Luarasit, duke qenë se ruan mjaft mirë formën, bartë shumë mirë emocionin, mllëfin e heroit. Shvarc në anën tjetër, me krijimin e rimës mes fjalëve *për ta dëgjuar* e *për ta ndihmuar*, krijon sërish një lidhje të pritshme, logjike.

Pasi tregon për dëshpërimin e përjetuar nga shpresat e kota që kishte varur tek ata, zotërat, sa ishte fëmijë, na bëhet i qartë largimi që bën folësi, Prometeu, nga zotërat. Autori i origjinalit në këto strofa, për të forcuar edhe më shumë bindjen e Prometeu-t se nuk ishin zotërat ato që e ndihmuan Prometeun në rrugën e tij, përdorë një varg pyetjesh retorike të drejtuara edhe lexuesit e me të cilat na bëhet e qartë se nuk ishin zotërat ato që e kishin ndihmuar Prometeun kundër ‘*Mllëfit të titanëve*’, apo *skllavëria*:

Këto strofa në origjinal janë kështu:

*Wer half mir  
Wider der Titanen Übermut?  
Wer rettete vom Tode mich,  
Von Sklaverei?  
Hast du nicht alles selbst vollendet,  
Heilig glühend Herz?  
Und glühdest jung und gut,  
Betrogen, Rettungsdank  
Dem Schlafenden da droben?*

*Ich dich ehren? Wofür?  
Hast du die Schmerzen gelindert  
Je des Beladenen?  
Hast du die Tränen gestillet  
Je des Geängsteten?  
Hat nicht mich zum Manne geschmiedet—  
Die allmächtige Zeit*

*Und das ewige Schicksal,  
Meine Herr und deine?*

*Wäbntest du etwa,  
Ich sollte das Leben hassen,  
In Wüsten fliehen,  
Weil nicht alle  
Blütenträume reifen?*

Në shqipërimin e Skënder Luarasi ato marrin këtë formë:

*Kush më ndihmoi  
Kundër titanëve mizorë?  
Kush më shpëtoi prej vdekjes mua,  
Prej skllavërisë?  
A nuk i bëre të gjitha vetë  
Ti, zemra ime e zjarhtë?  
Dhe prap, e rrejtur, digjeshe  
Me ndjenja miturie e mirënjohjeje  
Për atë që fle në qiell?  
Unë ty të të nderoj? Përse?  
Mos i ke zbutur ndonjëherë dhimbjet  
E të brengosurvet?  
Mos u ke tharë ndonjë herë lotët  
Të pikëlluarve?  
A nuk më bëri burrë  
Koha e tërëfuqishme  
Dhe fati i amëshuar  
Zotrit e mi edhe të tutë?  
Apo mos pandebe  
Që do ta urreja jetën  
Dhe t'arratisesha në shkretëtirë  
Se nuk m'u poqën  
Gjithë ëndërrat e lulëzuara?*

Ndërsa te Shvarci duken kështu:

*Kush më ndihmoi mua*

*bazdisjes së titanëve t'i bëj ballë?  
Kush më shpëtoi mua  
nga vdekja e nga skllavëria?  
A s'ishe ti, viganja, e zjarrta zemra ime,  
që kurdoherë i dole vetes zot  
dhe, ashtu e re, e qashtë, e mashtruar,  
mirënjohjen ia blatove  
atij që flinte atje lart?*

*Unë të të nderoj?! Përse, vallë?  
mos ia lehtësove, qoftë një herë,  
barrën të ngarkuarve?  
Mos ia shterove, qoftë edhe një herë,  
Lotët të dëshpëruarve?  
A s'më farkëtuan e më bënë burra  
mbi kudhrën e tyre  
koba e gjithëpushtetshme  
dhe fati i pamort-  
zotërit e mi, por edhe të tutë?  
Mos prisje ti, vallë,  
që unë ta urreja jetën  
e të mërgohesha shkretëtirave,  
pse nuk lëshuan bulëza  
të gjitha ëndrrat e mia të bardha?*

Luarasi fjalën “Blütenträume” e përkthen me “ëndërrat e lulëzuara”, besoj edhe për shkak të fjalës “blüten”, pra lulet, ndërsa Shvarci zgjedh ëndrrat e bardha. Megjithëse ne asnjë nga fjalorët e konsultuar nuk gjendet si fjale e veçante, kur në gjermanisht fjala blüte- është pjese e kompozitave, ajo ka kuptimin e diçkaje të re, në lulëzim, siç mund të jenë ëndrrat e fëmijërisë apo rinisë. Këtë e shohim qartë edhe te vargu në origjinal:

*Weil nicht alle  
Blütenträume reiften?*

Që besoj se do të mund të përkthehej:

*Se nuk u poqën*

*Gjithë ëndrrat e rinisë?*

Në gjithë poezinë, por posaqërisht në strofat e cituara mësipër vërejmë pra një mbisundim të pyetjeve retorike, besa edhe provokative dhe të fjalive urdhërore. Edhe kjo mund të shihet si karakteristike për *Sturm und Drang*-un dhe vënien në pyetje të gjithë rregullave. Pastaj, siç u tha, vërehet edhe përdorimi i shpeshtë i përemrit unë, që është poashtu për shkak të ndjenjës së subjektivitetit të autorët e kësaj periudhe. Edhe qëndrimi i Prometeut, i zotëruar nga subjektiviteti, kërkesa për autonomi dhe një rebelim kundër Zeusit, mund të shihet si një refuzim i autoritetit. Nëse e shohim këtë në kontekstin historik, Zeusi lehtë mund të shihet si pasqyrim i autoritetit të sistemit absolut.

Gjithë vrulli që shfaq Prometeu në shpërfilljen e perëndive apo edhe në dëshirën për tu krahasuar me ta shkon duke u përshkallëzuar, derisa e gjitha arrinë kulminacionin në strofën e fundit, kur Prometeu fiton fuqinë e krijimit të njerëzve sipas shëmbëlltyrës së vet:

*Hier sitz ich, forme Menschen  
Nach meinem Bilde,  
Ein Geschlecht, das mir gleich sei,  
Zu leiden, zu weinen,  
Zu genießen und zu freuen sich,  
Und dein nicht zu achten,  
Wie ich!*

Luarasi:

*Këtu rri e krijoj njerëz  
Pas fytyrës sime,  
Një fis që më nget mua:  
Të vuaj e të qajë,  
Të dëfrejë e të gëzohet  
Dhe ty të të urrejë  
Si unë!*

Shvarci:

*Këtu po rri e po krijoj njerëz  
sipas shëmbëlltyrës sime,  
pinjoj, që të më ngjasojnë:  
të vuajnë e të qajnë,*

*të shijojnë e të ngazëlleben -  
dhe ty mos të t'përfillin,  
ashtu si unë!*

Prometeu *formoi njeriun sipas imazhit, shëmbëlltyrës tij*<sup>3</sup>, është përmbajtja e vargut të 52-të të strofës së 7. Kjo do të thotë se njeriu i vërtetë është poaq krijues, poaq i pavarur dhe kritik ndaj të gjithë atyre që duan të mbajnë atë të varur. Dhe, pikërisht këtu bëhet hapi më i rëndësishëm drejt një vetëdije të re, vetë njeriu – i përfaqësuar nga figura mitologjike e Prometeut - merr cilësi krijuese dhe refuzon të gjitha rregullat ekzistuese. Këtu paraqitet një element qendror i *Sturm und Drang*-ut: Forca krijuese që vetvetiu arrinë të përmbush gjithçka. Në këtë himn, kjo manifestohet në Prometeun: ai nuk u bë burrë me mbështetjen e perëndive, por me forcën e tij.

Te shqipërimi i Luarasis, vargu i origjinalit gjermanisht "*Nach meinem Bilde,*" është përkthyer me *Pas fytyrës sime*, sepse me *Bild*, ndonjëherë mund të nënkuptojmë fytyrën, por gjithsesi edhe atëherë është fjala për pamjen, prandaj besoj se më i qëlluar është përkthimi i Shvarcit "*sipas shëmbëlltyrës sime,*" që i bën këtij vargu.

Me "**Si unë**" - një varg të shkurtër e të fuqishëm, Goethe përfundon këtë poezi, dhe sigurisht jo pa qëllim me përemrin vector *UNË*. Fuqia e këtij vargu, konsideroj të jetë edhe në shkurtësinë e tij, atë të një urdhri të prerë, prandaj mendoj se te shqipërimi i Shvarcit, me shtimin e fjalës *ashtu* në këtë varg, ai veçse ia zbeh qëllimin që arrihet shumë më mirë te Luarasi me: *Si unë!*

Kjo përmbajtje, pra është tipike për periudhën e *Sturm und Drang*-ut që kishte konceptin e 'Originalgenie' (gjeniut origjinal): njeriu genial, shpirti krijues, shkatërron të gjitha pengesat e kufizimet duke u bërë kështu më i fortë nga të rënat që i përgatitë fati, dhe ç'është më e rëndësishmja, nuk iu shmanget atyre. *Poezia mishëron një shembull të konceptit të gjeniut dhe kështu në mënyrë eksplicite paraqet qëndrimin e pakompromis të letërsisë së asaj kohe*<sup>3</sup>.

Pra, në poezinë "Prometeu" të J.V. Goethe, manifestohen elementet karakteristike të *Sturm und Drang*-ut. Edhe për sa i përket përmbajtjes, siç u tha mësipër, jo vetëm me figurën e Prometeut dhe qëndrimin të tij rebel ndaj perëndive, por edhe për sa i përket formës. Kjo shfaqet në ndërtimin e hapur të poezisë, e cila nuk ka as skemë uniforme të rimës dhe as strukturë uniforme të gjatësisë së strofave, formë kjo që e kanë ruajtur edhe autorët e shqipërimeve.

---

<sup>3</sup> Krahaso: Wellbery, David: *The Specular Moment, Goethe's Early Lyric and the Beginnings of Romanticism*, Stanford, 1996, fq. 290.





**Naim KRYEZIU**

## **ROLI KULTUROR E LETRAR I PËRKTHIMIT, SI EDHE DISA VEÇORI TË MJESHTËRISË SË PËRKTHIMIT TË PROZËS E TË POEZISË**

Ndryshe nga piktori, skulptori e kompozitori në artet figurative e në muzikë, shkrimtari e shpreh botën e vet të brendshme dhe perceptimin e vet të realitetit me anë mjetesh që nuk i njeh çdo individ e çdo popull. Këto janë mjete të caktuara të gjuhës, janë mjete të asaj gjuhe ku shkrimtari harton veprën e vet letrare. Përveç kësaj, ndërsa veprat dhe kryeveprat e muzikës, të pikturës e të skulpturës nuk kanë kufij gjuhësorë, por edhe në fushën e filmit ka raste kur gjuha nuk është ndonjë pengesë e madhe, shkrimtari, poeti ose dramaturgu duhet të jenë të vetëdijshëm lidhur me pengesat e me kufizimet që paraqesin natyra, lënda dhe karakteristikat e veprës së tyre për t'u përhapur e për të qarkulluar në një hapësirë më të gjerë lexuesish. Me fjalë të tjera, vepra letrare e çdo gjinie qoftë, është e detyruar të marrë vizën për të udhëtuar në botën e jashtme.

Pikërisht në këtë rast ka dalë në shesh gjatë shekujve roli tejet i rëndësishëm i përkthimit. Ky rol i përkthimit është rritur krahas zhvillimit të shoqërisë dhe të kulturës njerëzore. Në të njëjtën kohë, përkthimi është jo vetëm bashkudhëtar, por edhe interpretuesi më kompetent i letërsisë e i veprës letrare në shoqëri. Me qindra e me mijëra romane, tregime, poezi e drama kanë vizituar vende të ndryshme të huaja, duke u bërë zakonisht edhe pjesëtare të kulturës së atyre vendeve falë artit të përkthimit. Nëse vepra letrare është përkthyer me mjeshtri e me frymëzim, atëherë ajo ka ndihmuar edhe në begatimin e thesarit të përbashkët kulturor të shoqërisë njerëzore.

Në saje të përkthyesve e të përkthimit ka lindur edhe vetë nocioni i letërsisë botërore. Vetëm falë një përkthimi të mirëfilltë e me vlerë, një kryevepër e një artisti të madh të fjalës bëhet me të vërtetë vepër e letërsisë së përbotshme dhe kalon ngadhënjimtarisht kufijtë e vendeve e të shekujve, qarkullon në hapësirë e në kohë dhe ndikon sidomos në rrafshin e jetës shoqërore, kulturore, estetike, artistike dhe etike të njerëzimit. Së këndejmi rrjedh edhe interesi i të gjithë popujve për të nxitur e për të mbështetur zhvillimin e përkthimit dhe për të pasur, në saje të tij, jo vetëm një traditë

më të begatë letrare, por edhe horizonte më të gjera letrare dhe artistike. Përkthime të mirëfillta të kryeveprave e të veprave të rëndësishme të letërsive të huaja hasen tek të gjithë popujt e kulturuar e të qytetëruar në themelet e letërsisë së tyre kombëtare.

Roli i përkthimit nuk ka të bëjë vetëm me faktin se nëpërmjet mjeshtrisë së përkthyesit sigurohet një numër shumë më i madh lexuesish, përkundrazi, ky rol është shumë më i rëndësishëm për faktin se një vepër letrare bëhet pjesë përbërëse e një mjedisi të ri letrar vetëm me anë të përkthimit, çka mund të ushtrojë edhe ndikim të dobishëm e frytdhënës. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se në njëfarë mënyre vepra letrare dhe letërsia janë “mallra” që e ndryshojnë pamjen dhe cilësinë e tyre në çastin kur kalojnë kufirin gjuhësor, megjithëse këmbimet letrare janë më të dobishme e më frytdhënëse kur nuk ngjajnë fare me këmbimet tregtare. Një përkthim i bukur, adekuat e i mirëfilltë, i cili siguron ekzistencën e vet dhe pranohet nga kultura e nga lexuesit e saj, e pasuron thuajse përherë traditën e përgjithshme letrare dhe artistike, sepse u jep mundësi lexuesve të gjejnë, të përcaktojnë e të njohin aspektet e panjohura të origjinalit, duke krijuar kësaj edhe mundësinë e ndikimit në kulturën e në letërsinë e vendit përkatës. Ka edhe raste kur një kryevepër ose një vepër letrare e përkthyer pritet aq mirë nga lexuesit e një kulture e të një letërsie tjetër, saqë bëhet shtysë edhe për zhvillimin e kulturës e të letërsisë në fjalë.

Në historinë e kulturës, të letërsisë e të qytetërimit, përkthimi ka luajtur një rol të pashoq. Mjafton të përmendim këtu përkthimin e veprës biografike “*Jetë paralele*” të Plutarkut, që është pritur me admirim nga të gjitha qendrat kulturore evropiane të kohës. Përkthimi i kësaj vepre është lexuar me shumë ëndje nga Korneji e nga Shekspiri. Një shembull tjetër është edhe përkthimi i Dhjatës së Vjetër e i Dhjatës së Re në gjermanisht nga Martin Luteri, përkthim që u bë bazë për zhvillimin e gjuhës bashkëkohore gjermane. Me këtë rast duhet përmendur edhe përkthimi i Biblës nga komisioni i peshkopëve e i teologëve anglezë, i kryesuar nga Lansleti. Sipas historianëve të kulturës angleze, ky përkthim ka ndikuar së tepërmi në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës e të gjuhës angleze. Edhe në fushën e letërsisë shqipe mund të përmendim përshtatjen që ka bërë Buzuku në veprën e vet “*Meshari*”, si edhe përkthimin e Dhjatës së Vjetër e të Dhjatës së Re nga Kristoforidhi. Këta kanë luajtur që të dy një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare. Pothuajse në çdo vend ka shkrimtarë e përkthyes që kanë zënë një vend të shquar në letërsinë e tyre vetëm në saje të përkthimit, si për shembull Amioi në Francë, Shlegeli në Gjermani, Noli në Shqipëri, etj.

Sigurisht që në ditët e sotme është mjaft i dukshëm roli i përkthyesve. Sikurse vënë në dukje teoricienët e fushës së përkthimit, sot njeriu nuk ka mundësi t'i përvetësojë të gjitha gjuhët e letërsive të mëdha evropiane, sepse do t'i duhej të mësonte afro dhjetë gjuhë. Edhe specialistët e gjuhësisë e të letërsisë krahasuese dinë

zakonisht dy ose tri gjuhë, prandaj, si specialistët ashtu edhe lexuesit komunikojnë me veprat letrare të Evropës e të botës kryesisht nëpërmjet përkthimeve. Sipas specialistëve të kësaj fushe, sot, përballë konkurrentëve të tillë, siç janë radioja, televizioni dhe interneti, përkthimi i letërsisë është ngulitur në mendjen e shumicës së lexuesve si mundësia më e mirë për të siguruar një kulturë të gjerë e të thellë.

Megjithëse puna e përkthyesit nuk bie në sy dhe nuk bëhet objekt i analizave, vetë përkthyesi ndodhet nganjëherë përballë vështirësish mjaft të mëdha kur merret me përkthimin e ndonjë vepre të një letërsie me traditë shumë të pasur letrare, estetike, kulturore e filozofike. Në raste të tilla, përkthyesi detyrohet të krijojë fjalë, nocione, shprehje e ndërtime të reja gjuhësore. Përballë një sfide të tillë, zakonisht përkthyesi i aftë arrin t'i zgjidhë problemet dhe të japë një përkthim të suksesshëm. Në këtë mënyrë, ai e begaton gjuhën kombëtare, letërsinë dhe kulturën e vendit të vet. Pothuaj të gjithë ne, në moshën kur dinim vetëm gjuhën tonë amtare dhe s'ishim në gjendje të lexonim vepra në gjuhë të huaja, kemi pasur mundësinë të lexojmë në shqip vepra e kryevepra të letërsisë së huaj vetëm falë përkthyesve. Ndër këto vepra mund të përmendim "*Robinson Kruzonë*" e Defosë, "*Hamletin*" e Shekspirit, "*Rubairat*" e Kajamit, "*Zemrën*" e De Amicit, "*Tom Sojerin*" e Tuenit, "*Çajllid Haroldin*" e Bajronit, "*Sonetet*" e Petrarkës, "*Komedinë hyjnore*" të Dantes, "*Don Kishotin*" e Servantesit, "*Don Zhuanin*" e Molierit, etj.

Për tërë këto arsye mund të thuhet se përkthimi është mirëfilli një bartje ose transmetim i frymëzuar i një vepre letraro-artistike në një gjuhë tjetër. Prandaj, të përkthesh ashtu siç duhet e me sukses të plotë një vepër letrare do të thotë të shkruash përsëri me frymëzim një vepër në saje të shtysave që merren nga autori i origjinalit. Natyrisht, kalimi i një vepre të një shkrimtari në një letërsi tjetër nuk është kurrsesi ndonjë punë aq e thjeshtë dhe e lehtë. Nga ana tjetër, përkthimi s'mund të trajtohet vetëm si një kopje e origjinalit, për arsye se Shekspiri i përkthyer është në njëfarë mënyre një Shekspir i ri, Servantesi i përkthyer është po ashtu një Servantes i ri që na flet shqip, Dantja i përkthyer është njëherazi një Dante shqiptar, po njësoj edhe Gëtja i përkthyer është pjesë përbërëse e letërsisë shqipe. Në fund mund të themi se përkthimet i hapin çdo letërsie portat e kulturës e të qytetërimit botëror.

Dihet që një numër i madh lexuesish njihen me letërsinë e huaj dhe sidomos me kryeveprat e saj vetëm nëpërmjet përkthimeve. Zanafillat e mjaft letërsive kombëtare janë veprat e përkthyerat ose të përshtatura. Kështu, edhe zanafillat e letërsisë sonë janë të lidhura me përshtatje veprash të huaja. Një numër jo i vogël përkthyesish, me veprimtarinë e tyre në fushën e kulturës, kanë zënë një vend të denjë në historinë e letërsisë kombëtare. Në letërsinë shqipe kanë luajtur një rol të tillë Noli, Zavalani, Caci, Kuteli, Kokona, etj. Ata kanë dhënë një ndihmesë të madhe edhe në formimin e

në zhvillimin e gjuhës letrare. Duke u ballafaquar me idetë, me dukuritë e me problemet që shpeshherë s’kishin të bënin me problemet e mjedisit ku jetonin, duke u ballafaquar me kulturën e me gjuhën e huaj, duke kërkuar me vëmendje e me përkushtim fjalë e shprehje të reja, duke e përshtatur gjuhën e nisjes me gjuhën e mbërritjes, zakonisht përkthyesit u kanë bërë ballë sfidave të shpeshta dhe kanë arritur që, me forcën e dijes e të fjalës së tyre, të shqipërojnë bukur dhe të shndërrohen kësisoj në virtuozë të gjuhës kombëtare.

Siç dihet, arti i përkthimit nuk është më i ri se arti i krijimtarisë origjinale, por ndërkaq roli i mjeshtërisë së përkthimit ka qenë i njohur qysh në antikitet. Tani, kur fushat e kulturës sa vijnë e po zgjerohen, edhe përkthimi po merr një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Veprat dhe kryeveprat e përkthyer, me gjithë reagimet, vërejtjet dhe kritikata e herëpashershme, po e zgjerojnë horizontin kulturor të njerëzve, duke u dhënë mundësi të pasurojnë edhe shijen e tyre artistike.

Ndërkaq, ai që ka përkthyer vepra letrare është i vetëdijshëm se me çfarë vështirësish, sfidash e problemesh ballafaqohet përkthyesi në veprimtarinë e vet. Dihet se gjëja themelore që kërkohet nga përkthyesi është që përkthimi i tij të jetë besnik ndaj origjinalit. Në më të shumtën e rasteve, përkthyesit dhe kritikët e përkthimit nuk kanë mendime të njëjta lidhur me fjalën “besnikëri”, por zakonisht mendohet se, kur përmbushet një kërkesë e tillë, kur janë përcjellë përmbajtja, forma dhe stili i origjinalit, atëherë një vepër në prozë mund të quhet si përkthim i pranueshëm e normal. Megjithatë, në mjaft raste shtegu ku kalon përkthyesi për t’ia dalë mbanë me sukses misionit të vet, është i mbushur me pengesa, sepse nuk është shkelur asnjëherë dhe mund të jetë plot me peripeci. Gjatë veprimtarisë së tij, përkthyesi është i vetmuar, ndërsa fjalori dhe gramatika nuk i mjaftojnë në “eksplorimin” që bën, prandaj është i detyruar të mbështetet vetëm në përvojën, në fantazinë, në zgjuarsinë, në bagazhin kulturor e në talentin e tij.

Megjithëse ndonjëherë përmenden rregullat ose parimet e përkthimit, përkthyesi i veprës letrare nuk mbështetet në asnjë parim të shkruar, ai është i vetëdijshëm se rregullat e shkruara nuk mund ta ndihmojnë në çdo rast për të hyrë në botën e në thelbin e veprës që përkthen. Me fjalë të tjera, përkthimi është një veprimtari e pavarur, dhe suksesi i përkthyesit gjatë përzgjedhjes së fjalëve e të frazave nuk varet vetëm nga njohja e gramatikës dhe e leksikut, por, para së gjithash, edhe nga aftësia ose zotësia e tij për t’i parashikuar synimet e autorit të origjinalit, nga aftësia e tij për t’iu përshtatur frymës së veprës letrare, dhe nga dija e nga mjeshtëria e tij për ta bartur veprën e huaj letrare në gjuhën përkatëse. Kësisoj, përkthyesi ka për detyrë të hyjë në thellësi të botës shpirtërore të autorit e të veprës së tij, në mënyrë që t’ia dalë mbanë për të gjetur fjalët e sakta, fjalët e përshtatshme gjatë procesit të përkthimit.

Kështu, përveç njohjes së profesionit, të cilin e pasuron pareshtur me përvojën

e vet, përkthyesi duhet të ketë edhe pririje, shkathtësi e aftësi të tjera. Në radhë të parë, duhet të jetë i ndjeshëm, të ketë intuitë të mprehtë, të ketë fantazi të pasur, të jetë mendjehollë dhe të ketë kulturë gjuhësore e letrare. Mirëpo përkthyesi që nuk ka pririje të njëjtësohet, që s'është në gjendje ta përjetojë përmbajtjen e origjinalit, zor se mund të jetë i aftë t'i sjellë në gjuhën e re formën dhe stilin e veprës që përkthen. Si pasojë, përkthyesi letrar duhet të ketë pririje e përvojë të veçantë të përkthimit, të jetë jo vetëm njohës i gjuhës e i letërsisë së origjinalit, por edhe i traditës së vet. Është e ditur se temat, motivet, idetë, fabulat, personazhet dhe vlerat artistike të çdo vepre letrare, megjithëse mund të kenë karakter mbarënjëzësor, pothuajse përherë janë të kushtëzuara nga koha, nga hapësira e nga gjuha. Prandaj përkthyesit do t'i duhet të përkthejë jo vetëm fabulën, formën dhe idetë e veprës, por shpeshherë është i detyruar të rikrijojë edhe atmosferën e epokës e të vendit të veprës origjinale.

Ndërkaq, kur përkthen poezi, përkthyesi ballafaqohet me një numër edhe më të madh sfidash e peripecish, për arsye se, sikurse shprehet lidhur me këtë Zhukovski, një specialist rus i kësaj fushe, "përkthyesi i prozës është rob, kurse përkthyesi i poezisë është rival". Sado paradoksal të tingëllojë ky pohim, këtu ka edhe një të vërtetë. Është më se e qartë dhe dihet përgjithësisht se të përkthesh mirë një poezi do të thotë të krijosh një poezi të re. Përkthimi i poezisë në tërësi duhet të jetë besnik ndaj përmbajtjes dhe të ketë pak a shumë një formë të njëjtë si origjinali. Përveç kësaj, në përkthimin e poezisë duhet të spikatë edhe një cilësi e veçantë - zëri i përkthyesit. Përkthyesi dhe eseisti i njohur rus Brusov ka dhënë këtë mendim lidhur me përkthimin e poezisë: "Është e pamundur të përcjellësh një poezi nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, por njëherazi është po aq e pamundur të heqësh dorë nga një ëndërr e tillë." I pyetur për këtë çështje, poeti i njohur amerikan Frosti është përgjigjur: "Poezia është ajo që pëson humbjen më të madhe në përkthim."

Dihet se përkthyesi i poezisë do të hasë në më shumë vështirësi sesa përkthyesi i prozës, sepse ai do të ketë punë me formën, me stilin, me numrin e vargjeve, me vargëzimin, me eufoninë, me ritmin e me rimat, me figurat e me simbolet, me lojën e fjalëve e të tingujve, etj. Ndërsa përkthyesi i prozës mund t'i përmbahet më lehtë tekstit të origjinalit dhe t'i rikrijojë në njëfarë mënyre veçoritë kryesore të veprës së origjinalit në gjuhën e përkthimit, përkthyesi i poezisë nuk ka mundësi që brenda një kohe të caktuar t'i përkthejë të gjitha elementet ose veçoritë e gjuhës së origjinalit, sepse forma e poezisë është më e ndërlikuar, kurse shtresat dhe pjesët përbërëse të saj janë një sfidë e veçantë gjatë procesit të përkthimit. Megjithatë, përkthyesi i poezisë synon, para së gjithash, që poezia e përkthyer prej tij të lërë përshtypjen se tingëllon si origjinali, dhe shpreson njëherazi që përkthimi i tij të jetë adekuat me sistemin e vlerave estetike të origjinalit.

Një poezi quhet se është përkthyer në mënyrë adekuate atëherë kur përkthyesi ka pasur fat e sukses për të përcjellë si përmbajtjen ashtu edhe formën e origjinalit, duke i riprodhuar në gjuhën e vet ashtu siç duhet veçoritë kryesore të origjinalit. Prandaj përkthyesi i poezisë është i shtrënguar shpeshherë të përdorë fjalë, ndërtime, togfjalësja, neologjizma, ndonjëherë edhe elemente gjuhësore që i shkelin normat gramatikore, vetëm e vetëm për të krijuar një poezi të ngjashme me poezinë në origjinal. Përkthimi estetikisht adekuat dhe i suksesshëm siguron një ekuilibër të caktuar ndërmjet tërësisë dhe pjesëve përbërëse, ndërmjet karakterit të përgjithshëm të poezisë dhe nivelit të afrisë me origjinalin.

Në të vërtetë, është diçka e pamundur që gjatë përkthimit të një poezie të riprodhohen saktësisht e besnikërisht të gjitha elementet e saj. Përkthyesi i poezisë ia del mbanë shpeshherë të përkthejë në gjuhën e tij vetëm ato elemente ose shtresa poetike që i kupton e mund t'i rikrijojë, por duke ndryshuar, sakrifikuar dhe lënë mangët elemente të tjera. Ndërkaq, nëse përkthyesi ka prirje poetike ose shkruan edhe vetë poezi, përkthimi i tij mund të dalë më adekuat e më besnik. Gjatë përkthimit të vargjeve, poetin e tërheq dhe e nxit misioni i tij artistik për të rikrijuar në gjuhën e vet atë vepër që ka entuziazmuar e magjepsur të tjerët në gjuhën e origjinalit. Megjithëse në këtë rast përkthyesi paraqitet si rival i autorit të poezisë së origjinalit, ka mjaft dallime midis autorit të poezisë së origjinalit dhe përkthyesit të poezisë së tij. Përderisa autori i poezisë së origjinalit i ka zgjedhur qysh prej kohësh idetë, ndjenjat, përfytyrimet, imazhet, figurat, formën, vargjet, rimat, ritmin, intonacionin dhe mesazhin e poezisë sipas shijes dhe dëshirës së tij, përkthyesi i kësaj poezie ka të drejtë vetëm t'i përmbahet tekstit poetik të krijuar nga autori i origjinalit. Për këtë arsye, përkthyesit të poezisë i duhet të shfrytëzojë të gjitha mundësitë dhe potencialin e letërsisë e të gjuhës së vet dhe, nëse i ndih fati, të rikrijojë, me talentin që ka, një vepër artistike adekuate.

Një përkthyes i sprovuar i poezisë përkujdeset, para së gjithash, të gjejë se cilat janë elementet më kryesore të një poezie që do të përkthejë, sepse kështu do të arrijë të përkthejë edhe elementet e tjera, qofshin ato figura, rima, asonanca ose aliteracione, në mënyrë që në rikrijimin e tij poetik të ketë elemente të njëjta, të ngjashme, të përafërta ose edhe të barasvlershme me poezinë e origjinalit. Përkthyesi i poezisë do të ketë medoemos mjaft dilema në rikrijimin e strukturës semantike të poezisë. Por dilemat e tij do të kenë të bëjnë si me ato elemente të origjinalit që duhet t'i sakrifikojë, ashtu edhe me ato vlera poetike që duhet t'i rikrijojë në sistemin gramatikor, stilistikor e poetik të gjuhës së përkthimit. Në më të shumtën e rasteve, përkthyesi i poezisë e kupton se midis poezisë së origjinalit dhe poezisë së rikrijuar nuk ka vetëm mospajtim leksikor, sepse shpeshherë mungon edhe përputhja e metrit, e rimave dhe e tonit. Masën e vërtetë mund ta gjejë ai përkthyes që ka talent poetik ose që i njeh shumë

mirë si poezinë ashtu edhe artin e poezisë. Nëse ai është edhe vetë poet, prapë ka dy mundësi: ose të rikrijojë një poezi me normat, me parimet ose kanunet dhe me format e poezisë së origjinalit, ose të krijojë një poezi të re, e cila duket gati-gati si poezi origjinale. Meqë përkthimi i poezisë është një lloj arti kompleks, shumë përkthyes që nuk kanë talent në këtë fushë i shmangen përkthimit të poezisë.

Sidoqoftë, edhe përkthyesit e rëndomtë që nuk janë poetë, kanë të drejtë të përkthejnë poezi nëse u pëlqen poezia dhe janë lexues e njohës të mirëfilltë të saj. Këtij lloj përkthyesi të poezisë nuk i mjafton vetëm njohja shumë e mirë e të dy gjuhëve, ai duhet të njohë thellë edhe veçoritë kryesore të gjinisë së poezisë, të poetikës, të traditës letrare të origjinalit, të teorisë së letërsisë dhe të stilistikës. Përkthimi filologjik i një poezie ose i një cikli poezish kërkon nga filologu jo vetëm erudicion, por edhe njohjen e kontekstit e të traditës letrare nga e cila ai e përkthen poezinë. Mirëpo përkthimi poetik që është vetëm një version i interpretuar i origjinalit nuk mund të mbetet përkthim unik i poezisë origjinale, sepse në një gjuhë të huaj mund të ekzistojnë disa versione dhe interpretime të suksesshme të një poezie origjinale. Puna është se filologët, ndonëse kanë kulturë gjuhësore, duke u orvatur ta përkthejnë në mënyrë sa më besnike poezinë, rrallëherë kanë sukses në përkthimin e formës dhe të stilit të saj.

Ka raste kur përkthyesi beson se, duke përkthyer vetëm kuptimin e një poezie, ia ka dalë mbanë detyrës së tij. Mirëpo në këtë mënyrë jo vetëm që nuk është përkthyer origjinali, por në aspektin e poezisë përkthimi ka humbur shumë më tepër nga ç'ka fituar, sepse përkthyesi nuk ka patur parasysh edhe elemente të tjera të poezisë, elemente që kanë rëndësi për poezinë, siç janë, për shembull, eufonia, figurat, simbolet, etj., dhe, në vend që të marrë një liri të justifikueshme gjatë përkthimit, mundohet t'i mbetet besnik në mënyrë të verbër tekstit të origjinalit, duke shpresuar së në këtë mënyrë do t'u shmanget vështirësive që i dalin gjatë procesit të përkthimit. Në vend që të bëjë zhvendosje, zëvendësime, shndërrime dhe këmbime të anasjella të figurave ose të leksikut, përkthyesi i poezisë përpiqet nganjëherë të rikrijojë patjetër leksikun dhe domethënien e fjalëve, por në këtë rast harron se poezia nuk përbëhet vetëm prej fjalëve të thjeshta, harron se ajo ka edhe një strukturë emocionale, e cila duhet të riprodhohet në mënyrë dhe formë poetike.

Përveç kësaj, përkthyesi i afrohet poezisë së autorit të origjinalit si me ndjenjat emocionale poetike, ashtu edhe me gjykimin e vet kritik. Këto elemente kanë të njëjtën rëndësi, sepse mungesa e çdonjërit prej tyre do ta linte përkthimin pa veçori poetike dhe artistike. Sikurse dihet, bota poetike e autorit është më e gjerë dhe më e pasur sesa bota poetike e përkthyesit. Prandaj përkthyesi i poezisë duhet të bëjë çmos që të kuptojë temën, motivin dhe frymëzimin e autorit të origjinalit. Bash për këtë arsye,

poezia që ai synon të përkthejë do t'i japë mundësi të krijojë një botë të ngjashme me botën e autorit të poezisë nëpërmjet imagjinatës dhe talentit të vet poetik.

Disa përkthyes kanë prirjen që shkon në një skajshmëri tjetër. Ata mendojnë se në veprën poetike që përkthejnë duhet të vënë vulën e personalitetit të tyre e jo të autorit të origjinalit. Zakonisht, një përkthyes-poet i tillë krijon poezi, por në të vërtetë kjo është një poezi ku origjinali luan vetëm rolin e burimit dhe bëhet pretekst për një frymëzim të pavarur. Në këtë mënyrë, origjinali shndërrohet në shtysë, kurse ajo që krijohet në poezinë e përkthyer nuk përfshin thelbin e poezisë origjinale. Prandaj duhet që përkthyesi të vendosë e të përkthejë atë poet që e ndien të afërt dhe e admiron. Nuk duhet harruar se përparësia artistike dhe poetike e veprës së përkthyer varet tërësisht nga përkthyesi, nga vullneti e nga dëshira e tij për të shfrytëzuar mundësitë që i ofron origjinali.

Një ndër dëshmitë më të sigurta se përkthimi i një poezie ka dalë me sukses, është kur atë poezi e pëlqen ai lexues që, edhe pse nuk e njeh origjinalin e saj, ka shije estetike. Zakonisht, një poezi e përkthyer mirë e bukur lë përshtypje të thellë te lexuesi. Kur e përkthen poezinë duke bërë të mundur që numri më i madh i elementeve, i formave, i figurave dhe i shprehjeve poetike të origjinalit të riprodhohen edhe në versionin e përkthyer, atëherë përkthyesi ka arritur të përcjellë si idenë e autorit, ashtu edhe imazhet dhe shprehjet figurative. Përveç kësaj, kur përkthyesit i vjen ndoresh të rikrijojë edhe realitetin, atmosferën dhe tonin e poezisë së origjinalit, atëherë një poezi e tillë e përkthyer do të pritët me ngrohtësi e me mirëkuptim nga lexuesi.

Sikurse dihet, ndër përkthyesit letrarë të vendeve të ndryshme ka të tillë që poezinë e përkthejnë në prozë. Ata që mbështesin këtë teori janë të mendimit se përkthimi i vargjeve me vargje ekuivalente kërkon përkushtim, angazhim dhe dije të jashtëzakonshme, prandaj, meqë duhet të sakrifikojnë shumë në tekstin që përkthejnë, ata parapëlqejnë të japin vetëm kuptimin, përmbajtjen dhe mesazhin e poezisë, duke e përkthyer fjalë për fjalë strukturën semantike të poezisë origjinale.



Dije DEMIRI-FRANGU

## MODELE TË LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË

*Letërsia për fëmijë është letërsi që u furnizua vazhdimisht nga letërsia popullore. Për këtë arsye ajo gjatë ishte letërsi me përmbajtje e trajta folklorike. Nga vitet 70-ta, fillon një rikonceptim i botës së fëmijëve.*

Modeli i parë i krijimit të letërsisë shqipe për fëmijë është letërsia popullore, e udhëhequr nga koncepti i etikës dhe psikologjisë tradicionale, duke mos integruar individin, si përfaqësues të të kundërtës. Edhe sot kjo letërsi vazhdon të ketë prirjen kryesore kah letërsia popullore. Kontributi i kësaj letërsie, vlera e saj, që në konkluzionin e parë del të jetë e reduktuar, meqë fokusi i saj është vetëm brenda një procesi, që mund të llogaritet si transformues i kodeve jetësore, të njohura, të ngulitura dhe të izoluara në kolektivitet. Një kuptim të ri, kjo letërsi do të bartë vetëm atëherë kur nis e merret edhe me rikonceptimin e fenomeneve dhe jetës së fëmijës, duke dhënë një shmangie nga letërsia e traditës dhe duke bërë esencë të veten, tendencën për një letërsi urbane, me kode të reja tematike, si do të shfaqen Deva, Kikaj, Huruglica, Blushi e më vonë Dedja e Demolli. Nga trajtat eskuzivisht popullore-përralla dhe format e tjera gojore, si modele- arketipe, të shfrytëzuara shumë, nisin e ngjajnë veprat me njëra tjetrën, deri në ngatërrim. Një kohë, deri tek vitet e 70-ta kjo letërsi ishte “adaptuar” me vijën e saj lineare dhe me vështirësi doli nga binarët e rëndomësisë, duke e ruajtur modelin tradicional të shkrimit, duke mos bërë më shumë se materializimin e idesë në formë të drejtëpërdrejtë, me pak mundësi të konotimit të fjalëve., duke e ruajtur , thujse qëllimshëm njëtrajtshmërinë e paraqitjes.

Në këtë mënyrë kjo letërsi si shenjë identifikuese, me decenia, ruajti ndikimin oral. Prania e kësaj letërsie brenda letërsisë së shkruar për fëmijë ishte e fuqishme, për të mos thënë tërësore. Asgjë e keqe, poqese kjo letërsi do të integronte mirë folklorin. Gjëra të tjera ndërlihen tek më pas, kur edhe shtohet fuqia e kësaj letërsie me autorë Ymer Shkrelin, Kikajn, Batallin, K.Blushit, A Demollit dhe posaçërisht poezia e Devës.

Forma të reja shkrimi, që në një masë përmbysin letërsinë eskuzivisht me bazë përrallën dhe me motive idaktike e mësimore, janë të këtyre pak emrave të

lartëpërmendur, sado që paraqiten në të gjitha zhanret, prinë poezia. Në dy tri romane të këtyre viteve, prej një personazhi me karakter të përcaktuar tradicional, fillojmë e hasim karaktere me veçori individuale, që janë parasegjithash produkt i rrethanave shoqërore.

Letërsia shqipe për fëmijë përmes këtyre autorëve, vërehet se ka provuar të promovohet si vlerë serioze disa herë, por për fatkeqësinë e saj, disa herë edhe ia janë ndryshuar rrethanat shoqërore dhe kjo serish është dashur të kthehet në binarte e realitetit, duke u marrë me moralin –edhe nacional, me heroizma dhe duke u tkurrur brenda një etike krijuese për t mos prekur shpesh estetikën. Kështu, një kontigjent i mirë i veprave është mjaft modest dhe se mesazhet e kësaj letërsie dalin të përaferta , pa ndonjë shumësi kuptimore, me mundësi te pakta receptive e pa veçanti e nuancime vetijake. Ky kontigjent veprash me format dhe motivet poetike, të uniformuara me me një specter të ngushtë ideshë e vlerash, me influencën e tyre të thjeshtë estetike, është mirë të largohen nga lekturat dhe librat shkollorë. Mundësinë e diferencimit të artit nga jeta e krijon vetëm ndërtimi i ndjenjës estetike, e jo krijimi përfytyrimit, miteve mbi dramet historike, e tjerë të ndërtuara mbi një sistem kuptimor të shkëputur- shih për këtë fëmijët e moshës së re kërkojnë vepra të autorëve për të rritur, ku gjuha poetike ka një përmasë tjetër, sepse letërsia nuk do të duhej të ishte një përshkrim e shpjegim, një imazh dhe vetëm një mesazh, por një ndërtim estetik ngjarjeve për krijimin dhe kultivimin e receptuesit.

Nëse përqendrohemi në evoluimin e kësaj letërsie, vërehet se ende -psikologjia e heroit të saj nuk ka bërë kapërcime, ai ka një psikologji tradicionale dhe kryesisht rurale, pak zhvillohen ambiciet e heroit, talentet e veçanta - po e zëmë. Ne nuk e marrim vesh çka lexon një hero i romanit, çfarë dhe sa gjuhë i flet, çfarë filma shikon, çfarë gjykimesh ka për fenomenet e rrethit të vet apo edhe më larg dhe tek e fundit çfarë shije ka për ushqim e veshje ose edhe si feston ai. Heronjtë nuk shfaqen me preferenca të veçanta për artet, sportin apo edhe estraden. Erotizmi si pjesë e psikologjisë së fëmijës mungon, mungon kureshtja për veten –trupin dhe zhvillimin e vet dhe te të tjerët, kureshtja për dallimet gjinore, opinionet për çështje në shkollë, familje, zakonet, kujtimet e tyre, idetë, ndryshimet në zhvillimin e tyre etj. Ata nuk i kanë të hapura ndjenjat që janë edhe normale për mosha të caktuara, si: egoizmi, smira, xhelozia, inati, urrejtja etj. Disa nga këto attribute më shumë në letërsinë për fëmijë çudëtërisht i hasim te personazhet e rritur, sepse heroit fëmijë është tërësisht i idealizuar, i izoluar dhe kështu del të jetë një fëmijë pa informacion e dije dhe pa ndonjë perspektivë.

Autorët pak merren me gjestet, mimikën, lëvizjet, shprehitë trupore, me vrapimin, qëndrimin dhe të fjeturit, nëpërmjet të cilave edhe do të mund të tipizonin

në mënyrë më të plotë personazhet e tyre. Gjuha e trupit (55 për qind e mesazheve përcillen përmes gjuhës së trupit) nuk lexohet nga krijuesit tanë, ndaj edhe nuk jepet në kuadër të personalitetit të heroit.

Në aspektin e socializmit, ata nuk i rrëfehen intimisht njëri-tjetrit, janë optimistë, por jo me ide të veçanta. Në anën tjetër është dëgjuar disa herë edhe nga kritika se është një teprim nga autorët në idealizimin e fëmijëve.

Ky diskurs shkrimi- e largon fëmijën nga leximi. Ata shohin vrasëse në kompjuter e tv, kurse lexojnë një letërsi sentimentale, idealiste e iluministe- kjo mund të krijojë konfuzion dhe refuzim nga kjo pjesë e letërsisë, tematikisht larg fantazisë e projeksioneve të tyre dhe larg realitetit jetësor të tyre.

Teoria receptive mbërthen krijuesin –veprën dhe marrësin, kjo treshe është njëshe, e derisa krijuesi të injorojë nivelin e marrësit, duke u sjellë brenda motiveve stinore e familjare, -brenda florës dhe faunës, pa arritur të krijojë dimensione të reja imagjinare, është rreziku i qëndrimit bashkë të këtyre hallkave në letërsinë tonë për fëmijë.



**Antonio BELLUSCI**

## **LETËRSIA POPULLORE NË ARBËRORET E GREQISË**

### **1. Kërkime etnografike në Elladhë**

Kërkimet etnografike në terren në katundet arbërorë-arvanitë në Elladhë filluan që në në korrik të vitit 1965<sup>1</sup> dhe vazhduan rregullisht për dizetë vjet, duke botuar çdo herë lëndjen e mbledhur katund përkatund e regjistruar me manjetofon, dhe duke përkthyer tekstet të folmëve arbërore dhe në italisht<sup>2</sup>. Artikuj, intervista dhe studime janë të botuara në revistat arbëreshe “*Shejzat*”<sup>3</sup>, “*Lidhja*”<sup>4</sup>, “*Zgjimi*”<sup>5</sup> dhe “*Katundi Ynë*”<sup>6</sup>. Duke vajtur në krahinat të Elladhës në Pelloponezë<sup>7</sup>, në Korinthi<sup>8</sup>, Eube<sup>9</sup>, në Atikë<sup>10</sup>, në Beoci<sup>11</sup>, në Korinthi<sup>12</sup>, në Lokridë<sup>13</sup>, në Argolidhë<sup>14</sup> kam vizituar personalisht 150

---

<sup>1</sup> A.Bellusci (1965), *Viaggio tra gli albanesi di Grecia/Udbëtom ndër shqiptaret e Greqisë*, Zgjimi, 4, 1965, ff.18-20.

<sup>2</sup> A.Bellusci (1967), *Rilievi sulle comunità albanesi di Grecia/Studime mbi komunitetet shqiptare e Greqisë*, Shejzat, 7, 1967, ff.334-350; ID.(1969), *Tra i fratelli albanesi della Morea/Midis vëllezërve të Moresë*, Vatra Jonë, 2, 1969, ff.4-7.

<sup>3</sup> *Shejzat/Le Pleiadi* (1957-1974), e themeluar në Roma nga prof. Ernest Koliqi.

<sup>4</sup> *Lidhja/L'Unione* (1980-2014), e themeluar në Cosenza nga A.Bellusci.

<sup>5</sup> *Zgjimi/Il risveglio* (1962-1983), e themeluar në Marri-S.Benedetto Ullano nga adv. Albino Greco.

<sup>6</sup> *Katundi Ynë/Il nostro paese* (1970-), e themeluar në Civita nga Demetrio Emmanuele.

<sup>7</sup> A.Bellusci (1965), *Viaggio tra gli albanesi di Grecia/Udbëtim në shqiptarët e Greqisë*, Zgjimi, 7, 1965, f.18-20.

<sup>8</sup> A.Bellusci (1970), *Pellegrinaggio a Milo con gli arvanites di Corinto*, Bollettino Ecclesiastico di Lungro, 8, 1970, f.44-72.

<sup>9</sup> A.Bellusci (1985), *Gli eredi di Skanderbeg nell'Eubea/Trashëgimtarët të Skënderbeut në Eube*, Lidhja, 12, 1985, ff.285-301.

<sup>10</sup> A.Bellusci (1989), *Intervistë me me burrat në Krora-Dervenohorja*, Lidhja, 21, 1989, ff.646-647; ID. (1992), *Ricerche e studi tra gli albanesi dell'Attica/Kërkime midis shqiptarëve në Atikë*, Lidhja, 27, 1992, ff.896-903; ID.(1984), *Schegge di vita arberora/Copëzja jetesës arbërore*, Lidhja, 11, 1984, ff.265-267.

<sup>11</sup> A.Bellusci (1990), *Gli albanesi d'Italia tra gli albanesi di Grecia/Shqiptarët e Italisë midis shqiptarëve të Greqisë*, Lidhja, 24, 1990, ff.770-773; ID.(1990), *Kërkime midis shqiptarëve të Greqisë*, Lidhja, 24,

katunde dhe më kanë kënduar kënga arbërore dhe treguar përralla, toponime, besime, fjala t'urta, gjëgjëza më shumë se 350 burra dhe gra. Emrat e katundëve arvanitë kanë ëmrin e ri, që qeveria i ndërroi, dhe ëmtin e vjetër që edhe sot katundaret thonë arbërisht. Qeveria thotë se arbëroret-arvanitë nuk ekzistojnë zyrtarisht në Greqi sepse nuk janë të njohur si pakicë historike të Kushtetutit. Historiani A.Kollia më më thoj çdo herë. "Ne arbërorë në Greqi jemi shumicë jo mpakicë. Historia na tregon mirë se ne arbërorë kemi kërkuar dhe themeluar shtetin grek<sup>15</sup>. Në revisten "Dialogo", Elefasina,<sup>16</sup> drejtori dhe themeluesi Jorgo Marougas ka botuar një "provë inventari të katundëve arvanitë-arbërorë", një katalog me 900 katunde arbërorë-arvanitë në Greqi me një popullsi me tri milionë arbërorë<sup>17</sup>. Në vitet e fundit kam shkruar edhe një herë në katundet arbërorë-arvanitë në Greqi. Dhe kam shënuar se canore u rralluan shumë në katundet, sepse kanë emigruar të gjithë në Athinë e në qytetet e mëdha. Ky fenomen ndodhet edhe te katundet tanë arbëreshë në Kalabri. Rinia s'ka punë në katund dhe shkon në qytetet e veriut.

## 2. Historia e arbërorëve në Greqi

Kam njohur historianin arbëror Kosta Biris<sup>18</sup> dhe kam bashkëpunuar me historianin Aristidhi Kolljas<sup>19</sup> si edhe disa shkrimtarë dhe etnologë shumë të shquar e të mbëdhenj si Jorgo Haxhisotiriou<sup>20</sup>, Vangjeli Ljapisi<sup>21</sup>, Gjona Paidousi<sup>22</sup>, Jani

1990, ff.774-777; ID.(1991), *Martesa dhe puna shtëpiake në Thesòe-Thiva*, Lidhja, 26, 1991, ff.880-882; ID.(1995), *Prralla, vajtime dhe kënga në Kseronomi Thivon*, Lidhja, 33, 1995, ff.1145-1151.

<sup>12</sup> A.Bellusci (1993), *Këngë dhe tregime në Angjellokastros Korinthias*, Lidhja, 30, 1993, ff.1046-1055.

<sup>13</sup> A.Bellusci (1996), *Zakone, besime, vajtime dhe këngë në Muzakë – Lokrida*, Lidhja, 35, 1996, ff.1217-1239, dhe në Lidhja, 36, 1996, ff.1245-1250.

<sup>14</sup> A.Bellusci (1981), *Deti e proverbi popolari a/Të thëna dhe sjalë t'urta popullore në Kranidibi-Argolide*, Lidhja, 2, 1981, ff.8-9; ID.(1983), *Canti popolari di/Këngë popullore nga Kranidibi-Argolide*, Lidhja, 8, 1983, ff.159-161.

<sup>15</sup> Γιωργου Χατζησωτηριου(1971), *To 1821 Οι μεσογειτες και ο Ιωαννης Νταβαρης*, Αθηνα 1971.

<sup>16</sup> Διαλογοι (1978–1984), e themeluar në Elefsina nga Jorgo Marougas. Numri i fundit nr.41/1984 është i kushtuar arbëreshëve dhe ka studime të shkruara me alfabetin e Monastirit.

<sup>17</sup> Γιωργος Μαρουγας (1979), *Αποπειρα αρβαντικης απογραφης – Νομος Ατικης*, Διαλογοι, 26, 1979, 32–33; Διαλογοι, 27, 1980, 19–21, *Νομος Βιωτιας*, Διαλογοι, 29, 1980, 13–16, *Πελοποννησος*–1. Shih edhe A.Bellusci, *Nga rrënjat arbëreshë në rrënjat mëmë arbërore*, Lidhja, 10, 1984, pp.205-217, ku është botuar katalogu i plotë i katundëve arbërorë në Elladhë me numrin e popullsisë.

<sup>18</sup> Κωστα Μβιρι (1960), *Αρβανιτες οι δοριεις του νεοτερου ελληνισμού – Ιστορια των Ελληνων Αρβανιτων*, Αθηνα 1960.

<sup>19</sup> Αριστειδη Κολλια (1999), *Αρβανιτες και η καταγογη των Ελληνων*, Αθηνα 1983; ID., *Η γλωσσα των Θεων*, Αθηνα 1999; ID.(2000), *Ο Antonio Bellusci και η μαγεια της λαιλης παραδοσης*, Αθηνα 2000.

<sup>20</sup> Γιωργου Χατζησωτηριου (1960), *Τα λαογραφικα της Μεσογαιας Ατικης*, Αθηνα 1980; ID.(1973), *Ιστοριας της Παιανιας (1205–1973)*, Αθηνα 1973.

Gjikas<sup>23</sup>, Jorgo Michas<sup>24</sup> dhe Jorgo Gerou<sup>25</sup> e Maria Mihail Dede<sup>26</sup>. Këta njerez arbërorë-arvanitë, me krenari të madhe dhe me dituri, kanë mbledhur material etnografik në të gjitha fushat dhe kanë botuar vepra, që mund të bëjnë pjesë në një Antologji Arbërore<sup>27</sup>. Këto vepra janë në gjuhën greqishte, si edhe disa tekste popullore arbërore-arvanite. Mbi origjinën dhe historinë e arbërorëve në Elladhë kemi botime madheshitore të Kosta Biris dhe të Aristidhiy Kollia, që kemi cituar, që na tregojnë lashtësinë të këtij populli vëlla shqiptar. Këtu shtojmë vetëm Ioani Kristou Poulou<sup>28</sup> dhe Shkelzen Raça<sup>29</sup>. Në këtë studim qëllimi ynë është që të njihet dhe të studiohet më thellë historia dhe letërsia e popullsisë arbërore në Greqi, sepse të gjithë ne jemi vëllezer shqiptarë dhe sepse rrënja jonë e thellë gjëndet ende sot në qytërimin të gadishullit ballkanik. Për ne arbëreshë është dhe qëndron themellor Kuvendi I Lezhes (1444), ku lindi ndërgjegja e kombit shqiptar, filluan luftat e Skenderbeut kunder pushtimit ottoman dhe filluan ngulimet e para në Itali dhe lindja e mitit të Skenderbeut të trashëguara në rapsoditë tona kombëtare<sup>30</sup>.

<sup>21</sup> Βαγγέλης Λιαπης (1985), *Αρβανιτικο μοιρολογι*, Αθηνά 1985; ΙΔ.(1998), *ΑρΒανιτικα ζακονια*, Αθηνά 1998. Shih dhe A..Bellusci (1986), *Te vatra arbërore lepsiniote-Internistë me V. Ljapës*, Lidhja,30, 1986, ff.401-403, dhe në Lidhja, 16, 1987, ff.443-447. Αρβανιτες

<sup>22</sup> Γιονα Μικε Παιδουση (19980), *Τα Βιλια του Κιθαιρωνα και τα αρβανιτικα τραγουδια τους*, Αθηνά 1980. Kjo grua, shumë e urtë dhe shumë guximtare, është e vetmja që botoj kënga arbërore me alfabetin e Monastirit dhe jo me alfabetin grek. Bukuria e kësaj mbledhje etnografie është shumë e madhe dhe me domethënie kombëtare. E kam njohur dhe kam letra shumë të bukura nga ajo.

<sup>23</sup> Γιανης Π.Γικας (1985), *Οι αρβανιτες και το αρβανιτικο τραγουδι στην Ελλάδα*, Αθηνά 1985.

<sup>24</sup> Γεωργιου Κ.Μιχα (1980), *Το Μαρτινο (Μουζακ)-Λαρυμνα (Καστρι)-Λουτσι-Πυργος*, Λουτσι 1980; 1, *Το Λουτσι Βιωτας*, Κυφασια 2014.

<sup>25</sup> Γιωργος Κ. Γερου (1986), *Η ζωση των αρβανιτων (Νικου Ιω.Σαλταρι)*, Αθηνά 1986. Gerou jeton në Athinë. Ai ka qënë anëtar i shoqatës kulturore “Mark Bocari”. N.Saltari, i lindur në Salamina në vitin 1907, shkruajti dhe “*Arvanitikes istories kai thrillo?*”, Ed. Gerou, Athina 1987.

<sup>26</sup> Μαρια Μιχαηλ Δεδε (1981), *Αρβανικιτα τραγουδια*, Αθηνά 1981. Tekste me alfabetin grek.

<sup>27</sup> “*Neve thuhemi arbërorë?*”, kështu më thanë burrat që intervistojnë në katundet me origjinë shqiptare.” *Arvanitë?*” na thonë grekët dhe ka një kuptim jo I mirë”, kështu më spiegojnë. Ne në Itali thuhemi “*arbëreshë?*”, vëllezërit tanë në Greqi thuhën “*arbërorë?*”. Për këtë u përdorë fjalen arbërorë dhe jo arvanitë. Dhe preferoj Elladha e jo Greqi, sepse tekstet gojore na rrjedhin nga koha dhe nga tokat së Elladhes para formimit e shtetit grek.

<sup>28</sup> Ιωανου Χριστου Πουλου(1950), *Η εποικισις των Αλβανων εις Κορινθιαν*, εν Επετηρις του μεσαιωνικο υαρχειου -Ακαδημια Αθηνων, Αθηνά 1950, 1–105.

<sup>29</sup> Shkelzen Raça (2004), *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi sgek.XIII-XIV*, Prishtinë 2004.

<sup>30</sup> Tommaso Bellusci (2013), *Il sentimento di appartenenza nelle comunità arbëreshe alla Lega di lezhë*, Lajme, Lungro, nr.2, 2013, pp.69-79; G.De Rada, *I canti premilosaici (1833-1835)* (a cura di F.Altimari), Cosenza 2005,

### 3. Letërsia arbërore popullore

Në vitin 1994 kam botuar “*Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*”<sup>31</sup> dhe në vitin 2004 kam botuar “*Arbëoret-Arvanitë - Një popull i padukshëm*”<sup>32</sup>. Këto dy vepra të veçanta dhe unike kanë qenë të mirëpritura nga gjithë studiuesit albanologë. Dhe gjënden në Biblioteken kombëtare të Tiranës si edhe të Prishtinës. Ne do të zgjedhmi disa tekste popullore arbërore<sup>33</sup> të botuara nga unë në këto dy vepra, dhe do t’i sistemjmë sipas disa tematika kryesore. Nuk zgjatemi në analizen e tekstëve. Mendojmë se lexuesi është i aftë për të kuptuar vlerësinë letrare të tyre. Studiuesi ka përpara popullin e arbërorëve- arvanitë në Elladhë, që jeton prej shekujve afër neve por mjerëzisht nuk e njohim fare, sepse për çështje politike ë është i larguar prej nesh, dhe jeton si i padukshëm, i shkelur, i harruar. Ky popull është një pjesë e çmuar të trupit tonë kombëtar. Ditë e natë duke kënduar, këta vëllezër na kanë dhuruar në shpirt historinë e tyre bashkë me këngat e tyre, që lidhen me lindjet, me martesat, me punat bujqësore dhe blektorale. Një popull që punon dhe jeton me kënga, që janë një hymnë për identitetin e tyre arbërore dhe një lavdi jetesësë dhe së ardhmjesë. Ndjenja e fort e tyre e kombësisë e rrënjes shqiptare dh errënja e tyre arbërore e lashtë shprehen me këtë letërsi popullore gojore, që lartësohet në livelet artististike dhe shoqërore më të larta. Kjo pasuri letrare lidhet në kontekstin historiko-shoqëror-politik të vitrave 1965-2000, kur t’ri e pleq mbledhur në korrik dhe në gusht në baret e katundit na kanë kënduar dhe trashëguar shqip jetesën e tyre e përditshme dhe zakonet e të parëve.

Kjo poezi popullore arbërore është e veshur me shprehje dhe me veçori gjuhësore, që na vijnë nga largësia e shekujve. Të gjitha tekstet janë të zbukuruara dhe të shkelqyera nga leksiku arbëror, i qindisur me allegori, ironi, metafora, simbole, krahasime, epiteta dhe figuracione të pathënëshme. Muzika popullore gojore, bashkë me gjuhën arbërore, i jep shpirt, levizje, vallëzim, bukuri dhe gëzim këngëve, ku gjithë

<sup>31</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes, Nga rrënba arbëreshe në Itali në rrënjën mëmë në Greqi – Tekste dhe dokumente, Hryja nga A.Kolljas dhe Gj.Shkurtaj*, Centro Ricerche “G.Castriota”, Cosenza, ff.500.

<sup>32</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëoret-Arvanitë - Një popull i padukshëm – Kërkime etnografje në Elladhë (1965-2000)*, *Hyrje nga Agron Xhagolli, Zymer Nezirri, Vangjeli Ljapis*, Centro Ricerche “G.Kastriota”, Frascineto 2004, ff.360.

<sup>33</sup> Të gjitha tekstet gojore popullore janë të regjistruara dhe të kënduara me manjeto fon nga unë gjatë vitrat e udhëtimitëve-studimore.



shoqëria është protagonist. Këtu nuk është e mundur të sjellim dhe tekstin muzikor. Thanas Moroitis<sup>34</sup> ka botuar një CD me me 26 këngë arbërore si dhe të tjerë.

Një rol të rëndisishëm në ringjalljen kulturore arbërore në vitrat 1976-2000) e kanë mbajtur dhe këto revista:1.”*Dialogo?*”(nr.1/1976-Elefsina-nr.441/1984), e themeluar nga Jorgo Marouga; 2.”*Besa?*”(nr.1/1983-Atene-nr.34/1995) e themeluar nga Jorgo Mihas, Vangjeli Ljapi, Aristidhi Kollja, K.Kristou, J.Gerou e N.Souliotis.; 3.”*Arvanon?*” (nr.1/1998-Athina-nr.8/1999), e themeluar nga Aristidi Kollja<sup>35</sup>. Është me interes të citojmë dhe revisten “*Apollon?*” të vitit 1889<sup>36</sup>.

#### 4. Tekste nga letërsia popullore arbërore

Nga dy botimet tona mbi arbëroret-arvanitë të Greqisë kemi zgjedhur disa poezi popullore nga shume katunde, dhe i kemi regulluar sipas pesëmëdhjet tematika. Për studimin të këtyre teksteve të shkelqyer duhet një liber të veçantë. Te kjo antologji arbërore kemi lule letrare shumë të bukura, që na gëzojnë dhe na afrojnë me zemër këtyre vëllezërve të gjakut tonë shqiptar në Greqi.

##### I – Kënga arbërore

1. Kënga di sa shurë ka deti  
po s’guxonj nga xhanabeti.
3. Kënga di sa shurë ka via  
po i harrova nga agapia.
5. Kënga arbërore nuk thomë  
se kur t’zë nuk e shpetonjë<sup>37</sup>.
7. Do këndonj se jam i ri  
mblakem e s’më do njëri.

<sup>34</sup> Θανατς Μωραιτης (1994), Αρβανιτικα τραγουδια, Αθηνα 1994. Po edhe në 1988 kishte botuar të tjera kënga arbërore bashkë me kënga arbëreshe. Dhe Nikos Panourguas dhe të tjerë kanë botuar CD me këngë arbërore dhe kështu këto kënga u kanë përhapur dhe njohur shumë.

<sup>35</sup> A.Bellusci (2000), *Aristidhi Kollja (1955-2000) – Një hero bashkëkohor i diasporës arvanite arbërore*, në “Lidhja”, nr.44-45/2000, ff.1507-1550.

<sup>36</sup> A.Bellusci (1996), *Një poemë të vitit 1889 në gjubën arbërore*, në “Lidhja”, Cosenza, nr.35/1996, ff.1214-1216, dhe në “Lidhja”, nr.37/1997, ff.1298-1302. Ne kemi bërë transkriptimin në alfabetin e Monastirit. Shih dhe

Γιαννη Γκικα (1995), *Μια αγνωστη αρβανιτικη ωδη*, εν περιοδικω Βεσα, Αθηνα, τευχος 1°-34°, οκτωβριος 1995, σελ.7-22. Shih dhe Në revisten “Apollon” është i botuar ky poem arbëror në alfabetin grek.

<sup>37</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë - Një popull i pafukshtëm – Kërkitje etnografike në Elladhë (1965-2000)*, *Hyrje nga Agron Xhagolli, Zymer Neziri, Vangjeli Ljapi*, Centro Ricerche “G.Kastrioti”, Frascineto 2004, f.153. *Agapia* (greqisht=gr.):dashuria; *via* (italisht)=rruga.

9. Do këndonj e do këndonj  
njera mot vallë të rronjë<sup>38</sup>.
11. Thash u i ziu të mos këndonjë  
s'mund të shkonjë këtë qeronjë<sup>39</sup>.
13. Merr merraqe e do këndonjë  
çë këngë doni u i çonjë.
15. Andè i doni për agàp  
jam llevant e i zë në vrap.
17. Ande i doni për parè  
do zgjonjë vajzen çë fllë.
19. Merr merraqe e do këndonjë  
më të bukura do të conjë<sup>40</sup>.
21. Nga do vete, nga do shkonjë  
do luanjë e do këndonjë<sup>41</sup>.

## II – Besa arbërore

23. Do të mbanj besenë  
si ai bari vesenë.
25. Do të mbanj atë mërinë  
si ai bari mba shinë<sup>42</sup>.
27. Arvanite besalì  
po më do me tij do vi<sup>43</sup>.

## III – Vajza arbërore

29. Moj ti vajzë kur të flasë  
buzenë t'e kesh me gazë<sup>44</sup>.

---

<sup>38</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f.67.

<sup>39</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladbes, Nga rrënba arbëreshe në Itali në rrënjën mëmë në Greqi – Tekste dhe dokumente, Hryrja nga A.Kolljas dhe Gj.Shkurtaj, Centro ricerche "G.Castriota", Cosenza, ff.76. Qerò (gr.)=kohë.*

<sup>40</sup> Aty, f. 205. *Agàp* (gr.)=dashuri.

<sup>41</sup> Aty, f. 209. Në vargjet 1-31dëftohet fuqia e madhe dhe roli i këngëtarëve dhe të poetëve popullore.

<sup>42</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f. 145.

<sup>43</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladbes*, , f. 207. Në vargjet 23-27 shihet vlerësia e Besës sa e madhe është në arbëoret, si edhe disa rregulla e Kanunit të trashëguara në këta troje.

<sup>44</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f. 145.

- 31.** Lule ti lule jot'ëmë  
lule it'at çë të ka bërë<sup>45</sup>.
- 33.** Mos më rrih moj mëmë  
me një copë prrarë.
- 35.** U atë e dua e dua  
e dua e do t'e marrë.
- 37.** Mos më rrih moj mëmë  
me një copë dhri.
- 39.** Do t'e marrë moj mëmë  
leje të jetë bekrri<sup>46</sup>.
- 41.** Shkova një menatë andë  
laheshe në pergulë.
- 43.** Laheshe dhe kriheshe  
me të tëmë ziheshe<sup>47</sup>.
- 45.** Një vajzë e hollë e e glatë,  
një vajzë talihnë.
- 47.** Ajo m'muar mend  
me një vasilikò<sup>48</sup>.
- 49.** Kam marazë çë s'të mora  
ea të të zë ga dora.
- 51.** Edhe ga dora të më zëshë  
më shumë unaza do vëshë<sup>49</sup>.
- 53.** Atje poshtë te një lis  
ja një vajzë dhe qindis.
- 55.** Shkuanë virjotetë e panë  
me Dufeqetë u vranë<sup>50</sup>.
- 57.** Çë psove bilëza jime  
çë psove çë m'u mareshe.
- 59.** Çë psove çë m'u mareshe  
kaq e bukura çë jeshe<sup>51</sup>.
- 61.** Moj Marie çë u bë vera

---

<sup>45</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f. 232.

<sup>46</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f. 156.

<sup>47</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.70.

<sup>48</sup> Aty, f.70. *Vasilikò* (gr)=batzilok.

<sup>49</sup> Aty, f. 7.

<sup>50</sup> Aty, f. 298. Virjotetë=canoret nga Vira.

<sup>51</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.376.

- ga e e piva e ca e derdha.  
**63.** Moj Marie që u bë vali  
që vate nd'mest pithari<sup>52</sup>.  
**65.** Moj kocidhe e dredhurë  
sa ta kam bjedhurë.  
**67.** Moj kocidhe dragollë  
bërdha shtron dhe jasht fllë<sup>53</sup>.  
**69.** Moj kocidhe frangollë  
thug emi i jo i ne<sup>54</sup>.  
**71.** Moj këshet e dredhurë  
di sa ka dredhurë.  
**73.** Moj këshet e drangollë,  
jashtë shtronë e bërdha fllë.  
**75.** Do ta pres këshetetë  
do t'a rrevinj ga sqindetë<sup>55</sup>.  
**77.** Moj e bukura nga tërëzë  
Shër Mëria të ka bërëzë.  
**79.** Shër Mëria s'bëenë njeri  
më ka bërë njëmëmez si ti<sup>56</sup>.  
**81.** Pikrò dhafna e Llumareë  
ti je e bukura Moresë.  
**83.** Pikrò dhafna e lumit  
ti je e bukura katundit<sup>57</sup>.  
**85.** Çë më shtive te hëngëra  
çë më z'dell fare nga zëmëra?  
**87.** Çë më shtive në fai  
çë më z'dell nga mendit<sup>58</sup>?  
**89.** Ndë gurë shkava e guri humbi  
vajza iku ga katundi.  
**91.** Ndë gurë shkava e guri plasi  
vajza iku ga marzi<sup>59</sup>.

---

<sup>52</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f.78.

<sup>53</sup> Aty, f.61.

<sup>54</sup> Aty, f.796. I (gr)=ose.

<sup>55</sup> Aty, f.98.

<sup>56</sup> Aty, f.61.

<sup>57</sup> Aty, f.58. *Pikrò dhafna* (gr)=dafinë e tharet dhe e nguret.

<sup>58</sup> Aty, f.105. *Fai* (gr)= ushqim.

**93.** Mëma jote e keqe grua  
në kuvend çë m'thua?

**95.** Mëma jote e keqe grua  
çë s'më lë të bënj çë dua<sup>60</sup>.

#### **IV – Vajzë me dhenë e dhi**

**97.** Vajzë me dhenë e dhi  
ç'i janë ato ç'i ke në gji?

**99.** Di boçonje me rakì  
am çë a zë të pi.

**101.** Jo jo lalë zi  
se kam plakenë nd'argali.

**103.** Jo jo lalë zi  
edhe plakun me dhi.

**105.** Se do na xënë në shtëpi  
do na therenë si dhi<sup>61</sup>.

**107.** Friti era e tundi ullinjëtë  
gru çopàn se vanë dhitë<sup>62</sup>.

#### **V – Prapa malit lam një lëmë**

**109.** Prapa malit kam një lëmë  
Ia vajzë të flëmë.

**111.** Një vakzë e mirë e e bukurë  
çë më jep një të puthurë<sup>63</sup>.

**113.** Prapa malit bie borë  
vajza më bënë me dorë<sup>64</sup>.

**115.** Nga ai mali çë rrusheshe  
si një neraidhe dukeshe.

**117.** Trëndafille buqare  
çë s'më del nfa mendi fare<sup>65</sup>.

---

<sup>59</sup> Aty, f.74.

<sup>60</sup> Aty, f.75. Në vargjet 29-85 nënvizogen vyrtytet e vajzes arbërore, e cila është e ndershme dhe punëtore.

<sup>61</sup> Aty, f.32. *Argali* (gr)= veku.

<sup>62</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.296. Në vargjet 97-107 kemi jeten blegtorale, ku gjithë familja është e angaxhuar në punë ditë e natë.

<sup>63</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f.40.

<sup>64</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.70.

<sup>65</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f.69.

119. Anthisi driza e malit  
oj bëri karposqinë.  
121. Nga ti moi lule sqinë  
arnisa prindët e tim.  
123. Nga ti moj mavromate  
arnisa prindëtë tim<sup>66</sup>.  
125. Prapa malit kam shtëpinë  
merr furkenë dhe ëlla të rrimë.  
127. Vinjë po më vrasinë  
ëlla po nuk të ngasenë<sup>67</sup>.

#### VI – Gjitori këtu prrëzë

129. Gjitàni këtu prrëzë  
Ka një vajzë si thëllëzë.  
131. E kerkuamë e ning na e dhanë  
le t'e pjekenë e t'e hanë<sup>68</sup>.  
133. Moj sa pllasi gjitoneja  
pse s'u bëfsha atë çë tha.  
135. Moj gjitone moj gjitone  
Ti çë vete e bukurone<sup>69</sup>.  
137. Moj gjitone, moj gjitone  
potë do t'e harroneme.  
139. Vre, gjitone, mos u martua  
po ia një mbrëma e flë me mua<sup>70</sup>.

#### VI I– Martesa arbërore

141. Nga vemi nàni me vapë  
vemi të vëmë stefanë.  
143. Ku e ka nusja shtëpinë  
të na e thoni se s'e dimë.

---

<sup>66</sup> Aty, f.55. *Arnisa* /gr)= dergova,

<sup>67</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.291. Në varhjet 109-127 kemi jetenë bujqësore dhe blegtorale që mbahet në malet, ku gjënden shumë katunde arbërirë në Korinthi dhe në Morë.

<sup>68</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëoret-Arvanitë...*, f.44.

<sup>69</sup> Aty, f.72.

<sup>70</sup> Aty, f.79. *Gjìtonia* (gr)= fqinjë. *Potë* (gr) =kurr. Roli i gjitonisë(i fqinjisë) është shumë i vlershëm në të gjitha marrëdhëniet shoqërore dhe familjare (vargjet 129-139).

145. Dell moj mëmëzo në derë  
somë di peristerë.
147. Qaunë një siom di  
dell moj mama mu nd'avlli<sup>71</sup>.
149. Rrusu mal e bënu dreqë  
të shohë llullenë çë vjenë.
151. Rrusu mal e bënu prrua  
të shoh llullenë çë dua<sup>72</sup>.
153. Vendi u sos kuvendi u sos  
vajza sot u stefanòs.
155. U sos vendi u sos kuvendi  
sot u stefanòs llevanti<sup>73</sup>.
157. Mos na mba krushkò në derë  
se jemi bnjerez të kershterë.
159. Mos nab a krushkò, nd'avlli  
se jemi njerez evgjeni.
161. Hapna krushkò derenë  
do marrmë pelristerenë<sup>74</sup>.
163. Jëma nusesë ku je  
dell e shtena midhallë.
165. Midhalletë u bubunjaznë  
sot djemtë u rrevonjaznë.
167. Midhalletë u bluanë  
sot djemtë u martuanë.
169. Dellna krushkezë në derë  
se t'e sjellmë një peristerë<sup>75</sup>.

### VIII – Zura dhromë e vajta e vajta

171. Zura dhromë e vajta e vajta  
të kultova e ndinja e klajta.
173. Dova dhe gjakùn s'të pashë

<sup>71</sup> Aty, f.65. *Stefanë* (gr)= martesë; *peristerà* (gr)= zog i bukur; *avlli* (gr)=kopshti përpara deresë së shtëpisë.

<sup>72</sup> Aty, f.786.

<sup>73</sup> Aty, f.102. *U sos* (gr)= u mbarua; *u stefanòs llevanti* (gr)= u martua n'trim i bukur.

<sup>74</sup> Aty, f.105. Në vargjet 141-169 kemi vjershe që këndohen në martesat ku gjithë populli merr pjesë me kënga, me vallzime dhe dhe me gëzime dhe sakone të lashta.

<sup>75</sup> Aty, f.111. *Midhallë* (gr)= bahame; *u rrevonjaznë* (gr)= u martuan.

vajta dhe pan grënë rashë<sup>76</sup>.

**175.** Dhromi shkonë prapa shtëpisë

të veshgova në derë t'avllisë<sup>77</sup>.

**177.** Shtëpia në dhromë të gjerë

dhendro livàn ka në derë.

**179.** Shtëpia në dhromë të ri

tërë lule në avlli<sup>78</sup>.

### **IX – Me palo këpućenë**

**181.** Me palò këpućenë

shkava e çajta vucenë.

**183.** Si e bëre kapsarë

vuca ish katà e re.

**185.** Ç ajta vucenë moj mëmë

çë ujë do pimë prëmë<sup>79</sup>.

**187.** Llulle moj llulle moj mèta llulle

merr vucenë e vcemi ndë puse.

**189.** Puset ujë nëk mbanë

ku t'e mbllomë atje ku vanë<sup>80</sup>.

**191.** Ea nàni katanàani

ç'ishtë mëma ga bozdani.

**193.** Ea nàni çë të dua

ç'ishtë mëma vajtur ndë krua<sup>81</sup>.

**195.** Gru menatë te hera ài

të vemë lartë te pusi i ri.

**197.** Gru menatë çiu bë ditë

të vemë lartë të mjelmë dhitë<sup>82</sup>.

### **X – Ndë kseneti si do e shkonj i ndari**

---

<sup>76</sup> Aty, f.57. *Zura dhrom* (gr)= u vura në rrugë.

<sup>77</sup> Aty, f.69. Në vargjet 171-179 kemi ndjenja poetike shumë të fuqishme, ku rruga e jetës ka një domëthënie të thellë.

<sup>78</sup> A.Bellusci( 1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladbes*, , f.210. Dendro livàn ka (gr)= lisi tema ka.

<sup>79</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëoret-Arvanitë...*, , f. 89. *Palò* (gr)= e vjeter.

<sup>80</sup> Aty, f.58.

<sup>81</sup> Aty, f.74.

<sup>82</sup> Aty, f.110. Në vargjet 181-197 kemi vajzen që shkon e vete në krua ose në pus për ujë. Poezia është e plotësuar me allegori dhe me realitet,



199. Ndë kseneti si do e shkonj i ndari  
çë s'kam ndonjeri për parigorì.
201. Bie të flë e s'mund të flë i ndari  
krmin e kam po shpirtin m'a ke marrë ti.
203. Të llefteronj të vinjë e të të çonjë  
për të të them ato çë kam ndër mend.
205. Kur ikenj u ka Helli e vet endë shtepi  
s'mund e mbanj llothesia i ndari u per ti.
207. S'ishte njeri kur ngrihemë menatë  
ashtu edhe u shpirti jim të pashë.
209. E rash edhe u ndë kaimò të madhë  
ashtu edhe u shpirti jim t'e thashë.
211. Ashtu edhe u shpirti jim t'e thashë  
unë, kale, rashë ndë kaimò të madhë<sup>83</sup>.

#### XI – Koqe koqe kumbulloqe

213. Koqe koqe kumbulloqe  
ju llë me shëndet moj shoqe.
215. Koqe koqe li serrgjëndë  
të llë me shëndet moj mëmë.
217. Koqe koqe lis i thatë  
të llë me shëndet moj t'atë<sup>84</sup>.
219. Tërë vanë edhe vinë  
Burri im harroj shtëpinë<sup>85</sup>.

#### XII – Vajza arbërore në vek

221. Argali për patishë  
Bën të bukura podhë.
223. Argalia ishtë e marrë  
perpiqet me mitarë.
225. Do t'pienj sajtenë  
si e shkon vajza ditënë.

<sup>83</sup> Aty, f.131. Më ka kënduar këtë poezi Andrea Fostinis nga Qibadhja Argolidos në 5 shtator 1969, që kish vitra 50. Ndë kseniti është dheu i huaj ku ai kish emigruar. Dhe me këtë këngë shpreh deshiren e kthimit në shtëpi. Helli (vargu 205) është katundi Portohjelli Argolidos, afër detit. *Kaimò* (gr)=hidherim, zëmërim.

<sup>84</sup> Aty, f.63.

<sup>85</sup> Aty, f.101.

227. Do t'pienj mitaretë  
si e shkon vajza javenë<sup>86</sup>.

229. Si e shkonë vajza ditënë  
Rrëka streks me saitenë.

231. Njera dorë e rrëvinë  
jatra ètimo e prinë<sup>87</sup>.

### XIII – Vajza arbërore në t'korrat

233. Ndë t'korra dhe ndë ullinj  
t'vnj mortja të m'mirrë.

235. Mala drappi u pruar  
mesëholla akoma kuar<sup>88</sup>.

237. Vajza jonë vej tue kuar  
i ra drapri e e buar.

239. Hapni shok të çoem  
mos bari ergadhikon<sup>89</sup>.

241. Ndë t'korra s'korra fare  
çë s'më del ga mendi fare<sup>90</sup>.

243. Duta ë pesëmbetë orë  
tërë me draprë ndë dorë<sup>91</sup>.

### XIV – Vajza arbërore ndë vresht

245. Ndë vreshtë ndë një'kucur  
këndon një zog I bukur.

247. Ndë vresht ndë një'tua  
këndon një streivatua.

249. Ndë cresht ndë një edardhë  
këndon një zog I bardhë.

251. Bde vreshtë ndë një dhri  
këndon një zog I zi<sup>92</sup>.

---

<sup>86</sup> Aty, f.102.

<sup>87</sup> A.Bellusci (1994), *Kërkime dhe studime ndër arbëoret e Elladhes*, , f.209. Etimo (gr), me një herë. Në vargjet 221-231 kemi vajzen që punon në vek dhe këndon dhe ien stolitë për martesën. Veku ish në çdo shtëpi arbërore.

<sup>88</sup> A.Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, , f.153.

<sup>89</sup> Aty, f.101.

<sup>90</sup> Aty, f.145.

<sup>91</sup> Aty, f.157. Në vargjet 233-243 kemi jeten bujqësore në të korrat dhe në mbledhjen e ullinjëvet ku djali I shpreh dashuri vajzes dhe e nderon.

**XV –Poeti popullor Nikols I. Brodhimas**

**253. I. Kishem trima shqiptarë**

çë në luftë ishnë t'parë.

**255.** Bocari dhe Xhavelina

mitromara Bubullina.

**257.** Ndreu Miaulli ai ka Nidra

Suli çë do e kujtomi në vitra.

**259.** Ndë karjofill edhe ndë palë

shqiptaret ishnë të parë.

**261.** Kur e hilqenë shadërmanë

dunjaj tuti ik i mbanë<sup>93</sup>.

**263. II. Nd'ata miqt e Shqipërisë**

dhe vëgjezerit e Arbërisë.

**265.** U dergonj t'falla shuma

këtu ka katundi jinë.

**267.** Ka një shqiptar i ndarë

ç'u ka gjejiurë allà s'ju ka pare.

**269.** T'ifalla u dergonj me nj'vëlla

ç'u ka ardhur atje lla.

**271.** Si çë thojen për Perendia

papuj im ish ka Prametia.

**273.** Gramatë nëk di shumë

për të shkruanj më shumë<sup>94</sup>.

**5. Përfundim**

Botimet historike, etnografike dhe letrare e arbërovët-arvanitë në Greqi në gjuhën greke dhe botimet të studiuesve të tjerë na tregojnë vitalitetin dhe kulturën e

---

<sup>92</sup> Aty, f.103. Në vargjet 245-251 kemi vreshten ku vajza, si një bylbyl këndon bukurm dhe ounon.

<sup>93</sup> *Nikolaos Joanis Brodhimas*, një burr arbëror, lindur në vitin 1944 në katundin Dhidhima Argolidos, e kam njohur në gushtë të vitit 1985 në Dhidhima Argolidos. Erdhi e më nderoi bashkë me dhjetë burra arbërorë dhe më ftoi në darkë dhe u vu e më këndoi gjithë poezitë e tij. Poezi që dilin nga zemra e tij e thjeshtë dhe nga shpirti I tij shqiptar.

<sup>94</sup> A. Bellusci (2004), *Arbëroret-Arvanitë...*, f.119.

madhe të këtij populli vëlla shqiptar. Me emigrimet e vjetra dhe me emigrimet e reja në këto vitra na thonë se në Greqi janë qindra e qindra mil shqiptarë kudo. Këta vëllezër punojnë me nder dhe duan të mbajnë në zemër dhe duan të trashëgojnë gjuhën ëmtare dhe zakonet e atyvet e tyre. Fara e rrënjës shqiptare lulëzon tek ne arbëreshë në Itali dhe në një pjesë të madhe të gadishullit balkanik. Dhe kjo gjuhë dhe kjo kulturë shqiptare nderon Evropën dhe gjithë botën.

**Vebi BEXHETI**

**LIRIKA DERADIANE DHE AJO E LETËRISË GOJORE  
ARBËRESHE NË POEMËN “KËNGËT E MILOSAUT”**

Edhe në këtë vit jubilar të 200 vjetorit të lindjes së poetit të madh arbëresh, Jenorim De Radës, vepra, ndër më të rëndësishmet e krijimtarisë aq të gjithanshme të tij, “Këngët e Milosaut”, vjen ashtu, me bukurinë e saj të pashoqe poetike, me freskinë, rininë dhe e vitalitetin, siç thotë Ismail Kadare, por jo më e ndrojtur, me fat të keq, e belbër dhe nga një vend i humbur. Kur e kemi parasysh vitin e largët 1963, ky mendim i shprehur i Kadaresë në atë kohë në gazetën “Drita”, ndoshta ishte i drejtë dhe domethënës, edhe nga fakti se ashtu si shumë vepra të tjera të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, edhe poema “Këngët e Milosaut” vinte nga një vend që për Shqipërinë e kohës konsiderohej si i humbur. Vendi ku lindi, u rrit e jetoi De Rada, konsiderohej si i tillë, ndoshta edhe në mungesë të njohurive të gjithanshme që kemi sot për botën arbëreshe, jetën e tyre dhe letërsinë që u krijua atje, nga ajo më e vjetra deri në këtë të sotmen. Edhe pjesa e këtij mendimi, se kjo vajzë e bukur dhe e freskët hyri në pallatin e poezisë shqipe si e belbër, e ka shpjegimin e vet, sepse e folmja arbëreshe si varianti i vjetër i gjuhës shqipe që e ruajti formën e saj deri në ditët e sotme, ishte e pakuptueshme për lexuesin shqiptar, madje edhe për disa studiues. Kjo gjuhë mbeti e tillë edhe sot, por falë studiuesve të shumtë të letërsisë shqipe, e sidomos atyre arbëreshë, që këtë gjuhë e përdorin në familje dhe në mjedise tjerë, dhe shumë të tjerëve që e njohën këtë të folme, angazhimet e studiuesve të këtij krahu të letërsisë shqipe, nuk kanë munguar, që nga koha e botimit. Studiues të huaj, arbëreshë dhe të tjerë shqiptarë, këtë vepër e studiuuan në aspekte të gjithanshme, edhe pse në disa raste, lirizmi i veprës si elementi më i fuqishëm dhe si përbërës më i rëndësishëm (R. Qosja: 108) mbeti nën hijen e analizës së rrafshit të rrëfimit epik, apo edhe të karakterit të fragmentarizmit të veprës. Është fakt i pamohueshëm se vepra ka edhe karakter epik, por epizmi i rrëfimit të ngjarjes na vjen pa ndonjë lidhshmëri të mirëfilltë, nga fillimi deri në fund, nga se personazhet e veprës përmes gjuhës, dialogut dhe veprimit, përmes nuancash, tingujsh e emocioneesh, veprojnë sipas modelit krijues lirik. Me të drejtë Prof. Rexhep Qosja për fenomenin e karakterit liriko-epik të veprës shprehet: lirizmi i De Radës në paraqitjen e tij është pak a shumë specifik edhe për

shkak se përmbushet në kuadrin e strukturave që janë apo hiqen të jenë para se gjithash epike (Po aty, f. 113)

Edhe pse veprimi i personazheve dhe ndërtimi i ngjarjes së veprës që ka synim ndriçimin dhe bëmat e personaliteteve të kohës së “Motit të Madh” dhe dashurinë e arbëreshit për atdheun e tyre m’atënë detit, elementi epik i veprës, që përmes ngjarjesh historike tenton ta sjell të kaluarën, në kohën kur u shkrua kjo poemë, na vjen më i zbehtë, ndërsa ngjarja, e turbullt e pa ndonjë kontinuitet. Kur dihet se elementi lirik i veprës është shprehje e karakterit të brendshëm shpirtëror, e në këtë rast ashtu është, nuk ka nevojë që për momentet më të errësuar të ngjarjes, fajin ta kërkojmë nga vet autori, i cili në parathënien e veprës së botimit të parë e pat sqaruar se si lindi kjo vepër: Unë derdha në të shumë ëmbëlsi dhe mallëngjim, mbi gjithë të vërtetën duke përshkruar kryesisht ngjarje tamam të mija, pa lexuar asgjë n’atë kohë (Jeronim de Rada Vepra Prishtinë 1969, f.42). Ky mendim i De Radës që edhe përputhet me moshën e tij të re, pa ia mohuar edhe talentin e madh dhe gjithsesi edhe njohuritë paraprake të fituara gjatë shkollimit, duhej të shërbente si bazë e shëndoshë për t’i hyrë studimit të poemës, duke u përqendruar fillimisht në konceptimin aq të pasur e të sinqertë me nuanca ngjyrash, tingujsh dhe emocioneve (Po aty, f.43). Nga vet fakti se në këtë mendim të De Radës për veprën e vet, nuk përmendet emri i ndonjë shkrimtari të kohës, apo të më hershëm dhe i veprave të tyre, që ka mundur të jetë inspirues i drejtpërdrejtë për veprën, del se elementi lirik, si shpërthim emocional i botës së tij të brendshme është bazamenti i tij më fuqishëm, mbi të cilin mori shtat kjo vepër, që edhe sot konsiderohet si më e mira e De Radës. Këtë origjinalitet të veprës, që përmes personazhit të Milosaut, Rinës dhe të tjerëve, tregon mes tjerash edhe një të vërtetë historike për fatin e kombit, në një farë mënyre e paraqet edhe Lamartini, i cili pasi e kishte lexuar veprën, i shkroi De Radës se poezia ka lindur në brigjet tuaja dhe po aty duhet të kthehet. Ky mendim, ë pothuaj është përmendur në çdo studim për këtë vepër, e që jo rastësisht po e përmendim edhe në këtë rast, pa i harruar edhe ato të Hugojt, Mistralit dhe të ndonjë tjetri, duhet shikuar edhe në aspektin nëntekstual. Një vepër që lind në truallin e kombit, si rezultat i frymëzimit të një poeti, që me kohë është larguar nga gjiri i tij, është vetëm rezultat frymëzimi lirik që buron nga thellësia e shpirtit nostalgjik, mbi të cilin vendoset edhe ngjarja e rrëfimit epik. Kjo vepër nga disa studiues u vlerësua si më specifike se të tjerat, edhe nga shkaku se u botua e para, kur poeti ishte i ri, vetëm 22 vjeçar, nga format e komunikimit të personazheve që karakterizohen para se gjithash nga lirizmi i fuqishëm, si rezultat i ndjenjës së dashurisë ndaj atdheut të largët e të robëruar dhe dashurisë si përjetim personal ndaj një vajze të fshatit. Ky gërshetim motivesh që përmes kryepersonazhit Milosau, përcillet te lexuesi, nuk do ishte i plotë, edhe pa gërshetimin e lirizmit të poetit De Rada, dhe atij që vjen përmes vargut popullor arbëresh. Edhe pse autori nuk e përmend

në fjalën e vet hyrëse të veprës, ndikimin dhe frymëzimin nga kënga popullore, kjo nënkuptohet kur dihet se De Rada para se ta botoi veprën, u mor me mbledhjen e këtyre vlerave të mirëfillta shpirtërore, që dëshmohet edhe me dorëshkrimet paratekstuale të pjesëve të veprave që u botuan para “Milosaos”, bashkë me vargjet e shumta popullore arbëreshe, që tanimë i kemi në dorë, të botuara nga prof. Altimari, me titull, ”Këngët e para Milosaut”. Bota poetike e De Radës që përmes fuqisë lirike të tij në vepër, sjell edhe ngjarje me ngjyrim epik, nuk do ishte aq me vlera artistike pa praninë e lirikës popullore, vargjet e së cilës në disa raste i bën pjesë të poemës apo romanit lirik në vargje, siç shpesh quhet poema “Këngët e Milosaut”.

Disa nga studiuesit e shumtë të kësaj vepre, më tepër merreshin me karakterin epik dhe narracionin e rrëfimit, duke u bazuar në problemin e ndasive klasore dhe tërmetin shkatërrimtar të Shkodrës, përmes të cilit De Rada, siç është thënë shpesh, në “mënyrë” artificiale” ka tentuar t’i zhdukë klasat për t’ua mundësuar martesën e Rinës dhe Milosaut. Ky segment, që gjithsesi zë një vend të rëndësishëm në vepër, mendoj se nuk meriton aq vëmendje, edhe nga shkakut se martesja e dy kryepersonazhëve, para se gjithash, duhej të ishte rezultat i një dashurie të pastër e të sinqertë, ë edhe pa tërmetin e përfolur aq shumë, duhej të realizohej, me gjithë pengesat që vinin nga nëna e Milosaut, Zonja e madhe, fundja, një familje e pasur e shtresës së lartë shoqërore, si dukej ajo e Milosaut, princit të Shkodrës, nuk mund ta kishte shtëpinë, sa do e madhe të ishte, të vetmen pasuri. Tendenca për qasje të këtyllë pa depërtuar në lirizmin si shenjë funksionale e prirjes së tij (R. Qosja: 107.) poetike nuk i shërben poetit të madh dhe veprës së tij. Edhe dilema se a është Shkodra e sotme qyteti në rajonin e të cilit zhbillohen ngjarjet apo, ndonjë vend tjetër në jug të Shqipërisë, siç duket nuk është me ndonjë interes të një studimit të mirëfillt shkencor, për ta njohur këtë vepër, që në zanafillën e vet si lirike, e të ndërtuar në mjediset e fshatit të lindjes, Maki. Frymëzimet e poetit nuk do e kishin atë fuqi gati se magjike e as mrekullinë për ndërtimin e ngjarjeve e veprimeve të personazheve të vet lirik, në ambiente të panjohura dhe të pa përjetuara në moshën e fëmijërisë dhe të rinisë. Është e vërtetë se vepra ngërthen në vete ngjarje nga koha e “Motit të madh” dhe i kushtohet atdheut të braktisur, tanimë për shkaqe të njohura, por s’duhet harruar se zhvillimet e ngjarjeve bëhen në vende që emërtohen edhe me emra real sipas imazhit të fshatit të tij të lindjes dhe të viseve arbëreshe përreth (M. Mandala, koha, 25 gusht 2014). Arat e kodrinave të buta me vreshta, elbnaja, e ullinj, janë ambienti i vendlindjes së tij, ku poeti e kaloi fëmijërinë. Nostalgjia e studentit të ri për këtë ambient të ngrohtë, kur kthehej në pushimet verore nga Napoli, ku studionte, dhe kujtimet që lidhen me të, janë edhe një dëshmi që e vërtetojnë elementin autobiografik të veprës. Këtë ambient idilik, ku nuk mungon edhe ndonjë toponim, si bie fjala fshati Mbuzat,

poeti e përshkruan edhe me vargjet kur flet për natën e mrekullueshme brenda një atmosfere të qetë e të këndshme që poetin nuk e le të qetë edhe në gjumë:

*Herë e parë eë u zgjova;  
Nga Mbuçati hënza  
Mbi det po shkëlqente.  
Për së dyti kur u zgjova  
Njerëz e kafshë të përgjumur  
Ylli s'i vështronte,  
Por premtonte sy për delesh  
Netë me fate të mbëdha.  
Për së treti kur u zgjova  
Hëna kishte rënë, kulloste  
Ndonjë ka aty këtu,  
Kodrave gjysëm të bardha.  
Për së katërti u zgjova  
Delet tona genë përhapur  
Lumenjve të kaltër.  
Mua më zu malli katundit.*

Me kësisoj përshkrimesh, vepra përshkohet fund e krye. Takimi i Milosaut në krua me Rinën, dialogu i parë ku lindi dashuria e tyre, dhe shumë momente tjera të ngjarjeve nuk zhvillohen në asnjë vend tjetër, përveç ambienteve arbëreshe. Në mjedise të këtilla gjallëron jeta, vërehen dridhërimat e shpirtit që fshihen prapa tyre, ashtu si edhe ajo botë e madhe pasionesh, ndjenjash, veprimesh e fatesh njerëzore, që flasin për një poezi që vjen nga shpirti i artistit, për një poezi ndjenjash me manifestime të fuqishme lirike. (J. de Rada, Vepra: 38) Ashtu si shumë shkrimtarë të romantizmit shqiptar, edhe De Rada në veprat e veta, e sidomos te “Milosau”, është më tepër poet lirik se sa epik, madje edhe atëherë kur temat që i trajton janë epike, shprehet Rexhep Qosja (R.Qosja:108) Rrëfimi në poemat e De Radës, me theks më të madh në “Këngët e Milosaut”, nuk e tregon botën por Unin. Bota në këto poema në radhë të parë është botë që shihet me sytë e zemrës, shton ai.

Edhe përkimet e elementit të këngës popullore arbëreshe në këtë poemë, së pari duhet shikuar në aspektin e gërshetimit të lirizmit të këtij vargu popullor, me atë të poetit De Rada. Përmes këtij harmonizimi, vepra e tij poetike duket më burimore e autoktone, më e ndjeshme. Personazhët lirikë të poemës dhe ata të poezisë gojore arbëreshe, kanë ngjashmëri në veprimet e tyre, në atmosferën fshatare të dasmës, punimet në vreshta, mbledhjes së ullinjve etj. Edhe në lirikën gojore, ndjenjat e fuqishme



të personazheve që shprehen përmes takimeve, frikës së dashurisë së tyre do kuptohet në fshat, droja se prindërit nuk do pajtohen për martesë, përgojimet e ndryshme etj., ngjasojnë me lirikën e vargut deradian. Edhe dialogu në krua, mes Milosaut dhe Rinës zhvillohet në këtë frymë:

*Vajzë a, më jep një pikë ujë?  
Sa të duash bir bujari  
Bijë e kujt më je ti vashë?  
(Këngët e Milosaut)*

Siç vërehet, këto vargje ngjajnë me vargun popullor. Togfjalëshin "një pikë ujë", me kuptimin e ndajfoljes së sasisë (pak)apo, trajtën e shkurtër të përemrit vector "më", te fjalia: "bijë e kujt më je ti", shpesh i hasim edhe në këngët popullore. Të këtilla fjalë dhe shprehje me ngjyrimë lirike, të ngjashme me ato gojore, shtrihen në tërë poemën "Këngët e Milosaut". Përmes rrëfimit lirik të vargut të autorit, që shpeshherë na vjen me frymën popullore dhe atij që e sjell vet vargu popullor arbëresh, De Rada e krijon shijen e artit të fjalës të vet poetike, duke bërë që lexuesi, para se ta kuptojë, ta shijojë atë. Këtu edhe qëndron dallimi i kësaj vepre me të tjerat, me përjashtim të "Serafina Topisë", edhe pse jo me aq lirizëm të shprehur si të "Milosau". Përkimet e vargut të De Radës me poezinë gojore shtrihen në rrafsh tematike, strukturore e gjuhësore (R.Qosja: 456) madje, shpeshherë këto ngjashmëri paraqiten si variante me dallime të padukshme. Kënga XXV e botimit të vitit 1847, është gati se identike me një këngë të "Rapsodive" të De Radës, të përshtatura në gjuhën letrare nga Zijadin Kodra më 1957. Në vargjet autoriale të poetit tonë, ashtu rrjedhshëm dhe me tone lirike përmes metaforave të shumta, krahasimit dhe figurave tjera stilistike, ai e paraqet këngën e vajzave, kushtuar shoqes nuse, në këtë rast Rinës:

*Atje lart, kreshtës mbi mal,  
atje ish një shesh i madh  
ku na kullotnin thëllëzat.  
M'u lëshua një petrit,  
mori më të bukurën  
që nga mesi i shoqeve,*

De Rada si një romantik i madh, me përmasë edhe evropiane, përmes subjektit lirik e përshkruan atmosferën kur në shtëpinë e dhëndrit i këndohet nuses, që e krahason me thëllëzën. I tërë ky episod i ardhjes së nuses, paraqitet në mënyrë poetike, përmes kuptimit metaforik të petritit që u lëshua atje ku kullotnin thëllëzat për ta marrë më të bukurën. Ja si duken vargjet e këngës popullore arbëreshe, botuar në

“rapsoditë” e De Radës:

*Këtje lart, këtje për mali  
Atje ish një sheshi madh  
tek kullotënjin thëllënzat;  
m'u lëshua këtje një petrit.  
Më të hijeshmen zgjodhi  
m'e ngrëjti për qielli.*

Siç shihet, nga këto krahasime të lirikës së De Radës dhe të asaj të vargut popullor, autori i kësaj poem, diti të zgjedh vlerat e larta të poezisë popullore për t'i bërë, me shumë pak ndryshime, pjesë e veprës së vet. Vetëm poetët e mëdhenj, siç është edhe, De Rada këto vlera të rralla të shprehura me gjuhë aq të bukur poetike, i bëjnë për vete dhe bashkë me krijimin e vet në këtë frymë, e ndërtojnë vargun e bukur estetik që reflekton aq shumë efekte poetike dhe lirike njëkohësisht. Përvec përmasës së lirikës në artin e kësaj poeme, të një rëndësie të vecantë për veprën janë edhe figurat artistike, si figura mendimi, rrëfimi epik dhe shtrirja e ngjarjeve me përmasën e kohës dhe hapësurës. (Shih te E. Kabashi: 189)

### **Bibliografia:**

1. Rexhep Qosja, Romantizmi II, Prishtinë 1984
2. Jeronim de Rada, Vepra 1969, Prishtinë 1969
3. Jeronim de Rada, Kompleti i veprave, Prishtinë 1980
4. Emin Kabashi, De Rada, Poetika e poemave, Prishtinë 2003

## **I. SESIONI I GJUHËSISË**



**Rrahman PAÇARIZI**

## **LESIKU MENTAL DHE IDEOLOGJIA NË FJALIMET PARAZGJEDHORE**

Ideologjia gjuhësore dhe ideologjia në gjuhë janë terma që dallojnë nga njëri tjetri. Synim i këtij punimi është jo ideologjia gjuhësore, por ideologjia në gjuhë apo manifestimet ideologjike në gjuhë. Përkatësisht, synimi i këtij punimi është me nxjerrë ideologjinë apo orientimin ideologjik nga gjuha apo nga struktura të saj. Wodak thotë se “politikë nuk janë vetëm partitë dhe parlamenti apo lufta dhe paqja – politikë është gjithçka, së paku potencialisht. Gjithçka është potencialisht politike. Mirëpo, jo gjithçka shikohet politikisht. Shkalla e pjesëmarrjes politike ndryshon varësisht nga ndryshimet sociale dhe politike...”

Për ta nxjerrë ideologjinë nga gjuha, për korpus hulumimi është marrë gjuha e disa politikanëve të Kosovës, udhëheqës subjektsh politike garuese në zgjedhjet e vitit 2014. Në rastin e parë është krahasuar leksiku mental si pasuri leksikore dhe qasja në atë leksik mental në debatin final zgjedhor për zgjedhjet lokale ndërmjet dy kandidatëve në balotazh, Isa Mustafa i LDK-së dhe shpend Ahmeti i Lëvizjes Vetëvendosje. Në rastin e dytë janë marrë intervistat e realizuara nga “Zëri i Amerikës” në shqip, me katër drejtues subjektsh politike. Janë planifikuar pesë subjekte, por njëri prej tyre, për arsye të ndryshme, nuk është intervistuar nga asnjë medium. Pëerderisa në debatin e parë janë analizuar kryesisht elemnte psikolinguistike, por edhe disa markerë ideologjikë në diskursin e tyre politik, në rastin e dytë fokusi është zhvendosur te manifestimet ideologjike në gjuhën e katër subjekteve të hulumtuara, pasi që në këtë rast bëhej fjalë për zgjedhje nacionale dhe manifestimet ideologjike kanë qenë më të pranishme.

Gjithsesi, një nga fushat ku politika dhe ideologjia gjen zbatimin është gjuha, e cila ndërton një raport të ndërsjellë me politikën e sidomos me ideologjinë, duke qenë se pikërisht përmes gjuhës lansohen idetë politike, të cilat duke qenë produkt i një grupimi të caktuar të interesit, domosdo kanë përmbajtje ideologjike.

Ajo reflekton strukturat e fuqishme – dhe gjuha ka një impakt në strukturat e fuqisë. Gjuha mund të shihet si indikator i situatës shoqërore, prandaj edhe politike – dhe gjuha gjithashtu

mund të shihet si një forcë motorike e orientuar kah ndryshimi i politikës dhe shoqërisë. Gjuha është një faktor që është në raport të marrjes dhe dhënies me sistemet politike. Ajo ndikon në politikë dhe njëkohësisht ndikohet nga politika. Gjuha mund të jetë instrument për dhe kundër iluminimit, për dhe kundër emancipimit, për dhe kundër demokracisë, për dhe kundër të drejtave të njeriut. Gjuha mund të përdoret nga regjimet totalitare dhe mund të përdoret si mjet rezistence kundër atyre regjimeve” (Wodak, 2007, 6:1)

Sipas Van Dijk (1998) dhe Wodak e Weiss (2004), gjuha është e lidhur ngushtësisht me bindjet, opinionet dhe idelogjitë. Tani, ato bindje varësisht nga shkalla e konsolidimit të tyre dhe varësisht edhe nga faktorë të tjerë bëhen pjesë e leksikut, e realizimit fonetik, e më pak, e strukturës gramatikore të individit.

Koncepti i ideologjisë në gjuhë, megjithatë nuk mund të definohet lehtë dhe qartë. Zakonisht ne jemi mësuar t’i shenjojmë si negative ato që i perceptojmë si manifestime ideologjike në gjuhën e individëve të caktuar. Ndonjëherë i shohim edhe me paragjykim. Pikëpamjen se “ne kemi të vërtetën dhe ata kanë ideologjinë” Van Dijk e quan qasje marksiste, duke konstatuar se “ideologjia përgjatë shekullit 20 është përdorur me konotacion negativ si kundërshtim ndaj njohjes a dijes objektive (2006:728). Por, sidoqoftë, ideologjia shihet si e pashkëputur nga politika edhe pse politika nuk është substrati i vetëm ku zhvillohet e rrjedhimisht as fjalimet politike nuk janë janë manifestimi i vetëm i ideologjisë në gjuhë. Mirëpo, a është diskursi i politikanëve domosdoshmërisht politik. Nëse fusha politike është krejtësisht ideologjike, atëherë janë të tilla edhe praktikat politike, e së këndejmi edhe diskursi.

ideologjitë politike nuk janë të përfshira vetëm në prodhimin apo të kuptuarit e diskursit politik apo të praktikave të tjera politike, por edhe riporodhohen nga ato. Në njëfarë mënyre, diskursi i bën ideologjitë të observueshme ,pasi vetëm përmes diskursit ato mund të shprehen dhe formulohen në mënyrë eksplicite. Praktikrat e tjera politike i shfaqin ideologjitë vetëm në forma implicite, si për shembull në praktikrat e dskriminimit me bazë gjinore, racore apo politike. Vetëm përmes diskursit ne mund të shpegojmë se ai dskriminim ndodh “sepse ajo është femër”, “sepse ai është i zi” apo “sepse ata janë socialistë”. Së këndejmi përmes diskursit idelogjitë politike zotërohen, shprehen, mësohen, propagandohen dhe kontestohen thotë Van Dijk. (Van Dijk, 2006:730-731)

M. Fulcaut thotë se diskurset janë elemente taktike apo orë që veprojnë në

fushën e raporteve të forcës; mund të ekzistojnë diskurse të ndryshme e madje edhe të kundërta në kuadër të së njëjtës strategji; ato, ndryshe, qarkullojnë pa e ndryshuar formën e tyre nga një strategji në tjetrën duke iu kundërvënë një strategjie (Fulcault, 1981:101)

Për shembull, unë përdor shqipen standarde për ta kundërshtuar vetë atë dhe fakti se kjo shqipe standarde që unë përdor, mund të funksionojë në mënyrë të përkryer, nuk më bën të heq dorë nga strategjia e ndryshimit të saj. Ose, anasjelltas, mund të mbrohet standardi aktual, duke folur në një varietet, të afërt ose të largët me standardin. Apo, nëse një politikan përdor fjalën qytetarët në vend të populli, nuk e bën atë automatikisht të djathtë apo nëse flet për kontratë kolektive, ai nuk është automatikisht i majtë, dhe këtu ndërlidhen edhe përmbajtjet sociale dhe kognitive që u përmendën pak më sipër sipas Van Dijk-ut për të ndërtuar teorinë mbi ideologjinë në gjuhë.

Kjo qasje mund të duket skur e kundërshton qasjen time për të ndërtuar setet ideologjike të politikanëve nga leksiku mental i politikanëve dhe jo nga diskursi i tyre, edhe pse ky i fundt sigurisht që është tregues më i sigurt, por nuk përjashton leksikun mental si një nga treguesit, si një ndryshore domethënëse. Pra, me nxjerrë një orientim ideologjik nga leksiku mental i një politikani domethënë me i nda dhe seleksionu fjalët që janë më të zakonshme në perceptimin tonë socio-gjuhësor lidhur me përkatësinë ndaj një ideologjie specifike. Për shembull, përdorimi i fjalës “kujtoj” edhe kur duhet përdorur folja “mendoj” është tipar dallues i zyrtarëve të LDK-së që ndjekin filozofinë rugoviste, meqë Ibrahim Rugova, ideologu i kësaj partie dhe lëvizjeje të tërë, e ka përdorur vazhdimisht këtë fjalë (nëse e ka përdorur në kuptimin e duhur dhe në kontekstion e duhur, kjo është një çështje që do trajtim tjetër që nuk është synim i këtij punimi), prandaj kjo fjalë e vetme mund të përbëjë një tipar idelogjik. Përdorimi i “ë”-së për shembull të fala “shqipëtar”, është tipar i enveristëve në Kosovë, të cilët “ë”-në e identifikojnë me vetë standardin e shqipes, me vetë Shqipërinë komuniste dhe me vetë enverizmin. Made, dikush as që mund ta mendojë falën **kombtar** pa **ë**, edhe pse fjala shqiptar në drejtshkrimin aktual të shqipes është pa “ë”. Apo, kohët e fundit jemi dëshmitarë të futjes në diskursin politik të Kosovës fjala “kapje”, qoftë edhe si pjesë e strukturës **kapje e shtetit, kapje e institucioneve** etj. Kjo fjalë u fut fillimisht në diskursin e Vetëvendosjes për të kundërshtuar praktikata qeverisëse të qeverisë së Hashim Thaçit. Krijimi i bllokut (edhe kjo fjalë ka primesa ideologjike) kundër Thaçit dhe tendenca e partive të tjera për t’u afruar me Vetëvendosjen, me të cilën aktualisht kanë praktika të njëjta politike ka bërë që të zgjerohet shtrirja e përdorimit të kësaj fjale edhe nga zyrtarët e të gjitha partive anti-PDK papërfundimisht.

Krejt kjo u tha për të arsyetuar qasjen metodologjike për të nxjerrë orientimin

ideologjik nga fjalët si të tilla dhe jo vetëm nga diskursi si tërësi.

Kjo në njëfarë mënyrë është thënë edhe nga Norman Fairclough (1991), kur ai mbështet teorinë e Althusserit se “ideologjia nuk ekziston në ndonjë fushë misterioze të “ideve”, por ka një ekzistencë materiale, në kuptimin që “një ideologji gjithmonë ekziston si një aparatus dhe praktikë e tij”. Me aparatus, Althusser ka menduar për aparatin shtetëror ideologjik përmes shkollës, religjionit apo ligjit që ai e sheh si pjesë e aparatit represiv shtetëror.

Sipas Fairclough (1991), një numër mendimesh e vendosin ideologjinë në një formë të sistemit që potencialisht i nënshtrohet praktikës gjuhësore, qoftë si kod, si strukturë, si sistem apo si formacion (grup shprehjesh me marrëdhëniet e caktuara semantike). Një vendosje alternative për ideologjinë do të mund të ishte edhe vetë ngjarja diskursive. Prandaj, sipas Fairclough ka një variant tekstual të vendndodhjes së ideologjisë dhe ai është se ideologjia ndodhen apo jetojnë në tekste dhe nuk ka mundësi që ato të jenë të përjashtuara, pasi kuptimet prodhohen përmes interpretimit të teksteve, ndërsa tekstet janë të hapura për interpretime të ndryshme. (1991: 118)

Për më tepër, Ëoolard dhe Schieffelin (1994) mendojnë se “Ideologjia gjuhësore veprojnë dhe miratojnë lidhjet e gjuhës me identitetin personal dhe grupor, me estetikën, me moralin dhe me epistemologjinë” (teori e dijes dhe natyrën dhe gamën e dijes dhe origjinën e saj). Kjo është e qartë po t’u kthehemi fjalëve tipike të partive politike që i përmendëm më herët.

Woolard dhe Schieffelin thonë se Ideologjia gjuhësore/linguistike është dëfinuar si “set i besimeve lidhur me gjuhën e artikuluar nga përdoruesit si racionalizim apo arsyetim i strukturës dhe përdorimit të perceptuar (Ëoolard, Schieffelin, 1994) dhe në këtë pikë bashkohen me Michael Silverstein, ndërsa Shirley Heath (1977) mendon se ideologjia gjuhësore përbëhet nga ide dhe objektiva të qarta të një grupi lidhur me rolin e gjuhës në përvojat shoqërore të pjesëtarëve të saj, përderisa ato ide i kontribuojnë shprehjes dhe theksimit të grupit.

Në këtë punim është operuar me dy lloje korpusi për të nxjerrë markerët ideologjikë nga të cilët mund të ndërtohen setet ideologjike të subjekteve të hulumtuara, jo me qëllim të vendosjes apo rreshtimit të tyre politik a ideologjik, por për të parë koherencën e manifestimeve ideologjike dhe ndërtimin e strategjive të komunikimit.

Në rastin e parë është marrë për korpus hulumtimi një debat televiziv në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), ndërmjet kandidatëve në balotazhin për kryetarin e Prishtinës. Është zgjedhur pikërisht ky debat, meqë ishte gara finale ndërmjet tyre, meqë fitorja në Prishtinë ishte një paratregues për zgjedhjet e përgjithshme që priteshin vetëm disa muaj më pas, meqë partitë politike (ato që llogarisin për rezultate të mira) investojnë kudrot e tyre kryesore pikërisht në garat zgjedhore për kryeqytetin.



Debati final ndërmjet Isa Mustafës, kandidat i LDK-së, që veten e proklamoi si parti e djathtë dhe Shpend Ahmetit, kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje që vetëquhet si qendër e majtë është mbajtur në RTK, më 11.XI.2013 dhe ka zgjatur 132 minuta, apo 2 orë e 12 minuta. Të dy subjektet janë ekonomistë, por dallon mosha dhe shkollimi i tyre. Ata kanë dëshmuar një potencial pothuajse të barabartë gjuhësor dhe kanë operuar me terma të domeneve të caktuara. Gjatë 132 minutash, një pjesë të cilëve i ka marrë moderatori, subjektet kanë përdorur një leksik me nga më shumë se 8 mijë fjalë secili.

	<b>Isa Mustafa</b>	<b>Shpend Ahmeti</b>
Fjalë kryesore	8509	8251
Fjalë të përsëritura	4020	4006
Raporti	67.91%/32.09%	67.32%/32.68%
Leksiku mendor	8509	8251
Raporti	51%	49%
Zgjedhjet	48.2	51.8

*Tab 1*

Siç shihet nga tabela, raporti i pasurisë leksikore të demonstruar në këtë debat është 51:49 për qind, pothuajse njëjtë edhe më votat e fituara, por në kahun e kundërt-përderisa Isa Mustafa ka mbizotëruar me pasuri leksikore, kjo nuk është përkthyer në vota.

Nëe e shohim frekuencën e përdorimit të fjalëve të caktuara, është interesante se pesë fjalët e përdorura më së shpeshti janë formante gramatikore, përkatësisht folje ndihmëse, parafjalë, lidhëza dhe pjesëza. Përderi sa fjala *kemi* është përdorur më së shumti nga Isa Mustafa, kjo fjalë është e fundit në pesëshen e fjalëve më së shumti të përdorura nga Shpend Ahmeti, i cili më së shpeshti ka përdorur fjalën nuk, e cila është e fundit në pesëshen e fjalëve më të përdorura nga Isa Mustafa. Arsyet për këtë renditje të përmbytur të pesë fjalëve më të përdorura i shoh te fakti që Isa Mustafa e ka udhëhequr për disa vjet Prishtinën dhe domosdo që ka folur më shumë në kohën e kryer dhe është detyruar të përdorë foljen ndihmëse kam, ndërkohë që e njëjta periudhë është kontestuar nga Ahmeti, i cili këtë e ka bërë përmes pjesëzës mohuese nuk. Ideologjikisht, Isa Mustafa i takon një partie që thirret në institucionalizëm dhe qasje integruese, ndërkohë që Vetëvendosje është partia e cila ka ndjekur një logjikë përjashtuese nga partive të cilat kanë qenë në pushtet në një mënyrë a në një tjetër. Në

tabelën 3 mund të shihet raporti i 16 fjalëve më të përdorura . Tabela tregon se fjalët dhe, edhe, për, është, mund, shumë e sidomos Prishtinë janë në raportet më të përafërta sa i përket përdorimit nga të dy folësit. Madje fjala Prishtinë del në raportet 52:48 në favor të Isa Mustafës, ashtu sic del edhe raporti i leksikut të përgjithshëm mental me të cilin kanë operuar subjektet. Përmendja e Prishtinës, i cili ka qenë subjekti për të cilin garohej, është një tregues i rëndësishëm ideologjik, pasi që të dy kandidatët kanë ndërtuar nga një set ideologjik, por është e cuditshme se kjo fjalë llogaritet e katërbëdhjeta në mesin e 16 fjalëve më të përdorura nga akëcili prej subjekteve. Kjo e dëshmon faktin se gara për Prishtinën nuk ka qenë një garë për Prishtinën, por më shumë një paragarë për Kosovën, pasi që normalisht fjalët Prishtinë, komunë, qytetarë apo shërbime do të duheshin renditur të parat për nga frekuenca e përdorimit. Megjithatë, fjala Prishtinë, është emri më së shpeshti i përdorur pasi fjalët e tjera në një mënyrë a në një tjetër janë formante trajtëformuese apo fjalëformuese.

Prandaj, ideologjitë dhe manifestimet e tyre gjuhësore duhen parë si përmbajtje sociale dhe kognitive, pasi që në aspektin social ideologjitë u takojnë grupeve të caktuara sociale që përbëjnë komunitete ideologjike, ndërsa në kuptimin kognitiv ideologjitë ruhen në memorien afatgjatë, si një sistem i veçantë i besimit, pohon Van Dijk (2006:79), për të shtuar se “Ideologjitë, ashtu si gjuhët, janë esencialisht sociale. Nuk ka ideologji personale apo individuale, por ka përdorime personale apo individuale të ideologjive”, duke i parë ideologjitë si jo domosdo janë negative, por si struktura të caktuara të cilat u takojnë grupeve, qofshina to shtypëse a të shtypura, qofshin ato të mira a të këqija për perceptimin e përgjithshëm.

<b>Isa Mustafa</b>		<b>Shpend Ahmeti</b>	
Kemi	226	Nuk	259
Per	217	Për	227
Dhe	206	Dhe	187
Edhe	201	edhe	158
Nuk	145	kemi	132

Tab 2

<b>Fjala</b>	<b>Isa Mustafa</b>	<b>Shpend Ahmeti</b>	<b>Raporti</b>
Kemi	226	132	63:37
Për	217	227	49:51
Dhe	206	187	52:48
Edhe	201	158	56:44
Nuk	145	259	36:64
Është / osht	131/116 (247)	120/97 (217)	53:47
Sepse	96	31	76:24
Një	75	111	40:60
Unë	64	113	36:64
Janë	88	72	55:45
Tash	50	34	60:40
Mund	46	59	44:56
Shumë	46	53	46:54
Prishtinë	34	31	52:48
Duhet	33	54	38:62
Por	30	66	31:69
			49:51

Tab 3

Një luftë krejtësisht e barabartë është zhvilluar ndërmjet dy subjekteve edhe sa i përket pjesëmarrjes së tipave të fjalëformimit, sic shihet në tabelat 4 e5.

#### Statistikat për mënyrat dhe tipat e fjalëformimit në leksikon e Isa Mustafës

<b>Prejardhja</b>	<b>523 fjalë</b>
Prejardhje parashtesore	27 fjalë
Me prejardhje prapashtesore	484 fjalë
Me prejardhje parashteso-prapashtesore	12 fjalë
<b>Përngjitje</b>	<b>55 fjalë</b>
<b>Kompozim</b>	<b>11 fjalë</b>
<b>Nyjëzim</b>	<b>16 fjalë</b>
<b>Konversion</b>	<b>2 fjalë</b>
<b>Mënyrat e përziera</b>	<b>178 fjalë</b>
Nyjëzim dhe prapshtesim	156 fjalë
Kompozim dhe prapshtesim	14 fjalë
Nyjëzim dhe parashteso- prapashtesim	8 fjalë

Tab 4.

## Statistikat e leksikut të Shpend Ahmetit

<b>Prejardhja</b>	<b>446 fjalë</b>
Preardhje parashtesore	22 fjalë
Prejardhje prapashtesore	407 fjalë
Prejardhje parashteso-prapashtesore	17 fjalë
<b>Përngjitja</b>	<b>36 fjalë</b>
<b>Kompozim</b>	<b>6 fjalë</b>
<b>Nyjëzim</b>	<b>14 fjalë</b>
<b>Konversion</b>	<b>2 fjalë</b>
<b>Mënyrat e përziera</b>	<b>125 fjalë</b>
Nyjëzim dhe prapashtesim	102 fjalë
Kompozim dhe prapshtesim	10 fjalë
Nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim	10 fjalë
Nyjëzim dhe përngjitje	1 fjalë
Përngjitje dhe prapashtesim	2 fjalë

Tab5

Është interesant mendoj se konversioni përmes të cilit mund të shprehen ngjyrimet kuptimore a stilistike, si dhe kompozimi marrin pjesë shumë pak në skemën e përgjithshme të tipave të fjalëformimit me të cilët kanë operuar subjektet.

## Statistikat e përbashkëta

Prejardhje parashtesore	49 fjalë
Prejardhje prapashtesore	891 fjalë
Prejardhje parashteso-prapashtesorea	29 fjalë
Nyjëzim dhe prapashtesim	360 fjalë
Përngjitje	91 fjalëz
Kompozim dhe prapashtesim	24 fjalë
Kompozim	17 fjalë
Nyjëzim	30 fjalë
Nyjëzim dhe parashteso-prapshtesim	18 fjalë
Nyjëzim dhe përngjitje	1 fjalë
Përngjitje dhe prapshtesim	2 fjalë
Konversion	4 fjalë

Tab 6.

Një nga variablat psikolinguistike është edhe shpejtësia e të folurit e cila nuk varet vetëm nga shpejtësia e realizimit fonetik të rezultatit final të prodhimit gjuhësor, por më shumë varet nga faktorë të tjerë, që nga baza fundamentale e prodhimit gjuhësor, që është koncepti mendor, pastaj planifikimi i të folurit, ndërtimi i kornizës sintaksore, qasja në leksikon mental, përzgjedhja e lemës, procesimi morfologjik dhe realizimi fonologjik, për të ardhur krejt në fund në rezultatin artikullativ që është produkt fonetik. Dy subjektet, kanë realizuar mesatarisht një të folur të shpejtë që tejkalon mestaren e shpejtësisë së të folurit. Në anglisht shpejtësia mesatare e të folurit është rreth 150 fjalë në minutë dhe një rezultat i njëjtë ka dalë në disa matje që i kemi bërë në edicionet e lajmeve në tri televizione të Kosovës. Në edicione të lajmeve ka rrezik që rezultati të mos jetë krejt i saktë pasi që gjuha e realizuar aty nuk është prodhim direkt i gjuhës, por është reprodukim i saj, meqë prodhimi real gjuhësor ka pasur një kodim grafik, pra ka dalë si rezultat final i shkruar dhe leximi i atij prodhimi nuk mund të konsiderohet prodhim i gjuhës por riprodhim i saj. Gjithsesi, subjektet e hulumtuara në këtë studim kanë realizuar një të folur me shpejtësi mesatare prej rreth 173 fjalë për minutë (tab.7). Shkalla e lartë e përqendrimit dhe motivimi jashtëgjuhësor besojmë se ka ndikuar në rritjen e shpejtësisë së përdorimit të gjuhës, pasi që subjektet kanë arritur të jenë mjaft të përqendruar edhe për të procesuar gjuhën si të kuptuar, me një shpejtësi relativisht të lartë.

### Shpejtësia në të folur

<b>Isa Mustafa</b>	Mesatarisht – <b>170 fjalë në minutë</b>
<b>Shpend Ahmeti</b>	Mesatarisht – <b>175-180 fjalë në minutë</b>

#### Tab 7

Ndoshta një nga variablat e tjera që dalin në këtë matje është operimi i subjekteve të hulumtuara me lema<sup>1</sup> dhe leksema. Kështu, të dy subjektet e vëzhguara kanë një raport prej 17:83, Tab për qind të përdorimit të lema dhe leksemave, natyrisht në favor të leksemave. Leksema në këtë rast janë konsideruar të gjitha manifestimet e trajtëformuara dhe të fjalëformuara nga një lemë bazë prodhuese, por që nuk është e barabartë me temën si të tillë. Ky rezultat dëshmon se subjektet kanë kompetenca të barabarta gjuhësore.

<sup>1</sup> Termi lemw kwu wshtw pwrdror nw kuptim tw lemw psikolinguistike, si njwsi mw e vogwl leksikore e ruajtur nw leksikon mental dhe jo si trajtw pwrfaqwsuese qw wshtw term praktik dhe konvencional nw morfologji

## Numri i përgjithshëm i fjalëve

	Isa Mustafa	Shpend Ahmeti	
Gjithsej	5121	4791	52:48
Lema (psikolinguistikë)	877	811	
Leksema	4244	3980	
Raporti lemë/leksemë	17:83	17:83	

Tab. 8

Dhe, krejt në fund, por që nuk është më pak e rëndësishme si variabël që tregon kulturën gjuhësore të dy subjekteve të hulumtuara është përdorimi i varieteteve gjuhësore. Nga tabelat 9 e 10 shihet se subjektet e hulumtuara pavarësisht se kanë qenë në një situatë formale të realizimit të gjuhës, nuk i kanë kushtuar shumë rëndësi përdorimi të shqipes standarde. Arsyet për këtë mund të jenë nga më të ndryshmet. Pa paragjykuar renditjen, po përmendim disa nga faktorët që mund të kenë ndikuar për këtë raport që shkon në favor të përdorimit të trajtave dialektore ndaj atyre standarde: moszotërimi i duhur i shqipes standarde, të folurit nën presion, target audienca, deformalizimi i situatës për shkak të bisedës interaktive etj.

- *Moszotërimi i duhur i shqipes standarde* përgjithshësisht është një problem që përcjell figurat politike të Kosovës, e sidomos profesionet e shkencave ekzakste, ekonomistët, juristët etj, ndërkohë që të dy subjektet e hulumtuara janë ekonomistë me profesion.
- *Të folurit nën presion* ndikon shumë në situata të tilla në disa nga proceset e prodhimit të gjuhës, e para së gjithash në proceset e strukturimit morfologjik të fjalëve, ku subjektet nuk duan të humbin kohë, pasi e dinë që strukturimi morfologjik nuk ndikon shumë në përçarjen e mesazhit të synuar. Sidomos ky aspekt humb nga rëndësia, kur kandidsatët e kanë parasysh audiencën së cilës i drejtohen.
- *Audienca e synuar*, pra është një faktor tjetër po kaq i rëndësishëm që merr pjesë edhe në dizajnimin e strategjisë së komunikimit. Në ditën e fundit të debatit është mundësia e fundit për të mobilizuar militantët dhe trupin e papërcaktuar elektoral apo atë që quhet elektoratin gri, i cili trup në shoqëri me shkallë zhvillimi sic e ka Kosova, jo gjithmonë është një elektorat me

kërkesa të vecanta gjuhësore .

- *Deformalizimi i situatës për shkak të komunikimit dykrahësh interaktiv* bëhet për shkak të përpjekjes së pjesëmarrësve në debat për të grabitur sa më shumë nga koha në dispozicion, me ç'rast duhet bërë përpjekje që të thuhet ato që duhen thënë dhe të mos lihet pa përgjigje asnjë dilemë a pyetje e shtruar nga rivali dhe situata deformalizohet, me ç'rast çaktivizohen edhe mekanizmat e procesimit morfologjik apo leksematizimit të prodhimit gjuhësor. Gjithashtu, mund të mos bëhet kërkim i thelluar në leksikon mental, por kërkohen dhe gjenden elementet me frekuencë më të lartë përdorimi etj.

#### Isa Mustafa

	Pjesore	Paskajore	Përcjellore	Mohore
Standarde	39	1	5	0
Dialektore	47	8	6	0
Raporti st./dial.	45:55	11:89	45:55	-
Gjithsej	86	9	11	0

Tab. 9

#### Shpend Ahmeti

	Pjesore	Paskajore	Përcjellore	Mohore
Standarde	21	3	4	1
Dialektore	64	7	7	0
Raporti st./dial.	25:75	30:70	36:64	100:0
Gjithsej	85	10	11	1

Tab. 10

Dhe, si për të dëshmuar garën e barabartë ndërmjet dy subjekteve të hulumtuara, kandidatë në balotazhin për postin e kryetarit të Prishtinës, edhe gara zgjedhore ka dalë me rezultat pothuajse të barabartë. Përderisa Isa Mustafa ka mbizotëruar me shkathësitë e tij gjuhësore me një dallim prej 2 për qind, Shpend Ahmeti e ka fituar garën zgjedhore, duke marrë 2 për qind më shumë vota sesa Isa Mustafa.

Në interes të këtij punimi janë analizuar edhe katër intervista në “Zëri i Amerikës”, si shpalosje e programeve zgjedhore të përfaqësuesve të katër partive garuese në zgjedhjet nacionale të vitit 2014, përkatësisht Isa Mustafa (LDK), Albin Kurti (Vetëvendosje), Ramush haradinaj (AAK) dhe Fatmir Limaj (Nisma). Është planifikuar monitorim dhe analizë edhe e intervistës së paralajmëruar të Hashim Thaçit (PDK), por intervista nuk është bërë fare. Intervistat kanë pasur një kohëzgjatje përafërsisht të barabartë dhe janë moderuar nga gazetari Besim Abazi, në pajtim me kodet etike dhe standardet profesionale të “Zërit të Amerikës”.

<b>Isa Mustafa</b>	<b>Albin Kurti</b>	<b>Ramush Haradinaj</b>	<b>Fatmir Limaj</b>
1381	2000	1109	1277

*Tab. 11*

Nga tabela 11 mund të shihet se nga sa fjalë kanë përdorur katër subjektet e hulumtuara, por fokusimi në këto intervista nuik ka qenë të leksiku mendor, por te shpërfaqjet ideologjike të këtij leksiku mendor, sidomos në frekuencën e përdorimit të disa fjalëve që i kemi konsideruar si markerë ideologjikë.

Fjala më e përdorur është fjala dhe, ndërkaq e dyta është fjala për. Në mesin e 15 djalëve më së shpeshti të përdorura, kryesisht ka lidhëza, prafjalë, folje ndihmëse, pra fjalë që më shumë janë mjete gramatikore sesa njësi leksikore me kuptim të pavarëur apo bartëse të kuptimit. Për shembull te Isa Mustafa në mesin 15 fjalëve më të përdorura nuk ka asnjë njësi leksikore me kuptim të mëvetësishëm, përvec akronimit LDK, te Albin Kurti, është përdorur vetëm fjala Kosovës (13 herë), Ramush haradinaj e ka përdorur 8 herë fjalën vendit,, 7 herë fjalën qeverisës dhe 6 herë fjalën Kosovë, ndërsa Fatmir Limaj e ka përdorur 12 herë fjalën qytetar-ë-ve, 18 herë fjalën Kosovë-s, 10 herë emrin e partisë së tij (NISMA). Nga këtu del se Haradinaj dhe Limaj kanë qene më konkret në fjalimet e tyre dhe si parti me jo shumë gjasa për të siguruar shumë vota kanë operuar me një set të caktuar ideologjik më të fokusuar kah atraktimi i qytetarëve për t’i votuar si parti me orientime konkrete. Gjithashtu, Fatmir Limaj dhe Isa Mustafa janë ata që e kanë përdorur emrin e partisë së tyre në mesin 15 fjalëve më të përdorura, përkatësisht Isa Mustafa e ka përdorur 10 herë (LDK), po aq sa edhe Fatmir Limaj emrin Nisma. Kjo tregon për një orientim më të qartë ideologjik të këtyre dy subjekteve të hulumtuara.



	<b>Isa Mustafa</b>	<b>Albin Kurti</b>	<b>Ramush Haradinaj</b>	<b>Fatmir Limaj</b>
1	Dhe 35	Dhe 51	për 37	Dhe 48
2	Edhe 33	Për 39	dhe 21	për 30
3	Kemi 27	është 26	kemi 17	një 26
4	Për 20	Nuk 26	edhe 14	është 20
5	Një 19	edhe 22	është 14	kemi 15
6	Është 14	Një 19	një 13	kjo 12
7	Shumë 12	Pra 17	pra 11	duke 12
8	Cilat 12	Por 16	nuk 9	qytetarë 12
				ve
9	Por 10	kosovës 13	por 9	Ndaj 11
10	Nga 10	Kanë 12	vendit 8	Kosovës 18
11	Unë 10	nga 11	unë 8	Nisma 10
12	Ldk 10	qind 11	qenë 8	Nuk 9
13	Sepse 8	shumë 10	qeverisës 7	tonë 8
14	Ashtu 8	jetë 10	kosovë 6	edhe 7
15	Pasur 8	mund 10	ashtu 5	ajo 6

Tab. 12

Lidhur me markerët ideologjikë, Albin Kurti del shumë më i konsoliduar sesa rivalët e tij politikë (tab.13). Ai, 31 fjalët që i kemi supozuar si markerë të mundshëm ideologjik, i ka përdorur 137 herë, kundrejt Isa Mustafës që i ka përdorur 97 herë, Fatmir Limajt 91 herë dhe Ramush Haradinajt që i ka përdorur 73 herë. Fjala më e përdorur nga Kurti është fjala shtet me 29 herë dhe fjala Serbi me 21 herë, ndërkaq Ramush haradinaj e përdor 19 herë fjalën qeveri, përderisa Isa Mustafa e përdor 17 fjalën qeveri/qeverisje/qeveritar, po aq sa fatmir Limaj e ka përdorur fjalën qytetar<sup>2</sup>, ndërsa fjalën qeveri e ka përdorur 13 herë. Kjo tabelë nxjerr se Albin Kurti dëshmohe më i konsoliduar në planin ideologjik me një përqendrim në markerë të caktuar, ndërkohë që të tjerët janë më të pakonsoliduar në këtë plan. Kurti është i përqendruar të fjalët shtet, Serbi dhe dialog, ekonomi e Shqipëri që flet për një ideologji ambicioze të orientuar qartësisht dhe me një qasje agresive kah përmbushja e synimeve. Shpërfaqja ideologjike e subjekteve të tjera të hulumtuara është më relative dhe më e papërcaktuar. Më i çliruar nga gjuha e ideologjisë del Ramush Haradinaj, ndërkohë që Limaj e Mustafa tregohen shumë të kujdesshëm në planin ideologjik, duke ndërtuar një strategji të moskonfrontimit, duke u thirru në ligj dhe duke mos qenë përjashtues.

<sup>2</sup> Dallimet ndërmjet tab. 12 dhe tab. 13 ekzistojnë për shkak se në tabelën 12 janë matur fjalët ashtu siç kanë qenë, ndërkraju në tab.13 janë matur të gjitha lekset bashkë.

<b>Fjala</b>	<b>Isa Mustafa</b>	<b>Ramush Haradinaj</b>	<b>Fatmir Limaj</b>	<b>Albin Kurti</b>
Abuzim	1	1	0	0
Ardhm-e-ëri	6	2	0	1
Barazi	0	0	0	2
Bashkim	1	1	0	3
demokraci	5	0	1	4
Dialog	4	1	1	13
/bisedime				
Drejtesi (te drejta)	4	1	5	6
Ekonomi	4	6	9	9
Evropë	2	1	0	0
Funksion-on- im	1	0	0	0
Gjyqësor	2	0	1	0
Institucion	1	4	7	1
Integrim	2	2	1	5
Koalicion	1	2	0	0
korrupsion		8	0	
Krim	1	0	0	2
Ligj	7	0	10	5
Mision	0	0	0	2
Ndërtim	0	1	1	0
Parti	6	2	1	1
Politikë	6	3	8	3
Popull-si	0	0	0	2
Punë-oj-uar	9	2	5	2
Qeveri-tar-sur	17	19	13	8
Qytetar	5	10	17	7
Rrëzim	0	0	0	0
Serb-i	3	4	0	21
Shqipëri	0	0	0	8
Shtet	7	0	10	29
Tash	1	3	1	3
Uzurpim	1	0	0	0
	97	73	91	137

Tab. 13

Të dhënat e nxjerra nga hulumtimi mbi leksikun mental dhe ideologjinë në gjuhën e politikanëve gjatë fjalimeve të tyre në fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet nacionale japin dëshmi të mjaftueshme për shpërfaqjet ideologjike në gjuhën e përdorur nga ata. Markerët ideologjikë janë në përorthje edhe më orientimet e deklaruar ideologjike të këtyre partive politike, sidomos Vetëvendosje e LDK, ndërkohë që shpërfaqjet ideologjike të AAK dhe Nisma janë më të vakëta dhe në raport me zhvillimet aktuale në këto dy parti që në kohën e këtyre intervistave kanë kaluar nëpër një fazë konsolidimi, pa ide të qarta për të ardhmen e tyre. Duke qenë parti më të vogla politike, ato nuk ka synuar asnjëherë realisht që të sigurojnë numrin kritik të votave për të udhequr qeverinë, por nuk e kanë përjashtuar veten si letra të rëndësishme e madje vendimtare për koalicionet paszgjedhore. Ky synim shpërfaqet me orientimin jo mjaft të qartë ideologjik dhe mungesën e agresivitetit për shpërfaqjen e ideologjisë përmes gjuhës.

### **Bibliografia:**

1. Fairclough, Norman, *Language and Ideology*, Trab.Ling.Apl., (17):113-131, Jan./Jun. 1991,p.118
2. Fulcault, M, *History of sexuality, vol. 1, Penguin Books, 1981:101*
3. Heath S., SB. (1977). Social history. In *Bilingual Education: Current Perspectives*. Vol. 1: Social Science, pp. 53--72. Arlington, VA: Center for Applied Linguistics
4. Van Dijk, T., *Ideology, a multidisciplinary approach*, 1998, London, Sage
5. Van Dijk, T., *Politics, Ideology and Discourse*, 2006, Elsevier
6. Wodak and Weiss , *Visions, ideologies and utopias in the discursive construction of European identities: Organizingm representing and legitimizing Europe*, *Communication ideologies, Language discourse and Social Practice*, Frankfurt am Main: Peter Lang, 225:252, 2004
7. Wodak, Ruth *Language nd Ideology – Language in Ideology*, *Journal of Language and Politics*, 2007, 6:1
8. Wolard K., Schieffelin, B., *Language Ideology*, *Annual Review of Anthropology*, 1994, 23:55-82



Anila OMARI

## IDEJA KOMBËTARE NË THEMEL TË PËRPPJEKJEVE PËR NJË GJUHË TË PËRBASHKËT LETRARE SHQIPE

Qysh në periudhat e hershme të zhvillimit historik të kombit shqiptar ekzistonte mes fiseve të ndryshme të shqiptarëve ideja e një etniciteti të përbashkët, të përkufizuar nga disa faktorë si gjuha, doket e institucionet zakonore, të dallueshme nga ato të popujve të tjerë që i rrethonin.<sup>1</sup> Këtë tipar karakteristik të shqiptarëve e ka vënë në dukje edhe studiuesi i njohur i kombeve dhe nacionalizmave Erich Hobsbawm, i cili e cilëson popullin shqiptar si popull me vetëdije protonacionale të padiskutueshme.<sup>2</sup> Domethënës është edhe pohimi i Sami Frashërit: “Shqipëtarëtë, më tepër se çdo komp, e duanë e e nderojnë kombin’ e mëmëdhen’ e tyre”.<sup>3</sup> Kjo vetëdije etnike u zhvillua edhe në ballafaqim me popujt e tjerë fqinjë ballkanikë, si grekët e sllavët, dhe arriti një shkallë të lartë në periudhën e Skënderbeut, i cili u bë faktor bashkues dhe identifikues i shqiptarëve edhe në shekujt pasardhës.

Gjuha ka qenë ndër shqiptarët më shumë se në cilindo popull tjetër të Ballkanit faktori kryesor identifikues përbashkues (“Shën]e kombërisë është gjuha”, thoshte Sami Frashëri<sup>4</sup>). Megjithatë gjuha shqipe për mijëra vjet mbeti në nivelin e gjuhës së folur, në kushtet e një tradite shumëshekullore universale të përdorimit të gjuhëve ndërkombëtare të mesjetës, latinishtes e greqishtes, si gjuhë komunikimi zyrtar edhe të formacioneve të para shtetërore arbërore si Principata e Arbërit. Fillimet e shkrimit të shqipes u përcaktuan nga gërshetimi i një vargu rrethanash historike e kulturore të jashtme e të brendshme. Shekulli XVI është shekulli kulmor i Rilindjes evropiane dhe

---

<sup>1</sup> Khs. më gjerësisht për këtë çështje R. Memushaj, “Faktorët identifikues të Kombësisë shqiptare”, në: *Giorgio Castriota Scanderbeg e l'identità nazionale albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 2009, f. 184-199.

<sup>2</sup> E. Hobsbawm, *Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780*, Campus Verlag, Frankfurt/New York, 2. Auflage 1992, f. 86. Shih edhe R. Memushaj, “Faktorët identifikues të Kombësisë shqiptare”, art. i cit., f. 193.

<sup>3</sup> S. Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë, në: Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 53-54. (Botuar së pari në Bukuresht, 1899).

<sup>4</sup> S. Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë, në: Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 36. (Botuar së pari në Bukuresht, 1899).

njëkohësisht i lëvizjes politiko-fetare të Reformacionit që lëkundti pozitativ e latinishtes si gjuhë e Shkrimeve të Shenjta të Kishës katolike dhe shënoi fillimin e përkthimeve biblike në gjuhët popullore. Brenda vendit ishin rrethanat e pushtimit osman me rrezikun e përhapjes së fesë së tij që rizgjuan elementet e vetëdijes kombëtare dhe nxitën nevojën e ruajtjes së krishtërit nëpërmjet propagandimit të fesë në gjuhën e vendit. Çështja e ruajtjes së fesë ishte e lidhur ngushtë me atë të trojeve të të parëve, që për atë fazë parakombëtare të formimit të kombit shqiptar ishin një koncept i pandarë<sup>5</sup>. Bjerrja e fesë, dhe, bashkë me të, edhe e lirisë, shihej nga elita e arsimuar e asaj kohe si një pasojë e padijes, një plagë e përhershme e shoqërisë shqiptare, dhe prandaj përpjekjet e tyre u përqendruan në përhapjen e dijes në gjuhën e vendit. Përpjekjet e autorëve të qarkut kulturor katolik verior të shekujve XVI-XVIII për lëvrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe janë faktorë që ndikuan në ngjizjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve në periudhën para Rilindjes kombëtare. Këtu i gjejmë edhe premisat e idesë së mëvonshme të një gjuhe të përbashkët letrare shqipe, e lidhur ngushtë me ngritjen e vetëdijes kombëtare. Autorët e vjetër shkruan në një gjuhë që nga një anë i kapërcente kufijtë nëndialektorë të të folmeve të tyre të veçanta, dhe kjo u bë edhe me vetëdije, siç na kumton shprehimisht njëri prej tyre, Pjetër Bogdani, për t'u pranuar nga publiku "letrar" i kohës, por nga ana tjetër edhe në një bazë dialektore që asokohe përfshinte një hapësirë të gjerë nga verilindja në veriperëndim, pra ishte një lloj koineje veriore e përzier me trajta dialektore, siç e përcaktoi Çabej gjuhën e 'Mesharit' dhe që Desnickaja e zhvilloi më tej me idenë e "koinesë gojore mbidialektore të Veriut", e cila përmbante edhe trajta konservative të afërta me toskërishten. Krahas zgjerimit të bazës dialektore të veprave të tyre, autorët e vjetër bënë dhe një punë krijuese të jashtëzakonshme për të dhënë në shqip idetë e konceptet diturore të gjuhëve kulturore me traditë të lashtë letrare, duke krijuar në këtë mënyrë traditën letrare të qarkut kulturor-fetar të Veriut. Puna e tyre për pasurimin e gjuhës letrare nëpërmjet rigjallërimit të leksikut të vjetër vendas ("fjalëve plaka") dhe krijimit të njësie të reja leksikore është e ngjashme me atë të rilindasve. Veprat e autorëve të vjetër nuk patën përhapje të kufizuar vetëm në arealin verior të hapësirës shqiptare. Ato me gjasë u njohën edhe në jug të vendit, të paktën për sa dimë nga dëshmitë për Doktrinën e Budit. Kur misionari bazilian Neofit Rodinoi në vitin 1637 i kërkoi Propagandës Fide të botojë një Doktrinë të krishterë që po përkthehej në shqip nga prifti Dhimitër për shkollën e Dhërmiut, ai mori përgjigjen se Doktrina ishte botuar shqip dhe mund t'i dërgonte disa kopje nëse dëshironte. Me

5 Khs. për konceptin "fe e atdhe" në shekujt e parë të pushtimit osman E. Çabej, "Pesëqindvjetori i shkrimit shqip. Kuvendi kishtar i Matit i vitit 1462 dhe Formula e Pagëzimit", në Studime Gjuhësore VI, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 342.

siguri në këtë rast bëhej fjalë për Doktrinën e Budit që sapo ishte ribotuar nga Propaganda në vitin 1636.<sup>6</sup>

Në periudhën e konsolidimit të sundimit osman pas dështimit të Aleancës së krishterë në luftën me Perandorinë osmane (1683-1699) tradita gjuhësore-letrare e shkrimeve fetare në Veriun katolik të Shqipërisë bie fashë, edhe pse nuk shuhet, gjatë shekullit XVIII, ndërsa gjuha shqipe na dëshmohej si gjuhë e korrespondencës së klerikëve shqiptarë me Papatin.<sup>7</sup>

Në gjysmën e dytë të shek. XVIII, në një fazë zhvillimi ekonomik dhe qetësimi të trazirave antiosmane që u shoqërua edhe me përhapjen masive të islamizmit në trojet shqiptare, vetëdija kombëtare në dukje e fjetur e etnosit shqiptar gjen shprehje në traditën letrare shqipe të qarkut kulturor ortodoks të Shqipërisë së Mesme me qendër në Elbasan. Në këtë areal u zhvillua edhe kisha ortodokse nën juridiksionin e Patrikanës me qendër në Ohër deri në vitin 1769, kur u zhvendos në Stamboll. Disa nga klerikët më të shquar të kësaj kishe ishin formuar në Akademinë e famshme të Voskopojës, që frymëzohej nga iluminizmi evropian dhe ndikoi në formimin e identitetit kombëtar të popujve të Ballkanit. Për dy nga emrat më të njohur të dalë nga kjo shkollë, Grigori i Durrësit dhe Teodor Haxhifilipi, ka dëshmi se kanë luajtur një rol të dorës së parë në lëvrimin e letërsisë biblike në gjuhën shqipe. Sipas autorit grek të shek. XVIII, Jorgo Zavira, Grigori përktheu Dhiatën e vjetër dhe Dhiatën e re, me shkronja shqipe që i shpiku vetë, të paktën më se gjysmë shekulli para përkthimit të Dhiatës së Re nga Vangjel Meksi e Grigor Gjirokastriti. Dhaskal Todri po ashtu, siç dëshmon Hahni, thuhet se ka përkthyer të dy Dhiatat, me një alfabet të posaçëm, të shpikur ose të sjellë prej tij në Elbasan. Për fat të keq dorëshkrimet e këtyre përkthimeve kanë humbur pa gjurmë ose janë shkatërruar, siç njofton Hahni për shkrimet e Todrit. Megjithatë janë ruajtur disa fragmente nga shkrimet e Todrit dhe sidomos një dorëshkrim anonim elbasanas, ndoshta nga një Teodor Bogomili, sipas Shuteriqit. Ajo që ka rëndësi të theksohet për traditën letrare elbasanase është pohimi i Hahnit se Dhaskal Todri u mor me krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët për të dy

---

<sup>6</sup> Shih Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005, f. 185 v.

<sup>7</sup> P. sh. letra e Gashit (1689), botuar nga Peter Bartl & Martin Camaj, "Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689", në: *Zeitschrift für Balkanologie*, nr. 5, 1967, f. 23-33; letra e fretënve të Pultit (1761), botuar nga Bardhyl Demiraj & Peter Bartl: *La lettera dei frati di Pulati (1761), il suo sfondo storico ed il suo posto nella cultura della scrittura albanese*, në: "Nordalbanien – L'Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekanntem Teil Europas" (Hrsg. Monica Genesin & Joachim Matzinger) Hamburg 2009, f. 63 –79; letrat e Zef Skiroit (ndoshta 1746) botuar nga B. Demiraj, *Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, në: "Studime" 12 [2005] 67 – 97, Prishtinë 2006.

dialektet e shqipës, aq të ndryshëm nga njëri-tjetri<sup>8</sup>. Sipas këtij pohimi do të kishim përpjekjen më të hershme për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe, që do t'i paraprinte me një shekull ideve të Rilindjes kombëtare. Rajko Nachtigall e ka shtyrë më tej kontributin atdhetar të Teodor Haxhifilipit duke hedhur idenë se ai ka dashur të krijojë një kishë kombëtare shqiptare, ideja e së cilës jetonte ende në Elbasan deri në kohën kur ai e vizitoi qytetin (1917)<sup>9</sup>. Në këtë mënyrë ai vendos një paralelizëm mes veprimtarisë së Todrit dhe asaj të Dositej Obradovićit për sllavët e jugut dhe Adamant Koraisit për grekët, të cilët, nën ndikimin e iluminizmit perëndimor të shkollave më progresiste të Gadishullit dhe në një kontekst kulturor-historik të përbashkët ballkanik, përdorën gjuhën popullore në letërsi duke u bërë themeluesit e gjuhëve letrare të popujve të tyre me bazë gjuhën e folur.<sup>10</sup> Nga fragmentet e shkrimeve të Todrit të gjetura në manastirin e Shingjonit pranë Elbasanit dhe të botuara nga studiues të ndryshëm, si Hahni Geitleri, Pekmezi, Nachtigalli, Lef Nosi, Dh. Shuteriqi, mund të gjykojmë për dialektin e përdorur nga Todri, i cili sipas Hahnit duket shumë i purifikuar dhe i afruar me toskërishten, në dallim nga disa poezi gegërisht që gjendeshin në një fletore tjetër.<sup>11</sup> Analiza e gjuhës së Todrit nxjerr në pah bazën dialektore gego-jugore të Elbasanit, me lidhje të shumta me toskërishten.<sup>12</sup> Por këto përkime me toskërishten duken të jenë karakteristika të një faze më të vjetër të gegërishtes jugore të Elbasanit sesa një përzjerje e vetëdijshme me qëllim krijimin e një gjuhe të përbashkët. Tipare të ngjashme me karakteristika të të dy dialekteve shfaq edhe gjuha e Dorëshkrimit anonim të Elbasanit, e cila paraqet veçori më arkaike se gjuha e Todrit, që nga një anë përkojnë me veçoritë gjuhësore të teksteve të vjetra të Veriut, dhe nga ana tjetër me tiparet e toskërishtes së vjetër.<sup>13</sup>

Pavarësisht nëse kjo përzjerje gjuhësore është bërë me vetëdije ose jo, atë e ka lehtësuar fakti që e folmja e Elbasanit, në fazat më të vjetra, ishte shumë më pranë toskërishtes nga ç'është sot.

Nga ana tjetër kanë luajtur rol edhe bashkëveprimet ndërdialektore në zonën ekonomiko-tregtare dhe kulturore, që në shekullin XVIII përfshinte një hapësirë të

8 J. Georg von Hahn, vep. cit., f. 296.

9 R. Nachtigall, *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache*, Graz, 1917, f. 15.

10 R. Nahtigal, "O elbasanskem pismu...", art. i cit., f. 180-181.

11 J. G. von Hahn, vep. cit., f. 298, shën. 1.

12 Shih më hollësisht për gjuhën e Todrit Dh. Shuteriqi, "Dhaskal Todhri", *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr. 4, 1954; A. Omari, "Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe", në: *Një rilindje para Rilindjes*, Konferencë shkencore albanologjike, Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, 2014, f. 250-252.

13 Shih më hollësisht për gjuhën e Anonimit A. Omari, "Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe", art. i cit., f. 252-254.



pandërprerë nga Durrësi e Elbasani në veri e deri në Follorinë e Janinë në jug<sup>14</sup>. Me këto ndikime ndërkrainore dhe me traditën shkrimore me bazë gegërishten e Elbasanit shpjegohen edhe gegizmat në tekstet shqip të Kavaliotit e të Danil Voskopojarit apo të Nektar Terpos<sup>15</sup>. *Një lidhje e autorit të Anonimit të Elbasanit me Voskopojën na dëshmohet nga një* përkim interesant leksikor që vihet re në tekstin e Anonimit dhe në fjalorin e Teodor Kavaliotit<sup>16</sup>: është fjala për neologjizmin *kullotës* “bari”, që s’e kemi hasur gjëkund tjetër.

Përppjekjet për shkrimin e shqipes me alfabetë të posaçme në shek. XVIII dhe për kthimin e shkrimeve fetare në shqip, me synimin për t’u shkëputur nga ndikimet e huaja dhe për të afirmuar liturgjinë fetare në gjuhën kombëtare, natyrisht duhen konsideruar shfaqje të vetëdijes kombëtare shqiptare mjaft kohë përpara Rilindjes<sup>17</sup>. Në këtë mes nuk është pa domethënie fakti se alfabeti original për shqipen që shpiku Todri shërbeu në shek. XIX në Elbasan si shenjë e shqiptarizmit të atyre që e përdornin, në dallim nga përkrahësit e kishës greke që përdornin shkronjat greke, dhe si një kërkesë për të afirmuar më mirë gjuhën shqipe si një gjuhë e veçantë dhe popullin shqiptar si i dalluar nga të tjerët<sup>18</sup>.

U ndalëm pak më gjatë në traditën shkrimore të shek. XVIII për të theksuar faktin se ky shekull nuk ishte shekulli i përgjumjes kombëtare, por paraprijësi dhe ndriçuesi i rrugës drejt Rilindjes Kombëtare të shekullit XIX. Gjithsesi vetëm në këtë shekull u zhvilluan dhe poqën në mënyrën më të plotë kushtet ekonomike-shoqërore, historike, politike e kulturore që bënë të mundur ngjizjen e ideologjisë kombformuese shqiptare, që vendoste në plan të parë vlerat kombëtare mbi partikularizmat krahinore e fetare. Për arsye të zhvillimit më të madh ekonomik e kulturor të vendit ku kishin gjetur strehë prej qindra vjetësh, këto kushte u poqën më herët tek arbëreshët e Italisë, prej të cilëve dolën edhe disa nga nismëtarët e Rilindjes kombëtare shqiptare. Krahas me traktatet për identitetin historik-kulturor, antropologjik e gjuhësor të arbëreshëve si popull i ndryshëm nga grekët, me të cilët shpesh herë i ngatërronin për shkak të përkatësisë së njëjtë fetare, ndër dijetarët arbëreshë u artikulua më herët edhe ideja e një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kjo ide, në fillim pas gjase e kufizuar për rrethet letrare arbëreshe, duket se kishte zënë rrënjë që në shekullin XVIII tek

---

<sup>14</sup> Xh. Lloshi, “W. Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe”, studim hyrës në: W. Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, vep. cit. f. 68 v.

<sup>15</sup> Shih Xh. Lloshi, “W. Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe”, studim hyrës në: W. Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, vep. cit. f. 67-71 e vijim.

<sup>16</sup> Shih për fjalorin e Kavaliotit Shuteriqi, Tekstet shqipe, vep. cit., f. 303.

<sup>17</sup> Khs. edhe R. Elsie, “Dorëshkrimi elbasanas i Ungjijve, 1761, dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar”, Studime, nr. 1, ASHAK, Prishtinë, 1994, f. 134.

<sup>18</sup> Dh. Shuteriqi, “Anonimi i Elbasanit”, art. i cit., f.47.

arbëreshët intelektualë, të cilët me lëvrimin e letërsisë së tyre e ngritën gjuhën shqipe jo vetëm në rangun e një gjuhe “poetike”, me tekstet e Nikollë Brankatit, Nikollë Filjes, Nikollë Ketës, por edhe të një gjuhe “zyrtare”, p.sh. me letrat në shqip e latinisht të Imzot Zef Skiroit drejtuar Papës, apo në tekstet teologjike e doktrinare të hartuara nga Nikollë Keta. Këto tekste shpërfaqin një gjuhë letrare shqipe mbidialektore, të përzier me elemente të toskërishtes, gegërishtes dhe toskërishtes arbëreshe dhe të pastruar nga ndikimet dialektore dhe ato italiane, me tiparet e një koineje të komunikimit të shkruar.<sup>19</sup> Por në mënyrë të vetëdijshme dhe të argumentuar kjo ide u shpreh së pari nga gjuhëtari i shquar Dhimitër Kamarda në vitin 1866, kur shtroi nevojën për një gjuhë të përbashkët për të gjithë kombin shqiptar, me perspektivën për t’u bërë ajo një ditë edhe gjuhë letrare<sup>20</sup>. Kamarda e ka të qartë se gjuha letrare duhet të mbështetet mbi një bazë dialektore të caktuar, por sa më të gjerë e të kuptueshme për të dy dialektet e shqipes. Ai mendon se ekziston një hapësirë gjuhësore qendrore ku takohen e përzjehen të dy dialektet e shqipes, hapësirë që shkon nga lumi Shkumbin deri në Vjosë, e folmja e së cilës do të ishte më e përshtatshme për t’u bërë gjuhë e përbashkët<sup>21</sup>. Në të njëjtën periudhë kohore flamurtari i Rilindjes kombëtare De Rada kishte përpunuar idenë e një gjuhe letrare për të gjithë arbëreshët dhe shqiptarët, edhe pse e shihte këtë gjuhë të e folmja e shkruar e arbërishtes së Kalabrisë, pra të gjuha që përdorte ai.<sup>22</sup> Ai e shihte studimin e gjuhës si mjet bashkimi të shqiptarëve dhe të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, prandaj punoi me ngulm për promovimin e gjuhës shqipe me botime të ndryshme për lashtësinë e saj, për gramatikën dhe alfabetin, me organizime kongresesh gjuhësore e me ngritjen e katedrës së gjuhës shqipe në Napoli. Në themel të idesë së vet rilindase ai kishte krijimin e një letërsie kombëtare shqipe të cilën u mundua ta krijonte vetë duke u nisur nga modelet e poezisë popullore dhe duke u përpjekur ta përpunojë këtë gjuhë me synimin për të krijuar një gjuhë letrare.

Jo shumë vite më vonë, në 1877, një kërkesë të ngjashme do ta shtrojë mendimtari dhe atdhetari i spikatur pararendës i Rilindjes, Zef Jubani, i cili u dallua edhe në fushë të gjuhës me krijimin e një alfabeti, hartimin e një gramatike dhe me mendimet për një gjuhë letrare të përbashkët. Ai e shtron drejt çështjen e alfabetit të

<sup>19</sup> Shih M. Mandalà, “Introduzione”, në: P. Giorgio Guzzetta, *L’osservanza del rito presso gli Albanesi d’Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, Palermo, 2007, f. 25.

<sup>20</sup> D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866, Discorso preliminare, f. IV.

<sup>21</sup> D. Camarda, po aty, Discorso preliminare, f. V.

<sup>22</sup> Shih A. Kostallari, “Rreth një pikëpamjeje të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar”, *Studime Filologjike*, nr. 3, 1981, f. 33-46; J. Kastrati, *Studime për De Radën*, Gjonlekaj Publishing Co., New York, 2003, f. 71, -72.

përbashkët për të gjithë shqiptarët i cili nuk mund të vlejë si i tillë “pa u vendosur nga një mbledhje e letrarëve shqiptarë dhe arbëreshë”.<sup>23</sup> Ky alfabet do të shërbejë si mjet që gjuha shqipe të ketë letërsinë e vet me parime të përshtatshme për natyrën e saj<sup>24</sup>. Mbi këtë bazë filologët do të mund të dallojnë dialektet e ndryshme e të shumta të shqipes dhe duke i krahasuar, të vlerësojnë njërin prej tyre si më i përshtatshmi për të qenë i parë. Me këtë kërkesë Jubani shtron nevojën e një gjuhe të përbashkët letrare për të gjithë shqiptarët dhe në këtë çështje, ashtu si në shumë të tjera që lidhen me vizionin e tij për të ardhmen e kombit shqiptar, është në pararojë ndër shqiptarët e trojeve kompakte shqiptare.<sup>25</sup>

Veprimtarët e Rilindjes kombëtare i përqendruan përpjekjet te përhapja e letërsisë dhe arsimit në gjuhën shqipe si mjetin kryesor për forcimin e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve. Në fjalorin rilindas termat gjuhë dhe komb ishin një binom i pandarë. Në këtë periudhë u artikuluan më qartë idetë për një gjuhë letrare për të gjithë shqiptarët. Rilindasi i madh, Sami Frashëri, duke vënë theksin te ruajtja e gjuhës amtare si mjeti kryesor i ruajtjes së identitetit kombëtar,<sup>26</sup> i mëshon njëkohësisht shkrimt të gjuhës, si detyra parësore që duhet të kryejë një komb për të ruajtur kombësinë e tij<sup>27</sup>. Në vizionin e tij për të ardhmen e kombit shqiptar ai parashikon edhe një gjuhë të përbashkët, e cila do të krijohet në kryeqytetin e ardhshëm të Shqipërisë me përzjerjen e të folmeve të ndryshme të banorëve të ardhur nga të katër anët e vendit dhe do të shërbejë si gjuha letrare e gjithë Shqipërisë.<sup>28</sup> Samiu, ashtu si dhe rilindasit e tjerë, i shihte si një komb i vetëm shqiptarët gegë e toskë, madje si një nga kombet më të vjetër të Evropës e të botës, dhe për sa i përket gjuhës, ata “flasnin një gjuhë me fort pakë të ndruarë, të cilët do të ngrihet fare për s’afri duke ndërtuarë

---

<sup>23</sup> Z. Jubani, letër drejtuar J. De Radës, Trieste, 17 prill 1871, *Vepra të zgjedhuna*, Tiranë, 1966, f. 157 (përkthyer nga J. Kastrati).

<sup>24</sup> Z. Jubani, “Kundërime mbi gjendjen morale e mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar”, në *Vepra të zgjedhuna*, vep. cit., f. 79 (përkthyer nga J. Kastrati).

<sup>25</sup> Shih A. Omari, “Figura të shquara katolike me vizion kombëtar në çështje të gjuhës: nga Zef Jubani te Luigj Gurakuqi”, *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Shkodër, 2013, f. 51-59.

<sup>26</sup> “çço komp mbahetë me gjuhët; ata njerës, që harojnë a lënë gjuhën e tyre e flasnin një tjetër gjuhë, me kohë bëhenë njerëzit’ e atij kombi q’i flasnin gjuhënë e dalinë nga kombëri’e tyre.”, S. Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë...”, *Vepra 2*, vep. cit., f. 36.

<sup>27</sup> Shih S. Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë...”, *Vepra 2*, vep. cit., f. 63. Khs. edhe f. 79: “M’e par’ e këtyre është gjuha; s’munt të ketë Shqipëri pa Shqipëtar, s’munt të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s’munt të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe e pa shkolla, në të cilat të mësohetë shqipja”.

<sup>28</sup> “ndënjësit’ e ti [këtij qyteti] do të jenë të mbledhurë nga gjithë anët’ e Shqipërisë, edhe gjuha që të flitetë atje, do të jet’ e përzjerë, që të muntnjë të quhetë gjuh’ e përgjithçime e gjuhë letrarishte e gjithë Shqipërisë”, Po ai, po aty, f. 85.

gjuha”.<sup>29</sup> Kështu ai parashikon se me përpunimin e gjuhës në letërsi, ndryshimet themelore midis dialekteve do të vijnë duke u rrudhur, deri në zhdukje.

Në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, si një fillesë formacioni shtetëror autonom shqiptar të krijuar nga ndërgjegjia kombëtare e shqiptarëve, doli si një nga nevojat më të ngutshme çështja e një alfabeti të njëzuar për shkrimin e shqipes, në mënyrë që të zhvillohej letërsia shqipe dhe arsimit kombëtar. Kjo nevojë u konkretizua me krijimin nga Komiteti i Stambollit të Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip (1879) me kryetar Sami Frashërin dhe anëtarë figurat kryesore të Lidhjes së Prizrenit. Shoqëria mori përsipër detyrën e drejtimit e të organizimit të përpjekjeve për të ngritur shkolla shqipe në gjithë vendin dhe për të zhvilluar me ritme më të shpejta letërsinë shqiptare, duke botuar tekste shkollore, vepra letrare, broshura shkencore e organe periodike shqipe. Hapi i parë që ndërmorën nismëtarët e Shoqërisë ishte krijimi i një alfabeti të përbashkët, gjë që u realizua me miratimin e projektit të Sami Frashërit, i quajtur alfabetit të Stambollit. Ky alfabet pati përhapje të gjerë dhe luajti një rol të rëndësishëm në lëvizjen kulturore shqiptare. Nga gjiri i Shoqërisë së Stambollit dolën edhe shoqata të tjera atdhetare-kulturore si klubet “Bashkimi” të cilët përpunuan edhe ata një alfabet të shqipes që u zbatua krahas me të parin dhe më vonë u miratua si njëri nga dy alfabetet për shkrimin e shqipes në Kongresin e Manastirit (1908).

Në këtë periudhë veprimtarët e Rilindjes shtruan nevojën edhe të një gjuhe të përbashkët. Në një letër që i drejton De Radës bashkë me Jani Vreton dhe Naim Frashërin, Sami Frashëri shkruante: “Lidhja Shqiptare kërkon bashkimin e Shqipërisë në një vilajet autonom”. Krahas bashkimit politik Samiu shtronte edhe çështjen e gjuhës së përbashkët: “Një gjuhë shqipe e pandame dhe e njëjtë na duhet se shumë gjuhë e dialekte sjellin ndarje e mërgim. Gjuha shqipe do të bëhet e begatë, e gjerë e do të shpëtonjë nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja dhe gjithë dialektet do të gjenden të bashkuara e të përzjera.”<sup>30</sup>

Gjithë veprimtaria gjuhësore e letrare e rilindasit Konstandin Kristoforidhi (1827-1895) do të përmbante në mënyrë implicite idenë e tij për gjuhën e ardhshme të përbashkët letrare shqipe. Si njohës i thellë i gjuhës amtare si në përhapjen e saj gjeografike-dialektore ashtu dhe në fazat e vjetra të saj, ai pasqyroi në Fjalorin e tij (1904) pasuri leksikore nga të gjithë dialektet dhe nga tekstet të vjetra të Budit, Bardhit e Bogdanit, duke vendosur një gur themeli në kodifikimin e gjuhës letrare shqipe. Për të njëjtin qëllim shërbeu edhe gramatika e tij e gjuhës shqipe (1882) e mbështetur në dialektin toskë. Me lëvrimin e gjuhës shqipe në të dy dialektet ai dëshmoi se mes tyre

<sup>29</sup> S. Frashëri, *Vepra* 2, vep. cit., f. 47.

<sup>30</sup> “Një letër e Sami Frashërit mbi Lidhjen e Prizrenit”, në Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, 1954, II, f. 114-116.

nuk ka dallime të mëdha dhe u përpoq për afrimin e tyre në shkrim. Ai zhvilloi edhe një punë të ngjeshur krijuese për pasurimin e fjalorit të shqipes me neologjizma të goditur.<sup>31</sup> Cilësimi që përdori ai për veten si “babai i gjuhës shqipe” tregon për veprimtarinë e ndërjegjshme të tij për themelimin e një gjuhe letrare shqipe.

Çështjen e gjuhës letrare shqipe do ta trajtonte më pas në mënyrë sistematike Faik Konica në revistën *Albania*, që në numrin e parë të saj më 1897, me rubrikën “Për themelin e një gjuhës letrarishtes shqip”.

Përfytyrimi i rilindasve për gjuhën letrare kombëtare shqipe ishte krijimi i saj nga një përzgjedhje e të folmeve të ndryshme krahinore, që do ishte produkt i punës krijuese të lëvruesve të gjuhës. Këtë ide e pati një kohë Kamarda, i ndikuar nga procesi i formimit të gjuhës letrare italiane, i cili përgatiti edhe një antologji me tekste të zgjedhura shqipe për të bërë të njohur modelet gjuhësore të anëve të ndryshme të hapësirës shqiptare.<sup>32</sup> Kamarda ndërmori madje edhe nismën vetjake për të krijuar një gjuhë të përbashkët letrare, mbidialektore, me rastin e përkthimit në shqip të një studimi të Dora D’Istrias, botuar në frëngjisht në vitin 1866<sup>33</sup>. Për këtë qëllim ai lexoi e studioi tekstat e vjetra shqipe dhe gjuhën tyre, si dhe gjithë çka ishte botuar në shqip deri në atë kohë<sup>34</sup>, dhe përdori atë lëndë dialektore që i dukej më e mira, më e fishtë e më e pastra shqipe.<sup>35</sup> Edhe Faik Konica në fillimet e revistës *Albania* kishte mendimin se gjuha letrare duhet krijuar me lëndën e nëndialekteve të ndryshme, sipas disa rregullave të caktuara.<sup>36</sup> Sipas kësaj ideje disa rilindas shkruanin në një gjuhë të përzier,

---

<sup>31</sup> Khs. Shaban Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1970, f. 56.

<sup>32</sup> Vepra *Appendice al saggio de grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866; khs. idetë e tij për gjuhën letrare shqipe në *Discorso preliminare*, f. VIII, XI.

<sup>33</sup> Dora D’Istria, “La nationalité albanaise d’après les chants populaires”, në: *Revue des deux mondes*, Paris, 1866.

<sup>34</sup> D. Camarda, *Prékallëzimë*, në: Dora D’Istria, *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*, enkëthyme në shkijpe përej D. Camarda, Në Livurnë, te tipografia e P. Vannini e të Biritë, 1867, f. X.

<sup>35</sup> Shih më hollësisht për gjuhën letrare të krijuar nga Kamarda A. Omari, “Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe”, art. i cit., f. 258-260.

<sup>36</sup> “Për themelin e një gjuhës letrarishtes shqip”, *Albania*, nr. 1, 1897, f. 4-5: “Është dhe vërtet që, veç munt Elbasanishtes, as një nënëgjuhë ka miaft qëruari për me u-lartuem në krye të tjerave. Andaj duhet të marim pakë nga të tëra nënëgjuhërat; dhe jo të marim si të bjerë, po mbas këtyre kanuneve...”. Më vonë Konica e ndryshoi disa herë mendimin e tij mbi formimin e gjuhës letrare kombëtare. Shih edhe Kristina Jorgaqi, hyrje studimore në: *Faik Konica, Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tiranë, 2006, f. 16.

si Jani Vreto<sup>37</sup>, Samiu dhe Naimi, vetë Konica në fillimet e revistës Albania, Luigj Gurakuqi<sup>38</sup> etj. Me kalimin e kohës, kur u bë e qartë se shkrimi i dialekteve në një nuk kishte gjasa të ndodhte në një kohë të parashikueshme, veprimtarët dhe filologët pasrindas ndërruan mendim lidhur me gjuhën e përbashkët të shkrimit dhe u përqendruan në një dialekt natyror si bazë e gjuhës së shkrimit, në hullinë e idesë së Zef Jubanit, të Kamardës e të Konicës për “gjuhën e mesme” ose të Elbasanit e rrethinave të tij si “e folmja më e bukur e më e pastër shqipe” dhe njëkohësisht si “urë midis dialekteve”, ku përziheshin elemente të të dy dialekteve të shqipes.

Megjithëse përpjekjet për krijimin e vullnetshëm të një gjuhe të përbashkët nga përzierja dialektore u treguan të pasuksesshme, përpjekjet e përbashkëta afatgjata të pararendësve të Rilindjes, të vetë rilindasve dhe të të gjithë shkrimtarëve të mëvonshëm që u ndikuan nga ideja e një gjuhe letrare mbidialektore me pjesëmarrjen e të dy kryedialekteve të shqipes, kontribuan në formimin e një gjuhe letrare të përpunuar e të pasuruar me lëndë gjuhësore nga e gjithë hapësira mbarëshqiptare. Në fund të fundit, siç thotë Çabej, këto qarqe parakombëtare, qarku letrar katolik, ai ortodoks dhe qarku italo-shqiptar, duke kontribuar secili me elementet e veta dhe pavarësisht nga njëri-tjetri, janë derdhur të gjitha në “lumin e literaturës nacionale të shek. XX”<sup>39</sup>.

Në një ndërlidhje e bashkëveprim të ngushtë shkak-pasojë, shkrimi i gjuhës shqipe, hapja e shkollave shqipe dhe përhapja e letërsisë në gjuhën shqipe nga fundi i shekullit XIX e fillimi i shek. XX patën një ndikim të jashtëzakonshëm në forcimin e idesë kombëtare që çoi në pavarësimin e Shqipërisë më 1912.

<sup>37</sup> Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, 1970, f. 63-66, 68-69v. Shih edhe O. Myderrizi, “Çështja e zanores ë në ortografinë tonë”, Buletin i USHT, nr. 4, 1955, f.220.

<sup>38</sup> Idetë e tij për gjuhën letrare Gurakuqi i shpreh në artikullin: Lek Gruda, “Për themelimin të një gjuhe letrare”, Albania, IX, 12, 132, 217, në *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes kombëtare shqiptare* (përmbledhje artikujsh nga shtypi), përg. nga Zihni Haskaj, vëll. I, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1971, f. 288.

<sup>39</sup> E. Çabej, “Për gjenezën e literaturës shqipe”, *Hylli i Dritës*, vjeti XV (1939), nr. 3-7, f. 180.

**Teuta ABRASHI**

## **GJUHËSIA SHQIPTARE DHE IDEOLOGJIA**

Gjuha, qoftë ajo artefakt apo një organ i sistemit kognitiv njerëzor, nuk mund të jetë indiferente nga rrjedhat shoqërore të një komuniteti. Kjo më së miri vërehet me praninë e elementeve leksikore, sidomos në ato shoqëri, te të cilat regjimi qeverisës përdor ideologjinë si instrument parësor drejtues. Këto shoqëri dallohen ngase klasa e tyre politike zakonisht me ndërtimin e dogmës së vet specifike duke u bazuar në një platformë të caktuar. Thënë ndryshe, ajo përpilon një grup të parimeve të përcaktuara nga autoriteti udhëheqës, si të vërteta të padiskutueshme. Të përpiluara në këtë mënyrë, ato medoemos japin nocione të reja. Në këtë kumtesë do të bëhet fjalë për gjuhësinë shqiptare në periudhën komuniste, në përjasje me gjuhësinë në disa shtete të bllokut të ashtuquajtur komunist, e sidomos me Gjermaninë (e atëhershme Lindore), por edhe me Çekoslovakinë, si njëra nga qendrat e gjuhësisë strukturaliste evropiane, e identifikuar me këtë epitete edhe para regjimit komunist. Mirëpo, në këtë kumtesë do të bëhet përjasja edhe me Bashkimin Sovjetik si epiqendër e ideologjisë komuniste, sepse siç do të shohim, lëvizjet ideologjike atje kishin efekte të drejtpërdrejta në shtetet e përmendura, e posaçërisht se atje platforma ideologjike ishte ndërtuar shumë më parë duke e përfshirë edhe gjuhësinë.

Çështja ideologjike në gjuhësi te vendet e tjera të bllokut lindor filloi pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pra pas vitit 1945. Të rikujtojmë se të gjitha vendet e bllokut komunist menjëherë pas luftës ishin politikisht e ushtarakisht shumë kompakte dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Secila nga këto vende merrnin modelet e gatshme nga Moska për t'i zbatuar ato në terren. Prandaj, për të kuptuar se çka ka ndodhur në atë kohë, të shohim së pari se çka ishte duke ndodh në Bashkimin Sovjetik.

Në Bashkimin Sovjetik mbizotëronte teoria gjuhësore e Nikolai Jakovleviç Marr-it, një profesor ky i universitetit të Leningradit (pra, Sant Petersburgut të sotëm) dhe anëtar i Akademisë të Bashkimit Sovjetik, i lindur në Gruzë, nga një martesë e përzier anglezo-gruziane. Me imigrimin e Trubeskoit, Jakobsonit etj. në Evropën perëndimore pas Revolucionit të Tetorit, Marr-i u bë figura më e spikatur e gjuhësisë

sovjetike. Ai e zhvilloi teorinë e tij kontroverse të quajtur Teoria Jafitetike<sup>1</sup>, të pagëzuar sipas figurës biblike të Jafetit dhe në vitet e 20 të shekullit të kaluar arriti të hapte Institutin Jafetik në Leningrad. Në fakt ai e përfitoi përkrahjen e plotë të partisë, sepse ai dhe mbështetësit e tij ia arritën të bindin udhëheqësinë e atëhershme sovjetike se teoria e tij ishte në përputhje me konceptin e marksizmit sovjetik. Pohimi esencial i Jafitelogjisë ishte se strukturat gjuhësore varen nga predispozitat kognitive të komuniteteve folëse në nivele të ndryshme të zhvillimit të tyre socio-ekonomik. Thënë ndryshe, pra në terminologjinë marksiste, kjo i bie se gjuha është komponentë e superstrukturës ideologjike që del drejtpërdrejt nga baza ekonomike. Edhe pas vdekjes së Marr-it më 1934, mbështetësit e tij ishin aktiv dhe teoria e tij e cila parashihte se të gjitha gjuhët e botës do të përfundonin në një gjuhë të vetme – pra, në gjuhën marksiste – ishte e paprekshme. Ata e mbështetnin këtë edhe me shkrimet e Paul Lafargue-t, një gazetar marksist, përndryshe dhëndri i Marksit, për grua kishte vajzën e tij të dytë: Laurën. Ky marksist doli me tezë se ndërmjet vitit 1789-1794, pra gjatë revolucionit francez, ndodhi edhe revolucioni gjuhësor dhe pohonte se ka dallim ndërmjet gjuhës frënge para dhe pas revolucionit, duke kaluar nga gjuha borgjeze në gjuhë popullore. Për rrethana sovjetike kjo do të thotë, nga gjuha borgjeze në gjuhë revolucionare gjegjësisht në gjuhën e proletariatit.

Padyshim se këto rrethana sovjetike lanë gjurmë edhe në Gjermaninë Lindore. Për të bërë zhvillimin progresiv, pra revolucionar të gjuhës gjermane, udhëheqësia e atëhershme kishin për qëllim të pengonin amerikanizimin e gjuhës gjermano-lindore. Gjithashtu, ata filluan ta largonin zhargonin nazist, i cili, sipas tyre, ende përdorej në Gjermaninë Perëndimore. Në këtë mënyrë, kujtonin ata, do të ndërtohej njëkohësisht edhe baza socialiste e popullit gjerman. Kjo pikëpamje çoi në të ashtuquajturën tezën katër-variante të gjuhës gjermane, sipas së cilës ekzistonin katër versioneve të ndryshme gjuhësore kombëtare të gjermanëve: versioni i Gjermanisë Lindore, Gjermanisë Perëndimore, Austrisë dhe Zvicrës. Kjo sidomos insistohej që të dëshmohet te gjuha e masave, pra medievet dhe shkrimeve të tjera zyrtare. Por, kjo duhej realizuar edhe me anë të njëjësive leksikore. Për këtë arsye u përpilua fjalori filozofik si një libër referent i përdorimit të fjalëve. Këtu, sa për ilustrim po jap se ç'thuhej për fjalën *spontanitet*:

*Spontanität darf nicht mit Selbsttätigkeit, Eigeninitiative usw. verwechselt werden.*

*Selbsttätigkeit und Eigeninitiative des sozialistischen Menschen hohen Niveaus ist nur auf*

<sup>1</sup> His name for this putative language family was Japhetic, after the Biblical figure of Japheth (<http://www.questia.com/magazine/1G1-181856921/stalin-marr-and-the-struggle-for-a-soviet-linguistics#/>)



*der Grundlage sozialistischer Bewusstheit möglich. Die Spontanität ist ein Wesensmerkmal aller vorsozialistischen Gesellschaftsformationen.*

*Thënë shqip: Spontaniteti nuk guxon të ngatërrohet me vetëveprimin dhe vetiniciativën. Vetëveprimi dhe vetiniciativa e njeriut socialist të një niveli të lartë është i mundshëm vetëm në bazë të vetëdijes së tij socialiste. Kurse, spontaniteti është një tipar i të gjitha formacioneve shoqërore parasocialiste.*

Tendenca për të krijuar gjegjësisht për të mbrojtur gjuhën vetanake gjermano-lindore çoi deri te themelimi i redaksionit DUDEN në Lajpcig, një institucion ky leksikografik i cili tradicionalisht kishte selinë e tij në Mannheim të Gjermanisë Perëndimore.

T'i qasemi tani Shqipërisë. Nëse kihen parasysh trendët e përgjithshme komuniste menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, dhe pikëpamja e atëhershme marksiste për gjuhën, atëherë nuk habit aq shumë fakti i dëgjimit të zërave për të ndërruar gjuhën zyrtare. Dialekti i Shqipërisë së Mesme konsiderohej si gjuhë e bejlerëve, prandaj ajo duhej zëvendësuar me një dialekt “progresiv”. Sidoqoftë, lidhur me problematikën e standardit nuk po vazhdojmë më tutje, por këtu po themi se ngjashëm si në Gjermaninë Lindore, edhe në Shqipëri filloi depërtimi i fjalëve të reja dhe eliminimi i fjalëve “të panevojshme” të zhargonit bejlerë.

Mirëpo, në fund të viteve të dyzeta kundërshtimi i teorisë së Marrit filloi të bëhet i zëshëm. Nisën edhe reagimet e para publike në gazetën Pravda, në formë të reagimit të lexuesve të saj. Këto reagime kulmuan me reagimin e vet Stalinit në qershor, korrik dhe gusht të vitit 1950. Ky fakt vetvetiu tregon se sa e fuqishme ka qenë doktrina e Marr-it në atë kohë, sepse u desh të përdorej autoriteti i vet diktatorit për ta rrëzuar. Stalini i hidhte poshtë kalimet revolucionare të gjuhës. Ajo nuk ishte komponentë e superstrukturës dhe atë nuk duhej rrënuar dhe ri-ndërtuar. Sipas reagimit të Stalinit, reagim ky i inskenuar në një formë të intervistës, me pyetje të shkurta dhe përgjigje të detajuara, të formuluar në mënyrë shumë të thukët, thuhej se gjuha dhe struktura e saj nuk mund të konsiderohen si një produkt i një epoke të caktuar. Struktura e gjuhës, gramatika e saj dhe fjalori bazë i saj, janë produkt i shumë epokave. Ato nuk mund të ndërrohen për një kohë të shkurtë, prandaj pohimi i Lafraguet nuk është i saktë. Struktura, gramatika dhe fjalori themelor i saj nuk mund të ndërrojnë për një periudhë 5 vjeçare. Lidhur me këtë ai merr shembull gjuhët e Ballkanit, të cilat i rezistuan turqishtes. Një ndër propositë e këtij shkrimi ishte po ashtu se qasja marksiste rreth gjuhës nënkupton se kalimi i gjuhës nga kualiteti i vjetër në një kualitet të ri nuk bëhet nëpërmjet eksplodimit, duke rrënuar atë të mëparshmen dhe

ndërtuar të renë, por teoria marksiste thotë se ky kalim bëhet duke akumuluar elementët e kualitetit të ri dhe rënies graduale të elementeve të vjetër.

Shkrimi i Stalinit, i kualifikuar si i moderuar, la hapur dyert për strukturalizmin. Ai bëri jehonë jo vetëm në bllokun e shteteve socialiste, por edhe në shtetet e bllokut perëndimor, duke përfshirë edhe Amerikën. Si rrjedhojë e këtij ndërimi të ideologjisë marksiste të gjuhësisë filloi depërtimi i strukturalizmit evropian e amerikan në bllokun e shteteve lindore, duke vazhduar këtë depërtim pa ndonjë rezistencë qenësore deri në vitet 70'ta. Kështu, në Pragë rifilloi shkolla strukturaliste duke zgjeruar teorinë Mateisusit dhe përvetësuar modelin sintaksor të Tesnierit, valencën dhe depedencën, që mund të dëshmohej me punimet e botuara të Dokulil dhe Daneš-it më 1958.

Në Gjermaninë Lindore strukturalizmi gjithashtu filloi të depërtonte. Përveç dritës së gjelbër të dhënë nga Moska ishin së paku edhe dy arsye të tjera që e mundësuan këtë. E para, në Akademinë e Shkencave në Berlin ishte edhe Wolfgang Steinitz, një hebre me botëkuptime shumë të thella komuniste, dhe njëkohësisht një përfaqësues i gjuhësisë moderne, i ndikuar nga Roman Jakobson, me të cilin ishte takuar gjatë kohës së internimit. Ai filloi ti mbledh disa gjuhëtarë të rinj entuziastë, siç janë Manfred Bierwisch, Wolfgang Motsch etj. për të filluar studimet dhe hulumtimet në gjuhësinë strukturaliste. E dyta, në Gjermaninë Perëndimore strukturalizmi nuk kishte depërtuar. Ai mund 'të ndihej' në mënyrë sporadike te disa individë, mirëpo prania e tij institucionale mungonte. Këtë e dëshmojnë studimet e shumta, qoftë rreth historisë së gjuhësisë gjermane, qoftë ato rreth studimit të strukturalizmit në Gjermani. Arsyet për depërtimin aq të vonshëm të strukturalizmit në gjuhësinë gjermane janë të ndryshme dhe lidhen me shumë rrethana të cilat pikënisje kanë fillimin e shekullit të 20. Lufta e Parë Botërore e zuri Gjermaninë ende nën ndikimin shumë të fortë të Junggramatiker, kështu që Kursi i Gjuhësisë i Sosyrit, i botuar së pari më 1916, nuk depërtoi deri në fund të viteve të 20. Pas përfundimit të kësaj lufte dhe pas marrëveshjes së Versajit, Gjermania dhe gjuha gjermane u izoluan dhe u bojkotuan. Purizmi dhe Inhaltbezogene Gramatik të Leo Weisgerberit filluan të kanë ndikim, sidomos purizmi i cili gjatë kohës naziste ishte shumë i theksuar. Weisgerber vazhdoi të rezistoi strukturalizmin deri në fund të viteve 60<sup>2</sup>. Duke e marrë parasysh rivalitetin ndërmjet Gjermanive, nuk befason fakti se depërtimi i strukturalizmit në Gjermaninë Lindore u stimulua për të dëshmuar supremacinë dhe progresivitetin e saj ndaj Gjermanisë Perëndimore. Eseu i famshëm i Manfred Bierwisch<sup>3</sup>:

Strukturalismus, Ergebnisse, Methoden, Probleme (Strukturalizmi, rezultatet, metodat, problemet) u bë një tekst i detyrueshëm për studentët e gjuhësisë. Bierwisch

<sup>2</sup> Shiko Nachkriegslinguistik, p. 2

<sup>3</sup> Im Gespräch mit Manfred Bierwisch p. 3

dhe studiuesit e tjerë gëzonin një liri relativisht të gjerë shkencore. U përvetësua edhe modeli i Çomskit, madje ai erdhi edhe në Akademi Shkencore në Berlin. Lidhur me këtë këtu po përmendim Oda Buchholz, e cila në disertacionin e saj rreth rimarrjes së kundrines në gjuhën shqipe më 1969, përdori modelin e dytë të radhës së gramatikës së Çomskit apo siç njihet në literaturë; modelin e Aspektit. Mirëpo, në fillim të viteve 70'ta filloi një kampanjë partiake kundër strukturalizmit, e në veçanti ndaj strukturalizmit në gjuhësi<sup>4</sup>. Shkas i drejtpërdrejtë i ndërrimit të këtij kursi, ishte përvetësimi i strukturalizmit nga ana e komunistëve francez. Mirëpo, këtu po theksoj se gjenerativizmi dhe strukturalizmi në gjuhësi në Gjermaninë Lindore vazhdoi të jetë i pranishëm deri në rënien e Murit të Berlinit. Profesorët Bierwisch dhe Motsch ani pse të pensionuar ende vazhdojnë aktivitetet e tyre akademike. Madje profesori Wolfgang Motsch na nderoi me praninë e tij në Konferencën e Gjermanistëve të Evropës Juglindore, të mbajtur në tetor të vitit të kaluar (2013) në Prishtinë.

Në Shqipëri, siç duket shkrimi i Stalinit pati gjithashtu ndikim pozitiv. Kështu së paku mund të konkludohet tërthorazi nga shkrimet e Bahri Becit. Në librin e tij biografik: *Një libër që nuk do të doja ta shkruaja*, të botuar nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, rreth takimit të tij me Androkli Kostallarin, në ditën e parë në Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë, në shtator të 1958, së bashku me Mehmet Çelikun, Jani Thomai dhe Menella Totoni, në faqen 24 ai shkruan: “I kisha ndjekur me interes dhe pasion leksionet e tij<sup>5</sup> ... E çmoja shumë, kisha mësuar prej tij shumë gjëra, kisha mësuar për historinë e gjuhësisë, për drejtimet kryesore në fushën e gjuhësisë që nga Gramatika e Paninit e deri tek Ferdinand de Sosyri”. Pra, në vitet '50-ta ligjërohej edhe Sosyri. Mirëpo, në po të njëjtin libër, por në periudha të tjera kohore, Beci shkruan edhe rreth episodeve të hidhura që kanë përjetuar prof. Selman Rizën dhe Eqrem Çabej, e gjithashtu edhe me rimbrotjen e doktoraturës së tij nga Parisi. Këtu po përmendim edhe pohimin e Rami Memushaj, në kumtesën e tij në Seminarin XXIV, me ç'rast shkruan: Merita për krijimin e asaj që është quajtur “shkolla gjuhësore shqiptare”, në mund të quhet kështu, nuk i takon ndikimit të gjuhësisë sovjetike, por brezit të parë të gjuhëtarëve me formim perëndimor. Për sa i përket teorisë gjuhësore nga është orientuar gjuhësia shqiptare e periudhës në shqyrtim, nuk mund të flitet për një bazë teorike të saj. Kemi më shumë një përzierje të metodave tradicionale para-strukturaliste me elemente të veçanta të metodës strukturaliste, ndonëse Sosyri, Blumfildí dhe Hjelmlevi anatemohehin”. Fakti se Sosyri në një periudhë më të vonshme u anatemia, tërthorazi na bënë me dije se strukturalizmi nuk pati mundësi të shtrihet në gjuhësinë shqiptare, së paku jo në nivel

<sup>4</sup> Im Gespräch, po aty

<sup>5</sup> E ka fjalën për Androklo Kostallarin

siç ishte në shtetet e tjera të bllokut socialist, duke përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik ku madje edhe gjenerativizmi dhe modelet gjenerativiste sintaksore e semantike u përvetësuan. Këtu, sa për ilustrim po përmendi botimin e Gjuhësisë Strukturaliste të Sebastijan Shaumjan.

Pra, mund të themi se strukturalizmi në gjuhësi në Shqipëri nuk i pati dyert e hapura pa ndërprerë. Në Kosovë ishte situatë tjetër: Sosyri, Martineja u përkthyen që në vitet '70-ta nga profesor Rexhep Ismajli dhe këto tekste u përdorën nga studentët. Por ndikimi i këtyre përkthimeve nuk pati efektin e duhur në Shqipëri. Të sqarohemi: shumë kolegë të prof. Rexhep Ismajlit përfituan nga përkthimi, mirëpo mungoi vullneti dhe guximi intelektual të ndërrohet frjtimi i gjuhësisë në Shqipëri. Kjo vërehet edhe në debatin rreth përkufizimit të togfjalëshit të bërë ndërmjet Spiro Floqit dhe Hilmi Aganit. Vërejtjet e profesor Aganit, shumë të drejta, strukturaliste dhe koherente e valide edhe sot<sup>6</sup>, siç pohon edhe Dhima në Seminarin e 24, as që u morën parasysh nga gjuhëtarët në Shqipëri.

Si përfundim po themi se për shkak të rrethanave dhe ndikimeve ideologjike qoftë të përgjithshme, pra në nivel të bllokut të shteteve socialiste, qoftë specifike, në nivel të Shqipërisë, mund të themi se këto ndikime mund të vërehen në strukturë dhe leksik të gjuhës, për shkak të përvetësimit të standardit të sotëm gjuhësor, e që drejtpërdrejt janë pasojë e ndërtimit jo të duhur të bazës së gjuhësisë në Shqipëri.

---

<sup>6</sup> Prof. Agani qysh në vitet '70' propozoi përfshirjen e elementeve funksionale siç janë p. sh. nyja e shquar e shqipes, nyja e paravendosur 'të' dhe parafrjalët të përfshihen në krijimin e sintagmave dhe madje atyre t'u ipet statusi i kokës së frazës.

Lindita TAHIRI, Vjosa HAMITI

## IDEOLOGJIA NË TEKSTET E HISTORISË TË SHKOLLAVE FILLORE NË KOSOVË

### Përmbledhje

Në këtë punim analizohet gjuha e teksteve të historisë të shkollave fillore në Kosovë nga këndvështrimi i linguitikës kritike dhe stilistikës. Studimi përqendrohet në katër tekste të historisë duke e nxjerrë në pah këndvështrimin dhe pozicionimin e autorëve të teksteve, kundruall vlerësimeve për ideologjinë e pranishme në to. Analiza përqendrohet në praninë e moralizimit, vlerësimit e gjykimit në gjuhën e këtyre teksteve dhe ndikimit që mund të bëjë një gjuhë e tillë për të nxitur vlera dhe bindje të qëllimshme ideologjike. Nga rezultati i kësaj analize kritike del se rekomandimet për “pastrim” të historisë nga ndikimi i ideologjisë, e sidomos për redaktimin e teksteve shkollore të historisë për shkak të imazhit të shtrembëruar të “tjetrit” në këto tekste janë të pabazuara dhe gjenerojnë ideologji kufizuese duke ndikuar në mendësinë shoqërore dhe politike dhe duke formësuar imazhin e publikut për historinë si formulim preskriptiv e të ngurtë që pamundëson shprehjen e mendimit kritik.

**Fjalët çelës:** historia, ideologjia, kritika linguitike, funksioni ndërpersonal, skema polarizuese

### 1. Hyrje: tekstet e historisë dhe ideologjia

Viteve të fundit në të gjitha vendet shqiptare është diskutuar për nevojën e rishikimit të teksteve të historisë për shkak të ndikimeve ideologjike në to, por ky diskutim ka qënë më shumë i pranishëm në tryeza politike se sa në qarqe akademike. Në këtë aktualitet shfaqet nevoja për analizën kritike të strukturave gjuhësore në tekstet e historisë që ndërthejnë ideologji të caktuara, për të ndikuar në njohuritë, bindjet, vlerat, raportet, dhe identitetet shoqërore të nxënësve/lexuesve të këtyre teksteve.

Në Kosovë, ky debat madje mori dhe përmasa ndërhyrjesh shtetërore: ministri i jashtëm turk dhe zyrtarë të lartë turq u kërkuan autoriteteve kosovare në 2011 që të ndryshojnë tekstet shkollore . Kërkesa erdhi pas prezantimit të analistit nga Shqipëria

Olsi Jazexhi në një konferencë ndërkombëtare në Turqi për imazhin e Tjetrit në tekstet shkollore të Ballkanit. Dy vite më vonë ai boton librin “Rrëfimet e një kombi” ku analizon imazhin e shqiptarëve, turqëve, muslimanëve dhe të krishterëve në librat shkollore të Kosovës. Përfundimet e tija kryesore janë se “këto libra kanë karakter Shqipëri-centrik dhe i bëjnë anëtarët e komuniteteve në Kosovë të ndjehen të poshtëruar” (2013:149), dhe se “turqit trajtohen si armiq dhe sllavët si barbarë”, (2013:150). Jazexhi rekomandon që Kosova, meqenëse sipas tij ka popull të ndryshëm nga ai i Shqipërisë, duhet të prodhojë tekste të veta mësimore.

## **2. Metodologjia: funksioni ndërpersonal**

Metodologjia e hulumtimit të ndërlidhjes mes strukturave gjuhësore në tekst dhe vlerave shoqërore që i ngërthejnë ato, bazohet në modelin e gjuhësisë funksionale të zhvilluar nga M.A.K. Halliday (1973, 1978, 1994) të cilin e kanë përpunuar Roger Fowler (1979, 1991,2003), Hodge, Kress dhe Trew (1979), dhe që më shpesh emërtohet si gjuhësi sistemime funksionale. Ky model e nxjerr në pah rëndësinë e karakteristikave formale gjuhësore në përputhje me funksionin specifik që e bartin këto aspekte gjuhësore dhe në përputhje me efektin dhe vlerat që i transmetojnë ato dhe që bëjnë pjesë në makro-funksionet e tekstit. Klasifikimi në tre funksione tek Halliday, në funksionin ideacional, ndërpersonal dhe tekstual, e kujton klasifikimin e Bühler-i në po ashtu tre funksione (1934), atë shprehës, konativ dhe referues, që Jakobson-i (1960) e përpunoi duke shtuar edhe tre funksione të tjera, atë fatike, metalinguistik dhe funksionin poetik. Studiues të tjerë si Fairclough (1995,1997,2003,2010), van Dijk (1988, 1998, 2008), van Leeuwen( 2005, 2008), dhe Wodak (2005, 2009) e zhvilluan më tej bashkëpunimin e gjuhësisë dhe shkencave shoqërore, duke u përkufizuar një vetëdijësim kritik për gjuhën, një përpjekje për ta kuptuar rolin e diskursit në konstruktin dhe transformimin e realitetit.

Tekstet e analizuara janë: Historia 6 nga autorët Fehmi Rexhepi e Frashër Demaj, Historia 7 nga autorët Isa Bicaç dhe Arbër Salihu, Historia 8 nga autorët Fehmi Rexhepi e Frashër Demaj dhe Historia 9 me autor Fehmi Rexhepin. Ato analizohen nga aspekti i funksionit ndërpersonal, për të cilin Halliday thotë se “e përmbledh funksionin shprehës dhe atë konativ që faktikisht nuk dallojnë brenda sistemit gjuhësor” (1973:48). Ai e përshkruan funksionin ndërpersonal të gjuhës si ndëraktiv dhe njëkohësisht personal, meqë përmes këtij funksioni arrijnë të integrohen grupet shoqërore dhe të identifikohet individi. Sipas Hallidayt, ky funksion shpërfaqet përmes tipareve të caktuara në sistemin gramatikor të gjuhës, si: regjistri leksik, llojet e ligjeratës dhe modaliteti, përdorimi i vetës, i cilësorëve dhe përforcuesve, e sidomos përdorimi i shprehjeve vlerësuese dhe komentuese. Edhe pse ai i sheh këto tri

funksione si të ndara vetëm relativisht, meqë gjithsesi e përcaktojnë reciprokisht njëri tjetrin, megjithatë kuptimet ndërpersonale konsiderohen si më të pavarura duke e marrë parasysh se folësi e ka lirinë që të shprehë pikëpamje dhe role të ndryshme shoqërore edhe kur bëhet fjalë për përmbajtjen e njëjtë gjuhësore.

### 3. Rezultatet

Titulli i librit të Jazexhiut, “Rrëfimet e një kombi”, sugjeroheh fiksionalitetin e historisë dhe mungesën e objektivitetit meqenëse bëhet fjalë për “rrëfim”, edhe pse ka disa dekada që tanimë mendimi post-modern e post-strukturalist e ka nxjerrë në pah afrinë e historisë me letërsinë. Kur flet për ngjashmëritë mes letërsisë dhe historisë, studiuesi i letërsisë Culler (2000) thotë se që të ketë kuptim, historia duhet ta përdorë modelin e narracionit letrar. Modeli i shpjegimit historik e ndjek logjikën e rrëfimit, logjikën e ndër lidhjes mes nismës, zhvillimit, dhe rezultateve të një ngjarjeje. Cila është logjika e rrëfimit në tekstet e historisë në Kosovë dhe çfarë interpretimesh nxit ajo? A e reprodukon ajo vlerësimin polarizues të vetvetes kundruall tjetrit (Van Dijk:1998) si thotë Jazexhi, apo ai vetë e përcjell këtë skemë të gjykimit bardh e zi, kur e përdor termin politik tanimë pothuaj katër dekada të vjetër “evropiano-centrik” si mbiemër përshkrues të vendit me nuanca vlerësuese negative për Perëndimin, ndërkaq në kopertina të librit të vet e shënon datën e botimit si “Xhumada e dytë 1434” duke ia kundërvënë atributin islam atij evropian/shqiptar?

#### 3.1. Historia e klasës së gjashtë

Përkundër vërejtjes të Jazexhiut se në këtë libër të klasës së gjashtë në faqen 13 “... autorët tregojnë në mënyrë të vazhdueshme që shqiptarët janë nga popujt më të vjetër të botës” (f.73), pikërisht në këtë faqe thuhet “Gjurmët më të hershme të njeriut janë zbuluar në Afrikën Lindore, në Evropë, në Kinë, në Oqeani etj. Gjurmë të njeriut të parë janë gjetur edhe në trojet shqiptare” (f.13). Si shihet në tekst përdoret lidhëza “edhe” e jo ndonjë përforcues i tipit “vetëm” që do të sugjeronte kuptimin përjashtues të cilin ia mvësh tekstit Jazexhi. Madje, kur flitet për prejardhjen e gjuhës shqipe përdoren folje jo faktike (Hudleston: 2002): “Nga dijetarët është menduar se gjuha ilire rrjedh drejtpërdrejt nga pellazgjishtja” (f.24) e ndërkaq kur flitet për prejardhjen e ilirëve toni semantik është relativizues: “Ilirët janë ndër popujt më të vjetër të Ballkanit (f.24).

Jazexhi qëllimisht nuk i përmend shembujt në këtë tekst të historisë ku për nxënësin hapen perspektiva të vlerësimit pozitiv ndaj fqinjëve si p.sh. “Përveç luftërave, popullsitë vendase dhe grekët bënin tregti mes vete. Kështu, marrëdhëniet

tregtare ndikuan në zbutjen e armiqësive midis tyre.” (f. 32). Ai veçon shembuj të tjerë duke i hequr nga konteksti si: “Kolonët grekë në Iliri gjetën një kulturë të avancuar, të cilën nuk e kishin takuar më parë”. Ai madje e zbërthen termin “sllavët e jugut” duke u nisur retrospektivisht nga koncepti jugosllav edhe pse flet për periudha me shekuj dallim mes vete: “Sllavët e jugut që tregohet të jenë sllovenët, kroatët, serbët, malazezët, maqedonasit etj. Rrëfihen si pushtues të tokave shqiptare, ardhacakë që ndërronin emrat e vendbanimeve ilire, dignin, plaçkisnin, shkatërronin, asimilonin vendet dhe popullsinë ilire... Cilësimet raciste që i bëhen sllavëve në këtë tekst nuk janë të ndryshme nga ato që ASHA e Maqedonisë i bënte shqiptarëve (f.75). Ai pra i paraqet maqedonasit si viktimë dhe si agresor në të njëjtin paragraf, për të sugjeruar ngjyrimin racist të tekstit të historisë së klasës së gjashtë, ku në fakt përdoret gjuhë më e relativizuar dhe argumentim faktik siç është toponimia: “Sllavët e Jugut arritën në Gadishullin Ilirik (tokat shqiptare), duke ndjekur rrjedhat e lumenjve dhe rrugët e vjetra tregtare të romakëve. Ata ende jetonin si në kohën e bashkësisë primitive. Ata kudo që shkuan ua ndërruan emrat vendbanimeve ilire, edhe emërtuan shumë vende me emra të tyre si p.sh. Zadrinë (Anadrini), Dibër ( Greminë, Grykë), Çorovodë (uji i zi) etj. Ardhja e sllavëve në Ballkan pati pasoja të mëdha të cilat u reflektuan te popujt e lashtë ballkanikë. Ata zunë pjesën më të madhe të territoreve ilire, duke djegur, shkatërruar e plaçkitur vendet dhe popullsinë ilire (f.123)

Jazexhi akuzon se nxënësit mësojnë se para ardhjes së sundimit osman popullsia shqiptare i përkiste fesë së krishterë, gjë që, sipas tij, është rrëfim i dëmshëm, ndërkaq për fenë islame tregohet që u përhap në kushte dhune e pushtimi (f.89), që dëshmon se autori objektivitetin e sheh si përzgjedhje të qëllimshme. Ndërkaq, në historinë e klasës së gjashtë, nxënësve u mësohet se krishterimi u përhap pas pushtimeve romake (f.87) dhe në librin e klasës së shtatë thuhet: “Edhe pse të ndarë në tri besime, populli shqiptar është shquar për tolerancë e harmoni fetare. Gjuha, traditat dhe zakonet ishin elemente që i bashkonin shqiptarët” (118). Kjo frymë e hapur e tolerancës nuk ia tërheq aspak vëmendjen Jazexhiut dhe përzgjedhja ashtu si interpretimi i tij janë tendencioze.

### 3.2. Historia e klasës së shtatë

Vërejtjet e Jazexhiut fillojnë që nga kapaku i librit, i cili ka një foto nga Lidhja e Lezhës. Autori shfaq interpretim gjykues duke thënë se “Në sfond shihet edhe një ikonë e Shën Mërisë me Jezu Krishtin e vogël, e cila i jep një kontekst të krishterë fotografisë (f.83). Për të është negative që kjo pikturë ku shfaqet Skënderbeu, “ i ngjan më shumë një pikturë kontësh evropianë perëndimorë.” Mirëpo edhe vetë e pranon se burrat në të janë veshur me “fustanella, disa edhe me çallma, veshje që janë tipike



osmane”(f. 83 ). Ndërkaq, kjo kopertinë mund të nxisë këndvështrimin e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit kulturor gjë që edhe artikullohet qartë në tekst: “Sundimi i gjatë, pesëshkullor, osman, la gjurmët e veta në kulturën e popujve të Ballkanit [...] Të gjitha këto objekte që u ngritën shekuj me radhë kanë vlerën e vet. Ato janë dëshmi e sundimit të gjatë osman këtu. Por, janë edhe pjesë e kulturës së popullit tonë” (f. 131). Madje, në këtë tekst, rastet e ralla kur përdoren mbiemra vlerësues negativ për turqit, janë pikërisht ato kur citohen burime turke: “Kronisti osman Bihishti thotë *"mé-1431-1432 ushtria osmane depërtoi në" trojet arbërore. Atje plaçkiti,dëmtoi e shkatërroi fshatra të" tëra dhe grabiti shumë djem e vajza të" bukura".*( f.60). Këto fragmente asnjëherë nuk i përmend Jazexhi në tekstin e vet akuzues që u bë shkak për nismën e shtetit turk për të ndryshuar tekstet e historisë në shkollat e Kosovës.

### 3.3. Historia e klasës së tetë

Sipas Jazexhiut libri i klasës së tetë ashtu si edhe tekstet e lartpërmendura, janë shkruar në suazat e historiografisë së Tiranës dhe mitet që kjo historiografi ka prodhuar në kohën e komunizmit. Sipas tij edhe në këtë tekst shkollor dominon fryma anti-turke (f. 97). Në vazhdim ai paraqet një vlerësim jo faktik që mund të quhet edhe etiketim ideologjik: “[...] luftërat që bëjnë të krishterët e Ballakanit kundër osmanëve i quajnë luftëra çlirimtare për sa kohë që serbët, malazezët, grekët etj luftojnë kundër turqve. Por në rast kur serbët pushtojnë qytete që autorët i imagjinojnë si shqiptare (Nish, Tivar, Ulqin etj.) çlirimtarët ballkanas quhen pushtues.” (f.97). Në tekstin e klasës së tetë thuhet: “Në prill të vitit 1877 Rusia filloi luftën kundër Perandorisë Osmane. Sukseset e ushtrisë ruse krijuan kushte të favorshme që kryengritësit në Bosnjë e Hercegovinë të konsolidonin forcat e tyre. Situatën e shfrytëzuan edhe Serbia e Mali i Zi, të cilat pushtuan mjaft territore kryesisht të banuara me popullsi shqiptare - Sanxhakun e Nishit, Hotin, Grudën, Tivarin dhe Ulqinin.” (f.56).

Jazexhi thotë se autorët i trajtojnë si heronjë arvanitët si Bubulina Paskalina dhe të tjerët “që morën pjesë në luftën greke të pavarësisë, por i quajtën shovinistë grekët dhe serbomëdhenjtë serbët, kur cenohen shqiptarët.” (f. 97-98) Mirëpo në tekstin shkollor i behet një përshkrim asaj periudhë, ku ndër të tjera përshkruhet edhe roli i femrave në këtë kohë: “Në këtë fitore të madhe të grekëve rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe shqiptarët, sidomos qëndresa antiosmane e Ali pashë Tepelenës. Shumë luftëtarë shqiptarë u gjendën krah për krah grekëve në betejat më të njohura. Heroizëm treguan edhe arvanitasit në Peloponez, në Atikë e kudo tjetër. Ata u dalluan sidomos në luftën detare, të cilën kryesisht e përballuan marinarët arvanitas të Hidrës e të Speces. Edhe femrat arvanitase dhanë kontribut të rëndësishëm. Ndër to u dallua

Bubulina Paskalina (1771-1825), e bija e kapedanit të Hidrës, Stavri Pincoit, e cila me luftëtarët e vet trima çliroi shumë qytete greke, ndër të cilat edhe Nafaliosin, që më vonë u caktua kryeqytet i përkohshëm i Greqisë.” (f. 59).

Më tutje përshkruhen edhe “Në politikën e jashtme qarqet sunduese greke janë mbështetur në programin e "Megali Idesë", të shpallur zyrtarisht në vitin 1844. Sipas programit shovinist grekomadh të "Megali Idesë", ekzistonin dy qendra të popullit grek: Athina, që ishte kryeqytet i Greqisë, dhe Stambolli, që konsiderohej kryeqytet i helenizmit dhe i ortodoksizmit. Mbretëria greke përfaqësonte vetëm një pjesë të kombit grek. Ajo e konsideronte veten trashëgimtare të shtetit të Aleksandrit - Lekës së Madh e të Perandorisë Bizantine. Prandaj, të gjitha viset që përfshiheshin dikur në këto supershtete duhej t'i takonin Greqisë. Në Ballkan ajo pretendonte territoret deri në malin Ballkan, në lindje dhe deri në Shkodër, në perëndim. Për realizimin e këtyre planeve shoviniste dhe për krijimin e Greqisë së Madhe, sundimtarët grekë formonin organizata të fshehta, dërgonin çeta të armatosura e propagandistë të shumtë në vise të tjera të Ballkanit, pra edhe në trojet shqiptare. Veprimtaria e këtyre forcave shoviniste u solli dëme shumë të mëdha lëvizjeve çlirimtare të popujve të tjerë, në veçanti shqiptarëve. (f.60). Jazexhi nxiti propagandën e Shqipërisë së Madhe ku thotë: “Autorët tregojnë që Rilindja kishte këto synime: çlirimi i të gjitha tokave shqiptare nga zgjedha osmane dhe bashkimi i tyre në një shtet kombëtar shqiptar; mbrojtja e tokave shqiptare nga rreziku i shteteve fqinje; zhvillimi i arsimit dhe ekonomisë së Shqipërisë sipas shembullit të vendeve evropiane[...] “Rilindasit”[...] janë shumica të krishterë [...] dhe e tregojnë Lidhjen e Kosovës dhe Rilindjen sikur të ishin pjesë e një mega-plani kombëtar shqiptar.” (f.98-99). Teksti shkollor paraqet Rilindësit dhe planin për Shqipërinë në këtë formë: “Intelektualë e klerikë atdhetarë iu përkushtuan zhvillimit të gjuhës, letërsisë dhe të arsimit kombëtar. Në përputhje me kushtet e brendshme e të jashtme të Shqipërisë, rilindësit përpunuan programin e Rilindjes Kombëtare. Në vija të përgjithshme ai përmbante këto pika kryesore: çlirimin nga zgjedha osmane e të gjitha tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre në një shtet kombëtar shqiptar; mbrojtjen e tokave shqiptare nga rreziku i copëtimit ndërmjet shteteve fqinje; zhvillimin e arsimit e të kulturës në gjuhën amtare dhe përparimin ekonomik të Shqipërisë, si pas shembullit të vendeve evropiane.” (f.70). Sipas Jazexhi kapitullin e V te reformat osmane të tanzimatit, trajtohen si „lëshime që shteti feudal osman i bënte borgjezisë turke“ (f. 98). Kurse në tekstin shkollor bëhet një përshkrim i asaj periudhe, me pa ndonjë : “Tanzimati është periudha e reformave të moderuara borgjeze në Perandorinë Osmane. Reformat kishin për qëllim të ndalnin shthurjen e Perandorisë dhe të forconin pushtetin e sultanit. Në të njëjtën kohë reformat ishin lëshim që shteti feudal osman i bënte borgjezisë turke e cila ishte në formim e sipër.”(f.54)

Jazexhi thekson se miti i të keqes turke e greke dhe heroizmit shqiptar përforcohet në mësimin “arsimi dhe kultura shqiptare në fund të shekullit “ku autorët sërish përpjekjet e intelektualëve në metropolet e Perandorisë i tregojnë si të ndërlidhura me kryengritjet e muslimanëve në Kosovë. Ideja që autorët krijojnë është se“ sundimi i gjate amtare dhe kombëtare dhe shumica e popullsisë ishte analfabete. (f. 101) Por në tekstin shkollor thuhet: “Sundimi i gjatë osman në Shqipëri kishte lënë pasoja të rënda edhe në fushën e arsimit. Si pasojë e moslejimit të shkollimit të shqiptarëve në gjuhën amtare, shumica e popullsisë ishte analfabete. Edhe në shek.XIX, Porta e Lartë nuk e lejonte mësimin dhe shkollën shqipe. Ajo dhe Patrikana e Stambollit e pengonin arsimin shqip. Prandaj, shkrimi e leximi në gjuhën shqipe mësoheshin fshehurazi. Ndërkohë, lejohej që në Shqipëri të hapeshin shkolla turke, greke, serbe etj ., që ishin të veçanta për nxënësit muslimanë e të krishterë shqiptarë.” (f. 81)

### 3.4. Historia e klasës së nëntë

Ky tekst shkollor trajton historinë kombëtare, rajonale dhe historinë e përgjithshme që nga përfundimi i Luftës së parë Botërore e deri në fund të shekullit XX. (H9; 3). Sipas Jazexhiu në kundërshtim me tekstet e mëparshme të historisë në këtë tekst “Perandoria Osmane nuk shfaqet më si një nga historitë dominuese [...] zëvendësohet me Turqinë.[...] Kosova nis të shfaqet paralel me Shqipërinë [...] (f.107). Turqia përmendet kalimthi në mësimin e mbretit Zog [...] dhe pas adoptimit të Kodit civil shqiptar [...] (f.110).” Ai madje vazhdon dhe thotë që Kosova nis të shfaqet paralele me Shqipërinë, edhe pse shqiptarët vazhdojnë të tregohen si një “komb por tanimë i ndarë në dy pjesë (f.107). Me tutje ai thotë se autori i këtij teksti shkollor harron të përmendë që Turqia është një na vendet e para që njohi pavarësinë e Kosovës.”(f.111). Kjo konsiderohet si kundërthënëse dhe manipulim ideologjik. Sipas tij trajtimi që i bëhet historisë së Shqipërisë është “shumë idealist, ruhen heronjtë e tradhtarët që ka përcaktuar historiografia komuniste në Shqipëri” ku si shembull përmend figurat e Avni Rrustemin dhe Esat pashë Topanin si dhe Ahmet Zogut, e cila trajtohet pozitivisht sipas standardeve të sotme të Tiranës. (f.107-108). Ky konstatim përkufizohet si moralizim i prezantuar si fakticitet. Historia e klasës së nëntë e shpjegon këtë pjesë nga perspektiva e rrëfyesit: “Në kohën kur kryengritësit shqiptarë korrnin fitore në Vlorë, forcat patriotike të udhëhequra nga Bajram Curri përfunduan me sukses operacionin kundër bandave esadiste që vepronin kundër Qeverisë së, Sylejman Delvinës, kurse më 13 qershor 1920 patrioti Avni Rrustemi vrau në Paris tradhtarin Esat pashë Toptanin”. (f.47)

## 6. Përfundim: fabrikimi i objektivitetit historik

Përkundër opinionit të krijuar publik rreth ideologjisë të pranishme në librat shkollorë të historisë në Kosovë, megjithatë në studimin e autorit Jazexhi për këto libra është pikërisht diskursi i këtij studiuesi që e manifeston ideologjinë sidomos në rrafshin ndërpersonal të tekstit. Diskursi i këtij autori përmban vlerësime dhe gjykime të pambështetura në tekstet origjinale të përfolura të historisë. Ky studiues madje pretendon dhe censurim të gjuhës së figurshme dhe metaforave që janë shprehësi dhe kreativitet thelbësor i gjuhës (Lakoff: 1995): ai i quan parullë të Rilindasve vargjet e Pashko Vasës “feja e shqiptarit është shqiptaria” duke e interpretuar në mënyrë të drejtpërdrejtë metaforën.

Në emër të objektivitetit historik, diskursi i këtij autori përmban skemën e polarizimit, në përputhje me konceptin e van Dijk (1998) për shfaqjen e ‘vetes’ kundruall ‘tjetrit’ brenda një skeme kundërshtuese e cila i shërben përkufizimit të identitetit shoqëror të grupit shoqëror, interesat e të cilit përfaqësohen në diskursin përkatës. Diskursi i këtij autori pretendon perspektivën e vetme, të drejtë dhe përfundimtare të vlerësimit afirmativ të Perandorisë otomane, së cilës ia kundërvë konotacionet negative të “Perëndimit” si dominim post-kolonialist dhe dominues. Siç thotë van Dijk, pavarësisht se a janë të vetëdijshëm dhe a kanë njohuri për një ideologji disa individë më shumë apo më pak se të tjerët, ideologjia e caktuar ekziston dhe zbatohet, ashtu siç ekziston gramatika.

### Bibliografia:

1. Culler, Jonathan (2000): *Literary Theory. A very short Introduction*. Oxford University Press
2. Fairclough, Norman (2001): *Language and Power*. London: Longman.
3. Huddleston, Rodney and K. Pullum, Geoffrey (2002): *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge University Press
4. Jazexhi, Olsi (2013): *Rrëfimet e një kombi*. Tiranë: Free Media Institute
5. Lakoff, George (1995): *Metaphor, Morality and Politics, in Social Research*, Vol 62, no. 2. N.Y: The New School for Social Research
6. M.A. K. Halliday (1973): *Explorations in the Functions of Language*, Edward Arnold.
7. Van Dijk (1998): *Opinions and Ideologies in the Press*, në “Approaches to Media Discourse”, ed. Allan Bell dhe Peter Garrett. Blackwell Publishers,
8. Van Dijk, Teun A. (2008): *Discourse and Context*. Cambridge University Press.
9. **Wodak, Ruth. (2009): *The Discourse of Politics in Action*. London: Palgrave Macmillan.**

Sahadete LIMANI-BEQA

## POLISEMIA IDEOLOGJIKE E FJALËS „DEMOKRACI“ NË DISKURSIN POLITIK NË KOSOVË

### Hyrje

Në trajtimet teorike<sup>1</sup> rreth gjuhës dhe ideologjisë, fjala demokraci merret shpesh si shembull për të ilustruar funksionin e gjuhës në politikë. Në këto kërkime shkencore fjala *demokraci* definohet si pjesë e leksikut ideologjik dhe radhitet në grupin e fjalëve me vlerë të lartë. Ndër tiparet e këtyre fjalëve është se ato posedojnë një shumësi semantike, të cilën Dieckman (1975; f.13) e quan *polisemi ideologjike*. Kjo shumësi semantike dhe konotacioni pozitiv, të cilën fjalët me vlerë të lartë e kanë marrë historikisht, i mundësojnë politikanit një përdorim strategjik duke i theksuar kuptimet e fjalës varësisht nga grupi i audiencës së ligjërit. Për shkak të vlerës së lartë dhe ngarkesës kuptimore pozitive, politikanët e përdorin demokracinë si lajtmotiv të angazhimit të tyre politik. Sipas Spieß (2006: f.34) gjatë përdorimit të fjalëve me vlerë të lartë për të argumentuar për çështje të diskutueshme „nga grupi që flet bëhen specifitime të përmbajtjes së kuptimeve të shpërfaqura, me qëllim të përdorimit të këtyre fjalëve me vlerë të lartë për konceptet vetanake“.

Në këtë punim do të prezantohen gjetjet e një kërkimi për funksionin ideologjik të fjalës *demokraci* në diskursin politik në Kosovë, i cili ka për bazë këtë sfond teorik. Pyetja kryesore kërkimore është: A ka fjala demokraci kuptim polisemik? Nënpyetja kërkimore kryesore është: A e konceptualizojnë grupe politike të caktuara demokracinë në varësi të interesave të tyre politike dhe në varësi të audiencës së cilës i drejtohen? Cilat janë tiparet semantike të fjalës *demokraci* në korpusin e teksteve të analizuara?

**Fjalët kyqe:** *Gjuba, demokracia, politika, pushteti, demokracia qytetare, demokracia etnike, polisemia ideologjike, veqoritë semantike, fusha kollokative, prozodia semantike, implikatura, aludimet.*

---

<sup>1</sup> Shih: Dieckmann, 1964, 1974; Strassner 1987; Girnth 2002, Burkhardt 2003, Spieß 2006.

## Metodologjia

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve është përdorur Analiza Kritike e Diskursit<sup>2</sup>. Kërkimi është i bazuar në një korpus prej 41 058 fjalësh nga tekste të përzgjedhura nga ligjërimi i politikanëve kosovarë, i publikuar në gazetat ditore *Koha Ditore*, *Bota Sot dhe Epoka e Re*. Pjesë e korpusit janë deklarata të bëra të udhëheqësve të partive më të mëdha politike në Kosovë (LDK, PDK, AAK) në periudhën gjatë viteve 1999-2005, kur Kosova ishte nën administrimin e Misionit të Përkoshëm të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Për bazë janë marrë tekste nga ngjarje diskursive, të përzgjedhura në bazë të publikut parësorë të teksteve. Korpusi është i ndarë në dy nënkorpuse: Nënkorpusi 1, i cili përfshin tekste nga ngjarje diskursive, të cilat për publik kryesor kanë zgjedhësin shqiptarë të Kosovës, si fjalimet në fushatat zgjedhore për zgjedhjet nacionale të vitit 2001 dhe 2004 dhe fjalimet gjatë ceremonive me karakter memorial si 28 Nëntori Dita e flamurit shqiptar dhe ditët përkujtimore për të rënë. Ndërsa në nënkorpusin 2 bëjnë pjesë tekste të cilat për adresat primare kanë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Këto janë deklarime të bëra të politikanëve për ngjarje diskursive si: bisedimet për decentralizimin, bisedimet për Standardet e UNMIK-ut për statusin dhe bisedimet për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Në fillim do të përqëndrohemi në kuptimet e fjalës *demokraci* ashtu siq trajtohen ato në leksikone të ndryshme, në shkencat politike si dhe në teoritë e ndryshme të demokracisë.

Do të vazhdojmë me paraqitjen e gjetjeve të analizës rreth veqorive semantike të fjalës *demokraci* ashtu si ato paraqiten në nënkorpusin 1. Analizës cilësore të implikaturave dhe aludimeve ju paraprijnë analiza sasiore e kollokateve të familjes së fjalëve *demokraci demokratik/e*. Kjo ka për qëllim të gjendet se çfarë kuptimi asociativ marrin këto fjalë në ambientin e tyre kollokativ. Më tutje prezentohen analizat sasiore e cilësore të rasteve të marra si mostër nga nënkorpusi 2 rreth përdorimit të familjes së fjalës *demokraci*.

Pyetjet konkrete të parashtruara gjatë analizës janë: Si perspektivohet demokracia? Çfarë prozodie semantike zhvillohet përmes kollokateve rreth grupit të fjalëve *demokraci, demokratik/e* në korpusin e teksteve të analizuara dhe çfarë vlerash transportohen përmes saj? Cilave strategji komunikimi ju shërben motivi i ndërtimit të demokracisë? Me cilat motive të tjera ndërlidhet demokracia në diskursin politik? Përmes cilave veprime të natyrës gjuhësore përmbushet me kuptime të caktuara fjala

---

<sup>2</sup> Analiza Kritike e Diskursit mbron pikëpamjen se ideologjitë shprehen dhe konstruktohen në tekste andaj përmes analizës së kategorive gjuhësore është e mundur të demistifikohen ideologjitë e teksteve. Për këtë kërkim si bazë e kornizës teorike kanë shërbyer modelet e AK të Norman Fairclough, Teun van Dijk, Gerlinde Mautner dhe Sigfried Jäger.

demokraci? Cfarë tregojnë implikaturat, dhe aludimet? Këto pyetje parashtrohen gjatë analizës së dy nënkorpuse të ndara me qëllim që të shohim nëse fjala demokraci në të dy nënkorpuset merr kuptimin e njejtë.

### **Korniza teorike**

Në trajtimet teorike rreth përdorimit të gjuhës në politikë fjala demokraci merret shpesh si shembull për të ilustruar funksionin gjuhësor në politikë.<sup>3</sup> Në këto kërkime shkencore ‚demokracia‘ definohet si pjesë e leksikut ideologjik dhe radhitet në grupin e fjalëve me vlerë të lartë.<sup>4</sup> Fjalët me vlerë të lartë përshkruajnë fenomene abstrakte të cilat vlerësohen pozitivisht, por të cilat nga ana përmbajtësore kanë domethënie të ndryshme „Ato nënkuptojnë cdo gjë për secilin“ (Hayakawa 1964: F.112). Ndër tiparet e këtyre fjalëve është se ato posedojnë një shumësi semantike të cilën Dieckman e quan „polisemi ideologjike“<sup>5</sup>. Kjo shumësi semantike dhe konotacioni pozitiv të cilën fjalët me vlerë të lartë e kanë marrë historikisht, i mundësojnë politikanit një përdorim strategjik duke i theksuar veqoritë semantike të fjalës varësisht nga grupi i dëgjuesve. Fjalët me vlerë të lartë e kanë funksionin të shpërfaqin realitetin në mënyrë të thjeshtëzuar me qëllim të ndikimit emocional (shih Girth 2002:f.52). Në ligjërimin politik, politikanë apo grupe politike përdorin këto fjalë për të shërbyer njëkohësisht grupe adresatësh me preferenca të ndryshme, për ti lënë vetes hapësirë veprimi dhe në rast nevojë për të interpretuar më vonë thëniet e

---

3 Shih. Dieckmann 1964, 1974, 1979, Strassner 1987, Burkhardt 2003, Klein 2002, Girth 2002, Spieß 2006.

<sup>4</sup> Fjalët me vlerë të lartë janë një nënloj i fjalëve parollë. Termi “Fjalë parollë” përdoret shpesh si sinonim i tyre. Dieckmann (1964:f.79f) p.sh. përdor termin ‘parollë’ dhe e definon kështu: „përshkruan një formë të ngjeshur stilistikisht si një fjalë e vetme apo familje fjalësh e cila lëviz vetëdijen dhe vullnetin kolektiv, një tendencë qëllim apo program të një grupi të caktuar kundër një grupi tjetër apo më shumë grupeve të tjera. Lëviz më së shpeshti në një nivel më të lartë abstrakcioni dhe thjeshtëzon realitetin varësisht nga kërkesat e veprimit kolektiv; ka për detyrë të tërheq dhe mbledh favoritë apo të luftojë dhe të përul kundërshtarin. Sa I përket funksionit apelativ, është e orientuar kah dëgjuesi dhe ndikimi I saj është si rrjedhojë e kuptimeve me të cilat është veshur. Girth (2002) përdor për këto fjalë termin “Fjalë simbol”.

<sup>5</sup> Strauß/Zifonun (1982/83: S. 68f, cituar në Girth 2002: f. 52) e definojnë diferencën semantike si „diferencë në përdorim të një fjale e cila është e varur nga mendimi i grupit, dhe në secilin rast theksohet një dimensin semantik“. Për këtë Dieckmann përdor termin „polisemi ideologjike“ (1974:f.13). Sipas tij kjo polisemi mund të shtrihet edhe në rrafshin e kuptimit përmbajtësorë apo edhe në vlerësimin e paraftyrimit për referentit e fjalës. Te fjala demokraci kemi të bëjmë me një polisemi semantike në rrafshin kuptimor, përderisa sa i përket vlerës së referentit ajo mbetet e njejtë në cdo përdorim. (shih. Dieckmann 1974: f. 213, cituar në Burkhardt 2003: f. 354).

tyre në bazë të interesave të tyre, pa u gjykuar nga publiku për mashttrim (shih Klein 1998: f.386). Sipas Spieß (2006: S.34) gjatë përdorimit të fjalëve me vlerë të lartë për të argumentuar për çështje të diskutueshme „ nga grupi që flet bëhen specifikime të përmbajtjes së kuptimeve të shpërfaqura, me qëllim të përdorimit të këtyre fjalëve me vlerë të lartë për konceptet vetanake“.

Dieckmann (1974:f.70f) niset nga ajo se, mënyrat e ndryshme të përdorimit të kushtëzuar politik të fjalës *demokraci* bazën e kanë te etimologjia e konceptit „sundim i popullit“. Është ky kuptim, i cili fjalës *demokraci*, gjatë zhvillimit të saj i ka dhënë konotacion pozitiv. Me këtë fjalë nënkuptohet në të gjitha anët sundim i popullit, por se cili është subjekti i këtij sundimi, dhe në çfarë mënyre do të organizohej ai politikisht, qëndrimet e konceptet për këtë çështje mbeten gjithmonë të ndara. (shih Burkhardt 2003: f. 356).

### Konceptualizimi i demokracisë në leksikone dhe diskursin shkencor

Fjalorët e ndryshëm ende mbeten shumë të përgjithshëm në përcaktimin e saktë të kuptimit të demokracisë. Gjatë shfletimit të fjalorëve terminologjik demokracia shpjegohet si: 1. Parim politik sipas të cilit populli përmes zgjedhjeve të lira merr pjesë në ushtrimin e pushtetit në shtet; 2. sistem qeverisës në të cilin përfaqësuesit e zgjedhur nga populli e ushtrojnë pushtetin. 3. Shtet me kushtetutë demokratike, dhe sitem shtetëror me qeverisje demokratike. 4. Parimi i ndërtimit të vullnetit dhe bashkë vendosjes së lirë dhe të barabartë në grupet shoqërore. 5. Greqisht: Sundim I popullit si një formë e jetës politike, e cila e ka pikënisje barazinë dhe lirinë e të gjithë qytetarëve, dhe e cila vullnetin për të krijuar komunitetin apo shtetin e sheh si rrjedhojë të vullnetit të popullit. 6

Diskursi shkencor e trajton demokracinë jo si term, por si koncept veprimi të natyrës praktike. Në Greqinë Antike, në qytetet shtete grekët e lashtë praktikonin vetëvendosjen dhe vetëqeverisjen e qytetarëve përmes përfshirjes së shtresave të gjera qytetare. Kjo praktikë quhej demokraci. Kërkuesit nisen nga termi etimologjik i përgjithshëm i demokracisë dhe e definojnë këtë fenomen „shkurtë dhe qartë si ushtrim i drejtëpërdrejtë ose jo i drejtëpërdrejtë i pushtetit të demosit, pushtet popullor apo pushtet i shumicës“ (Schmidt 2000: F. 19). Për më tepër diskursi shkencor kërkon dhe përpiqet të njoh format e praktikimit të këtij lloji të pushtetit në

<sup>6</sup> Shih Duden, Universalwörterbuch 2007; Brockhaus Enzyklopädie 1999; dhe Meyers Lexikon, në:  
<http://lexikon.meyers.de/ëissen/Demokratie;jsessionid=4331B4871669F8ABB7DD9D9C69A01BD1;jvm1>



shtetet moderne, duke u nisur dhe pajtuar se demokracia është forma më e mirë edhe pse jo perfekte e një sistemi të pushtetit që i shërben realizimit të mirëqënies së përgjithshme.<sup>7</sup>

Problemi qëndron aty se si pajtohet vetëvendosja e natyrshme individuale e njeriut me minimizimin e pushtetit, „çfarë forme institucionale duhet të marrë demokracia për të sjellur këto përparësi, pra si të praktikohet sundimi i popullit“ (Saage 2005: f.5). Sipas Lipjardt (1984:f2) një lloj i demokracisë ideale nuk ka egzistuar asnjëherë për shkak se është e vështirë për tu praktikuar.

Demokracia si thelbi i shtetit modern konstitucional është „demokracia konstitucionale“. Ajo është një formë e shtetit konstitucional e praktikuar në shtete me sipërfaqe të mëdha dhe të vogla, në të cilat pushteti del nga baza e lirisë dhe barazisë politike e të gjithë popullsisë, d.m.th nga populli i shtetit (Schmidt 2006: f. 21f). Sipas Schmidt (po aty) „populli“ është i definuar politikisht si popull shteti e për këtë arsye demokracia konstitucionale nuk e ka për bazë ndonjë përkatësi etnike të caktuar. Ndërsa Smooha (2001: f.11) sa i përket popullit respektivisht sundimit të popullit dallon dy kategori të demokracisë që praktikohen: “Demokracitë qytetare, gurtthemel i të cilave është qytetari apo qytetaria pa marrë parasysh dallimet etnike apo fetare; dhe demokracitë etnike në të cilat pjesa qëndrore është kombi etnik”. Në kategorinë e parë hyjnë demokracitë republikane, multikulturale dhe demokracia konkordive. Këto lloje të demokracisë dallojnë nga demokracia etnike për shkak se të gjithë qytetarët janë bartës të elementit shtetërorë. Populli i shtetit në këto demokraci nuk është etnikisht i njësuar, por një bashkim i individëve. Në modelin e demokracisë etnike ka një komb etnik bërthamë dhe grupe të tjera që nuk janë bërthamë, por të dy grupet janë ligjërisht të barabartë. Demokracinë etnike Smooha e definon sin ë vazhdim: “ ‘Demokracia etnike’ kombinon tejzgjatjen e të drejtave civile dhe politike të të gjithë banorëve permanent me një me një dominim etnik të institucionalizuar të grupit shumicë. Kombi etnik bërthamë kontrollon shtetin dhe e përdor për interesa të tij kombëtare për tu dhënë anëtarëve të tij një status favorizues. Grupeve jo bërthamë u garantohen të drejta individuale dhe kolektive dhe u lejohen përpjekjet për ndryshim, por trajtohen si qytetarë të rendit të dytë dhe të vendosur nën kontroll” (Smooha 2001: F. 5).

Në demokracitë perëndimore janë parimet normative të cilat janë të shtrira në kushtetutat e këtyre vendeve që reflektojnë konceptcionet e demokracive perëndimore. Parimet në vazhdim shprehen në strukturat, proceset dhe institucionet dhe këto

---

<sup>7</sup> Shih Schmidt 2000:f 19; Tocqueville 1976: f 276ff.

marrin pastaj forma të ndryshme kulturore dhe historike.<sup>8</sup> 1. Respektimi I të drejtave të njeriut dhe qytetare, veqanërisht të drejtave të lirisë dhe barazisë; 2. E drejta për pjesëmarrje të barabartë në çështjet e përbashkëta për shoqërinë dhe shtetin; 3. Sovranitetin e popullit; 4. Ndarjen e pushteteve; 5. Njohjen e pluralitetit dhe të heterogjenitetit të shoqërive modern si pasojë logjike dhe faktike të të drejtave individuale; 6. Reprerentativiteti, 7. Parimi I shumicës; 7. Vetëvendosja kolektive dhe kufizimi i pushtetit politik.<sup>9</sup>

Këto parime shërbejnë si kritere në bazë të të cilave gjykohet nëse një shtet është demokratik apo jo. Për shkak se në këtë punim është domethënëse që fusha semantike e termit demokraci të definohet ashtu siq përdoret në diskursin politik, këto parime do të shiqohen si tipare semantike të termit të sotëm Demokraci dhe do të përdoren si masë për të identifikuar tiparet semantike të konceptit të cilat shpërfaqen në ligjërimin e politikanëve në Kosovë.

### **Përdorimi i termit Demokraci në ligjërimin politik në Kosovë**

Politikanët kosovarë e përdorin demokracinë si lajtmotiv të angazhimit të tyre politik. Në korpus prej gjithsejt 41 058 fjalësh, fjala demokraci përdoret 875 herë. Në nënkorporusin 1 grupi i fjalëve *demokraci/a, demokratik/e* paraqitet 386 herë, ndërsa në nënkorporusin 2, 489 herë. Si në tekstet e nënkorporusit 1, të cilat i adresohen në radhë të parë publikut kosovar e poashtu edhe në ato të nënkorporusit 2, të cilat adresat parësore kanë bashkësinë ndërkombëtare, politikanët përdorin këtë term për të legjitimuar pushtetin e tyre. Ky është vetëm një indikator i cili nuk thotë shumë për fushën kuptimore të këtij grupi të fjalëve.

Politikanët i konstruktojnë realitetet e njëjta varësisht nga adresatët e teksteve të tyre. Se si conceptualizohet demokracia varet nga makrostrategjia, të cilën politikanët e përdorin për të bindur publikun për t'iu dhënë atyre pushtetin politik. Dy janë strategjitë të cilët politikanët kosovarë i zbatojnë përmes ligjërimin politik: 1. konstruktimi i imazhit të heroit që lufton për të shpëtuar kombin dhe 2. të heroit që bën paqen midis etnisë shqiptare e serbe në Kosovë. Ky konstruktim bëhet përmes përdorimit të gjuhës. Për këtë arsye për të nxjerrë në pah konceptin e demokracisë është hulumtuar ambienti gjuhësor i fjalës *demokraci*. Por para se ta bëjmë këtë është e nevojshme të përmenden këtu disa tipare të cilat janë hasur gjatë analizës së dy

<sup>8</sup> Shih Massing 2007: f. 78.

<sup>9</sup> Shih Massing po aty dhe Shubert Klein 2008: f 70.

nënkorpuseve.

Në fjalime dominon strategjia e politikanit që „flet shumë por nuk thotë asgjë“<sup>10</sup>. Të mos thënit asgjë në korpus u referohet gjetjeve në vazhdim: 1. Fjala *demokraci* përdoret në kuptimin e saj shumë të përgjithshëm. 2. Paraqitet shumë shpesh si mjet retorik në figurën krahasuese trehapëshe „liri, barazi, demokraci“ dhe përdoret si parollë. 3. Demokracia përdoret në tautologji dhe për nga përmbajtja nuk thotë shumë. 4. Shpesh demokracia nuk është subjekt për të cilën flasin politikanët, por përdoret më shpesh si cilësim paushall i veprimeve të tyre për të aluduar në dicka të bukur dhe hypostazuar. 5. Janë kategoritë gjuhësore të implikaturës dhe aludimeve të cilat na mundësojnë të kuptojmë se si e konceptualizojnë politikanët demokracinë.

### **Konceptualizimi i demokracisë në tekstet e fushatave zgjedhore dhe ditëve përkujtimore**

#### **Demokracia sistem sundimi i vullnetit “të popullit tonë”**

*Analiza e fushës kollokative të grupit të fjalëve „Demokraci-a, demokratik/e.*

Fusha kollokative është analizuar me qëllim të gjetjes së treguesve të tipareve të mundshme, të cilat qojnë deri te kuptime të caktuara të konceptit ‚demokraci‘ ashtu siq shpërfaqet në ligjërimin e politikanëve<sup>11</sup>. Në një korpus prej 9864 fjalëve, emri *demokraci* në të gjitha rasat zgjedhore paraqitet 38 herë. Si mbiemër *demokratik/e* paraqitet 94 herë. Kjo frekuencë reflekton faktin se fjala *demokraci* si emër paraqitet shumë më rrallë se sa si mbiemër. Mund të jetë një indikator se demokracia dhe demokratizimi trajtohen shumë më pak si tema në vetvete, por demokracia paraqitet si atribut për dicka tjetër. Për të shkuar përtej gjetjeve sasiore dhe për të ndriquar ambientin e koncepteve janë hulumtuar rreshtat e konkordancës në të cilët paraqitet grupi i fjalëve *demokraci, demokratik/e*. Rreshti i konkordancës ka përfshirë 15 fjalë para dhe 15 fjalë prapa fjalës *demokraci* dhe *demokratik/e*. Këto konkordanca mund të japin më shumë informacion për shpeshësinë dhe fenomenet mikro semantike p.sh. çfarë cilësohet si *demokratik/e*.

Si emër fjala *demokraci* përdoret më së shpeshti menjëherë pas ose para fjalëve *liri, pavarësi, Kosova, populli shqiptar*. Kjo fjalë shoqërohet edhe nga fjalë të tjera si *paqe*,

---

<sup>10</sup> Shih Klein 2002: f.83

<sup>11</sup> Sipas Mautner (2000), fusha kollokative mund të jetë tregues që mund të mirret si pikënisje për të mbështetur vëzhgimet cilësore empirike në nivelin makroanalitik të diskursit, nën këndvështrimin e raporteve tematike më komplekse.

*luftë, humanizëm*. Gjatë përdorimit të fjalës *demokraci* në korpus bie në sy edhe një veqori sintaksore. Fjala *demokraci* përdoret në fjali më së shpeshti si objekt. Sipas pikëpamjeve të autorëve të analizës kritike të diskursit mbi tranzitivitetin<sup>12</sup> vijmë në përfundim se demokracia nuk vepron apo nuk shpjegohet dhe nuk i mveshen veqori drejtëpërdrejtë. Në të katër herat sa paraqitet fjala si emër ajo shoqërohet me kollokatë si *pushtet i popullit, presupozon pluralizmin politik; në Kosovë të fitojë*.

Fjala *demokraci* paraqitet më shpesh si mbiemër (94 herë). Demokratik/e cilësohen: *Kosova 15 herë, Institucionet 14 herë, shteti 10 herë, zgjedhjet 6 herë, parlamenti 5 herë; pushteti 4 herë; vlera 4 herë; rregulli 3 herë; bota 3 herë; vlera 4 herë; rregull 3 herë; të drejta 3 herë; mënyrë 2 herë; shoqëri 2 herë; zhvillime 1 herë; pjesëmarrje 1 herë; procese 1 herë; modele 2 herë; parime 1 herë; garë 1 herë; ardhmëri 1 herë; standarde 3 herë; garë 1 herë.*

Sipas këtyre rezultateve vijmë në përfundim se *demokracia* përdoret më së shumti në lidhje me fjalët *Kosova*, *shteti*, *institucionet*. Ndërsa siq mund të shihet nga analiza më e gjerë e nënkorporit 1 këto fjalë nuk përdoren në kuptimin neutral të tyre por më shpesh janë të ngarkuara pozitivisht. Të glorifikuara këto fjalë shqiptarët i asociojnë me luftën për të qeverisur vetë në Kosovë. Për këtë arsye këto fjalë në kontekstin në të cilin përdoren, d.m.th në ligjërimin politik që për adresat ka publikun shqiptar të Kosovës identifikohen si fjalë me vlera të larta. E rrethuar më shumë me këto fjalë *demokracia* merr një aurë semantike pozitive. Por kjo nuk na thotë më shumë se si vihet në raport demokracia me fjalët *Kosovë* dhe *shtet*, e për këtë arsye na duhet të ndërmarim një analizë dhe ta zgjerojmë rreshtin konkordues për të parë të thënë në raport me kontekstin jashtëgjuhësorë.

#### *Aludimet dhe implikatura*

Analiza e aludimeve tregon se veqoritë semantike të fjalës *demokraci* në tekstet e nënkorporit 1 me frekuencë më të madhe janë: 1. Përfaqësimi, 2. Sovraniteti i popullit; 3. Vetëvendosje kolektive; 4. Parimi i shumicës; 5. Pranimi i rregullave të lojës; pranimi i rregullave paqësore dhe formale të krijimit të vullnetit dhe vendimimeve politike.

Demokracia rrethohet në tekste me një fjalor të emocionalizuar. Një shembull tipik është teksti në të cilin zgjedhjet nuk konceptualizohen vetëm si zbatim i parimit të pjesëmarrjes së barabartë në ushtrimin e pushtetit, por për më tepër ato shihen si një festë zyrtare, për arsye se populli i Kosovës për herë të parë zgjedh institucionet legjitime.

<sup>12</sup> Shih Fairclough 1995; Mautner 2000.

*<1> Sot kur po bëjmë promovimin e Programit të LDK-së dhe të deputetëve të LDK-së për Kuvendin e Kosovës, kemi ndjenjën e fuqishme për Kosovën tonë të dashur. Mbajtja e zgjedhjeve nacionale 2001 është një manifestim solem për të gjithë Kosovën. Është moment i shprehjes së vullnetit demokratik të popullit të Kosovës për të zgjedhur përfaqësuesit e vet legjitimë dhe institucionet legjitime të shtetit të vet: parlamentin, qeverinë dhe presidentin e Kosovës. Është akt solem, sepse mbahen në Kosovën e lirë. (Rugova Ibrahim, LDK, Bota Sot 11102001).*

Ky fjalim ndodh në një kontekst si në vazhdim: është fjala hyrëse e ish kryetarit të LDK Ibrahim Rugovës për hapjen e fushatës së vitit 2001. Rugova prezanton programin e partisë së tij dhe kandidatët për zgjedhjet. Fjalimi ndodh në kryeqytet, adresatë primare janë zgjedhësit shqiptarë, por prezent në atë takim janë edhe përfaqësues të OSBE-së. Në sfond ndëgjohej muzikë folklorike dhe para fjalimit transmetohej himni shqiptar.

Këtë paragraf e karakterizon strategjia e mobilizimit të masave por edhe vetëvlerësimi i Rugovës si një njeri, i cili lufton për mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në Kosovë. Pjesë e kësaj strategjie është në njërin anë vlerësimi i zgjedhjeve duke e theksuar tiparin e konceptit të demokracisë si “vetëvendosje kolektive”. Në anën tjetër paraqiten në tekst terme në plural të cilat aludojnë në përkatësinë grupe. P.sh. Fjalja, ‘kemi ndjenjën e fuqishme për Kosovën tonë të dashur. Ai flet për ‘ne’ dhe për të gjithë Kosovën’, për popullin e Kosovës’. Këto cilësime mund të jenë si aludime për shqiptarët e Kosovës, kur i analizojmë edhe në raport me të adresuarët e ligjëritimit dhe të kontekstit historik. Populli i Kosovës nuk do të kishte kuptim për serbët sepse ishin shqiptarët ata të cilët qysh me 1992 shprehën vullnetin për të qenë popull të një territor të pavarur. Me këtë mund të argumentohet edhe përdorimi i sintagmës deiktike “institucione legjitime”. Legjitimiteti në këtë kontekst i referohet legjitimitetit të së drejtës ndërkombëtare të këtyre institucioneve të cilat legjitimohen nga populli. Vetëm në këtë kontekst mund të arsyetohet glorifikimi i mbajtjes së zgjedhjeve si moment për të festuar. Për më tepër në pjesën e fjalisë në vazhdim sepse ‘mbahen në Kosovën e lirë’ implikon që edhe kur Kosova nuk ka qenë e lirë ka pasur zgjedhje. Kjo implikaturë mund të përmbajë si zgjedhjet që ka organizuar Serbia para luftës në Kosovë e poashtu edhe zgjedhjet që ka organizuar Institucionet paralele të krijuara para luftës nga shqiptarët e Kosovës në vitin 1992.

Më tutje në tekst vie në pah kuptimi i demokracisë si e drejtë për vetëvendosje kolektive. Vullneti i shqiptarëve për vetëvendosje paraqitet si një çështje që është shprehur edhe me dhjetëra vite më parë:

*<2> Themelet e shoqërisë dhe të shtetit të Kosovës janë vendosur me Deklaratën e Pavarësisë, Kushtetutën e Republikës së Kosovës (1990), me Referendumin për Pavarësi (1991), me zgjedhjet presidenciale e parlamentare më 1992 dhe më 1998, zgjedhjet presidenciale e parlamentare më 1992 dhe më 1998 si dhe janë mbrojtur me rezistencën e popullit të Kosovës, të mbrojtur nga SHBA-të, NATO, BE dhe bashkësia ndërkombëtare. (Rugova Ibrahim, LDK, Bota Sot 11102001).*

Në këtë paragraf listohen ngjarjet përmes të cilave shqiptarët në Kosovë e kanë shprehur kolektivisht vullnetin e tyre për vetëvendosje. Partia të cilën e përfaqëson Rugova në momentin që ai flet ishte organizatore e këtyre ngjarjeve. LDK identifikohet me këto ngjarje dhe i përdor ato si evidencë për të ngritur veten, si një parti që ka luftuar për vetëvendosjen e shqiptarëve në Kosovë. Se veqimi i këtyre ngjarjeve aludon në tiparin e demokracisë si vetëvendosje e popullit shqiptar në Kosovë mund të argumentohet me kontekstin në të cilin gjen vend fjalimi. Këtu janë present dy kategori publiku, njëri janë shqiptarët të cilët kanë shprehur vullnetin për të pasur pushtetin në Kosovë dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, qëllimi I të cilëve I shprehur në dokumente normative ishte ndërtimi o një shoqërie multietnike. Duke mos përmendur drejtëpërdrejtë, por duke përdorur si aludim ngjarjet që nënkuptojnë vetëvendosjen e shqiptarëve Rugova llogarit në një mirëkuptim të votuesve dhe shmang në të njëjtën kohë konfliktin me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare.

Edhe përfaqësues të partive të tjera politike përdorin angazhimin në të kaluarën për të koduar llojin e demokracisë, të cilën e favorizojnë ata. Hashim Thaci kryetar I Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) gjithashtu aludon në të kaluarën por më shumë në kryengritjen e armatosur. Këtu një shembull për të ilustruar se si Thaci përdor motivin e luftës si aludim. Ai vë në lidhje demokracinë ‘për të cilën do të punojë vazhdimisht partia e tij’ me ‘idealin e Adem Jasharit’.

*<3> Ju siguroj se PDK-ja do të punojë vazhdimisht që ta çojë në vend idealin e Komandantit tonë legjendar Adem Jasharit, idealin për pavarësinë e plotë dhe demokraci të Kosovës. Vota për PDK-në është votë për idealin e lirisë së Kosovës, është votë për mosriktimin kurrë të Serbisë në Kosovë. Prandaj përcaktohuni. siç jeni përcaktuar edhe më herët. për demokraci, për liri, për pavarësinë dhe përcaktimin, e kjo është vota për PDK-në. (Thaçi Hashim, PDK, Epoka e Re 13112001).*

Thaci në këtë fjalim shpalos programin e PDK për zgjedhjet në Skënderaj. Të pranishëm janë votues potencial shqiptarë, të cilët e kanë përjetuar nga afër luftën dhe

në këtë mënyrë mund të thuhet se më shumë u flet emocioneve të votuesve. Vetëvendsoja kolektive si tipar semantik i termit demokraci, përmes aludimit mbështetet në përmendjen e demokracisë për të cilën kishte luftuar Adem Jashari, e cila njëkohësisht implikon demokracinë të cilën e propagon Thaci. Demokracia të cilën e premtonte PDK barazvlerësohet me realizimin e Adem Jasharit. Në fjalinë e fundit Thaci përmbledh të dy termet të lirinë e Kosovës të cilën ai e konkretizon si liri nga Serbia. Ky konkretizim ndodh kur ai angazhimin e partisë së tij ia atribuon ‚idealit të lirisë së Kosovës‘ dhe që Serbia të mos kthehet kurrë më në Kosovë. Përmes paralelizmit ai i barazon këto dytribute. Interpretimi i mundshëm i Thacit për definicionin e demokracisë në këtë rast, si vetëvendosje e shqiptarëve në Kosovë mund të bazohet edhe në aktivitetet e Adem Jasharit. Ai nuk e kishte pranuar pushtetin shtetëror të Serbisë dhe e kishte luftuar atë. Ai si nismëtar kishte marrë pjesë në luftën e armatosur të këtij regjimi.

Jo vetëm në fushatat zgjedhore, por edhe në ditët përkujtimore kërkesat e shqiptarëve për vetëvendosje zëvendësohen me fjalën demokraci. Të shohim këtu një shembull ilustrativ:

*<4> Ky flamur u bë bashkëluftëtari më besnik i shqiptarëve në përpjekje të pashtritura historike për liri e demokraci, e këto përpjekje u bartën brez pas brezi dhe erdhën deri te trimat e UÇK, të cilët lidhën zinxhirin e përpjekjeve tona historike, duke mbajtur lartë këtë flamur të lavdishëm. (Çeku, Agim, Epoka e Re 29112000).*

Koncepti demokraci ngërthehet në një sekuencë, temë e së cilës është glorifikimi i flamurit shqiptar. Flamuri si simbol i identitetit kombëtar cilësohet si ‚bashkëluftëtarë për demokraci‘. Lufta për demokraci në këtë kontekst mund të implikojë luftën e shqiptarëve për vetëvendosje dhe bashkim. Sundimi i popullit i referohet pushtetit të popullit shqiptar në trojet e ku jetojnë shqiptarët shumicë. Kjo i afrohet konceptit të demokracisë etnike sipas Smoohas (shih më lartë).

Rrethanat situative në të cilat mbahet fjalimi por edhe ato historike që lidhen me flamurin mund të merren bazë për dekodifikimin e demokracisë në këtë paragraf. Është Dita e flamurit 28.Nëntori, data e themelimit të shtetit shqiptarë. Shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës kishin luftuar për themelimin e këtij shteti, megjithëse Kosova nuk ishte njohur ndërkombëtarisht si pjesë e Shqipërisë. Skënderbeu një autoritet, mbi mitin e të cilit mbështetet vetëdija kombëtare e shqiptarëve si komb. Me fjalinë ‚trimat e UÇK, të cilët lidhën zinxhirin e përpjekjeve tona historike, duke mbajtur lartë këtë flamur të lavdishëm‘ folësi aludon në luftën e fundit në Kosovë.

„Zingjiri i lidhur“ asociohet një proces i përmbyllur. Këtë metaforizim mund ta interpretonim edhe si „UCK ka përfunduar luftën për sundimin e shqiptarëve në territoret e tyre“. Përfundimi logjik i nxjerrë nga ky paragraf mund të jetë se shqiptarët do të kenë vetë pushtetin në territoret në të cilat ata jetojnë. Kështu shtrohet pyetja çfarë funksioni kryen termi *demokraci* dhe metafora që karakterizon gjithë këtë pjesë të fjalimit. Në radhë të parë kjo metaforë shmang konfliktin me bashkësinë ndërkombëtare. Ideja e një Shqipërie etnike, që nënkupton bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, për shkak të pasojave politike mbetet tabu. Së dyti përmes përdorimit të kësaj metafore fjalimi merr ngjyrim emocional.

Një veqori tjetër semantike që e karakterizon fjalën *demokraci* në nënkorporusin 1 është përfaqësimi. Fjala *demokraci* në korpus shfaqet më së shpeshti si mbiemër. Përfaqsimi shprehet në fjalitë e politikanëve të cilat kanë si referencë institucionet e kryetarit, kryeministrit, parlamentit. Këto institucione shpesh cilësohen si demokratike. Këto vihen në lidhje me motive si pavarësia dhe shtetësia. Politikanët i vlerësojnë këto institucione, duke argumentuar se ato po legjitimohen përmes zgjedhjeve. Në zgjedhje politikanët premtojnë se këto institucione do të zbatojnë vullnetin e popullit të Kosovës për pavarësi. Ky është motivi me të cilin politikanët e argumentojnë cilësinë e të qënurit demokratik të institucioneve. Tipare të tjera si shteti ligjor, të drejtat e njeriut, mirëqënia paraqiten shumë rrallë në ligjërim.

Politikanët premtojnë që këto institucione do të përfaqësojnë vullnetin e popullit, por thënie e tyre për mënyrën se si do ta bëjnë këtë janë shumë të vagullta. Ata përdorin strategjinë e mjegullimit përmes fjalëve duke përdorur terme të pastërholluara e të paqarta. Pavarësia si qëllim i „institucioneve demokratike“ shprehet si një arritje pa një kufi kohor të caktuar. Në fjalitë në të cilat premtohet se institucionet demokratike do të reflektojnë vullnetin për pavarësi, gjejmë folje të cilat shprehin veprimtari por jo një veprim të caktuar për një kohë të caktuar. Koha e foljeve është e ardhme, e përdorur si modalitet „do të“ e cila shpreh një kategorialitet të fuqishëm. Në rreshtet konkordive përreth fjalës demokraci nuk gjenden ndajfolje kohe, që con në përfundimin se demokracia si vetëvendosje e popullit nuk do të ndodh në një kohë të caktuar por është e vazhdueshme. Një shembull tipik është fjalia: „do t’i zgjedhim organet tona legjitime, duke filluar nga presidenti Qeveria dhe Parlamenti që do ta qojnë Kosovën më tutje në rrugën e lirisë, pavarësisë dhe demokracisë“.

Kur flitet për institucionet ato përdoren të pasuara nga cilësori shtetërore dhe përmes përcaktimit të detyrës së këtyre institucioneve duke përdorur implikaturën arritjen e pavarësisë. Por asnjëherë nuk gjejmë rrethorë kohe ose mënyre që shpjegojnë se si dhe kur. Institucionet kanë veprimtari por jo veprim të njëhershëm.



Përderisa pavarësia siq njihet me aktet ndërkombëtare është akt I njëhershëm dhe jo rezultat i veprimtarisë së vazhdueshme. Përzgjedhja e foljeve, të cilat shprehin procese të përgjithshme i lë mundësinë zgjedhësit të besoj se pavarësia do të arrihet menjëherë pas zgjedhjeve.

Se si gërshetohen motivet e pavarësisë dhe shtetësisë me institucionet demokratike dhe si realizohet strategjia e mashtrimit përmes fshehjes së deficiteve të qartësisë tregojnë shembujt në vazhdim.

*<5> Sot Kosova në lirinë e merituar, në demokracinë e re, po ndërton institucionet demokratike për të gjithë qytetarët e Kosovës, po ngrit themelet e shtetësisë së saj. Më 17 nëntor, populli i Kosovës do të zgjedhë lirshëm parlamentin e Kosovës, që do ta udhëbejë Kosovën drejt paqes dhe stabilitetit, ekonomisë së zhvilluar, demokratizimit, pavarësisë dhe integritetit në strukturat evropatlantike. (Haradinaj Ramush, AAK, Epoka e Re, 0410 2004).*

*<6> Ne kërkojmë që të votoni për LDK në, siq keeni bërë deri më tani. LDK-ja duhet të ketë një shumicë absolute për t'i udhëbëhur institucionet e vendit tonë në mënyrë efektive në të mirë të shtetit të Kosovës. Vota juaj na jep fuqi dhe ne e mbajmë me krenari dhe shumë përgjegjësi atë, që të ndërtojmë një Kosovë të pavarur, demokratike, paqesore, me mirëqenie të plotë dhënë të pasur për të gjithë qytetarët e saj. (Rugova, Ibrahim, LDK, Bota Sot, 14102004).*

*<7> Ne kemi treguar sesi ndërtohet partia, kemi ndërtuar vetë një parti moderne, në mënyrë që ti hapim perspektivë fitores në zgjedhjet e përgjithshme, të ndërtojmë institucione moderne, demokratike dhe të demokratizojmë ato institucione dhe shoqërinë e Kosovës, në mënyrë që të fitojmë një mbështetje edhe me të fuqishme politike, diplomatike dhe natyrisht edhe për investime ekonomike në Kosovë, nga bota“. (Thaçi Hashim, PDK, ER 16112001).*

Në këta tre shembuj vlerësohen institucionet që do të dalin nga zgjedhjet. Së pari ato vlerësohen si 'shtetërore', së dyti institucionet do ta kenë detyrën për arritjen e pavarësisë. Këtë veprim ata u mveshin institucioneve e jo vetes. Përmes metonimisë shmangin përgjegjësinë personale dhe ja mveshin këtë përgjegjësi institucioneve p.sh. nuk gjenden në tekste referentë të qartë si ,ne si përfaqësues të institucioneve' por subjekte si ,parlamenti'. Në të gjithë shembujt theksi vihet te institucionet dhe te pavarësia. Se si dhe kur do të arrihet pavarësia mbetet e pathënë, fshihet përmes petëzimit të fjalëve. Institucioneve ju vishet një veprimtari e jo një veprim. Psh. Formulimet si ,Parlamenti do të qoj Kosovën drejt pavarësisë'; ,Demokratizimi i institucioneve për të marrë një përkrahje politike ndërkombëtare më të madhe'. Pavarësia shihet si rezultat i veprimtarisë së institucioneve. Në praktikën e së drejtës

ndërkombëtare shtetet e kanë shpallur mvetësinë e tyre qoftë si koloni, pjesë e një federate apo konfederate përmes një akti ligjor, shpalljen e pavarësisë. Shpallja e pavarësisë është një veprim i njëhershëm që nuk shpreh vazhdimësi. Përzgjedhja e foljeve të cilat shprehin procese të përgjithshme, i lë mundësinë zgjedhësit të besojë se pavarësia do të ndodhë menjëherë pas zgjedhjeve.

### **Konceptualizimi i demokracisë në nënkorporusin 2 – Demokracia qytetare „pranim i pluralitetit të grupeve“ dhe „e drejtë e individit për vetëvendosje“**

Analiza e teksteve në nënkorporusin 2 tregon se në krahasim me tekstet e nënkorporisit 1 këtu demokracia konceptualizohet ndryshe. Ambienti semantik i fjalës *demokraci* ndryshon nga ambienti i kësaj fjale në nënkorporusin 1. Në nënkorporusin 1 grupi i fjalëve *demokraci dhe demokratik/e* rrethohet nga fjalë si *Kosova, shteti, institucionet*. Ambienti semantik në këtë nënkorporus është indikator për konceptualizimin e demokracisë si realizim i vullnetit nacional të shqiptarëve për të qeverisur Kosovën, një model i demokracisë të cilin mund ta fusim në konceptin e demokracisë etnike sipas Smoohas.

Analiza sasiore e teksteve në nënkorporusin 2 përmes softverit concordance për fushën kollokative tregoi rezultatet si në vazhdim:

*Fusha kollokative e grupit të fjalëve „Demokraci/a, demokratik/e“*

Në nënkorporusin 2 fjala *demokraci* paraqitet si emër në një frekuencë prej 29 herësh ndërsa si mbiemër *demokratik/e* 89 herë. Në paraqitjet si emër shpesh shoqërohet nga një mbiemër që tregon llojet e demokracisë të cilat duhet të zbatohen në Kosovë. P.sh. *demokracia parlamentare 4 herë, demokracia qytetare 3 herë, demokracia si pushtet i popullit 2 herë, shteti i së drejtës, identiteti qytetar. Demokracia* paraqitet edhe e shoqëruar me fjalët si *vepra, respektimi i të drejtave të njeriut, shteti, identiteti qytetar, shoqëria civile*.

Mbiemri *demokratik/e* paraqitet si atribut për emrat *proces 9 herë, Kosovë 7 herë, institucione 6 herë, vend 4 herë; pushtet 4 herë; tolerant 3 herë; paqësore 3 herë, forca 3 herë, mundësi 2 herë; procedura 2 herë; struktura 3 herë; qeveria 1 herë; qeverisje 1 herë, shoqëri 2 herë; vlera 3 herë; pavarësia 1 herë; vetëqeverisje 1 herë; shtet 2 herë; sistem 1 herë; nivel 1 herë; organizim 1 herë*.

Fjalorin me të cilin shoqërohet grupi i fjalëve *demokracia, demokratik/e* mund ta ndajmë në tre regjistra: 1.Termet *Kosova, Shteti Qeveria* na kujtojnë fjalorin e stukturave të shteteve të pavarura. Këto mund të shpjegohen me definicionin e demokracisë si „shtet me kushtetutë demokratike, sistem qeverisës demokratik, sovranitet të

popullit“. 2. Termet *rregull, pushtet, vetëqeverisje, zgjedhje, sistem, vend, qeverisje* përshkruajn një sistem qeverisës. Sistemi qeverisës nuk duhet që patjetër të barazohet me shtetin si entitet në të drejtën ndërkombëtare. Edhe vendet pjesë të një federate, provincat e komunat qeverisen dhe kanë qeveri. Kjo është një indikatorë që tregon se *demokracia* këtu përdoret për të përshkruar „një sistem qeverisës në të cilin pushtetin e ushtrojnë të zgjedhurit nga populli“. 3. Termet *zhvillim, mënyrë, mundësi, shoqëri* janë terme shumë të përgjithsuara. Kur këto cilësohen si demokratike atëherë kjo lidhje na lë të kuptojmë se me këtë nënkuptohet definicioni i demokracisë si „princip i krijimit të lirë dhe të barabartë të vullnetit dhe bashkëvendimmarrjes në grupet shoqërore“.

#### *Analiza e aludimeve dhe implikaturës*

Indikatorët që ofron fusha kollokative nuk janë të mjaftueshëm për të ardhur deri te përfundime valide e gjithpërfshirëse për konceptualizimin e demokracisë në të gjithë diskursin politik-publik të politikinavë kosovarë. Andaj ishte më se e nevojshme të studiohen kategoritë gjuhësore si aludimet dhe implikaturat, për të parë se si konceptualizohet *demokracia* në tekst dhe kontekst të nënkorporit 2 dhe cilave strategji u shërben ajo.

Fjala *demokraci* përdoret më së shumti në katër ngjarje diskursive, në bërjen zyrtare të planit për zbatimin e strategjisë së UNMIK-ut Standardet për Kosovën (24 herë), gjatë bisedimeve për decentralizimin (20 herë) dhe në fillim të bisedimeve për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës (11 herë).

Në diskutimin për standardet e UNMIKU-t për Kosovën dhe bisedimet për statusin *demokracia* vihet në lidhje me “njohjen e pluralitetit dhe heterogjenitetit të grupeve” dhe “njohjen e të drejtës për vetëvendosje të individëve”. Me këtë nënkuptohet pjesëmarrja e Serbëve të Kosovës në ushtrimin e pushtetit. Në këtë pjesë të korpusit paraqitet për herë të parë koncepti i demokracisë qytetare. Në bisedimet për decentralizimin theksohet veqoria e demokracisë “njohja dhe pranimi i parimit të barazisë”.

Shembujt në vazhdim tregojnë se si përdoret termi *demokraci* në diskursin për standardet. Këto pjesë tekstesh janë deklarata të politikanëve të bëra në një konferencë shtypi. Konferenca për shtyp u organizua ditën kur Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes e bënë publike fillimin e zbatimit të standardeve të UNMIK-ut. Në këtë konferencë morën pjesë Ibrahim Rugova, ish Kryetar i Kosovës, Bajram Rexhepi,

ish kryeministër i IPVK-së, Hashim Thaqi, kryetar i PDK-së dhe Ramush Haradinaj kryetar i AAK-së.

<9> *Plotësimi i standardeve lidhet drejtëpërsëdrejti me të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës dhe ky moment dëshmon përshpejtim të proceseve nëpër të cilat po kalon Kosova e të cilat kanë për synim bërjen e Kosovës një vend demokratik sipas standardeve evropiane ku të gjithë do t' i gëzojnë të drejtat e barabarta dhe do të jetojnë në paqe dhe prosperitet. (Rexhepi Bajram, Kryeministër, PDK, KD 11122003).*

<10> *Dokumenti që e kemi sot para nesh është një specifikim i standardeve sipas fushave të caktuara. Standardet, që bashkësia ndërkombëtare i kërkon nga Kosova, kanë për qëllim vlerësimin e të arriturave të Kosovës, para vendosjes së statusit final të Kosovës, që për ne është pavarësia, si dhe përmbushjen e normave për integrim në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në bashkësinë ndërkombëtare. (Rugova Ibrahim, Kryetar, LDK KD 11122003).*

<11> *Standardet nuk janë vetëm standarde për statusin, por edhe për integrimin e Kosovës në strukturat veriatlantike. Ju e dini se edhe disa vende të tjera të pavarura që kanë dalë nga ish Jugosllavia dhe Evropa Juglindore edhe sot janë në fazën e implementimit të këtyre standardeve. Unë jam 100 përqind i sigurt se deri në vitin 2005 nuk do të arrijmë t'i realizojmë, por do të sigurojmë bazë solide për rend demokratik në Kosovë, që nënkupton njohjen e realitetit për ndërkombëtarët dhe njohjen e vullnetit të qytetarëve për pavarësinë e Kosovës. Mospërmbushja e këtyre standardeve nuk do t'a çparrisë statusin vetëm nëse të gjithë do të angazhohemi për pavarësi dhe demokratizim të vendit. (Thaçi Hashim, PDK, KD 11122003).*

Strategjia ligjërimore, e cila ndiqet në këto tekste është vlerësimi pozitiv i standardeve. Motivi për këtë vlerësim është demokracia, e ndërlidhur me pavarësinë, por edhe integrimi në strukturat perëndimore. Demokracia paraqitet këtu si rrjedhojë e standardeve. Se çfarë lloji i demokracisë nënkuptohet mund të përndrisim më së miri duke e parë më për afër shembullin 9. Me shprehjen ,ta bëjmë Kosovën një vend demokratik me standarde evropiane, në të cilat të gjithë do ti gëzojnë të drejtat e barabarta dhe jetojnë në paqe e mirëqënie', shpjegohet koncepti i vendit demokratik, si një vend ku të gjithë gëzojnë të drejta të barabarta. Shtrohet pyetja kush janë të gjithë. Në këtë kontekst flitet për standardet, një dokument ligjor i përgatitur enkas për të zbatuar të drejtat e grupeve etnike pakicë në Kosovë dhe jo vetëm të shqiptarëve.<sup>13</sup> Veqoria semantike që e përdor Rexhepi për të konceptualizuar demokracinë është ,njohja e pluralitetit të grupeve'.

---

<sup>13</sup> Shih dokumentin "Standards for Kosovo".

Edhe Thaci në arsyetimin e tij për pranimin e standardeve përdor termin demokraci. Edhe pse ai shprehet se është skeptik për zbatimin e standardeve në këtë fazë, ai i sheh ato si një kontribut për një *rend demokratik*. Në *rendin demokratik* ai përmbledh apo fut shumë më shumë se Rexhepi, meqenëse nuk e sqaron, por e lë të nënkuptohet. Edhe pse sintagma *„rend demokratik“* është shumë e përgjithshme, në këtë kontekst ku është përdorur mund të nxirren disa lloj kuptimesh të kësaj sintagme. Thaci thotë se „standardet nuk mund të zbatohen 100% deri më 2005, por do të krijohet një bazë solide për rend demokratik“. *Rendi demokratik* subsumohet në standarde sepse i referohet fjalës „standarde“ me të cilën ai e fillon fjalinë. Dhe nëse standardet në vetvete janë një realizim i konceptit të demokracisë si bashkëqeverisje e grupeve etnike atëherë Thaci këtu conceptualizon demokracinë si „njohje e pluralitetit të grupeve“. Për më tepër që të tre Rugova, Thaci e Rexhepi, flasin për standardet si pjesë e zbatimit të normave për integrim në Bashkimin Evropian. Thaci e Rugova përmendin edhe NATO-n. Paraqitja e standardeve si ndihmë apo kontribut për integrim në BE dhe NATO, nënkupton pranimin e obligimit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve etnike. Si anëtrsimi në BE e poashtu edhe në NATO ka parakusht mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pakicave e poashtu edhe zgjidhjen e konflikteve në rrugë paqësore.<sup>14</sup> Vënia në lidhje e standardeve me integrimin në BE dhe NATO presupozon theksimin e veqorisë semantike të demokracisë si „Njohje e pluralitetit të grupeve si pasojë e të drejtës individuale për vetëvendosje“.

Përdorimi i motivit të integritimit në BE dhe NATO për vlerësimin pozitiv të standardeve është në kontekstin ku përdoret më me ndikim, për arsye se të dy grupet, të cilave u adresohen politikanët në këtë rast, si pjesëtarët e bashkësisë ndërkombëtare, poashtu edhe zgjedhësit e të cilat grupe janë vendosëse për të legjitimuar apo jo pushtetin e këtyre politikanëve, mund të përfitohen më këtë motiv. Për publikun mesatar integrimi në BE dhe NATO asociohen me mirëqenien dhe sigurinë e me shanse për një jetë më të mirë. Në atë kohë ka qenë jorealiste të pritët integrimi i Kosovës dhe BE dhe NATO. Për publikun e informuar në atë kohë ishte jorealiste përdoimi i këtyre dy argumenteve për të vlerësuar pozitivisht standardet para statusit

---

<sup>14</sup> Në Planin Veprues për anëtarësimin në NATO këto janë kriteret e para të cilat duhet të plotësojë një vend kandidat për anëtarësim në këtë organizatë. Shih NATO Membership Action Plan. NATO Press Release NAC-S (99)66. 24 04. 1999, në: <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-066e.htm>; Edhe kriteret e Kopenhagës të BE nga vendet candidate për anëtarësim kërkojnë plotësimin e kriterëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Shih: Bruno 2005 dhe Europäischer Rat Kopenhagen 21-22 Juni 1993, Schlussfolgerungen des Vorsitzes. SN180/1/93. S.13. URL: [http://ue.eu.int/ueDocs/cms\\_Data/docs/pressData/de/ec/72924.pdf](http://ue.eu.int/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/de/ec/72924.pdf).

ishite një strategji retorike iracionale se sa realiste.<sup>15</sup> Politikanët përdorin fjalët me vlerë të lartë demokraci, pavarësi dhe NATO e BE për të mjegulluar paraqitjen e thelbit dhe qëllimit të zbatimit të dokumentit të standardeve i cili ishte krijimi i një Kosove multietnike në kuptimin e pjesëmarrjes së grupeve etnike në qeverisjen e vendit.

Në bisedimet për statusin politik të Kosovës theksohet veqoria semantike e konceptit të demokracisë si „e drejtë e individëve për të vetëvendosur“. Në vend të konceptit të demokracisë, si sundim i popullit etnik, i cili koncept dominon në korpusin e parë që për publik primarë ka zgjedhësin kosovar, në bisedimet për statusin dhe në dokumentin final për zgjidhjen e statusit politik shpërfaqet dhe nga politikanët pranohet demokracia si sundim i popullit të shtetit të Kosovës, dhe si pjestarë të popullit të shtetit të Kosovës nuk janë më vetëm shqiptarët por të gjitha grupet etnike. Në këto bisedime dhe në dokumentin final për zgjidhjen e statusit i njohur si propozimi i Ahtisarit<sup>16</sup> merret për bazë dhe dominon koncepti i „demokracisë qytetare“. Për demokracinë qytetare në ardhë të parë vihet vetëvendosja e qytetarëve të Kosovës si individë e jo më të grupeve etnike si Shqiptarët apo Serbët.

Shembulli më përfaqësues për këtë koncept të demokracisë është dokumenti të cilin e kishin nënshkruar përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës me ndërmjetësuesin e bisedimeve për statusin.

Në këtë dokument shpërfaqen qëndrimet e delegacionit të Kosovarëve edhe sa i përket zgjidhjes së statusit por edhe rezultatit të këtij procesi. Statusi të cilin e propozojnë ata është Kosova si shtet i pavarur me një sistem demokratik, i cili e nxit krijimin e një identiteti shtetëror qytetarë.

Grupi i fjalëve demokraci paraqitet në pjesën e dytë të dokumentit ku përshkruhet sistemi politik i Kosovës si shtet i pavarur. Këtë pjesë e karakterizojnë strategjia e politikave afirmative ndaj grupeve pakicë në Kosovë. Kjo pjesë fuqizon qëndrimin e politikanëve, për ndërtimin e një sistemi demokratik i cili pasqyron jo vetëm vullnetin e shumicës shqiptare, por edhe interesat në radhë të parë të etnisë serbe.

Termi demokraci barazohet me njohjen e pluralitetit të grupeve shoqërore. Si sundim i popullit, nuk postulohet vetëm sundimi i një populli etnik, por propozohet

<sup>15</sup> Edhe studiuesit dhe politikanët ndërkombëtarë i shihnin këto standarde si shumë idealiste dhe në kontekstin e aktualitetit të atëherëshëm në Kosovë si të pazbatueshme. Shih Ingimundarson 2007: f. 98; Raporti HSK 2004: f.6; Bugajski/Hitchner/Williams 2003:f.6ff .

<sup>16</sup> Dokumenti ishte derivat i një rezolute të Kuvendit të Kosovës, e cila i parapriu bisedimeve për statusin. Kjo rezolutë shprehte përsëri vullnetin e shqiptarëve të Kosovës për të jetuar në një shtet të pavarur.

Dokumenti me titull: DOKUMENTI I DELEGACIONIT TË KOSOVËS DORËZUAR KRYNEGOCIATORIT MARTI AHTISARI u publikua në shtypin ditor.

një sistem demokratik që ka parasysh sundimin e Kosovarëve si qytetarë të shtetit. Demokracia përkundër teksteve të nënkorporit 1 kët nuk vihet më në lidhje me motive si lufta apo e kaluara, por me motive si të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja e pakicave në qeverisje. Në konferencën e parë për shtyp pas takimit në të cilin delegacioni i Kosovës i kishte dërguar këtë dokument Ahtisarit, Thaci shpjegon llojin e demokracisë të cilën delegacioni i Kosovës i kishte propozuar atij të ndërtohej në Kosovë:

*<12> është një fillim i mirë, një fillim i ri dhe i mbarë. Delegacioni i Kosovës paraqiti qëndrimet e qarta dhe unike, për një status që do t'i hapë perspektivë evropiane vendit që do ndikonte edhe në stabilitetin e paqen në rajon. Një shtet i pavarur dhe sovran që do të ndërtohet demokracia qytetare në identitet shtetëror dhe një vend i integruar në strukturat evropatlantike. (Thaci Hashim, PDK, Epoka e Re 23 112005.)*

Në këtë tekst Thaci paraqet qëndrimin e delegacionit kosovar. Para se të filloj të paraqes këtë qëndrim ai e vlerëson atë pozitivisht duke e cilësuar si një propozim që „do të ndikonte edhe në stabilitetin e paqen në rajon“. Këto dy aspekte janë të rëndësishme për komunitetin ndërkombëtar njëri nga faktorët vendimmarrës për statusin e Kosovës. Komuniteti ndërkombëtar është ndërmjetësues në bisedimin për statusin në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Pas këtij vlerësimi Thaci prezanton konceptin e shtetit demokratik që delegacioni ka propozuar. Për demokracinë përdor togfjalëshin „demokraci qytetare me identitet shtetëror“. Në krahasim më nënkorporit 1 ai nuk flet më për „demokracinë që merr parasysh vullnetin e popullit“ por këtu flet për „identitet shtetëror“. Identiteti shtetëror presupozon identitetin e kosovarit, pavarësisht nga prejardhja etnike. Kosova si shtet nuk do të njeh më grupet etnike, por vetëm qytetarët. Ky pranim i demokracisë qytetare konkretizohet më tutje përgjatë tërë dokumentit për statusin politik.

Si shembull për ilustrim këtu më poshtë kemi analizuar disa nga pjesët e dokumentin në të cilat delegacioni shpaloq qëndrimet e tij për sistemin demokratik, që merr parasysh ineteresat e të gjitha grupeve etnike.

*<13> 4.1. Shteti i ardhshëm demokratik i Kosovës do të jetë shtet ligjor në të cilin do të kenë qasje të gjithë qytetarët e saj. Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të barabartë të jetojnë në paqe dhe siguri dhe t'u respektohen të drejtat e tyre individuale dhe politike. Kushtetuta e ardhshme e Kosovës dhe strukturat e Qeverisë do t'u sigurojnë të gjithë qytetarëve të Kosovës mbrojtje të plotë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Shteti i Kosovës garanton ndërtimin e mëtejshëm dhe funksionimin e institucioneve demokratike.*

4.2. *Delegacioni i Kosovës zotohet për organizimin e tillë të qeverisjes ashtu që të gjithë komunitet e Kosovës të kenë pjesëmarrje të drejtë në Qeveri, si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendror. Delegacioni i Kosovës është i vetëdijshëm për rëndësinë që ka decentralizimi në sigurimin e kësaj të drejte. Delegacioni i Kosovës dhe institucionet e Kosovës do të hartojnë komizën e dubur ligjore për reformën e pushtetit lokal. Kosova do të krijojë struktura efektive demokratike të vetëqeverisjes lokale në shërbim të lehtësimit të bashkëjetesës dhe të komuniteteve të ndryshme për të siguruar qasjen e drejtë në shërbimet publike. (Bota Sot 25112005).*

Në këto dy paragrafe shpërfaqet qartë strategjia për të vendosur identitetin qytetarë para atij etnik. *Demokracia qytetare* e përdorur si term në mënyrë shumë të përgjithshme në fjalinë e parë konkretizohet më tutje në paragrafet në vazhdim. Në tërë dokumentin flitet për qytetarin e jo për popullin. Pastaj siguri i të drejtave qytetare e jo kolektive. Për vetëvendosjen individuale në pjesëmarrjen në qeverisje propozohen forma të ndryshme të pjesëmarrjes në pushtet. Delegacioni zotohet për të mbrojtur këto të drejta përmes kushtetutës. Njëra nga masat për të siguruar pjesëmarrje të qytetarëve të grupeve etnike është decentralizimi. Ky tekst është i pari në korpus në të cilin parashihet identiteti i Kosovës në të ardhmen si shtet jo njëetnik. Megjithatë edhe këtu asnjëherë në mënyrë të drejtëpërdrejtë nuk flitet për shtetin multietnik. Kosntruktohet një identitet që është mbietnik. Politikanët në këtë dokument propozojnë krijimin e identitetit të Kosovarit si qytetar shteti.

Siq ka treguar analiza e teksteve të tjera deri në këtë pikë politikanët shqiptarë mbronin qëndrimin për ndërtimin e një demokracie në Kosovë që nënkuptonte sundimin e popullit si kolektiv, që në konceptin e Smoohas është demokracia etnike, me të cilin ata edhe kishin marrë legjitimitetin nga qytetarët për të ardhë në pushtet. Shteti i Kosovës i propozuar dhe i oktrojuar nga Bahskësia Ndërkombëtare parasheh konceptin e demokracisë si realizim i të drejtës së individit për vetëqeverisje.<sup>17</sup>

<sup>17</sup> Grupi i Kontaktit, i cili ishte përgjegjës për Bisedimet Ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit të Kosovës, kishte mbrojtur qëndrimin për krijimin e një shteti multietnik. Në pjesën e dokumentit në të cilën Grupi I Kontaktit paraqet parimet e bisedimeve thuhet se “marrëveshja për statusin duhet të sigurojë multietnicitetin dhe pjesëmarrjen e të gjitha grupeve etnike në strukturat e pushtetit sit ë nivelit lokal e poashtu edhe të atij qendror. Shih Guiding principles of the Contact Group for a settlement of the status of Kosovo. URL: <http://www.unosek.org/>. Edhe në një deklaratë të bërë pas një takim të përfaqësuesve të nivelit të lartë të BE dhe Këshillit të Sigurimit të KB thuhet edhe njëherë se „Ministrat theksojnë rëndësinë e një marrëveshje për statusin e Kosovës, e cila promovon një shoqëri multietnike”. Shih Kosovo Contact Group Statement. London, 31.01.2006. URL:[http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/060130-KOSOVO\\_CONTACT\\_GROUP\\_STATEMENT.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/060130-KOSOVO_CONTACT_GROUP_STATEMENT.pdf)



## Përmbledhje

Në këtë tekst kemi trajuar poliseminë e fjalës „*demokraci*“ dhe përdorimin e saj nga politikanët kosovarë për legjitimimin e pushtetit, para dy grupeve të publikut me preferenca të ndryshme për sistemin demokratik që duhej vendosur në Kosovë në periudhën 2001-2005. Kemi ardhur në përfundim se konceptualizimi i demokracisë lëviz në varësi nga ngjarja diskursive dhe nga publiku primar të cilit i drejtohen politikanët kosovar për marrjen dhe ruajtjen e pushtetit. Në nënkorporusin 1 i cili për adresat ka qytetarin shqiptar të Kosovës fjala *demokraci* ka tiparin semantik të vetëvendosjes së popullit për qeverisje. Pra karakteristike për këtë korpus është përdorimi i *demokracisë etnike* si koncept. Deri te këto përfundime qojnë analiza e fushës kollokative dhe implikaturës e aludimeve në ngjarje në të cilat shqiptarët e Kosovës kishin shprehur vullnetin e tyre për të qeverisur me Kosovën. Ata argumentojnë me parimet karakteristike të demokracisë të shtrira edhe në modelin e Smoohas si sovraniteti i popullit, vetëvendosje kolektive dhe reprezentim. Në korpusin 2 vihen në rend të parë veqoritë semantike të demokracisë si barazia, trajtimi i barabartë i të gjithë individëve, njohje e pluralitetit të grupeve, pra demokracia qytetare. Deri te këto gjetje kemi ardhur duke përdorur kategoritë analitike gjuhësore si fusha kollokative dhe aludimet e implikatura.

## Bibliografia:

1. Agani, Fehmi 2002: Demokracia, Kombi, Vetëvendosja. Basha, Eqrem/Ismajli, Rexhep/Maliqi, Shkëlzen/ Islami, Hivzi (Hrsg.). Prishtinë: Dukagjini.
2. Austin, J. L. 1962: How to do things with words. Oxford: Oxford University Press.
3. Andersen, Aasmund 2002: Transforming Ethnic Nationalism. The Politics of Ethno-Nationalistic Sentiment Among the Elite in Kosovo. URL: <http://www.aasmundandersen.net/1nationalism.htm>.
4. Böke, Karin / Jung, Mathias/Wengeler, Martin (Hrsg) 1996: Öffentlicher Sprachgebrauch.
5. Praktische, theoretische und historische Perspektiven. Georg Stötzel zum 60.
6. Geburtstag. Opladen: Westdeutscher Verlag 1996. S. 430–452.

7. Bugajski, Janusz/Hitchner, Bruce R./Williams, Paul 2003: Achieving a Final Status Settlement for Kosovo. Washington: Center for Strategic and International Studies.
8. Burkhardt, Armin 2003: Das Parlament und seine Sprache. Studien zu Theorie und
9. Geschichte parlamentarischer Kommunikation. Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
10. Brockhaus Enzyklopädie 1999: 19. Auflg., B.26. Deutsches Wörterbuch. Mannheim.
11. Dieckmann, Walther 1979: Politische Sprache/ Maßstäbe ihrer Bewertung. In: Ermer Karl Hrg. Loccumer Protokolle 20/1979.
12. Dieckmann, Walther 1974: Sprache in der Politik. Einführung in die Pragmatik und Semantik der politischen Sprache. Heidelberg: Winter.
13. Dieckmann, Walther 1969: Sprache in der Politik. Einführung in die Pragmatik und Semantik der Politischen Sprache. Heidelberg: Carl Winter Universitätsverlag.
14. Duden 2007: Duden Deutsches Universalwörterbuch. 6. überarbeitete Auflage.
15. Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich: Dudenverlag.
16. Elsie, Robert (2004): Historical Dictionary of Kosova. Lanham.
17. Fairclough, Norman 2003: Analysing Discourse. Textual Analysis for Social Research. London: Routledge.
18. *Fairclough, Norman 2000: New Labour, New Language?* London: Routledge.
19. Fairclough, Norman 1992: Discourse and social Change. Cambridge: Polity Press.
20. Fairclough, Norman 1989: Language and power. London: Longman
21. Fowler, Roger 1991: Language in the news. Discourse and ideology in the press. London:Routledge.
22. Girnth, Heiko 2002: Sprache und Sprachverwendung in der Politik. Eine Einführung in die linguistische Analyse öffentlich-politischer Kommunikation. Germanistische Arbeitshefte 39. Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
23. Hayakawa, S.I. 1964: Language in Thought and Action. 2Ed. New York [u.a.]: Harcourt, Brace & World Inc..
24. Jäger, Siegfried 2001: Kritische Diskursanalyse. Eine Einführung, aktual. Neuauf lage.
25. Duisburg: DISS.

26. Januscek, Franz 1986: Arbeit an Sprache. Konzept für die Empirie einer politischen Sprachwissenschaft. Opladen: Westdeutscher Verlag.
27. Klein, Joseph 1998: Politische Kommunikation als Sprachstrategie. Në: Jarren, Ottfried/Sarcinelli, Ulrich/Saxer, Ulrich (Hrsg.): Politische Kommunikation in der demokratischen Gesellschaft. Opladen: Westdeutscher Verlag. S. 376–395.
28. Klein, Joseph 1989: Wortschatz, Wortkampf, Wortfelder in der Politik. Në: Klein, Joseph (Hg.): Politische Semantik , Bedeutungsanalytische und sprachkritische Beiträge zur politischen Sprachverwendung. Opladen: Westdeutscher Verlag. S. 3–50.
29. Kühn, Peter 1995: Mehrfachadressierung. Untersuchungen zur adressatenspezifischen Polyvalenz sprachlichen Handels. Në: Henne, Helmut [u.a.] (Hrsg): Reihe Germanistische Linguistik 154. Tübingen: Niemeyer.
30. Lijphart, Arend 2008: Thinking about democracy. Power sharing and majority rule in theory and practice. New York: Routledge.
31. Linz, Juan J. /Stepan, Alfred 1996: Problems of democratic transition and consolidation. Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe. London:Baltimore.
32. Massing, Peter 2007: Në: Weißeno, Georg/Peter Hufer, Klaus/ Werner Kuhn, Hans, Massing, Peter (Hrsg.). Wörterbuch Politische Bildung. Wochenschauverlag.
33. Mautner, Gerlinde 2000: Der britische Europa-Diskurs. Methodenreflexion und
34. Fallstudien zur Berichterstattung in der Tagespresse. Wien: Passagen Verlag.
35. Merkel, Wolfgang 2008: Plausible theory, unexpected results. The rapid democratic consolidation in Central and Eastern Europe. Në: Friedrich Eber Stiftung (Hg.). Internationale Politik und Gesellschaft. Heft 2/2008. S. 11–29.
36. Meyer, Michael/Wodak Ruth (Hrsg.) 2002: Methods of critical discourse analysis.
37. London: Sage.
38. Partington, Alan 2004: Utterly content in each other's company. Semantic prosody and semantic preference. Në: International Journal of Linguistics.Vol 9(1). S. 131–156.

39. Saage Richard 2005: *Demokratietheorien. Historischer Prozess. Theoretische Entwicklung. Sozio technische Bedingungen. Eine Einführung.* Wiesbaden: Verlag für Sozialwissenschaften.
40. Strassner, Erich 1987: *Ideologie, Sprache, Politik. Grundfragen ihres Zusammenhangs.*Tübingen: Niemeyer.
41. Schmidt, Manfred 2006: *Demokratietheorien. Eine Einführung.* 3. überarb. U. erweit. Auf l. Wiesbaden: Verlag für Sozialwissenschaften.
42. Smooha, Sammy 2001: *The Model of Ethnic Democracy.* European Center for Minority Issues. Working Paper No.13.
43. Spieß, Constanze 2006: *Zwischen Hochwert und Stigma – Zum strategischen Potenzial lexikalischer Mittel im Bioethikdiskurs.* Nö: Girnth, Heiko/Spieß, Constanze (Hrsg.): *Strategien politischer Kommunikation. Pragmatische Analysen.* Berlin: Schmidt. S. 27–45.
44. Tocqueville de, Alexis 1976 (franz.1835/40): *Über die Demokratie in Amerika.* München: Deutscher Taschenbuch Verlag.
45. Van Dijk Teun 1995: *Ideological discourse analysis.* Nö: New Courant (English Dept, University of Helsinki), Vol. 4, Special issue: *Interdisciplinary approaches to Discourse Analysis.* Eija Ventola u. Anna Solin(Hrsg). S. 135–161.
46. Van Dijk, Teun 1993a: *Principles of critical discourse analysis Dis course & Society, Vol. 4 (2).* London. S. 249–283.
47. Van Dijk, Teun 1985: *Semantic discourse analysis.* Nö: Van Dijk, Teun (Hrsg.) *Handbook of Discourse Analysis. Vol.4. Discourse Analysis in society.* London: Academic Press. S. 103–136.

## Dokumente:

1. Guiding principles of the Contact Group for a settlement of the status of Kosovo. URL: <http://www.unosek.org/>.
2. Kosovo Contact Group Statement. London, vom 31.01.2006. URL: [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/060130-OSOVO\\_CONTACT\\_GROUP\\_STATEMENT.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/060130-OSOVO_CONTACT_GROUP_STATEMENT.pdf)
3. North Atlantic Treaty Organization (NATO): NATO Membership Action Plan. NATO Press Release NAC-S (99)66. 24 April 1999 URL: <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-066e.htm>
4. Resolution on reconfirmation of political will of Kosovo people for Kosovo an independent and sovereign state. 17.11.2005. URL:

<http://www.assemblykosova.org/common/docs/Resolution.%20english,%20version.17.11.05.pdf>.

5. United Nations Mission Interim Kosovo (UNMIK): Standards before Status. URL:  
[www.unmikonline.org/pub/focuskos/apr02/benchmarks\\_tablefinal.pdf](http://www.unmikonline.org/pub/focuskos/apr02/benchmarks_tablefinal.pdf)
6. United Nations Mission Interim Kosovo (UNMIK): Kosovo Standards Implementation Plan. 31.03.2004. URL:  
[www.unmikonline.org/pub/misc/KSIP-Eng.pdf](http://www.unmikonline.org/pub/misc/KSIP-Eng.pdf)



**Sazana ÇAPRIQI**

## **GJUHA, GJINIA, IDEOLOGJIA**

Tipari kryesor mbase edhe i vetmi që e dallon njeriun nga gjithë qeniet e tjera të gjalla është gjuha, mjeti përmes të cilit njeriu shndërrohet në qenie shoqërore. Përmes gjuhës njeriu arrin të kuptojë botën dhe realitetin që e rrethon dhe po përmes gjuhës ai e analizon dhe e ndërton këtë realitet. Gjuha dhe shoqëria janë dy sisteme paralele në raport të përhershëm varshmërie me njëra tjetrën. Shoqëria mund të kuptohet nëpërmjet gjuhës e gjuha mund të shërbejë si mjet komunikimi mes njerëzve, vetëm atëherë kur ata krahas kompetencës linguistike i dinë apo i njohin edhe konvencat shoqërore.

Gjuha funksion përmes koncepteve dhe kategorive. Filozofi gjerman Ernst Cassirer në librin e tij “Gjuha dhe miti”<sup>1</sup> kur flet për formimin e koncepteve thotë: “Sipas mësimëve tradicionale të logjikës, mendja i formon konceptet ashtu që i vë së bashku një numër të caktuar objektivash që kanë cilësi të përbashkëta, d.m.th. që përkojnë në disa aspekte të caktuara me njëra tjetrën dhe i abstragon dallimet mes tyre, kështu ruhen dhe kujtohen vetëm ngjashmëritë mes tyre dhe në këtë mënyrë në vetëdije krijohet ideja e përgjithshme për një klasë të caktuar objektivash. Kështu, koncepti (notio, conceptus) është ajo ide që përfaqëson tërësinë e atributëve thelbësore, d.m.th. thelbin e objekteve të caktuara.”<sup>2</sup> Mirëpo, vazhdon ai më tutje: “Formulimi i një koncepti të përgjithshëm sipas të cilit është e mundur të grumbullohen objektet, që përgjasojnë mes vetes, në një klasë presupozon attribute të përcaktuara; vetëm për rastet kur ka karakteristika të fiksuara në bazë të të cilave gjërat mund të njihen si të ngjashme apo të pangjashme, që koincidojnë ose që nuk

---

<sup>1</sup> Ernst Cassirer, “Language and Myth”, Dover Publications INC New York 1953

<sup>2</sup> Po aty. fq 24.

“According to the traditional teachings of logic, the mind forms concepts by taking a certain number of objects which have common properties, i.e., coincide in certain respects, together in thought and abstracting from their differences, so that only the similarities are retained and reflected upon, and in this way a general idea of such-and-such a class of objects is formed in consciousness. Thus the concept (notio, conceptus) is that idea which represents the totality of essential properties, i.e., the essence of the objects in question.”

koincidojnë me njëra tjetrën.”<sup>3</sup>

Termet si “klasa”, “gjinia” dhe “identiteti” në sociolinguistikë përdoren si kategori të fiksuara, që ekzistojnë përtej gjuhës dhe shpërfaqen apo bëhen të dukshme, përmes gjuhës së folur të individit. Për socio-linguistin, mënyra se si dikush e flet gjuhën e tregon përkatësinë klasore dhe identitetin e individit. Mirëpo, sipas kritikës teorike të shoqërisë gjuha nuk e tregon identitetin po e ndërton atë, respektivisht gjuha është njëri prej elementeve që e ndërtojnë identitetin e individit dhe termet “klasa”, “identiteti” dhe “gjinia” janë konstruksione të paqëndrueshme.

*“Fjalët ‘koncept’ dhe ‘kategori’ përdoren në mënyrë shumë të lirshme dhe trajtohen sikur janë të këmbyeshme me njëra tjetrën.”* Thotë, Dereck Bickerton në librin “Gjuha e Adamit”<sup>4</sup>, *“Përmes konceptit, ne, ‘mund të mendojmë’ ndërsa gjithçka që mund të bëjmë me kategorinë është të përcaktojmë nëse një gjë e caktuar i takon një kategorie ose jo. Këtu është dallimi në mes këtyre fjalëve. Ngjashmëria në mes tyre qëndron në faktin se të dyja i referohen ndonjë lloj klase në të cilën mund të radhiten dhe klasifikohen gjërat si p.sh. leopardët, tavolinat, gjyshet apo çka do qoftë tjetër. Për shkak të kësaj ngjashmërie, kategoritë dhe konceptet trajtohen si emra të ndryshëm për të njëjtën gjë. Po nëse nuk arrijmë të bëjmë dallimin mes tyre asnjëherë nuk do të kuptojmë pse qeniet humane janë të ndryshme nga ato johumane.”*<sup>5</sup>

Në këtë kuptim mund të diskutohet edhe për fjalët ‘seks’ dhe ‘gjinia’. Derisa fjala seks tregon kategorizimin biologjik kryesisht të bazuar në rolet riprodutive po edhe te disa dallime fizike mes meshkujve dhe femrave; gjinia është koncept përmes të cilit shpjegohen dhe përcaktohen rolet shoqërore të burrave dhe grave. Megjithëse, diferenca në kuptimin e termave seks dhe gjinia nuk është krejtësisht e prerë dhe e qartë, ajo që dihet me siguri është se trupi i njeriut nuk është vendi i origjinës së natyrshme të gjinisë.

*“Gjinia është formë e rregullimit shoqëror brenda të cilit ndërtohet gjinia e secilit individ”,*

<sup>3</sup> Po aty. Fq 24

“The formulation of a general concept presupposes definite properties; only if there are fixed characteristics by virtue of which things may be recognized as similar or dissimilar, coinciding or not coinciding, is it possible to collect objects which resemble each other into a class.”

<sup>4</sup> Dereck Bickerton, “Adam’s Tongue How Humans Made Language How Language Made Humans”, Hill and Wang New York 2009 fq 32

<sup>5</sup> Po aty. Fq 205

“..concept is something you can "think about" and "think with," whereas with categories, all you can do is say whether something belongs in them or not. That's the difference. The similarity is that both terms refer to some kind of class into which things can be sorted-leopards, or tables, or grandmothers, anything at all. Because of that similarity, categories and concepts are sometimes treated as different names for the same thing. But if we don't distinguish between them, we'll never understand why humans differ from nonhumans.



konstatojnë linguistët” (linguistet, fem.) Penelope Eckert dhe Sally McConnell-Ginet,<sup>6</sup> Ky rend gjinor ka karakter dikotomik: individët ndahen në pjesëtarë të gjinisë mashkullore dhe në pjesëtarë të gjinisë femërore, (dhe nuk lë shumë hapësirë për ndonjë opion të tretë, megjithëse, ndarja bëhet sipas parimit të dallimeve biologjike,). “Gjinia, është pikërisht ky proces i krijimit të dikotomisë, që bëhet duke i zbehur ngjashmëritë dhe elaboruar dallimet, pastaj ato dallime biologjike që vërtetë ekzistojnë theksohen dhe ekzagjerohen shumë në shërbim të krijimit të gjinisë.”<sup>7</sup>

Simone de Beauvoir e kishte parasysh pikërisht këtë proces kur tha: “Gruaja nuk lindet, ajo krijohet!”. E vërteta është se edhe burri nuk lindet por krijohet. Ky proces i krijimit është i gjatë dhe i vazhdueshëm. Nis që nga momenti kur fëmija lind, mbase edhe më përpara, kur prindërit, farefisi dhe miq të tjerë sapo mësojnë seksin e fëmijës nisin të zgjedhin veshmbathjet apo lodrat që do t’ia dhurojnë, me ngjyra dhe përmbajtje të ndryshme: të kuqe dhe me lajle lule për vajzat dhe të kaltra e pa ornamente për djemtë. Kështu fëmija duke qenë i trajtuar sipas modelit gjinor nis të mendojë për veten sipas këtyre termave dhe fillon sjelljet brenda kornizave të përcaktuara gjinore. Ky lloj dallimi apo kjo mënyrë e trajtimit përgjatë linjave gjinore, pastaj vazhdon gjatë adoleshencës, (si: përzgjedhja e profesioneve përkatëse), moshës së pjekurisë madje edhe gjatë moshës së tretë. Filozofia Judith Butler, në librin e saj “Problemi i gjinisë”<sup>8</sup> argumenton se ‘gjinia’ është një konstruksion që konsiderohet se është i ndërtuar mbi një themel ‘të natyrshëm’ që është seksi, prandaj identiteti gjinor konsiderohet si një ndër komponentët më të qëndrueshëm të identitetit personal. Po, ky mendim është thjeshtë një iluzion, asgjë më shumë: “gjinia është stilizimi i ripërsëritur i trupit, një sërë veprimesh të ripërsëritura në kuadër të një kornize rregulluese shumë të ngurtë që me kohë krijojnë aparcën substanciale, të një lloji natyral te qenies”. Individu i përsërit në vazhdimësi veprimet që e përcaktojnë gjininë dhe me kohë këto duken sikur janë të integruara në natyrën e tij. Sikur identiteti të ishte i fiksuar dhe i mirëqenë nuk do të kish ndonjë arsye që këto veprime përcaktuese të përsëriteshin me kaq këmbëngulësi. Kjo ripërsëritje e tillë sipas Butler, është e nevojshme në mënyrë që të ruhet identiteti gjinor i cili nuk ekziston përtej veprimeve apo sjelljeve të dallueshme gjinore.

<sup>6</sup> Penelope Eckert and Sally McConnell-Ginet, “Language and Gender”, 2003 Cambridge University Press Cambridge, New York, Melbourne, Madrid, Cape Town, Singapore, São Paulo

<sup>7</sup> Po aty. Fq.13 “Gender is the very process of creating a dichotomy by effacing similarity and elaborating on difference, and even where there are biological differences, these differences are exaggerated and extended in the service of constructing gender”

<sup>8</sup> Judith Butler, “Gender Trouble Feminism and Subversion of Identity”, Routledge, New York, London 1990

Sjellja gjinore është e mësuar dhe jo e lindur. Ky konstatim mund të ilustrohet shumë bukur me fenomenin e virgjërshave të përbetuara. Këto gra dhe vajza që për arsye të ndryshme objektive apo subjektive, marrin vendimin për ta ndryshuar gjininë. Pasi të kenë bërë betimin ato ndryshojnë veshjen, përqafojnë sjellje të caktuara burrërore, ndryshojnë edhe mënyrën e të folurit, duke marrë përsipër rolin shoqëror të burrit. Secila nga këta persona funksionon fare mirë si *'burrë social'* po nuk mund të funksionojë si *'burrë/mashkull natyral'* thjeshtë sepse nuk është i tillë. (Shoqëria i pranon si të tillë pa i stigmatizuar. Pra ndryshimi i gjinisë në këto raste është fare i lehtë ndërsa seksi biologjik nuk mund të ndryshohet kaq lehtë, edhe pse duhet të pranojmë se edhe kjo nuk është e pamundur.

Gjuha, përbëhet nga një sistem shenjash të strukturuar e gjinia është e ngulitur në këtë sistem ashtu sikur që është e ngulitur edhe brenda sistemit të komunikimit, dhe shfaqet në mënyra të ndryshme. Mund të jetë përmbajtje e shenjës linguistike sikur p.sh. te përemrat, ai/ajo, i,e tij/saj; del edhe në leksik sikur te fjalët vajzë, djalë, mashkull, femër etj. Në mënyrë më indirekte del atëherë, kur fjalë të caktuara që konsiderohen se paraqesin attribute burrërore u referohen grave, kuptohen si lavdërim: grua burrneshë, trimëreshë etj. ndërsa kur fjalët që paraqesin attribute femërore u referohen meshkujve nuk janë lavdërim por mund të jenë fyerje përçmim apo zhvleftësim, burrë delikat, a sentimental. Fjalë të njëjta marrin kuptime të ndryshme varësisht se kujt i referohen. P.sh Nga fjalitë: Shpresa është grua e mirë. dhe fjalja tjetër: Tomori është burrë i mirë. Ne nxjerrim domethënie të ndryshme të fjalës 'mirë' sepse nxjerrim paralelen nga njohuritë e konventave shoqërore, që përcaktojnë role të ndryshme për Shpresën dhe Tomorin.

Gjinia si kategori gramatikore sikur e imiton dikotominë e rendit gjinor të shoqërisë, pavarësisht se në gjuhë edhe gjinia asnjënjëse ka status të barabartë me dy gjinitë e tjera. Ky element mbase e mjegullon supremacinë mashkullore që ndeshet në gjuhë po njësoj sikur që ekziston edhe në shoqëri. Rregullat e përcaktimit se kur një emër i takon një gjinie apo një tjetre janë kryesisht arbitrare, hiq disa emra që shënojnë frymorë, sikur edhe rregullat se kur dhe si mund të përdoren emrat në gjininë mashkullore apo femërore. Po kaq arbitrare është edhe rregulla që thotë se duhet të përdoret një emër në gjininë mashkullore kur përdoret për të treguar universalen. Si kur themi: Njeriu është qenie humane. Nxënësi shkon në shkollë. Studenti mëson. Te shembujt e tillë konsiderohet gjinia femërore përfshihet. Me një fjalë dihet se gruaja, nxënësja dhe studentja përfshihen edhe pse nuk janë përmendur. Duke marrë parasysh se bota ka pothuaj numër të barabartë të burrave dhe grave arsyeja që na bën të ndjekim këtë rregull është krejtësisht arbitrare. Po kaq arbitrar është përdorimi i përemrit vetor *ata* për të treguar grupin e përzier madje edhe atëherë kur grupi të cilit i referohemi mund të ketë vetëm një individ të gjinisë mashkullore. Këtë lloj përdorimi

nuk e vërejmë edhe në rastet kur u referohemi kafshëve. Pikë së pari vetë fjala kafshë ekziston vetëm në gjininë femërore. Nuk ka një variant të kësaj fjale në gjininë mashkullore. Pastaj disa llojeve të caktuara të kafshëve u referohemi sipas emrit të gjinisë femërore madje edhe atëherë kur ekzistojnë emërtimet në mashkullore. P.sh. Macja gjuan miun. Delja është kafshë e butë. Lopa është kafshë shtëpiake. Dhelpra është dinake. Disa llojeve të tjera jo: Luani mbret i kafshëve. Qeni është besnik. Kali është mik i njeriut. E kështu me radhë. Themi delet, lopët apo pulat etj. Pse ndodh ky përjashtim nga rregulla? Pse nuk mund të themi: Nxënësja shkon në shkollë, e me këtë të kuptojmë se edhe nxënësi përfshihet, ashtu si është e natyrshme të themi: Macja gjuan miun, e me këtë të kuptojmë se edhe daci e gjuan miun po njësoj.

Në shek XVI, gramatikanët anglez kishin konstatuar se emrat e gjinisë mashkullore duhet të renditen para emrave të gjinisë femërore për arsye se në këtë mënyrë duhej respektuar rendin e natyrshëm që vë burrin para gruas sepse gjinia mashkullore është më e denjë se ajo femërore. Me një fjalë duhet thënë “husband and wife” burrë e grua apo “Zoti dhe Zonja Brown” e jo anasjelltas. Ky përcaktim është bërë sipas ideologjisë gjinore. Gjinia mashkullore paraqitet si universale, e përgjithshme, e me këtë edhe si neutrale. Nga ana tjetër përgjithësimi i tillë e mban gjininë femërore si partikulare në të njëjtën kohë fsheh prejardhjet mashkullore si partikulare dhe e ngre atë në nivel neutral. Kështu ndarja hierarkike në gjuhë del si diçka e paracaktuar dhe e vetëkuptueshme.

Rendi gjinor është sistemi që përcakton gjithçka që ka të bëjë me gjininë si, të drejtat, obligimet, lirinë, kufizimet, kufijtë, mundësitë, fuqinë dhe vartësinë sipas klasës së seksit. Ka mbështetje nga konvencioni dhe ideologjia, njësoj sikur edhe i mbështet ato. Ideologjia gjinore është tërësia e besimeve që udhëheq pjesëmarrjen e njerëzve në rendin gjinor sipas të cilit ata e shpjegojnë dhe arsyetojnë këtë pjesëmarrje. Ideologjia dominante jo vetëm që thotë se meshkujt dhe femrat duhet të jenë të ndryshëm, por insiston se ata me të vërtetë janë të ndryshëm.



Mimoza PRIKU

## NDIKIMI I IDEOLOGJISË GJINORE GJATË PROCESIT TË PËRKTHIMIT (RASTI I PËRKTHIMIT TË VIRGINIA WOOLF- IT NË SHQIP)

### Abstrakt

Gjuha e letërsisë është bërë objekt vëzhgimesh linguistike duke ndihmuar si në zbërthimin e materialit gjuhësor, por në të kuptuarit e kontekstit kulturor. Një urë lidhëse ndërmjet kulturave të ndryshme ka shërbyer edhe përkthimi i letërsisë artistike, prandaj këtij procesi po i kushtohet gjithnjë e më tepër vëmendje, duke i shtrirë studimet jo thjesht tek autori, por edhe tek puna e përkthyesve, mënyra se si e përdorin ata pushtetin e gjuhës. Pas viteve '90 në studimet me karakter sociolinguistik një vend të rëndësishëm po zë edhe shqyrtimi i identitetit gjinor të përkthyesit dhe transmetimi i ideologjisë gjinore gjatë përkthimit. Për të bërë një lloj përjasjeje gjuhësore të përkthimit, me qëllim identifikimin e dallimeve gjinore është marrë në shqyrtim rasti i përkthimit në gjuhën shqipe i shkrimtares angleze **Virginia Woolf**, nga dy përkthyes me identitete gjinore të ndryshme. Qëllimi i studimit lidhet me zbulimin përmes përdorimit të gjuhës të ideologjisë gjinore të përkthyesit. Sa e e kapshme bëhet ajo gjuhësisht dhe cilat janë mjetet gjuhësore që e bënë të mundur dallimin e ideve, bindjeve a besimeve të përkthyesit? Si realizohet loja me fjalën nga secili prej tyre? Këto dallime do të ilustrohen me shembuj konkretë dhe përballja do të na ndihmojë të arrijmë në disa rezultate konkrete.

**Fjalë kyçe:** *përkthim, ideologji gjinore, gjuha e letërsisë.*

Qëllimi i këtij punimi lidhet me zbulimin e disa tipareve gjuhësore që arrijnë të identifikojnë identitetin gjinor të përkthyesit, një kënvështrim i ri të cilit po i kushton vëmendje sot gjuhësia e aplikuar.

Përkthimi ka luajtur që herët një rol mjaft të rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Ai parakupton, siç shprehej Roman Jakobson, “*dy mesazhe të barazvlershëm në dy kode të ndryshme*”. Me këtë gjuhëtar përkthimi nisi të vështrohej edhe si një produkt gjuhësor. “*Për ne si gjuhëtarë si fjalëpërdorues të zakonshëm,*- shkruante Jakobson,- *kuptimi i*

*secilës shenjë është përkthimi i saj në disa shenja të tjera alternative.*<sup>1</sup> Pas gjuhëtarit rus, përkthimi u konsiderua si *proces* edhe nga gjuhëtarë të tjerë, si Eugene Nida etj., i cili solli në këto studime konceptin *dinamik* dhe *barazpërën funksionale* të përkthimit që në vitin 1964,<sup>2</sup> koncepte të cilat u zhvilluan më tej në vitet në vazhdim.

Përkthimi është një akt komunikimi i dyfishtë i cili nënkupton pra, praninë e dy kodeve gjuhësore: **gjuhën burimore** (*Source text*) dhe **gjuhën e përkthimit** (*Target text*). Sot ai konsiderohet si një fushë ndërdisiplinore, por pa dyshim është një proces i cili lidhet drejtpërsëdrejti me *materien gjuhësore*. Një përkthyes i mirë nuk duhet të mjaftohet vetëm me njohjen gramatikore apo pasurinë leksikore të dy gjuhëve respektive, por ai duhet të njohë mirë rregjistrat e ndyshëm gjuhësorë të dy kodeve, stilet, të njohë kulturën e dy vendeve që përfaqësojnë këto gjuhë etj. Në këshillat që përkthyesi i njohur E. Tupja u jep përkthyesve të rinj shkëpusim: “*përkthyesit i mbetet ta riformulojë atë në gjuhën amtare. Për këtë, ai mobilizon gjithë njohuritë e kompetencat e veta gjuhësore d.m.th. rifjalëzon atë që ka kuptuar deri tani nga çfjalëzimi i tekstit në gjuhë të huaj duke e shprehur në gjuhën e vet amtare*”.<sup>3</sup>

Përgjatë shekujve vëmendja është përqendruar më shumë drejt besnikërisë së tekstit të përkthyer, stilit e gjuhës së zgjedhur sesa përbërësve të tjerë. Por, pas viteve ‘80 të shek. XX, procesi i përkthimi filloi të shihej në një këndvështrim të ri, atë të *kontekstit kulturor*, duke përfshirë edhe gjininë e seksualitetin. Ishin studiuesit G. Spivak and Judith të cilët hapën siparin e kësaj metode të re, që e konsideronte identitetin gjinor si pjesë e identitetit të përgjithshëm, së bashku me: kombësinë, etninë, klasën shoqërore, racën, besimin etj. Në të vërtetë terreni ishte përgatitur më herët në mesin e viteve ‘60, atëherë kur lindi ideologjia gjinore si lëvizje në Amerikën Veriore dhe në Europën Perëndimore, si reagim i dominancës së mentalitetit patriarkal e mbizotërimit të botës mashkullore edhe në fushën përkthimit. Gratë përkthyesë filluan të ndërtonin një *network* të tyre, me qëllim që të arrinin të depërtonin në botën mashkullore dhe të fitonin të drejtën të hynin në sfera publike.

Më parë, jo rrallë ndodhte që *teksti burimor* përshtatej kur kalonte në *tekstin e përthyer* duke iu nënshtruar si idologjisë politike dhe asaj gjinore, e cila është këtë herë është bërë objekt studimi. Raste të tilla historia e përkthimit njihte më herët, që gjatë Mesjetës në Romë. Me ridimensionimin e konceptit *përkthim* edhe si proces kulturor, suaza e studimeve mbi përkthimin erdhi duke u plotësuar. Sipas Sherry Simon, njëres prej studiueseve bashkëkohore të problemeve gjinore të përkthimit: “*Studimet kulturore*

<sup>1</sup> Roman Jakobson (1959) 2000. “On Linguistic Aspects of Translation.” *In The Translation Studies Reader*, ed. Lawrence Venuti, 113–18. London: Routledge, f.114.

<sup>2</sup> *Toward a Science of Translating. With Special Reference to Principles and Procedures Involved in Bible Translating*. Leiden: Brill.

<sup>3</sup> E. Tupja. *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri. Tiranë, 2000, f. 22.

*i sollën përkthimit të kuptuarit e komplekëtit të gjinisë dhe të kulturës. Kjo na lejon,-sipas saj,- që ta vendosim lidhjen gjuhësore brenda shumë realiteteve "post" të sotme, si: postrukturalizëm, postkolonizëm postmodernizëm".<sup>4</sup>*

Sa i takon historisë së përkthimit në gjuhën shqipe mund të themi se është e hershme dhe lidhet ngushtë me historinë e shkrimit të kësaj gjuhe dhe sidomos me përkthimin e librave të shenjtë. Me epokën e Rilindjes Kombëtare u nxit puna edhe për përkthimin e letërsisë artistike në gjuhën shqipe, të cilat "janë dëshmi e pasurisë dhe e vitalitetit të kësaj të fundit".<sup>5</sup> Në Shqipëri, sidomos gjatë periudhës 1944 -1990 një pjesë e mirë e shkrimtarëve të konsideruar *modernë* nuk lejoheshin të përktheheshin, ndërsa, në tekstet që arritën të depërtonin, megjithë punën madhështore të përkthyesve, ideologjia edhe ajo gjinore ishte mjaft e dukshme. Nuk lejoheshin fjalë që tregonin seksualitetin.<sup>6</sup>

Po pas viteve '90 a ndjehet ideologjia gjinore? Po sa është i pranishëm përkthyesi në tekst dhe si shprehet identiteti i tij, sidomos ai gjinor? Sa dhe si arrin të kapërcejë ai ndërtimet gjinore? Për këtë me qëllim është përzgjedhur një prej romaneve të shkrimtares së njohur anleze Virginia Woolf , "Zonja Dalloway. Ky roman është sjellë në gjuhën shqipe nga një përkthyes i gjinisë mashkullore. Në këtë rast gjuhë burimore është anglishtja, ndërsa si gjuhë e përkthimit ka shërbyer shqipja.

Nëse i refrohemi gjinisë së emrave, si kategori gramatikore mund të themi se anglishtja karakterizohet nga gjinia natyrore, ndërsa në shqipe gjinia ka përgjithësisht natyrë gramatikore, e cila karakterizohet nga ndarjet *mashkullore-femërore-asnjnjëse*. Kjo do të thotë se përkthyesit nga anglishtja në gjuhën shqipe duhet të zgjedhin gjininë dhe kjo përbën një objekt ku mund nisin polemikat gjinore p.sh.

Gjuha origjinale	Përkthimi në gjuhën shqipe
<i>...she had helped <b>young people</b>, who were grateful to her... (f. 30)</i>	<i>...Ajo kishte ndihmuar <b>djem të rinj</b>, të cilët e nderonin... (f. 43)</i>

<sup>4</sup> Sherry Simon, *Gender in Translation Cultural identity and the politics of transmission*. (1996). London and New York: Routledge, f. 129.

<sup>5</sup> Sh. Rrokaj, "Rreth problemeve në fushën e përkthimit dhe kujdesin ndaj tij në shkollë", në *Çështje të gjuhës shqipe* 2, Tiranë, 2009, f. 21.

<sup>6</sup> Aurel Plasari kur përkthente G. Marquez-in në shqip kujtonte: "*Márquez-i ishte problem për atë që redaktorët e qanin përdorim i "fjalëve të pista". Për mua t'i hije ato ishte jo vetëm si t'i hije erëzat, beharnat, një gjelle të mirë, por edhe të çënoje nuanca të holla të natyrës së personazheve. ... Nuk mund t'i bindja që heqja e termave të tillë ia vështirësonte tejmasë lexuesit vetë të kuptuarit e personazheve me probleme të ndryshme seksuale. Heqja e tyre do të thoshte madje t'i korrigjonte këta personazhe, duke i bërë "pa probleme". (Gazeta shqiptare, 19 prill 2014).*

Po në këtë punim më shumë do të ndalemi tek disa ndërtime tekstore të cilat mund të na ndimojnë për të zbuluar identitetin gjinor të përkthyesit.

Sipas Spivak “Nëse ne mendojmë të përkthejmë Marianne Moore ose Emily Dickinson, standardi për përkthyesin nuk mund të jetë “dikush që mund të bëjë një bisedë në gjuhën origjinale (anlishtes në këtë rast)”<sup>7</sup>. Pra përkthyesi duhet të njohë stilin e të shkruarit të shkrimtareve femra, por nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për dallime gjinore apo koncepte që lidhen me të, duhet të bëjmë shumë kujdes, sepse ajo çfarë mund të jetë e pranueshme në kulturën e gjuhës burimore, në gjuhën dhe kulturën tjetër mund të jetë e vështirë për t’u pranuar ose krejtësisht e papranueshme.

Gjatë leximi të romanit të V. Woolf-it në shqip dhe krahasimit me origjinalin të bie në sy se përkthyesi në disa vende përkthen me konotacione negative kur flitet për personazhe femra. Këtë gjë mund ta dëshmojnë shembujt e mëposhtëm:

Nr.	Në anglisht	Në gjuhën shqipe	Mund të ishte...
1.	... <i>Nothing that would serve to amuse her and make that indescribably dried-up little woman look, as Clarissa came in, just for a moment cordial; before they settled down for the usual interminable talk of women's ailments...</i> (f.8)	... <i>s'ishte libër që ta dëfrente, që të mund t'i falte kësaj gruaje të vogël e pabesueshëm thatanike, një pamje të ëmbël, qoftë edhe për një çast kur Klarisa do të hynte. ...Do të ishte në vijim <b>llomotitja</b> e përsëritur dhe e stërzgatur mbi sëmundjet e grave...</i> (f.14)	
2.	... <i>That grim old housemaid, Ellen Atkins, went about <b>grumbling</b>—"Suppose any of the gentlemen had seen?" Indeed she did shock people. She was <b>untidy</b>, Papa said ...</i> (f. 28).	... <i>Shërbyesja e vjetër grindavece, Elen Etkins, thoshte <b>duke hungëritur</b>- Merreni me mend një nga zotërinjtë ta kishte parë! Ajo ishte <b>jo e rregullt</b>, thoshte babai...</i> (f.40)	<i>duke ankuar, duke mërmëritur</i>  <i>e shkujdesur</i>
3.	... <i>How many million times she</i>	... <i>Sa here e kishte pare</i>	<i>rrudhte buzët,</i>

<sup>7</sup> Gayatri Chakravorty Spivak “The politics of Translation”, *In The Translation Studies Reader*, ed. Lawrence Venuti, 113–18. London: Routledge, f. 404.



NDIKIMI I IDEOLOGJISË GJINORE GJATË PROCESIT TË PËRKTHIMIT (RASTI I  
PËRKTHIMIT TË VIRGINIA WOOLF-IT NË SHQIP)

	<i>had seen her face, and always with the same imperceptible contraction! She <b>pursed her lips</b><sup>8</sup> when she looked in the glass... (f. 30)</i>	<i>këtë fytyrë, dhe gjithnjë me njëfarë tkurrjeje të paperceptueshme. Fytyra e saj <b>ngërdheshej e pakënaqur</b>, teksa vështronte veten në paqyrë... (f.43).</i>	<i>shtrengonte etj.</i>
4.	<i>...How he scolded her! How they <b>argued!</b>... (p.6)</i>	<i>...Sa e qortonte atë. Sa <b>grindeshin</b>... (f.12)</i>	
5.	<i>"Don't you want to go with them?" said Aunt Helena—<b>old Miss Parry!</b>—she had guessed. (f. 51)</i>	<i>-A nuk do të shkoni me ta?,-foli teta Helena,- <b>e gjorë zonja plakë!</b>- e kishte fukeptuar. (f. 70)</i>	<i>shton cilësorin <b>e gjorë</b></i>

Në rastin e parë edhe ndërprerja e frazës duket se është bërë për të nxjerrë më në pah ndërtimin me sintagmën **llomotitje**. Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* gjemë këtë shpjegim për këtë emër prejfoljor: 1. Flas nëpër dhëmbë e mbyturazi, murmurit, pëshpërit 2. Flas kot pa përgjegjësi; flas poshtë e lart, përhap thashetheme 3. Shpifje (2006:583). Në asnjë prej rasteve ajo nuk del e zhveshur nga konotacionet, përkundrazi e përdorur në kuptimet e dyta fraza rëndohet. Është ndoshta vendi të kujtojmë fjalët e gjuhëtarit A. Dhrimo i cili duke diskutuar për marrëditjet e gjuhës me përkthimin tërheq vëmendjen se “një nga detyrat kryesore dhe njëkohësisht një nga vështirësitë më të mëdha të përkthyesit është të gjejë fjalën shqipe që i përgjigjet sa më mirë kuptimisht e stilistikisht fjalës përkatëse të origjinalit, t’i përgjigjet pasurisë leksikore të autorit me pasurinë e shqipes pa zbehur ngjyrimet, pa dëmtuar përpikmërinë e shprehjes.”<sup>9</sup>

Në shembullin e dytë përkthyesi i vesh personazheve femra veprime që zakonisht karakterizojnë kafshët, si në rastin e foljes **hungëroj** (nxjerr britmë therëse e kërcënuese; nxjerr një zë therës e të përvaishëm, nxjerr hungërima (qeni, ujku etj.); 2006:396).

Nëse i referohemi thënies së studiuesve më ideologjinë gjinore të përkthimit “*Shprehjet gjuhësore mund të ndryshohen në mënyrë që të përshtatet idioma femërore e cila reflekton*

<sup>8</sup><http://www.macmillandictionary.com/>

purse your lips: to press your lips together and outwards because you are angry or are thinking.

<sup>9</sup> A. Dhrimo, “Rreth gjuhës së përkthimeve artistike” në *Për shqipen dhe shqiptarët*, Infbotues, Tiranë, 2008, f. 126.

*eksperiencat femërore; „sidomos ato shprehje të cilat vënë shenjën e barazimit mes forcës mashkullore dhe dobësisë femërore”*,<sup>10</sup> logjika e përkthimit mund të lejojë disa modifikime por, kjo nuk nënkupton që këto shprehje mund të ndryshohen duke marrë nuanca negativiteti gjatë procesit të përkthimit, sepse edhe mesazhi dekodohet në mënyrë të gabuar.

Interesant është fakti se një gjë e tillë nuk vërehet kur flitet për personazhe të gjinisë mashkullore. Në mjaft raste në këto situata përkthimi ka nota positive. Krahaso:

Nr.	Në anglisht	Në gjuhën shqipe	
1.	... <i>And it was <b>cowardly</b> for a man to say he would kill himself, but <b>Septimus</b> had fought; he was brave; he was not Septimus now...</i> (f.19)-	... <i>Ishte <b>e ulët</b> për një burrë të thoshte se do të vriste veten, por kejo <b>qënie njerëzore</b> kishte marrë pjesë në luftë dhe ishte treguar trim, nuk ishte më Septimusi ...</i> (f. 28)	
2.	... <i>He was a thorough good sort; a bit limited; <b>a bit thick in the head</b>; yes; but a thorough good sort...</i> (f.61)	... <i>këtyj djali pak të kufizuar, <b>pak të mefshtë</b>, por gjithsesi, një brum të mirë...</i> (f.83)	

Në shembullin e parë *cowardly* “a person is not brave to fight or do something difficult or dangerous that they should do”<sup>11</sup>

Më domethënëse medojmë se është shprehja “**a bit thick in the head**”(Of low intelligence; stupid:*he’s a bit thick*)<sup>12</sup>e përdorur në stilin joformal të cilën përkthyesi e zbut në maksimum duke ngritur rregjistrin me mbiemrin thjesht “*pak i mefshtë*”).

Paraqitja e mësipërme është vetëm një fillim i një pune që na dëshmon se gjuha sa është e varur nga proceset gramatikore aq është e lirë në interpretim, gjë që e dëshmon më së miri përkthimi. Por, nga ana tjetër ideologjia gjinore gjatë përkthimit me të vërtetë zbulon se rrugët e komunikimit janë të hapura dhe shpesh ajo ka luajtur dhe luan rol pozitiv në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërive të ndryshme, por që nuk duhet abuzuar e keqinterpretuar.

<sup>10</sup> Lina Fisher, “Theory and Practice of Feminist Translation in the 21st Century” in *Continuum Studies in Translation. Translation: Theory and Practice in Dialogue*, (2010) Edited by Antoinette Fawcett, Karla L. Guadarrama García and Rebecca Hyde Parker, Continuum International Publishing Group, f. 74.

<sup>11</sup> <http://www.macmillandictionary.com/>

<sup>12</sup> <http://www.oxforddictionaries.com/>

**Bibliografia:**

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2006.
2. Bermann, S. & Porter, C. (2014) (edit). *A Companion to Translation Studies* Wiley Blackwell.
3. Dhrimo, A. (2008). “Rreth gjuhës së përkthimeve artistike” në *Për shqipen dhe shqiptarët*. Tiranë: Infbotues.
4. Fawcett, A.& Guadarrama García K. L. & Parker R. H. *Continuum Studies in Translation. Translation: Theory and Practice in Dialogue*, (2010) Edited by, Continuum International Publishing Group.
5. Jakobson, Roman (1959). “On Linguistic Aspects of Translation.” *In On Translation*, ed. Reuben A. Brower, 232–39. Cambridge, MA: Harvard University Press.
6. Rrokaj, Sh., (2009). *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë: Shkronjë pas Shkonje.
7. Simon, Sherry, (1996) *Gender in Translation Cultural identity and the politics of transmission* London and New York: Routledge.
8. Tupja, E. (2000) *Kësbilla një përkthyesi të ri*, Onufri. Tiranë.
9. Venuti, Lawrence (1995) *The Translator’s Invisibility. A History of Translation* London and New York: Routledge.
10. Von Flotow, L. (1995) “Translating Women of the Eighties: Ethnicity, Eroticism and Anger,” in S. Simon (ed.) *Culture in Transit: Translating the Literature of Quebec*, Montreal: Véhicule Press.
11. Venuti, L. (1992) (ed.) *Rethinking Translation: Discourse, Subjectivity, Ideology*. London and New York: Routledge.

**Burimet:**

1. V. Woolf, *Zonja Dalloway*, Skanderbeg books (përkthyes Dorian Kroqi), Tiranë, 2004.
2. Woolf, V. (1925). *Mrs. Dalloway*. EBook No.: 0200991h.html, Retrieved September 10, 2011 from <http://gutenberg.net.au>
3. <http://www.macmillandictionary.com/>
4. <http://www.oxforddictionaries.com/>



Mimoza GJOKUTAJ, Irida HOTI

## ÇËSHTJE TË TRAJTIMIT GJUHËSISË SË ZBATUAR PARA DHE PAS VITEVE '90 NË GJUHËSINË SHQIPTARE

### Abstrakt

Gjuhësia e zbatuar përgjithësisht pranohet si një fushë kërkimi ndërdisiplinare për studimin e të gjitha aspekteve të gjuhës në përdorim. *“Gjatë gjithë historisë së mësimdhënies formale ka pasur një farë gjuhësie të zbatuar siç njihet sot.”*

Ndonëse si term i shfaqur në SHBA për të emërtuar një kurs aplikimi, të quajtur *‘teori kërkim’* për mësimin e gjuhës, ky term në Shqipëri para viteve '90 është trajtuar pak ose aspak e kjo për arsye më tepër ideologjike. Ndërsa pas viteve '90 gjuhësia e zbatuar ka filluar të lëvrohet në disa disiplina gjuhësore, që synojnë të paraqesin zbatime të gjuhës me shqyrtime të thelluara, studime rasti e analiza të hollësishme.

Zhvillimet e fundit në gjuhësinë e zbatuar tregojnë që termi paraqet kërkime të sotme përqendruar në analiza gjuhësore të çrregullimeve të gjuhës, në përdorimin e gjuhës amtare dhe në zhvillimet në leksikografi, përkthim dhe stilistikë.

Ky kumtim synon pikërisht të paraqesë disa çështje të trajtimit të gjuhësisë së zbatuar si fushë me objekt të përcaktuar studimi, rrugëtimin e kësaj disipline, lëvrimit dhe përfshirjen e saj pas viteve '90 në gjuhësinë shqiptare.

***Fjalë kyç:*** gjuhësi e zbatuar, ideologji, disiplinë, gjuhësi shqiptare

### 1. Gjuhësia e zbatuar si fushë kërkimi ndërdisiplinare

Gjuhësia e zbatuar përgjithësisht pranohet si një fushë kërkimi ndërdisiplinare për studimin e të gjitha aspekteve të gjuhës në përdorim. *“Gjatë gjithë historisë së mësimdhënies formale ka pasur një farë gjuhësie të zbatuar siç njihet sot.”* Termi *‘gjuhësi e zbatuar’* shfaqet relativisht i përdorur në gjysmën e dytë të shek XX-të, në Britani dhe USA për t’iu referuar disiplinës së re akademike të studimit të mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës. Termi është përdorur më shumë për të mbuluar të gjithë pikëpamjet e studimit akademik të mësimdhënies së gjuhës dhe të nxënimit në shkollë (duke përfshirë më

shumë tema psikologjike se sa gjuhësore si motivim për mësimin e gjuhës). Në vitet '80 ky term ka filluar të përdoret për t'iu referuar më gjerësisht çdo fushe të studimit përtej vetë 'gjuhësisë'.<sup>1</sup> “Gjuhësia e aplikuar është një fushë ndërdisiplinare e lidhur ngushtë me gjuhën dhe e bazuar në gjuhë dhe me synimin në një kuptim më të thellë të ndërveprimit gjuhësor njerëzor në kontekste të ndryshme dhe në mënyra eksploruese për të ndihmuar përmirësimin e cilësisë së rritjes dhe zhvillimit komunikues njerëzor.”<sup>2</sup>

Ndonëse si term i shfaqur në vitin 1941 në SHBA për të emërtuar një kurs aplikimi, të quajtur ‘teori kërkim’ për mësimin e gjuhës, ky term në Shqipëri para viteve '90 është trajtuar pak ose aspak e kjo për arsye më tepër ideologjike.

## 2. Përcaktime dhe përkufizime mbi gjuhësinë e zbatuar

Në botimet e shumta të gjuhësisë së zbatuar, studiuesit e përcaktojnë atë si një fushë ndërdisiplinare dhe shumëdisiplinare, e cila nuk mund të mendohet pa disipinat e tjera gjuhësore dhe jogjuhësore, sepse do të ishte e çalë, pa interes dhe pa dobi tek përdoruesi i gjuhës. Detyra e gjuhësisë së zbatuar është të ndërmjetësojë mes gjuhësisë dhe përdorimit të gjuhës.

Përkufizimet dhe përcaktimet mbi termin ‘gjuhësi e zbatuar’ janë nga më të larmishmit:

- “Gjuhësia e aplikuar përfshin: Çfarë dimë për gjuhën?, Si mësohet?, Si përdoret?”<sup>3</sup>
- “Gjuhësia e aplikuar ka të bëjë me lidhjen mes njohurive, teori dhe praktikë në fushën e gjuhës.”<sup>4</sup>
- “Gjuhësia e aplikuar nënkupton shumë gjëra për shumë njerëz.”<sup>5</sup>
- “Gjuhësia e aplikuar nisat më shumë nga problemet e botës së vërtetë se sa nga eksplorimet teorike.”<sup>6</sup>
- “Gjuhësia e zbatuar është disiplinë akademike që merret me lidhjen e njohurive rreth gjuhës me vendimmarrjen në botën e vërtetë. Detyra e gjuhësisë së zbatuar është të ndërmjetësojë mes gjuhësisë dhe përdorimit të gjuhës.”<sup>7</sup>

<sup>1</sup> Keith Johnson; Helen Johnson, *Encyclopedic Dictionary of Applied Linguistics: A Handbook for Language Teaching*, 1999, f.15.

<sup>2</sup> Francisco De Gomes, *What is applied linguistic? A personal view. Issue of applied linguistics*; Vol. 2, 2005, f. 159.

<sup>3</sup> Alan Davies, *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Edinburgh University, 2007, f. 1.

<sup>4</sup> Michael McCarthy, *Issues in applied linguistics*, Cambridge University Press, 2001, f. 9.

<sup>5</sup> Vivian Cook, ‘What is applied linguistics?’, in Vivian Cook: *Obscure Writing*. 2006, f. 5., <http://homepage.ntlworld.com/vivian.c/Writings//index.htm>.

<sup>6</sup> William Grabe, *Applied linguistics: An emerging discipline for the twenty – first century*. In B.R Kaplan (f.3-12), *The Oxford handbook of applied linguistics*, Oxford University Press, 2001.

### 3. Gjuhësia e zbatuar në Shqipëri para viteve '90

Gjuha amtare si lënda kryesore në shkollë, ka kaluar përmes proceseve të vështira të konceptimit dhe reformimit të saj. Kjo gjendje ka qenë së pari si rrjedhojë e nivelit të ulët të kërkimeve në këtë fushë dhe qëndrimeve të theksuara tradicionaliste mbi mësimin e gjuhës si gramatikë dhe jo si gjuhë në përdorim. Në vëzhgimet e kryera për këtë qëllim kryesisht në programe e tekste shkollore që në titull të emërimit të tyre bie në sy termi gramatikë dhe jo mësim gjuhe. Gramatika ishte kthyer si qëllim në vetvete në tërë përmbajtjen shkollore për dekada të tëra. Ndryshimi u ndie shumë vonë. Vetëm rreth viteve '80 dolën në pah tekste të gjuhës amtare në të cilat ranë në sy ushtrimet e zhvillimit të të folurit dhe të të shkruarit duke kapërcyer në këtë mënyrë kërkesat e thekshme të mësimin të gramatikës. Aq e rëndë ishte kjo gjendje sa edhe sot e kësaj dite ndihet ende një lloj dëshire e mësuesve për t'i kthyer orët e gjuhës në orë gramatike.

#### ❖ Programet e gjuhës shqipe para viteve '90

Vetë ndryshimi i shpeshtë i programeve mësimore të gjuhës shqipe, leximit letrar dhe letërsisë është tregues i paqëndrueshmërisë të përcaktimit qartë dhe pastër të objektit të saj si lëndë me karakter të përcaktuar shkencor dhe kombëtar, gjë e cila shpesh është diktuar nga qëndrimet e politikëbërësve, apo “tradicionalistëve”, të cilët nga pavetëdija apo padija pengonin qartësimin e objektit të të mësuarit të gjuhës amtare në shkollë. Mbyllja e Shqipërisë bëri që edhe vetë formimi intelektual i gjuhëtarëve të rinj në ato vite të ishte shumë i kufizuar si rrjedhojë edhe në përcaktimin e këtyre objektivave u vu re ky lloj qëndrimi i ngushtë. Vetëm pas viteve '50<sup>8</sup> nisi një erë e re, kur u kthyen nga studimet e bëra në vendet e Evropës, Çabej, Domi, Koci etj., të cilët nisën të përcjellin një vizion të ri për mësimin e gjuhës. Por

---

<sup>7</sup> Guy Cook, *Applied linguistic*, Oxford introduction to languages study, Series H. G. Widdowson, Oxford, 2003, f. 20.

<sup>8</sup> Në vitin 1952 doli ligji mbi arsimin e detyruar 7-vjeçar. Gjatë kësaj periudhe u bënë disa përmirësime të planeve, programeve dhe teksteve mësimore si dhe të metodave të mësimin. Në vitin 1963 shkolla kaloi në arsim 8- vjeçar të detyruar, u ripunuan tërë planet dhe programet mësimore, duke bërë ndryshime të ndjeshme në forcimin e brendisë ideologjike. Në vitin 1985-1987 u fol për përmirësimin e përmbajtjes së programeve dhe teksteve shkollore në frymën e modernizimit shkencor pedagogjik. Në vitet 1989-1990 modernizimi shkencor pedagogjik i lëndëve kryesore mësimore dhe të mësuarit aktiv krijues ishin motoja e modernizimit të shkollës.

(*Mimoza Gjokutaj, Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2012, f. 235-236)

edhe pse të kthyer nga perëndimi dhe me një frymë të re ata përcillnin me doza të kufizuara mentalitetin e ri në përmbajtjen e shkollës dhe kryesisht të mësimin të gjuhës shqipe.

Në programet e vitit 1963 më tepër rëndësi i kushtohej edukimit të nxënësve me frymën e moralit komunist, dashurinë për atdheun e punën, pra mësimdhënien shihej në dritën e kuptimit të praktikës së botëkuptimit materialist: “Nëpërmjet mësimet të gjuhës amtare nxënësve të shkollës fillore edukohen në frymën e moralit komunist, kuptojnë praktikën e ndërtimit të socializmit, përvehtësojnë, sipas fuqisë së tyre kuptimore, elementet e para të botëkuptimit materialist dhe mësohen ta duan atdheun e punën.”<sup>9</sup>

Tekstet shkollorë dhe antologjike ishin tejet të politizuara. Brenda strukturave të tyre nxënësve dhe mësuesve ju duhej të kërkonin dukuritë dhe fenomenet letrare apo gjuhësore.

Po në këto programe parashtrohej edhe rëndësia në mësimin e gramatikës dhe mësimin e gjuhëve të huaja, të cilat lidheshin edhe me edukimin patriotik: “Mësimet e gjuhës i bëjnë nxënësve të aftë të kuptojnë pasurinë dhe varietetin e madh të mjeteve për të çfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ata kuptojnë ëmbëlsinë, forcën dhe ekspresivitetin e gjuhës, gjë që ndihmon edukimin e patriotizmit. ... Në mësimet e gjuhës nxënësve duhet të përvehtësojnë bazat e gramatikës, të pajisen me njohuri të shëndosha leximi të mirë, shprehje me gojë e me shkrim. ... njohja e gjuhës është një kusht i domosdoshëm paraprak për studimin me sukses të gjuhëve të huaja.”<sup>10</sup>

Edhe në vitet ’70 mësimi i gjuhës amtare, nuk i shpëtoi politikës dhe ideologjisë së kohës.

### ❖ Tekstet e gjuhës shqipe para viteve ’90

Edhe pse flitej për përmirësime në pasurimin e kurrikulës së kësaj lënde, futjen e metodologjive e të metodave efektive në mësimdhënien dhe rritjen e rezultateve të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit, përmes të nxënësve efektiv, të mësuarit logjik e krijues, mendimit kritik të lexim-shkrimit etj., realiteti fliste ndryshe.

Shumë nga tekstet ishin pa autorësi, tejet të centralizuara të dala nga një shtëpi botuese tejet e kontrolluar dhe me redaksi me partishmëri të lartë ku redaktorët pjesa më e madhe e tyre ishin komunistë, të cilëve nuk iu shkiste asgjë jashtë moralit. Shpesh shumë prej tyre ishin autorë të pjesëve letrare apo poetike, por që ia mihonin vetes autorësinë.

Në pikëpamje të pasurisë gjuhësore dhe leksikore që në vitet e hershme pas

---

<sup>9</sup> Programi i shkollës tetëvjeçare, gjuhë shqipe, lexim letrar, klasat V-VIII, Tiranë, 1963, f. 3.

<sup>10</sup> Programi i shkollës tetëvjeçare, gjuhë shqipe, lexim letrar, klasat V-VIII, Tiranë, 1963, f. 3.



çlirimit të vendit bie në sy glorifikimi i figurave të rëndësishme politike përmes të cilave përcillej një lëndë gjuhësore leksikore që lidhej me fushën e politikës, luftës, trimërisë etj., *luan trim guximtar, udhëbeqës, parti, fitore, brigade, sulm, vullnetar, armë, mbrojtje, hero, kombëtar*.

Në abetaren e vitit 1946, që në faqe të parë nxënësve u shprehej me foto:  
“*Enver Hoxha Hero kombëtar, Rroftë Enveri ynë*”.



Edhe teksti “*Leximi 3*”, i vitit 1985 hapet me “*Pionierë të Enverit*”<sup>11</sup> apo pjesë të tilla, si: “*Për Enver Hoxhën këngë thur tërë jetën*”.<sup>12</sup>



Pra nxënësve tanë u ushqeje ndjenja e ideologjisë nëpërmjet mësimin të gjuhës

---

<sup>11</sup> B. Harxhi, E. Bimbashi, I Reso, N. Prifti, Sh. Osmani, Sh. Dhimitruka, *Leximi 3*, Për klasën e 3-të të shkollës 8-vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1985, f. 3.



<sup>12</sup> B. Harxhi, E. Bimbashi, I Reso, N. Prifti, Sh. Osmani, Sh. Dhimitruka, *Leximi 3*, Për klasën e 3-të të shkollës 8-vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1985, f. 36.

dhe leximit.

Përsa i përket **leksikut**, nxënësit në abetaren e vitit 1946 nxënësit mësonin fjalë të tilla, si:

- **emra:** *luftë, mitraloz, pushkë, demonstratë, burg, bombardime, barbarë, fashistë etj.*
- **folje që shprehin urrejtje dhe agresivitet:** *bombardohen, u thyen etj.*

*“Partizanët liruan Tiranën, Demonstrata e grave të Tiranës –  
Poshtë fashizmi, poshtë tradhtarët, gjithë burgu buçiste.  
Sa barbarë janë fashistët, Po bombardohen shkollat e spitalet.”*



Ndërkohë që nxënësit tanë duhet ta mësonin gjuhën amtare me këtë leksik krijohej tek ato një shprehje e mbushur me revolta e larg botës së tyre femërore e aq

më tepër shprehive me imagjinatë e kreativitet.

Aq i dukshëm ishte qëndrimi konservativ mbi të mësuarin e gjuhës sa edhe vetë tekstet e gjuhës shqipe para viteve '90, në titull mbanin termin “Gramatikë” apo ‘Metodika e Gramatikës’<sup>13</sup>, e cila kufizonte të mësuarin e gjuhës, siç është sot, në përdorim në të gjitha shprehitë e saj të lexuarit, të kuptuarit, të folurit e të shkruarit. Duke iu dhënë më tepër përparësi gramatikës, synohej të pasqyrohej:

- rëndësia, roli dhe qëllimi i të mësuarit të gramatikës,
- metodat e të mësuarit të gramatikës,
- formimi i nocioneve gramatikore dhe i shprehive gjuhësore të nxënësit,
- analiza gramatikore dhe llojet e analizave etj.

Edhe shembujt konkretizues përmbanin fjalë të tilla, si: *ushtarë, parti, ushtari i popullit*.

P. sh. Në librin “Metodika e gramatikës”, -Për shkollat pedagogjike dhe për mësuesit e shkollave fillore, i vitit 1963 ndeshim këto konkretizime për shpjegimin e gramatikës:

Tabela e lakimit të emrit <sup>14</sup>	Si ndryshon emri në fjali <sup>15</sup>
<p><i>Ushtari është mbrojtësi i atdheut.</i>  <i>Detyra e ushtarit është e shenjtë.</i>  <i>Ushtarit nuk i trembet syri.</i>  <i>Ushtarin e do i gjithë populli.</i>  <i>Prej ushtarit sigurohet mbrojtja e atdheut.</i></p>	<p><i>Ne kemi një <b>parti</b> të fortë.</i>  <i>Nën udhëheqjen e <b>partisë</b> ne kemi fituar lirinë.</i>  <i>Ne e duam <b>partinë</b> tonë të dashur.</i></p>

Po në librin “Leximi 3” në rubrikën ‘Mësoni’, ndeshen mësimet të tilla si:

*“Partia komuniste e Shqipërisë u themelua në Tiranë më 8 Nëntor 1941. Sot ajo qubet Parti e Punës e Shqipërisë. Shoku Enver Hoxha, udhëheqësi ynë i madh dhe i pabarruar, është*

<sup>13</sup> *Metodika e gramatikës*, -Për shkollat pedagogjike dhe për mësuesit e shkollave fillore, Drejtorja e Botimeve Shkollore, Tiranë, 1963.


<sup>14</sup> *Si duhen zhvilluar mësimet e gramatikës dhe të ortografisë sipas themës dhe qëllimit*, në *Metodika e gramatikës*, -Për shkollat pedagogjike dhe për mësuesit e shkollave fillore, Drejtorja e Botimeve Shkollore, Tiranë, 1963., f. 23-24.

<sup>15</sup> *Si ndryshon emri në fjali*, në *Metodika e gramatikës*, -Për shkollat pedagogjike dhe për mësuesit e shkollave fillore, Drejtorja e Botimeve Shkollore, Tiranë, 1963., f. 29.

*themeluesi i Partisë sonë të dashur.*"<sup>16</sup>

apo

*"Lenini ishte udhëheqësi i Revolucionit të Tetorit dhe shtetit të parë socialist në botë."*<sup>17</sup> në vend që të jepeshin njohuri të ndryshme gjuhësore, letrare, kulturore etj.



### ❖ Mësuesit e gjuhës para viteve '90

Edhe mësuesi si një praktikues e zbatues, përçues i dijeve gjuhësore e letrare ishte i ndikuar dhe nën tryninë e ideologjizimit i kërkohej ngritja e nivelit të tij ideologjik e politik. Aq e theksuar ishte fryma e politizimit dhe e partishmërisë sa mësuesit në ditaret e tyre ishin të detyruar që *qëllimin edukativ ta lidhnin me moralin komunist*. Në programin e vitit 1963 thuhej: *"Për t'ia arritur qëllimit, është e domosdoshme që mësuesi të bëjë përpjekje të pandërprera për të ngritur nivelin e tij ideologjik e politik, për t'u ushqyer gjithnjë me të rejat e shkencës gjuhësore dhe për të përsosur vazhdimisht sistemin e tij të punës pedagogjike e metodike, duke mbajtur qëndrim krijues dhe kritik ndaj punës së tij."*<sup>18</sup>

Literatura që ata përdorinin ishte e kufizuar dhe aspak e përshtatshme për rritjen e tyre shkencore. Pothuajse mungonin tekste që mund të ndihmonin në formimin e tyre bashkëkohor.

Mësimi i gjuhës sipas arteve të gjuhës i ndarë në linja dhe nënlinja ishte një zhvillim mjaft i vonë. Pas viteve '85 u qartësuan parime dhe kritere që e drejtonin mësimin e gjuhës shqipe rreth mësimin të gjuhës në përdorim, drejt të mësuarit me tema dhe në situata reale komunikimi.

Depolitizimi i teksteve shkollore të gjuhës shqipe dhe letërsisë ishte një lëvizje tjetër, e cila nisi pas viteve '90 duke i dhënë përmbajtjes së mësimin të gjuhës shqipe hapësira shkencore dhe didaktike, duke ofruar tekste më të përshtatshëm për nxënësit dhe projekte dhe praktika bashkëkohore për mësuesit të cilat nisën të vijnë nga perëndimi. Por ende sot pjesa më e madhe e mësuesve edhe pse janë përcjellë praktika të reja mësimdhënieje janë konfuz dhe larg praktikave që sigurojnë sukses në

<sup>16</sup> B. Harxhi, E. Bimbashi, I Reso, N. Prifti, Sh. Osmani, Sh. Dhimitruka, *Leximi 3*, Për klasën e 3-të të shkollës 8-vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1985, f. 53.

<sup>17</sup> B. Harxhi, E. Bimbashi, I Reso, N. Prifti, Sh. Osmani, Sh. Dhimitruka, *Leximi 3*, Për klasën e 3-të të shkollës 8-vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1985, f. 55.

<sup>18</sup> *Programi i shkollës tetëvjeçare*, klasat I-IV, Tiranë, 1978, f. 5- 6.

mësimdhënie dhe të nxënë. Rezultatet e Pizës flasin ende për nivele të ulta të nxënësi të nxënësve në lexim shkrim. (Piza, 2010)

#### 4. Studime në fushën e gjuhësisë së aplikuar në Shqipëri pas viteve '90

Pas viteve '90 në sistemin tonë arsimor shqiptar kanë ndodhur mjaft ndryshime. Lëvizja politike, ekonomike e shoqërore, ndryshimet demokratike, të gjitha këto ndikuan mjaft edhe në fushën e arsimit. Këto u pasqyruan në fillim në lëndët shoqërore duke synuar çideologjizimin dhe depolitizimin e programeve dhe teksteve mësimore si dhe pasurimin me dijet shkencore e didaktike bashkëkohore. Shkolla u çlirua nga tutela dhe ideologjizimi. Pas kësaj periudhe vihet re një lëvrim dhe disa studime në gjuhësinë e zbatuar.<sup>19</sup>

Dhe pikërisht studimet në Shqipëri përfshijnë disa fusha si:

- **Në fushën e leksikografisë** interes paraqet “Fjalori krabasues i termave të gjuhësisë”<sup>20</sup> i studiuesve Rrokaj, Belluscio.

Në **Sociolinguistikë**, botimet: “Sociolinguistikë”, “Etnografi e të folurit të shqipes”<sup>21</sup>, të gjuhëtarit Gjovalin Shkurtaj.

- **Në fushën e didaktikës**, librat e studiuesve Mimoza Gjokutaj, “Didaktika e gjuhës shqipe”<sup>22</sup> dhe Njazi Kazazi “Didaktikë e gjuhës shqipe”.

---

<sup>19</sup> Në fjalorin “Routledge Dictionary of language and linguistics” gjuhësia e zbatuar përkufizohet si “Term që mbulon nëndisiplina të ndryshme si edhe disa fusha ndërdisiplinare që përdorin metodat gjuhësore: pedagogji gjuhësore, psikolinguistikë, njohje e gjuhës, njohje e gjuhës së dytë, përkthim, analizë kontrastive, planifikim gjuhësor, leksikografi, gjuhësi të njehsuar, etnolinguistikë, sociolinguistikë etj.”

(Hadumond Bussmann, (1996). *Routledge Dictionary of language and linguistics*, Routledge, f. 30.)

<sup>20</sup> Ky fjalor është hartuar në dy pjesë dhe jep përkime terminologjike në katër gjuhë: shqip, italisht, frëngjisht, anglisht me synimin për ta lidhur terminologjinë shqipe me traditat gjuhësore të këtyre tri gjuhëve të rëndësishme. Fjalori paraqitet si normative, në kuptimin që ai i përmbahet një tradite gjuhësore të qëndrueshme, e cila e ka tashmë një terminologji të ngulitur.

(Giovanni Belluscio, Shezai Rrokaj, *Fjalori krabasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë, 2011.)

<sup>21</sup> Libri “Sociolinguistikë” pasqyron një vështrim të përgjithshëm mbi sociolinguistikën si shkencë dhe problemet kryesore të studimit të gjuhës në kontekstin shoqëror, duke ngërthyer çështje që trajtojnë gjenezën e kësaj shkence të re hibride, bashkësia shoqërore dhe bashkësia gjuhësore, varieteti gjuhësor, akti gjuhësor, kompetenca komunikative e deri tek gjuhët në kontakt.

(Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, ShBLU, Tiranë, 1999.)

<sup>22</sup> Libri “Didaktika e gjuhës shqipe” përfshin një problematikë të gjerë në lidhje me mësimin e gjuhës shqipe, duke zbrëthyer në mënyrë shkencore dhe metodike shumë parime dhe kritere, që lidhen me vizionin e sotëm kurrikular. Libri trajton probleme të ndryshme të aplikimit të gjuhës në shkollë shoqëruar me parime, koncepte, metoda, teknika e strategji mësimdhënieje.

- **Në fushën e fonetikës** librat: “*Fonetika e shqipes standardë*” e gjuhëtarit Rami Memushaj dhe “*Fonetikë akustike: analizë e sistemit fonologjik* e studiueses Aljula Jubani.<sup>23</sup>

- Në **Psikolinguistikë** libri “*Përftimi i shqipes përmes dialektit dhe standardit*” (Rasti i fëmijëve nga Shkodra)<sup>24</sup> i studiueses Rrezarta Draçini.

- **Në fushën e gjuhësisë së zbatuar** librat: “*Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*”<sup>25</sup> e studiuesit Tomor Plangarica dhe “*Gjuhësia e zbatuar përmes kurrikulës së gjuhës shqipe*”, e studiueses Irida Hoti.

- Botimi “*Stilistika dhe pragmatika*” është i vetmi libër në gjuhën shqipe, që trajton këto dy fusha studimi.<sup>26</sup>

- Vëllimi “*Semiotikë e teksti*”<sup>27</sup> është një tjetër botim në gjuhësi të zbatuar. Ndeshen gjithashtu edhe përmbledhje punimesh në disa fusha gjuhësore, si: morfologji, sintaksë, leksikologji dhe kulturë e gjuhës, nga gjuhëtarët: Tomorr Osmani

---

(Mimoza Gjokutaj, *Didaktikë e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë, 2009.)

<sup>23</sup> Libri i ndarë në tre krerë: *Gjuha shqipe standarde dhe sistemi i njësive fonologjike; Analiza akustike e sistemit fonologjik të shqipes standarde; Karakteristikat funksionale të sistemit fonologjik të shqipes standarde* përqendrohet në analizën akustike të realizimeve të sistemit fonologjik të variantit standard të shqipes.

(Aljula Jubani, *Sistemi fonologjik i shqipes standarde-Analizë akustike*, Tiranë, 2011)

<sup>24</sup> Libri pasqyron nga njëra anë, rrugën që ndjek fëmija në përfitim gjuhësor, duke parë nga afër kontaktin “dialekt-standard” ndërsa përfiton gjuhën mëmë, mbështetur si në teoritë bashkëkohore ashtu dhe në vëzhgime të drejtpërdrejta; dhe, nga ana tjetër, pasqyrohen arritjet në shkallë botërore të shkencës së psikolinguistikës, që e kanë bazën tek veprat origjinale të Noam Çomskit.

(Rrezarta Draçini, *Përftimi i shqipes përmes dialektit dhe standardit*, Shkodër, 2013)

<sup>25</sup> Autori synon të paraqesë disa mënyra interpretimi, të dukurive, problemeve, fakteve të ndryshme gjuhësore, këndvështrimin e disa prej formave, metodave dhe teorive të gjuhës.

(Tomor Plangarica, *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, Sejko, 2002)

<sup>26</sup> Pragmatika është një degë e re e kërkimeve gjuhësore, e cila shqyrton se si përdoret gjuha në marrëdhëniet reale të njerëzve, duke e përfshirë edhe folësin në këtë dukuri që është karakteristika më thelbësore e njerëzimit. Në këtë vëllim jepen disa njohuri themelore fillestare, si: Lindja dhe përcaktimi i pragmatikës, nocionet themelore dhe parimet e pragmatikës, dy nivelet e studimit (mikropragmatika dhe makropragmatika), aktet e të folurit, analiza e bisedës dhe pragmatika sociale etj. Pjesa për stilistikën është më e plotë se pjesa për pragmatikën, e ndarë në dy pjesë: stilistikë e përgjithshme dhe stilistikë e shprehësisë me 15 kapituj.

(Xhevat Lloshi, *Pragmatikë dhe stilistikë*, Tiranë, 1999.)

<sup>27</sup> Libri përpiket t’i përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjes: Si të analizojmë një reklamë, një artikull gazete, një përrallë, një tekst letrar, një program televiziv deri edhe një objekt konsumi?, duke na vënë në dispozicion mjetet për të kaluar nga teoria semiotike në praktikën e analizës së tekstit.

(Maria Pia Pozzato, *Semiotika e tekstit*, Përktheu: Dhurata Shehri, Tiranë, 2005.)

“*Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*”<sup>28</sup>, Tefë Topalli “*Kërkime gjuhësore*”<sup>29</sup>, Shezai Rrokaj “*Çështje të gjuhës shqipe*”<sup>30</sup> etj.

Këto dhe të tjera botime në gjuhësi të zbatuar synojnë të paraqesin zbatime të gjuhës në disiplinat përkatëse, me prurje të reja interesante, duke dhënë një kontribut të vyer nëpërmjet trajtimit të problemeve që përfshijnë këto disiplina të reja si edhe në shqyrtime të thelluara me studime rasti e analiza të hollësishme.

Kjo formë e trajtimit të gjuhësisë së zbatuar, pas viteve '90, (mësimi i gjuhës asnjëherë nuk ka qenë e integruar me disiplina të tjera), para viteve 90 kanë qenë disiplina të veçuara me objekt të veçantë studimi, të cilat kanë ndërvepruar me njëra-tjetrën në mënyrë intuitive e jo në mënyrë të planifikuar shkencërisht dhe objektiva të qarta për këtë ndërthurje disiplinash

Megjithatë ka ende vend për të eksploruar për një gërshetim të këtyre shkencave në fushën e gjuhësisë së zbatuar, duke e përkshruar më tej atë

### ❖ Vendi i gjuhësisë së zbatuar në gjuhësinë shqiptare

Gjuhësia e zbatuar si një degë e gjuhësisë, në të cilën çështja kryesore është aplikimi i teorive gjuhësore, metodave dhe gjetjeve për shpjegimin, sqarimin e problemeve gjuhësore, të cilat janë ngritur në fusha të tjera po merr një zhvillim të vrullshëm edhe në Shqipëri me botime në fusha të ndryshme gjuhësore.

Bussmann në fjalorin e gjuhës dhe gjuhësisë thekson se “*Dega më e mirë e zhvilluar e gjuhësisë së zbatuar është mësimdhënia dhe nxënia e gjuhës së huaj, dhe ndonjëherë termi përdoret edhe sikur të jetë e përfshirë vetëm kjo fushë... Gjendet një kusht i pacaktuar mes gjuhësisë së zbatuar dhe degëve të tjera ndërdisiplinare të gjuhësisë si: sociolinguistika dhe psikolinguistika. Nga ana tjetër, ndërsa këto degë zhvillojnë bazat e tyre teorike, dallimi mes ‘pure – e saktë, e*

---

<sup>28</sup> Përmbledhje studimesh në fushë të gjuhësisë që nga alfabeti, historia e shkrimit të shqipes, deri në vlerësime e rivlerësime të ngjarjeve gjuhësore, apo autorë të ndryshëm për kontributin e dhënë në hartimin e teksteve, në trajtimin e problemeve të shumta të planifikimit a normimit të gjuhës shqipe.

(Tomorr Osmani “*Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*”, Shkodër, 2006-)

<sup>29</sup> Përmbledhje shkrimesh studimore në dy pjesë: me kumtesa për probleme të ndryshme, artikuj përkujtimorë, analiza veprash gjuhësore e letrare, duke sjellë një shumësi tekstesh të modeluara sipas kërkesave të modelimit të tyre, nga teksti shkencor, publicistik, përshkrues, argumentues dhe poetik në lëmë të sintaksës, gjuhësisë së tekstit, stilistikës etj.

(Tefë Topalli “*Kërkime gjuhësore*”, Enti Botues Poligrafik ‘Gjergj Fishta’, Lezhë, 2011.)

<sup>30</sup>Përmbledhje shkrimesh në disa fusha të gjuhës si: morfologji, sintaksë, leksikologji dhe kulturë e gjuhës, trajtime që lidhen me shqipen e sotme dhe problemet që ajo ka, si: Përdorimi i vetës së dytë njëjës me kuptim përgjithësues; Fjalësi me –shëm në disa vepra të Kadarese; Dy çështje për mësimdhënie e gjuhës shqipe në shkollë etj. Këto trajtime shoqërohen me përshkrime e analiza të dhënash.

(Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, 2007.)

*thjeshtë' dhe 'applied – e aplikuar' po bëbet më e dukshme dhe po hasen shumë shpesh karakteristikat e kërkimeve në 'psikolinguistikën e zbatuar'.”<sup>31</sup>*

## **Përfundim**

Sot, gjuhësia e zbatuar është larguar nga politizimi, ajo po lulëzon si shkencë më vete.

Po shtohet numri i studimeve dhe botimeve në fusha të ndryshme të gjuhësisë.

Në programet dhe tekstet e para viteve '90 kishte njëanshmëri të theksuar dhe politizim, ndërsa pas viteve '90 sistemi arsimor shqiptar u çideologjizua, u depolitizuan programet dhe tekstet mësimore duke u pasuruar me dijet shkencore e didaktike bashkëkohore.

Shkolla u çlirua nga tutela dhe ideologjizimi.

Gjuha amtare si lënda kryesore në shkollë, megjithëse ka kaluar përmes proceseve të vështira të konceptimit dhe reformimit të saj ende gjallon dhe kjo vihet re qartazi në programet mësimore, në tekstet dhe tek vetë mësuesit. Gjuhësia e zbatuar kërkon një vëmendje të veçantë nga studiuesit dhe gjuhëtarët shqiptarë sepse studion gjuhën e gjallë, gjuhën në përdorim.

## **Bibliografia:**

1. Belluscio, G., Rrokaj, Rr., (2011). *Fjalor kerabasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
2. Bussmann, H., (1996). *Routledge Dictionary of language and linguistics*, London and Neë York, Routledge.
3. Cook, G., (2003). *Applied linguistic*, Oxford introduction to languages study, Series H. G. Widdowson, Oxford.
4. Cook, V., 'What is applied linguistics?', in Vivian Cook: *Obscure Writing*. 2006, f. 5., <http://homepage.ntlworld.com/vivian.c/Writings//index.htm>.
5. Crystal, D., *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*. Fourth Edition, Oxford: Blackwell Publishers, 2001
6. Davies, A., *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Edinburgh University, 2007.

---

<sup>31</sup> David Crystal, *A Dictionary of Linguistics and Phonetics*. Fourth Edition, Oxford: Blackwell Publishers, 2001, f. 23.



7. De Gomes, F., *What is applied linguistics? A personal view. Issue of applied linguistics*; Vol. 2, 2005.
8. Dracini, R., *Përfitim i shqipes përmes dialektit dhe standardit*, Shkoder, 2013
9. -Duhaxhiu, A.; Xhumari, K., *Gjuha shqipe, Klasa I*, Instituti i Studimeve dhe Botimeve shkollore, Tiranë, 1965
10. Grabe, W., *Applied linguistics: An emerging discipline for the twenty – first century*. In B.R Kaplan, *The Oxford handbook of applied linguistics*, Oxford University Press, 2001.
11. Gjokutaj, M., (2009, 2012). *Didaktikë e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë.
12. Harxhi, B.; Bimbashi, E.; Reso, I.; Prifti, N.; Osmani, Sh.; Dhimitruka, Sh., *Leximi 3*, Për klasën e 3-të të shkollës 8-vjeçare, SHBLSH, Tiranë, 1985.
13. Hoti, I., (2013). *Gjuhësia e zbatuar përmes kurrikulës së gjuhës shqipe*, Shkodër.
14. Johnson, K.; Johnson, H., (1999). *Encyclopedic Dictionary of Applied Linguistics: A Handbook for Language Teaching*.
15. Jubani, A., (2011). *Sistemi fonologjik i shqipes standarde-Analizë akustike*, Shtëpia Botuese “Shkronje pas shkronje”, Tiranë.
16. -Kazazi, Nj.; Garuci, N.; Zhabjaku, N., (2006). *Didaktikë e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë.
17. Lloshi, Xh., (1999). *Pragmatikë dhe stilistikë*, Botimet Toena, Tiranë.
18. McCarthy, M., (2001). *Issues in applied linguistics*, Cambridge University Press.
19. -Memushaj, R., (2010). *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë.
20. *Metodika e gramatikës*, -Për shkollat pedagojike dhe për mësuesit e shkollave fillore, Drejtoria e Botimeve Shkollore, Tiranë, 1963.
21. Osmani, O., (2006). *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Camaj-Pipa, Shkodër.
22. Plangarica, T., (2002). *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, Sejko.
23. Pozzato, M., (2005). *Semiotika e tekstit*, Përktheu: Dhurata Shehri, ShBLU, Tiranë.
24. *Programi i shkollës tetëvjeçare, gjuhë shqipe, lexim letrar*, klasat V-VIII, Tiranë, 1963.
25. *Programi i shkollës tetëvjeçare*, klasat I-IV, Tiranë, 1978.
26. Richards, J., Schmidt, R., (2002). *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*.
27. Rrokaj, Sh., (2007). *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë.
28. Topalli., (2001). *Kërkeime gjuhësore*, Enti Botues Poligrafik ‘Gjergj Fishta’, Lezhë.



Julie KOLGJINI

**RE-ORIENTIMI I EKOLOGJISË SË GJUHËS NË KORNIZËN  
METROLINGUALE BASHKËKOHORE: SUGJERIM KRITIK PËR  
NDËRRIMIN E PARADIGMËS DREJT ZGJËRIMIT, TË BAZËS SË  
STANDARDIT TË PERBASHKËT TË SHQIPES**

**1.0 Hyrje**

Gjatë disa dekadave të fundit, gjuhëtarë të ndryshëm kanë komentuar se një mënyrë për të unifikuar shqipen letrare (dmth *gjuhën letrare të njësuar* GjLNj) është përballimi i testit të kohës; ashtu si gjuhët e tjera normative të gjalla, ajo duhet të jetë e “lejuar” që t'u nënshtrohet ndryshimeve gjuhësore evolutive (shih Milroy 2001; Milroy dhe Milroy 2012). Inkludimi i elementeve të ndryshme që janë përjashtuar gjatë procesit të standardizimit në vitin 1972 në kongresin e drejtshkrimit, do të ndihmonin kështu për një formë më të kultivuar të gjuhës; do ta distanconin GjLNj-në nga natyra e saj homogjene dhe monocentrike duke i nxjerrë në pah praktikën policentrike gjuhësore të folësve të saj (shih Bajroni 1973, 1976; Milroy 2001).

Duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë aktual të medieve të reja ndërllokale në një mjedis të de-territorializuar dhe polilingual, një qasje e shqipes letrare të unifikuar ekzistuese (GjLNj) drejt integritit të elementeve të ekologjisë gjuhësore të policentrizmit Gramscian dhe heterogjisë së Bakhtin-it do të ishte më në sinkronizim me realitetin bashkëkohor poliglosik me shumë komunitete të folësve të shqipes në tregun gjuhësor të shekullit të 21-të. Gjithashtu, do të shërbente si shërim i pjesshëm për situatën aktuale të padrejtësive (dëmtimeve) gjuhësore dhe pasigurisë, veçanërisht në lidhje me humbjen e rrjedhshmërisë së të folurit të disa folësve të marginalizuar prej heqjes të së drejtës së varieteteve të stigmatizuara të shqipes, duke shmangur, të paktën deri në një fare mase, pasojat represive të së kaluarës. Një pozicionim i tillë do të lejojë brezin e ri të përdoruesve të gjuhës të ushtrojë lirinë e vet në arritjen e “vetaranzhimit në normën [gjuhësore]” ku “identiteti [n]acional dhe gjuha mund të kenë më pak rëndësi...se interesat e përbashkëta [zhvillimore imediate], vlerat, dhe mënyrat e jetesës” (Leppänen et al. 2009:1080). Kjo perspektivë mund të inkurajojë gardianët e gjuhës me tendencat ortolinguistike që të rifokusojnë energjitë e

tyre nga mbështetës të “dogmave të ngulitura thellë” (Del Valle 2014:370) të ideologjisë së standardit të gjuhës që u përqëndrua në imponimin gjuhësor dhe denigrimin, si dhe të politikave të tjera përjashtuese e neglizhuese që lanë pas dore konsiderimin e realitetit të pasur socio-historik të përdoruesve të gjuhës, në nxitjen e një regjimi më përfshirës ku folësi është në qendër të regjimit gjuhësor, që përfshin diversitetin real, stilet kundër-standarde, regjistrat, dhe repertorët, në hapësirën policentrike të sociolinguistikës aktuale. Në vend të përjetësimit të politikave gjuhësore të vjetruara që insistojnë në intolerancën këmbëngulese të epokave të shkuara që (ende) përfshijnë që hermetikisht të nënshkruajnë gjuhën dhe të parandalojnë ndonjë rrjedhje, nder-kontaminim, ndër-gjuhëzim, ose *codemeshing* (përzierje kodesh) nga një variant në një tjetër, qasja alternative (në fjale) që mbështet akomodimin dhe komunikueshmërinë. Gjithashtu, duke pasë parasysh përhapjen e sociolekteve policentrike të cilësive të ndryshme urbane shqipfolese (p.sh. si Tirana, Prishtina, Shkupi apo Tetova, ndër të tjera), politika e vjetër që i ngjan përpjekjes për ta “kthyer pasten e dhëmbëve përsëri në tubet” është po aq sfiduese sa dhe e kotë. Kështu, shumë prej përpjekjeve të tanishme të disa gardianëve të standardit (GjLNj), duke përfshirë zëvendësimin dhe paradigmat e përshtatshmërisë, mund të jenë mjaft të padobishme, sidomos duke pasur parasysh realitetin aktual metrolingual të shumë përdoruesve të gjuhës shqipe (shih Otsuji dhe Pennycook 2010; Jaworski 2014).

## **2.0 Ideologjia e gjuhës (standarde) shqipe në kuadër të policentrizmit gjuhësor dhe heteroglosisë**

Studiues të shumtë kanë theksuar, se ideologjia e gjuhës standarde luan një rol të konsiderueshëm, por shpesh të nënkuptuar, në mënyrën se si shumë përdorues e përceptojnë gjuhën, veçanërisht në lidhje me politikat e standardizimit dhe planifikimit, dhe në këtë mënyrë edhe format (jo) të standardizuara (p.sh. Milroy 2001; Milroy dhe Milroy 2012; shih gjithashtu Woolard dhe Schieffelin 1994; Woolard, Schieffelin dhe Kroskrity 1998; Wiley 2014; Armstrong dhe Mackenzie 2013; Ag dhe Jørgensen 2012; Watts 2010; Heller 2008; Shohamy 2006; Leeman 2005; Cameron 1995). Milroy (2001:531) shpjegon: “[S]tandardizimi funksionon duke promovuar invariance ose uniformitetin në strukturën e gjuhës...[dhe] konsiston në imponimin e uniformitetit mbi një klasë të objektivizuar... Përkufizimi i tij supozon që objektet në fjalë (duke përfshirë objektet abstrakte, siç është gjuha) janë, në natyrën e gjërave, jo uniforme, por të ndryshueshme (variable)” (Milroy 2001:531). Kjo ndodh, kur e ndryshueshmja në thelb, bëhet shpesh e pandryshueshme prej politikave të ndryshme gjuhësore të vëndosura. Ideologjia e gjuhës Standarde ka tendencë për ta pa gjuhën si një objekt të fiksuar (krh. proces dinamik) diskret, që përbëhet nga “idealizim[e] të

qendrushme sinkronike, finite” si zgjidhje e dhanë një here e mire e gjuhës (Milroy 2001:540) dhe promovon invariance, homogjenitet, të folur të “kujdesshëm”, nocione të rrepta të “korrektësisë,”<sup>1</sup> prescriptivizëm, gramatikalitet, e shoqëruar me fushata për “përdorim të drejtë” (Blommaert dhe Verschueren 1998: 128), forma kanonike, me justifikime dhe apele post-hoc për “sens të përbashkët” me pretendimet për ligjshmërinë<sup>2</sup>, autenticitetin, pronësinë mbi gjuhën amtare (gjuhën e nënës; shih gjithashtu Milroy 2001:532, 533, 535, 536, Silverstein 1996) nën nocionet “një komb/një gjuhë (standarde) kombëtare” (Ricento 2000:198), pastërti gjuhësore, ideologji monoglothe gjuhësore (Blommaert 2013:12), pra “politikë e gjuhës dhe kulturës ‘homogjene’”<sup>3</sup> (Blommaert 2013:12). Kjo ideologji gjuhësore në mënyrë implicite (dhe në disa raste edhe eksplicite) dekurajon përdorimin e formave të “pasakta” (p.sh. jo-standarde), të cilat shpesh shihen si moralisht të gabuara (Milroy 2001:537), nuk pranon të njohë ndryshueshmërinë (faktike) të (standardit) (shih Blommaert dhe Verschueren 1998 për një diskutim mbi ideologjinë e homogjenitetit gjuhësor), duke u përpjekur të eliminojë fragmentimin mbrenda standardit. Milroy thekson, megjithatë, “në përdorimin praktik nuk mund të ketë ... standardizim të plotë të një varianti” (Milroy 2001:534). Sipas Milroy-t standardizimi është “një proces vazhdimisht në zhvillim e sipër në ato gjuhë që i nënshtrohen procesit” (2001:534), në vend të gjendjes flegmatike të mbylljes në vetvete. Më tej, folësit të cilët kanë rënë pre e ideologjisë së gjuhës standarde dhe të kulturës shpesh i atribuojnë prestigj dukshëm të mbivlerësuar asaj. Milroy (2001:532) vëren: “[P]restigji atribuohet nga qeniet njerëzore të grupeve të caktuara shoqërore për objekte pajetë, të tilla si...variate gjuhësore, dhe kjo varet nga *vlerat* që i atribuohen objekteve të tilla. Veshja me prestigj e varianteve gjuhësore (nga metonimia) është tregues i përfshirjes në jetën sociale të folësve.” Pra, njerëzit ia veshin prestigjin gjuhës; prestigji nuk është një element i

---

<sup>1</sup> Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Møller (2011:30) shpjegojnë: “[T]here is no such thing as inherently correct language. Correctness is social construction about the characteristics of specific linguistic features. Correctness has nothing to do with the linguistic characteristics of features – correctness is ascribed to the features by (some) speakers. The notion of ‘correct language’ may index specific features in (at least) two different ways...[like] native speakers...”

<sup>2</sup> Milroy (2001) shënon: “The standard form becomes the legitimate form, and other forms become, in the popular mind, illegitimate...Urban forms...although probably used by a majority of the population...were at the bottom of the pile...These were not ‘dialects’ at all: they were seen...as vulgar and ignorant attempts to adopt or imitate the standard and were therefore illegitimate” (547).

<sup>3</sup> “‘Homogeneity’ [is] a fundamental non-acceptance of diversity,” including where diversity is seen as a type of societal “pollution,” often involving “intolerant and anti-pluralistic measures” (Blommaert dhe Verschueren 1998:i, 122, 125, 126).

lindur me gjuhën, por është një konstrukt socio-kulturor<sup>4</sup> (shih Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Møller 2011: 28).

Ngjashëm me gjuhë të tjera të standardizuara, GjLNj-ja është gjithashtu objekt i diskutimeve të ideologjisë së standardit gjuhësor dhe kulturës. Në vitin 1972 standardizuesit e GjLNj-së në kongresin e drejtshkimit, së bashku me kujdestarë e derëtarë të tjerë të ndryshëm të gjuhës, triumfalisht u bënë avokatë të homogjenitetit, invariances, striktizmit rigoroz ortolinguistik ndaj rregullave të përcaktuara normative, për pasojë, eliminues të formave të ndaluara, dhe mbrojtës të puritanizmit gjuhësor duke marrë përsipër koston e diversitetit të një standardi pluricentrik, të ngjashëm me atë që Gramsci përfytyroi përtej Adriatikut për italishten (shih Carlucci 2013; Ives 2004), për një standard që përfshin elementet e heteroglosise Bakhtinian-e<sup>5</sup>, në mënyrë që i hap rrugë kodifikimit të praktikave komunikuese në një atmosferë përfshirëse, të paktën deri në një masë të konsiderueshme, të fleksibilitetit (pasiv) të dygjuhësisë së reciprocitetit si dhe përpjekjeve të tjera akomoduese në lidhje me varietetet e ndryshme (letrare) të shkruara dhe të folura të shqipës (shih Bajroni 1973, 1976). Gramsci ishte për një formë të gjuhës gjithëpërfshirëse, që gjeneron dhe rezonon me zërat e përdoruesve të gjuhës e dialekteve të ndryshme (të italishtes); një standard të tillë të përbashkët, pluricentrik që do të lejojë folësit të artikulojnë në menyre koherente idetë në vend të një sistemi monocentrik (unitar) të imponuar (shih Dentith 1994:197, 200). Carlucci shkruan: “Përvojat dhe reflektimet e Gramscit lidhur me diversitetin gjuhësor e pajisën atë me vetëdijen për rëndësinë e punës drejt bashkimit përmes një shqyrtimi të kujdesshëm të diversitetit - jo nëpërmjet denigrimit apo eliminimit shtrëngues të tij” (200). Për Gramsci-n ruajtja e sensit të ekologjisë gjuhësore ishte e një rëndësie të vecantë për një formë të unifikuar të gjuhës (kombëtare).

Në një shënim të ngjashëm, Bakhtin-i eksploron nocionin e heteroglosisë<sup>6</sup> (dhe

<sup>4</sup> Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Møller (2011:28) shkruajnë: “The insight of current sociolinguistics is then that ‘languages’ as neat packages of features that are closely connected and exclude other features, are sociocultural constructions that do not represent language use in the real world very well...Rather than being natural objects, comprising readily identifiable sets of features, ‘dialects’, ‘sociolects’, ‘registers’, ‘varieties’, etc. are sociocultural constructions exactly as ‘languages’ are.”

<sup>5</sup> Otsuji dhe Pennycook (2010:252) shkruajnë: “Heteroglossia, as Bailey (2007, p. 258) reminds us, ‘encompasses both mono and multilingual forms’ allowing a ‘level of theorising about the social nature of language that is not possible within the confines of a focus on code-switching.’ Blommaert (2010:12) shpjegon: “The intrinsic hybridity of utterances (something, of course, introduced by Bakhtin a long time ago) is an effect of interactions within a much larger polycentric system.”

<sup>6</sup> Hayward shkruan: “Postmodern appropriations of Bakhtin’s work are too diverse to summarize briefly. In its implication that language carries within itself ideological orientations

poliglossisë), ose *multispechedness*, përfshirjen e gjithë të folmeve në përpjekje për të përfaqësuar një formë autentike të gjuhës, duke u përqendruar tek stili (shih Dentith 1994:200-203). Hayward-i shkruan: “Heteroglossia është një koncept që shpreh ndarjen e shtresave të gjuhës së praktikuar nga folësit e një gjuhe të vetme (zyrtare apo kombëtare), dhe dinamikën e krijuar nga kryqëzimet dhe ndërveprimet e ndryshme të tyre.” Praktikant gjuhësore të tilla përfshijnë aktivizimin e gjuhëve të ndryshme dhe/ose varieteteve të ndryshme gjuhësore, shpesh herë mbrenda dhe/ose ndërmjet shprehjeve të të folmeve dhe/ose të shkruara dhe fjet lidhëse të gjuhës. Hayward-i shpjegon se për Bakhtin-in, heteroglossia “drejtohet nga dy forca kundërshtarë, centripetale (në drejtim të vetëm prej ‘qendrës’ duke nënkuptuar nocionin e një gjuhe ‘zyrtare’ apo ‘kombëtare’), dhe centrifugale (larg nga ‘qendra’ në drejtim të dialekteve rajonale, si ‘gjuhët’ e përdorura nga klasa të ndryshme, breza dhe profesione që përbëjnë një komunitet të folësve). Bakhtin-i tenton të theksojë centrifugalitetin...” Koncepti i heteroglossisë<sup>7</sup> përfshin fokusimin në shumëllojshmërinë e elementeve gjuhësore, jo limitim në mënyrë rigoroze standarde dhe jo-standarde, por ndërthurjen ndërmjet tyre (p.sh. *duke shkue*(e), *tu(e/j) shkuar*), plasticitetin semantik (p.sh. *mollatarta*, *domate*, *patëllxhan i kuq*, *dru*, *pemë*, *tamël*, *qumësht*, *gjalpë*, *tlynë*), si dhe çlirimin e formave të frenuara morfologjike, sidomos të atyre shpesh të stigmatizuara (p.sh. *me shkue*(e), *të shkoj*, ndër të tjera). Tjupa thekson, “Sipas të kuptuarit Ba[kh]tin-ian të përdorimit të

---

accrued from previous usage, but also that it can be modified in and by any new speech act, the concept of heteroglossia enables queer, feminist and post-colonial theories to interrogate dynamics of power without replicating them, and to elaborate the problems as well as the possibilities for subjects attempting to assert themselves ideologically and politically.”

<sup>7</sup> Bailey shënon: “Heteroglossia can encompass socially meaningful forms in both bilingual and monolingual talk; it can account for the multiple meanings and readings of forms that are possible, depending on one’s subject position; and it can connect historical power hierarchies to the meanings and valences of particular forms in the here-and-now” (cituar në Creese dhe Blackledge 2010:106). Creese dhe Blackledge (2010) shpjegojnë: “Bailey demonstrated that the perspective of heteroglossia allows one to distinguish between local functions of particular codeswitches and their functions in relation to their social, political, and historical contexts, in ways that formal codeswitching analysis does not. He convincingly argued that the perspective of heteroglossia ‘explicitly bridges the linguistic and the sociohistorical, enriching analysis of human interaction’ p. 269) and is ‘fundamentally about intertextuality, the ways that talk in the here-and-now draws meanings from past instances of talk’ (p. 272)” (in Creese and Blackledge 2010:106). Bakhtin shkruan se “language is something that is historically real, a process of heteroglot development, a process teeming with future and former languages, with prim but moribund aristocratic-languages, with parvenu-languages and with countless pretenders to the status of language which are all more or less successful, depending on their degree of social scope and on the ideological area in which they are employed’ (Bakhtin 01943/35] 1981: 356-57)” (cituar në Tjupa 2009:124).

gjuhës, një ‘person social’, i cili është gjithashtu një folës, nuk operon me gjuhën si një normë abstrakte rregullash, por me një numër të praktikave të diskursit të formuar në tërësinë e një kulturë dinamike verbale që i përket shoqërisë në fjalë” (124). Me fjalë të tjera, përdorimin e gjuhës, duke përfshirë edhe sociolektet e ndryshme (p.sh. të folurit e komuniteteve të ndryshme si në Tiranë, Prishtinë, Shkup apo Tetovë, ndër të tjera), përfshi këtu edhe aspekte të shumta të komponenteve të ndryshme shoqërore dhe kontekstuale, të cilat mund të luajnë një rol kryesor në ndikimin apo influencimin e formave (p.sh. standarde, jo-standarde; formale, informale) që aplikohen nga “gjuha e gjalle e folësve” (Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Moller 2011:29)<sup>8</sup>.

Në lidhje me GjLNj-në, qasja policentrike heteroglosike mund të japë një standard që është më shumë në përputhje me praktikat gjuhësore aktuale dhe në këtë mënyrë të reflektojë ndryshimet gjuhësore dhe natyrën heterogjene të të folurit nga të gjitha komunitetet (Leeman 2005:38). Një qasje e tillë do të harmonizohej me konceptin e Heller-it (2007:1), i cili “në mënyrë të qartë pozicionohet ‘kundër nocionit se gjuhët janë tërësi sistemesh objektivisht të kufizuara,’ dhe...preferon ta kuptojë përdorimin e gjuhës si dukuri që folësit ‘tërhiqen nga burimet gjuhësore të cilat janë të organizuara në mënyra të tilla që kanë kuptim në rrethana të caktuara shoqërore’” (Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Moller 2011:27-28)<sup>9</sup>. Këto burime gjuhësore përfshijnë shkriren e formave hibride (p.sh. varietetet e ndryshme, elementet divergjente dhe konvergjente gjuhësore, modelet, e kështu me radhë), që rezultojnë në një shprehje unike të stilit, dmth në shprehje autentike të vehtes. Për Bakhtin-in, “baza e stilit është pikërisht diversiteti i të folurit, dhe jo uniteti i një gjuhe të përbashkët normative” (Dentith 1994:203). Aplikimi i heterglosisë Bakhtin-iane lejon që “forma të tilla të hapin mundësinë që dikush ti përktheje synimet e veta nga një sistem gjuhësor në tjetrin, ti shkrijë ‘gjuhën e së vërtetës’ me ‘gjuhën e përditshme’, thënë ndryshe ‘unë jam vetja’ në gjuhën [(ose variantin)] e dikujt tjetër, dhe në gjuhën [(ose variantin)] tim ‘unë jam ai tjetri’” (Dentith 1994:209). Kjo pikpamje, evoluon shumtrajtshmërinë e perspektivave dhe këndvështrimeve dinamike (dmth “dy zëra, dy

<sup>8</sup> “[L]anguage is something that is historically real, a process of heterglot development, a process teeming with future and former languages, with prim but moribund aristocratic-languages, with parvenu-languages and with countless pretenders to the status of language which are all more or less successful, depending on their degree of social scope and on the ideological area in which they are employed’ (Baxtin 01943/35] 1981: 356-57)” (cituar në Tjupa 2009:124).

<sup>9</sup> Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Møller (2011:28) shënojnë: “Blommaert (2010: 102) similarly refers to ‘resources’ as the level of analysis. He observes that ‘[s]hifting our focus from ‘languages’ (primarily an ideological and institutional construct) to resources (the actual and observable ways of using languages) has important implications for notions such as ‘competence.’”



këndvështrime, dy gjuhë” Dentith 1994:218). Pra, multipliciteti i prespektivave ne evoluim dhe kendveshtrimeve dinamike ka potencial përçues kur këto akte të të folurit autentik dhe mundësitë gjuhësore janë të lejuara. Lemke thekson, megjithatë, se “presionet dominuese politike dhe ideologjike...i mbajnë ‘gjuhët’ të pastra dhe të ndara” (2002:85); dmth gjuhët dhe varietetet janë shpesh të “penguara politikisht” nga përzjerja, ndërthurja, shkrirja (Lemke 2002:85), e që në fakt ilustron ekzakt në rastin e GjLNj-së. Derëtarët e saj kanë tentuar që ta mbyllin hermetikisht standardin, duke e ruajtur me fanatizëm nga ndonjë rrjedhje apo prurje të palejuar, si p.sh. nga format jo-standardë (gegnishte) (shih Creese dhe Blackledge 2010:104, 106)<sup>10</sup>.

### 3.0 Gjendja (aktuale) e gjuhës, hibriditeti fluid dhe repertorët gjuhësor

Tani le ta marrim në konsideratë realitetin nën efektet e ndryshme të globalizimit, duke përfshirë migrimin e njerëzve dhe ideve, në pejsazhin lingvistik aktual (Blommaert dhe Rampton 2011: 3), për ta analizuar GjLNj-në. Ag dhe Jørgensen (2012) shpjegojnë, se superdiversiteti, i zbuluar nga Steven Vertovec (2007, 2010), përfshin “diversifikimin e diversitetit...prej nga popullsia bëhet gjithnjë e më shumë etnikisht dhe gjuhësisht heterogjene...dhe zgjerimi transnacional si dhe komunikimi ndërkufitar përmes internetit apo fenomene të tjera të reja teknologjike që kontribuojnë në çmontimin e komunikimit të idevë të thjeshta dhe të qarta” (527-528). Ky superdiversitet sjell shfaqjen e rregullave dhe normave si dhe respektimin e tyre, ashtu si dhe paraqitjen e normave alternative (Blommaert 2013:7), siç mund të vërehet në pejsazhe lingvistike të ndryshme, p.sh. në kontinentet Amerikane dhe Europë, ku nuk bën përjashtim rasti i shqipës në lidhje me kufizimet (më parë) të imponuara të GjLNj-së. Shpesh herë format e cinguarat shumëgjuhësore dhe repertorë gjuhësorë hyjnë në lojë (shih Blommaert 2010:103; Kramersch 2014:300, 305), ku “policentriciteti i mbrendshëm...karakterizon sistemet e sociolinguistikës” (Blommaert 2013:11), siç shfaqen shpesh në praktikat gjuhësore të shumë përdoruesve të GjLNj-së. Për shembull, elemente polilinguale të ndryshme mund të

---

<sup>10</sup> “[T]he teacher avoids, it is argued, cross-contamination, thus making it easier for the child to acquire a new linguistic system as he/she internalizes a given lesson...It was felt that the inappropriateness of the concurrent use [of two linguistic systems] was so self-evident that no research had to be conducted to prove this fact. (p. 4)” (Jacobson and Faltis 1990, cituar në Creese dhe Blackledge 2010: 104).

hyjnë në diskursin, ku polilingualizmi<sup>11</sup>, i cili përfshin “përdoruesit e gjuhës që aktivizojnë çfarëdo karakteristike gjuhësore në dispozicion për të arritur qëllimet e tyre komunikuese” (Ag dhe Jørgensen 2012:528), dhe shfaqja e fenomenit të shumëgjuhësisë receptive, dmth kur secili bashkëbisedues komunikon në gjuhën e tij/saj amtare (dhe në rastin e shqipes, “variantin” e ndryshëm mbrendagjuhësor), duke qenë në gjendje të kuptojë bashkëbiseduesin. Blommaert (2013) përmend që sot nga të dhënat e punës në terren, regullisht hasim “forma të dendura dhe shumë të paqëndrueshme hybride dhe multimodale” (8), që inkludojnë elemente të ruajtjes së ekologjisë gjuhësore (shih Kramersch dhe Whiteside 2008), duke përfshirë peisazhin e ndryshëm virtual gjuhësor të mediave të reja në zhvillim (shih Blommaert 2013, 2014), ku shpesh është vërejtur rrjedhshmëria semiotike e formave gjuhësore (Kramersch 2014:300), e cila na çon në metrolingualizëm.

Metrolingualizmi thekson kryqëzimet e strukturave gjuhësore, semiotikën, identitetin, mediat e reja, praktikat lokale gjuhësore policentrike, duke përfshirë, ndër të tjera, peisazhin gjuhësor që manifeston diversitetin, shumëllojshmërinë, dhe hibriditetin. Metrolingualizmi<sup>12</sup> mund të përkufizohet si “mënyra me të cilën njerëzit me prejardhje të ndryshme dhe të përzier përdorin, luajnë me të dhe negociojnë identitetet përmes gjuhës; nuk supozon lidhjet në mes gjuhës, kulturës, përkatësisë etnike, kombësisë ose gjeografisë, por kërkon të shqyrtojë se si janë prodhuar këto marrëdhënie, rezistencën, sfidat, ose riorganizimin e tyre; fokusi i tij nuk është në sistemet e gjuhës, por në gjuhët si zhvillim në kontekste të ndërveprimit” (Otsuji dhe Pennycook 2010:246). Një këndvështrim i tillë është i rëndësishëm për gjuhën shqipe, sidomos duke pasë parasysh migracionin e folësve shqiptarë. Ndërsa një folës është rritur duke folur gjermanishten zvicerane ose frëngjishten standarde në shkollë apo në punë dhe shqipen në shtëpi, një tjetër folës përdor italishten në komunitetin ku jeton, dhe shqipen në ambientin familjar. Kur këta folës përzihen shpesh këto repertorë divergjentë komunikues në mënyrat e të folurit dhe/ose mënyrat e shkrimit, rezultojnë në *codemeshing* dhe *translanguaging*, ku një sistem gjuhësor pëson “rrjedhje” por dhe “infekton” të tjerët duke i “sfid[uar] hierarki dhe hegjemoni të veçanta, sado të përkohëshme që mund të jenë” (Creese dhe Blackledge 2010:104; shih gjithashtu

<sup>11</sup> Ngjashëm, *polylinguaging* është “the use of features associated with different ‘languages’ even when speakers know only few features associated with (some of) these ‘languages’” (Jørgensen, Karrebæk, Madsen, and Møller 2011:33, 34; shih gjithashtu Ag dhe Jørgensen 2012).

<sup>12</sup> Otsuji dhe Pennycook (2010:245-246) shkruajnë: “We do not, however, want to limit the notion of metrolingualism only to the urban...[W]e want to avoid an idealization of the urban metrolingual landscapes set against the assumed narrowness of rural living. This has two corollaries: on the one hand, metrolingualism as a practice is not confined to the city; and on the other, it is intended as a broad, descriptive category for data analysis rather than a term of cosmopolitan idealism...[M]etrolingualism may be rural, mobile, local and fragile.”

Canagarajah 2011; Li 2011), pra “duke penguar kështu...praktikat ortolinguistike” (Otsuji dhe Pennycook 2010:245). Nga perspektiva e metrolingualizmit, folësit nuk shihen si *bastardizues* të gjuhëve ose dialekteve. Otsuji dhe Pennycook (2010) shpjegojnë, se “fokusi nuk është aq shumë në sistemet e gjuhës por në zhvillimin e tyre në kontekstin e ndërveprimit...Nocioni i metrolingualizmit jep mënyra për të lëvizë përtej kornizave të zakonshme të gjuhës, duke siguruar njohuri mbi praktikat gjuhëore bashkëkohore urbane, dhe akomodimin e të dyjave, të fiksuarës dhe të rrjedhshmes në qasjen ndaj përdorimit të gjuhës” (240). Jaworski (2014: 139) shpjegon, metrolingualizmi është “manifestim i shfaqjeve gjuhësore,” duke përfshirë edhe ato që shfaqin praktikat policentrike dhe heteroglosike “në të cilat forma gjuhësore të zgjedhura me vetë-koshiençë indeksojnë situata të përsëritura të përdorimit apo kategori të caktuara shoqërore” si psh. gjininë apo rajonin. Këto janë akte metapragmatike që krijojnë indeksikalitete kuptimore dhe vlera simbolike të reja (Rampton, 2009a), që askush nuk i ka dëgjuar më parë (Jonstone 2009, Silverstein, 2003).” Kjo qasje gjuhësore përfshin “rikontekstualizimin...ose transplantimin dhe zhvendosjen e burimeve gjuhësore nga një sferë në tjetrën, shpesh me sens kreativ... Manipulimi i tillë i kategorive sociale relativisht fikse është guri i themelit të përdorimit metrolingual që synon të sfidojë dhe të destabilizojë atribuime të identiteteve tradicionale dhe fikse, ideologjitë dhe praktikat ‘ortolinguistike’” (Jaworski 2014 139; shih gjithashtu Otsuji dhe Pennycook 2010:249-250). Shprishja dhe turbullimi i ideologjiave dominuese si dhe negocimit të identitetit janë komponentët përbërëse të metrolingualizmit (Jaworski 2014 139). Metrolingualizmi është “i interesuar në shprishjen e praktikave ortolinguistike në kohë dhe hapësirë që mund të përfshijë kontekste urbane dhe rurale, elitare ose komunitete minoritare, implikime lokale apo globale” (Otsuji dhe Pennycook 2010:246). Me fjalë të tjera, është “strategji pluralizuese me orientim-hybrid” në kuadrin metrolingual përqafues të “prodhimit të mundësive të reja” të gjuhës, si “një pronë në zhvillim të praktikave të ndryshme shoqërore,” duke refuzuar ideologjitë ortolinguistike si një gjë e fiksuar dhe e ngurtë kulturore.

#### **4.0 Mundësia e ri-orientimit të regjimit linguistik të shqipes: sugjerim kritik për ndryshimin e paradigmës**

Gjendja aktuale e gjuhës shqipe përmban shumë nga çka u tha në seksionet e mëparshme, p.sh. heteroglosia, *codemeshing* dhe *translanguaging*, ndër të tjera, sidomos

duke pasë parasysh realitetin e saj diglosik<sup>13</sup> ku GjLNj-ja (apo varianti toskë) gëzon statusin dhe prestigjin e gjuhës së ngritur në krahasim me variantet e stigmatizuara gege. Aktualisht gjuha shqipe është duke kaluar nëpër ndryshime të konsiderueshme nga poshtë, një lloj ndryshimi në bazë të folës-motivim-it, ku një numër i nëndialekteve është në procesin e “rrjedhjes” në të, ku një strukturë gjuhësore bashkohet, apo ndërthuret, me një tjetër (p.sh. *duke shkruar; tuj shkruar*). Përzierje të tilla dialektesh, dmth transferimet ndër-dialektore dhe huamarrja e elementeve gjuhësore (p.sh. artikuj leksikore dhe karakteristika strukturore) janë rezultat i njohur i kontakteve dialektore, sidomos kur sistemet gjuhësore kanë qenë (dhe janë) në situata të tilla kontakti (intensiv) të konsiderueshm (Lofi 2007:38; krh. ndërhyrjet strukturore). Gjendja e tanishme e gjuhës shqipe ilustron se si, kur folësit janë në karriken e shoferit, ajo mund të shfaqë karakteristika mjaft fluide dhe dinamike, sidomos në lidhje me praktikën e tilla gjuhësore pluricentriste dhe heteroglosiste folës-drejtues, ku elemente urbane, rurale, provinciale, arkaike, kanonike, (jo)ortodoksiste si dhe elemente inovative janë të endura në repertorët<sup>14</sup> e tyre gjuhësore. Influenca multi-dialektore dhe “praktika transidiomatike” (Blommaert 2013:8), duke përfshirë raste të herëpashershme të ideologjisë dialektore (Watts 2010), ilustruar me shembullin agjenci e folësve në zgjedhjen gjuhësore ku kozmopolitizmi gjuhësor (Sonntag 2009) dhe metrolingualizmi (Otsuji dhe Pennycook 2010; Jaworski 2014) futen në lojë.

Më tej, përhapja e mediave moderne, peisazhi metrolingual, dhe faktorë të tjerë kontribues kanë ndikuar dhe në formimin (deri në një fare masë) e një brezi (apo më shumë) folësish të cilët i kushtojnë rëndësi më të vogël identitetit kombëtar sesa

<sup>13</sup> Ferguson e përcakton diglosinë si përfshirëse të “the coexistence of two varieties of the same language, [where] a High variety (H)...describes the standardized form of the language, and a Low variety (L)...refers to its vernacular form” (Lotfi 2007:40). Ambjentet me kontakte ndër-gjuhësore zakonisht zhvillojnë mekanizmat e *code-switching*, *code-alteration* dhe familjarizimit pasiv (dmth. ‘broad diglossia’ e Fasold-it; Lotfi 2007:41, 42, 47). Kur niveli i kompetencës në variantin (ose gjuhën) tjetër është i elaboruar, huazimet (dhe përzierja ose *meshing*) e elementeve mund të konvergjojnë, duke përfshirë strukturat fonologjike dhe morfosintaktike, sidomos në rastet e kontakteve intensive (shih Lotfi 2007:47), ku frekuenca e përdorimit mund të luajë rol, siç mund të jetë rasti i përdorimit të shpeshtë të konstrukteve jo-standarde, si p.sh. me paskajorjen gege (*dua me shkru(e)*) dhe mbikorrigjimet ortografike (p.sh. me <ë>; <gj> dhe <xh>; <q> dhe <ç>).

<sup>14</sup> Jørgensen, Karrebæk, Madsen dhe Møller (2011:29) shpjegojnë: “The notions of ‘varieties’, ‘sociolects’, ‘dialects’, ‘registers’, etc. may appear to be useful categories for linguists. They may indeed be strategic, ideological constructs for power holders, educators, and other gatekeepers (Jørgensen 2010, Heller 2007). However, what speakers actually use are linguistic features as semiotic resources, not languages, varieties, or lects (Jørgensen 2004, 2008, Møller 2009). It is problematic if sociolinguistics habitually treats these constructs as unquestioned facts. Blommaert & Backus (2011) have proposed the term ‘repertoires’ for the set of resources which the individual commands or ‘knows’...”

zhvillimit në grupe ndërsociale të përbashkëta të përvojave (virtuale), vlerave, interesave, dhe mënyrave të jetesës, si brenda ashtu dhe jashtë rrejtit (Leppänen et al. 2009:1080). Prioritetet e tyre janë më pak të orientuara drejt nocionit të kufijve të kombit-shtet (p.sh. shfaqjen e elementeve me tendenca nacionaliste) sesa lidhja me folësit të tjerë me të cilët ata ndajnë kuptime të përbashkëta në lidhje me nocionet e ngjashme të de-territorialitetit, komunitetet hibride, dhe praktikatat e komunikimit hibrid, shumë prej të cilave realizohen online (nëpërmes internetit). Në këtë sens ata nuk dëshirojnë të identifikohen me atë mentalitet të vjetëruar folësish duke jetuar në kohën post-moderne (p.sh. me ideologjinë e komb-shtetit, gjuhëve të ngurta standarde monocentrike, ideologjitë monoglotë, ndër të tjera), disa folës më parë do të donin të shiheshin me identitet (semiotik) më dinamik dhe fluid, që promovojnë farkëtim të përhershëm në kërkesat e ditës, çka i lejon ata që të ndihen, deri në një masë “pjestarë kontribues të normimit” (Leppänen et al 2009:1080), aq sa është e mundur në gjuhët statike standarde. Disa mund ta kritikojnë një qasje të tillë për mungesën e rregullave të ngurta dhe të fiksuara; megjithatë, në realitet, vendimi se cilat “rregulla” të ndiqen është në dorën e folësve më tepër se të një pjesë të vogël të akademikëve në një dhomë konferencash apo një kullë guri të izoluar, nga njerëzit që e përdorin gjuhën dhe posedojnë komunikimin, ndërlingual, dhe kompetencën simbolike (shih Kramersch 2010, 2012, 2014). Një qasje e tillë e sfumon preskriptivizmin, por jo normizimin, në të njëjtën kohë përfaqon diversitetin, në vend të fokusimit në paradigmat e zëvendësimit dhe përshtatshmërisë. Krijon hapësirën e nevojshme në mënyrë që të rivizatojë “horizontin përfundimtar të folësve që të përshtaten në një botë globale të rritjes së pasigurisë semiotike dhe luftrave simbolike për pushtet...si një praktikë adaptive që ndërvepron me ndërmjetësimet e saj kulturore dhe teknologjike,” që merr përgjegjësi për burimet e ndryshme decentralizuese të dijes dhe inkurajimit për zgjedhjet e përcaktuara në mënyrë reflektuese (Kramersch 2014:306, 307, 308).

## 5.0 Përfundim

Më pak se pesë dekada më parë, afërsisht në kohën kur GJLNj ishte miratuar nga autoritetet e gjuhës në kongresin e drejtshkrimit dhe kishte filluar që ti prezatohej masave, Janet Byron-i kishte parashikuar integrimin e formave gjuhësore alternative, të tilla si “alternativa[t] e përjashtuara” (të variantit gegë), në repertorin e standardit, duke e perforcuar nocionin se “një standard me kohë bëhet heterogen, duke iu larguar gjendjes fillestare” (1976:120). Përfshirjet e tilla, në fakt, mundësojmë “sado pak përpjekjen për të përmbushur kërkesat e komunikimit njerëzor” (Byron 1976:120). Edhe ajo pati parashikuar se elementet e tilla alternative “mund të përmbushin

funksi­one stilistike” (1976:120). Hapja e GjLNj-së mund të kontribojë në ndryshimin e paradig­mës, që orien­tohet drejt kultivimit të gjuhës: “Më e rëndësishmja, megjithatë, është që ky zhvillim ndoshta paralajmëron një ndryshim të planifikimit të gjuhës shqipe nga politike në një qasje të kultivimit gjuhësor” (Byron 1976:120). Kjo është disi në përputhje me elemente të ndryshme të policentrizmit Gramscian dhe heteroglo­sisë Bakhtiniane. Proce­se zhvillimore, që janë të krijuara nga dhe për folësit, si aktor aktiv evolues të gjuhës (Milroy 2001:551; shih gjithashtu Lass 1980:120), ku “origjina sociale e ndryshimeve gjuhësore” merret në konsideratë (Milroy 2001:553). Toleranca e vërtetë për një normë të tillë të një procesi eminent që hapet dhe për­qafon diversitetin e praktikimit gjuhësor të folësve do të lejojë atë që Haugen-i (1966) i referohet si “elaborimi i funksionit” (Milroy 2001:534), e që është i pranishëm në përzgjedhjet gjuhësore aktuale të shumë përdoruesve të gjuhës shqipe. Një relaksim i tillë i normës do të lejojë që folësit të kenë “liri imagjina­tive, e jo detyrim zbatues” (Blommaert 2013:10). Dalja në dritë e këtij realiteti thekson vetëdijen metalinguistike (Blommaert dhe Rampton 2011:8; shih gjithashtu Kram­sch 2014:301). Kjo na lejon ti shohim folësit si “vektorë të ndryshimit” (Blommaert 2013:13), - të atij ndryshimi që tashmë po ndodh praktikisht, dhe që përforcon nocionin se “sistemet ndryshojnë në mënyrë të pakthyeshme” (Blommaert 2013:13). Blommaert-i (2013) shpjegon se, rregullat e vjetra “zëvendësohen me një imazh të parazgjedhur të hapjes, dinamikave, multifiliare dhe zhvillimit jolinear, në mënyrë të paparashikuar - çka konsiderohej devijim dhe formë e parregullt, në këtë perspektivë kthehet në, formë normale” (13-14), ku “semiotizimi i hapësirës kthehet në hapësirë bashkëjetuese natyrale sociale, kulturore dhe politike” (16). Një qasje e tillë do të lejojë folësit të marrin pjesë në ekzaminim kritik të strategjive dhe politikave dominuese të kaluara dhe aktuale, si dhe në “propozimin e modeleve alternative” (Leeman 2005:35), përfshi këtë të propozuar këtu, “heqjen dorë nga mitet e degjenerimit prej varianteve të kohës moderne” (Leeman 2005:40). Siç shpjegon Sanchez-i, folësit “duhet ti vlerësojnë në mënyrë kritike normimet dominuese, të përcaktojnë se kush është duke u asimiluar dhe kush është duke u refuzuar nga procesi i krijimit të këtyre normave, dhe të analizojnë implikimet e procesit të standardizimit” (Sanchez 1981:99 qtd. në Leeman 2005:41), duke përfshirë edhe “eksplorimin e mekanizmve të nënshtrimit gjuhësor” (Leeman 2005:42) duke “shfrytëzuar fuqinë e tyre për tu pozicionuar në mënyra të ndryshme” (Leeman 2005:43). Për­qafimi i elementeve të prirjes metrolinguale hapë rrugën për një analizë kritike që të lëshojë rrënjë, dhe ndoshta edhe të lulëzojë në të ardhme.

**Bibliografia:**

1. AG, A. AND J. N. JØRGENSEN. 2012. Ideologies, norms, and practices in youth poly-languaging. *International Journal of Bilingualism* 17.4.525-539.
2. ANDROUTSOPOULOS, J. 2011. From variation to heteroglossia in the study of computer-mediated discourse. *Digital discourse: Language in the new media*, ed. by C. Thurlow and K. Mroczek, 227-298. New York, NY: Oxford University Press.
3. ARMSTRONG, NIGEL and IAN E MACKENZIE. 2013. *Standardization, ideology, and linguistics*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.
4. BLOMMAERT, JAN. 2014. Infrastructure of superdiversity: Conviviality and language in an Antwerp neighborhood. *European Journal of Cultural Studies*. 17.431-451.
5. BLOMMAERT, JAN. 2013. Critical language and literary studies, volume 18: Ethnography, superdiversity and linguistic languages: Chronicles of complexity. Clevedon, GBR: Channel View Publications.
6. BLOMMAERT, JAN (ED.). 2010. *Language, Power and Social Process: Language Ideological Debates*. Munchen: Walter de Gruyter.
7. BLOMMAERT, JAN AND BEN RAMPTON. 2011. Language and Superdiversity. *Language and Superdiversities* 13.2.1-21.
8. BLOMMAERT, JAN AND JEF VERSCHUEREN. 1998. Debating diversity: Analysing the rhetoric of tolerance. London: Routledge.
9. BLOMMAERT, JAN; SIRPA LEPPÄNEN; PÄIVI PAHTA; and TIINA RÄISÄNEN (EDS.). 2012. *Dangerous multilingualism: Northern perspectives on order, purity and normality*. Houndsmill, GBR: Palgrave Macmillan.
10. BYRON, JANET LEOTHA. 1973. Selection and evaluation of alternatives in Albanian language standardization. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania dissertation.
11. BYRON, JANET LEOTHA. 1976. *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.
12. CAMERON, DEBORAH. 1995. Verbal hygiene. New York: Routledge.
13. CANAGARAJAH, S. 2011. Codemeshing in academic writing: Identifying teachable strategies of translanguaging. *Modern Language Journal* 95.401-417.
14. CARLUCCI, ALESSANDRO. 2013. Gramsci and languages: Unification, Diversity, and Hegemony. Historical Materialism Book Series, Volume 59. Leiden, NLD: Brill.

15. CREESE, ANGELA and ADRIAN BLACKLEDGE. 2010. Translanguaging in the bilingual classroom: A pedagogy for learning and teaching. *The Modern Language Journal* 94.103-115.
16. DEL VALLE, JOSÉ. 2014. The politics of normativity and globalization: Which Spanish in the classroom? *Modern Language Journal* 98.358-372.
17. DENTITH, SIMON. 1994. Bakhtinian thought: An introductory reader. Florence, Ky: Routledge.
18. GARCIA, OFELIA. 2009. Bilingual education in the 21<sup>st</sup> century: A global perspective. Oxford: Wiley-Blackwell.
19. HAYWARD, S. 2001. Heteroglossia. In Charles E. Winquist and Victor E. Taylor (Eds.), *Encyclopedia of postmodernism*. Retrieved from <http://search.credreference.com.ezproxy.rit.edu/content/entry/routpostm/heteroglossia/0>
20. HELLER, MONICA. 2008. Language and the nation-state: Challenges to sociolinguistic theory and practice. *Journal of Sociolinguistics* 12.4.504-524.
21. IVES, PETER. 2004. Reading Gramsci: Language and Hegemony in Gramsci. London: Pluto Press.
22. JAWORSKI, ADAM. 2014. Metrolingual art: Multilingualism and heteroglossia. *International Journal of Bilingualism*. 18.2.134-158.
23. JØRGENSEN, J. NORMAN; MARTHA S. KARREBÆK; LIAN M. MADSEN; AND JANUS S. MØLLER. 2011. Polylinguaging in superdiversity. *Language and Superdiversities* 13.2.23-37.
24. KRAMSCH, CLAIRE. 2014. Teaching foreign languages in an era of globalization: Introduction. *Modern Language Journal* 98.1.296-311.
25. KRAMSCH, CLAIRE. 2012. Imposture: A late modern notion in poststructuralist SLA research. *Applied Linguistics* 33.5.483-502.
26. KRAMSCH, CLAIRE. 2010. Theorizing translingual/transcultural competence. In G. Levine & A. Phillips (Eds.) *Critical and intercultural theory and language pedagogy* (pp. 15-31). Boston: Heinle Cengage.
27. KRAMSCH, CLAIRE. 2006. From communicative competence to symbolic competence. *Modern Language Journal* 90.249-252.
28. KRAMSCH, CLAIRE AND ANNE WHITESIDE. 2008. Language ecology in multilingual settings: Towards a theory of symbolic competence. *Applied Linguistics* 29.4.645-671.
29. LEEMAN, JENNIFER. 2005. Engaging critical pedagogy: Spanish for native speakers. *Foreign Language Annals* 38.35-45.



30. LEMKE, J. 2002. Language development and identity: Multiple timescales in the social ecology of learning. *Language acquisition and language socialization*, ed. by C. Kramsch, 68-87. London: Continuum.
31. LEPPÄNEN, SIRPA; ANNE PITKÄNEN-HUHTA; ARJA PIIRAINEN-MARSH; TARJA NIKULA; and SAIJA PEUROEN. 2009. Young people's translocal new media uses: A multiperspective analysis of language choice and heteroglossia. *Journal of Computer-Mediated Communication* 14.1080-1107.
32. LI, WEI. 2011. Moment analysis and translanguaging space: Discursive construction of identities by multilingual Chinese youth in Britain. *Journal of Pragmatics*. 43.1222-1235.
33. LOFTI, SAYAHI. 2007. Diglossia and contact-induces language change. *International Journal of Multilingualism* 4.1.38-51.
34. MAKONI, S. and A. PENNYCOOK 2007. Disinventing and reconstituting languages. *Disinventing and reconstituting languages*, ed. by S. Makoni and A. Pennycook, 1-41. Clevedon: Multilingual Matters.
35. MARTÍNEZ, GLENN. 2003. Classroom based dialect awareness in heritage language instruction: A critical applied linguistic approach. *Heritage Language Journal* 1.1-14.
36. MILROY, JAMES. 2001. Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics* 5.4.530-555.
37. MILROY, JAMES and LESLEY MILROY. 2012. *Authority in language: Investigating Standard English* (4th ed.). Florence, Ky: Routledge.
38. MØLLER, J. S. 2008. Polylingual performance among Turkish-Danes in late-modern Copenhagen. *International Journal of Multilingualism* 5.3.217-236.
39. OTSUJI, EMI and ALASTAIR PENNYCOOK. 2010. Metrolingualism: Fixity, fluidity and language in flux. *International Journal of Multilingualism* 7.3.240-254.
40. PENNYCOOK, ALASTAIR. 1998. The right to language: Towards a situated ethics of language possibilities *Language Sciences* 20.1.73-87.
41. RICENTO, THOMAS. 2000. Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics* 4(2).196-213.
42. RICENTO, THOMAS. 2009. Theoretical perspectives in language policy: An overview. In Thomas Ricento (Ed.) *Introduction to Language Policy: Theory and Method* (pp. 3-9). Hoboken: Wiley-Blackwell.
43. SHOHAMY, E. 2006. *Language policy: Hidden agendas and new approaches*. New York: Routledge.

44. TJUPA, VALERIJ. 2009. Heterglossia. In P. P. Huhn & J. S. Wolf (Eds.), *Narratologia – Contributions to narrative theory: Handbook of narratology* (pp. 124-131). Berlin: Walter de Gruyter.
45. WATTS, RICHARD J. 2010. The ideology of dialect in Switzerland. In Jan Blommaert *Language, Power and Social Process: Language Ideological Debates*. Munchen: Walter de Gruyter. 67-103.
46. WILEY, TERRENCE G. 2014. Diversity, super-diversity, and monolingual language ideology in the United States: Tolerance or intolerance? *Review of Research in Education 2014* 38.1.1-32.
47. WOOLARD, KATHRYN A. & BAMBI B. SCHIEFFELIN. 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23.55-82.
48. WOOLARD, KATHRYN A., BAMBI B. SCHIEFFELIN, AND PAUL V. KROSKRITY (EDS.). 1998. *Language ideologies: Practice and theory*. New York: Oxford University Press.

**Mustafa IBRAHIMI**

## **IDEOLOGJIA DHE PURIZMI SI KONFLIKT GJUHËSOR GJATË PËRDORIMIT TË VARIETETEVE NË TERMINOLOGJINË KOMPJUTERIKE**

Termi ideologjia gjuhësore në kuptim më të gjerë ka të bëjë me një sistem të besimeve të përbashkëta për vlerat e varieteteve të ndryshme gjuhësore. Në këtë punim do shqyrtojmë konfliktin gjuhësor që paraqitet midis purizmit gjuhësor dhe ideologjisë gjuhësore gjatë përdorimit të termave të huaja kompjuterike në krahasim me termat e gjuhës shqipe. Shumë shtete të cilët manifestojnë identitetin e vet, i japin rëndësi çdo aspekti gjuhësor, duke përfshirë edhe format e reprezentimit grafik, shikuar nga aspekti sociolinguistik. Emërtimet kompjuterike shqipe shpesh marrin emrat nga gjuha angleze, me adaptime të ndryshme gjuhësore. Në këtë punim do të tregojmë tri mënyra, theks të veçantë do ti kushtojmë zëvendësimit të fjalëve të huaja me fjalë shqipe. Por sa kjo respektohet dhe nga cilat shtresa do të jetë tema kryesore e punimit tonë.

**Fjalë kyçe:** *konflikt gjuhësor, ideologjia gjuhësore, purizmi, terme kompjuterike, identiteti, terminologji*

### **Hyrje**

Baza e hulumtimit të këtij punimi do të jenë ideologjia gjuhësore, konflikti gjuhësor dhe purizmi në kuadër të diskutimeve rreth anglicizmave që përdoren në terminologjinë kompjuterike. Përdorimi i kësaj teknologjie e me këtë edhe emërtimet e saja, konsiderohet si kusht kryesor për funksionimin e një bashkësie shoqërore. Ndikimi kaq i madh, zanafillën e ka nga vitet 90 të shek.XX, kur teknologjia kompjuteristike mori hov, duke patur ndikim të veçantë në gjuhët evropiane (Fischer 2008:2), vlerësohet se për çdo vit krijohen rreth 1000 fjalë të reja nga fusha e teknologjisë informative (Munday 2005:61).

Ky ndikim i anglishtes nuk është karakteristik vetëm ndaj gjuhës shqipe, por anglishtja në masë të njëjtë ka ndikim edhe ndaj gjuhëve tjera botërore, në të cilat po ashtu analizat janë të përqendruara në fushën leksikore (Gorlach 2003:1). Ky ndikim

ka vazhduar edhe në fillim të shek.XXI, falë zhvillimit teknologjik që vazhdon edhe sot me një intensitet edhe më të madh, duke u vetëkuptuar se edhe pas dy dekadash numri i anglicizmave është në rritje edhe në Shqipëri, Kosovë dhe viset tjera shqipfolëse. Shkaku pse ndodh kështu, gjithsesi përgjigjen e gjejmë tek statusi i anglishtes sot si gjuhë globale dhe si lingua franca. Ndikimi i anglishtes, nuk është i vogël edhe në fushat tjera, porse në fushën e kompjuteristikës ai është më i madh (Hoffmann 2000:10). Domosdoshmëria për njohjen e këtij repertori leksikor vërtetohet edhe në faktin se me këtë terminologji përveç folësve të rritur, shërbehen edhe shumë fëmijë, (Robinson, 2009:3), madje në raste të caktuara edhe fëmijë nga mosha tetëmbëdhjetë muajsh (Healy 1998:20). Mirëpo, emërtimet kompjuterike në të shumtën e rasteve nuk janë të rregulluara mirë, prej këtu ekzistojnë edhe shumë dilema, pasiguri dhe dyshime (Jurko 2005:235), që e bën kjo fushë të jetë interesante për hulumtim, jo vetëm nga aspekti leksikologjik në kuadër të kontakteve gjuhësore, por edhe në aspektin e konflikteve gjuhësore si dhe manifestimeve të ndryshme të ideologjive gjuhësore.

## 1. Rreth termit anglicizma

**Anglicizmat** që përdoren në terminologjinë kompjuterike shumë rrallë konsiderohen si ndërkombëtare, sepse anglishtja shërben si burim i veçantë nga dalin të gjitha emërtimet kompjuterike. Anglicizmat përbëjnë shtresën më të re të huazimeve të shqipes dhe si të tilla nuk kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve nga fusha e etimologjisë. Në “pjesën hyrëse” prej më se 100 faqesh të veprës së tij në 7 vëllime “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, Eqrem Çabej nuk përmend asnjë fjalë me burim nga anglishtja. Në gjuhësinë shqiptare anglicizmat kanë filluar të trajtohen si të tilla në vitet ’80 të shekullit të shkuar. (Lafe 2011:294). Studiuesi Vesel Nuhiu, në përpjekjen për të përcaktuar anglicizmat e kodifikuara të përfshirë në “Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (1976) dhe në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”(1980) ka nxjerr se të dy këta fjalorë së bashku përmbajnë 160 anglicizma, ndërsa sipas vëzhgimeve të tij në gjuhën e folur e të shkruar përdoren rreth 850 anglicizma. (Nuhiu 1988:88,129). Sipas studiuesit Emil Lafe, nga një listë prej 600 anglicizmash që janë të njohur në një masë pak a shumë të gjerë njerëzish në Shqipëri dhe në Kosovë, do shohim se anglicizmat që lidhen me fushën kompjuterike, informatike dhe internetit zënë vendin e dytë me 77 terma, menjëherë pas fushës së sportit me 79 terma. (Lafe 2011:296-297).

## 2. Purizmi

Kur bëhet fjalë për manifestimet e ndryshme të ideologjive gjuhësore, më e

rëndësishme është ajo që lidhet me intervenimin e drejtpërdrejtë gjuhësor në kuadër të planifikimit gjuhësor, purizmit gjuhësor dhe standardizimit. Purizmi gjuhësor njësoj është i lidhur si me shprehjet e gjuhës amtare ashtu edhe me shprehjet e huazuara që nuk janë të pranuar me normat e standardit, por në një apo në mënyrë tjetër kanë gjetur përdorim të gjerë në një gjuhë.

## 2.1. Purizmi në shtetet e ndryshme të botës dhe tek ne

Purizmi ka pasur një truall të përshtatshëm dhe ka lulëzuar sidomos në regjimet diktatoriale, të cilët me këtë kanë dashur të krijojnë një sensibilitet për gjuhën e popullit të vet. Kështu Pol Poti, gjatë sundimit të tij diktatorial në Kamboxhia, kishte futur si një nen kushtetues *“dënimin” me vuajtje fizike për atë që përdorte fjalë franceze gjatë shkrimit në gjuhën kmere*. Diktatori spanjoll, gjenerali Franko e shpalli jolegale komunikimin në çfarëdo gjuhe tjetër përveç katalonishtes spanjolle, duke ndaluar gjuhët baske, katalonase dhe gale. (Trask 2005:154). Edhe gjatë diktaturës në Shqipëri ka pasur një politikë puriste. Interesante është edhe regjimi kinez i cili ndalon të gjitha fjalët e huaja.

Te disa popuj purizmi është më i theksuar, se disa të tjerë. Për pastërtinë e gjuhës nga elementi i huaj si kampionë mund të shquhet Franca, e cila me ligjin numër 94-665 detyrohen të gjithë që lajmërimet publike, reklamat e me këtë edhe fjalët kompjuterike të jenë në gjuhën frënge. Ky ligj është i njohur edhe si ligji i Toubonit. Irlandezët për çdo shprehje angleze krijojnë neologjizëm nga gjuha e vet. Purizmi në gjuhën gjermane është trajtuar në traktate e botime të veçanta dhe vazhdon të trajtohet edhe sot. Te popujt e Ballkanit, purizmi është më i theksuar te kroatët, i cili gjerësisht mbështetet edhe nga qeveria, duke krijuar statusin e religjionit shtetëror. Edhe në gjuhën shqipe purizmi vazhdon të konceptohet si një shekull më parë – pothuajse si në epokën e romantizmit. Megjithatë ekzistojnë shumë gjuhëtarë që janë vënë në anën e purizmit, duke filluar me rilindësit Naim e Sami Frashëri, A.Xhuvani, E.Çabej, S.Pepa etj. Dhe kundërshtarët e purizmit që nuk janë të paktë, si: Fan Noli, J.Nokli, Sh.Demiraj, K.Jorgaçi, A.Vebiu, të cilët mbajnë një tjetër qëndrim të përkundërt ndaj purizmit. (Murati 2011:284-285).

## 2.2. Anglicizmat në raport me purizmin si formë të ideologjisë gjuhësore

Procesi i standardizimit dhe përpjekjet puriste janë ngushtë të lidhura dhe janë në kompetenca thelbësore të kulturës gjuhësore. Në purizmin gjuhësor mund të shikojmë edhe si një formë e ideologjisë gjuhësore, në kuadër të cilës vjen deri te izolimi i gjuhës ndaj huazimeve nga jashtë. Në kuadër të zhvillimit të purizmit

gjuhësor, ky izolim është selektues, sepse në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për mënjanimin e elementeve të atyre gjuhë të huaja që paraqesin rrezik në kontekst të gjerë sociolinguistik (Weinstein 1989). Në situata të tilla lind konflikti gjuhësor, që në të shumtën e rasteve manifestohet në vetëdijen e individit në raport me qëndrimet ose stereotipat ndaj gjuhëve të caktuara ose varieteteve gjuhësore, gjegjësisht folësve të tyre.

Edhe ndikimi i anglishtes ndaj gjuhëve tjera, përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe sjell deri te reaksionet puriste me intensitete të ndryshme. Interpretimet e anglicizmave në kuadër të gjuhës shqipe, jo përherë gjejmë qasje puriste tradicionale, duke ditur se në proceset e përgjithshme globale, anglishtja luan rol kryesor, andaj edhe shumë fjalë nuk mund të përkthehen. Pa marrë parasysh se në periudha të caktuara të zhvillimit historik të gjuhës shqipe ka pasur tendenca purizmi, kryesisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare gjatë shek. XIX, në kohën e krijimit të identiteteve, si dhe gjatë diktaturës në Shqipëri kur ka pasur një politikë puriste. Kjo veprimtari puriste me fjalët e huazuara nga turqishtja gjatë Rilindjes zhvillohej si shenjë e urrejtjes ndaj sundimit të gjatë osman, kurse gjatë diktaturës si shenjë ndaj urrejtjes ideologjike ndaj imperializmit anglo-amerikan. Falë albanologëve të ditur të kohës, siç ishte Norbert Jokli, i këshillonte që ta ndalin këtë veprimtari jodobiprurëse për vetë ata, duke theksuar *“Mos shani gjuhën duke kujtuar se po e pastroni. Puna nuk është aq në fjalët e huaja sesa në shpirtin e gjuhës, të cilin dubet ta ruani nga çdo bastardim”*. (Murati 2011:274).

### **3. Format e konfliktit gjuhësor midis anglishtes dhe shqipes**

#### **3.1. Format e konfliktit gjuhësor në fushën e leksikut**

Format e konfliktit gjuhësor midis anglishtes dhe shqipes, paraqiten më së shumti në fushën e leksikut. Analiza serioze të këtij konflikti gjuhësor daton nga gjysma e dytë e shekullit XX. Ky ndikim i anglishtes nuk është karakteristik vetëm ndaj gjuhës shqipe, por anglishtja në masë të njëjtë ka ndikim edhe ndaj gjuhëve tjera botërore, në të cilat po ashtu analizat janë përqendruar në fushën leksikore (Gurlach 2003:1). Ky ndikim ka vazhduar edhe në fillim të shek.XXI, falë zhvillimit teknologjik që vazhdon edhe sot me një intensitet të madh.

Teoria e konfliktit gjuhësor lindi me zhvillimin e gjuhësisë së kontaktit në pjesën e dytë të shek.XX, zakonisht midis folësit dhe bashkësisë gjuhësore, e jo midis vetë gjuhëve ose varieteteve të tyre gjuhësore. Konfliktet midis gjuhëve lindin edhe për shkak të kuptimit dhe vlerës që folësi ia përshkruan një forme gjuhësore (Bugarski 1990). Sipas parimeve të gjuhësisë së kontaktit, çdo kontakt gjuhësor përfshinë edhe konfliktin gjuhësor (Strubell 2001:48; Nelde 1991:59; Salverda 2003:130), sidomos në

raportin gjuha e shumicës në raport me gjuhën e pakicës në një shtet shumëkulturore dhe shumëgjuhësor. Por një situatë të tillë nuk kemi midis anglishtes dhe shqipes, sepse shqipja nuk është pakicë në një shtet anglishtfolës, prandaj shtohet pyetja a kemi konflikt gjuhësor, pa kontakt gjuhësor? A bëhet këtu fjalë për konflikt gjuhësor serioz, apo konflikti gjuhësor që është paraqitur në një kohët të caktuar, i pranishëm vetëm si një mundësi. Prej këtu ky konflikt gjuhësor përmban dimension shoqëror, sepse folësi nuk përdor qëndrime apo stereotipa ndaj një gjuhe të caktuar apo varietetit gjuhësor, apo ndaj folësve të tyre (McRae 1989).

### 3.2. Purizmi si tentativa e spastrimit rrënjësor të gjuhës

Purizmi në kuptimin e sotëm filologjik është pastrimi i gjuhës nga fjalët e huaja me tendencë për të larguar çdo huazim nga gjuhët e huaja. Purizmi nuk ka qenë kurë i theksuar te anglishtfolësit, por folësit e kroatishtes, frëngjishtes, gjermanishtes, islandishtes, turqishtes, finlandishtes, baskishtes, shqipes etj, kanë qenë më kërkuar në veprimtarinë e tyre gjuhë pastruese nga elementet e huaja. Kështu francezët edhe termin e anglishtes *computer* “llogaritës” e quajnë *ordinateur*, termin *software* “pajisje programore” – *logiciel*, etj. (Trask 2005:154). Si argument i kësaj, shpeshherë si ekuivalent i fjalës së huaj, në gjuhën shqipe, por edhe në shumë gjuhë tjera paraqiten më tepër fjalë, p.sh.: (*hardware* - “pjesë metalike / pjesë elektronike”, *software* (*softuer*) - “program / mjete programuese / program kompjuterik”) (Hysa 1998). Mungesa e emërtimeve të tilla ndodh për shkak se janë joekonomik dhe se është shumë vështirë të formohen fjalë të reja, me të cilat termi do të mund të shpjegohej në mënyrë më precize. Megjithatë, në të shumtën e rasteve gjatë përkthimit të një huazimi, paraqitet një rezistencë e fortë. Një argument tjetër gjatë përpjekjes që një huazim të zëvendësohet me një fjalë burimore është dëshira për vënien e shprehjeve burimore si imponim i autoritetit gjuhësor.

Koncepti i ideologjisë gjuhësore, në kuptim më të gjerë i referohet një sistemi të besimit të përbashkët të vlerave të varieteteve të ndryshme gjuhësore. Në përputhje me purizmin gjuhësor, si një formë e ideologjisë gjuhësore, e cila në mënyrë parësore manifestohet me mospranimin e elementeve të huaja (në rastin tonë anglicizmave), hulumtimi duhet të tregojë raportin konkret midis përdorimit të anglicizmave dhe shprehjeve burimore të shqipes, në kuadër të terminologjisë kompjuterike. Një vend të rëndësishëm do ti jepet edhe theksit, si një formë e rëndësishme të ideologjisë gjuhësore. Në vendet të cilët e theksojnë identitetin e tyre, kujdesen për çdo aspekt, duke përfshirë edhe “format e përfaqësimit grafik”(Woolard 1998:23). Deri te kjo vjen, sepse sipas kontekstit sociolinguistik, si normë krijuese nuk merren vetëm format

drejtshkrimore, por edhe simbolet të cilët me veti mbajnë kuptime historike, kulturore dhe politike. Në këtë mënyrë drejtshqiptimi është ngushtë i lidhur me konceptin e vlerave që i jepen një shenje të caktuar gjuhësore (Schieffelin i Charlier Doucet 1998: 285), e me këtë edhe konceptit të ideologjisë gjuhësore. Shkallët e ndryshme e adaptimit të anglicizmave mund të zbulojnë edhe ekzistimin dhe natyrën e kësaj forme të ideologjisë gjuhësore.

Emërtimet shqipe të termeve kompjuterike shpesh krijohen me marrjen e termave angleze në shkallë të ndryshme të adaptimit. Zakonisht gjatë huazimeve leksikore zhvillohet procesi i ndërimin të huazimeve dhe zëvendësimi me shprehje burimore. Numri më i madh i huazimeve (p.sh. *firewall, web, multitasking*) ose në kufirin e huazimit (*bakerizëm, disketa etj.*). Gjithashtu duhet theksuar se deri sa më parë emërtimet kompjuterike adaptoheshin në aspektin drejtshkrimor (*harduer, softuer*) ose në aspektin morfologjik (*aplikim, adresoj*), sot më së tepërmi gjejmë emërtime të paadaptuara angleze (*shareware, download, freeware, firewall, desktop*), në disa raste edhe me përdorimin e gabuar të fjalëve të huaja.

Megjithatë, rezistenca ndaj huazimeve nuk ka ndalur dhe ka qenë element përbërës i zhvillimit të gjuhës shqipe. Si rezultat i kësaj, në këtë veprimtari shquhet emri i Aleksandër Xhuvani, me veprën e tij *“Për pastërtinë e gjuhës shqipe”*. (Tiranë, 1956). Në vitin 1979 u formua Komisioni i përbërshëm për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe. Në revistën “Gjuha jonë” u hap rubrika e re *“Fjalë shqipe në vend të fjalës së huaj”*. Në vitin 1998, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Tiranës, botoi fjalorin *“Për pastërtinë e gjuhës shqipe”*. Në vitin 1999, ky fjalor është botuar edhe në Prishtinë *Fjalë shqipe në vend të fjalës së huaj*. Të gjithë këto përpjekje u botuan për të dhënë një nxitje të re punës konkrete në fushën e pastërtisë së gjuhës, për zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe.

Për të vërtetuar sa më mirë ndikimin e gjuhës angleze në përdorimin e emërtimeve kompjuterike shqipe, dhe në bazë të rezultateve duhet të jemi në gjendje të nxjerrim përfundime për konfliktin gjuhësor dhe ideologjinë gjuhësore. Hulumtimet, midis tjerash duhet të na sigurojë informacione për intensitetin dhe formën e adaptimeve të tilla, në bazë të të cilave mund të sjellim përfundime për ekzistimin eventual dhe natyrën e ideologjisë së dhënë gjuhësore në lidhje me emërtimet kompjuterike në gjuhën shqipe.

#### *Shkalla e përshtatjes së anglicizmave*

Shumë shtete të cilët manifestojnë identitetin e vet, i japin rëndësi çdo aspekti gjuhësor, duke përfshirë edhe format e reprezentimit grafik, shikuar nga aspekti sociolinguistik. Emërtimet kompjuterike shqipe shpesh marrin emrat nga gjuha



angleze, me adaptime të ndryshme gjuhësore. Në ato punime, theks të veçantë duhet ti kushtojmë zëvendësimit të fjalëve të huaja me fjalë shqipe. Por sa kjo respektohet dhe nga cilat shtresa duhet të jetë tema kryesore e punimeve tona. Ne mund të vijmë në të dhëna se:

- 1) Huazimet nuk shkruhen sipas grafisë origjinale, por sipas grafisë së shqipes.  
P. sh.: *kopi pejs (copy past), sërç (search)*
- 2) Një numër të anglicizmash të rinj po shkruhen si në anglisht. P.sh. : *copyright, e-mail, zoom*
- 3) Në disa raste përdoret herë forma shqipe sipas shqiptimit, herë forma e anglishtes. P.sh. *onlajn/online, flesh/flash,*
- 4) Në një numër të vogël rastesh fjala shkruhet si në anglishte dhe shqiptohet si të ishte një fjalë e shqipes. P.sh.: *modem, monitor,*

### **Përfundim**

Nga përkufizimet e gjuhëtarëve, por edhe nga rezultate e fituara mund të përfundojmë se prishja e gjuhës nuk vjen nga ndikimi i gjuhëve të huaja, por nga njohja e keqe të tyre dhe përdorimi i gabuar i tyre. Dihet se nuk ka gjuhë në botë pa huazime, por çdo gjuhë duhet të përpiqet ta ruaje brumin e tyre, duke mos shmangur çdo gjë që vjen nga jashtë, por as duke pranuar në mënyrë jokritike çdo risi.

Në botën globale, fjalët e huaja janë të nevojshme për çdo kulturë, por ato duhet të përdoren me formën dhe kuptimin e duhur, aty ku ka vend, dhe në masën e nevojshme.

Në kohën e globalizmit apo pushtetit të madh kompjuterik, komunikimi shqip nuk mund të jetë më vetëm brenda llojit, por prapë kjo nuk do të thotë se duhet t'i përbuzim dhe përjashtojmë fjalët tona.

### **Bibliografia:**

1. BUGARSKI, Ranko (1990). The social basis of language conflict and language attitudes. *Plurilingua*
2. CAKA, NEBI. (2005). *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë. Në Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë* (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004). Tiranë.
3. COULMAS, Florian, ur. *A Language Policy for the European Community:*

- Prospects and Quandries*. Berlin – New York: Mouton de Gruyter, 59–73.
4. FISCHER, Roswitha (2008). Introduction. Studying anglicisms. Fischer, Roswitha, Hanna Puaczewska, ur. *Anglicisms in Europe: Linguistic Diversity in a Global Context*. Newcastleupon Tyne: Cambridge Scholars Publishing, 1–15.
  5. GORLACH, Manfred (2003). *English Words Abroad*. Amsterdam – Philadelphia: John Benjamins Publishing.
  6. HEALY, Jane M. (1998). *Failure to Connect: How Computers Affect Our Children's Minds –For Better and Worse*. New York: Simon & Schuster.
  7. HOFFMANN, Charlotte (2000). The spread of English and the growth of multilingualism with English in Europe. Cenoz, Jasone, Ulrike Jessner, ur. *English in Europe: The Acquisition of a Third Language*. Clevedon – New York – North York – Artarmon: Multilingual Matters, 1–21.
  8. HYSA, Ramazan (1998). Fjalor anglisht-shqip. Tiranë.
  9. JURKO, Nela (2005). Integracija engleskoga ra\_unalnog nazivlja u talijanskom i hrvatskom jeziku. Stolac, Diana, Nada Ivaneti\_, Boris Pritchard, ur. *Jeziik u društvenoj interakciji. Zbornik radova sa savjetovanja održanoga 16. i 17. svibnja u Opatiji*. Zagreb – Rijeka: HDPL, 227–236.
  10. LAFE, Emil. (2011). *Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme*. (Konferencë shkencore “Java e Albanologjisë”, Prishtinë, 25-29 tetor 2010). Botuar në Albanologji, nr.1/2010, vëll.II. Prishtinë.
  11. McRAE, Kenneth D. (1989). Linguistic conflict: Some theoretical reflections. *Plurilingua (Urban Language Conflict)* 7: 1–20.
  12. MUNDAY, Jeremy (2005). E-mail, Emilio or Mensaje de Correo Electrynico? The Spanish language fight for purity in the new technologies. Anderman, Gunilla, Margaret Rogers, ur. *In and Out of English: For Better, For Worse?* Clevedon – Buffalo – Toronto: Multilingual Matters, 57–70.
  13. MURATI, Qemal. (2011). *Për të ashtuqajturat fjalë të huaja dhe purizmin*. (Konferencë shkencore “Java e Albanologjisë”, Prishtinë, 25-29 tetor 2010). Botuar në Albanologji, nr.1/2010, vëll.II. Prishtinë.
  14. NELDE, Peter Hans (1991). Language conflicts in multilingual Europe – Prospects for 1993.
  15. NUHIU, Vesel. (1988). *Reth disa termave me prejardhje nga anglishtja*. Në Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi. ((Konferencë shkencore, Prishtinë, 28 dhe 29 janar 1988). Prishtinë.
  16. ROBINSON, Helen Mele (2009). *Emergent Computer Literacy: A Developmental Perspective*. London – New York: Routledge.

17. SALVERDA, Reinier (2003). Conflict linguistics and the case of multilingualism in London. *Plurilingua (Methodology of Conflict Linguistics)* 24: 129–144.
18. SCHIEFFELIN, Bambi B., Rachele Charlier Doucet (1998). The “real” Haitian Creole: Ideology, metalinguistics, and orthographic choice.
19. STRUBELL, Miquel (2001). Minorities and European language policies. *Plurilingua (Minorities and Language Policy)* 22: 45–58.
20. TRASK, Robert Lawrence. (2005). *Temeljni lingvistički pojmovi*. Školska knjiga. Zagreb.
21. WEINSTEIN, Brian (1989). Francophonie: Purism at the international level.
22. WOOLARD, Kathryn A. (1998). Language ideology as a field of inquiry.



**Haki HYSENAJ**

## **NDIKIMI I IDEOLOGJISË NË VARIETETET E SHQIPTUARA TË SHQIPES**

### **Abstrakt**

Bindjet, opinionet dhe ideologjitë e ndryshme janë të lidhura ngushtë edhe me gjuhët. Ato kanë ndikim jo vetëm në procesin e standardizimit, por edhe në sjelljen gjuhësore të folësve të tyre. Ky ndikim del edhe në rastin e shqipes.

Punimi nuk merret çështjen e parë, d.m.th. me politikën e standardizimit dhe të planifikimit gjuhësor të shqipes. Synon të pasqyrojmë çështjen e dytë, d.m.th. ndikimin e varietetit të folur të gjuhës së elitës politike mbi varietetet e shqiptuara të shqipes standarde dhe sjelljen gjuhësore të folësve të standardit në ditët e sotme.

Matjet vërtetojnë se disa ndryshore të përdorura nga elita politike e kohës i kanë rezistuar pritshmërisë së mënjanimin nga gjuha e folur standarde. Kjo për faktin se kanë pasur prestigj ideologjik, pasi që përdoren nga qendra të caktuara të elitës politike e të cilat ishin me prejardhje rajonale nga Jugu i Shqipërisë.

Ky punim vërteton, gjithashtu, se trajtat e tilla me kohë janë shtrirë edhe te folësit e tjerë, të cilët mund të mos e kenë pasur prejardhjen nga Jugu, por mund t'i kenë kapur këto forma si shqiptim prestigjioz, gjithnjë duke imituar varietetin e gjuhës së folur të elitës politike.

**Fjalë kyçe:** Ideologji, elitë politike, gjuhë standarde, gjuhë dialektore, varietete shqiptimore, tinguj, nyjëtim dialektor, nyjëtim prestigjioz.

### **Hyrje**

Ideologjia përkufizohet si sistem idesh e besimesh të cilat manifestohen në sjelljen e individit dhe të bashkësisë shoqërore. Identifikohet më shumë si një veprim publik që shërben për realizim të objektivave të një grupi të caktuar. Nisur nga ky

përkufizim del se ideologjia ka ndikim në të gjitha realitetet shoqërore. Në këtë mes edhe gjuha është e ndikuar prej saj. Kjo ndodh për faktin se gjuha është mjet i pashmangshëm, madje shumë i fuqishëm për grupet e caktuara, që synojnë përmbushjen e objektivave të veta, në radhë të parë politike dhe ideologjike. Kështu, Van Dijk (1998) dhe Wodak e Weiss (2004) theksojnë se gjuha është e lidhur ngushtë me ideologjitë dhe se varësisht nga shkalla e konsolidimit të tyre, dhe nga faktorë të tjerë, ajo bëhet pjesë e leksikut, e realizimit fonetik e më pak edhe e strukturës gramatikore të individëve, folës të një gjuhe të caktuar. Ky konstatim përlligj tezën tonë se gjuha e folur e elitës politike të Shqipërisë së pasluftës pati ndikim në varietetet e shqiptuara të shqipes standarde, posaçërisht në fushë të fonetikës. Kjo dëshmohet me matjet tona që do të prezantohen në kuadër të këtij punimi.

Në anën tjetër, Wolard dhe Schieffelin (1994) shprehen se *“ideologjitë gjuhësore veprojnë dhe miratojnë lidhjet e gjuhës me identitetin personal dhe grupor...”*. Kështu, gjuha e elitës politike në Shqipëri, e cila përhapte një ideologji të re, gjithsesi se identifikonte grupin elitare që kishte ndikim në politikën dhe planifikimin gjuhësor të shqipes. Këtij ndikimi nuk i shpëtoi as realizimi konkret në variantin e folur.

Megjithatë, ideologjia gjuhësore dhe ideologjia në gjuhë janë dy koncepte të ndryshme. Ndonëse është vështirë të bëhet një prerje strikte midis kufijve të tyre, në këtë punim kemi hulumtuar vetëm elementet ideologjike në gjuhë, të cilat mendojmë se u bënë pjesë e saj nga prestigji që kishin. Megjithatë, këtu nuk jemi marrë me përcaktimin statusit të këtyre elementeve dhe as me paragjykimin nëse ato sot paraqesin grup “gabimesh ortoepike” ose jo. Vetëm kemi bërë përshkrimin dhe kemi përcaktuar dëndurinë e përdorimit e tyre.

Rezultatet e këtij punimi mbështesin mendimin e Shilery Heath (1977), pas të cilit del se ideologjia i kontribuon shprehjes dhe theksimit të një grupi të caktuar. Kështu, në këtë punim pasqyrohet pikërisht theksimi i elementeve të caktuara të gjuhës së folur të elitës politike dhe ndikimi i tyre mbi varietetet e folura të shqipes standarde.

Elita politike e Shqipërisë vinte gati e tëra nga Jugu. Gjatë dhe pas procesit të standardizimit të gjuhës, në komunikimin gojor ajo përdori varietetin shqiptimor të toskërishtes, të përzier edhe me elemente e dukuri dialektore të së folmes së vet.

Siç do të shihet në këtë punim, varieteti shqiptimor i liderëve politikë të Shqipërisë, kryesisht për shkak të prestigjit që kishte, pati ndikim në varietetet e shqiptuara të shqipes edhe pas standardizimit. Ky ndikim vërehet edhe sot në gjuhën e masmedieve elektronike shqiptare.

Situata del më ndryshe jashtë kufijve të Shqipërisë. Ndikimi i varietetit të gjuhës së folur i elitës politike që i vogël te pjesëtarët e tjerë të bashkësisë, të cilët jetonin pa kontakte mes vete, ndërkohë që standardin e mësonin në distancë.

Rasti i shqipes së folur në Shqipëri pasqyron ndikimin e gjuhës së elitës. Ideologjia komuniste përhapej bashkë me gjuhën e stilit e kësaj elite. Kjo ideologji pranohej edhe nga pjesëtarë të tjerë të bashkësisë, pavarësisht përkatësisë së tyre rajonale dhe dialektore.

Si rrjedhojë e këtij procesi varieteti i folur i shqipes standarde edhe sot del i panormuar tërësisht dhe reflekton segmente të caktuara të gjuhës së ish-liderit dhe elitës rreth tij.

Punimi ynë provon të vërtetojë se sjellja ideologjike dhe gjuhësore e elitës politike la gjurmë në varietetet e shqiptuara të shqipes, pra edhe në varietetin standard.

### **Sfondi**

Pas fitores mbi fashizmin në shtetin shqiptar toskërishtja letrare u bë gjuhë me prestigj. Ajo u përcaktua si gjuha zyrtare e arsimit, shkencës, shtypit, indoktrinimit ideologjik dhe pjesës më të madhe të letërsisë artistike (Byron, 2012:75).

Elita politike e kohës përdorte këtë varietet të shoqëruar edhe me elemente të karakterit më të ngushtë dialektor. Këto elemente identifikonin përkatësinë rajonale të elitës. Përdorimi i tyre sikur ua fuqizoi prestigjin, prandaj edhe u pranuan në mënyrë të heshtur si trajta “të normuara” nga folësit e standardit në Shqipëri.

Ideologjia po pranohej bashkë me varietetin gjuhësor të protagonistëve të saj. Kjo situatë vazhdoi gjatë tërë periudhës së standardizimit të gjuhës dhe pas saj.

Kjo sjellje gjuhësore nuk ka dyshim së është derivat i përkimit me prejardhjen regionale të elitës politike, prandaj varieteti i saj i folur u pranua si të ishte varieteti i standardizuar. “... *variantet e folura jugore, duke qenë më afër standardit, por edhe duke pasur shtytje politike dhe kulturore, janë imponuar si variante me prestigj për të gjithë arealin e shqipes*” (Munishi, 2013:159).

Në këto rrethana standardi i folur përjetoi zhvillim jo krejt të njëjtë me standardin e shkruar. Derisa i pari u përqaftua nga të gjithë shqiptarët i dyti përjetoi zhvillime të ndryshme. Në Shqipërinë jugore dhe në vernakularin e Tiranës mbisundoi varieteti shqiptimor i toskërishtes, i përzier me elemente tipike të gjuhës së folur të elitës politike. Në veri të Shqipërisë varietetet e shqiptuara nuk arritën të njëjtësoheshin me këtë model përfaqësues. Arsytet janë të ndryshme.

Nga ana tjetër, në trevat shqipfolëse jashtë kufijve të Shqipërisë, përpjekja për realizimin e standardit të folur u bë në kundërshtim me traditën e pranimit të standardit, u bë “*preferencë*” vetëm e grupeve që idealizonin Shqipërinë komuniste” (Paçarizi, 2011:98).

Njëjtësimi me ideologjinë dhe me varietetin e gjuhës së folur të liderit shpjegohet më së miri me sjelljen ideologjike e gjuhësore të Ramiz Alisë, njeriut që

ishte një ndër figurat kyçe të sistemit e që kishte prejardhje regjionale nga Veriu.

Wiliam Labovi thekson se sjellja gjuhësore ndryshon me shpejtësi, ndërsa ndryshon pozicioni social i folësit (cituar sipas Byron, 2012:130). Alia del shumë besnik në zënien dhe riprodhimin e varietetit të folur të liderit Hoxha. Imitimi që bën Alia konkretizohet posaçërisht me përzgjedhjen dhe përdorimin e ndryshoreve **ë/e**, **ll/l** dhe **r/rr**.

Haugen-i qysh në vitet e 70-ta kishte konstatuar se përzgjedhja e një varianti për gjuhë të përbashkët është favorizim i një grupi njerëzish. *“Të përzgjedhësh një variant si normë, do të thotë të favorizosh një grup njerëzish të cilët e flasin këtë variant të gjuhës. Kjo u jep atyre prestigjin si mbartës të normës dhe një përparësi në garën për pushtet dhe pozitë”* (cituar sipas Byron, 2012:77). Toskërishtja ishte gjuhë native e elitës politike.

Ndërsa, Ismajli konteston përzgjedhjen e cilitdo dialekt a varietet për normë të standardit kombëtar, pasi që, siç thotë ai *“përzgjedhja mund të mos pranohet nga një shumicë e madhe dhe, përkundër faktit se mund t’i shërbejë fare mirë grupit që e zgjedh, ai nuk do të arrijë të bëhet standard kombëtar”* (Ismajli, 1981:312).

Përzgjedhja e një dialekti për bazë të gjuhës standarde më pas u bë edhe gjenerator i lëkundjes së rendit ndikues gjuhësor dhe në raste të caktuara edhe promotor i procesit të *“dialektizmi”* të varietetit standard (shih: Hysenaj, 2012/1:73-75). Kjo dëshmohet me ndryshoret dialektore të gjuhës së elitës, të cilat u bënë pjesë e diskursit të figurave të shquara politike e kulturore të Shqipërisë.

Më 1972 disa trajta të toskërishtes mbetën jashtë normës. Megjithatë, elita politike nuk i mënjanoi nga diskursi publik dhe kështu ato filluan të inkuadroheshin si elementë gjuhësorë ideologjikë në gjuhë. Në këtë situatë trajtat me zanoren **ë** të theksuar para hundoreve, ato me tingullin **i** në vend të **y**-së, me **neutralizim** në vend të të zëshmeve në fund të fjalës dhe me elemente të tjera nga *“gjuha e elitës”* vazhduan të ruanin prestigjin që kishin edhe në gjuhën standarde dhe për më shumë filluan të bëhen *“pronë e të gjithëve”*.

Kështu, dialekti me prestigj i përdorur nga elita politike, përkatësisht varieteti i folur i tij, doli se me kohë kishte fituar prestigjin mbi varietetin e standardizuar përfundimisht në vitin 1972.

Në këtë mënyrë ideologjia e re, që shpërfaqej edhe përmes sjelljes gjuhësore të elitës, krijoi parakushte të volitshme për funksionimin e varieteteve të ndryshme shqiptimore të shqipes.

Kjo gjendje vërtetohet nga matjet që ua kemi bërë disa fjalimeve politike të Enver Hoxhës dhe të Ramiz Alisë. Matjet tregojnë se varieteti i shqiptuar nga Hoxha, Alia dhe pjesa tjetër e elitës politike në Shqipëri mori primatin e të qenit model shqiptimi edhe për të tjerët.

Për të vërtetuar këtë hipotezë kemi analizuar të folurit publik edhe të disa



politikanëve e intelektualëve të tjerë, si të Fatos Nanos, Genc Pollos, pastaj të Ismail Kadaresë, Blendi Fevziut e Adi Krastës. Krahasimi tregon se në varietetin e tyre standard kanë zënë vend trajta të varietetit të “*gjuhës së elitës politike*”.

### **Subjektet dhe korpusi**

Për realizimin e këtij hulumtimi kemi përzgjedhur 7 subjekte folëse. Gjuha e Enver Hoxhës është hulumtuar në 10 fjalime të tija publike dhe në një bashkëbisedim me banorët e Bajzëz. Kohëzgjatja e përgjithshme e materialit të hulumtuar është 1:08:46 sekonda. Ndërsa, gjuha e Ramiz Alisë është analizuar në dy intervista, në kohëzgjatje 1:62:95 sekonda.

Ndikimin e varietetit të folur të elitës politike e kemi hulumtuar në varietetet shqiptimore të Fatos Nanos e të Genc Pollos, politikanë të mëvonshëm dhe me përkatësi të ndryshme partiake.

Gjuha e Nanos është analizuar në një intervistë të tij të vitit 2012, e gjatë 1:37:53 sekonda, ndërsa ajo e Genc Pollos në dy intervista, që bashkë zgjasin 1:04:43 sekonda.

Duke parë ngjashmëri të mëdha midis varieteteve shqiptimore të këtyre katër politikanëve lista e subjekteve është zgjeruar edhe me Ismail Kadarenë, Blendi Fevziun dhe Adi Krastën. Për analizimin e gjuhës së folur të Kadaresë është shfrytëzuar një intervistë e vitit 2012, në kohëzgjatje 1:05:34 sekonda. Gjuha e Blendi Fevziut është analizuar paralelisht me gjuhën e të intervistuarve të tij, ndërsa si mostër për analizimin e gjuhës së Adi Krastës është përzgjedhur një monolog i gjatë 02:24 sekonda dhe një intervistë e vitit 2014, në kohëzgjatje 33:34 sekonda.

Korpusi i këtij punimi ngërthen 10 fjalime, 1 bashkëbisedim, 7 intervista dhe 1 monolog. Kohëzgjatja e tyre e përgjithshme është 6:54:29 sekonda.

I gjithë korpusi është vjelë nga rrjeti social [www.youtube.com](http://www.youtube.com) gjatë majit dhe qershorit të vitit 2014<sup>1</sup>.

## **1. Ndryshoret gjuhësore të hulumtuara**

William Labov (1972) përcakton ndryshoren sociolinguistike si mjetin themelor për të përshkruar një varietet gjuhësor dhe për të lidhur atë varietet me shtresën shoqërore përkatëse. Varieteti përkufizohet “*si një tërësi njësisish gjuhësore me përhapje shoqërore të ngjashme*” (Hudson, 2004:33).

Bazuar në këtë konstatim si ndryshore për hulumtim kemi përzgjedhur alternantët fonetikë: /e/-/ë/, /y/-/i/, /l/-/ll/, /r-rr/ dhe **procesin e neutralizimit** të bashkëtingëlloreve të zëshmeve në fund të fjalës.

---

<sup>1</sup> Shih linqet në fund të punimit.

Këto ndryshore në toskërishte janë variante alternative e jo konkurrenente në vargun fonematik. Matjet tona tregojnë se subjektet e përzgjedhura kanë përdorur gati gjithnjë alternativat e toskërishtes. Këto trajta dalin edhe sot në varietetin e folur të shqipes standarde në Shqipëri.

Mungesa e një norme shqiptimore e konsoliduar dhe e sanksionuar nga planifikuesit e gjuhës i ka hapur rrugë imponimit të ndryshoreve shqiptimore të elitës politike që përfaqësonte ideologjinë komuniste në shtetin shqiptar.

## 2. Përvetësimi dhe përdorimi i ndryshoreve

Analiza e gjuhës së folur të subjekteve tona tregon se edhe pas standardizimit gjuhësor variantet dialektore fonetike të përdorura nga elita politike ruajtën prestigjin e tyre.

*“Shqiptimi i e-së së theksuar përpara bashkëtingëlloreve hundore përbën një nga problemet, ku norma e drejtshqiptimit nuk paraqitet e njëzuar plotësisht. Për formën e shëruar të gjuhës letrare me rregullat e drejtshkrimit është vendosur që fjalët me e të theksuar + bashkëtingëllore hundore, të cilat diku shqiptohen me e, diku me ë, të shëruhet me e”*-thekson Dodi (Dodi, 2004:222). Jep konstatimin e diskutueshëm se norma e drejtshqiptimit mbi bazën e formave me e po përhapet gjithnjë e më shumë edhe në toskërishte, në të gjithë stilet e përdorimit të gjuhës ((Dodi, 2004:222). Matjet tona tregojnë të kundërtën. Alternativat **ë + n** dhe **ë + m**, në trup të fjalës për folësit jugorë të standardit dhe jo vetëm të tyre, janë trajta me prestigj dhe gjithnjë janë konkurrenente të trajtave të normuara. Nuk kemi gjetur asnjë rast të përdorimit të trajtave standarde **e + n** dhe **e + m** te asnjëri nga subjektet tona.

Vibrantet **r/rr** dalin me një status të paqartë. Në rastet kur këta dy tinguj dallohen vetëm nga mënyra e nyjetimit nuk kanë ndonjë rregullsi përdorimi, prandaj **r** dhe **rr** paraqesin homonime të shumta. *“Standardizimi i shqipes nuk është treguar i efektshëm për të eliminuar paqartësitë tradicionale midis këtyre dy tingujve”*, shprehet Byron (2012:122). Përdorimi i tingullit **i** në vend të **y**-së është tregues tjetër se dialekti nativ edhe përkundër standardizimit të gjuhës mund të marrë prestigj për shkak se vishet me ideologjinë e grupit përkatës.

Raportet konkurruese midis anësoreve **I-II** në këtë hulumtim dalin specifike. Subjektet tona shqiptojnë gjithmonë tingullin **II** në fjalët neolatine të huazuara relativisht vonë, shumica e të cilave kanë karakter ideologjik. Vetëm në gjuhën e Krastës nuk dalin fjalë të kësaj origjine.

Dukuria e fundit e hulumtuar është neutralizimi i zëshmerisë në fund të fjalës. Ky tipar me prestigj në toskërishte ka ruajtur “statusin” edhe në ligjërimin standard të subjekteve tona.

### 3. Rezultatet e matjeve

Për të konkretizuar pohimet e dhëna deri tash më poshtë po prezantojmë në formë tabelore rezultatet e matjeve që i kemi bërë në materialin e përzgjedhur për hulumtim.

#### Pasqyra e përdorimit të ndryshoreve dialektore në varietetet e folura te 7 subjekteve tona

Variantet dialektore

Subjektet shurdh.	ë	i	ll	rr	
E. Hoxha	30	10	20	13	07
R. Alia	20	06	05	11	10
F. Nano	22	04	01	08	03
G. Pollo	31	03	03	03	03
I. Kadare	28	02	05	01	05
A. Krasta	13	/	/	11	08
B. Fevziu	15	05	03	12	07
Gjithsej	159	35	38	59	43

Matjet tregojnë se tri nga pesë ndryshoret e hulumtuara: **ë**, **i** dhe **neutralizimi** dalin trajta me prestigj konstant. Përdoren gjithmonë në vend të trajtave të standardizuara. Numri i varianteve dialektore del i barabartë me numrin e fjalëve që përdorin subjektet folëse.

Ndryshoret **l/ll** dhe **r/rr** reflektojnë realitete specifike. E para përdoret vetëm në një kategori të caktuar fjalësh me prejardhje neolatine, të cilat kryesisht kanë ngjyrim ideologjik, ndërsa e dyta nuk ka rregullsi përdorimi. Subjektet tona i ngatërrojnë diferencat nyjetimore midis këtyre dy tingujve. Këtu kemi të bëjmë me prirjen e përgjithshme në shqipe drejt rrafshimit të kundërvënies **r/rr**.

Trajtat dialektore me **ë** para bashkëtingëlloreve nazale dalin rregullisht në

materialet e hulumtuara. Janë gjithsej 159 raste.

Frekuenca e përdorimit të saj sipas subjekteve folëse është: te Hoxha 30 raste, te Alia 20, te Nano 22, te Pollo 31, te Kadare 28, te Fevziu 15 dhe te Krasta 13 raste. Subjektet nuk kanë shqiptuar në asnjë rast **e**-në e standardizuar.

Ndryshorja e dytë e hulumtuar është tingulli **i**. Të gjitha subjektet realizojnë shqiptimet e fjalëve me **i** në vend të **y**-së standarde. Përjashtim bën Krasta. Në gjuhën e tij nuk kemi gjetur prova të mjaftueshme që do të qartësonin përzgjedhjen e tij midis këtyre ndryshoreve.

Është thënë edhe një herë se rasti me ndryshoret **I-II** është pak më specifik. Të gjitha subjektet tona, në përjashtim të Adi Krastës, përdorin gjithmonë **II**-në në vend të **I**-së standarde.

Fjalët më të shpeshta të shqiptuara me **II** janë fjalët: **llogjikë, ideologji, psikologji, kllasë, komplot, plan, megaloman, flotë (Hoxha), llogjikë, anullim, Atlantik (Alia), konkluzion, dialog, llogjikë (Nano), illuzione (Kadare) dhe diplomë (Pollo)**.

Në shqipe vibrantet **r-rr** janë duke e humbur karakterin opozicional. Në toskërishte ky opozicion është rrafshuar, prandaj në gjuhën e folur të subjekteve tona këto dy fonema nuk dalin asnjëherë në raporte kundërvënëse.

Ky tingull, që tashmë ka fituar prestigj edhe në të folurit standard, duket se nuk përputhet tërësisht me tiparet nyjetimore dhe akustike të **rr**-së së mirëfilltë shqipe. Me një perceptim të thjeshtë hetohet se është më intensiv dhe më sonor se **r**-ja, por jo aq as sa **rr**-ja e shqipes. Ne mendojmë se zhdukja e opozicionit midis këtyre dy fonemave është duke ndikuar në lindjen e një varianti të ri tingullor, i cili për ditë e më shumë po plotëson zbrastirën e krijuar në sistemin fonetiko-fonologjik të shqipes pas zhdukjes së këtij opozicioni fonologjik. Shkaqet duhet kërkuar te ndikimi i gjuhëve të huaja dhe tek faktorët ekstralinguistikë.

Në gjuhën e subjekteve tona fjalët më të shpeshta me këtë vibrante janë: **internazionale, internim, rregjim, rrini (rini), ritmi (ritmi), interesant, radio, rraport, rrezistencë**.

Ndryshorja e fundit, **shurdhimi** në fund të fjalës, realizohet në 100 për qind të rasteve të të gjitha subjektet. Hulumtimi tregon se kjo dukuri fonetike e ka ruajtur prestigjin që kishte në toskërishte, prandaj është normuar, siç kemi thënë edhe një herë tjetër, në mënyrë “*të heshtur*” si dukuri e konsoliduar dhe “*e standardizuar*”.

## Përfundime

1. Varieteti i folur i gjuhës së elitës politike të pasluftës, në radhë të parë i liderit komunist, Enver Hoxha, ka lënë gjurmë në varietetet e shqiptuara të shqipes, në këtë mes edhe në varietetin standard.

2. Se varieteti i folur i liderit Hoxha është përhapur bashkë me ideologjinë komuniste dëshmon varieteti i folur i njërit prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të tij, Ramiz Alia, por edhe i pjesëtarëve të tjerë të elitës politike dhe kulturore të kohës.

3. Ndikimi i gjuhës së elitës politike vërehet edhe sot në varietetin standard brenda territorit të Shqipërisë, posaçërisht në vernakularin e Tiranës.

4. Jashtë Shqipërisë, posaçërisht në Kosovë, për shkak se standardi mësohej në distancë, nuk hetohet se ka ndikuar varieteti i folur i elitës në gjuhën e folur standarde. Këtu më shumë shfaqet dukuria e hiperkorrektësisë, e cila manifestohet me riprodhimin besnik të normës së shkruar edhe në të folurit standard. Megjithatë, ky vlerësim mbetet hipotezë dhe hipotezat duhen provuar.

5. Përzgjedhja e njërit dialekt si normë për shqipen standarde kombëtare dhe bashkë me të edhe ndikimi i gjuhës së elitës politike ka bërë që varieteti i folur i shqipes standarde të jetë ende larg synimit të standardizuesve institucionalë.

6. Moskonsolidimi i variantit shqiptimor ka krijuar hapësira për shfaqjen e varieteteve të ndryshme shqiptimore në shqipen standarde.

7. Elementet dialektore të përdorura nga elita politike, e cila përmes gjuhës përhapte edhe ideologjinë e re komuniste, mbesin në përdorim në varietetin e folur të shqipes standarde.

8. Përcaktimi i statusit të këtyre ndryshoreve në shqipen e sotme kërkon hulumtim dhe përshkrim të thelluar. Mbetet një synim për t'u realizuar në të ardhmen.

### Linqet:

1. Për mirëqenien e popullit tonë 1948-enver hoxha, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=A5cHIBhqMvw>
2. Fjalim madheshtore i Enverit, 1952, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=LxyhxKygiP0>
3. FJALIM MADHESHTOR I SHOKUT ENVER HOXHA 1961, në:  
[https://www.youtube.com/watch?v=uKuzRA\\_0VBQ](https://www.youtube.com/watch?v=uKuzRA_0VBQ)
4. Enver Hoxha fjalim 1966, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=7KhxTA6cnxA>
5. Enver Hoxha fjalim 1971, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=7KhxTA6cnxA>
6. Enver Hoxha ne Bajz, 1979, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=pv9Qvco3aE8>
7. Mall per shokun Enver Hoxha Kosova 1981 qershor, 2011, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=ALqnv-9FngI>

8. Enver Hoxha fjalim 1983, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=VGJCSbxVogë>
9. Enver Hoxha-Fjalim,1983, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=2D0bJkoNBAo>
10. Enver Hoxha-Fjalim, 1983, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=qfYOegjxiRU>
11. Enver Hoxha Kongresi III, në:  
[https://www.youtube.com/watch?v=Cr3\\_nM4TvLc](https://www.youtube.com/watch?v=Cr3_nM4TvLc)
12. Opinion-Ramiz Alia (19 tetor 2011), në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=NEuBHHeNEbg>
13. Top story-Intervista e Ramiz Alisë 15.10.2009, në:  
[https://www.youtube.com/watch?v=2fu\\_k-Idqp0](https://www.youtube.com/watch?v=2fu_k-Idqp0)
14. Opinion-FATOS NANO, 20 qershor 2012, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=jPMf77enX9E>
15. Opinion-ikja e Ismajl Kadaresë! (24 tetor 2014), në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=qzj5xov340M>
16. Intervista e mbrëmjes, Genc Pollo, në:  
[https://www.youtube.com/watch?v=CXfLeDJ\\_jBA](https://www.youtube.com/watch?v=CXfLeDJ_jBA)
17. Agon Channel-Kontrata-Genc Pollo-2, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=XH0thxr6gN4>
18. Agon Channel-A Krasta Shoë-Monologu, në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=phiVK0Wy5tg>
19. Agon Channel-akrastaShow-në:  
<https://www.youtube.com/watch?v=BëiNtCKuQtA>

### **Bibliografia:**

1. Van Dijk, T., *Ideology, a multidisciplinary approach*, 1988, Sage.
2. Wodak and Weiss, *Comunitacion ideologies, Language discourse and Social Practice*, Frankfurt am Main: Peter Lang, 225-252, 2004.
3. Wolard K., Schirffelin, B., *Language Ideology*, Annual Review of Anthropology, 1994, 23:55-82.
4. Byron, J., (2012) *Perzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës shqipe dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë.
5. Munishi, Sh., (2013) *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*, Zero Print, Prishtinë.
6. Subačius, D., (2011) *Ēritten and Spoken standard*, Baltu filologija, Riga.

7. Paçarizi, R., (2011) *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*, QSA, Tiranë.
8. Labov, W., (2012) cituar sipas J. Byron, *Për zgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës shqipe dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë.
9. Haguen, (2012) cituar sipas J. Byron, *Për zgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës shqipe dhe shkrime të tjera*, Dituria, Tiranë.
10. Ismajli, R., (1981) *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë.
11. Hysenaj, H., (2012) *Shqipja e folur 40 vjet pas standardizimit të gjuhës*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
12. Hudson, R., (2002) *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë.
13. Dodi, A., (2004) *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë.





**Maklena ÇABEJ**

## **FJALË TË HUAZUARA DHE TË FORMUARA ME SHITYSË IDEOLOGJIKE**

Ideologjitë kryesore që kanë mbizotëruar në Shqipëri qysh prej krijimit të alfabetit të parë shqip nga Naum Veqilharxhi, në mesin e shekullit XIX, kanë qenë ideologjia nacionaliste-romantike e Rilindjes Kombëtare dhe ideologjia komuniste e diktaturës së proletariatit. Mbizotërimi i ideologjisë nacionaliste-romantike ka zgjatur rreth një shekull, deri në vitet '40 të shekullit të kaluar, ndërsa mbizotërimi i ideologjisë komuniste mbulon harkun kohor të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Ndikimi i këtyre dy ideologjive ka qenë i gjithanshëm në fusha të ndryshme.

Ideologjia është një bashkësi idesh që formojnë një vizion normativ, një mënyrë të caktuar të këndvështrimit të gjërave ose një bashkësi idesh të propozuara nga klasa mbizotëruese e shoqërisë për të gjithë anëtarët e saj. Duke qenë sisteme të mendimit abstrakt, të zbatuara për çështje të rëndësishme publike, ideologjitë bëhen koncepte qendrore për lëvizjet politike. Termi ideologji lindi gjatë debateve të ashpra politike dhe filozofike në periudhën e Revolucionit Francez. Qysh prej futjes në përdorim të këtij termi, janë dalluar ideologji që mbizotërojnë falë ndikimit të elitave në shoqëri, që i kanë përqafuar ato, ose falë adoptimit të tyre prej shteteve të caktuara (shtete fashiste, shtete komuniste).

Në Shqipëri, në rastin e ideologjisë nacionaliste-romantike ka pasur ndikim të elitave rilindëse, kurse ideologjia komuniste u mor nga shtetet e tjera komuniste, ku ky sistem ishte kristalizuar tashmë (ndikimi i ideologjisë fashiste pati jetë të shkurtër në Shqipëri dhe, për më tepër, u soll prej fashistëve).

Duke ndikuar në mënyrë të gjithanshme, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, *forës ndikuese të ideologjisë nuk i shpëton as gjuha si dukuri shoqërore... Duke pasur patash funksionet e gjuhës, kjo e fundit shndërrohet në një prej terreneve më të përshtatshme për ndikimin e ideologjisë<sup>1</sup>.*

Kështu, ideologjia nacionaliste-romantike e Rilindjes Kombëtare, duke pasur si qëllim një shkëputje të plotë politike e kulturore nga Perandoria Osmane, që *shqipëtarët*

---

<sup>1</sup> Sh. Munishi, Gjuha dhe ideologjia, Prishtinë, 2011.

*të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohetë prej të huajve, të mbajnë gjuhën' e kombërin' e tyre*<sup>2</sup>, synoi të punonte veçanërisht me gjuhën, me shqipen e shkruar dhe atë të foluar. *E par' e punëvet, që duhetë të ketë kujdes një komp, që do të ruajnë kombërin' e ti*, thoshte Sami Frashëri, *është të shkruarët' e gjuhës së ti*<sup>3</sup>. Në këtë periudhë, një ndër prirjet kryesore në lëmë të shqipes ishte zëvendësimi i turqizmimeve dhe i orientalizmeve me fjalë të reja për të spastruar dhe për të pasuruar fjalorin e shqipes. Kështu, shkrimtarët e Rilindjes, përveçse u dhanë kuptime të reja disa fjalëve të gjuhës së popullit, krijuan edhe shumë fjalë të reja. Një pjesë e mirë e këtyre neologjizmeve mbetën thjesht krijime me ndikim ideologjik, pra patën vlerë të paçmuar kombëtare, por nuk mundën të hynin në fjalorët e shqipes e të gjenin përdorim të gjerë. Nga pikëpamja e fjalëformimit, këto ishin kryesisht kompozita (fjalë të përbëra), si: *dhëkërkonjë* për *gjeologji*, *dhëshkronjë* për *gjeografi*, *dhëtregonjë* për *gjeologji*, *gjitburdhërim* për *republikë*, *gjitbëmësime* për *universitet*, *njeritregonjë* për *antropologji*, *jjëvështronjë* për *observator* etj.; kompozita afiksoide, si: *kryeshkronjës* për *kryesekretar* etj.; formime me prefikse, si: *nënëkrye* për *nënkryetar*, *nënëgastër* për *rreth*, *pakryesi* për *anarki* etj.; formime me sufikse, si: *gjqëri* për *drejtësi*, *katundëri* për *bashki*, *shkronjës* për *sekretar*, *shkronjëtor* për *shkrimtar*, *shkronjëto* për *gramatikë* etj.<sup>4</sup>

Por disa fjalë të reja të krijuara asokohe me shtysë ideologjike i bënë ballë kohës e hynë në përdorim të gjerë. Sot gjenden në të gjithë fjalorët e gjuhës shqipe. Të tilla janë: *ditare*, *kryeministër*, *letrëri* (për *letërsi*), *disa terma të gramatikës*, si: *mbiemër*, *folje*, *rrokje*, *presje* etj.<sup>5</sup>

Ndryshe nga ideologjia nacionaliste-romantike e Rilindjes, ideologjia komuniste nuk ishte ideologji mbizotëruese e elitave, por u importua nga një numër i kufizuar individësh që kishin punuar ose kishin studiuar jashtë Shqipërisë. Kështu, ajo nuk arriti të bëhet ideologji mbizotëruese e shoqërisë në mënyrë të natyrshme, por iu imponua asaj nga Partia Komuniste, e cila mori në dorë frenat e shtetit dhe e drejtoi atë për gjysmë shekulli.

Në funksion të mbajtjes së pushtetit dhe të forcimit të tij, Partia Komuniste ia imponoi gjithë shoqërisë njohjen dhe përqaftimin e ideologjisë komuniste. Gjithashtu, në gjithë veprimtarinë e shoqërisë shqiptare, në të gjitha fushat e shkencës, të letërsisë

<sup>2</sup> S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?*, Tiranë, 1962 : 68.

<sup>3</sup> Po aty, 54.

<sup>4</sup> Të gjithë neologjizmat janë marrë nga fjalorthi i veprës: *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?*, Tiranë, 1962. Gjithashtu, prof. Shaban Demiraj, në disa shënime të përmbledhura rreth gjuhës së kësaj vepre (fq. 99-103) thekson se për krijimin e fjalëve të reja, S.Frashëri ka shfrytëzuar pasurimin e fjalëve të gjuhës amtare e kuptime të reja, ku fjalë të tilla, si *krye*, *katundar*, *gastër* etj. i ka përdorur edhe me kuptime, që s'i kishte gjuha e folur. Dhe mbi bazë të tyre ka krijuar edhe fjalë të tjera, si: *nënëkrye*, *nënëkatundar*, *nënëgastër* etj.

<sup>5</sup> Shih: Sh. Demiraj, *Disa shënime të përmbledhura rreth gjuhës së veprës së S.Frashërit "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?"*, Tiranë, 1962 : 102.

dhe të artit, ideologjia komuniste u imponua si busulla e tyre. Natyrisht që këtij imponimi nuk i shpëtoi dot as gjuha. Ideologjia komuniste ushtroi ndikimin e saj dhe ndërhyri në gjuhë si në drejtim të çështjeve teorike, ashtu edhe në drejtim të disa çështjeve praktike. Gjatë gjysmëshekullit të sundimit komunist, u huazuan fjalë (duke iu përshtatur normës drejtshkrimore e gramatikore të shqipes) dhe u krijuan një sërë fjalësh të reja që ishin në funksion të propagandës shtetërore apo të përkufizimit e të përshkrimit të dukurive të posaçme. Këto fjalë u pasqyruan edhe në fjalorët e shqipes e sidomos në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, të 1980-ës. Në fjalorët e mëparshëm, kryesisht në atë të '54-ës, një pjesë e mirë e fjalëve me shtysë ideologjike mungojnë. Megjithatë, ashtu si të gjitha fjalët që hyjnë e veprojnë në gjuhë për shkak të ndikimit të një ideologjie të caktuar, qoftë kjo ideologji e elitave, qoftë ideologji e imponuar, edhe fjalët e huazuara dhe të krijuara gjatë periudhës së sundimit komunist nuk arritën të mbijetonin të gjitha edhe pas rënies së diktaturës së proletarietit. Asokohe u huazuan (kryesisht nga rusishtja) ose u krijuan fjalë dhe togfjalësha ku këto fjalë ishin pjesë përbërëse e strukturës së togfjalëshit, të tilla si: agjitprop, aksionist (frymë aksioniste), ballëçelëk (parti ballëçelike), emulacion (kënd emulacioni, tabelë emulacioni), fletëlavdërim, fletërrufe, organizatë-bazë, plan-detyrë, qytet-hero, zbor etj.<sup>6</sup> Nga pikëpamja e fjalëformimit, shumica e fjalëve të krijuara nën ndikimin e ideologjisë komuniste ishin fjalë të përbëra, për shkak se vetë kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft prodhimtare në gjuhën shqipe dhe me prirje në rritje dhe sepse përmes saj emërtohen nocione komplekse dhe mjaft nocione të reja. Këto fjalë gjetën përdorim të gjerë në gjuhë për aq kohë sa mbijetoi edhe ideologjia komuniste. Më pas, me rënien e diktaturës, përdorimi i tyre filloi të zbehej dhe sot pothuajse nuk përdoren më, të paktën në ligjërimin e përditshëm, ose përdoren në kontekste të kushtëzuara.

### **Bibliografia:**

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973
2. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, 1976
3. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980
4. Fjalor i gjuhës shqipe, 2006
5. S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhet*, 1962
6. Sh. Munishi, *Gjuha dhe ideologjia*, Prishtinë 2011

---

<sup>6</sup> Shënim: Këto fjalë janë vjelë nga Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973 dhe nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980.



**Kledi SHEGANI**

## **VËSHTRIM KRAHASUES MBI SEMANTIKËN IDEOLOGJIKE TË FJALËVE NË FJALORËT E SHQIPES**

Përkufizimi që i bëhet fjalës ideologji nëpër fjalorë<sup>1</sup> dhe roli i tyre në dëshminë e larmishmërisë gjuhësore dhe jo vetëm, me të drejtë na bën të vlerësojmë pushtetin e fjalës dhe të ideve në jetën e një shoqërie.

Jeta e gjuhës dhe etapat nëpër të cilat ajo kalon, ndër të tjera pasqyrohen edhe nëpër fjalorë si mbledhës të lendës së parë , e cila përpunohet dhe ideon mendimin. E gjitha kjo si dëshmi e asaj çka lëviz në gjuhë dhe konsiderohet si prurje, apo me kohë bëhet pjesë e fondit pasiv. Fjalorët janë pasqyrë e ndryshimeve politike, shoqërore, që ndodhin në jetën e një kombi dhe më së pari reflektohen edhe në gjuhë dhe sidomos në leksikon e saj. Për të përligjur në fakt atë, që ideologjia mund të reflektojë në gjuhë, do të sjellim një korpus fjalësh dhe vendin që ato kanë zënë , apo jo nëpër fjalorë.

Pasurimi me fjalë dhe kuptime të reja, sipas kontekstit historik dhe kushteve politiko-shoqërore ,apo futja e termave “të ndaluar” do të jetë objekt i studimit tonë , duke marrë në konsideratë fjalorët e viteve 1954,1980 dhe 2002 dhe ndikimin e ideologjisë në fjalët dhe ngarkesën e tyre kuptimore. Ngarkesa me karakter politizues, leksiku fetar, apo edhe ajo shtresë, që lidhet me sistemin komunist dhe interpretimin e dukurive nën spektrin politik janë pjesë e vëzhgimit tonë, natyrisht pa lënë jashtë vëmendjes edhe frazeologjinë, e cila jo rrallë ngjyroset nga ideologjia dhe merrte ngarkesa të reja kuptimore, në përshtatje me sistemin politik dhe vlerave të tij të referimit.

---

<sup>1</sup> (1954) Botëkuptim, system pikëpamjesh dhe idesh; (1980)Sistem idesh e pikëpamjesh politike, filozofike, juridike, estetike, morale e fetare, që shprehin interesat, qëndrimin e kërkesat e një klase, të një grupi shoqëror, të një partie, të një sistemi politiko-shoqëror etj., si pjesë e superstrukturës dhe që pasqyrojnë, në fund të fundit, marrëdhëniet ekonomike; botëkuptim. Ideologjia marksiste-leniniste. Ideologjia borgjeze (revizionistë, reaksionare, mesjetare, fetare, mikroborgjeze). Ideologji sunduese. Ideologjia e klasës punëtore. Shfaqje të ideologjisë së huaj. Në fushën e ideologjisë. Përvetësoj ideologjinë revolucionare. (2002) Sistem idesh e pikëpamjesh politike, filozofike, juridike, estetike, morale e fetare, që shprehin interesat, qëndrimin e kërkesat e një klase, të një grupi shoqëror, të një partie, të një sistemi politiko-shoqëror etj

Duke qenë se gjuha është një sistem që evoluon, gjithmonë është e lidhur me të shkuarën dhe të ardhmen. Nëse do të bënim një interpretim ,duke e vendosur sistemin gjuhësor të shqipes në boshtin e kohës, atëherë do të na rezultonte se vlera e ideologjisë e ka kurbën e zhvillimit në nivelet maksimale në sistemin komunist dhe sa vjen dhe zbehet duke shkuar drejt zeros në periudhën e pas viteve '90-të. Gjithsesi , është i padiskutueshëm ndikimi i ideologjisë në rrjedhën e politikave gjuhësore, gjë që, natyrshëm pasqyrohet në pasurinë leksikore të gjuhës.

Bashkohemi me mendimin e prof.Rrokajt, sipas të cilit, “në disa tipa ligjërimesh gjuha shqipe, duke dashur t'i përshtatej perceptimit të dogmës ideologjike marksiste-leniniste, filloi të ngurtësohej e të kalkohej në një shtrat të gjerë parafabrikatesh tipike për shprehjen e një vetëdijeje botëkuptimore për këtë dogmë. Në terminologjinë gjuhësore, kjo mënyrë komunikimi është quajtur edhe “gjuhë druri”, gjuhë e ngurtësuar, e cila “përkthen” perceptimin e dogmës”<sup>2</sup>.Duke vazhduar më tej këtë arsyetim, përpos këtij interpretimi dhe aspekteve teorike të marrëdhënieve të gjuhës me ideologjinë,do të përpiqemi të sjellim disa elemente konkrete nga krahasimi i shpjegimit të fjalëve në fjalorë të shqipes, që identifikojnë dy periudha të ndryshme si nga sistemi politik, ashtu edhe nga konteksti shoqëror dhe përvoja gjuhësore.

Në studimin tonë do të përpiqemi të sjellim disa vëzhgime, që kanë krijuar nëpër fjalorë interpretime “të cinguar”, brenda kornizës politike, duke qenë se ato fjalë dhe dukuritë, apo elementet, që ato përfaqësonin nuk ishin pjesë e jetës shqiptare në atë kohë, mjafton të përmendim fjalë të tilla si: *pluralizëm*, (*nuk ekziston në fjalorin e vitit 1954*); në fjalorin e vitit 1980 *përkufizohet si :“ një doktrinë idealiste, sistem shtetëror borgjezo-revizionist, pluralizmi revizionist ”<sup>3</sup>; apo fjalë të tilla si: demokraci, diktaturë, zgjedhje, kapitalizëm, kapital,bllokade, bojkot, borgjezi, agjitacion, bestytmi, dualizëm, spiun,autarki etj.*

Në fakt, interpretimi i ideologjive në fjalorin e vitit 1980-të, nuk i shpëton dot kornizës politike.Psh: epiteti “borgjez” është i pranishëm në cdo përkufizim për atë që quhej e papranueshme për shoqërinë tonë. Kështu: *kozmpolitizmi* etiketohet si teori borgjeze, *obskurantizmi* si qëndrim reaksionar i klerit; *opozita* , term që i takon vendeve revizioniste (lufta midis grupeve për të marrë fuqinë), *simbolizmi* si drejtim dekadent dhe antirealist. Një korpus i madh fjalësh si: hipotejë<sup>4</sup>, interprelancë<sup>5</sup>, idealizëm<sup>6</sup>,

<sup>2</sup> Sh.Rrokaj “Shqipja në epokën e globalizmit dhe identiteti i saj”, gazeta “Panorama”, 13 prill, 2013

<sup>3</sup> Shih për më tepër :Fjalor i Gjuhës se sotme shqipe,Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980, f.1508

<sup>4</sup> Fjalori, '80 f.684,

<sup>5</sup> Fjalori '80 f.726

<sup>6</sup> Po aty, f.708

kozmpolitizëm<sup>7</sup>, obskurantizëm<sup>8</sup>, imperialist<sup>9</sup>, reaksion<sup>10</sup>, simbolizëm<sup>11</sup>, sindikalizëm<sup>12</sup>, socialdemokraci,<sup>13</sup> etj shiheshin dhe përkufizoheshin vetëm si dukuri të shoqërive borgjeze .

Ndërkaq, edhe zoodiaku, apo shenjat e zoodiakut mungojnë në fjalorët e shqipes, duke qenë se ishin dukuri të panjohura për shoqërinë shqiptare dhe normalisht nuk kish se si të pasqyroheshin nëpër fjalorë si të tillë.

Për t'u orientuar më lehtë do të bëjmë një ndarje të thjeshtë, sipas fushave të politikës dhe ekonomisë (më së shumti këto dy fusha kanë koncepte dhe elemente që identifikohen me nocionet e sistemit) dhe natyrisht, që fjala dhe kuptimi i saj interpretoheshin në përputhje me këto nocione dhe filli ideologjik përshkonte semantikën e fjalëve dhe frazeologjive që rrjedhin prej tyre. Me ndryshimin e sistemit dhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore, gjuha u përball me një “zbrazje” fjalësh dhe kuptimesh, që mbetën vetëm në formën e shkruar, si dëshmi e asaj periudhe që tashmë kish mbaruar nga njëra anë dhe me një prurje leksikore ,apo plotësime semantike që nuk ishin lejuar më parë . Për ta konkretizuar këtë ndryshim, do të sjellim një shembull të tillë:

*Psh në fjalorin e vitit –'54 dhe të vitit '80-të gjejmë këtë shpjegim për fjalën AUTARKI*

*Autarki: në politikën ekonomiko- imperialiste, t'izoluarit e ekonomisë nacionale duke ua ruajtur tregun e brendshëm monopoleve kapitaliste,për të përgatitur luftë agresive.*

*Në fjalorin e vitit 1980 gjejmë këtë shpjegim:*

**AUTARKI** f. ek.

*Politikë ekonomike e shteteve imperialiste, që synon të krijojë një ekonomi kombëtare të mbyllur, për të përgatitur luftëra pushtuese; gjendja e një shteti ose synimi për t'u mbyllur brenda caqeve të ekonomisë së vet për plotësimin e të gjitha kërkesave. Politika e autarkisë. Bie në autarki.*

**AUTARKIK** mb. ek.

*Që mbyllet brenda caqeve të ekonomisë së vet për plotësimin e të gjitha kërkesave, që bazohet në autarki. Ekonomi autarkike. Shtet autarkik. Plan autarkik.*

---

<sup>7</sup> Po aty, f.878

<sup>8</sup> Po aty, f.1305

<sup>9</sup> Po aty, f.715

<sup>10</sup> Po aty, 1636

<sup>11</sup> Po aty, f.1752

<sup>12</sup> Po aty, f.1754

<sup>13</sup> Po aty, f.1771

*Në fjalorin e vitit 2002 thjeshtohet akoma më shumë shpjegimi: "Politikë ekonomike që synon të krijojë një ekonomi kombëtare të mbyllur, synimi I një shteti, për t'u mbyllur Brenda cageve të ekonomisë së vet*

Në shpjegimin e fjalës, në fjalorin e vitit '54 të bie në sy, përdorimi i dy fjalëve përcaktuese: izoluese dhe agresivitet, që ishin brenda natyrës së sistemit komunist.

Nëse do të lexojmë dhe kuptimin e mbiemrit *i/e izoluar* do të shohim së në fjalorin e '54-ës është shpjeguar vetëm me një fjali " që e kanë izoluar, që është i vecuar, ndërsa në fjalorin e sotëm gjejmë shpjegim më të zgjeruar.

### **IZOLUAR** *mb. libr.*

1. Që është veçuar; që mbahet i veçuar; i shkëputur krejtësisht nga vendet e tjera, që ka mbetur i vetmuar, pa lidhje e marrëdhënie me vendet e tjera (për vende). Vend i izoluar. Shtëpi (dhomë) e izoluar. Mbetën të izoluar.
2. tek., elektr. Që është mbështjellë a është veshur me lëndë jopërçuese, i veçuar.  
Tel i izoluar. Dhomë e izoluar dhomë e veshur me lëndë izoluese që nuk e përçon zërin a ngrohtësinë.

Sic vihet re, brenda logjikës së sistemit, shmanget shpjegimi për *vend të izoluar*, dhe jepet diçka më e përgjithshme. Madje edhe në shpjegimin e foljes *izoluj* mjaftohet me shpjegimin e izolimit të një personi, apo një përcjellësi, ndërkohë, që në fjalorin e vitit 2002 gjejmë një shpjegim më të detajuar

### **IZOLOJ** *kal.*

1. libr. *Veçoj; mbaj të veçuar dikë; e shkëput krejtësisht një vend nga vendet e tjera, bëj që të mbetet i vetmuar, pa lidhje e marrëdhënie me vendet e tjera. Izoloi të sëmurin. I izoloi dimri. Nuk na izolojnë dot.*
2. tek., elektr. *Vesh a mbështjell me veçues një përçues elektrik; e mbroj diçka nga dëmtues të ndryshëm me anë të një mbulese a të një shtrese të papërshkueshme; veçoj. Izoloi me izolant. Izoloi mirë.*

Për mbiemrin *:agresiv*, shpjegimi i të cilit në fjalorin e vitit '54 mjaftohet vetëm me një fjali, madje edhe shpjegimi i emrit *:agresion* si "sulm me armë i një shteti, ose disa shteteve imperialiste..." nuk kish se si të shmangete përdorimin e mbiemrit "imperialist", kaq identifikues për një periudhë, në të cilën ndikimi i ideologjisë ishte i pranishëm, thuajse në çdo fushë.



**AGRESION** *m.*

*Sulm i armatosur i një shteti kundër një shteti tjetër për t'i pushtuar tokat e për ta nënshtuar, për të shtypur lëvizjet demokratike, revolucionare ose nacionalçlirimtare dhe për të vendosur regjime reaksionare; luftë e ashpër që bën një shtet për të depërtuar me mënyra të ndryshme në një shtet tjetër e për ta dëmtuar nga ana ekonomike, politike, ideologjike e kulturore. Agresion i armatosur. Agresion i hapur. Agresion imperialist. Agresion ekonomik (ideologjik). Vatër agresioni. Akt agresioni. Burim luftërash e agresioni. Kryejnë (bëjnë, ndërmarrin) agresione.*

Shpjegimet dhe interpretimet e fjalëve dhe kuptimeve të tyre, duke qenë se bëheshin brenda kornizës ideologjike ishin të kufizuara. Sot, mund të vërejmë se disa fjalë nuk përdoren më, duke qenë se edhe elementet, që ato emërtojnë nuk janë më pjesë e jetës sonë. Kështu, në morinë e fjalëve që nuk përdoren përmendim fjalën “stakanovist”<sup>14</sup>, e cila mungon edhe në fjalorin e vitit 1980-të. Gjithashtu, fjalë apo formime të tilla si: *zbor, kënd emulacioni, fleterrufe, informacion politik, edukim në gjirin e klasës punëtore, fshati të rrethojë qytetin*; e të tjera fjalë si këto, përbëjnë një korpus jo të vogël, që e ka zbehur përdorimin dhe ka mbetur si një relike që dëshmohet e tillë gjuhësisht.

Për ta vazhduar më tej, interpretimin e fjalëve dhe frazeologjive si: *”gjitbë populli ushtar”, “Të jetojmë e punojmë si në rrethim”, “Në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën dorë pushkën”, “Të punojmë dhe të jetojmë si revolucionarë”,* etj, shohim se ideologjia, edhe me frazeologjizmat “punonte”, brenda kornizave të sistemit politik të kohës.

Kështu për fjalën “masë”<sup>15</sup> në fjalorin e vitit 1954 gjejmë shpjegimin”shtresat e gjera të popullit, në fjalorin e vitit 1980-të<sup>16</sup> gjejmë: organizatë masash, vijë masash, zëri i masës, vepër e masave, në gji të masave, shkrirja me masën, e bëjnë masat, t’u shërbejnë masave, etj. Në fjalorin e vitit 2002, nuk ekzistojnë shpjegime të tilla.

Fjala “fe”<sup>17</sup> në fjalorin e vitit 1954 shpjegohet si: *”ide dhe pikëpamje të bazuara në mistikë, në besimin se ekzistojnë forca dhe qenie që bëjnë mrekullira. Ky shpjegim shoqërohet me thënien e Marksit “feja është opiumi i popullit”*

Po kështu, “fe”<sup>18</sup> në fjalorin e vitit 1980-të shpjegohet si: *”besim i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyrshme hyjnore...”*

Në fjalorin e vitit 2002 feja<sup>19</sup> është *“Besimi në qënien e një fuqie të*

---

<sup>14</sup> Stakanovist- punëtor i përparuar i epokës socialiste që di të shfrytëzojë teknikat e reja... më shumë shih Fjalor i Gjuhës Shqipe, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954, f.504

<sup>15</sup> Fjalor i Gjuhës Shqipe, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954, f.293

<sup>16</sup> Shih Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980, f.1066

<sup>17</sup> Fjalor i Gjuhës Shqipe, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954, f.115

<sup>18</sup> Shih Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980, f.458

mbinatyrshe që ka krijuar, sundon e drejton gjithësinë;besimi te Zoti a te një perëndi”.

Mund të themi se dukuritë që kemi vërejtur më së shumti janë:

Së pari , zbehja ose humbja e kuptimit të një korpusi fjalësh, që tani përdoren pak, ose aspak, si elemente të një ideologjie që e ka përfunduar ndikimin e saj.

Së dyti, mjetet e ndryshme gjuhësore, të cilat përdoren në interpretimin ideologjik te dukurive apo koncepteve, apo dhe në formimin e frazeologjizmave në kontekste të caktuara shoqërore ndryshojnë nga një epokë në tjetrën.

Së treti, sektorë të tillë si :politika, ekonomia ,apo edhe feja janë fushat që kanë ndjerë më së shumti “luhatjet” ideologjike në koncepte dhe interpretime brenda kornizave të sistemit politik.

Si përfundim të këtij vëzhgimi modest mbi semantikën ideologjike të fjalëve, mund të themi se gjuha dhe ideologjia kanë bashkëjetuar dhe bashkëvepruar brenda sistemit politik. Politika i ka përdorur si instrumente për “manipulimin” e informacionit duke shfrytëzuar ndikimin ideologjik në “ngjyrosjen” apo “çngjyrosjen” e fjalëve dhe të njësive leksikore që formohen . Mjafton për këtë, të shohim korpuset e fjalëve dhe shpjegimet e tyre në kontekste të ndryshme shoqërore dhe gjuhësore, të dëshmuar në fjalorët e shqipës.

---

<sup>19</sup> Shih:Fjalori I shqipës së sotme, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Botimet Toena, f.324

**Linditë SEJDIU-RUGOVA**

## **IDEOLOGJIA E SHPREHUR NËPËRMJET MODALITETIT NË STUDIMET PËR “PASTËRTINË E SHQIPES”**

Qëllim parësor i këtij punimi është që ta hulumtojë tekstin e studimeve të botuara në vëllimin e studimeve “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, të botuar në vitin 1989, nën dritën e studimeve të analizës së diskursit dhe të pragmatikës funksionale. Modaliteti si koncept semantik, sintaksor dhe pragmatik do të vështrohet si element ideologjik i diskursit, që shpreh subjektivitet, pavendosmëri dhe jofaktualitet, si tipare themelore, të përbashkëta, të të gjitha foljeve modale në të gjitha gjuhët. Koncepti teorik i modalitetit do të mbështetet në terma të autorëve si: Coates, Halliday, Palmer, Nuyts, de Haan, Kaufmann

Bybee & Fleischman, Friedman, Johannesson, Portner, Simpson, Barden, etj. Pra, nëpërmjet studimit të analizës së ideologjisë në diskurs, studimi do të mëtojë të hulumtojë rolin e modalitetit në përfaqësimin e ideologjive të nënkuptuara si dhe të paqëndrueshmërive ideologjike gjuhësore brenda korpusit të këtij vëllimi të botuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë.

Ideologjia definohet nga aspekte të shumta dhe në mesin e dhjetra përkufizimeve do t'i veçoja disa të shprehura nga Eagleton (1991: 2): një grumbull idesh që e karakterizojnë një grup apo klasë shoqërore, ide që e legjitimojnë një fuqi dominante politike, ide false që ndihmojnë në legjitimimin e një fuqie dominante politike, mënyrë e të menduarit e motivuar nga interesa shoqërore dhe si një lidhje të fortë midis diskursit dhe fuqisë.

Koncepti dhe qëllimi i ideologjisë në gjuhësinë shqiptare janë më të dukshëm dhe më të prekshëm në procesin e standardizimit të shqipes dhe një dukuri e tillë është zhvilluar me qëllim të fuqizimit të një klase politike krahasuar me grupet e tjera shoqërore, në rastin konkret qarqet gjuhësore toske dhe ideologjia e tyre ndaj gegërishtes. Paçarizi (2011) e konsideron këtë proces si një stigmatizim të vazhdueshëm të dialektit verior, folësit e tij inferiorë ndaj standardit me bazë toskërishten dhe geërishten e folme që ende vazhdon të nënçmohet dhe folësit e saj shpeshërë të diferencohen. Ndërkaq, Munishi (2013: 95) thekson se ngarkesa ideologjike vazhdon t'i shpjerë gjuhëtarët shqiptarë (me theks në Kostallarin) në shpjegime teorike kundërthënëse dhe jo objektive.

Këtë dukuri, kryesisht në baza regjionale, më së miri e vërejmë nëse e analizojmë një reklamë të shpërndarë nëpër shtëpitë tona për regjistrim të fëmijëve 6 vjeçarë në shkollat fillore private me moton: “*A dëshironi ta mësoni shqipen e Shqipërisë? Të mësoni me mësuës nga Shqipëria, të cilët e flasin gjuhën standarde vetëm? Ejani dhe bashkohuni me ne!*” Një reklamë e ngjashme e cilësuar si “e fshehtë” (classified), e cila sugjeron se si të fitohet theksi i huaj në SHBA është prezantuar si shembull në librin e Barbara Johnstone-it: *Discourse Analysis* (2008: 66), dhe sipas saj, disa nga aspektet e ideologjisë përfaqësohen si ide që e shprehin lidhjen midis gjuhës dhe realitetit, si ide që tregojnë se si mësohen gjuhët, si ide të korrektësisë dhe të jokorrektësisë gjuhësore, ngjashëm me idetë rreth rolit të gjuhës në përcaktimin e identitetit personal, si dhe me idetë se cilat duhet të jenë funksionet e gjuhës, cilat janë autoritetet gjuhësore<sup>1</sup> si dhe a duhet apo jo të rregullohet me ligj përdorimi i gjuhës.

Por cili është roli i modalitetit gjuhësor në këtë rreth? A mund ta konceptojmë si ideologjik përfaqësimin modal të trajtave të përdorura gramatikore në artikujt e një punimi shkencor si ideologjik? Dhe cilët janë këta autorë që karakterizohen me një diskurs të tillë?

Sa i përket modalitetit dhe mundësisë së krijimit të një lidhjeje gjuhësore midis modalitetit dhe ideologjisë, gramatikave të shqipes, përfshirë edhe ato të sotmet, nuk na ofrojnë një bazament të fortë mbi të cilin do të mund ta mbështesnim një lidhje të tillë. Me përjashtim të studimeve të viteve të fundit, kryesisht me karakter kontrastiv, që janë botuar në Prishtinë (Ismajli, 2012, 2013; Hamiti, 2014).

Në gjuhësinë botërore modaliteti dikur kategorizohej në përgjithësi sipas kriterëve deskriptivë me të vetmin qëllim: klasifikimin e foljeve dhe shprehjeve modale. Të gjitha këto shpjegime, shpeshherë me elemente të deskriptivizmit tradicional, në rrafshin praktik dhe teorik, synonin klasifikimin e strukturave që do të konsideroheshin modale ose jo. Këto shpjegime e kanë lënë anash aspektin funksional të diskursit: pragmatikën funksionale të diskursit!

Lakoff (1972: 229-230) është ndër të parët që përpiqet ta ndryshojë kahjen e studimeve të tilla duke u përpjekur që t'i klasifikojë shprehjet modale dhe ta përcaktojë përdorimin e tyre në situata të caktuara gjuhësore duke e marrë parasysh kontekstin sintaksor, strukturën logjike si dhe kontekstin e tërë thënies, paragjykimet e folësit dhe të dëgjuesit, situatën shoqërore të presupozuar nga pjesëmarrësit në situatë të

---

<sup>1</sup> Në temra të Johnstone-it, citimi i fjalëve të një autoriteti kulturor, pa marrë parasysh nëse ai është gjuhëtar ose jo, me qëllim të marrjes së përkrahjes së opinionit të gjerë rreth një çështjeje të caktuar gjuhësore, është treguesi më i mirë i një ndërhyrjeje ideologjike! Në shumë studime gjuhësore të studiuesve (pseudostudiuesve) shqiptarë për shqipen, Kadareja dhe fjalitë e tij për shqipen a shqiptarët, të përdorura në kontekste krejtësisht të ndryshme nga konteksti që u mvishet, paraqesin përdorimin tipik të një ideologjie të tillë.

komunikimit si dhe përshtypjen që folësi dëshiron t’ia bëjë dëgjuesit.

Palmer në vitin 1986, në librin e tij “Mood and Modality”, sjell një klasifikim pak më ndryshe të modalitetit, duke e prekur edhe aspektin jashtëgjuhësor të tij. Sidoqoftë, Palmeri është i vetëdijshëm për faktin se kategorizimi i modalitetit nga aspekti jashtëgjuhësor nuk do të ishte aq i qëndrueshëm dhe adekuat. Rrjedhimisht, ai e përcakton subjektivitetin bashkë me pavendosmërinë dhe jofaktiken si tipare themelore dhe të përbashkëta të modalitetit në të gjitha gjuhët. Ndonëse ai njëkohësisht shpreh njëfarë rezerve ndaj subjektivitetit si kriter themelor të kategorizimit të modalitetit në një gjuhë, me këtë kategorizim ai i nxit të tjerët për një përfshirje më funksionale dhe pragmatike të diskursit në shpjegimin e koncepteve të tilla gjuhësore.

Sa i përket pavendosmërisë si kriter i dytë në këtë rrafsh, Dany Badran (2001) thekson se Coates (1983) i ka dhënë një shtytje të madhe, duke e cilësuar si tiparin themelor të interpretimit të modalitetit në një gjuhë.

Halliday (1985: 85-86) e karakterizon modalitetin si zgjedhje gjuhësore midis dy polariteteve, midis po-së dhe jo-së, e cila i kap të gjitha shkallët e pavendosmërisë midis këtyre dy ekstremeve. Badran (2002:132) thekson se ndarja që ai i bën modalitetit në *modalizim* (që paraqet vlerësimin apo gjykimin e folësit ndaj një koncepti) dhe *modulim* (që paraqet dëshirueshmërinë e folësit ndaj një koncepti) e paraqesin funksionalizmin e studimeve të tij, ndërkaq nëndarja e mëtejme e këtyre nocioneve në kategori të shpeshëtësishë, të propabilitetit, të detyrimit dhe të prirjes apo preferencës personale si dhe matja e shkallës së shprehjes së këtyre nuancave sipas nivelit të ultë, të mesëm apo të lartë, në mënyrë implicite bën që Halliday t’i shmanget shpjegimit vetëm semantik të modalitetit. Rrjedhimisht, interpretimi gjuhësor i modalitetit që ai e ngërthen në këtë teori është i rëndësishëm për qasjen pragmatike të analizës, të cilës ai i paraprin.

Simpsoni (1994:47) e vështron modalitetin nga aspekti praktik, më pak teorik se Halliday, dhe e ndan në deontik dhe epistemik, deontiku duke përfshirë qëndrimin e folësit ndaj shkallës së obligimit që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar si dhe dhe epistemiku, që lidhet me të pasurit ose jo të besimit folës ndaj një koncepti të shprehur nga folësi. Ky i fundit, gjithnjë sipas Simpsonit, në vetvete ngërthen edhe sistemin e modalitetit perceptiv që në të vërtetë paraqet aftësinë e folësit për ta besuar ose jo një koncept të shprehur duke u mbështetur ose jo në një perceptim vizuel.

Palmeri (1986:121) e pati definuar tashmë saktësisht këtë ndarje të Simpsonit duke e quajtur modalitetin epistemik si modalitet që merret me gjuhën si informacion dhe atë deontik si modalitet që merret me gjuhën si veprim. E para duke përfshirë nuancat kuptimore si mundësia, probabiliteti, nevoja, siguria, parashikimi, ndërsa e

dyta duke përfshirë nocionet nga lejimi deri te urdhërimi: detyrimin, obligimin, dhe insistimin.

Meqë duam që modalitetin ta vështrojmë nga aspekti i analizës së diskursit, jo nga ai puro semantik, dhe meqë duam që nëpërmjet modalitetit ta analizojmë shprehjen e ideologjisë në tekste të caktuara, do të ndalemi më gjerësisht te lidhja që krijohet midis interpretimit të modalitetit dhe të ideologjisë nëpërmjet të subjektivitetit dhe të pavendosmërisë (Subjectivity dhe Indeterminacy), por duke i marrë parasysh gjithnjë edhe elementet e tjera semantike të rëndësishme për një analizë të tillë, siç janë realizimet strukturore të modalitetit epistemik, deontik, perceptiv, bulemik, tentativ, etj. si dhe të shkallës së forcës së modalitetit që shprehet.

Në terma të Bardenit (2002:139), shkalla e subjektivitetit lidhet me *shkallën e përfshirjes ose jo të folësit në situatë të komunikimit* (që ndikon jashtëzakonisht shumë në modalitetin e thënies dhe me këtë edhe në diskurs, meqë efekti i një përfshirjeje të tillë nuk është gjithmonë i lirë dhe i vetëdijshëm e si pasojë edhe mjaft i diskutueshëm), dhe nëpërmjet të *pavendosmërisë*. Barden e përkufizon subjektivitetin si shenjë të përfshirjes së tipit të dërguesit dhe shkallës së përfshirjes së tij, të parë nga perspektiva e marrësit. Pra, sipas tij, subjektiviteti lidhet drejtpërsëdrejti me interpretimin meqë marrësi paraqet shkallën e fundit për përcaktimin e kuptimit të shprehjes modale. Por, ka një sërë kufizimesh mbi të cilat nuk kalon dot interpretimi i trajtave modale. Dhe kjo çon drejt pavendosmërisë së përcaktimit të një kuptimi modal. Prandaj, pavendosmëria (indeterminacy) konsiderohet e rëndësishme në përcaktimin e kuptimit sipas të cilit është klasifikuar shprehja modale (epistemike apo deontike), në përcaktimin e forcës së shprehjes modale (autoriteti i folësit) si dhe të shkallës së subjektivitetit gjatë komunikimit (interferenca eksplicite ose implicite e folësit). (Barden, 2002: 142-143)

Rrjedhimisht, kur e analizojmë modalitetin nga aspekti pragmatik, ne në të vërtetë e kërkojmë një vazhdimësi tridimensionale (të ngjashme me ‘orientimet’ dhe ‘vlerat’ e Halliday-it) e që kanë të bëjnë me cilësimet: shkallë epistemiko-deontike, shkallë e dobët karshi të fortës brenda faktivitetit apo modalitetit si dhe shkallë subjektive karshi asaj objektive, me tendencë të përafrimit të shkallës subjektive ndaj shkallës së dobët e që jo gjithmonë na del e saktë meqë çdo përdorim modal është përdorim individual, brenda kontekstit të caktuar: p.sh.: *Mendoj se ai do të vijë*. (epistemik (*mendoj*), i kombinuar me modalitet dinamik të sigurisë (*do të vijë*) - subjektiv; posibilitet me shkallë të lartë të faktivitetit: *ka shumë gjasa që ai të vijë*), dhe *Ai ndoshta vjen me ty*. (epistemik, me shkallë më të ultë të faktivitetit krahasuar me fjalinë paraprake: gjasat janë 50 me 50!, por objektiv).

Me terma të tilla do të përpiqemi ta mbështesim edhe analizën tonë, duke i përfshirë edhe ato elemente gjuhësore, të rëndësishme për një interpretim ideologjik të

modalitetit. Pra, do të përpiqemi të nxjerrim në pah ndërveprimin midis modalitetit dhe ideologjisë. Për këtë lloj analize janë zgjedhur disa segmente të teksteve të studimeve të botuara në vëllimin e studimeve “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, të botuar në vitin 1989 nga ASHRPSSH. Do të ndalemi kryesisht te teksti i studimit të Emil Lafes “Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë”, (Vëllimi III, 1989: 243-265).

Shikuar si tërësi, një tekst i tillë përmban cilësime të shumta që e zvogëlojnë neutralitetin dhe paanshmërinë shkencore të një teksti argumentues dhe ekspozitor, qëllim themelor i të cilit supozohet të jetë pikërisht vlerësimi kritik dhe argumentimi i saktë i dukurisë së pastërtisë së shqipes (vetë termi metaforik *pastërti* na del si ideologjik për shkak se shpreh pozicion folës, lexuesi mbetet me përshtypje se shqipja na qenkështa e papastër, e ndytë!). Pra, kemi të bëjmë me tekstin e një gjuhëtari, ndër autoritetet më të fuqishme politiko-gjuhësore të kohës, përfshirja e të cilit në të gjitha proceset e standardizimit, të “pasurimit” apo të “varfërimit” të shqipes ishte e padiskutueshme.

Në terma të Palmerit, në studimin e Lafes modaliteti na del edhe si gjuhë në funksion, edhe si gjuhë në veprim. Arsyetimi i Lafes se gjuha shqipe ishte preokupim “qysh nga Veqilharxhi e deri te Enver Hoxha” del si përshkrues, preskriptiv dhe shumë obligues për lexuesin. Detyra, të cilën Lafe ua cakton gjuhëtarëve shqiptarë, i pozicionuar pas emrit të një udhëheqësi politik dhe Partisë konsiderohet si modalitet i shkallës së fortë subjektive (në terma të Halliday-it, autori shpreh prirje personale të nivelit të lartë), pastaj kalon në modalitet deontik për nga qëndrimi i folësit ndaj një dukurie të tillë që kërkon veprim të menjëhershëm, pra paraqitet si detyrim ndaj dikujt që udhëheq shtetin dhe ligjin. Një perspektivë e tillë folëse shtetin dhe ligjin i sheh si elemente të stabilitetit dhe të rregullsisë. Përfshirja e autorit në ngjarjet e kohës si element i subjektivitetit (duke e cituar drejtpërsëdrejti fjalimin e ‘shokut Enver’ të vitit 1962 dhe përdorimi i ligjëratës së drejtë në këtë situatë) e bën prezencën e tij në këto veprimtari më aktive dhe më të afërt me udhëheqësin, respektivisht me politikën e kohës. Theksimi i vendit të mbajtjes së fjalimit, Instituti Pedagogjik i Shkodrës, duke e potencuar një qytet të veriut të Shqipërisë, dialekti i të cilit është përmbysur në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, d.m.th. institucionalizimi i një ngjarjeje propagandistike brenda një teksti shkencor, e nxjerr në pah shkallën e lartë të interferencës eksplicite të autorit. Të gjitha këto elemente gjuhësore shkojnë në favor të subjektivitetit si tipar ideologjik i modalitetit.

Faktualiteti i veprimit si pjesë e modalitetit të zvogëluar epistemik në tekst shprehet gjatë përshkrimit të veprimtarisë së autorëve të vjetër dhe të Rilindësve. Kështu, në fjalitë (244) :

“Kjo vijë e Rilindjes në qëndrimin ndaj fjalëve të huaja, ashtu si edhe në tërë problemin e gjuhës letrare, frymëzoi në vitet e para të këtij shekulli si edhe pas Shpalljes së Pavarësisë, forcat demokratike të kulturës dhe të shkollës shqipe.”. Më pas, ky faktivitet zbehet, sepse folja në të kryerën frymëzoi e bën marrësin (lexuesin apo dëgjuesin) të bindur për idetë e autorit, por faktiviteti është falso, është pseudofaktivitet. Këtë falcitet e bëjnë zgjerimet tematike të foljeve kryesore: nëse folja frymëzoi na lë përshtypje se nuk kemi modalitet në një tekst të caktuar, atëhere foljet hipotaktike, të varura prej saj dhe nuancimet kuptimore të përdorura më pas në shprehjet e tipit: *demagogji, autoritete kuislinge, janë tronditur nga rrënjët, munda t'i shpëtojë*, etj. në vazhdim të fjalisë, shprehin pasiguri modale (shih fjalitë në vazhdim, fq. 244: “Gjuhën e vet amtare populli ynë e mbrojti dhe e shpëtoi duke luftuar me armë kundër fashizmit për të fituar lirinë” ose “autoritetet kuislinge krijuan për demagogji një komision për gjuhën shqipe”). Ose referenca direkte që autori u bën Leninit e Partisë vazhdimisht, flet për një shkallë të lartë të nuancimit kuptimor, kryesisht të përshkruar me shkallë të lartë deontike të autoritetit folës, por me shkallë të ultë të modalitetit epistemik. Në rrafsh të faktivitetit, do të mund të konsiderohej shkallë e dobët (d.m.th ka pak faktivitet) dhe me elemente subjektive.

Në tipin e fjalisë që vazhdon më tutje: “Por në këtë veprimtari rol vendimtar luajnë edhe disa faktorë subjektivë, ...” modaliteti duket të jetë faktik nëse e kemi parasysh trajtën foljore *luajnë rol* në të tashmen, por mbiemri *subjektivë* vetvetiu i jep fjalisë forcë të nuancimit epistemik të shkallës së ultë.

Fjalitë e Lafes që thërasin për veprim dhe që shprehin vullnetin e tij dhe të Partisë për çuarjen e punës deri në fund janë dëshmi të deonticitetit të lartë ideologjik të qëllimit, në formë propozimesh, e që në strukturën e tyre të thellë në të vërtetë janë një lloj detyrimi ose urdhëri për secilin folës të shqipes. Pjesa e propozimeve që i jep autori lidhur me hapat që sipas tij duhet ndërmarrë “për ta vazhduar rrugën e vërtetë të përparimit në këtë fushë”, është përplot shprehjesh modale deontike të insistimit dhe të këshillave për të ardhmen e përdorimit të gjuhës.

Po qe se e krahasojmë këtë studim të Lafes me një studim tjetër të këtij autori me rastin e shënimit të 30 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, 2001), vërejmë se pjesa hyrëse e punimeve të tij përmban më shumë faktivitet dhe e shpreh modalitetin në nivel më të ultë krahasuar me tekstin e vitit 1989. Një dukuri e tillë vërehet sidomos te fjalitë kryesore brenda periudhave me nënrenditje e që kanë të bëjnë me përshkrimin kronologjik të ngjarjeve, si dhe gjatë përdorimit të ligjëratës së drejtë gjatë citimeve që ai ua bën gjuhëtarëve të vjetër me qëllim të arritjes së një simpatie te lexuesi Gegë (si shembull mund ta marrim theksimin e fjalëve të Justin Rrotës krahasuar me fjalimin e Enver Hoxhës në Shkodër).

Por, janë pikërisht fjalitë kushtore të tipit: “Kur të dëgjojmë të thubet gjithnjë e më



*dendur me bërë, me pasur, me shkruar, etj. dhe kur kjo formë të ketë hyrë edhe në gjuhën e shkrimit, nuk do të ketë arsye bindëse që të mos përfshihet edhe në gramatikë, të bëhet element i standardit.”*ato që shprehin një dobësim të qëndrimit folës të autorit krahasuar me fjalitë ku ai mendon se suksesi i gjuhës standarde është i jashtëzakonshëm. Gjuha ideologjike e artikullit të vitit 1989 vazhdon edhe në atë të vitit 2002: derisa në vitet 80të jep sugjerime dhe propozime konkrete të tipit **do të**, në vitin 2002 këto propozime bëhen urdhëra të drejtpërdrejta:

*Zhvillimi i shqipes nuk mund të libet jashtë vëmendjes së një organizmi që të bashkojë kompetencën shkencore me fuqinë urdhëruese (Lafe, 2002: 22).*

Por, ndryshe nga artikulli i parë, i dyti përfaqëson justifikime dhe arsyetime dualistike si përpjekje të qetësimit të zërave nga veriu për futjen e paskajores në standard. Përdorimi i trajtave të modalitetit të ultë epistemik të sigurisë, pra, jofaktualitetit, si dhe dyshimi që ka autori ndaj rezultatit përfundimtar të këtij procesi gjuhësor, e dëshmon një gjë të tillë. Pasiguria e tij për futjen e paskajores në standard shprehet më së miri nëpërmjet të modalitetit epistemik me foljen *mund*. Autori duket se me foljen modale *mund* po e parashton një objektiv me një kushtëzim shumë të fuqishëm subjektiv dhe me një realizim të pasigurtë në të ardhmen.

Po t'i krahasojmë përfundimet e këtyre dy studimeve të Lafes, vërehet qartë se modaliteti me foljen *dubet* kalon në modalitet edhe më subjektiv me foljen *pritet*, ndërkaq kërkesa e drejtpërdrejtë në formë të urdhërit kalon në kërkesë indirekte për përkrahje materiale për jetësimin e dëshirave të brezave të mëparshëm.

Për “mos me u mbetë borxh” edhe gjuhëtarëve të tjerë që kanë shkruar në stilin ala Partia, dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe pas vitit 2000, po i paraqesim dy fragmente nga tekstet e botuara të dy gjuhëtarëve të mirënjohur shqiptarë nga Kosova, rreth çështjes së paskajores, në mënyrë që ta krahasojmë diskursin e tyre dhe të vërejmë se cili prej tyre dominohet nga ideologjia e cili jo, natyrisht në terma të gjuhësisë pragmatike dhe funksionale e jo në terma të purizmit dhe ideve të rrënjosura që nga koha e Partisë dhe shokut Enver. Në fragmentet e tilla janë hijezuar vetëm shprehjet modale që kanë të bëjnë me arsyetimin e mospërfshirjes të paskajores në standardin e shqipes dhe me argumentimin jomodal shkencor të mëvonshëm që i bëhet përfshirjes së saj:

*I Teksti i parë: Në rastin tonë **nuk mund të bëhet fjalë për kurrfarë arbitrariteti apo majoriteti mbi variantin letrar gegë; është vënë në peshore cilësia fonetike dhe gramatikore e të dyja varianteve letrare shqipe dhe.....njohësi shqiptar i dialekteve të shqipe s'ka mundur të mos ta gjente më të pranueshme letrarishten letrare jugore shqipe.***

Pse **gjykimi i tillë** i Këderiqit për gjuhën e njësuar shkrimore shqipe të gjejë vend **makar** edhe te “Dardania Sacra”?

(Ajeti, 2003: 26)

*II Teksti i dytë: Paskajorja me+forma e pjesores pësore e së kryerës është krijuar para formimit të mbiemrit të nyjsbëm, që do të thotë se ishte e tërë shqipes, ashtu si edhe privativi pa+forma e pjesores. Përveç në disa raste tepër të pakta, ku nuk ishin të zëvendësueshme nga njëra-tjetra, lidhorja dhe paskajorja e tillë ishin variante stilistike, të lira. .... E vetmja formë e pjesores që mbeti e barabartë në të dy dialektet është forma e foljeve apofonike në sonante: vjelë, mbjellë, dalë, marrë dhe në ato që përfundonin në –n: lënë, thënë.....(Bokshi, 2011:159 -161)*

### Bibliografia:

1. Badran, D. (2001) 'Ideology through Modality in Discourse Analysis', *The Nottingham Linguistic Circular* **16**: 47-63.  
<http://eprints.nottingham.ac.uk/12216/1/275961.pdf>
2. Bloomfield, L. (1933) *Language*, London: Allen & Unwin.
3. Boyde, J. and J. P. Thome (1969) 'The Semantics of Modal Verbs', *Journal of Linguistics* 5: 57 - 74.
4. Brown, G. and G. Yule (1983) *Discourse Analysis*, Cambridge: Cambridge University Press.
5. Carter, R. and P. Simpson (eds) (1989) *Language, Discourse and Literature*, London: Unwin Hyman.
6. Coates, J. (1983) *The Semantics of Modal Auxiliaries*, London and Canberra: Croom Helm.
7. De Beaugrande, R. (1991) *Linguistic Theory*, London and New York: Longman.
8. Eagleton, J. (1991) *Ideology: An Introduction*, London: Verso
9. Fairclough, N. (1995) *Critical Discourse Analysis: the Critical Study of Language*, London: Longman.
10. Fowler, R. (1986) *Linguistic Criticism*, Oxford: Oxford University Press.
11. Halliday, M. A. K. (1973) *Explorations in the Functions of Language*, London: Edward Arnold.
12. Halliday, M. A. K. (1978) *Language as a Social Semiotic*, London: Edward Arnold
13. Halliday M. A. K. and R. Hasan (1985) *Language, Context, and Text: Aspects of*
14. *Language in a Social-Semiotic Perspective*, Oxford: Oxford University Press.
15. Klein, W. & Levinson S. (eds.) (2006), *Expression of Modality (ECC 1- Expression of Cognitive Categories)*, Mouton de Gruyter, Berlin & New York, 2006

16. Lakoff, R. (1972) 'The Pragmatics of Modality', *Papers from the Eighth Regional Meeting of the Chicago Linguistic Society*: 229-246.
17. Leech, G. (1974) *Semantics*, Harmondsworth: Penguin.
18. Levinson, S. C. (1983) *Pragmatics*, Cambridge: Cambridge University Press
19. Lyons, J. (1977) *Semantics* (Vol. 2), Cambridge: Cambridge University Press
- Mills, S. (1997) *Discourse*, London: Routledge.
20. Paçarizi RR. (2011). Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë. Prishtinë: Pen Qendra
21. Munishi Sh. (2013a). Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe. Prishtinë: Zero Print
22. Munishi Sh. (2013b). Probleme të shqipes standarde në Kosovë. Prishtinë: Zero Print.
23. Palmer, F. R. (1986) *Mood and Modality* , Cambridge. Cambridge University Press.
24. Palmer, F. R. (1990) *Modality and the English Modals*, London and New York: Longman
25. Perkins, M. R. (1983) *Modal Expressions in English*, London: Frances Pinter Publishers.
26. Schiffrin, D. (1994) *Approaches to Discourse Analysis*, Oxford: Blackwell.
27. Searle, J. (1983) *Intentionality*, Cambridge: Cambridge University Press.
28. Simpson, P. (1993) *Language, Ideology and Point of View*, London and New York: Routledge.
29. Van Dijk, T. A. (ed.) (1985) *Handbook of Discourse Analysis*, London: Academic Press.
30. Van Dijk, T. A. (ed.) (1997a) *Discourse as Social Interaction*, London: Sage Publications.



**Aleksandr NOVIK, Rusana HRISTOVA-BEJLERI**

## **SHQIPTARËT E FSHATIT MANDRICA TË BULLGARISË: SHKENCA DHE IDEOLOGJIA**

Fshati Mandrica njihet si i vetmi fshat në Bullgari ku akoma flitet shqip. Për të folmen e Mandricasve janë bërë hulumtime fundamentale linguistike nga studiues bullgarë dhe shqiptarë që në mes të shekullit të XX. Disa gazetarë, shkencëtarë dhe studentë kanë shkruar për ekspedita folklorike, linguistike dhe etnokoreografike gjatë 17 viteve të fundit [Kamberi, Idrizi 1997]. Edhe pse duket se çdo gjë është sqaruar për këtë të folme dhe për banorët e fshatit, projekti i fundit etnolinguistik bullgaro-rus realizuar në qershor të vitit 2014 dëshmoi se akoma ka shumë për të thënë. Diçka më shumë, ka vend për spekulime nga këndvështrimet greke mbi prejardhjen e Mandricasve që janë përkthyer e botuar në gjuhën bullgare përtej kufirit dhe shpërndahen aktivisht gjatë tubimeve të përbashkëta vjetore të banorëve të fshatit që u shpërngulën në Greqi më 1913 me ato që kanë mbetur në Bullgari.

Kumtesa në fjalë ka për qëllim të hedhë vështrim të shkurtër mbi këto rrethana dhe të paraqesë situatën më aktuale sociolinguistike në fshat, e cila shënon një dinamikë të shpejtë.

Është fakt që në çështjen e ruajtjes së identitetit shqiptar në fshatin Mandricë ka katër pika kryesore. Së pari, banorët e Mandricës kanë ruajtur vetëdijen etnike d.m.th. ata e dinë që janë shqiptarë dhe deklarojnë që janë shqiptarë. Së dyti, e folmja e tyre shqiptare flitet deri në ditët tona pas një periudhe mjaft të gjatë të qendrimit në trojet bullgare. Së treti, traditat kulturore në fushën e festave, riteve, zakoneve etj. trajtohen nga vendasit si ato shqiptare (pra, refleksimi i vetëdijes). Së katërti, si një marker i rëndësishëm është ruajtur kostumi tradicional (në radhë të parë kostumi i grave) [Kamberi, Idrizi 1997].

Për sa i përket vetëdijes banorët e fshatit e quajnë veten shqiptarë të Bullgarisë. Në narativat që janë inçizuar nga autorët gjatë punës shkencore në terren më 2014 një nga temat kryesore të tregimeve është historia e mërgimit dhe e themelimit të fshatrave shqiptare në këtë zonë të Ballkanit [AOE: НОВИК 2014: МАНДРИЦА]. Informantët që ruajnë dhe kanë qejf të ritregojnë gojëdhënat për Odisenë e vendasve janë të moshave të ndryshme: të rinjtë, të moshës mesatare dhe të moshuarit. Dhe ky

fakt është shumë relevant.

Fshatrat shqiptare të kësaj zone kufitare bullgare-greke janë themeluar, si mund të konstatojmë bindshëm, në shekullin XVII, d.m.th. në atë kohë kur administrata osmane filloi të qeveriste territoret e shqiptarëve në krahinat juglindore të Shqipërisë së sotme në mënyrë të rreptë dhe të egër. Proceset e islamizimit morën frymë në nivel të lartë në shekujt XVII-XVIII për shkak të fitores përfundimtare të Perandorisë Osmane në asimilimin ekonomik dhe kulturor të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Si pasojë ishte përhapja e fesë së re, rritja e prestigjit të kulturës osmane, gjuhës turke, mënyrës së jetesës, të stilit oriental në artet e zbatuara etj. Është e qartë se në shekujt e para pas zaptimit të Ballkanit (shekujt XIV-XVI) qeveria turke as kishte fuqi as kishte qëllim të asimilonte krejt popullsinë e vendeve të robëruara. Më shumë dobi e shikonte në shfrytëzimin ekonomik të territoreve të shqiptarëve, serbëve, malazezëve etj. Vetëm pas fuqizimit të rëndit të ri administrata osmane filloi aktivitetet e rrepta kundër popullsisë së krishterë. Në këto aktivitetet morën pjesë jo vetëm funksionarët e Portës së Lartë por edhe feudalët vendas që kishin interesat e veta.

Këto procese të islamizimit kishin vend në të gjitha pjesët e trojeve shqiptare, diku ishin më të buta dhe me pasoja minimale, diku ishin shumë të dhunshme dhe kishin pasoja të dukshme themelore. Krahinat e Shqipërisë Juglindore (Korça, Devolli, Kolonja) me popullsi të krishterë dhe me traditën e lashtë kishtarë ortodokse ndodheshin në epiqendër të proceseve të islamizimit. Organet e administratës vendase me përkrahjen shtetërore filluan të zbatonin politikën e diskriminimit të të krishterëve. Shumë fshatra me tërë popullsinë ishin dëbuar nga fushat në rajonet malore kurse tokët e tyre ishin propozuar myslimanëve të kësaj zone (kështu për shembull ndodhi në fshatin Baban të Devollit në të cilin deri në ditët tona të moshuarit tregojnë histori për përhapjen e Islamit në shekullin XVII dhe për ndërrimin e fesë me dhunë) (materialet e ekspeditës së vitit 2011) [АМАЭ: Новик 2011А; АМАЭ: Новик 2011Б].

Në këto rrethana historike një pjesë e popullsisë shqiptare të krahinës së Korçës ka ikur në rajonet kufitare bullgare-greke. Këtu në afërsi të rrugës së rëndësishme Sofje-Selanik është themeluar fshati i Mandricës. Në vitet 1912-1913 turqit kanë djegur në këtë zonë dy fshatra bullgare dhe pjesa e popullsisë së Mandricës ka ikur në territorin e Greqisë së sotme dhe kanë themeluar dy fshatra: Mandres (emri tjetër Kota) dhe Zangliver [АМАЭ: Новик 2014: 20, 25, 92] ku banorët edhe në ditët tona deklarojnë që janë shqiptarë dhe përfaqësojnë shumicën e popullsisë në këto vendbanime. Kështu në këtë zonë kufitare janë themeluar 3 fshatrat shqiptare një prej të cilëve ndodhet në territorin e Bullgarisë (të tjerat janë në territorin grek për shkak të ngjarjeve të fillimit të shekullit XX) por këto fshatra kanë një zanafillë [АМАЭ: Новик 2014: 20, 25, 92]. 7 fshatrat arnautë janë themeluar në territorin e Turqisë së sotme (këto të dhëna tregohen nga informantët tanë në Mandricë si njohuri nga paraardhësit

e tyre) [AMAÐ: НОВИК 2014: 25].

Sipas gojëdhënës popullore shqiptarët e Mandricës kanë prejardhje nga fshati Vithkuq të krahinës së Korçës. Për këtë është ruajtur bile edhe një barcoletë.

*Tokët e lëruara në Vithkuq kanë ngjyrë të kuqe. Si e dimë ne atje në Korçë ka shumë bekur në dhe [narrativi i informantes me shkollë të mesme d.m.th. me njohuri gjeografike – A.N.]. Një hërë një burrë shkoi në qytet [me siguri Korçë – A.N.] dhe u ul në tokë anës rrugës për të pushuar. Ishte veshur në tirqe të bardha si kishte zakon në këtë zonë. Kur u ngrë nga toka nuk vuri re se tirqit i ishin ngjyrosur shumë. Dhe vazhdoi në qytet. Kur erdhi në pazar të gjithë të pranueshëm vunë re tirqit e tij të ngjyrosura dhe filluan së qeshuri: “Vithet e kuqe!” Nga ai rast fshati i tij e ka emrin Vithkuq. Paraardhësit tanë ishin nga ai vend nga Vithkuqi.*

[AMAÐ: НОВИК 2014: 94].

Menjëherë pas ardhjes në Bullgari në fshatin Mandricë janë ndërtuar kishat ortodokse (kisha e Shën Mitrit dhe kisha e Shën Së Dieles) që konsiderohen në ditët tona si pika kryesore të hapësirës arkitektonike të kësaj zone rurale. Kisha e Shën Mitrit ndodhet mu në qendër të Mandricës dhe është objekt kryesor fetar në të cilin mbliidhen gjithë fshatarët dhe njerëzit nga fshati që jetojnë në qytete ose jashtë shtetit për festat e krishtera gjatë vitit. Në oborrin e kishës janë varrosur priftërinjtë dhe banorët e Mandricës që ishin donatorë të mirëfilltë të shpenzimeve për aktivitetet kishtare ose shoqërore në shekujt XIX-XX.

Kisha tjetër, kisha e Shën Së Dieles, ndodhet në varrezat që janë në periferi të fshatit pak në mal. Kjo kishë në formën e bazilikës konsiderohet ndër vendasit si kisha më tradicionale dhe bile më e rëndësishme. Në këtë kishë shërbehen meshat gjatë varrimit të bashkatdhetarëve. Sipas traditës së fshatit meshkujt dhe femrat rrinin veç a veç gjatë meshave, për këtë arsye hapësira e ndërtesës është organizuar në formën e bazilikës së ndarë në tre pjesë: pjesa e altarit, pjesa ku rrinin meshkujt, dhe pjesa për femra. Rëndësi ka që banorët e Mandricës e lidhin këtë veçori të organizimit të jetës kishtare më traditën shqiptare (është fakt se në përgjithësi ortodoksët luten në një sallë të kishës, mundet sipas rregullave patriarkale në qoshe të ndryshme të hapësirës së kishës por jo në dhoma të ndryshme si puna e kishës së Së Dieles në Mandricë). Në kohën moderne ky zakon nuk ekziston më – banorët e Mandricës, jo të moshuar, jo të moshës mesatare, jo të rinj – luten në një dhomë të kishës ku më parë bile edhe pas Luftës së Dytë Botërore luteshin vetëm meshkujt.

Gjëja më e rëndësishme e cila dallon banorët e Mandricës nga fqinjët e tyre është gjuha. Mandricasit ruajnë të folmen e tyre arkaike dhe e konsiderojnë si pasuri të dukshme të trashëgimisë së tyre. Kryesorja është se ata të Mandricës konstatojnë

faktin që janë shqiptarë (shqiptarë të Bullgarisë) dhe jo grekë shqipfolës si mund të gjejmë në botime të angazhuara (nga një anë) [Μαϊκίδης 1972; Μαϊκίδης 1985-1986; Μαράβελάκη, Βακαλόπουλου 1993]. E folmja e shqiptarëve të Mandricës është arkaike dhe ky fakt ka shpjegim shkencor dhe objektiv: paraardhësit e mandricasve kanë ikur nga trojet shqiptare që në shekullin XVII dhe kanë ruajtur gjuhën e tyre në atë formë në të cilën ajo ka ekzistuar dhe funksionuar në krahinën e Korçës në atë periudhë. Pas shpërnguljes e folmja e tyre është ngulitur në formë arkaike – dukuri të tilla mund të gjejmë në shumë vende të botës ku kanë pasur vend mërgime të popullatës.

E folmja e shqiptarëve të Mandricës është përshkruar në vitet 1970 – 1980 nga gjuhëtarja bullgare Bojka Sokollova (libri i saj “Die Albanische Mundart von Mandrica” është botuar në gjermanisht si numër i veçantë në serinë periodike “Balkanologische Veröffentlichungen”<sup>1</sup> pas shumë viteve të studimit) [Sokolova 1983]. Deri në ditët tona ky libër konsiderohet në botën shkencore si përshkrimi më i përkushtuar i së folmes së Mandricës. Por pas studimeve në terren të linguistes bullgare Bojka Sokollova kanë kaluar shumë vite. Bile edhe monografia e Bojkës Sokollova mungon në bibliotekat e Bullgarisë, ato disa kopje që janë në disponim të shkencetarëve ndodhen në bibliotekat e Gjermanisë, Ruisë dhe vendeve të tjera. Ekspeditat shkencore që ishin organizuar nga specialistët e Universitetit Shën Kliment Ohridski (Sofje) në vitet e fundit kishin pasur sukses në mbledhjen e materialeve gjuhësore dialektore por deri sot këto materiale nuk janë transkribuar dhe botuar. Autorët kanë shpresë të madhe që kjo punë do përfundohet me botimin e materialeve të inçizuara.

Ekspedita jonë e vitit 2014 ishte shumë e suksesshme nga pikëpamja e mbledhjes së materialeve si etnografike edhe linguistike. Për të bërë konkluzione të sakta shkencore na duhet një analizë të zellshme dhe kjo punë do të marrë jo pak kohë. Tani për tani mund të themi vetëm disa gjëra për tiparet e së folmes së Mandricës që janë tejet të dukshme për karakterizimin e sistemit gjuhësor [AOE: Новик 2014: Мандрица].

E folmja shqipe e Mandricës është arkaike nga pikëpamja e morfologjisë, leksikut dhe të sintaksës [Sokolova 1983]. Sistemi fonetik i së folmes ka pësuar ndikim të fortë të bullgarishtes. Megjithatë e folmja e Mandricës ka ruajtur tingujt që janë karakteristikë për zonën e Vithkuqit dhe për krahinën e Korçës në përgjithësi. Ajo ruan format e fjalëformimit që i përkasin sfondit të shqipes së zonave toske të Shqipërisë Juglindore. Duke bërë krahasime me të folmen e shqiptarëve të Ukrainës

<sup>1</sup> “Balkanologische Veröffentlichungen” kanë dalë 1979 – 1993 në Osteuropa-Institut an der Freien Universität Berlin (kryeredaktor Norbert Reiter).



(fshatrat Zhovtnevoe, Gamovka, Devninskoe, Georgievka) mund të supozojmë se ajo e Mandricës është më moderne d.m.th. i përket periudhës më të re të zhvillimit dhe funksionimit të gjuhës shqipe se sa e folmja e shqipes së Ukrainës. Pa tjetër duhet të përgatitet një studim krahasimtar të së folmes së Mandricës, së folmes së shqiptarëve të Ukrainës dhe të të folmeve të Shqipërisë Juglindore (ato të fundit janë analizuar në studime të kolegëve tanë shqiptarë dhe rusë, na duhet të përmendim këtu Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, botim i përbashkët të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Universitetit të Napolit, Itali) [ADGJSH 2007; ADGJSH 2008].

Marker i rëndësishëm i identitetit shqiptar të fshatit Mandricë janë festat e krishtera që mbledhin pothuajse tërë komunitetin shqiptar. Për festat vijnë familjarët, fqinjët, miqtë nga qytetet përreth dhe nga vendet e largëta. Çdo vit në verë në Mandricë organizohet tubimi i banorëve të fshatit dhe të shqiptarëve që u shpërngulën në Greqi më 1913 për shkak të ngjarjeve luftarake. Ky aktivitet konsiderohet si një nga më të rëndësishmet në jetën shoqërore të fshatit. Për të marrë pjesë në këtë festë vijnë shqiptarët që jetojnë në Greqi në fshatra të themeluara pas shpërnguljes (në fakt janë 2 fshatra). Mandricasit konsiderojnë atdhetarët si njerëz të afërt që flasin në një gjuhë dhe nderojnë dhe vazhdojnë traditat e stërgjyshërve.

Në këtë plan të studimeve tona ka shumë rëndësi të përmendim edhe kostumin tradicional të shqiptarëve të Mandricës. Deri në ditët tona gratë e moshuara ruajnë në syndyqe veshjet e nënave dhe gjysheve të tyre. Përdorimi i materialeve, stofrave, gajtaneve në prodhimin e veshjeve, prerja e detajve, zbukurimi dekorativ i kostumeve etj. na dëshmojnë për vazhdimësinë e traditës në këtë fushë dhe mund të vërejmë paralele me atë të zonës së Korçës. Është realitet se në ditët tona janë ruajtur vetëm kostumet e grave. Kjo dukuri fiksohet edhe ndër shqiptarët e Ukrainës dhe arbëreshët e Italisë (në fakt edhe ndër grupe të ndryshme të popullit shqiptar në Ballkan, dhe kjo situatë shpjegohet me faktin e pjesëmarrjes aktive të meshkujve në jetën shoqërore, me udhëtime, me kurbet ashtu më radhë dhe me jetën deri diku patriarkale të femrave që jetonin tërë jetën në fshat më parë në shtëpinë e babait dhe më vonë në atë të burrit). Për këtë arsye veshjet e grave janë ruajtur në kulturën tradicionale shumë më mirë se sa ato të burrave.

Në vitet e fundit vërejmë zhvillim të dukshëm të interesit nga ana e shqiptarëve të Mandricës ndaj historisë, së folmes, traditave të veta. Në këto rrethana janë aktivizuar gjithashtu përpjekjet e politikanëve, shkencëtarëve të angazhuar, të injorantëve të revizionojnë realitetin. Kështu janë botuar dhe shpërndahen falas librat në të cilët shpjegohet se grupi etnik i shqiptarëve të Bullgarisë “në fakt janë grekë shqipfolës” [Μαϊλίδης 1972; Майкидис 1972; Μαϊλίδης 1985-1986].

Është fakt se në shumë studime të sotme faktet dhe dukuritë konkrete dhe

objektive zëvendësohen me falcifikime ideologjike që kanë të bëjnë në radhë të parë me politikën dhe interesat e shtresave konkrete dhe jo me realitetin objektiv. Prandaj shkencën dhe këndvështrimin shkencor duhet të jenë të pavarur në studime, në analizë dhe në prezantim të të dhënave që hulumtohen në terren.

### **Burimet dhe literatura:**

#### **Arkivat:**

#### **Arkivi i Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë të Akademisë së Shkencave të Rosisë:**

1. АМАЭ: Новик 2011А – *Новик А.А.* Тоскерија – 2011. Изучение традиционной культуры албанцев Тоскерији (области: Корча, Колёнья, Дэвол), черногорцев Черногории, сербов Черногории. Полевая тетрадь. Ксерокопия. Сентябрь 2011. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2049. 123 л.
2. АМАЭ: Новик 2011Б – *Новик А.А.* Отчет об экспедиционных исследованиях в Тоскерији (Албания) в сентябре 2011 г. Принтерный вывод. Сентябрь 2011. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. № 2050. 11 л.
3. АМАЭ: Новик 2014 – *Новик А.А.* С. Болгария. Часть I: С. Мандрица. Изучение традиционной культуры и языка албанцев Болгарии (область Хасково). Полевая тетрадь. Май – июнь 2014. Архив МАЭ РАН. К-1, оп. 2. 6/н. 96 л.

#### **Arkivi i Departamentit të Europeistikës të Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë të Akademisë së Shkencave të Rosisë:**

АОЕ: Новик 2014: Мандрица – *Новик А. А.* Мандрица. Цифровая аудиозапись. 2014 // Архив отдела европеистики МАЭ. Мандрица. 2014. Новик А.А.

#### **Bibliografia:**

1. Майкидис 1972 – *Майкидис, Апостолос А.* Мандрица. Бележки – Спомени – Традиции. Солун, 1972.
2. ADGJSH 2007 — Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. (Gjinari J., Beci B.,

- Shkurtaj Gj., Gosturani Xh). Vëllimi I. Napoli: Universita degli studi di Napoli l'Orientale; Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë. 464 f.
3. ADGJSH 2008 — Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. (Gjinari J., Beci B., Shkurtaj Gj., Gosturani Xh). Vëllimi II. Napoli: Universita degli studi di Napoli l'Orientale; Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë. 602 f.
  4. Kamberi, Idrizi 1997 – *Kamberi, Alush; Idrizi Muharrem*. Katër shekuj të pagjunjësuar. (Shqiptarët e Mandricës). Tetovë: Konica, 1997. 129 f.
  5. Sokolova 1983 – *Sokolova, Bojka*. Die Albanische Mundart von Mandrica // Balkanologische Veröffentlichungen. 1983 / VII / Hrsg. von Norbert Reiter. 232 Seiten.
  6. Μαραβελάκη, Βακαλόπουλου 1993 – *Μαραβελάκη Μ., Βακαλόπουλου Α.* Οι προσφυγικές εγκαταστάσεις στην περιοχή Θεσσαλονίκης. Ανατύπωση Εκδόσεις Βάνιας. Θεσσαλονίκη, 1993.
  7. Μαϊνίδης 1972 – *Μαϊνίδης, Απόστολος*. Μανδρίτσα. Η κωμόπολις που έσβησε. Σημειώσεις - Αναμνήσεις - Παράδοσις. Θεσσαλονίκη, 1972.
  8. Μαϊνίδης 1985-1986 – *Μαϊνίδης, Απόστολος*. Η βιοτεχνία στη Μανδρίτσα Αν. Θράκης. Θρακική Εστία Θεσσαλονίκης. Ημερολόγιο- Λεύκωμα, 4, 1985-1986.



**Mimoza KORE**

## **NDIKIME IDEOLOGJIKE NË ÇËSHTJE TË HISTORISË SË GJUHËS**

### **Abstrakt**

Në këtë punim jemi përpjekur të faktojmë raste të ndërhyrjeve ideologjike, veçanërisht atyre nacionaliste në trajtimin e çështjeve të historisë së gjuhës. Sado të shtyra në kohë të jenë faktet që bëhen objekt studimi në këtë fushë, përsëri mungesa e dokumentacionit, krijimi i trajtave të supozuara, kanë bërë që edhe kjo fushë e studimit të gjuhës, dikur, por edhe sot të mos jetë “e lirë”. Kjo disiplinë gjuhësore ka qenë shpesh subjekt i një shumëllojshmërie ndikimesh e mendimesh, në shumë raste të drejta, e në disa të tjera, jo shkencore, objektive e të dobishme. Duke qenë se në historinë e gjuhës trajtohen çështje madhore si prejardhja e popullit dhe e gjuhës që flet ai, marrëdhëniet me gjuhët fqinje e të një areali më të gjerë etj, kjo ka bërë që me objektin e kësaj discipline të jenë të lidhura edhe interesat e një shoqërie të caktuar, e cila në shumë raste është ushqyer me mite dhe ideologji.

Historia e gjuhës, për vetë objektin e saj të studimit, është një disiplinë që përfshin një periudhë të shtrirë nga prehistoria, nga e cila mungojnë dëshmitë e shkruara, e deri në ditët e sotme. Ajo ngjan siç thoshte prof. E. Çabej si hallkat e nje zinxhiri të këputur aty-këtu që duhen rindërtuar. Por ky rindërtim kërkon objektivitet shkencor, intuitë dhe integritet prej studiuesit. Pikërisht aty ku duhet të ngjiten këto hallka të padokumentuara që të krijojnë vijimësinë gjendet edhe shtegu për ndërhyrje jo shkencore e të gatuar shpesh me ideologji. Po a ka pasur ndikime prej ideologjive të ndryshme në çështjet e historisë së gjuhës shqipe apo kjo fushë studimi ka qenë e mbrojtur prej tyre?

Historia e gjuhës është pjesë e shkencave shoqërore të cilat kanë qenë gjithmonë nën presionin ideologjik dhe politik të regjimit të kohës, pre e kuturisjeve antishkencore e diletante ku shpesh është ndërhyrë edhe qëllimisht si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Megjithatë, ndryshe nga shumë fusha, mund të themi se historia e gjuhës ka qenë disi më e mbrojtur, por jo krejtësisht e lirë. E themi këtë sepse kemi qenë dëshmitarë të ndryshimeve rrenjësore që pësuan shkencat shoqërore pas rënies së sistemit komunist. U panë me sy kritik, u përmbysën dhe u reformuan shumë nga

studimet, tekstet, teoritë, literatura e përdorur në fushat e shkencave shoqërore, por nuk pamë të ndodhte ndonjë ndryshim i thellë në studimet e historisë së gjuhës shqipe, veçanërisht në thelbin e teorive bazë të kësaj fushe. Kjo erdhi për disa arsye:

*Së pari*, sqarimi i problemeve të kësaj fushe studimi kërkon njohuri të gjera dhe përgatitje filologjike të mirë të studiuesit. Kjo ka bërë që me çështjet e historisë së gjuhës të merren studiues seriozë, të cilët të mbështetur në metoda shkencore rigorozë kanë arritur në përfundime të drejta që nuk lejojnë ndërhyrje as nga studiues diletantë e as nga ndikimet ideologjike.

Me problemet themelore të kësaj fushe si ato që kanë të bëjnë me etnogjenezën e popullit shqiptar, me origjinën e shqipes dhe autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre, me marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera gjatë shekujve me evolucionin e sistemit fonetik e gramatikor të shqipes u morën fillimisht alabanologë të huaj, shkencëtarë që hapën e shtruan rrugë në këtë fushë studimesh, si G.Von Hahn, N. Jokli, G. Meyer, H. Pedersen etj e që më tej në të ecën studiues shqiptarë po aq të përgatitur, si A. Xhuvani, I. Ajeti, E. Çabej, S. Riza, Sh. Demiraj, B. Bokshi, R. Ismajli, S. Mansaku etj.

*Së dyti*, argumentet e historisë së gjuhës u mbështetën edhe nga studiuesit e historisë dhe të arkeologjisë. Edhe në këto fusha, autoriteti shkencor, integriteti intelektual e qytetar i studiuesve me në krye prof. A. Budën, H. Cekën, K. Frashërin e të tjerë nuk lejuan ndërhyrje ideologjike e politike.

*Së treti*, edhe pse kjo fushë e dijes u zhvillua në vendin tonë në vitet e diktaturës, kohë gjatë së cilës dhuna dhe ndërhyrjet politike edhe në shkencë nuk njohën kufi, përsëri historia e gjuhës ishte disi e mbrojtur sepse, siç pohon S. Mansaku, vetë fusha e kërkimeve, studimi i evolucionit historik të gjuhës, kryesisht në periudhën antike e mesjetare deri në Rilindje, nuk ka qenë afër problemeve aktuale të politikës së ditës. Problemet më themelore të kësaj fushe [...] mund ta bënin studiuesin që të rrëshqiste më shumë drejt qëndrimeve nacionaliste sesa drejt politizimeve të mirëfillta. Do të duhej një zell i tepruar politik i studiuesit për të futur politikën e ditës në trajtimin e evolucionit historik të tingujve të shqipes dhe të kategorive gramatikore të saj.<sup>1</sup>

Duke i parë çështjet e historisë së gjuhës sipas rendit kronologjik do të jepnim më poshtë ndonje konsideratë të shkurtër për problemin që po shqyrtojmë.

Gjuha shqipe pasi u përcaktua nga F. Boppi si gjuhë e familjes i.ev. për një periudhë bukur të gjatë mbeti jashtë vëmendjes së studiuesve të huaj, të cilët në kuadrin e studimeve për indoevropianishten nuk iu referuan, për kushedi ç'arsye,

<sup>1</sup> S.Mansaku, *Objektivitet shkencor dhe qëndrim kombëtar në veprën e Eqrem Çabejt*, në "Studime filologjike shqiptare" Konferencë shkencore 21-22 nëntor, organizuar nga Akademia e Shkencave e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2007, botuar në përmbledhjen me të njëjtin titull, Prishtinë, 2008, f.71-72, Kosovë.

njërës prej gjuhëve më të veçanta të kësaj familjeje gjuhësore. Më 1964 M. Domi, në artikullin “Shqipja dhe struktura e saj gramatikore” botuar në Paris më 1966, duke theksuar se nuk mjafton vetëm leksiku, por shqipja ka edhe elemente themelore të sistemit gramatikor që lidhen me indoevropianishten, vëren me shqetësim se: “Me gjithë punën e lavdërueshme që është bërë në studimin e shqipes dhe rezultatet e shënuara që janë arritur, nuk mund të thuhet që gjuhësia krahasuese historike i.e.v i ka kushtuar asaj vemendjen e duhur, përkundrazi, shqipja nuk ka gjetur vendin që i takon si përfaqësuese e vetme e një grupi gjuhësh; të dhënat e saj janë përdorur pak nëpër manualët dhe traktatet përgjithësuese për gjuhët indoevropiane”. Ky arsyetim shkon edhe pas shqetësimit të N. Joklit më parë se “Gjuha e shqiptarëve deri më sot ka mbetur si një fëmijë i gjetur për gjuhësinë i.e.v”, apo të C. Tagliavinit më vonë: “Indoevropianistët vazhdojnë ta trajtojnë shqipen si hirushen e gjuhëve i.e.v”.

Problemi i prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre është një nga pikat ku mbizotëron ideologjia nacionaliste. Formimi i etnosit shqiptar ose gjeneza e shqiptarëve mbetet një nga enigmat më joshëse të historisë së lashtë të Ballkanit. Në këtë mes vështirë se mund të dalim nga fusha e hipotezave. Kjo u vu re sidomos në periudhën e Rilindjes gjatë së cilës kërkimi i rrënjëve historike u pa edhe si mjeti që i shtonte madhësi të kaluarës dhe fisnikëri legjitimitetit të një populli për të mbijetuar. Kjo retorikë përmbushte një mision të caktuar ideologjik<sup>2</sup>, por e gjykuar nga pozita nacionaliste ishte mision patriotik, sepse kërkonte bashkimin e shqiptarëve të cilët kishin një komb, por jo një shtet të tyrin. Formimi i shtetit dhe ndërtimi i kombit përfaqësojnë dy procese të ndryshme, të cilat, në Evropë, shpesh u mbivendosën<sup>3</sup>. Ndërsa në Evropën Perëndimore formimi i shtetit, përgjithësisht, i parapriu ndërtimit të kombit, në shumicën e rajoneve të Evropës Qendrore dhe Lindore ndërtimi i kombit u arrit para formimit të shtetit. Në vendet perëndimore, populli nën ndikimin e shtetit dhe të ligjeve të tij, formoi për shekuj edhe një ndërgjegje kombetare, kurse në vendet e Evropës Lindore e veçanërisht në Ballkan, shtetet u krijuan si rezultat i proceseve identifikuese kombetare, i veçimit sa të ishte e mundur dallues nga të tjerët. Duke qenë se gjuha është edhe mjeti më identifikues, kombet e shtetet më vonë, me ndonjë përjashtim, u organizuan sipas parimit të *gjuhës kombëtare*.

Edhe shqiptarët krijuan së pari kombin e tyre e pastaj shtetin. Gjatë periudhës së Rilindjes zuri vend ideja se kombi ka në bazën e tij gjuhën kombëtare, e cila shihej si faktor i ngjizjes sociale. “Nëse do të përpiqeshim ta përcaktonim Epokën e Rilindjes Kombëtare nga pikëpamja gjuhësore, besoj se nuk do të gabonim të thoshim se ajo

<sup>2</sup> D. Egro, Historia dhe ideologjia, Tiranë, 2007, f.60

<sup>3</sup> Urs Altermatt, “Language and Nation: Is Switzerland a Model for Europe?” NATION AND NATIONAL IDEOLOGY PAST, PRESENT AND PROSPECTS In the International Symposium held at the New Europe College, Bucharest, April 6-7, 2001, f. 323v 24

është epoka që e bëri gjuhën pjesë të pandarë të ndërgjegjes kombëtare, faktorin më të rëndësishëm në lëvizjen për bashkimin dhe pavarësinë e vendit dhe për përparimin shoqëror të tij, është epoka që dashurinë, kujdesin dhe nderimin për gjuhën, për lashtësinë, veçantinë dhe bukurinë e saj i ngriti në shkallën e një kulti të vërtetë [...]”<sup>4</sup>.

Ishin intelektualët e kësaj periudhe që propaganduan edhe mitin e lashtësisë për të mbështetur aspiratat nacionale. Ideatori i kësaj lëvizje të madhe në historinë tonë, Sami Frashëri në librin e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, botuar më 1899 në zërin *Shqiptarët në Kamusul* – lam vell. I, f. 143-148 pohon se në vazhden e mësimëve të Hahnit, Boppit, princshës Dora d’Istria, Kamardës e De Radës arrihet në përfundimin: “Pa dyshim Pellazgët janë kombi më i vjetër arian i Europës. Ka shumë fakte dhe shumë rrëfime që na tregojnë se Pellazgët që ne na duken si një përrallë për faktin që janë një komb shumë i lashtë, kanë folur këtë gjuhë që flasim edhe ne sot e kësaj dite. Emrat e perëndive që Pellazgët u faleshin, i ka huazuar mitologia e grekëve dhe romakëve, por edhe shumë fjalë të tjera që historia i ka ruajtur si emra vendesh etj,.. duken që janë fjalë thjeshtë shqip edhe na tregojnë që Pellazgët kanë folur mijra vjet më parë të njëjtën gjuhë që flasim edhe ne sot, pothuajse pa ndryshime, ose me aq pak ndryshime saqë po të dilte ndonjë pellazg do të mund të flisnim me të si flet një gegë me një toskë.”

Edhe Naim Frashëri, për t’i mbrytur shqiptarët me idenë kombëtare, e përdori këtë tezë të origjinës pellazgë dhe shkroi ndër të tjera edhe vjershën e njohur “Shqipëria”, që nis me vargjet: Bota që kur është zënë / Shqipëria gjallë ka qenë / Pellazg’ u thoshin më pare / Më së fundi shqiptarë.

Kjo ideologji romantike që zotëroi gjithë këtë periudhë nuk e pengoi ideologun e madh, Samiun, të arrinte në përfundime shkencore të drejta, të cilat duke i shkëputur nga konteksti pellazgik janë aktuale: “Nuk ka asnjë dyshim se ilirët janë vetëm etrit e shqiptarëve të sotëm” dhe më tej: “Ndonëse ngjarjet që kanë ndodhur qysh prej dy mijë vjetëve në thelb janë të shkruara, nuk mbahet mend që në viset e Shqipërisë të ketë ardhur ndonjë popull tjetër dhe të jetë vendosur aty”<sup>5</sup>

Nga dëshmitë e profesorëve tanë, mësojmë se edhe gjatë viteve ’50-’60 u ringrit nga udhëheqja e kohës çështja e pellazgjishtes, sepse është i njohur fakti që diktaturat, historinë kombëtare e kërkojnë të “pastër”, “origjinale” e për nga vlerat të mos ketë krahasim me të tjerët. Kjo na kujton thënien e studiueses bullgare M. Todorova, “Elita politike komuniste historinë e konsideroi si politikë të kthyer pas në kohë”<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Seit Mansaku, Probleme të historisë së gjuhës shqipe në veprën e Sami Frashërit, PERLA, Revistë shkencore – Kulturore tremujore, Viti IX 2004 Nr. 2 (33) fq. 98-104

<sup>5</sup> Shih: S. Frashëri, *vep. cit.*, f.247.

<sup>6</sup> M.Todorova, ‘Historiography of the Countries of Eastern Europe: Bulgaria,’ *American Historical Review*, vol. 97. No. 4, October 1992, p.1109.



Gjuhëtarët nuk u joshën nga kjo tezë e cila ka shumë të panjohura dhe që më së shumti mund të jetë objekt i helenistikës dhe jo i albanologjisë. Profesor E. Çabej e kishte dhënë prerë përgjigjen për këtë çështje gjatë analizës së teorisë së G. V. Hahnit: “[...]teza e një prejardhje pellazgjike të ilirëve, maqedonasve dhe epirotasve nuk ka mundur t’i qëndrojë kohës”<sup>7</sup>

Edhe në ditët e sotme është ringjallur diskutimi për këtë çështje, veçanërisht në shkrime divulgative. Hapja ndaj botës, inferioriteti në disa raste, ka bërë që shumë pseudostudies të struken tek e rrënjët e largëta e të trillojnë gjithëfarë bashkëpërkimesh leksikore. Kurthe të tilla ngre e ashtuquajtura “metodë etimologjike”, d.m.th. krahasimi i fjalëve të shkëputura me tingëllim të ngjashëm, të dy gjuhëve të ndryshme dhe vendosja e lidhjeve gjenetike ndërmjet tyre. Kemi vënë re se këtë e nxit edhe fakti i mungesës së koherencës në tekstet tona mësimore, kur në ndonjë rast (libri i historisë kl.VI) historianët flasin për prejardhjen pellazgjike, kurse gjuhëtarët e nisin argumentin nga ilirët.

Në studimet tona historike duket se historianët po i rikthehen te ashtuquajturës tezë pellazgjike duke i bërë koncesion asaj edhe me kthimin në teorinë e lidhjes ballkanike e anatolike. Siç vëren prof. R. Ismajli “Diskutimi ekziston dhe Çabej ka një kontraverzë gjysmë të heshtur me arkeologët dhe historianët. Edhe Buda që gjithandej ndjek mendimin e Çabejt, kur vjen këtu thotë se kishte ‘edhe lidhje anatolike’”<sup>8</sup>

Sot ka një prirje të re që vjen kryesisht nga jashtë për të vënë përsëri në diskutim si të dyshimtë tezën e prejardhjes nga ilirishtja, duke e interpretuar si dogmë të pushtetit, “si klishe e pëlqyer në literaturën divulgative, por edhe në librat shkencorë për historinë apo ata për historinë e gjuhës. Hipoteza e zanafillës ilire të shqiptarëve është shumë e pëlqyer sidomos në Shqipëri, ku ajo funksionon si ngjizëze e identitetit dhe ka fituar plotësisht statusin e një doktrine shtetërore”<sup>9</sup>

Sot, në kushtet e reja politike të krijura në shtetet ku jetojnë shqiptarë, besojmë se shkenca është e lirë të interpretojë me objektivitet dhe paanshëmëri faktet e reja shkencore që do të dilnin në dritë në të mirë të kësaj çështjeje, por gjer më sot nuk kemi parë ndonjë argument që të rrëzojë bindshëm tezën e prejardhjes ilire, e cila nuk është vetëm objekt i historisë dhe i historisë së gjuhës, por edhe i arkeologjisë, etnografisë madje edhe i gjenetikës e që në këtë pikë janë në një emërues të përbashkët.

Një çështje tjetër që duam të trajtojmë këtu, është edhe qëndrimi ndaj

<sup>7</sup> E.Çabej, Studime gjuhësore, Prishtinë, 1976.

<sup>8</sup> R. Ismajli, Diskutime për prejardhjen e gjuhës shqipe, në Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 32/1, f. 22

<sup>9</sup> J. Matzinger, Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi I gjuhësisë historike, në Historia e shqiptarëve, “përpyekja”, Tiranë, 2012, f.13

huazimeve. Për qëndrimin që kanë mbajtur shqiptarët ndaj tyre, veçanërisht atyre që vinin prej turqishtes, është folur mjaft dhe është vlerësuar si një qëndrim krejtësisht i përiligjur në atë kohë kur rilindësit e mëdhenj po luftonin për mbrojtjen e ndërgjegjes sonë kombëtare, madje edhe pse purizmi i tepëruar është kritikuar edhe nga ndonjë albanolog i huaj si N. Jokli<sup>10</sup> apo P. Skoku<sup>11</sup>. Duke ecur në këtë vazhdë, studimet e historisë së gjuhës shqipe, por edhe të historisë në përgjithësi mund të themi se janë dëmtuar kur me të njëjtin sy të njerks dhe me po të njëjtin qëndrim nënvleftësues janë trajtuar edhe tekstet me alfabet arabo-turk, të cilat në shumë raste edhe janë asgjësuar duke humbur bashkë me to mundësia e ndriçimit të fakteve historike e gjuhësore. Kjo ka ndodhur si në Shqipëri<sup>12</sup>, por edhe në Kosovë e që siç vëren I. Ajeti “Kundrejt kësaj trashëgimie gjuhëtarët shqiptarë e të huaj pas mendimit tonë, kanë mbajtur qëndrim në mos përbuzës, indiferent po sigurisht”<sup>13</sup>

Por do të donim të kujtonim se ideologjitë nacionaliste që ndeshen në Ballkan kanë anashkaluar qëllimisht edhe huazimet që shqipja iu ka dhënë gjuhëve fqinje. Këtë e kish vërejtur edhe E. Çabej (Studime gjuhësore, VII, 282) kur thoshte: “Nuk mund të mos thuhet që ka pasur dhe ka edhe sot një prirje të ngritur vise-vise në një traditë që të mos gjykohet ndikimi shqiptar mbi gjuhët fqinje në përmasat e drejta”

Po kështu tejet të ideologjizuara, duke kapërcyer të vërtetën objektive e duke manipuluar rregullat fonetike janë shpjegimet etimologjike të toponimeve, prej disa gjuhëtarëve të huaj. Le të përmendim këtu: Scup (=Shkup Maqedoni), Skardos (=Shar) apo Gardhiqi, Kriekuqi, Hundëkuqi<sup>14</sup>, të cilat ndonjë gjuhëtar sllav i shpjegon me sllavishten e jo me shqipen e që me të drejtë I. Ajeti ia nënshtron analizës kritike. “Dihet me siguri se bazat për një ndikim shumëduarsh të shqipes në gjuhët e tjera të

<sup>10</sup> "Purizma, -fillon Profesor Jokli-, që shihet ndër disa botime shqipe nuk më duket e arsyeshme. Sidomos mënia kundër fjalëve tyrqishte është shumë e përhapur ndër juve. Është e vërtetë se në të kaluemen keni patur shumë arsëyena të urrenit çdo send që kishte lidhje me Tyrqin e vjetër. Ishte gjë fare e natyrshme që deri sa luftonit për Pamvarësinë t'uej, të quhej si një shfaqje patriotizmi lufta kundër çdo të mbeture të sundimit të huaj. Por tani që keni njëzet e pesë vjet jete të pamvarur, tani që me Tyrqin e përtrimun jetoni si miq të mirë, është koha të bëheni pak ma objektivë..." (Marrë nga revista "Përpjekja shqiptare", 1938, nr. 13 (Janar) f. 45-46. (Janë ruajtur veçoritë gjuhësore të origjinalit)

<sup>11</sup>“Zgjidimi i Kombeve të Balkanit deshi të thotë njëkohësisht edhe lenje të drejtimit kulturor oriental, për të pranuar qytetërimin oksidental, gjë që pa tjetër do të përfundonte në rënjen e prestigjii të gjuhës tyrke. Sa do që për këto arsye historike do të mund të pritesh se në të tëra gjuhët balkanike do të çfaqeshin tendenca të forta puristike kundra tyrqismi, me gjith atë, këjo nuk ndodhi.” Marrë nga revista “Përpjekja shqiptare” 1938, nr. 114-15 (shkurt-Mars) f. 125-129. (Janë ruajtur veçoritë gjuhësore të origjinalit).

<sup>12</sup> M.Karagiozi Kore, Gjyrokastër, vështrim historik, gjuhësor etnologjik, Tiranë, 2014

<sup>13</sup> I. Ajeti, Dokumenti më i vjetër në Kosovë i shkruar në alfabein arabo-turk në *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, II, Prishtinë, 1985, f. 167.

<sup>14</sup> Shih më tej I. Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, në *Vepra 3*, Prishtinë 1998, f. 145-153

Ballkanit s'kanë munguar".<sup>15</sup>

Këto janë disa nga mendimet që do të donim të jepnim për këtë çështje duke e mbyllur me fjalët e E. Çabejt që në trajtimin e këtyre çështjeve "Të jemi objektivë, por jo indiferentë".

### **Bibliografia:**

1. Ajeti, I.: *Dokumenti më i vjetër në Kosovë i shkruar në alfabein arabo-turk në Studime gjuhësore në fushë të shqipës*, II, Prishtinë, 1985.
2. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare –sllave*, SF, 4,1972, Tiranë.
3. Altermatt, U.: "Language and Nation: Is Switzerland a Model for Europe?" NATION AND NATIONAL IDEOLOGY PAST, PRESENT AND PROSPECTS In the International Symposium held at the New Europe College, Bucharest, April 6-7, 2001.
4. Çabej, E.: *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976.
5. Egro, D.: *Historia dhe ideologjia*, Tiranë, 2007.
6. Ismajli, R.: *Diskutime për prejardhjen e gjuhës shqipe, në Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 32/1, f. 22.
7. Karagjozi Kore M.: "Gjirokastra, vështrim historik, gjuhësor etnologjik", Tiranë, 2014
8. Mansaku, S.: *Objektivitet shkencor dhe qëndrim kombëtar në veprën e Eqrem Çabejt*, në "Studime filologjike shqiptare", Konferencë shkencore 21-22 nëntor, organizuar nga Akademia e Shkencave e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2007, botuar në përmbledhjen me të njëjtin titull, Prishtinë, 2008.
9. Mansaku, S.: *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në veprën e Sami Frashërit*, PERLA, Revistë shkencore – Kulturore tremujore, Viti IX 2004 Nr. 2 (33)
10. Matzinger, J.: *Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi i gjuhësisë historike, në "Historia e shqiptarëve"*, "Përpyekja", Tiranë, 2012.
11. Todorova, M.: *Historiography of the Countries of Eastern Europe: Bulgaria*, *American Historical Review*, vol. 97. No. 4, October 1992.

---

<sup>15</sup> I. Ajeti, *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare –sllave*, SF, 4,1972, Tiranë.



**Idriz METANI**

## **RRETH IDEOLOGJIZIMIT TË FJALËVE**

Ideologjizimi<sup>1</sup> i fjalëve ose modifikimi i përmbajtjes<sup>2</sup> së tyre nga ndërhyrja subjektive e grupeve politike a shtresave të caktuara shoqërore për ta përshtatur atë në

---

<sup>1</sup> Parapëlqejmë termin ideologjizim përkundrejt termit politizim që përdoret rëndom sot për të shenjuar dukurinë e modifikimit të karakterit ngjyrimor të përmbajtjes së fjalës nga faktorë jashtëgjuhësorë jo vetëm në gjuhësinë shqiptare, por edhe në gjuhësinë e shumë vendeve të tjera, për të paktën dy arsye kryesore: së pari, kemi bindjen se në gjuhësinë shqiptare politizimi ka qenë më i thellë e në përmasa më të mëdha në krahasim me politizimin e gjuhësisë në vende të tjera për shkak të trysnisë së fortë që ushtronte shteti monist ndaj shkencave shoqërore në përgjithësi e ndaj gjuhësisë në veçanti; së dyti, edhe pse leksikografët seriozë dhe objektivë normalisht nuk duhet ta pranojnë ndërhyrjen e një faktori të jashtëm në punët e një fjalori, për fat të keq hartuesit e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe e kanë bërë një gjë të tillë. Ky fakt i ka dhënë përmasa të gjera politizimit duke e cuar atë deri në ideologjizim herë-herë edhe të skajshëm të leksikografisë njëgjuhëshe shqiptare.

<sup>2</sup> Lënda gjuhësore që i nënshtrohet analizës në artikullin tonë përfshin një numër jo të vogël fjalësh kryesisht nga fusha e ideologjisë për të cilën Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) jep përkufizimin e mëposhtëm: “sistem idesh e pikëpamjesh politike, filozofike, juridike, estetike, morale e fetare, që shprehin interesat, qëndrimin e kërkesat e një klase, të një grupi shoqëror, të një partie, të një sistemi politiko-shoqëror si pjesë e superstrukturës dhe që pasqyrojnë, në fund të fundit, marrëdhëniet ekonomike” (f. 709). Si të tilla mund të përmendim p.sh. agjitrop “organi a seksioni që merrej me punën e agjitacionit e të propogandës në komitetet e partisë, në organizatat e masave etj. (f. 13), amerikan “ai që zbaton politikën dhe synimet e imperializmit amerikan” (f. 28), anarkosindikalizëm “rrymë mikroborgjeze, oportuniste e reaksionare në lëvizjen sindikaliste, që synon të zbatojë metodat e vijën politike e ideologjike të anarkizmit në këtë lëvizje” (f. 32), anglez “ai që zbaton politikën dhe synimet e imperializmit anglez” (f. 36), armik<sup>2</sup> “ai që është kundër interesave të klasës, të partisë, të atdheut e të socializmit dhe që lufton e vepron kundër tyre” (f. 53), arqiomarksist “anëtar i një organizate antimarksiste, të krijuar në Greqi më 1920, që shtrëmbëronte marksizëm-leninizmin e që luftonte lëvizjen komuniste...” (f. 54), bolshevizëm “teoria dhe taktika e lëvizjes revolucionare proletare për përmbysjen e kapitalizmit me revolucion dhe për kalimin në shoqërinë komuniste, që u përpunuan nga V.I. Lenini sipas përvojës së nxjerrë nga lufta e klasës punëtore ruse e ndërkombëtare dhe që u vazhduan më tej nga J.V. Stalini” (f. 163), celulë<sup>2</sup> “Organizata bazë e partisë komuniste të Shqipërisë gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare dhe në vitet e para pasçlirimit” (f. 216) etj. Po kështu janë bërë objekt shqyrtimi edhe fjalë të fushave të tjera të cilat në strukturën e tyre kuptimore mbartin edhe kuptime ideologjike e politike, si p.sh. bulevard<sup>2</sup> “dicka që u përshtatet shijeve të këqija mikroborgjeze”, fidanishte<sup>2</sup> “mjedis shoqëror

përputhje me bindjet<sup>3</sup>, politikën<sup>4</sup> dhe me pikëpamjet e tyre, është një dukuri e pranishme në etapa a faza të ndryshme historike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, por ajo spikat më tepër, pra bëhet më e dukshme dhe më e përgjithshme, sidomos në kohën kur në një vend vendoset një regjim i vecantë politik (totalitar a autokratik)<sup>5</sup>. Kështu ka ndodhur p.sh. në Shqipëri që prej vitit 1944 e deri në vitin 1990, kur, si rezultat i totalitarizmit, ideologjia marksiste-leniniste dhe filozofia e saj sundonin të gjithë jetën e vendit dhe arrinin të depërtonin në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare të kohës, duke ideologjizuar gjithcka, pra edhe gjuhësinë e degë të veçanta të saj siç është fjala vjen leksikografia<sup>6</sup>. Mendojmë se dëshmia më e qartë e idelogjizimit të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi e të leksikografisë shqipe<sup>7</sup> në vecanti është padyshim Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), i hartuar nga një grup leksikografësh<sup>8</sup> me përvojë

---

ku përgatiten e edukohen të rinjtë e të rejtat për të vijuar në të ardhmen atë që kanë bërë paraardhësit e tyre” (f. 467), komunikatë2 “fletë e shtypur që nxirrej rregullisht nga organet e partisë komuniste shqiptare gjatë luftës nacionalçlirimtare” (f. 857) etj.

<sup>3</sup> Është pranuar tashmë edhe në gjuhësinë shqiptare se faktorët jashtëgjuhësorë ndikojnë në përmbajtjen e fjalëve e mund ta zhvillojnë atë semantikiisht me kuptime e ngjyime të reja (shih J. Thomai, *Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, SF, 1983, 3, f. 78)

<sup>4</sup> Një trajtim të thukët të dukurisë së politizimit të leksikut politiko-shoqëror e jep studiuesi Mico Samara në punimin “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe, Tiranë, 2008

<sup>5</sup> Shih më gjerë për këtë edhe Le discours sur la langue sous les regimes autoritaires (Cahiers de ILSL, 17, 2004, f.

<sup>6</sup> Leksikografia shqipe, fusha me histori më të hershme në gjuhësinë shqiptare, me një prodhimtari të pasur e të pandërprerë, ka shënuar rezultate të rëndësishme, numri fjalorëve të botuar deri tani, sic është pohuar nga studiues të ndryshëm, e kalon shifrën 500, shumica e tyre janë fjalorë dygjuhësh me shqipen si gjuhë të parë e të dytë, por, krahas arritjeve, para kësaj dege të gjuhësisë shqiptare qëndrojnë, sigurisht, edhe detyra parësore, të mëdha e të vështira që lidhen, në radhë të parë, me rritjen e cilësisë shkencore të fjalorëve që hartohen e botohen, me regjistrimin elektronik të fondeve leksikore, sidomos të atyre që ruhen në Kartotekën e leksikut të shqipes për të hartuar në të ardhmen një fjalor të madh disa vëllimësh të gjuhës shqipe, por edhe fjalorë të shkrimtarëve të vecantë, fjalorë shkollorë a moshorë etj. (shih më gjerë, Leksikografia shqipe-trashgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005).

Sic dihet, një nga pasuritë më të mëdha të gjuhës shqipe është Kartoteka e leksikut të shqipes, e cila pret të dixhitalizohet, por ne do të shtonim edhe të tematizohet, d.m.th. pasuria leksikore, semantike e frazeologjike që ajo mbart, të grupohet sipas fushave tematike me qëllim që spektri leksikografik i shqipes të ketë në të ardhmen e afërt edhe fjalorë tematikë, të cilët sot pothuajse i mungojnë gjuhës shqipe

<sup>7</sup> Edhe në fjalorë të gjuhëve të tjera kemi vërejtur “gjurmë” të politikës e të ideologjisë në fjalë të vecanta (Shih, ndër të tjerë: Micro-Robert, 1971; R. Scruton, Dictionary of Political Thought, 1982; A. Leotti, Dizionario albanese-italiano, 1937). Ky i fundit, sic dihet, është mbushur plot me citate e thënie që i thurin lavde regjimit të Musolinit.

<sup>8</sup> Është zhvilluar një diskutim i gjerë teorik në gjuhësinë e sotme për qëndrimin e leksikografëve ndaj disa fjalëve të fushës së ideologjisë e të politikës dhe për mënyrën se si i kuptojnë hartuesit e fjalorit nocionet që këto fjalë shënojnë, ndërkaq, nga oponenca leksikografike, është pohuar se trajtimi leksikografik i disa fjalëve me përmbajtje politike e

(Androkli Kostallari, Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Mico Samara, Josif Kole, Palok Daka, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Ferdinand Leka, Emil Lafe, Kornelja Sima, Thanas Feka, Beatrice Keta, Agim Hidi) mbi bazën e disa parimeve themelore<sup>9</sup>, të konceptuara prej kryeredaktorit të këtij fjalori që i “detyrojnë”, si të thuash hartuesit dhe redaktorët e tij të gjejnë mjete gjuhësore për ta spërkatur këtë vepër të rëndësishme<sup>10</sup> të leksikografisë njëgjuhëshe shqiptare me pak marksizëm-leninizëm.

Ky është edhe qëllimi i kumesës sonë: të vërë në dukje, pikësëpari, mjetet gjuhësore që kanë përdorur hartuesit e fjalorit të vitit 1980, për të realizuar ideologjizimin e fjalëve në procesin e përkufizimit të tyre.

Dy janë, të paktën, mjetet gjuhësore kryesore që kanë përdorur autorët e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 për të modifikuar përmbajtjen e fjalëve e për t’ia përshtatur këtë përmbajtje, kryesisht, synimeve të politikës së shtetit totalitar:

**Së pari**, *shembullsimet a ilustrimet* sic quhen rëndom në praktikën e hartimit të fjalorëve. Janë të shumta shembullsimet të qëmtuara me kujdes në shtypin monist e në propagandën komuniste të kohës të pranishme jo vetëm në strukturat kuptimore të fjalëve me përmbajtje politiko-ideologjike, por edhe në fjalë që nuk kanë një semantikë të tillë për “ta stërpikur” fjalorin me pak politikë e ideologji marksiste-leniniste. Po japim më poshtë disa shembuj: **aksion** “veprimtari e gjallë, me pjesëmarrjen e masave punonjëse, për të kryer në mënyrë luftarake e me frymë revolucionare, brenda një kohe të shkurtër, një detyrë të rëndësishme politike, shoqërore ose ekonomike”

---

ideologjike pasqyron “gjurmë”, jo vetëm të epokës, por edhe të shkollës së leksikografit (J.B. Migliorini, *Che cos e vocabolario*, 1961, f. 82; G. Klein, *De la langue unitaire a la langue autarcique: le discours sur la langue pendant fascisme en Italie* në *Le discours sur la langue sous les regimes autoritaires*, I ILSL, 2004, 17, f. 93; A. Kostallari, Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes, në *Buletin për shkencat shoqërore*, 1955, 4, f. 43)

<sup>9</sup> Duke folur për parimet e kriteret e vecanta që do të përcaktojnë përfshirjen e një fjale në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (Shih, A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, f. 3-80), Androkli Kostallari pohon: “Përdorimi i qëndrueshëm i fjalës në gjuhën e sotme zyrtare, në dokumentet kryesore të jetës politiko-shoqërore e ekonomike të vendit: në Kushtetutën e R.P. të Shqipërisë e në ligjet e shtetit në vendimet e Kongreseve e të Konferencave të Partisë së Punës të Shqipërisë, si dhe në vendimet e Pleniumeve të K.Q. të saj, në fjalimet e në veprat e udhëheqësve të Partisë e të shtetit, në statutet e organizatave shoqërore, të kooperatave bujqësore etj. në rregulloret kryesore të Ushtrisë sonë Popullore, si dhe në organet qëndrore e krahinore të shtypit (sidomos lidhur me jetën e organizatave e institucioneve që përfaqësojnë). Këtu duhet të përfshihen dhe dokumentet themelore të Luftës nacional-çlirimtare, përdorimi i fjalës në veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit të botuara nga K.Q. i P.P.SH”, f. 18

<sup>10</sup> Edhe pse ideologjizuar, në vlerësimin tonë Fjalori i gjuhës së sotme shqipe i vitit 1980 mbetet njëra nga veprat më të mira të leksikografisë shqipe që ka bërë kodifikimin më sistemor e më normativ të pasurisë fjalësore semantike e frazeologjike të gjuhës së sotme shqipe.

(aksion politik, ideologjik, me frymë revolucionare, me goditje të përqëndruar, kombëtar, i rinisë, metoda e aksionit, fryma e aksionit, flamuri i aksionit), **botëkuptim** “tërësia e pikëpamjeve të njeriut për botën që e rrethon” (botkuptim filozofik, marksist-leninist, socialist, materialist, idealist, komunist, revolucionar, borgjez, mikroborgjez, fetar, i shëndoshë, i ri, i ngushtë, botkuptime të huaja, të vjetra), **çakall** “fig. njeri gjakpirës e i pangopur” (cakejtë imperialistë), **çizme** “fig. sundim i egër i klasave shfrytëzuese; zgjedha e huaj” (cizmja e imperializmit), **direktivë** “udhëzim që jepet nga një organ drejtues për vijën që duhet ndjekur e duhet zbatuar në një punë a në një veprimtari” (direktivë e partisë, zbatoj direktivën, lëshoj direktivën, zbërthym direktivën, në zbatim të direktivës së partisë), **diversion** “veprimtari dëmprurëse që zhvillon një shtet armik në një vend tjetër me anë të agjentëve të vet a të grupeve të posacme, duke bërë sabotime, shkatërrime, vrasje etj., e duke përdorur mjete të ndryshme propagandistike me qëllim që ti dobësojë forcën ushtarake, ekonomike dhe ti minojë rendin politik shoqëror; veprimtari kriminale e sabotuese e armikut të klasës” (diversion ekonomik, ideologjik, politik, kulturor, i imperialistëve, i revizionistëve, i organizatave armiqësore, akte diversioni, mjete diversioni), **doktrinë** “teori shkencore ose filozofike; tërësia ë parimeve teorike të një shkence a të një dege të saj” (doktrinë materiliste, revolucionare, idealiste, reaksionare, filozofike, politike, e Marksit, e Engelsit), **drejtoj** “fig. i tregoj dikujt rrugën për të arritur një qëllim, i caktoj atij pikësynimet e afërta e të largëta dhe rrugën që duhet të ndjekë për ti arritur ato” (drejtoj popullin, masat, shtetin, revolucionin, luftën, vendin, na drejton partia), **emulacion** “metodë pune dhe veprimi në socializëm, e cila synon zhvillimin e përgjithshëm nëpërmjet përhapjes së përvojës së më të mirëve, që nxit inisiativën e guximshme, vetëveprimin dhe shpirtin krijues të masave të gjera punonjëse” (emulacioni socialist, forca, fryma, vala e emulacionit, zhvillimi, gjallërimi i emulacionit, tabela e emulacionit, qendër emulacioni, këndi i emulacionit, nxit emulacionin, shpërthen emulacioni), **etikë1** “shkenca që studion moralin, karakterin klasor dhe historik të tij, normat e sjelljes së njerëzve si një nga format e ndërgjegjës shoqërore, detyrat e tyre kundrejt njëri-tjetrit, kundrejt, shoqërisë, atdheut, shtetit etj. (etika marksiste-leniniste, marksiste, leniniste, materialiste, komuniste, idealiste), **etikë2** “tërësia e normave të sjelljes, morali i një shoqërie, i një klase të caktuar a i një grupi shoqëror (etikë proletare, revolucionare, borgjeze), **fakultet** “pjesë e një shkolle të lartë që përfshin një degë ose disa degë të përafërta të dijes” (I gjithë fakulteti shkoi në aksion), **fidanishte2** “fig. mjedis shoqëror ku përgatiten dhe edukohen të rinjtë e të rejtat për të vijuar në të ardhmen atë që kanë bërë paraardhësit e tyre” (rinia është fidanishtja e partisë), **forcë** “aftësia që ka dikush të ushtrojë autoritetin e tij tek të tjerët, të ndikojë mbi ta, ti bindë për dicka etj. ; aftësia që ka dicka për të vepruar në mendjet e njerëzve, për ti udhëhequr ata në punë e në jetë” (forcë bindëse,



udhëheqëse, forca e partisë, e proletariatit, e popullit, e ideve të marksizmit, e shembullit pozitiv, e fjalës, e zakoni, e traditës), **fundërrinë3** “fig. llumi i njerëzve” (fundërrinat e kapitalizmit), **histerik-e2** “fig. i shfrenuar, i papërmbajtur, i tërbuar” (propagandë histerike, thirrjet histerike të imperialistëve, fushatë histerike kundër komunizmit), **ideologjik-e** “që ka të bëjë me ideologjinë; që shpreh, përcon e mbron një ideologji të caktuar” (revolucion ideologjik, çështje e mprehtë ideologjike, boshti ideologjik, përmbajtje e thellë ideologjike, bindje ideologjike, edukim ideologjik, luftë ideologjike, armë ideologjike, pastërti, qartësi, cektësi, ngritje, brumosje, pjekuri, mprehtësi ideologjike, niveli ideologjik, rrënjët ideologjike, ndikim, agresion ideologjik, krizë, shturje ideologjike, në frontin ideologjik) etj.

**Së dyti**, *përbërësit kuptimorë të vecantë*, të cilët kanë zënë vend në makrosistemet e në mikrosistemet semantike të fjalëve jo aq për të identifikuar realien d.m.th sendin, frymorin a dukurinë që shënojnë fjalët, se sa për të shprehur enkas një qëndrim të caktuar të karakterit politiko- ideologjik të autorëve. Si përbërës të tillë mund të përmendim: a) *në vendet ku vepron kisha katolike; në të kaluarën edhe në Shqipëri* (**abaci** “manastir ose kuvend i pasur katolik”, **abat** “prift katolik, i pari i murgjëve, titull kishtar”, **franceskan** “murg i një urdhëri reaksionar katolik”, **jezuit** “murg i urdhërit fetar katolik”, **krezm** “vaj i shenjtë që përdoret në shërbesat fetare katolike”, **krezmim** “rit fetar a ceremonia që bëhet në kishë kur krezmohet fëmija a i rrituri”, **krezmoj** “lyeje me krezm në kishë fëmijen e rritur për ta bërë katolik”); b) *në vendet ku vepron kisha ortodokse; në të kaluarën edhe në Shqipëri* (**arkimandrit** “titull më i lartë për murgjit dhem kryetarët e manastireve”, **arkidioqezë** “rriht i veprimit kishtar; juridiksion kishtar më i madh se dioqeza, që është në drejtimin e një arkiveskopit”, **dhespot** “titull fetar në kishën ortodokse ndërmjet priftit e metropolitit”, **dhjak** “titull fetar në kishën ortodokse, grada më e ulët fetare në këtë kishë”, **kallogre** “murgeshë ortodokse”, **kallojjer** “murg ortodoks”) etj.; c) *në vendet ku vepron feja myslimane; në të kaluarën edhe në Shqipëri* (**bektashizëm** “sekt fetar i besimit mysliman”, **dervish** “murg i sektit bektashian që jeton e kryen shërbime fetare në një teqe”, **imam** “hoxhë që drejton lutjet e besimtarëve në xhami”) etj.; d) *në vendet ku vepron kisha (feja) e krishterë* (**altar2** “tryezë e gjerë në një të ndarë në pjesën lindore të kishës ku bëhen shërbesat më të rëndësishme e ku mbahen sendet kryesore që përdor prifti”, **dioqezë** “juridiksioni kishtar në të cilin ushtron funksionet e tij një peshkop a një prelat tjetër”, **katedrale** “kisha kryesore në një qytet ku ushtron veprimtarinë e vet një peshkop”, **katekizëm** “shtjellim i përmbledhur i dogmës së fesë së krishterë”, **kishë** “organizatë fetare e klerit të krishterë, e cila drejton jetën fetare të besimtarëve që përfshin ajo sipas disa dogmave e riteve të caktuara”, **krishterë i, e** (që lidhet me krishtërimin, që i përket krishtërimin), **krishtlindje** “një nga festat kryesore të të krishterëve”, **kryepeshkop** “titull më i lartë se ai i peshkopit”, **kryepeshkopatë** “dioqeza që

drejtohet nga një peshkop”, kungë “pjesa e kishës së krishterë në trajtë gjysmë të rrumbullakët e me kube ku prifti kryen shërbesat fetare dhe ku mbahet kumbimi”, kungatë “buka dhe vera e ashtuquajtur e bekuar”, kungim “rit fetar që bëhet zakonisht në kishë, ku prifti u jep besimtarëve me lugë verë me copa meshe”; dh) *në vendet ku vepron feja* (**devocion** “ndjenja e besimit të pakufishëm tek dogma e një feje”, **kler** “të gjithë ata që kryejnë shërbime fetare të një kulti”, **klerik** “ai që kryen shërbime fetare”, **haxhi** “titulli që u jepet besimtarëve myslimanë a të krishterë”, **haxhillëk** “shtegëtimi që bëhet nga besimtarët myslimanë e të krishterë” ) etj. Në pak fjalë të tjera po të fushës fetare janë përdorur edhe përbërës të tillë, si: *sipas besimeve të kota* (**kurban2** “bagëti që therej kur fillonte ndërtimi i një ndërtese”, **demon1** “qënie mbinjerëzore me fuqi të fshehtë, që besohej se kishte në dorë fatin e një njeriu, të një familjeje, të një fisi etj”); *sipas paragjyqimeve fetare* (**aureolë** “kurorë e ndritshme që u pikturohet përçark kokave të shenjtorëve në ikonat për të treguar shenjtërinë e tyre”, **bekuar i,e** “që ka marrë bekimin”); *sipas paragjyqimeve dhe ritit fetar ortodoks* (**ajazmë** “ujë i bekuar, ceremonia e përgatitjes së ujit të bekuar”; sipas dogmës në shërbesat e krishtera (**alilluja** “pashtrirmë lavdëruese që shqiptohet pas disa këngëve e lutjeve”)

Përvec përbërësve të përmendur më lart, që, sic shihet edhe nga shembujt e përdorur më sipër (të cilët janë fjalë kryesisht të fushës religjioze) kanë shërbyer për autorët e fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1980 për të shprehur qëndrimin afetar të veprës së tyre, hartuesit e kësaj vepre kanë futur në përkufizimet e një numri jo të vogël fjalësh të fushave të tjera edhe disa përbërës kuptimorë që shprehin gjuhësisht treguesit e tipareve të realieve që shënjohehen prej tyre. Po japim më poshtë disa shembuj: **abstraksionizëm** “rrymë krejt formaliste e *subjektiviste* në artin e sotëm dekadent, borgjez e revizionist, që nuk i paraqet me vërtetësi qënie e sendet e botës objektive”, **agresion** “sulm i armatosur i një shteti kundër një shteti tjetër për ti pushtuar tokat e për ta nënshtruar, për të shtypur lëvizjet demokratike revolucionare ose nacionalclirimtare dhe për të vendosur regjime reaksionare...” **dekantetizëm** “tërësi drejtimesh letrare e artistike, borgjeze e revizioniste që i kundërvihet realizmit e i vënë vetes si qëllim kryesor të pasqyrojë botën e ngushtë të individit... që predikojnë individualizmin borgjez, pesimizmin dhe shturjen morale për ti larguar masat punonjëse nga lufta klasore e clirimtare”, **ekonomizëm** “rrymë reaksionare, oportuniste e revizioniste, sipas së cilës klasa punëtore në vendet kapitaliste duhet të luftojë vetëm për reforma ekonomike gjysmake e të pjesshme, vetëm për përmirësimin e gjendjes së saj ekonomike dhe jo për të marrë pushtetin politik; rrymë oportuniste e revizioniste që mohon raportin e drejtë midis ekonomisë e politik, që mbivlerëson qëllimin ekonomik në revolucion e në ndërtimin e socializmit dhe nënvlerëson revolucionin ideologjik si dhe edukimin ideopolitik të masave”, **ekzistencializëm** “rrymë filozofike idealiste e epokës së imperializmit, që e paraqit jetën si dicka të kotë

e shterpë, e shkëput dhe e vecon njeriun nga shoqëria...drejtim reaksionar, idealist e dekadent në letërsinë e artet e epokës së imperializmit”, **empiriokriticizëm** “rrymë reaksinare, idealiste, subjektive... e cila mohonte qënien objektive të botës materiale...” etj.

Duke e pare në tërësi dukurinë e ideologjizimit të fjalëve e pranishme në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980, mund të nxjerrim, të paktën, dy përfundime më të përgjithshme:

**Së pari**, numri i njësive leksikore (fjalëve) dhe i njësive semantike (kuptimeve) në Fjalorin e vitit 1980, tek të cilat reflektohet jo vetëm “pikëpamja filologjike” e “botëkuptimi” i hartuesve të tij, por edhe qëndrime të qarta politiko-ideologjike, krahasuar me numrin e fjalëve e kuptimeve që kjo vepër përmban gjithsej, nuk është i madh, ndërkaq, numri i shembullimeve ose i ilustrimeve të nxjerra prej hartuesve të fjalorit nga propaganda komuniste e kohës në të cilën ai i botua dhe të futura prej tyre në strukturën kuptimore të leksemave, nuk mund të themi se është i vogël, madje një pjesë e këtyre ilustrimeve, edhe pse fjalori u ripunua, kanë mbetur ende në faqet e tij.

**Së dyti**, korpusi i leksemave që janë prekur nga dukuria e politizimit dhe ideologjizimit përbëhet jo vetëm prej asosh që kanë, si të thuash semantikë ideologjike, por edhe prej mjaft fjalëve që nuk e kanë një semantikë të tillë. Mjetet gjuhësore që janë përdorur nga autorët e veprës për të cilën po flasim për të lënë në përmbajtjen e fjalëve “gjurmë” të kohës janë të ndryshme për të dy grupet e fjalëve që përmendëm: për fjalët me përmbajtje të njëmendët politike e ideologjike janë përdorur kryesisht përbërësit semantikë të posacëm, të futur enkas në përkufizimet e fjalëve, kurse tek fjalët që nuk kanë semantikë ideologjike janë përdorur, shpesh herë edhe me tepëri, shembullsimet a ilustrimet, të qëmtuara me kujdes, sic e kemi përmendur edhe më parë në këtë kumesë, në shtypin e publicistikën e shtetit monist.



Anila KANANAJ

## NDIKIME TË IDEOLOGJISË NË STUDIMET SINTAKSORE TË SHQIPES

Përmbajtja e termit *ideologji* është një çështje mjaft e diskutueshme sot. Për këtë është shkruar jo pak nga gjuhëtarët, filozofët, psikologët e sociologët (Silverstein, 1979; Milroy & Milroy, 1985; Eagleton, 1991; Simpson, 1994; Woolard, 1998; Irvine & Gal 2000, Bauman & Briggs, 2003; Pullum, 2004, Saussure & Schulz, 2005 etj.), prandaj nuk do ta prekim këtë problem këtu. Sidoqoftë, në përgjithësi, një ideologji e caktuar përbëhet nga një sistem idesh, faktesh dhe vlerash për marrëdhëniet sociale e gjuhësore. Sipas filozofit Robert Higgs, ideologjia ka katër aspekte të dallueshme: (a) kognitiv (strukturon perceptimet e individit, paracakton të kuptuarit e botës sociale); (b) afektiv (i tregon individit nëse ajo që ai 'sheh' është e mirë, e keqe ose moralisht neutrale); (c) programatik (e shtyn individin të veprojë në përputhje me kognicionin dhe vlerësimet e tij); (d) solidar (si anëtar i përkushtuar i një grupi politik, individi ndjek objektiva të përcaktuara sociale) (1987:37). Një konceptim i tillë bashkon në një bosht si ideologjitë politike, ashtu edhe ideologjitë gjuhësore, pra të dyja janë shfaqje të të njëjtit fenomen: diktati në gjuhë e në shoqëri. Këto ideologji bashkëveprojnë ngushtë me njëra-tjetrën, të përdorura fort nga klasa sunduese. Politikanët, gjuhëtarët, etnografët, gazetarët etj. janë grupe që klasa sunduese i fton në hegjemoni me qëllim që t'i shërbejnë hegjemonisë (Register, 2001). Ideologjitë gjuhësore nuk mbahen në këmbë vetëm nga pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në të, por edhe nga gjuhëtarët. Këta të fundit caktojnë kufijtë gjuhësorë dhe i mbështesin ideologjitë në mënyrë deskriptive (Irvine & Gal, 2000: 36). Studimet mbi këto çështje në literaturën e huaj janë të shumta. Pikërisht ndikimi i ideologjisë politike, i gërshetuar me atë të ideologjisë gjuhësore, në studimet sintaksore të shqipes do të jetë objekti i këtij studimi. Konkretisht, do të merren në studim ideologjia politike në periudhën komuniste-enveriste dhe ideologjia gjuhësore e preskriptivizmit, si dy dukuri që kanë vepruar paralelisht në kohë. Për më tepër, janë dy dukuritë që kanë ndikuar më shumë në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri. Të dyja këto ideologji rekomandojnë, parashkruajnë dhe imponojnë rregulla, duke ushtruar kështu diktatin e vet në gjuhë dhe në shoqëri. Jo vetëm kaq, por në qasjen e studiuesit Koerner (2001) edhe vetë

teoria gjuhësore e një drejtimi të caktuar, p.sh. teoria gjenerativiste, është një lloj ideologjie. Ideologjia, shprehen Joseph & Taylor (1990: 5), është një forcë e fuqishme, më e fuqishmja në të gjithë kulturën njerëzore. Siç shihet, lidhja e ideologjisë me gjuhën është kaq e fortë, saqë prek çdo aspekt dhe çdo çështje të kërkimit njerëzor. Për këtë arsye hulumtimi i gjurmëve të ideologjisë në sintaksën e shqipes ka rëndësi të veçantë për shkencën gjuhësore. Ideologjia do të konceptohet në dy dimensione: (1) Ideologjia si një sistem konceptual politiko-filozofik i legjitimuar në shërbim të klasës në fuqi; (2) Ideologjia si një sistem idesh e pikëpamjesh gjuhësore të legjitimuara në shërbim të një grupi. Ndikime të ideologjisë në studimet sintaksore në Shqipëri vërehen në të dyja këto dimensione. Rrjedhimisht, ndikimet e ideologjisë në studimet sintaksore në Shqipëri do të shihet në dy aspekte kryesore që kanë vepruar e që, deri në një farë mase, veprojnë edhe sot në mënyrë paralele: a) ndikime të ideologjisë politike të periudhës komuniste-enveriste në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri, dhe b) ndikime të ideologjisë gjuhësore, konkretisht të preskriptivizmit në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri.

### **1. Ndikime të ideologjisë politike të periudhës komuniste-enveriste në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri**

Komunizmi enverist si një ideologji sunduese në shoqërinë shqiptare të periudhës së pasqilimit është studiuar jo pak, porse në aspektin gjuhësor nuk janë ndërmarrë studime që të shqyrtojnë nëse ka pasur ndikime në studimet sintaksore të gjuhës shqipe, dhe nëse po, deri në ç'masë kanë depërtuar ato. Por fillimisht të sqarojmë kuptimin me të cilin do të përdoret ky term në këtë studim. Dihet që teoritë politiko-ekonomike të Karl Marksit dhe Frederik Engelsit u përpunuan nga ndjekësit e tyre dhe u bënë baza e sistemit komunist. E ashtuquajtura ideologji marksiste që u zbatua në sistemin komunist pas viteve 60' në Shqipëri, ndryshon shumë nga idetë origjinale të Marksit dhe Engelsit. Për të identifikuar pikërisht këtë ideologji politike, filozofike e sociale që u zbatua në periudhën e socializmit enverist në Shqipëri, do të përdoret termin *komunizëm enverist*.

Për sa i përket studimeve sintaksore, pjesa më e madhe e gjuhëtarëve në Shqipëri mëtojnë se komunizmi enverist nuk ka pasur ndikime të rëndësishme në sintaksë. Sigurisht, pohohet nga të gjithë se ishte detyrim i kohës që shembujt të ishin të politizuar. Gjithashtu, një sërë autorësh perëndimorë nuk lejohej të citoheshin. Sidoqoftë, këto nuk lidhen aq me anën përmbajtjesore të studimeve sintaksore shqiptare të periudhës në studim. Por a është kjo panorama e plotë e gjendjes së studimeve sintaksore në periudhën në fjalë në Shqipëri? Për të krijuar një ide mbi këtë çështje, po citoj nga *Marksizmi dhe probleme të gjuhësisë* i J. V. Stalinit, botuar së pari në

gazetën Pravda, Moskë, në 1950:

“Gramatika (morfologjia, sintaksa) është koleksion i rregullave që drejtojnë modifikimin e fjalëve dhe kombinimin e tyre në fjali. Vetëm falë gramatikës, gjuba investon mendimet njerëzore në një shtresë materiale gjubësore” (1972: 22).

“Pranimi i formalizmit në gjubë përbën një gabim serioz dhe konceptet gjubësore formaliste konsiderohen si njolla që duhen pastruar nga gjubësia marksiste” (1972: 40).

Citimi i mësipërm tregon se Stalini është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështje thelbësore të gramatikës, siç është konceptimi dhe përkufizimi i saj. Po ashtu, ai ka dhënë udhëzime të qarta edhe për qasjet shkencore ndaj saj. Në këndvështrimin e ofruar nga ai qasja formaliste në sintaksë jo vetëm që është e ndaluar, por konsiderohet “njollë” që duhet pastruar. Lufta kundër kësaj qasjeje nuk ka si të shprehet më mirë. Për më tepër, ajo që ka shumë rëndësi në këtë artikull të botuar të Stalinit, është fakti që mëtohet për një *gjubësi marksiste*, tiparet dhe konturet e së cilës janë dhënë nga udhëheqësi kryesor i marksizmit komunist. Shumë prej sintaksologëve shqiptarë më të njohur dhe më me ndikim në gjuhësinë shqiptare studiuin dhe u formuan në Rusi. Puna e tyre tregon se orientimi i sintaksës shqiptare të kësaj kohe ka ardhur nga gjuhësia ruse. Po e ilustruam me një shembull të marrë nga një artikull të S. Floqit, i cili është vlerësuar për bazat shkencore. Shënojmë që në krye se shembulli është përzgjedhur në mënyrë redondante, pa pasur qëllimin për t’u përqendruar tek autori, por vetëm për të ravijëzuar disa tipare të studimeve sintaksore të periudhës së komunizmit enverist.

Artikulli *Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme letrare* hapet nga autori me këto fjalë: “*Gjuhësia marksiste* shtron para studiuesit kërkesën e hulumtimit të fakteve gjubësore jo në mënyrë të veçuar, por në lidhjet e tyre dialektike, në lidhjet e tyre sistemore” (1978: 1). Në krye të krijohet përshtypja e një slogani rutinë, i detyrueshëm në botimin e punimeve shkencore të kohës. Porse në përfundimet e artikullit autori shënon: “*Rryma të caktuara të gjuhësisë së sotme* nuk janë në gjendje të japin në mënyrë të kënaqshme vlerën semantike të fjalive të një modeli të caktuar, sidomos *sepse baza e tyre teorike metodologjike çalon për shkak të ideologjisë e të botëkuptimit idealist* me ngjyrimet nga më të ndryshmet. Pa një hetim paraprak për përcaktimin e nocioneve e të termave themelore të semantikës në bazë të materializmit dialektik nuk do të jetë e mundur të jepet një përshkrim i saktë dhe i hollësishëm i semantikës së modeleve të fjalisë. ...Është detyrë e *gjuhësisë marksiste në përgjithësi, dhe e gjuhësisë marksiste shqiptare në veçanti*, të sqarojë çështjet e ndryshme të këtij problemi...” (1978: 50) (theksimi me shkronja kursive – A. K.).

Ky paragraf e bën të qartë se nuk flitet thjesht për një formulë të detyrueshme hapjeje të artikujve, por për bindje e botëkuptim të autorit. Vihet re se gjuhëtari shtron disa probleme themelore për shkencën e gjuhësisë, të cilat detyrimisht përfshijnë edhe

disiplinën e sintaksës. Së pari, ai shtron nevojën e hulumtimeve në kuadër të gjuhësisë marksiste në përgjithësi dhe më specifiku, të gjuhësisë marksiste shqiptare. Më tej diskutohet çështja e qasjes teoriko-shkencore në gjuhësi, e cila, në përputhje me udhëzimet e Stalinit, duhet të jetë marksiste dhe joidealiste. Detyrimisht, kategoritë sintaksore duhen konceptuar sipas kriterit dialektik, që do të thotë se ato shihen jo vetëm në kundërvënien me njëra-tjetrën, por edhe se prania e njëres kategori nënkupton praninë e tjetrës, dhe e kundërta, mosprania e njëres kategori nënkupton mospraninë e tjetrës. Ky është një kriter që ka pasur ndikim rrënjësor në konceptimin dhe në trajtimin e kategorive sintaksore të shqipes në gramatologjinë e kësaj periudhe. Gjithashtu, kërkesa për të studiuar faktet gjuhësore në sistem është tipar i njohur i *Kursit të gjuhësisë së përgjithshme* të Sosyrit, por këtë ndërthurje të tipareve të komunizmit enverist me ato të gjuhësisë sosyriane (e jo vetëm), do ta shqyrtojmë më në detaje më poshtë gjatë studimit.

Janë pikërisht konceptet e lartpërmendura ato që përbëjnë thelbin e trajtimit të kategorive sintaksore në sintaksën e Akademisë së Shkencave, e cila është vepra më e cituar dhe e mësuar në auditorët shqiptarë edhe sot e kësaj dite. Në përgjithësi, pjesa dërrmuese e sintaksave shqipe të botuara më pas, në thelb nuk ndryshojnë prej Sintaksës së Akademisë. Për këtë arsye, tiparet e gjuhësisë komuniste enveriste dhe mënyra e reflektimit të tyre në studimet sintaksore shqiptare do të shqyrtohen më hollësisht në vijim, jo vetëm sepse kanë ndikuar thellësisht, por edhe sepse ende vazhdojnë të ndikojnë dhe të jenë frymë mbizotëruese në studimet sintaksore shqiptare të botuara e të mësuara në universitetet tona.

### **1.1. Reflektimi i tipareve të ideologjisë komuniste-enveriste në studimet sintaksore shqiptare në Shqipëri**

Tipari kryesor i gjuhësisë komuniste-enveriste është vështrimi i gjuhësisë pak a shumë me të njëjtën qasje ideologjike me të cilin u trajtua organizimi social i shoqërisë. Konkretisht, në studimet sintaksore në Shqipëri, që në krye të herës, bie në sy përdorimi i sloganeve politike, ilustrimi i teorisë sintaksore me shembuj të politizuar, moscitimi i literaturës bashkëkohore formaliste dhe jo rrallë, referim eksplicit ndaj materializmit dialektik. Gjithashtu, ligjet e procesit të gjenerimit të gjuhës konsiderohen vetëm ligje sociologjike. Më specifiku, në sintaksën shqipe gjuha shihet vetëm si produkt shoqëror. Gramatika universale, koncept i Laibnicit i vazhduar nga shkolla sosyriane dhe i rimarrë e i përpunuar nga gramatika gjenerative, nuk pranohet, për arsye se përbën shfaqje të idealizmit dhe formalizmit në gjuhë.

Sipas materializmit dialektik, ideologjia, shenja dhe komunikimi nuk mund të ndahen nga realiteti material; aspekti fizik dhe kuptimor i shenjës janë të pandashëm



dhe nuk mund të studiohen të veçuar nga njëri-tjetri (Volosinov, 1929). Parimi i unitetit të kundërvënies binare është gjithmonë në veprim. Ashtu si forma me përmbajtjen, edhe gjuha me mendimin shihen në unitet dialektik. Ato nuk abstragohen nga njëra-tjetra. Rrjedhohat dhe pasojat e këtij këndvështrimi në sintaksën e shqipes janë të shumta. Po përmendim vetëm disa.

a) Në vitet e sundimit të komunizmit enverist në Shqipëri, një akuzë, zyrtare ose jo zyrtare, për pikëpamje të huaja në gjuhësi, apo për të qenit kundër zbatimit të filozofisë marksiste në gjuhë, kishte pasoja të rënda për jetën e gjuhëtarit dhe të familjes së tij. Për ilustrim, sjellim në kujtesë fatin e gjuhëtarit të mirënjohur Selman Riza, i cili në vitet gjashtëdhjetë u përjashtua zyrtarisht prej veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe përfundoi ciceron në muzeun e Beratit, pikërisht me këto akuza. Në një klimë të tillë frike dhe terrori të diktaturës komuniste-enveriste, është e kuptueshme që kategoritë e zbrazëta sintaksore (*gjurmët si një formë e elipsës, pro etj.*) nuk do të pranoheshin në gramatologjinë gjuhësore të pasditeve 60'të në Shqipëri, edhe për faktin se ishin kritikuar si shfaqje e idealizmit dhe formalizmit në gjuhë. Për më tepër, nuk mund të mohohet fakti që një pjesë e gjuhëtarëve, ashtu si dhe shumica e popullit shqiptar, ishin të indoktrinuar nga ideologjia politike e periudhës për të cilën po flasim.

Për hir të së vërtetës, duhet përmendur edhe ndikimi i madh i drejtimit gjuhësor më me ndikim të periudhës së marrë në studim, konkretisht i gjuhësisë strukturaliste. Gjuhësia strukturaliste nuk erdhi në variantin sosyrian në gjuhësinë shqiptare në Shqipëri, por nëpërmjet interpretimeve filozofike e ideologjike të gjuhëtarëve rusë të përkthyer në Shqipëri e të shumë gjuhëtarëve nga Shqipëria që kishin studiuar në Rusi.

Pra, mospranimi i kategorive të zbrazëta në sintaksë lidhet me faktorë të ideologjisë politike të sistemit në fuqi, por edhe të ideologjisë gjuhësore të periudhës së marrë në shqyrtim. Sidoqoftë, vlen të shënohet se në përgjithësi teoria sintaksore në Shqipëri në këtë periudhë ka mangësi të mëdha, gjë që shpjegohet edhe me faktorë të tjerë jo ideologjikë.

b) Parimet e lidhjes dialektike të gjuhës me mendimin, si dhe të kundërvënies binare, të materializmit dialektik shfaqet të zbatuara me përpikëri në sintaksën e shqipes në interpretimin e gjymtyrëve kryesore të fjalisë si kryefjalë, si kallëzues, apo thjesht si kryegjymtyrë. Në përputhje me parimet e materializmit dialektik, kategoritë e kryefjalës dhe të kallëzuesit në sintaksën shqipe shihen në kundërvënie me njëra-tjetrën. Jashtë kësaj kundërvënieje nuk pranohet as kryefjalë, as kallëzues, por vetëm gjymtyrë kryesore (kryegjymtyrë) (Totoni, 1981: 109). Të shohim, p.sh., fjalitë që kanë të shprehur fonetakisht vetëm foljen:

Po *shkoj*.

Do të *nisem* që tani.

S'më *flibet*.

(Sintaksa e Akademisë, 1996: 110,114).

Interpretimi sintaksor i dhënë në Sintaksën e Akademisë për këto fjali është që ato nuk kanë kallëzues, megjithëse kryefjala apo subjekti i veprimit nënkuptohen lehtë. Këto fjali kanë vetëm kryegjymtyrë. Ky parim përbën thelbin e teorisë së strukturës sintaksore të fjalive në shqipe (fjali njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe, me nëntipat përkatës të tyre).

c) Parimi i unitetit dialektik & mospranimi i ideale (kategorive të zbrazëta) në gjuhë e detyron gjuhëtarin M. Totoni të pranojë si kallëzues edhe pjesë të pandryshueshme të ligjëratës (pjesëza, pasthirmma, onomatope) në fjalitë që kanë kryefjalë të realizuar fonetikiisht, por nuk kanë një kallëzues të shprehur fonetikiisht. P. sh.:

Në këtë kohë *tërr* telefoni!

Zagarët *ham ham!*

Ne *po se po*.

(E njeh ti atë djalë?) – *Po. – Ab!* – tha Prela.

(Sintaksa e Akademisë, 1996: 173, 197)

Në kuadër të parimit të unitetit dialektik dhe të mospranimit të kallëzuesit të eliptuar/ nënkuptuar, autori ka vetëm dy mundësi: 1) të pranojë që në këto fjali nuk ka as kryefjalë, as kallëzues, por vetëm një kryegjymtyrë të realizuar me emër në rasën emërore; 2) t'i interpretojë fjalitë me kryefjalë dhe kallëzues, por kallëzuesi në këtë rast do të jetë një onomatope (*tërr, ham-ham*), pjesëz (*po, po se po*) apo pasthirmë (*ab*). Autori ka zgjedhur qëndrimin e dytë, duke përdorur argumentin se onomatopetë, pjesëzat dhe pasthirrat janë kallëzues, pasi transmetojnë idenë e një veprimi ose shprehin një vlerësim subjektiv-emocional të kryefjalës (Totoni, 1978: 77)<sup>1</sup>. Në fakt jemi të mendimit se veprimi ose vlerësimi subjektiv-emocional i kryefjalës shprehet nga folja e eliptuar, e cila në disa prej fjalive të mësipërme nënkuptohet edhe pa kontekst:

Në këtë kohë tërr ia *bëri* telefoni!

<sup>1</sup> Një trajtim i tillë mund të mendohej se e ka burimin në punën e Vilhelm Wundt-it, sipas të cilit, një pasthirmë mund të barazohet me fjalinë, pasi ajo mund të shprehë predikatin logjik. Megjithatë, duke marrë parasysh se Totoni ka shkruar mjaft në punën e vet mbi zbatimin e parimit të unitetit dialektik si parim bazë për identifikimin e gjymtyrëve kryesore të fjalisë, si dhe duke vlerësuar faktin që ai e ka kritikuar fort ndikimin e drejtimit logjik në gjuhësinë shqiptare, jemi të prirur të mendojmë se nuk kemi të bëjmë me ndikim nga Wundt-i.

Zagarët *lebnin* ham-ham!

E njeh ti atë djalë? – Po, e *njob*.

Absurditeti i këtij trajtimi rritet edhe më po të sjellim kujtesë se, në përgjithësi, kallëzuesit e shprehur me forma të pashtjelluara foljore nuk pranohen, megjithëse janë mirëfilli folje<sup>2</sup>.

d) Rolet tematike (theta), të cilat zënë vend me rëndësi në teorinë gjuhësore perëndimore që me punimet e Gruber 1965, Fillmore 1968, nuk kanë gjetur vend në studimet sintaksore shqiptare në Shqipëri për motivin e thjeshtë se përfaqësojnë një mjet *formal* të paraqitjes së strukturës argumentore sintaksore<sup>3</sup>. Mospranimi i kësaj teorie në sintaksën e gjymtyrëve të dyta të fjalisë në gjuhën shqipe, ka sjellë vështirësi të mëdha në përkufizimin, përcaktimin dhe dallimin e këtyre kategorive nga njërta-tjetra. Rrethorët dallohen me vështirësi nga kundrinorët me parafjalë dhe shpesh merren si të tillë (Kananaj, 2009, 2012a, 2012b). Mjaft problematikë paraqiten edhe përcaktorët kallëzuesorë, kategoria e të cilëve nga disa studiues madje as nuk pranohet (Kananaj, 2012a, 2012b).

e) Tipar tjetër që është vënë në dukje nga studiuesit për studimet sintaksore shqiptare të periudhës së komunizmit enverist, por edhe më pas, është ndikimi i gjuhësisë strukturaliste evropiane, përfshi pararendësin e saj, Sosyrin. Si shpjegohet kjo? *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme* Sosyrit jo vetëm që njihej mirë, por pati ndikim të madh te gjuhëtarët e rinj rus. Sidoqoftë, disa prej ideve sosyriane u kundërshtuan nga strukturalizmi evropian, por edhe nga materializmi komunist, i cili orientonte gjuhësinë ruse. Kjo bëri që në studimet e gjuhëtarëve të rinj rus të shihej një ndërthurje e koncepteve sosyriane me ato marksiste e strukturaliste. Të njëjtat karakteristika të ndërthurjes së tipareve të gjuhësisë “marksiste”, sosyriane e strukturaliste vërehen edhe në sintaksën shqipe, gjë që u vu në dukje edhe më lart.

Pas kësaj paraqitjeje, natyrshëm shtrohet pyetja: A njihej sintaksa formale nga

<sup>2</sup> Në Sintaksën e Akademisë pranohet se kallëzuesi foljor mund të shprehet me një formë foljore të pashtjelluar pranë një kryefjalë të realizuar fonetikisht, si në shembullin: *Ai erdhi pa dalë dielli* (1995: 179). Sidoqoftë, rastet e realizimit të formave të pashtjelluara me kryefjalë eksplicite janë të rralla dhe nuk përbëjnë modelin e përgjithshëm të realizimit strukturor të tyre. Për më tepër, ky qëndrim nuk përkrahet nga të gjithë sintaksologët në Shqipëri.

<sup>3</sup> Sipas Butt (2005), teoria e roleve tematike, të cilat njihen ndryshe si rolet *Kāraka*, në të vërtetë i ka fillesat në shek. VI P.K. në gramatikën e parë për një gjuhë njerëzore, shkruar nga Pānini për gjuhën sanskrite. Gramatika e Pāninit kaloi në heshtje për 2500 vjet, pasi tradita gjuhësore e filozofike perëndimore, të paktën deri në shek. XIX, është bazuar ekskluzivisht në trashëgiminë greko-romake. Koncepti i rasave semantike erdhi në vëmendjen e gjuhëtarëve perëndimorë me analizën semantike të rasave nga Blake (1930), por mori zhvillim të vërtetë në punimet e gjuhëtarëve Grubber dhe Fillmore.

gjuhëtarët shqiptarë? Në biseda personale, disa sintaksologë e gjuhëtarë që kanë punuar në Institutin e Gjuhësisë, Tiranë, në periudhën e komunizmit enverist, kanë pohuar se e kanë njohur gjuhësinë formale, madje e kanë vlerësuar dhe janë përpjekur të përfitojnë prej saj<sup>4</sup>. Një argument në mbështetje të këtij pohimi vjen nga ekzistenca në Institutin e Gjuhësisë, Tiranë, e disertacionit *Théorie et méthode en syntaxe (Teori dhe metodë në sintaksë)*, të gjuhëtarit rumun Sorin Stati, botim i Akademisë RSR, Bukuresht (1967)<sup>5</sup>. Në këtë disertacion të përkthyer në gjuhën shqipe trajtohen çështje të gjuhësisë së përgjithshme dhe hulumtohet e citohet gjerësisht sintaksa bashkëkohore formale. Sjellim gjithashtu në vëmendjen tonë se shumë prej gjuhëtarëve dhe sintaksologëve më të mirë shqiptarë studiuan në Rusi. Por edhe për ata që nuk kishin studiuar në Rusi, gjuha dhe literatura ruse njihej mirë. Ndonjë gjuhëtar tjetër ka pohuar se Sosyri, Blumfildi dhe Hjelmslevi anatemohehin<sup>6</sup>. Këto argumente tregojnë se sintaksa formale njihej nga gjuhëtarët në Shqipëri, por mospranimi i gjuhësisë formale mund të ketë qenë rezultat i një sërë faktorëve. Konkretisht: a) rezultat i frikës së ndëshkimit nga diktatura komuniste-enveriste, b) rezultat i indoktrinimit nga ideologjia komuniste-enveriste, dhe c) deri diku edhe rezultat i ndikimit të strukturalizmit gjuhësor që lindi në atë periudhë.

## **2. Ndikime të ideologjisë gjuhësore të preskriptivizmit në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri**

Shkenca nuk e përjashton ideologjinë. Ideologjia ka një ekzistencë gjuhësore dhe gjuha ka një ekzistencë ideologjike (Foucault, 1972:186). Midis shumë ideologjive gjuhësore që kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve bashkëkohorë të gjuhës, është edhe preskriptivizmi. Në gjuhësinë e huaj, duke filluar nga mesi i shekullit të kaluar, studimet dhe punimet gjuhësore nuk mendohen preskriptiviste, madje preskriptivizmi nuk mendohet më si objekt studimi i gjuhëtarëve. Shumë gjuhëtarë të njohur i kanë analizuar me thellësi të metat e preskriptivizmit dhe i kanë mëshuar fort faktit se gjuhësia bashkëkohore duhet të jetë deskriptiviste (Milroy & Milroy, 1985: 1-17; Pinker, 1994: 370-403; Pullum, 2004). Në kontekstin shqiptar, ideologjia preskriptiviste ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në standardizimin e gjuhës shqipe, për të cilën është luftuar, madje është derdhur gjak, nga shumë mësues, gjuhëtarë e patriotë shqiptarë. Në këtë situatë kaq specifike për gjuhën dhe popullin shqiptar, është e kuptueshme që preskriptivizmi është bërë ideologjia gjuhësore

<sup>4</sup> Përmendim këtu gjuhëtarë si R. Përnaska, S. Mansaku, A. Duro etj.

<sup>5</sup> Këtë disertacion të përkthyer në shqipe e kam konsultuar personalisht.

<sup>6</sup> R. Memushaj, Seminari 24, vëll. 1, f. 284.

sunduese e pesëdhjetë viteve të fundit. Përmendim gjithashtu domosdoshmërinë e preskriptivizmit në hartimin e teksteve mësimore të të gjitha niveleve të arsimit shqiptar, si dhe në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies së gjuhës shqipe në shkollë. Sidoqoftë, krahas anëve pozitive të ideologjisë preskriptiviste, zbatimi shabllon dhe çuarja në ekstrem e preskriptivizmit kanë nxjerrë në pah disa mangësi, për të cilat do të flitet në vijim.

### a) Preskriptivizmi dhe shumëkuptimësia strukturore

Dihet që funksioni i preskriptivizmit është normativizimi i gjuhës, veçanërisht në ligjërimin e shkruar. Nga dy a më shumë forma a struktura gjuhësore paralele me të njëjtin kuptim, zakonisht mund të ngrihet në normë njëra. Kështu, në rastin e ndërtimeve *emër jofoljor + emër me parafjalë që shpreh një karakteristikë cilësore + emër në gjinore*, p.sh. *truallë me kashtë i kolibes*, emri me parafjalë, sipas Totonit (1981, 1983:72), qëndron para emrit në gjinore. Rendi i anasjelltë mund të shkaktojë dykuptimësi, prandaj, sipas autorit, duhet shmangur. Po e ilustruam me dy shembuj të autorit:

- (a) aeroplanët prej letre të Pacit
- (b) shtëpitë pa oborr të Naforës

(Totoni, 1981)

Në shembullin (a) emri në gjinore strukturalisht mund të përcaktojë përbërësin e parë të sintagmës (aeroplanët), përbërësin e dytë (letra), ose të dy përbërësit njëkohësisht (aeroplanët, letra). Pra kemi këto interpretime: (1) aeroplanët janë të Pacit, (2) letra është e Pacit, (3) të dyja, edhe aeroplanët, edhe letra janë të Pacit. E njëjta analizë mund të bëhet edhe për shembullin e dytë. Konkretisht, (1) shtëpitë mund të jenë të Naforës, (2) oborri mund të jetë i Naforës, (3) edhe shtëpitë, edhe oborri mund të jenë të Naforës.

Në të tilla raste, rregullat preskriptive sugjerojnë mënjanimin e përdorimit të strukturave të shumëkuptimta dhe të paqarta: “*Në gjuhën e përpunuar duhet të ketë një strukturë të qartë të tillë që të mos lejojë dykuptimësi. ... Është detyra jonë t’i shoshitim të gjitha lëvizjet që bëhen në strukturën e gjuhës, si pasojë e veprimit të faktorëve të brendshëm ose e ndikimit të faktorëve të jashtëm, të ndihmojmë të gjitha ato lëvizje që përsosin strukturën, dhe të frenojmë e t’i shmangim ato që e ndërlikojnë dhe e bëjnë të paqartë atë*” (Totoni, 1983: 74).

A mund të konsiderohet i zgjidhur problemi i shumëkuptimësisë strukturore me anë të mënjanimin të ndërtimeve të shumëkuptimta? Nëse mendohet kështu, cili nga përbërësit duhet mënjano dhe çfarë kriteresh duhen përdorur për këtë? Këto pyetje presin përgjigje nga sintaksologët preskriptivistë. Ç’është më e rëndësishmja, a ka gjetur vend në ligjërimin e shkruar ose të folur të shqipes ky lloj rekomandimi?

Vëzhgimet tregojnë që jo. Ligjërimi i folur e i shkruar është i mbushur me struktura të shumëkuptimta. Për ta konkretizuar, të marrim një shembull të freskët nga televizioni:

Ai u hodh nga ura me litarë.

Kjo fjali mund të interpretohet në disa mënyra, përkatësisht:

- a) Ai u hodh me litarë.
- b) Ai u hodh nga ura, e cila ishte me litarë.
- c) Edhe hedhja u bë me litarë, edhe ura ishte me litarë.

Në kontekstin real, ishte e qartë që fjalia kishte kuptimin (b), d.m.th., ai u hodh nga një urë e cila ishte me litarë. Shembuj si ky mund të sillen shumë. Ligjërimi, i shkruar ose i folur, është i lidhur ngushtë me kontekstin situativ, i cili bën edhe procesin e sqarimit. Ky fakt tregon se ligjërimi mund ta tolerojë shumëkuptimësinë më shumë nga sa mendohet nga preskriptivistët. Atëherë përse duhen sajuar rregulla për të shmangur shumëkuptimësinë në ligjërimin gjuhësor? Rregullat preskriptive të kësaj natyre e ngurtësojnë gjuhën dhe humbasin fuqinë dhe zhdërvjelltësinë sintaksore të asaj.

### **b) Preskriptivizmi dhe rendi i përbërësve sintaksorë**

Në sintaksat dhe studimet gramatikore të shqipes është shkruar se rendi normativ i fjalëve në fjalinë dëftore në gjuhën shqipe është kryefjalë – folje – kundrinë. Nisur nga kjo, mësuesit e gjuhës shqipe e imponojnë këtë rregull jo vetëm ligjërimin e shkruar, por edhe në ligjërimin e folur, me anë të kriterit pedagogjik të ‘përgjigjes me fjali të plotë’. Nxënësit duhet të përgjigjen me fjalinë e formulizuar *kryefjalë + folje + kundrinë*. P.sh.:

Çfarë po bën nxënësi?

Përgjigja “Po lexon” do të korrigjohej nga mësuesi menjëherë si “përgjigje jo e saktë”. Përgjigje e saktë do të pranohej vetëm “Nxënësi po lexon librin”. Moskuptimi i faktit që rregullat preskriptive i drejtohen në radhë të parë gjuhës së shkruar, ka çuar në situata si kjo, ku rregullat standardizuese çohen në ekstrem nga mësuesit. Veçse një ngurtësim i tillë i gjuhës dëmton fuqinë dhe zhdërvjelltësinë sintaksore të shqipes, madje aq shumë, sa e nxjerr shqipen jashtë natyrës së saj.

**c) Preskriptivizmi, korrektësia, gramatikaliteti dhe pranueshmëria**

Ideja se gjuha mësohet në shkollë, është mjaft e përhapur. Kur shqiptarët shkruajnë apo shqiptojnë fjali “jogramatikore”, kjo i atribuohet gjithmonë mangësive të krijuara në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë. Gramatika, sipas ideologjisë preskriptiviste të standardizimit, mendohet si një sërë rregullash që i imponohen përdorimit të gjuhës, bazuar në parimin e korrektësisë. Në përgjithësi, këto rregulla përqendrohen në përforcimin e strukturave sintaksore korrekte, përkundrajt ndalimit të atyre strukturave sintaksore që janë përshkruar si jokorrekte. Të marrim, p.sh., një folës të shqipes që thotë:

Kam *me dal* sot.

Kam *punu* shumë sot.

Këto fjali janë ndërtime jokorrekte në shqipen standarde, pasi standardi nuk e përmban infinitivin geg dhe pjesoren e shkurtuar. Rrjedhimisht, fjalitë e sapopërmendura konsiderohen jogramatikore. Për shumë folës amtarë të shqipes, këto struktura janë pjesë e gramatikës së tyre, të përvetësuar qysh në fëmijëri. Në të vërtetë, të gjithë folësit amtarë kanë njohuri të brendshme për gjuhën shqipe, gjë që u mundëson të përdorin dhe kuptojnë gjuhën. Është pikërisht kjo njohuri e brendshme që e mundëson folësin të gjykojë nëse një ndërtim i caktuar sintaksor është i mundshëm në gjuhën shqipe apo jo. Deri në kohën që fëmija hyn në shkollë, e ka përvetësuar gramatikën në mënyrë të tillë, saqë ajo që ai di për gramatikën e shqipes, është shumë më e madhe nga ajo që nuk di, me gjithë ndonjë pasaktësi të vogël në performancë. Pra, ideja se gjuha mësohet në shkollë nuk është mbështetur fort me argumente. Fëmijët mësojnë të shkruajnë e të lexojnë standardin në shkollë, mësojnë gjithashtu një sërë rregullash preskriptiviste për strukturat korrekte e jokorrekte në shqipen standarde. Pranueshmëria dhe gramatikaliteti janë dy gjëra që nuk duhet të ngatërrohen me zbatimin e rregullave preskriptiviste për standardin. Kështu, fjalitë e mësipërme janë të pranueshme për një grup shqipfolësish dhe të papranueshme për disa të tjerë, në varësi të gramatikës së dialektit të tyre. Ato fjali janë plotësisht gramatikore, d.m.th. janë pjesë e sistemit gramatikor që folësit amtarë të shqipes kanë përvetësuar qysh në fëmijëri, por janë jokorrekte në shqipen standarde. Dallimi i parimit preskriptiv të korrektësisë nga pranueshmëria e gramatikaliteti, ka rëndësi jo vetëm për njohjen dhe mësimin e gjuhës shqipe, por edhe që të shmanget stigmatizimi i drejtpërdrejtë, shpesh i vetëdijshëm, i strukturave gramatikore të varianteve të shqipes jostandarde.

#### **d) Preskriptivizmi dhe gramatikat mësimore**

Tekstet mësimore, universitare ose parauniversitare, përshkruajnë kryesisht shqipen standarde. Në tekste universitare mungon përshkrimi dhe studimi i strukturave sintaksore tipike të varianteve jostandarde të shqipes, megjithëse këto struktura të shqipes mund t'i gjejmë të përshkruara e të analizuar në literaturën e huaj bashkëkohore. Pjesa më e madhe e studentëve dhe mësuesve të gjuhës shqipe i konsiderojnë jogramatikore strukturat sintaksore të varianteve të shqipes jostandarde. Studimi i strukturave sintaksore jostandarde në gramatikat shqipe nuk e dëmton procesin e përvetësimit të shqipes standarde, përkundrazi. Sintaksa e shqipes standarde nuk mund të mësohet me efikasitet derisa mësuesi të ketë një koncept të qartë për ndryshimet sistematike midis variantit standard dhe dialekteve të gjuhës shqipe që flasin nxënësit e tij. Studimet e thelluara sintaksore për variantet e tjera të shqipes ndihmojnë për të kuptuar më mirë se çfarë është gjuha standarde, çfarë roli dhe funksioni ka ajo. Për më tepër, nisur nga karakteri arbitrar i shenjës, nuk ka arsye për të menduar se struktura të caktuara gjuhësore janë “superiore” dhe si të tilla përbëjnë një objekt me vlerë studimi për gramatikën e shqipes, ndërsa disa struktura të tjera janë “inferiore”, prandaj nuk mund të përfshihen në to. Teoria sintaksore bashkëkohore kërkon që të përshkruhen dhe të analizohen strukturat sintaksore të ligjërit të shkruar e të folur të gjithë varianteve të gjuhës shqipe, jo vetëm të standardit. Kjo shtron nevojën e hartimit të një sintakse të re të shqipes, e cila të jetë tërësisht deskriptive dhe të studiojë në mënyrë sa më përfaqësuese jo vetëm strukturat e shqipes standarde, por edhe të varianteve të tjera të shqipes jostandarde.

Në mbyllje, theksoj përsëri se kritikën e mësipërme ndaj preskriptivizmit nuk duhet interpretuar si kritika ndaj gramatikës në përgjithësi dhe si kundërvënje ndaj mësimimit të shqipes standarde. Preskriptivizmi është i nevojshëm për mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës shqipe në shkollë, por zbatimimi i verbër dhe në mënyrë jokritike i rregullave dhe parimeve preskriptive në gjuhë, sidomos kur këto rregulla i imponohen gjuhës së folur, sjell më shumë dëme sesa dobi.

#### **Përfundime**

Nga ky studim arrijmë në përfundimin se studimet sintaksore shqiptare në Shqipëri kanë ndikime të forta nga ideologjia, e cila shfaqet shfaqet në dy forma më përfaqësuese: 1) ideologjia politike, dhe 2) ideologjitë gjuhësore. Ideologjia politike që ka vepruar në Shqipëri pas viteve të çlirimit është ajo e komunizmit enverist. Ajo ka pasur ndikime në studimet sintaksore në dy forma: a) nëpërmjet indoktrinimit, dhe b) duke ushtruar dhunë e terror. Ideologjia gjuhësore ndikon në studimet sintaksore me anë të disa formave: a) nëpërmjet strukturalizmit gjuhësor, b) nëpërmjet preskriptivizmit, dhe c) nëpërmjet planifikimit gjuhësor (ideologjia e standardizimit).



Të gjitha këto ideologji jo vetëm që kanë ndikuar fort, por kanë vepruar paralelisht dhe në mënyrë të gërshetuar me njëra-tjetrën në studimet sintaksore të shqipes në Shqipëri. Fatkeqësisht, ndikimi i tyre nuk mund të konsiderohet pjesë e së shkuarës, pasi ai vazhdon edhe sot.

Shkenca e sintaksës bashkëkohore i konsideron këto ideologji tashmë të kapërcyera, prandaj është momenti që studimet shkencore sintaksore shqipe të çlirohen nga këto ideologji. Kjo shtrou nevojën e hartimit të një sintakse të re të gjuhës shqipe, e cila duhet të reflektojë arritjet e teorisë sintaksore bashkëkohore. Gjithashtu, kjo sintaksë duhet të jetë tërësisht deskriptive dhe të përshkruajë e analizojë në mënyrë sa më përfaqësuese variantet e shqipes, ndër të cilat standardi është vetëm njëri.

### **Bibliografia:**

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. 1996. *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.
2. Bauman, Richard and Charles L. Briggs. 2003. *Voices of Modernity: Language ideology and the politics of inequality*. Cambridge: Cambridge University Press.
3. Blake, Frank R. 1930. A Semantic Analysis of Case. In: *Curme Volume of Linguistic Studies*. Ed. by J. T. Hatfield, W. Leopold, A. J. Friedrich Zieglschmid.
4. Butt, Miriam. 2005. *Theories of Case*. Cambridge: Cambridge University Press.
5. Eagleton, Terry. 1991. *Ideology: An introduction*. London & New York: Verso.
6. Fillmore, Charles J. (1968). The Case for Case. In Emmon Bach, and Robert T. Harms (eds.), *Universals in Linguistic Theory*, 1-88. New York: Holt, Rinehart and Winston.
7. Floqi, Spiro. 1978. Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme letrare, *Studime Filologjike* 4: 25-52.
8. Foucault, Michel. 1972. *The Archaeology of Knowledge* (translated from the French by A. M. Sheridan Smith). London: Routledge.
9. Gruber, Jeffrey. 1965. *Studies in lexical relations*. Ph.D Dissertation, Massachusetts Institute of Technology.
10. Higgs, Robert. 1987. *Crisis and Leviathan*. Oxford: Oxford University Press.
11. Irvine, Judith T. & Susan Gal. 2000. Language ideology and linguistic differentiation. In P. V. Kroskrity (ed.), *Regimes of language: Ideologies, politics, and identities*, 35-84. Santa Fe: School of American Research Press.

12. Joseph, D. John & Taylor, J. Talbot. 2014. Introduction: Ideology, Science and Language. In: *Ideology of language. Ideologies of Language* (RLE Linguistics A: General Linguistics) (Routledge Library Editions: Linguistics), pp. 1-6.
13. Kananaj, Anila. 2008. Çështje të rrethanorit në gjuhën shqipe, *Studime filologjike* 1-2: 127- 137.
14. Kananaj, Anila. 2009. Teoria e roleve tematike dhe probleme që lidhen me të në gjuhën shqipe. *Studime Filologjike* 3-4: 111-126.
15. Kananaj, Anila. 2012 (a). Mbi konstruktet predikative të shqipes standarde. Në *Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax* (*Studime teorike dhe empirike në fushën e sintaksës së shqipes*), 75-92, München: Lincom Europa.
16. Kananaj, Anila. 2012 (b). *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe*. Disertacion, Universiteti i Tiranës.
17. Koerner, E. F. K. Linguistics and Ideology in 19-th and 20-th century studies of language. In: Dirven, René, Bruce Hawkins and Esra Sandikcioglu (eds.), *Language and Ideology: Volume 1: Theoretical cognitive approaches*. 2001. vi, pp. 253–276.
18. Mar-Molinero, Clare & Patrick Stevenson (eds.). 2006. *Language ideologies, policies, and practices: language and the future of Europe*. Houndmills: Palgrave Macmillan.
19. Milroy, James & Lesley Milroy. 1985. *Authority in Language: Investigating Language Prescription and Standardisation*. Third edition. 2002. Taylor & Francis e-Library.
20. Pinker, Stephen. 1994. *The language instinct*. Harmondsworth: Penguin.
21. Pullum, Geoffrey K. 2004. Ideology, Power and Linguistic Theory. Presented in a special session at the Convention of the Modern Language Association, Philadelphia, Pennsylvania, December 2004. Revised draft paper, 12 pages, available in two-up form (prints on 6 sides, landscape mode): PDF version [people.ncsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf](http://people.ncsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf)
22. Register, Brian. 2001. Class, hegemony and ideology: A libertarian approach. Paper on Premises of Post-Objectivism website: <http://folk.uio.no/thomas/po/class-hegemony-ideology-lib.html>, hapur më 20 nëntor 2014.
23. Saussure, Louis De & Peter Schulz (eds.), *Manipulation and ideologies in the twentieth century*. Amsterdam: Benjamins, 2005.
24. Schieffelin, Bambi B., Kathryn A. Woolard & Paul V. Kroskrity. 1998. *Language Ideologies: Practice and Theory*. Oxford: Oxford University Press.

25. Silverstein, Michael. 1979. Language structure and linguistic ideology. In R. Cline, W. Hanks, and C. Hofbauer (eds.), *The Elements: A Parasession on Linguistic Units and Levels*, 193-247. Chicago: Chicago Linguistic Society.
26. Simpson, Paul. 1994. *Language, ideology, and point of view*. London: Routledge.
27. Stalin, Josif V. (1950). *Marxism and problems of linguistics*. Peking: Foreign Languages Press, 1972.
28. Stati, Sorin. 1967. *Théorie et méthode en syntaxe*. Disertacion. Akademia e RSR, Bukuresht. Përkthyer në gjuhën shqipe nga Fija.
29. Totoni, Menella. 1981. Çështje të gjymtyrëve të fjalisë. *Studime Filologjike* 3: 109-115.
30. Totoni, Menella. 1981. Rendi i përcaktorëve të një gjymtyre. *Mësuesi*. Qershor, 10.
31. Totoni, Menella. 1983. Rreth rendit dhe trajtës së gjymtyrëve plotësuese. *Gjuba jonë* 2: 71-74.
32. Totoni, Menella. 1978. Kallëzuesi në shqipen e sotme letrare. *Studime Filologjike* 1: 55-83.
33. Volosinov, Valentin N. (1929). *Marxism and the philosophy of language*. Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1973.
34. Wodak, Ruth (ed.). 1989. *Language, power, and ideology; Studies in political discourse* (Series in Critical Theory, volume 7). Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
35. Woolard, Kathrine A. 1998. Introduction: Language ideology as a field of inquiry. In Bambi Schieffelin, Kathryn Woolard, and Paul Kroskrity (eds.), *Language Ideologies: Practice and Theory*, 3-47. Oxford: Oxford University Pre



**Bardh RUGOVA**

## **IDEOLOGJIA E PRESKRIPTIVIZMIT NË GJUHËN SHQIPE**

Synim i këtij hulumtimi është që, duke e pasur parasysh se preskriptivizmi është ideologji më vete, të hetojë ndikimin e tij në gjuhësinë shqiptare, si rast të veçantë studimi.

Ky është një metastudim, i cili i bën analizë diskursit të përdorur në shkrimet e gjuhëtarëve preskriptivë shqiptarë të viteve tetëdhjetë.

Hulumtimi mëton të nxjerrë përgjigjet e pyetjeve:

- Cili ka qenë grupi përfitues?
- Cilat kanë qenë synimet prapa kësaj ideologjie?
- Cilët mekanizma janë shfrytëzuar? dhe

Mirëpo, para kësaj le ta shqyrtojmë nocionin ideologji dhe ta shpërfaqim ideologjinë e këtij punimi.

Foucault (1975) heq dorë nga termi ideologji dhe e zëvendëson me diskurs, duke theksuar se gjuha e përdorur për komunikim mes njerëzish ka funksione të ndryshme dhe se nuk mund të përcaktohet nëse një thënie është ideologjike ose jo, duke e kundruar jashtë kontekstit të përgjithshëm. Autorë të tjerë (Althusser 1971, Johnstone 2008, Eagleton 1991) janë dakord për ta hedhur poshtë argumentin epistemik, në favor të atij politik e social. Të gjithë këta autorë ofrojnë përkufizime të ndryshme të ideologjisë, por po përpiqemi t'i gjejmë të përbashkëtat e secilit:

Ideologjia përfshin një varg nocionesh, nga të cilat mund të kundrohen ndjekja e diskurseve të caktuara në favor të një grupi shoqëror, kryesisht për qëllime pushteti a prestigji. Së këndejmi, për të pasur ideologji, duhet të ketë një grup shoqëror përfitues dhe një diskurs të orientuar drejt këtij synimi.

Në kuptim më të gjerë, autorë postmodernë e kanë përmendur edhe ideologjinë e shkencës, si një formë shoqërore që mëton status prestigji kundruall mënyrave të tjera të jetës. Fayeraband (2011) pohon se pjesë thelbësore të ideologjisë së shkencës janë krijuar mbi bazën e përgjithësimeve superficiale. Ai shton se teoristët imponojnë tirani konceptesh dhe kujton se eksperimentet subjektive e bëjnë jetën të kuptimtë. Koncepti, siç e shohim, madhëron epokën pluraliste, në të cilën edhe argumentet shkencore shihen si kuazinarrativa që garojnë me të gjitha të tjerat për t'u pranuar. Pra, dalin, pak a shumë si kritikë ndaj vijës së demarkacionit dhe konceptit vetëm

deduktivist të shkencës në këndvështrimin poperian të shprehura në pjesën e parë të shekullit XX (Popper 1997, 2005).

Njëherësh është anarki epistemologjike që vë secilin drejtim si pushtet të mundshëm: pushteti i artit, i dijes, i së bukurës...

Ky studim synon një kënd më të ngushtë, në të cilin “diskursi i orientuar” mbështetet ose në besim ose në kontekstualizim të fakteve empirike.

Preskriptivizmi në gjuhësi, sipas Pullumit (2004, 2006), është ideologji më vete – si një prirje për t’iu shmangur studimit, në favor të normëzimit. Sipas tij, preskriptivizmi lidhet me ideologjinë konservatore që mëton ruajtjen e një tradite të caktuar, në dëm të zhvillimit, ndërsa ideologët preskriptivistë e marrin si të mirëqenë punën deskriptive (ose si të panevojshme – mjafton që një klasë e caktuar ta konsiderojë korrekte një formë). Në këtë kuadër, bëhet edhe ngatërrimi i nocioneve – gramatikë vs variant.

Sa për ilustrim:

Trajta: Doli me punue është gramatikore dhe është e shqipes, por është një variant gjuhësor.

Trajta: Ia dha librin atyre, është jogramatikore.

Në rastin e shqipes, krahas kësaj ideologjie, preskriptivizmi ka mbartur edhe ideologji të tjera, pasojat e të cilave vazhdojnë ende.

Për ndikimin e ideologjisë së preskriptivizmit kemi raportuar edhe më parë. Më 2012, kemi raportuar për diskursin e kumtesave për shqipen standarde në konferencat e ndryshme shkencore, përfshirë Seminarin dhe kemi arritur të nxjerrim përfundimin se pos gjuhës subjektive, shmangies së hulumtimit konkret, pjesa më e madhe e punimeve të prezentuara janë, në të vërtetë, vërejtje preskriptive, të cilat i trajtojnë shmangiet nga norma, kryesisht si mostra rasti, pa matje dhe pa mëtim që këto shmangie t’i shfrytëzojnë për përshtetshmëri gjuhësor.

Në këtë metastudim (Rugova 2013), duke hulumtuar 51 artikuj të ndryshëm, kemi nxjerrë përfundimin se 38 sosh kanë trajtim preskriptiv dhe e synojnë “mbrojtjen”, “pastrimin”, “ruajtjen”, e gjuhës.

Në një punim tjetër, (Rugova 2009), kur kemi shqyrtuar konceptin e “gjuhës së popullit”, kemi argumentuar se mekanizmat për kthimin në gjuhën e fshatit, për ngurrosjen e shprehjeve të caktuara popullore dhe fushata për zëvendësimin e fjalës së huaj me fjalë shqipe, kanë bërë rrafshim diskursesh, duke përdorur gjuhën e njëjtë në të gjitha situatat e komunikimit – psh. Një artikull gazete me gjuhë përrallash dhe pamundësi komunikimi për disa fusha të reja, të jetës shkencore, politike – përgjithësisht të jetës urbane, bashkëkohore.

Nocioni “i ruajtjes së shqipes letrare” është parë si pjesë e mekanizmave të njëjtësimimit shoqëror dhe të konformizmit intelektual të kohës. Norma e Kongresit të

Drejtskkrimit ka shërbyer si një nga mjetet për standardizimin dhe uniformitetin e sjelljes shoqërore.

Është sanksionuar me Vendimin nr 50 “Mbi masat për zbatimin e drejtskkrimit të njësuar të gjuhës shqipe”, të datës 8. 3. 1974, nënshkruar nga Mehmet Shehu.

“Partia e Punës dhe pushteti popullor, duke e çmuar gjuhën amtare si një thesar të pazëvendësueshëm, si shprehje e fuqishme të kulturës sonë kombëtare e të shpirtit krijues të popullit, janë kujdesur vazhdimisht për zhvillimin, pasurimin dhe lulëzimin e saj. Kongresi i Drejtskkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbledh në nëntor të vitit 1972, si forumi më i lartë shkencor gjithëkombëtar, pas një diskutimi e analize shkencore të gjerë e të thelluar, miratoi rezolutën ku përcaktohen parimet dhe vijat themelore për hartimin e drejtskkrimit të gjithë shqipe në trajtë përfundimtare”, thuhet aty.

Në vendim, në 7 pika, kërkohet zbatimi i detyrueshëm i normës dhe kërkohet ndihmë e institucioneve shkencore për këtë.

1. Rezoluta e Kongresit të Drejtskkrimit të përkrahet nga të gjitha organet shtetërore dhe “Drejtskkrimi i gjuhës shqipe”, i hartuar në bazë të kësaj rezolute, si drejtskkrimi i parë i njësuar në historinë e gjuhës sonë letrare kombëtare, të zbatohet detyrimisht në të gjithë veprimtarinë arsimore e botuese, si edhe në gjithë veprimtarinë tjetër shtetërore e shoqërore.

Krahas kësaj, ndërhyrja në punën kërkimore të gjuhëtarëve u shpreh me vendimin nr. 82, “për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe”. Në mesin e pesë pikave të këtij vendimi, këtu thuhet: Akademia e Shkencave, ministritë dhe institucionet e tjera kërkimore-shkencore, Universiteti i Tiranës dhe të gjitha shkollat e vendit tonë të përfshijnë kryerjen e detyrave që u dalin në këtë fushë në planet e tyre vjetore dhe të ngarkojnë për këtë njerëzit më të aftë e më të përgatitur.

Ky studim mëton të nxjerrë në pah këtë ideologji brenda shqipes. Për këtë studim janë nxjerrë qëndrimet e disa autorëve preskriptivistë më me ndikim të asaj kohe. Për nevoja praktike, të gjitha janë nga i njëjti vëllim. Janë mendime të përsëritura gjithandej, por këto janë vjelë nga vëllimi “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”. Shembujt dhe autorët janë zgjedhur sipas peshës së tyre dhe namit.

1. Kostallari (1989:11): Politika gjuhësore e Partisë sonë, e shoqërisë së re shqiptare, duke i lidhur në një fill të vetëm të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen, i ka çuar shumë më përpara idetë e Rilindjes dhe u është përgjigjur e u përgjigjet tre (sic) qëllimeve themelore a. të lehtësojë e të forcojë funksionin komunikues të gjuhës shqipe si tipar dallues a si mjet

përparimi për gjithë kombin dhe ta ngrejë e ta mbajë këtë gjuhë në shkallën e kulturës botërore bashkëkohore; b. t'i ruajë gjithnjë të gjalla lidhjet e gjuhës letrare me gjuhën popullore; c. të ruajë e të zhvillojë më tej traditat kombëtare të gjuhës letrare dhe vetëqenien e origjinalitetin e saj, si shprehëse e kulturës së lashtë e të re, origjinale të popullit shqiptar dhe e njësisë së tij shpirtërore, si forcë aktive për këtë njësi. Kjo politikë gjuhësore, që mishëron dëshirat më të zjarra të popullit tonë, ka vepruar jo në rrugë thjesht administrative, por nëpërmjet shkencës gjuhësore (sic), shkollës, botimeve, radiotelevizionit, teatrit, kinematografisë etj.

...Dialektet e shqipes... në kohën tonë janë kategori mbeturinore në rrugën e shuarjes (ibid.)

...Kështu zgjidhja e problemit të gjuhës sonë letrare kombëtare u pranua jo vetëm nga shkenca gjuhësore, por edhe nga shoqëria (Kostallari 1989:12).

Siç mund të vërejmë këtu, Kostallari e përcakton qartë “Politikën gjuhësore të Partisë sonë” si detyrë që duhet arritur e realizuar. E përmend nocionin e “njësimit”, pra uniformitetin shoqëror që qe prioritet i kësaj politike. Në këto mendime, qartazi preskriptive, sepse jepet një lloj udhëzimi a urdhëri i sjelljes dhe i veprimit, tregohet për mbështetjen që i jep “shkenca” politikës gjuhësore të partisë, tok me mekanizmat e tjerë: shkolla, televizioni, madje edhe teatri e kinematografia. Pra, autori e sheh shkencën në funksion të një diçkaje e jo në funksionin e saj të kërkimit të së vërtetës. Mendimi se dialektet e shqipes janë kategori mbeturinore që duhen zhdukur e jep nocionin e uniformitetit social si prioritet politik të Partisë dhe e ndalon kërkimin deskriptiv linguistik që është edhe baza e studimit shkencor gjuhësor.

Në anën tjetër, shkenca mund të përkufizohet (Wilson 1998) si veprimtari e sistemuar që e ndërton dhe e organizon dijen në formë të shpjegimeve të testueshme dhe të parashikimeve për botën. Pra, është deskriptive.

Autorët kryesorë (Popper 2005, Pigliucci 2009) të metodës shkencore e shohin në formën e të mbështeturit në fakt dhe në qëndrim kritik, duke vërejtur se një shkencëtar, studiues nuk njih autoritet. Pra, shkenca nuk është në funksion të dikujt, pos kërkimit të së vërtetës dakull.

Sa për diskutim, vërejmë këtu shkrarjen tre dhe tri, te tre qëllimeve. Në shqipen është e gramatikalizuar kundërvënia gjinore tre dhe tri, siç është rasti me dy dhe /dy:/, me ç'rast kundërvënia mbështetet në kuantitetin vokalik.



Ta shohim autorin tjetër.

2. Jani Thomai: Shtypi ynë popullor është vepër e Partisë dhe e shokut Enver Hoxha. Shoku Enver ka përcaktuar edhe tiparet themelore të shtypit tonë që i ka rrënjësuar në të thellë partia, si partishmëria e lartë, parimorësia dhe vërtetësia, papajtueshmëria me armiqtë, shpirti luftarak e sulmues, karakteri popullor masiv e tj. Me këto e me llojet e shkrimeve janë përcaktuar edhe kërkesat për gjuhën e stilin në shtyp që formojnë një sistem të plotë e shkencor (sic) e i përgjigjen politikës së përgjithshme gjuhësore të Partisë dhe evolucionit të gjuhës letrare kombëtare në tërësi. (Thomai 1989:200)

Sërish e kemi Partinë si përfituese dhe sërish shkencën në funksion të saj. Një faqe më pas Thomai ofron edhe përkufizimin e totalitarizmit, mbështetur në konceptet e Leninit (1902), sipas të cilit shtypi nuk duhet të jetë vetëm agjikator, por edhe organizator. Ky koncept, thjesht, është bartur edhe në gjuhësi, me ç'rast, siç e shohim nga ky paragraf, gjuhëtarët rreken të organizojnë synimet e partisë.

3. Xhevat Lloshi: Temelimi i PPSH-së më 1941 përbën një ngjarje me rëndësi vendimtare për gjithë historinë e popullit tonë. Për herë të parë në Shqipëri kishim një parti të vërtetë politike, të organizuar dhe me një ideologji e program të qartë. Gjuha shqipe u vu përballë kërkesës për të përpunuar një sistem leksikor që të shprehte saktë nocionet e kësaj ideologjie (Lloshi 1989:2016)

Më duket se as nuk ka nevojë të diskutohet më gjatë. Lloshi ka ditur të përkufizojë, kështu që nuk kemi as çfarë të shtojmë më shumë. E thënë troç: Kemi partinë me ideologji të qartë dhe kemi gjuhën shqipe të vënë përballë kërkesës për të përpunuar një sistem leksikor që do të shprehte saktë nocionet e kësaj ideologjie. Orveliane.

4. Emil Lafe (1989): Kujdesi dhe vëmendja që i kanë kushtuar vazhdimisht Partia dhe shoku Enver zhvillimit të gjuhës letrare, kanë qenë një ndihmë e madhe e drejtpërdrejtë edhe për punën për pastërtinë e gjuhës. Këtë çështje shoku Enver e ka vlerësuar si një detyrë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e nëtejshtëm të kulturës sonë kombëtare socialiste... Nga ky mësim i shokut Enver gjuhësia jonë normative ka nxjerrë detyra të rëndësishme për veprimtarinë e saj teorike dhe praktike (Lafe 1989:245)

Po ashtu, e thënë qartë: Nga ky mësim i shokut Enver gjuhësia jonë normative

ka nxjerrë detyra të rëndësishme për veprimtarinë e saj teorike dhe praktike. Sintagma gjuhësia jonë normative, tregon se gjuhësia do të jetë preskriptive dhe se nuk ka nevojë studimi fare desriptiv (përshkrues).

Vërejmë, po ashtu, sintagmën kultura jonë kombëtare socialiste, si një term karakteristik.

Vërejmë, po ashtu, siç kemi treguar më parë (Rugova 2013) se ajo që ka ndodhur, ka qenë pastrim por jo pasurim i gjuhës. Gjuhësia preskriptive ka punuar në favor të varfërimit.

Siç dëshmon leximi i këtyre katër autorëve, këtu kishte një grup, i cili kishte një program dhe i cili e kërkonte mbështetjen “e shkencës”, ndërsa “shkenca” po i përgjigjej, duke preskriptuar receta për zbatimin e këtij programi. Kjo realizohet jo vetëm në forma agitacioni, por organizimi të gjithëmbarshtëm.

### **Përfundime:**

- Grupi përfitues i kësaj ideologjie preskriptive në gjuhësi është Partia e Punës me politikën e saj shoqërore;
- Synim i kësaj ideologjie del të jetë zbatimi i koncepteve të partisë për uniformitet shoqëror, përfshirë uniformitetin gjuhësor;
- Mekanizëm kryesor i kësaj ideologjie uniformiste në fushën e gjuhësisë del gjuhësia preskriptive, si koncept udhëzues, normëzues; kundrimi i normës si variant i vetëm i drejtë i gjuhës dhe tabuizimi e stigmatizimi i çdo varianti tjetër. Të përmendurit se “shkenca jonë” është në shërbim të pushtetit e dëshmon këtë.

### **Bibliografia:**

1. Althusser Louis, 2006 [1971]. *Lenin and philosophy and other essays*. Delhi: Aakhar Books
2. Eagleton Terry. 1991. *Ideology: An Introduction*. London, New York: Verso Books
3. Foucault Michel. 2010 [1975]. *Disiplinë dhe ndësbkëim: lindja e burgut*. Tiranë: Odeon
4. Johnstone Barbara. 2008. *Discourse Analysis*. Singapore: Blackwell
5. Kostallari Androkli. 1989. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. In: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III* (ed. Androkli Kostallari), 7 - 40. Tiranë: ASHRSH

6. Lafe Emil. 1989. Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë. In: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III* (ed. Androkli Kostallari), 243 - 268. Tiranë: ASHRSH
7. Lenin Vladimir Ilich. 1967 [1902]. *Collected Works* vol 5. Moskow: Progress Publishers
8. Lloshi Xhevat. 1989. Zhvillimi i leksikut politik-shoqëror në gjuhën shqipe pas Çlirimit. In: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III* (ed. Androkli Kostallari), 215 - 224. Tiranë: ASHRSH
9. Pigliucci Massimo. 2009. *Nonsense on Stilts: How to tell Science from Bunk*. Chicago, London: University of Chicago Press
10. Popper Karl. 1997. "Science: Problems, Aims, Responsibilities". IN: *The Myth of the framework: in defence of science and rationality*. New York: Routledge
11. Popper Karl. 2005. *The Logic of Scientific Discovery*. London, New York: Routledge
12. Pullum Geoffrey. 2004. Adverbs & demons: Just how good is the former English teacher's English? In: *Secrets of Angels and Demons: An Unauthorized Guide to the Best-Selling Novel*, (ed. Dan Burstein and Arne de Keijzer), 366-370. New York: CDS Books.
13. Pullum Geoffrey. 2006. *Ideology, Power and Linguistic Theory*. <http://people.ucsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf> (Së fundi kundruar më 10 gusht 2014)
14. Rugova Bardh. 2009. *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA
15. Rugova Bardh. 2013. Gjuha e kumtesave për shqipen standarde. In: *Studime 19* (ed. Rexhep Ismajli), 53 – 60). Prishtinë: ASHAK
16. Thomai Jani. 1989. Tipare e prirje të gjuhës së shtypit në kohën tonë. In: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III* (ed. Androkli Kostallari), 199 – 214. Tiranë: ASHRSH
17. Wilson Edward. 1998. *Consilience: The Unity of Knowledge*. New York: Vintage Books



Aljula JUBANI-BENGU

## STUDIMET FONOLOGJIKE NË SHQIPËRI, NË KORNIZAT E IDEOLOGJISË MATERIALISTE

Përkufizimi i kuptimit të termit ideologji është mjaft i thjeshtë, po t'u referohemi fjalorëve të shumtë dhe jo vetëm gjuhësorë. Një ideologji mund të jetë thjesht një “kompleks idesh”, një prej kompleksesh të tilla të shumta konceptuale në historinë e shoqërisë. Nga ana tjetër, ajo mund të shpjerë drejt një procesi më të gjerë, jo vetëm për njohjen dhe shenjimin e gjithçkaje na rrethon, mbi çka jemi e çfarë është shoqëria jonë, por edhe duke përzgjedhur si parësore disa ide në mendësinë e një grupi të caktuar shoqëror apo edhe më gjerë. Ky proces shpie në krijimin dhe mbizotërimin e një ideologjie të caktuar deri në shndërrimin e saj si të vetme dhe të njësuar. Pikërisht ky model, duket se ka mbizotëruar edhe në shoqërinë shqiptare të pas Luftës së Dytë Botërore, ku ideologjia marksiste gjeti zbatim në çdo fushë të dijes dhe të rregullimit të jetës sociale.

Për Marksian, synimi ishte ndryshimi i botës, jo thjesht përshkrimi i saj. Duket se ideologjia marksiste e materialiste, jo vetëm si filozofi dhe bazë e sistemit politik kushtëzoi edhe studimet gjuhësore, si të shkollave të mëdha teorike, ashtu edhe të kërkimeve gjuhësore mbi shqipen në Shqipëri. Kjo ideologji drejtohej jo vetëm drejt studimit, por edhe drejt identifikimit dhe orientimit të përparësive në kërkimet gjuhësore duke vlerësuar rolin e tyre në shoqëri, lidhur kjo ngushtë me marrëdhënien e ndërsjelltë gjuhë-shoqëri.

Si pararendës dhe ndjekës të saj u dalluan gjuhëtarët e Shkollës së Pragës. Në fundin e viteve '60, Havránek shkruante, duke iu kthyer synimeve më të hershme të funksionalizmit se: ... *që gjuha standarde të bëhet një subjekt me të drejta të plota për kërkimet studimore, duhet të ndërroheshin parimet metodologjike bazë të kërkimeve gjuhësore. Ishte e nevojshme të shkonin drejt një perspektive funksionaliste, një perspektive që të përcaktonte detyrat e gjuhës, në përgjithësi dhe në shprehjet konkrete gjuhësore dhe se me çfarë qëllimesh e në çfarë situatash ne përdorim një gjuhë standarde (cit. sipas Bermel).*

Kështu, po t'i referohemi situatës së studimeve në Shqipërinë politike të para viteve '90, duket se ato u orientuan nga preskriptivizmi dhe vështrimi i gjuhës, ashtu siç shkruante Stalini: “Historia na thotë se gjuhët nacionale nuk janë gjuhë klase, por të gjithë popullit, janë të përbashkëta për anëtarët e një kombi dhe unike për atë komb..... Natyrisht kishte edhe dialekte, idioma lokale, por gjuha unike dhe e përbashkët e klanit ose e popullit sundonte mbi to dhe i nënshtrohte.”. (Stalin,1951:11).

Shumë kohë para se të kishim një shkencë marksiste të gjuhës, funksionalistët kishin theksuar nevojën për të marrë në konsideratë funksionet e gjuhës në shoqëri, por artikulli i Stalinit u dha atyre mundësinë ta inkuadronin teorinë e tyre në “trendin” politik të kohës. Stalinizmi u shfrytëzua edhe për të riparaqitur idetë strukturaliste, të cilat mund të vështroheshin të mbështetura në ligjet e natyrës, duke qenë kështu si shkencore, por edhe marksiste, në mënyrë të pashmangshme. Kjo përshatetej mjaft mirë edhe me prirjen për kultivimin e gjuhës, bazuar në perspektivën e gjuhësisë strukturaliste, edhe kur kjo gjë favorizonte variantin e elitës së shoqërisë, siç ka vënë re edhe Bermel (2007: 126).

Është me interes të veçantë të shohim sesi kjo prirje vërehet në studimet e asaj periudhe. Kështu, nëse u kthehemi këtyre studimeve në kohë, është e vështirë të gjejmë botime të fushës së sociolinguistike, jo vetëm pse kjo është një disiplinë relativisht e re, por edhe pse variantet sociale të gjuhës shkonin kundër kësaj ideologjie. Në një shoqëri ku klasat shkonin drejt asgjësimit, edhe studimet mbi veçoritë gjuhësore të tyre nuk mund të gjenin mbështetje. Mjaft të përmendim se ndërsa në artikullin e Stalinit për gjuhën, edhe kur citohet Marksi në lidhje me gjuhën e borgjezisë, saktësohet se Marksi duhet të ketë dashur të thotë se *borgjezët e kanë ndryrë gjuhën unike nacionale me leksikon e tyre prej tregtari, se ata kanë një zhargon të tyre prej tregtari*. (Stalin, 1951:13) Në një prej pohimeve të Stalinit sqarohet se ndryshe nga dialektet lokale, dialektet e “klasave”, që do të ishte më mirë të quheshin zhargone, nuk u shërbejnë masave popullore, po një shtrese të lartë dhe të ngushtë shoqërore.

Studimet fonologjike mbi shqipen kanë filluar që në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të kaluar. Shpesh, autorët e tyre i kanë trajtuar këto probleme në kuadër të gramatikave për mësimin e shqipes nga të huajt. Mund të përmendim këtu analizat e sistemit fonologjik të Solano-s, Fiedler-it, ndërkohë që kemi studime si ai i Lowman-it (1932), Cimochovski-t (1960), Bevington-it (1974), i cili boton pikërisht “Albanian Phonology”, Newmark-ut (1984), Hamp-it (1993), Belluscio etj. Në Shqipëri, para viteve '90, kemi studime të fonetikës dhe të fonologjisë nga Gjinari, Dodit, Becit, Boriçit, Gogës etj., që sjellin kontribute të rëndësishme në analizën të sistemit fonologjik të shqipes.

Duke ndjekur shkollën e studimeve gjenerative, në vitin 1974, Bevington-i botoi

“Albanian Phonology”. Në këtë fonologji, sistemi i tipareve i përdorur është, në thelb, ai i propozuar nga Chomsky dhe Halle, me disa modifikime, që vetë autori i sheh si të diskutueshme. Ky përbën edhe një nga studimet me të plota fonologjike mbi shqipen, me mjaft risi, disa që ndihmohen pikërisht nga paraqitja e tipareve binare dhe sitemit gjenerativ në përgjithësi, ndryshe nga ai funksionalist dhe të tjera vijnë edhe për shkak të njohjes së mirë konsultave të thelluara që autori ka kryer me studiues të shumtë.

Megjithatë, dhe pse studimet fonetike dhe fonologjike përtej kufijve të Shqipërisë kishin marrë rrugë të reja kërkimesh, edhe pse kishim falë Bevingtonit, një fonologji gjenerative, të botuar që në vitin 1974, maketi i fonetikës dhe i fonologjisë i botuar në vitin 1983, nga Dodi dhe Gjinari, nuk mund t'i pasqyronte këto kërkime gjuhësore, që tejkalonin kornizat e ideologjisë materialiste.

Kështu, edhe pse ndahen më vete tri degët që merren me tingullin dhe fonetika funksionale apo fonologjia, që studion fonemën, besojmë se në mënyrë të qëllimshme, autorët bëjnë përshkrimin fonologjik të sistemit fonemor të shqipes, por i shmangen dhënies së përkufizimit të fonemës. Natyrisht, dhënia e përkufizimit të një njësie ideale, jomateriale do të binte ndesh me idenë staliniste se gjuha nuk është një superstrukturë.

Një nga kundërshtitë e Stalinit ndaj Marrit, ishte pikërisht pohimi i së pari i Marrit se “gjuha është një superstrukturë e bazës”. Për të sqaruar terminologjinë, termi “super strukturë” përfshin gjithçka që nuk lidhet drejtpërdrejt me prodhimin, kurse “baza” lidhet drejtpërdrejt me prodhimin e të mirave materiale.

Në këtë kuadër, kuptohet më mirë edhe pse Bevingtoni nuk përmendet në asnjë citim në studimet e kohës. Mjaft të kemi parasysh se si zbatues i teorisë gjenerative, studimi i tij shkon përtej, në përpjekjen për të zbuluar strukturën e thellë, e cila modifikohet nëpërmjet rregullave fonologjike, për t'u shfaqur në formën e saj përfundimtare në strukturën sipërfaqësore. Natyrisht, veç kesaj, një arsye e rëndësishme mbetet pamundësia për të cituar gjuhëtarët e huaj, veçanërisht të vendeve “imperialiste”, ashtu siç u veprua edhe me Hamp-in, krejtësisht i lënë jashtë vemendjes për kohën, pavarësisht kontributit madhor që ai ka dhënë në studimet albanologjike.

Nëse “kodifikimi” i ortografisë është një çështje gjuhëtarësh që zbatojnë një teori fonologjike të caktuar, bindja e qeverive dhe publikut të gjerë për të përdorur një “spelling sistem” është thelbësisht një akt politik. Ideologjia, jo fonologjia, bëhet faktori kyç i një ortografie (Sebba, 1998:19). Ortografia, si paraqitja më e dukshme e normave të një gjuhe të shkruar, shpesh bëhet aspekti më i kundërshtuar i standardizimit. Për shumë përdorues, pavarësisht gjithçkaje përreth, “gjuha” është gjuha standarde e shkruar dhe vetëm ajo. Ky qëndrim shfaqet, veçanërisht

problematik, në vende si Shqipëria e periudhës së diktaturës, së cilës i përshtatet mjaft mirë shprehja që shkruante një shkrimtare disidente çeke “vendlindja ime e mbyllur hermetikisht”. Shumësia shkonte drejt zhbërjes dhe gjithçka orientohej vetëm drejt një mundësie: ideologjike, kulturore, gjuhësore etj. Një shoqëri që shfaqej gjithmonë e më shumë e varfëruar në ekonomi, mendësi, potencial human, ide, njësi e forma gjuhësore.

Duket se nisur nga e njëjta bazë ideologjike, preskriptivizmi shtyhet deri në atë pikë sa, në manualin e fonetikës, një nga krerët është pikërisht drejtshkrimi. Kjo praktikë duket pak e përdorur në tekstet dhe manualet e fonetikës, jashtë Shqipërisë dhe gjendet larg objektit të studimeve fonetike. Edhe më e çuditshme duket për shqipen, e cila nuk kishte një normë drejtshqiptimore të kodifikuar. Ndoshta, për hir të një praktike botuese të krijuar para viteve '90, gjejmë vijimin e saj edhe në tekstet e fonetikës dhe të fonologjisë të pas viteve '90.

Për t'iu rikthyer argumentit të drejtshkrimit dhe lidhjes së tij me fonetikën e fonologjinë, duhet të kujtojmë se ortografia e shqipes është përcaktuar si e organizuar, duke pasur parim bazë atë fonetik. Në të vërtetë, do të ishte shumë e vështirë nëse do të ishte kështu, madje që me përcaktimin e alfabetit të shqipes dhe me “lajmet” e Komisionit Letrar të Shkodrës, gjithmonë e më shumë, shkrimi orientohej drejt parimit “një fonemë” një “grafemë”. Në këtë mënyrë, mund të themi se drejtshkrimi ynë është “morfofonemor”, që do të thotë se ka një bazë fonologjike, por lidhet me format e fjalëve, për të ruajtur trajtën e morfemave. Arsyeja pse nuk sqarohet si duhet ky parim duhet të lidhet pikërisht me pamundësinë e theksimit të vlerës së natyrë fonologjike të këtij parimi bazë dhe dallimit me atë fonetik.

Në fakt, autorët e manualit, të vetëdijshëm për dallimin mes këtyre parimeve, përpiqen të sqarojnë dhe të përligjin këtë zgjedhje, *...janë shprehur mendime se më e drejtë do të ishte që ai të qubej jo parim fonetik, por parim fonematik ose fonemor. ....termi “parim fonetik” është përdorur këtu me kuptim të gjerë, duke e kuptuar fonologjinë si një nga aspektet e studimit të anës tingullore të gjuhës dhe jo si një shkencë më vete. Nga kjo pikëpamje, ortogramet fonetike, po të vështrohen fonologjikisht, janë fonemore, sepse fonemat jepen me shkronjat gjegjëse... (Gjinari, Dodi, 1984:171).*

Është e kuptueshme, për çdo studiues, se drejtshkrimi nuk mund të ketë parim themelor parimin fonetik, pasi do të ishte një ngarkesë jashtëzakonshme, nëse do të paraqiteshin të gjithë tingujt siç shqiptohen ata. Nevoja për këtë sqarim, përpjekja për të justifikuar një përzgjedhje termash, që ndërkohë mund të interpretohet si ngatërrim konceptesh, ndoshta dëshmon edhe zotërimin mjaft të mirë të argumentit, nga ana e studiuesve shqiptarë, po aq sa edhe pamundësinë e tyre për të realizuar studimin sipas parametrave të duhur shkencorë.



**Bibliografia:**

1. Bermel, N. [2007] Linguistic authority, Language and Ideology, Mouton de Gruyter
2. Berlin · New York
3. Bevington, G. L. (1974) Albanian phonology, Harrasovitz, München
4. Dodi, A. – J. Gjinari [1983] Fonetika dhe gramatika e gjuhës letrare shqipe, Fonetika, Tiranë
5. Stalin, J. [1951] Mbi çështjen e marksizmit në gjuhësi, SHBSH “Naim Frashëri”, Tiranë
6. Sebba, M. [1998] Phonology meets ideology: the meaning of orthographic practices in British Creole, *Language Problems and Language Planning*, 22(1), Department of Linguistics and Modern English Language, Lancaster University, England



**Bade BAJRAMI**

## **ROLI I GJUHËS NË TË KUPTUARIT E IDEOLOGJISË SË DISKURSEVE**

### **Rezyme**

Qëllimi është të tregohet se roli i gjuhës është qenësor në të kuptuarit e ideologjisë së fshehur në një diskurs: një analizë adekuate të elementeve gjuhësorë, madje para analizës diskursive (çfaredoqoftë) mund të zbulojë këtë ideologji. Gjatë këtij punimi do të vëmë në pah karakteristika semiotike dhe gjuhësore të diskursit të analizuar për të cilin do të tregojmë se ato kontribuojnë në të kuptuarit e ideologjisë së folësit. Do të tregojmë se, nëse arrijmë të bëjmë hipoteza mbi ideologjinë e folësit duke dëgjuar diskursin e tij, kjo është me një anë falë vlerave që marrin fjalët e “plota” që ai përdor në diskurs ku dalin ato, dhe nga ana tjetër falë konektorëve ( të quajtur më herët fjalë të zbraza”) të cilët detyrojnë distribucionin e vlerave. Ky punim do të tregojë edhe se vlera ideologjike e veçantë e fjalëve në diskurs nuk është thjesht vlerë diskursive: ajo imponohet nga karakteristikat e fjalëve në gjuhë.

### **Hyrje**

Ajo që do të na interesojë është të formulohen hipoteza mbi mënyrën se si elementet gjuhësore të diskurseve mundësojnë të identifikohet ideologjia e fshehur në një diskurs. Ideja në të cilën jemi mbështetur është ajo se diskursat zbulojnë ideologjinë e folësit. Kjo ide mund të konsiderohet si një banalitet madje si diçka që është e evidente. Jemi mbështetur në të ashtuquajturën Shkollën franceze të analizës së diskursit.

Për të shqyrtuar mënyrën se si ideologjia e një folësi manifestohet në diskursin e tij duhet fillimisht të përgjigjemi në pyetjen që ka të bëjë me raportin në mes të asaj që është gjuhësore dhe asaj ideologjike. Pyetja që na shtrihet është se si është e mundur të identifikohet ideologjia në një diskurs? Në çka diskursi, objekt që ka një materialitet gjuhësor mundëson të arrihet te ideologjia, te një sistem pikëpamjesh dhe besimesh, objekt pa materialitet të prekshëm?

Përgjigjia që propozojmë mbështetet në konceptet qendrore të Semantikës së Pikëpamjeve<sup>1</sup>. Falë këtij nocioni, mund të formulojmë një definicion diskursiv të konceptit të ideologjisë: ideologjia e një folësi i përgjigjet pikëpamjeve të domosdoshme për të kuptuar diskursin e tij, pikëpamjeve që bashkëbiseduesit duhet të pranojnë për të ndërtuar një kuptim enonçimeve të diskursit të tij. Me një definicion të tillë, kuptohet lehtë interesimi i shkencëtarëve të analizës së diskursit për elementet gjuhësore: me të kuptuarit e thjeshtë (interpretimit) të një diskursi, kuptojmë gjithashtu edhe ideologjinë e atij që e mban.

Por modeli i komunikimit i Jakobsonit i frymëzuar nga një model matematik duket i papërshtatshëm për të paraqitur komunikimin gjuhësor sepse ai redukton komunikimin në një proces thjesht të transmisionit, gjuhën në një kod dhe domethënien dhe interpretimin në procese të kodimit dhe të dekodimit. Raccah<sup>2</sup> propozon një model të ri në të cilin komunikimi gjuhësor përshkruhet si një proces i manipulimit. Ky model na mundëson të kthehemi te çështja e ideologjisë në diskutet dhe të tregojmë se në çka gjuha kontribuon në të kuptuarit e ideologjisë se fshehur të një diskursi. Ideja e formuluar nga Raccah është se për të kuptuar një diskurs jemi të detyruar të pranojmë pikëpamje<sup>3</sup>. Pikëpamjet në fjalë imponohen nga vet elementet gjuhësore. Do të shohim mënyren se si tipat e ndryshme të fjalëve detyrojnë interpretimin e enonçimeve.

## 1. Ideologji dhe marrëveshje e fshehtë

Është pothuajse banale të thuhet se diskutet që na rrethojnë, që dëgjojmë çdo ditë, shkaktojnë reagime. Kështu, një reklamë e thjeshtë shikuar në televizion apo gjetiu mund të shkaktojë efekte të ndryshme, duke u nisur nga një ndjenjë konformitetit e deri te ajo e dëshpërimit. Pyetja që shtrohet dhe për të cilën kërkojmë përgjigje është ajo të dihet pse ky palet reaksionesh? Çka është shkaktar në këto diskurse të efekteve të shkaktuara? Për t'u përgjigjur në këto pyetje, kemi rimarrë një shembull, cituar nga Raccah<sup>4</sup>. Fjala është për enonçimin (e përshtatur të Lakoffit<sup>5</sup>).

*(1) Xboni është republikan, por ai është i ndersbëm*

Folësi i një enonçimi të tillë paraqitet si dikush që ka një opinion, një farë

<sup>1</sup> Shih RACCAH, Pierre-Yves, « Une sémantique du point de vue : de l'intersubjectivité à l'adhésion, 2005

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Shih RACCAH, Pierre-Yves, « Lexique et idéologie » 2002.

<sup>4</sup> Shih RACCAH, Pierre-Yves, « Une sémantique du point de vue : de l'intersubjectivité à l'adhésion, 2005

<sup>5</sup> LAKOFF, George, « Presuppositions and relative well-formedness » In. D. D, 1971, f. 67

ideologjie të veçantë lidhur me republikanët. Që bashkëbiseduesi të ndërtojë një kuptim për këtë enonçim, ai është i detyruar të pranojë – së paku përkohësisht-pikëpamjen subjektive të folësit lidhur me republikanët. Nëse kërkojmë të dimë se për çfarë arsye një enonçim i tillë do të mund të shkaktonte reagime pozitive apo negative, arrijmë te ideja se është, me një anë, për shkak të ideologjisë së fshehur në enonçimet, dhe nga ana tjetër për shkak të faktit se ideologjia në fjalë paraqitet si e ndarë. Nëse një dëgjues ka reagime pozitive para këtij enonçimi, kjo është sepse ai e ndan me të vërtetë ideologjinë në fjalë, ai e njih vetën aty. Nëse reagimet janë negative, kjo ndodh sepse dëgjuesi nuk ndan ideologjinë në fjalë, por enonçimi e detyron të pranojë edhe pikëpamjet jo të ndara. E vetmja mënyrë për t'iu distancuar është të shprehim gjendjen shpirtërore të krijuar dhe të kundërshtojmë, jo në atë që është thënë por në pikëpamjet e përdorura në enonçim.

Një nga fenomenet komunikative që na bën të preferojmë modelin e manipulimit nga ai i transmissioinit është ai se një marrëveshje e fshehtë ideologjike është e domosdoshme për të kuptuar një diskurs. Domosdoshmëria e marrëveshjes së fshehtë ideologjike në të kuptuarit do të na mundësojë të karakterizojmë më mirë definicionin diskursiv të ideologjisë si pikëpamje e domosdoshme që duhet pranuar për të kuptuar një diskurs.

## **2. Ideologjia në diskurs: shembull i dy analizave**

Duke ndjekur konceptin manipulues të komunikimit, kur themi se një diskurs zbulon ideologjinë e folësit të tij, themi se diskurset detyrojnë të pranojmë disa pikëpamje që të jenë të interpretueshme. Çështja që shqyrtojmë në vazhdim ka të bëjë me tipa elementesh gjuhësorë të ndryshëm të diskurseve dhe mënyrën se si secili kontribuon në adoptimin e tyre. Veçanërisht në dy lloje elementesh gjuhësore që mundësojnë të bëhen hipoteza mbi ideologjinë e folësit që mban një diskurs: elementet e leksikut dhe elementet e nyjetimit të diskursit. Pra të themi se një diskurs zbulon ideologjinë e folësit do të thotë gjithashtu se diskursi mundëson të shtrohen disa hipoteza mbi një tërësi besimesh të atij që i mban. Do të shqyrtojmë tani dy tekste autentike për të cilat do të komentojmë interpretimet e mundshme në mënyrë që të shkojmë gjër te përshkrimet semantike që ato supozojnë.

### **2.1. Analiza e parë: leksik dhe ideologji**

Po paraqesim këtu disa dallime të nxjerra në dy shkrime lidhur me të njëjtin libër dhe tregojmë se këto dallime janë shenja të qëndrimit ideologjik ndaj ideologjisë

së autorit të librit që prezentojnë. Libri në fjalë quhet « Kurban » i Edi Ramës<sup>6</sup> (në vijim ER), njëri shkruhet nga Fatos Lubonja<sup>7</sup> (në vijim FL), tjetri nga Nerimane Kamberi<sup>8</sup> (në vijim NK). Edhe një lexim sipërfaqësor mundëson të vërehet se autorët kanë qëndrime të kundërta, se ata konsiderojnë librin në dy mënyra të ndryshme. Objekti i kësaj analize nuk është të sqarohet në detaje mënyra se si krijohet kjo përshtypje, por të ilustrojmë idetë që i paraqitem duke nënvizuar disa elemente tekstuale që mund të konsiderojmë si burim i këtij efekti.

Që nga titulli i artikullit të parë dhe lloji i shkrimit të dytë (promovim) vërehet qendrimi i kundërt i dy autorëve. Me promovim të librit (shkrimi i NK) mund të avansojmë hipotezën se diskursi do të përkrah kryesisht veprën e ER dhe rrjedhimisht ideologjinë e tij, kurse me titullin “Memuaristika si operacion plastik”, FL shënon qëndrimin e tij në mënyrë më radikale. Edhe këtu mund të avansojmë hipotezën se efekti i marrjes se qëndrimit të titullit të dytë do të shkaktohet nga kookurrenca e një fjale që shpie te një ideologji negative – meqenëse operacion plastik bëhet për të mbuluar apo korrigjuar të metat trupore - edhe këtu do të bëjmë hipotezën se autori përdor një veprë letrare, memuarët për të bërë lidhjen me ngjarje historike ose private në të cilat ka marrë pjesë ose ka qenë dëshmitar i tyre.

Në të dy shkrimet kemi një aludim për atë që ka bërë ER si kryetar i bashkisë lidhur me ndërtimin e vendit dhe përsëri vërehet, një kundërvënje në mes të qëndrimeve që kanë të dy autorët lidhur me idetë e ER: NK arsyeton veprimet ideologjike të ER duke e paraqitur si kryerës të një veprë titaneshke, kurse FL i dënon sjelljet e tij duke e akuzuar për shkatërrimin e Tiranës. Roli që ka luajtur ER në ngjarjen e cituar, sjellja dhe ideologjia e ER shihen në dy mënyra të ndryshme nga NK dhe FL: e para, thjesht “*përmes metaforës së politikëtarit që thetet për një ideal*” kurse shprehja « ...shpalos gënjeshtrën... se këtij artisti dhe intelektualit iu lutën që të kryente sakrificën e të bërit politikëtar, që ai e pranoi vetëm e vetëm për t'u bërë mirë shqiptarëve », përdorur nga FL, e paraqet me sjellje të dënueshme.

Megjithatë, edhe sikur të ishim të prirur, duke veshtruar këto dy pasuse, të konkludojmë se dallimi i perceptuar i gjykimit në mes të dy shkrimeve shkaktohet nga këto shprehje, nuk mund t'a pohojmë. Për të vërejtur se këto shprehje nuk kanë vlerë negative apo pozitive në absolutin, mjafton të ndërtohen sintagma të tjera duke u nisur nga këto dy shprehje në fjalë. Është lehtë të tregohet se mund të përdorim shprehjen « *shkatërrimin që i shkaktoi Tiranës* » në një kontekst ku ajo do të tregonte një qëndrim të favorshëm lidhur me veprimin e përshkruar: Në sintagmën “... *idenë e*

<sup>6</sup> RAMA, Edi, Kurban, Dudaj, 2011

<sup>7</sup> Artikull i botuar në web faqen <http://www.peshkupauje.com/2011/11/memuaristika-si-operacion-plastik>

<sup>8</sup> Promovimi i librit « Kurban » në Preshevë më 29 janar 2012 .

*rrejshme, e trilluar të shkatërrimit që i shkaktoi Tiranës...*” akti i përshkruar do të paraqitet në mënyrë positive, do të kuptonim se folësi ka një gjykim pozitiv ndaj sjelljes së X dhe se ndan ideologjinë e tij. Me të njëjtën mënyrë « këto gjëra që do të tregohen açikë ...», e përdorur nga ER dhe e rimarrë nga NK, nuk është në vetvete një shprehje që zmadhon rëndësinë e aktit të emëruar ose që çfajëson personin akti i të cilit përshkruhet me këtë mënyrë. Do të mjaftonte p.sh. të ndërfitet në thënien e NK fjala « kinse » që qëndrimi ideologjik që ia mvëshim të largohet nga ai i ER dhe të afrohet ngai ai i FL : ...*Këto gjëra të cilat do të tregohen kinse açikë...*

Edhe pse ideologjia e dy autorëve të artikujve nuk mund t’u mvishet vetem foljeve që përshkruajnë veprimin e ER , megjithatë na duket se përdorimi i dy sintagmave «*tregohen açikë...*» dhe «*...shpalos gënjeshtërën...*» kanë një rol vendimtar në efektin e kuptimit. Ideja që duam të mbrojmë këtu është se dallimi i qëndrimit që perceptojmë duke lexuar të dy artikujt , lidhet me shprehjet e nxjerra : gjykimi i vlerës që perceptojmë pas këtyre dy shprehjeve në të dy tekstet vjen nga vendi i tyre në diskurs dhe lidhjes me *rrethin* gjuhësor. Duke shqyrtuar më mirë këto *rrethe* gjuhësore , vërejmë se në tekstin e FL, arsyeja e hyrjes së ER në politikë paraqitet si një gënjeshtër ku ai e ka bërë këtë sacrifice kinse tu bënte mirë shqiptarëve kurse te NK politikani theret, flijohet për në ideal. I njëjti period i historisë, e njëjta ideologji, i njëjti veprim përshkruhet nga FL me fjalën «*shkatërrim*», të cilës FL ia përforcon vlerën negative duke ia shtuar pjesoren «*shkaktuar*», dhe që këtë veprim ER, sipas FL «*“dubet të na beqë nga pamja*». Konotacioni i shprehjeve të analizuara, konotacioni negativ i «*shpalos gënjeshtërën*» dhe konotacioni pozitiv i «*politikani theret për një ideab*» rrjedhin nga vendi i këtyre shprehjeve në diskurs: vëzhgimi i dy teksteve mundëson të karakterizohet konotacioni i fjalëve.

Të rezumojmë atë që këto pasuse dhe mendimet tona lidhur me to na tregojnë. Na duket e arsyetuar të pohojmë se të dy raportuesit e librit shprehin, në mënyrë eksplicite, qëndrimin e tyre ndaj ideve të autorit të librit. Na duket e arsyeshme të pohojmë se qëndrimi i tyre është i kundërt: NK pranon idetë e ER, FL nuk i pranon. Më saktësisht ky i fundit akuzon ER për gënjeshtër.

Nëse pranojmë këto pohime, rrjedh se të dy autorët e artikujve kanë identifikuar ideologjinë e autorit të librit, dhe këtë duke u nisur nga diskursi i këtij të fundit. Nëse gjykimet e tyre janë të kundërta (ose të ndryshme), kjo është sepse ata vetë e kuptojnë diskursin e ER duke pranuar qëndrime ideologjike të ndryshme, sepse kanë pikëpamje të ndryshme. Dhe rrjedhimisht, më në fund, se ne, si lexues të shkrimeve , duke lexuar të dy diskutet, kemi mundur të identifikojmë së paku kundërvënien ideologjike të dy autorëve duke u nisur nga diskutet e tyre. Pra këtu jemi në një situatë në të cilën dy folës flasin për një referent të vetëm dhe të njëjtë (librin për të cilin raportojnë) në dy mënyra të ndryshme. Ajo që u mundëson të

shprehin qëndrimin e tyre, nuk është referenti, sendet për të cilat flasin, por mënyra se si i paraqesin.

Në analizën e sipërme, jemi marrë me elemente të leksikut të përdorur nga autorët e artikujve. Jemi përpjekur të tregojmë se dallimi i gjykimit ndaj ER që del në krahasimin tonë, shkaktohet, pjesërisht, nga shprehjet që NK dhe FL përdorin për të përshkruar shkrimin, idetë, sjelljet e ER. Këto shprehje paraqesin ER nga dy pikepamje të kundërta, nga dy qëndrime ideologjike të kundërta. Mbetet të dihet nëse është fjala këtu për një fenomen të shkaktuar nga gjuha ose nga diskursi, pyetje në të cilën do të përpiqemi të përgjigjemi pasi të kemi shqyrtuar mënyrën se si artikulli i një diskursi mundëson të identifikohet ideologjia e folësit të tij.

## 2.2. Analiza e dytë: artikulum dhe ideologji

Sipas paragrafeve të mëparshëm, do të mund të mendojmë që fakti se diskurset dhe enonçimet zbulojnë ideologjinë e folësve do të shkaktohej vetëm nga veçori të përdorimit të gjuhëve, sepse është fjala thjesht për një dukuri pragmatike, diskurzive ose enonçuese. Ne vijim do të përpiqemi të tregojmë se këto elemente ideologjike të diskurseve detyrohen nga elemente gjuhësore.

Në paragrafet paraprake, kemi analizuar vlerën konotative të sintagmave «*shpalos gënjeshtëri*» dhe «*tregohen açik..*» dhe ia kemi mvëshur një rol vendimtar në identifikimin e gjykimit të atij që i përdor, por vetëm në raport me kontekstin e tyre në të cilin kemi treguar shprehje qartë negative si «*shkatërrim*» apo positive si “*titaneske*”.

## 2.3. Deiktikët ideologjikë

Vlera ideologjike e disa shprehjeve nuk është rezultat i artikullimit të tyre me kontekstin, ato paraqesin njëfarë pavarësie kontekstuale dhe nga kjo, ato funksionojnë si deiktikë ideologjik: ato drejtojnë interpretimin e diskursit nga fakti se janë ideologjikisht të shënuara në nivelin leksikor. Raccat<sup>9</sup> përshkruan këtë fenomen si një mini program argumentativ. Kjo shenjë që mund të konsiderohet si një firmosje ideologjike, tregon pikëpamjet e referencës, ato që është e domosdoshme të pranohen, edhe përkohësisht, që të mund të ndërtohet një kuptim për enonçimin në fjalë<sup>10</sup>.

Të themi se «*i ndershëm*» në shembullin 1 të sipërshënuar ka një vlerë ideologjike pavarësisht nga konteksti i saj nuk do të thotë se duke modifikuar

---

<sup>9</sup> Shih RACCAH, Pierre-Yves, 2002, «*Lexique et idéologie*.

<sup>10</sup> Po aty, f. 242



kontekstin në të cilin gjendet, nuk modifikohet ideologjia e fshehur e enonçimit. Përkundrazi, nëse zëvendësojmë, fjalën “republikan” me “demokrat” në shembullin 1:

2. *Xhoni është demokrat, por ai është i ndershëm*

do të përftojme një enonçim folësi i të cilit do të kishte në ideologji, besime plotësisht të ndryshme nga ato të folësit të 1. Megjithatë, nëse ideologjia e folësit të fjalisë 2 nuk është e njëjtë me atë të 1, mënyra se si rindërtojmë këtë ideologji është e njëjta: falë konektorit «por» dhe mbiemrit «i ndershëm» kuptojmë ideologjinë e folësit.

Nëse zëvendësojmë konektorin me një tjetër, ose nëse zëvendësojmë “republikan” me një tjetër mbiemër, ashtu siç e bëmë, ideologjia e folësit ndryshon. Tash, për të treguar se fjala e gjuhës është ideologjike, duhet treguar se vlera pozitive e fjalës «i ndershëm» nuk ndryshon, cili do qoftë konteksti. Për t’u bindur, mjafton të krijohet një kontekst në të cilin vlera e fjalës do të duhej të ishte negative, sikur të shembulli 3, dhe të vërejmë se ajo shtron probleme interpretimi:

(3)?? *Xhoni është vrasës, por ai është i ndershëm.*

Me të vërtetë, mund të supozojmë se për çdo shqipfoles ky enonçim do të dukej i painterpretueshem. Në shembullin 3, segmenti «*ai është i ndershëm*» do të duhej të interpretohej si një argument në favor të një farë përfundimi dhe si një argument më i fortë se «*Xhoni është vrasës*». Ajo që shtron problem, është të gjendet një përfundim i tillë, dmth një pikëpamje e synuar nga të dy segmentet. Çuditshmëria e shembullit 3 sqarohet nëse pranojmë se një pikëpamje e tillë do të duhej të ishte përnjëherë negative, për shkak të vlerës negative të «*vrasës*» dhe pozitive, për shkak të vlerës pozitive të «*i ndershëm*».

#### 2.4. Deiktikët ideologjikë në të dy diskurset

Disa nga shprehjet e përdorura nga të dy autorët e përmendur për raportimin e librit të cituar, dhe për të cilët kemi analizuar disa pasuse, kanë një funksionim analog me atë të mbiemrit «i ndershëm»: ato shërbejnë si tregues të ideologjisë së folësit, si deiktikë ideologjikë. Kështu sintagma “shpalos gënjeshtren” përdorur nga FL në artikullin e cituar e udhëheq interpretimin tonë me vlerën e saj negative. Është po kjo sintagmë që na ndihmon të kuptojmë se pikëpamja nga e cila FL përshkruan idetë e ER është negative. Veçoria e kësaj sintagme qëndron në faktin se vlera e saj negative mbetet e njëjtë në çdo kontekst, ajo udhëheq pra interpretimin tonë me vlerën e saj negative.

## Përfundim

Në këtë punim e kemi afruar konceptin e ideologjisë nga ai i pikëpamjeve. Kemi parë se vlera ideologjike e veçantë e fjalëve në diskurs nuk është një vlerë e mirëfilltë diskursive: ajo detyrohet nga karakteristikat e fjalëve në gjuhë. Po ashtu, mënyra se si konektorët mundësojnë të identifikohet vlera ideologjike e fjalëve në diskurs është e shënuar në gjuhë. Përshkrimet në gjuhë janë domosdo rezultat i një argumentimi i cili shpie të formulohen hipoteza (lidhur me gjuhën) që kanë për synim të sqarojnë efektet e fjalëve mbi interpretimin e diskurseve.

## Bibliografia:

1. ALTHUSSER, Louis, 1970, « Idéologie et Appareils Idéologiques d'État (Notes pour une recherche) », *La Pensée*, n° 151, mai-juin 1970., pp. 3-38.
2. ANSCOMBRE, Jean-Claude, 1983, « Pour autant, pourtant (et comment) : à petites causes, grands effets », *Cahiers de linguistique française*, n° 5, pp. 37-84.
3. BENVENISTE, Émile, 1966, *Problèmes de linguistique générale*, 1, 2, Paris, Gallimard, Coll. tel.
4. DUBOIS, Jean et al., 1994[2002], *Dictionnaire de linguistique et des sciences du langage*, Paris, Larousse.
5. DUBOIS, Jean, – SUMPFF, Joseph, 1969, « Problèmes de l'analyse du discours », *Langages*, n° 13, pp. 3-7.
6. FUCHS, Catherine – PÉCHEUX, Michel, 1975, « Mises au point et perspectives à propos de l'analyse automatique du discours », *Langages*, n° 37, pp. 7-81.
7. LAKOFF, George, 1971, « Presuppositions and relative well-formedness » In. D. D.
8. MAINGUENEAU, Dominique, 1995, « Présentation », Les analyses du discours en France, *Langages*, n° 117. pp. 5-11.
9. MOUNIN, Georges, 1972[1997], *La sémantique*, Paris, Payot et Rivages, Coll. Petite Bibliothèque Payot.
10. RACCAH, Pierre-Yves, 2002, « Lexique et idéologie. Les points de vue qui s'expriment avant qu'on ait parlé », in. *Les Facettes du dire. Hommage à Oswald Ducrot*, Carel Marion (dir), Paris, Kimé, pp. 242-268.
11. RACCAH, Pierre-Yves, 2005, « Une sémantique du point de vue : de l'intersubjectivité à l'adhésion », *L'énonciation identitaire : entre l'individuel*

- et le collectif, n° spécial sous la dir. de Danielle Forget, *Discours social / Social Discourse*, Nouvelle série, Vol. XXI., pp. 205-242.
12. RAMA, Edi, *Kurban*, Dudaĳ, 2011
13. <http://www.presheva.com/lajme/11864-edi-rama-sot-viziton-presheven.html>
14. <http://www.peshkupauje.com/2011/11/memuaristika-si-operacion-plastik>



Milote SADIKU

## RRETH PËRDORIMIT TË METAFORAVE NË DISKURSION POLITIK NË GAZETAT E PËRDITSHME TË KOSOVËS

### 1. Hyrje

Duke u bazuar në shembujt e nxjerrë nga tekstet e gazetave ditore të Kosovës (nga versionet e tyre elektronike), qëllim i këtij punimi është që të hulumtojë se cilat mjete gjuhësore e posaçërisht cilat metafora e karakterizojnë diskursin politik shqiptar në Kosovë. Do të hulumtohet se cila metaforikë është përdorur në diskursin politik gjatë fushatës zgjedhore parlamentare 2014 në Kosovë rreth temës së korrupsionit, si dhe cilët tipa të metaforave sa i përket kësaj teme përdoren më së shpeshti dhe si ndikojnë ata te lexuesit. Pasi që leksiku militar është i ngarkuar me ideologji, një rëndësi më e madhe në këtë punim do t'i kushtohet përdorimit të metaforikës së luftës në diskursin politik.

Analiza e metaforave në këtë punim bazohet në qasjen kognitive-gjuhësore të metaforave të krijuar nga Lakoff/Johnson (1980;<sup>6</sup>2008). Sipas tyre, metafora ka një rol qendror për të menduarit tonë, dhe me këtë edhe për gjuhën tonë. Metaforat janë bartëse të emocioneve dhe kognicioneve.

Korpusi për këtë punim është nxjerrë nga artikujt e gazetave ditore “Zëri” dhe “Koha Ditore”, nga versionet e tyre elektronike, prej periudhës 01.05.2014 deri më 25.06.2014. Janë hulumtuar tekstet nga arkiva e këtyre gazetave, të cilat për këtë hapësirë kohore ishin në dispozicion në internet. Është kërkuar në bazë të fjalëve kyçe, si p.sh. ‘*luftoj*’ dhe ‘*korruption*’, për ta verifikuar shpeshhtësinë e përdorimit të shprehjes metaforike (*do të luftojë korrupsionin*). Shprehjet metaforike do të jepen në korpus ashtu siç përdoren në tekstin e gazetës, ndërsa në shembujt e paraqitur këtu do të theksohen me shkrim kursiv.

Analiza e këtij korpusi ka treguar që metaforat që përdoren më së shpeshti janë: metaforat e sëmundjeve (p.sh. *korruptioni si kancer, si dergjë, si endemi*) dhe metaforat e luftës (p.sh. *lufton korrupsionin* etj.).

## 2. Metaforat në Linguistikën Kognitive

Metafora është një fenomen për të cilin njerëzit kanë shfaqur interesim qysh para 2000 vjetëve. Që nga Aristoteli në retorikën antike ajo është trajtuar si një fenomen i qartë gjuhësor, si një mjet stilistik-retorik. Mirëpo në hulumtimet me karakter kognitiv metafora nuk është vetëm një dukuri gjuhësore, pra “si element zbulues” (Becker 2014:199), por përsëri dimensionit të saj gjuhësor ajo e shfaq edhe dimensionin e saj kognitiv, d.m.th. “trajtohet si një shprehje e aftësisë themelore kognitive të njeriut” (Becker 2014:199). Në fillim të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar metafora u bë objekt hulumtimi i studimeve kognitive-psikologjike e sidomos në studimet e gjuhëtarit Georg Lakoff dhe filozofit të gjuhësisë Mark Johnson, të cilët vunë bazën e teorisë konceptuale të metaforës me librin “*Metaphors We Live By*” (1980). Sipas teorisë konceptuale të metaforës, metafora ka një rol qendror për të menduarit tonë, dhe me këtë edhe për gjuhën tonë. “Sistemi ynë i përditshëm konceptual, në bazë të të cilit ne mendojmë dhe veprojmë, në thelb dhe parimisht është metaforik”, theksojnë Lakoff/ Johnson (2008:11). Lakoff/Johnson pohojnë që metaforat janë bartëse të emocioneve dhe kognicioneve. Funkcioni kryesor i metaforave është që raportet abstrakte dhe komplekse t’i bëjnë më të kuptueshme si gjuhësisht ashtu edhe nga aspekti kognitiv. Metaforat paraqesin një lidhje sistematike në mes të një rrafshi më të pakuptueshëm, të ashtuquajturës *pushës së qëllimit* (“Zielbereich”) të metaforës, dhe të një rrafshi tjetër, të ashtuquajturës *pushës burimore* (“Herkunftsbereich”) të metaforës. Sipas Lakoff/Johnson, thelbi i metaforës është që “ne me anë të saj mund ta kuptojmë një gjë apo një ngjarje përmes koncepteve të një gjëje apo ngjarjeje tjetër” (2008:13).

Këtu është e rëndësishme të theksohet se teoria konceptuale e metaforave nga shumë gjuhëtarë nuk pranohet si shumë e saktë, sidomos për shkak të dobësive të saj teorike dhe metodike (krh. edhe Schwarz-Friesel 2014:57). Dallohen dy lloje të metaforave: metaforat konceptuale dhe shprehjet metaforike (krh. Spencer 2014:112). Metaforat konceptuale (si p.sh. KORRUPSIONI ËSHTË LUFTË<sup>1</sup>) na mundësojnë që me anë të projekcionit metaforik konceptet më abstrakte t’i kuptojmë më lehtë përmes koncepteve më pak abstrakte (apo konkrete) (krh. Burger 2010:89-91; Drewer 2003:6). Metaforat konceptuale mund të mos i vërejmë drejtpërdrejtë në diskutim, ato më shumë shërbejnë si bazë për shprehjet metaforike (Spencer 2014:113). Ndërsa shprehjet metaforike janë metaforat që i shohim, që i gjejmë drejtpërdrejtë në tekst, si p.sh. “Qeveria [...] do të luftojë korrupsionin [...]” (zëri.info 03.06.2014).

<sup>1</sup> Të shkruarit me shkronja të mëdha i përgjigjet një konvencioni të shkrimit që karakterizon metaforikën konceptuale.

### 3. Analiza e metaforave në diskursin politik

Diskursi politik më shumë se çdo diskurs tjetër është jashtëzakonisht ideologjik (krh. van Dijk 2002:15). Sipas Van Dijk, ideologjia është besim themelor i përbashkët për pjesëtarët e një grupi. Ai thekson që koncepti i ideologjisë përdoret shpesh në media dhe në shkencat sociale, por është koncept mjaft i paqartë, i cili zakonisht përdoret me kuptim negativ dhe i referohet ideve të gabuara të pjesëtarëve të partive të tjera: “*we have the truth, and they have ideologies*”<sup>2</sup> (van Dijk 2006:728). Ndërsa diskursin politik ai e definon thjesht si “diskurs të politikanëve”, të cilin e përdorin politikanët gjatë aktiviteteve të tyre politike në institucione, si në qeveri, parlament, apo gjatë fushatës elektorale (krh. Van Dijk 2002:20). Diskursi politik i legjitimon idetë dhe veprimet politike të një grupi, por edhe i kritikon anët negative të grupeve të tjera.

Në diskursin politik posaçërisht gjatë fushatës elektorale mund të tematizohen aspekte të ndryshme nga jeta e përbashkët sociale dhe prodhuesi i këtij diskursi qëllimisht zgjedh leksemat e caktuara për të arritur efektin e duhur të lexuesit. Metaforat përdoren shpesh në komunikimin publik, me synimin që t’i transmetohen recipientit (lexuesit) qëndrimet dhe vlerësimet e autorit/gazetarit: “*metaphors powerfully shape how we reason about social issues*” (Thibodeau/Boroditsky 2011)<sup>3</sup>. Pra përdorimi i metaforave në diskursin politik ka për qëllim që të arrijë një efekt emocionues tek lexuesi. Schwarz-Friesel (2014:57) thekson që desiderat i hulumtimeve kognitive mbi metaforat është që të analizohen funksionet e metaforave, pra aftësia e tyre për të ndikuar te recipientët/lexuesit, për të parë nëse metaforat ndikojnë në formimin e mendimeve të tyre. Analiza e metaforave është njëra ndër “metodat që janë përdorur më së shpeshti në analizën e diskursit në politikë” (Spencer 2014:112). Sipas Spencer, rezultatet e kësaj metode njihen edhe në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, ku janë analizuar tema të ndryshme në politikën ndërkombëtare, si p.sh. rreth Integritimit Evropian, rreth politikës së migrimit e të sigurisë, etj.

Dihet që ndikimi i mediave në opinionin publik është mjaft i madh, sidomos kur bëhet fjalë për tema të rëndësishme politike si korrupsioni. Roli i mediave është që ngjarjet ditore të shoqërisë t’i interpretojë dhe pas publikimit të tyre ta bëjë të mundur që lexuesit të kenë qasje në to. Në një numër të madh të artikujve në gazetatat e përditshme në Kosovë është raportuar vazhdimisht për korrupsionin, për shkak se pritet një përfshirje më emocionuese e lexuesit kur dihet që korrupsioni paraqet një kërcënim për shoqërinë tonë. Temën e korrupsionit e kanë prekur kryesisht partitë

---

<sup>2</sup> “*ne e kemi të vërtetën, dhe ata i kanë ideologjitë*”

<sup>3</sup> Cituar nga Schwarz-Friesel (2014:55).

politike opozitare gjatë fushatës së tyre elektorale, pasi që korrupsioni shihet si një ndër shkaktarët e ngecjes së zhvillimit të shoqërisë sonë. Edhe në fushatën elektorale të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014 politikanët tanë në refren kanë folur për temën e korrupsionit, si një strategji për t'i fituar zgjedhjet.

Në diskursin e partive tona politike janë identifikuar këto metafora konceptuale: KORRUPSIONI ËSHTË SËMUNDJE; KORRUPSIONI ËSHTË LUFTË; KORRUPSIONI ËSHTË ORGANIZËM I GJALLË; KORRUPSIONI ËSHTË NJË GJENDJE E VËSHTIRË.

### 3.1. Metaforat e sëmundjes:

#### KORRUPSIONI ËSHTË KANCER

Me anë të metaforës KORRUPSIONI ËSHTË KANCER, potencohet fuqia kërcënuese dhe e rrezikut e kësaj dukurie ndaj shoqërisë tonë. Kjo metaforë e sëmundjes haset shpesh në artikujt e hulumtuar të gazetave. Fuqia emocionuese është shumë e madhe, pasi që me këtë rast aktivizohen komponentët konceptualë si 'i rrezikshëm gjegjësisht vdekjeprurës për organizmin e sulmuar', 'përhapet shpejt', 'vështirë i kontrollueshëm', 'i pashpresë', 'deprimues' (krh. Schwarz-Friesel 2014:61).

(1) Për BE-në dhe NATO-n vlen: Kush dëshiron të ndalojë përhapjen e mëtejme të strukturave kriminale, duhet të ketë kurs të qartë. Ne duhet dhe do ta mbrojmë veten dhe të tjerët nga *kanceri politik i korrupsionit dhe krimit*. [...]" (zëri.info 24.05.2014)

(2) Zëvendës-presidenti amerikan Joe Biden, ka thënë sot se *korrupsioni është "kancer"* dhe një kërcënim për sigurinë kombëtare të secilit vend. (zëri.info 21.05.2014)

(3) Shkaqet pse nuk duhet të vazhdohet kjo keqqeverisje janë të shumta, por më kryesorja është se kjo qeveri e ka *sëmurë* Kosovën me *kancer* e qe, në terma politikë, *është korrupsioni*. [...] (zëri.info 16.05.2014)

(4) Kështu të paktën vlerësojnë analistët kosovarë, sipas të cilëve, *korrupsioni* në Kosovë po konsiderohet *si dukuri shumë normale*, prandaj ata vlerësojnë se kjo dukuri po shndërrohet në "*kancer*" për shoqërinë kosovare. Sipas analistëve, përgjegjësia për dështimin *në luftimin e korrupsionit* duhet ta bartin pushtetarët dhe institucionet që janë formuar me qëllim *të luftimit të kësaj dukurie*. (zëri.info 15.06.2014)

(5) Për BE-në dhe NATO-n vlen: Kush dëshiron të ndalojë përhapjen e mëtejme të strukturave kriminale, duhet të ketë kurs të qartë. Ne duhet dhe do ta



mbrojmë veten dhe të tjerët nga *kanceri politik i korrupsionit dhe i krimit...*“ (*koha.net* 30.05.2014)

(6) Disa here kam thënë se *kancer* i vendit është *korupsioni*. *Korupsioni është kancer*, *kancer* sepse s’lejon me u zhvillohet shëndetshëm asnjë pore e jetës. (*koha.net* 15.05.2014)

Shprehjet metaforike në shembujt (1) - (6) e krijojnë një relacion specifik në mes të konceptit<sub>1</sub> (KORRUPSIONIT) dhe konceptit<sub>2</sub> (KANCERIT), që interpretohet si ‘koncepti<sub>1</sub> është konceptit<sub>2</sub> sa i përket veçorive Z’ (krh. Schwarz-Friesel 2014:55). Në këta shembuj theksohet që korupsioni është bërë ‘një dukuri normale’ e cila po shndërrohet në një sëmundje serioze, të rrezikshme të shoqërisë kosovare gjegjësisht të vendit tonë, që ‘s’lejon të zhvillohet shëndetshëm asnjë pore e jetës’, nga e cila duhet të mbrohem me masa të duhura. Pra, kjo metaforë fokuson plagën e shoqërisë dhe institucioneve tona.

### **KORRUPSIONI ËSHTË DERGJË**

(7) Nuk kemi llogari që Republika e Kosovës *të dergjet* edhe më tutje nga *ky korupsion* i cili na vë neve nëpër lista të frikshme nga organizata ndërkombëtare, të pllakosemi me këtë mjerim që përbëhet prej varfërisë dhe papunësisë së madhe. (*koha.net*.31.05.2014)

### **KORRUPSIONI ËSHTË PLAGË VDEKJEPRURËSE**

(8) Vota juaj duhet të jetë për një Parlament që sjell një qeveri, e cila *lufton* pa kompromis *korupsionin*, *këtë plagë vdekjeprurëse* për demokracinë në Kosovë. (*zëri.info* 06.06.2014)

Konceptualizimi i korupsionit si një sëmundje e rëndë, që e bën shtetin tonë *të dergjet* nga kjo sëmundje, apo si *plagë vdekjeprurëse*, lidhet drejtpërdrejtë me përvojën e njerzve: Frika nga një sëmundje që e rrezikon jetën e njeriut projektohet në frikën nga korupsioni<sup>4</sup>. Sipas Schwarz-Friesel (2014:62), kur shprehjet në diskursin politik lidhen me gjëra të njohura dhe të ditura nga jeta dhe nga bota emocionale e recipientëve/ lexuesve, atëherë ato kanë funksion persuasiv<sup>5</sup>, pra e zgjojnë vëmendjen e recipientëve/ lexuesve të tekstit dhe arrijnë efekt emocionues të lexuesi.

---

<sup>4</sup> Për metaforat që e konceptualizojnë terrorizmin në media para dhe pas sulmeve terroriste në SHBA më 9.11.2001 Schwarz-Friesel/Kromminga (Ed.) (2014): *Metaphern der Gewalt*.

<sup>5</sup> Sipas Bußmann (2008:519), fjala persuasiv vjen nga lat. *persuadere* <bind>. Të folurit persuasiv karakterizohet me përdorimin efektiv të mjeteve të caktuara gjuhësore dhe ka për qëllim që të

## KORRUPSIONI ËSHTË ENDEMI

(9) Sfida e 8 qershorit, bëhet mes dy partive kryesore, LDK, e themeluar nga Ibrahim Rugova e president i parë i vendit, dhe PDK e kryeministrit në ikje Thaçi, por në një vend ku *korruptsioni është endemik*, kush është outsider rrezikon të jetë gjilpëra e vërtetë e peshores. (*zëri.info* 07.06.2014)

Intensifikimi i ndjenjës së rrezikimit apo kërcënimit nga korruptsioni mund të arrihet edhe përmes metaforës së endemisë, sëmundje kjo infektive që paraqitet vazhdimisht në një region a te një popull. Në këtë rast aktivizohet koncepti i rrezikut të lartë nga infeksioni, i cili përhapet shpejt dhe i cili vështirë vihet nën kontroll.

### 3.2. Metaforika e luftës: KORRUPSIONI ËSHTË LUFTË

Fusha semantike e luftës njihet si një burim mjaft produktiv i metaforës. Fushat semantike ‘lufta’ dhe ‘politika’ e ndajnë me njëra tjetrën leksikon e përbashkët, si leksemat *fitues*, *humbës*, *kundërshtar*, *aleat* apo *pushtues*, si në kryetitullin e gazetës “Zëri” të datës 22.06.2014 “*Drenica dhe Dukagjini ‘pushtojnë’ Kuvendin*”. Në tërë korpusin e hulumtuar, i cili përbëhet prej 64 artikujve (24 nga *koha.net* dhe 40 nga *zëri.info*), dominojnë metaforat nga rrafshi konceptual i LUFTËS. Shprehjet metaforike në artikujt e hulumtuar si “luftë kundër/ndaj korruptsionit”, “e lufton korruptsionin”, ‘beteja kundër korruptsionit’ e projektojnë rrafshin e burimit ‘lufta’ te rrafshi i qëllimit ‘korruptsioni’, pra tiparet e konceptit konkret LUFTA barten te koncepti abstrakt KORRUPSIONI.

(10) “Fatkeqësisht përpjekjet për luftimin e korruptsionit nuk kanë qenë shumë serioze dhe rrjedhimisht *beteja* jo shumë e ashpër *kundër korruptsionit* nuk ka mjaftuar për zvogëlimin e pranisë se *korruptsionit* për të cilin ekziston një perceptim i madh edhe te bizneset. (*zëri.info* 15.06.2014)

Në korpusin e hulumtuar i hasim dendur shembujt në të cilët përdoren leksema të ngjashme si në shembullin (10). Me përdorimin e leksemave *luftim* e *betejë* në shembullin (10) hyjnë në diskurs tiparet e qarta nga koncepti i LUFTËS. Autori qëllimisht i ka zgjedhur këto mjete gjuhësore për ta sulmuar korruptsionin, këtë dukuri të keqe të shoqërisë sonë që në të shumtën e rasteve në korpusin tonë barazohet me ‘*krimin e organizuar*’, apo siç cilësohet në njërin prej artikujve: ‘[...] *korruptsioni në Kosovë*

---

bindë të adresuarin (lexuesin) lidhur me një mendim të caktuar. (më gjerësisht rreth kuptimit të fjalës ‘persuasiv’ shih Bußmann, Hadumond (2008): *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart. Faqe 519.)

*mbetet njëri prej problemeve më shqetësuese në shoqërinë kosovare*' (koha.net 05.06.2014). Sipas Spencer (2014:115), arsyeja pse përdoret shpesh metaforika e luftës është se lufta është një dukuri lehtësisht e kapshme, e njohur për secilin. Lufta është një situatë e jashtëzakonshme që kërkon mobilizimin e të gjithëve për të korrur fitore ndaj armikut. Përmes metaforës së luftës, e cila projektohet te koncepti abstrakt KORRUPSIONI, “problemi bëhet i qartë, duke u reduktuar deri aty sa të mposhtet armiku dhe të fitohet lufta” (Spencer 2014:115). Krh. shembullin (11):

(11) [...], ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje do të sjellë drejtësi e *luftë korrupsionit* (koha.net 02.06.2014)

Në shembullin (11), si dhe në shembujt në vijim, armiku është ‘korrupsioni’, të cilit partitë politike gjatë fushatës elektorale i shpallin *luftë* për t’u *çliruar* nga ai:

(12) Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do të fitojë bindshëm zgjedhjet e 8 qershorit dhe do ta qeverisë vendin në mandatin e ardhshëm, gjatë të cilit Kosova *do të çlirohet* plotësisht nga *krimi i organizuar e korrupsioni*, [...] (koha.net 01.06.2014)

(13) Gjyqësia, sundimi i ligjit, *lufta kundër korrupsionit*, kishin karakterizuar fushatën e partive politike në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. [...], *korrupsioni në Kosovë mbetet njëri prej problemeve më shqetësuese në shoqërinë kosovare*. “Fushata e zgjedhjeve të vitit 2010 u karakterizua nga premtimet e partive politike, sidomos nga partia në pushtet PDK-së, për reformimin e sistemit gjyqësor, *luftën ndaj korrupsionit* dhe përmirësimin e gjendjes së qeverisjes në Kosovë, këto realisht edhe pas katër viteve mbesin sfidat kryesore të Kosovës. (koha.net 05.06.2014)

(14) Kurse deputeti i legjislaturës së fundit Glauk Konjufca ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje është e vendosur *t’i shpall luftë krimit e korrupsionit*. (koha.net 02.06.2014)

(15) Deputetja e kandidaturës së fundit Albulena Haxhiu tha se Lëvizja Vetëvendosje zotohet *për luftë kundër korrupsionit* dhe se do të kërkojë ligjin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme dhe ligjin *anti-korrupsion*. (koha.net 01.06.2014)

(16) [...], që në Kosovë *të luftohet korrupsioni e krimi i organizuar* dhe këtë thotë se do ta bëjë me shtimin e numrit të prokurorëve, që do të punojnë në Prokurorinë Speciale. (zëri.info 07.06.2014)

## KORRUPSIONI ËSHTË ORGANIZËM I GJALLË

Në diskurs haset edhe metafora konceptuale KORRUPSIONI ËSHTË ORGANIZËM I GJALLË. Korrupsioni metaforizohet si një bimë që rritet dhe *lulëzon*, si në një titull të gazetës ‘Zëri’: “*Mimozës i lulëzon korrupsion?*”. Pra, korrupsioni nënkuptohet si një fenomen natyror.

(17) Është vetëm elektoral, sepse Thaçi që shtatë vjet e ka drejtuar Qeverinë e Kosovës dhe ai nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë, përkundrazi në bazë të raporteve ndërkombëtare krimi dhe *korrupsioni kanë lulëzuar*. (zëri.info 03.06.2014)

## KORRUPSIONI SI NJË GJENDJE E RËNDË

Mjaft e shpeshtë është edhe kjo metaforikë konceptuale, sipas së cilës korrupsioni konceptualizohet si një gjendje e vështirë, pa rrugëdalje, në të cilën *zhyten* partitë tona politike apo anëtarët e tyre. Ata të cilët janë zhytur në korrupsion janë ‘mashtues’, ‘abuzues’, ‘me imazh të keq’.

(18) Ju lus që vota e juaj kësaj here mos të shkojë në llogari të atyre partive që janë të *zhytura në krim e korrupsion*. Mos e jepni votën te ata që tërë kohën e mashtuan qytetarin. (koha.net 01.06.2014)

(19) Me burra dhe gra të *zhytur në krim e korrupsion*, me imazh gjithnjë në rënie, partitë, sidomos këto që e provuan pushtetin qendror, [...] (koha.net 01.06.2014)

(20) Nëse një kastë politike, e cila për dy mandate rresht abuzoi arkën e shtetit, duke *u zhytur në korrupsion gërryes*, [...] (koha.net 30.05.2014)

(21) Se qeveria Thaçi ishte e *zhytur në korrupsion* është e qartë për të gjithë. (zëri.info 19.06.2014)

(22) [...], porse të gjithë ata 46 mijë maturantë bashkë me prindërit e tyre e bashkë me shoqërinë kosovare, e cila edhe më tej *po zhytet në llumin e korrupsionit* të gjithçkaje. (koha.net 18.06.2014)

*Llum-i* në këtë kontekst (shemb. 22) i aktivizon tiparet semantike ‘ujëra të turbullta’, ‘baltë e papastërt’, ‘fundërrinë’, ‘në të cilën zhytesh’, me të cilat tipare karakterizohet korrupsioni.

#### 4. Përfundim

Qëllim i këtij punimi ishte që të paraqesë se cilët tipa të metaforave sa i përket temës së korrupsionit përdoren më së shpeshti në diskursin politik dhe si ndikojnë ata te marrësit. Metaforat janë mjete të rëndësishme gjuhësore përdorimi i të cilave e lehtëson të kuptuarit e emocioneve, ideologjive a fenomeneve e proceseve më abstrakte dhe më vështirë të kuptueshme. Funkzioni i tyre në diskursin e përditshëm dhe gazetaresk është që të arrijnë një efekt emocionues te marrësi/lexuesi. Përdorimi i metaforave në diskursin politik lidhur me dukurinë e korrupsionit shërben për përforcimin e ndjenjës së rrezikut dhe kanosjes nga kjo dukuri e rrezikshme që e ka kapluar vendin tonë.

Në këtë punim janë analizuar metaforat e diskursit të korrupsionit në artikujt e gazetave ditore në Kosovë. Korpusi përbëhet prej 64 artikujve, 24 nga *koha.net* dhe 40 nga *zëri.info*. Analiza e këtij korpusi ka treguar që metaforat konceptuale që përdoren në diskursin e korrupsionit janë: Korrupsioni si sëmundje, korrupsioni si luftë, korrupsioni si organizëm i gjallë dhe korrupsioni si gjendje e vështirë. Metaforat e rrafshit konceptual LUFTË dominojnë në korpusin e hulumtuar, sidomos në diskursin e partive opozitare, dhe nga kjo rezulton që partitë politike opozitare në Kosovë janë parti luftuese gjegjësisht parti që i shpallin luftë korrupsionit. Kjo metaforë konceptuale ndikon që masat militare, juridike e politike të ndërmarra kundër korrupsionit të na duken si reaksione të përshtatshme.

#### Bibliografia:

1. Becker, Mathias J. (2014): *Gewaltmetaphern im französischen Präsidentschaftswahlkampf 2011/12*. Në: Schwarz-Friesel, M./Kromminga, J. (Ed.): *Metaphern der Gewalt. Konzeptualisierungen von Terrorismus in den Medien vor und nach 9/11*. Tübingen. Fq. 197-214.
2. Burger, Harald (2010): *Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen*. Berlin.
3. Bußmann, Hadumond (2008): *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart.
4. Drewer, Petra (2003): *Kognitive Metapher als Werkzeug des Denkens. Zur Rolle der Analogie bei der Gewinnung und Vermittlung wissenschaftlicher Erkenntnisse*. Tübingen.
5. Lakoff, G. / Johnson, M. (2008): *Leben in Metaphern, Konstruktion und Gebrauch von Sprachbildern*. Heidelberg.

6. Schwarz-Friesel, M./ Kromminga, J. (Ed.): Metaphern der Gewalt. Konzeptualisierungen von Terrorismus in den Medien vor und nach 9/11. Tübingen.
7. Schwarz-Friesel, Monika (2014): “*Hydra, Krake, Krebsgeschwür, Sumpf, Killer-GmbH, Franchise-Unternehmen und Nebenwolke*”. *Perspektivierung und Evaluierung von islamistischen terrorismus durch Metaphern im deutschen Pressediskurs nach 9/11*. Nö: Schwarz-Friesel, M./Kromminga, J. (Ed.): Metaphern der Gewalt. Konzeptualisierungen von Terrorismus in den Medien vor und nach 9/11. Tübingen. Fq. 51-74.
8. Spencer, Alexander (2014): *Bilder der Gewalt: 9/11 in der Boulevardpresse*. Nö: Schwarz-Friesel, M./Kromminga, J. (Ed.): Metaphern der Gewalt. Konzeptualisierungen von Terrorismus in den Medien vor und nach 9/11. Tübingen. Fq. 111-127.
9. Van Dijk, T. A. (2002): *Political discourse and Ideology*. Nö: Lorda, C. U./ Ribas, M. (Eds.): *Anàlisi del discurs polític*. (pp.). Barcelona. Fq. 15-34.
10. Van Dijk, T. A. (2006): *Politics, ideology, and discourse*. Nö: Brown, K.(Ed): *The Encyclopedia of language and linguistics*. Vol. 9 Oxford ; New York. Fq. 728-740.

**Xhavit BEQIRI**

## **ARSHI PIPA PËR POLITIKËN E GJUHËS NË SHQIPËRINË SOCIALISTE**

Në studimet për shqipen standarde dhe procesin e formimit të saj, Arshi Pipa, pa dyshim, është kundërshtari më i rreptë i këtij procesi. Qëndrimin e vet kundër standardit të shqipes Pipa e ka pohuar vazhdimisht, po në mënyrë të veçantë këtë e ka bërë në librin “Politika e Gjuhës në Shqipërinë Socialiste”. Gjuha e Njësuar Letrare (GjNjL), shkruante Pipa, është një përzierje marriste, e përgatitur sipas recetës së Stalinit. I tërë tehu i kritikës ndaj GjNjL-së dhe atyre që ishin në krye të procesit që e prodhoi atë (GjNjL-në), në pikëpamjen e Pipës, del të jetë rezultat i vullnetit të kastës sunduese në Shqipërinë socialiste dhe i ideologjisë së saj.

### **Gegë e toskë, lehtësi kuptimi e shpërftyrim dialekti**

Në këtë tekst, unë do të përpiqem të interpretoj qëndrimin e Pipës për GjNjL-në pikërisht duke u mbështetur në librin e sipërcekur të tij. Meqenëse në kohën kur “debatohej dhe vendosej çështja e standardizimit të gjuhës shqipe”, Pipa ndodhej në burg, për shkak se “kish fye regjimin socialist”, libri u shkrua “vjete mâ vonë”, në mërgim (anglisht), në vitet ’60, kur ai, pas “detyrimesh profesionale si italianist”, riktheu vëmendjen kah kultura shqiptare, më tepër kah letërsia, sesa gjuha. Vetë Pipa tregon se ishte bâ “i ndieshëm për punët e gjuhës në Shqipni prej shkrimesh që shpërndanin mërgimtarët kroatë lidhë me çështjen e gjuhës kroate”<sup>1</sup>. Sado që shkaku, i cili e bën Pipën “të ndieshëm” për “punët e gjuhës në Shqipni”, është pak i pazkontë, sepse “buron” nga një vend e nga një gjuhë tjetër, kjo nuk ia humb aspak vlerën dhe rëndësinë këtij studimi të tij.

Libri “Politika e Gjuhës në Shqipërinë Socialiste”/ “Politika e Gjuhës në Shqipninë Socialiste” u përkthye nga anglishtja edhe gegërisht, edhe toskërisht nga studiuesi Primo Shllaku, i cili në *Parathanie* shkruan: “Arshi Pipa na vjen si një model. Mbas tij, na shqiptarët, nuk e kemi mâ alibinë e mospasjes çka me zgjedhë. Mbas tij na

---

<sup>1</sup> Arshi Pipa, *Politika e Gjuhës në Shqipninë Socialiste*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 23.

i kemi modelet, mundsinë e zgjedhjes dhe rezultatet e zgjedhjeve”.<sup>2</sup>

Në ish-federatën jugosllave gjuha kroate ishte vënë në pozitë inferiore ndaj serbishtes. Cilësori (gjuhë) *serbokroate* sugjeronte rolin dytësor të kroatishtes në raport me gjuhën serbe. Më 1967 një grup intelektualësh kroatë, në mesin e të cilëve kishte edhe anëtarë partie, botuan një manifest, nëpërmjet të cilit kërkonin që edhe kroatishtja të njihej si gjuhë më vete, si sllovenishtja dhe maqedonishtja, të cilat e kishin statusin e gjuhës së dallueshme nga serbishtja. Më 1971, rikujton Pipa, qeveria federale goditi udhëheqësit e kësaj lëvizjeje nacionaliste me argumentin se seperatizmi gjuhësor të çon te seperatizmi politik.

“Tani shqipja është, sikurse serbokroatishja, një gjuhë me dy dialekte, Gegërishten (në Veri) dhe Toskërishten (në Jug), situatë që i përgjigjet dialektit Shtokavia (Jekavian) dhe atij Kaikavian. Ndryshimet mes të dy dialekteve janë të krahasueshme me ata mes gegerishtes dhe toskërishtes, veçse ndryshimet mes dy dialekteve shqiptarë, janë më së shumti strukturorë, ndërsa ata mes dy dialekteve sllavojugorë, janë kryesisht leksikorë”<sup>3</sup>, vëren Arshi Pipa. Analogji në këtë krahasim ai gjen edhe te formimi kulturor i folësve të këtyre dy çifte dialektesh: “Serbët janë të orientuar nga Lindja, pasi feja e tyre është ortodoksia lindore, por edhe shkrimi i tyre është cirilik; ndërsa kroatët janë katolikë romanë e në përdorim kanë shkronjat latine. Gegët, që janë më së shumti myslimanë e katolikë (ortodoksë janë pak e aspak), janë po ashtu të orientuar nga Perëndimi, pasi të gjithë katolikët shqiptarë janë vetëm gegë, kurse toskët, të cilët janë ose myslimanë, ose ortodoksë, janë të orientuar nga Lindja, sepse bashkësia ortodokse është më së shumti toske”<sup>4</sup>.

Më tej, pasi rikujton se kroatët ishin pjesë e Hungarisë, komb katolik, pothuajse prej fillimeve të shekullit XII deri në vitin 1918, ndërsa serbët ishin raja e Perandorisë Otomane prej vitit 1938, deri në gjysmën e parë të shek. XIX, Pipa pohon se ndarja krahinore mes gegëve e toskëve pasqyron më shumë ndryshime kulturore sesa politike, dhe kjo zë fill me ndarjen e Perandorisë romake në dy pjesë, në atë të Lindjes dhe në atë të Perëndimit.

“Pas kësaj ndarje, Shqipëria i përkiste politikisht Lindjes, kurse kishtarisht Romës. Dhe kur më 1054 ndodhi Skizma mes Romës e Konstantinopolit, Shqipëria e Veriut mbeti nën juridiksionin e Romës. Ndryshimet më të mëdha dialektore që ekzistonin edhe para Skizmës dhe që shënojnë edhe dokumentet më të vjetra të shkrimit shqip (shek. XV), dëgjohen ende sot e gjithë ditën. Gegët e toskët, lehtësisht e kuptojnë njëri-tjetrin, por asnjëri s’e flet dialektin e tjetrit pa e shpërfytyruar sado

<sup>2</sup> Parathania e librit *Politika e Gjuhës në Shqipëri në Socialiste*, e shkruar nga Primo Shllaku, fq. 18.

<sup>3</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 14.

<sup>4</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 24.



pak”<sup>5</sup>.

### **Komisia Letrare e Shkodrës - zelli patriotik dominoi mbi rreptësinë shkencore**

Arshi Pipa, në mënyrë kronologjike, ka analizuar aktet më të rëndësishme të historikut të shqipes, që nga Kongresi i Manastirit (1908) dhe Komisia letrare e Shkodrës (1916) deri te Kongresi i Drejtshkrimit i Tiranës (1972). Kështu, Kongresin e Manastirit (1908) Pipa e cilësoi si “një datë të rëndësishme në historinë e gjuhësisë shqiptare, sepse vuri bazat për një alfabet të përbashkët”. Por, po ashtu, ai vëren se “problemi i një gjuhë të përbashkët letrare, u la për më vonë për shkak të vështirësive që paraqiteshin lidhur me ndryshimet e mëdha fonologjike mes dy dialekteve”.

Sa i përket Komisionit letrarë (me anëtarë si Gjergj Pekmezi, Aleksandër Xhuvani, Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta dhe Ndre Mjeda), A. Pipa vlerëson se “Komisia ishte e mirëkualifikuar për një hulumtim shkencor rreth çështjes së një gjuhe letrare të përbashkët”.

“Vendimi i Komisionit ishte të adoptojë idiomën gego-juçore të Elbasanit “me disa përmirësime”, si bazë për konvergimin e të dy dialekteve. Ky konvergjim duhet të ishte i shkallëshkallshëm, rezultat i një kompromisi të arsyeshëm, si ai i arritur prej Kongresit të Alfabetit (Mjeda, Fishta, Gurakuqi dhe Soti Peci, kishin qenë edhe anëtarë të Kongresit të Alfabetit). Kështu, pra, vendimet e Komisionit patën karakter tendencë – tregues, sesa ndonjë natyrë normative. Fare pak norma u cilësuan: 1) ruajtja e *ë* “atje ku është etimologjikisht e duhur dhe ku dëgjohet në toskërishte”, qoftë në pozicion të brendshëm: *Mëria, këndoj* (Lat. ‘cano’), qoftë në pozicion fundor: *vashë, punëtorë, ranë* (folja ‘bie’); 2) heqja e shenjave diakritikë për zanoret e gjata; 3) përdorim i kufizuar i shenjës diakritike të hundakes (‘) mbi hundoret geqe në emra që mbarojnë me *â* (*zâ*), *i* (*hî*), *ê* (*phê*); 4) përdorimi i diftongjeve të pamanoftongjizuar *ue, ie, ye*, dhe 5) përdorimi i paasimiluar i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ngj*”<sup>6</sup>, pohon Pipa.

Sipas tij, të pesta këto norma, janë lëshime ndaj dialektit toskë, i cili e ruan *ë* (në gerërisht bie); nuk shënon zanoret e gjata dhe hundoret, të cilat pothuajse janë zhdukur në toskërisht (gegërishtja i ka mbajtur ato); ruan diftongjet *ua, ie, ye* (të cilat gegërishtja i monoftongjizon); dhe nuk asimilon (siç ndodh me gegërishten) grupet bashkëtingëllore *mb, nd, ngj*. Komisia letrare e Shkodrës, vijon Pipa po aty, në pjesën e saj dërmuese e përbërë prej anëtarësh gegë, u ndje e detyruar për t’i bërë këto lëshime të rëndësishme toskërishtes, për hatër të afrimit të dialekteve, çfarë shpresohet, se do

<sup>5</sup> Po. aty

<sup>6</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 23.

të çonte te një shqipe e përbashkët letrare.

“Parimi kryesor i Komisionit ishte ai fonetik, që do të thotë se grafema e një fjale duhet të përputhet me shqiptimin e saj. Ky parim funksionon mirë për toskët, kurse për gegët jo, të cilët (a) nuk i shqiptojnë *ë* fundore, por shpesh edhe të ndërmjetme: *Mria, këndoj, vash, puntor, rën*; (b) jo vetëm ka zanore të gjata, por kompenson për bjerrjen e një *ë* duke zgjatë zanoren në rrokjen paraardhëse; (c) nazalizon një seri zanoresh që në toskërisht dëgjohen si gojore; (d) i ka bjerrë diftongjet *ue, ie, ye*, të cilët në toskërisht ruhen (*ua, ie, ye*); dhe (e) i asimilon grupet bashkëtingëllore *mb, nd, ngj* në *m, n, nj (Ŋ)*”<sup>7</sup>, shkruan Pipa.

Gjithashtu, Pipa mendon që (citoj) “me këto lëshime që bëri Komisioni letrare, në fakt e shkatërroi parimin themelor të projektit të saj reformues. Me fjalë të tjera, zelli patriotik dominoi mbi rreptësinë shkencore. Rrjedhojë e kësaj qe se, ndërsa shkrimtarët gegojugorë (shumica prej Elbasani dhe të udhëhequr nga Xhuvani) zbatuan rregullat e Komisionit Letrare, shkrimtarët shkodoranë (Fishta e Mjeda ndër ta, se Gurakuqi iu përmbajt rregullave) vazhduan t’i shënojnë zanoret e gjata me shenjën diakritike *’/*, ndërsa përgjithësisht iu përmbajtën rregullave të vendosura prej Komisionit Letrare”<sup>8</sup>.

Tendenca letrare e Elbasanit, vijon po aty Arshi Pipa, fitoi terren në zyrat e shtetit dhe në shkolla (sidomos fillore – Xhuvani për kohë të gjatë ishte sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit), kurse tendenca letrare e Shkodrës preku letërsinë, falë prestigjit të shkrimtarëve të saj madhorë (Fishta, Mjeda, Koliqi, Migjeni).

### ShNjL, përzierje teorish kundërthënëse

Gjatë viteve 1920 -1930, madje edhe gjatë pushtimit të Shqipërisë prej Italisë dhe Gjermanisë (1939-1944), situata gjuhësore mbeti pothuajse e njëjtë. Ndërkohë që nuk pati ndonjë përpjekje për afrimin e dialekteve, shqipja shkruhej sa në dialektin gegë, aq edhe në atë toskë. Mirëpo, “situata ndryshoi menjëherë, sapo e morën pushtetin në dorë komunistët: toskërishtja u bë gjuhë zyrtare e partisë dhe e shtetit”<sup>9</sup>.

Më 1952, Lidhja e Shkrimtarëve (e Shqipërisë, v. j.) vendosi që botimet të dilnin vetëm toskërisht. *Gëgërishtja letrare*, thotë Pipa po aty, *u ngushta vetëm në sferën e letërsisë artistike, e cila vazhdoi të lejohet, ndërsa vazhonte të humbte terren. Shpejt dialekti toskë e mundi dialektin gegë.*

Ndërsa të shkruarit në variantin gegë mbeti privilegj vetëm i shkrimtarëve të

<sup>7</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 24.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Po aty.

Kosovës dhe viseve të tjera në ish-Jugosllavi, revolucionin kulturor shqiptar (1966-1969), “i zhduku edhe gjurmët e fundit të gegërishtes”. Madje, Pipa mendon se nuk është aspak e rastit, që vepra vendimtare që do të caktonte atë çfarë do të quhej “gjuhë letrare e njësuar”, *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (1968) u botua pikërisht në kohën e kulmit të këtij revolucionit maoist.

Sa i përket pozicionit të studiuesve nga Kosova, dhe studiuesve të tjerë shqiptarë në ish-federatë, të cilët, në Konferencën e Prishtinës (1968) “vendosën të përqafonin gjuhën zyrtare shqipe”, Arshi Pipa thekson: “Këtë, kosovarët e bënë për të theksuar kombësinë e tyre shqiptare në formë proteste kundër refuzimit të Federatës Jugosllave për t’i dhënë Kosovës statusin e republikës”<sup>10</sup>. Madje, duke e pranuar ShNjL-në, nën parullën “një komb, një gjuhë letrare”, Pipa thotë se “ata u përnjësuan me stalinizmin shqiptar, duke i rënë ndesh kështu Jugosllavisë, e njohur për vijën e saj politike antistaliniste”. Si të mos i mjaftonte që i gjuan në thes studiuesit nga Kosova e Maqedonia në kampin stalinist, Pipa bën një hap më tutje, duke akuzuar: “Ata nuk arritën për të kuptuar, se gjuha e përçon ideologjinë në atë mënyrë që lumi bart dheun prej brigjeve të veta, ideologji që në Shqipërinë staliniste ishte përdorë edhe për të ilustruar deri rregullat gramatikore”<sup>11</sup>.

Një përgjithësim i tillë është i pavend, sepse t’i akuzosh në bllok të gjithë studiuesit e Kosovës për stalinizëm është një gafë e rëndë, aq më tepër kur pikërisht në Prishtinë, madje për dekada të tëra, studimet albanologjike njohën një hapje dhe ndërkomunikim të vrullshëm dhe cilësor me dijet dhe shkollat e ndryshme evropiane të kohës, të cilat për studiuesit nga Shqipëria, për shkak të vetizolimit të saj, ishin të paaritshme. Edhe shembulli që ka zgjedhur Pipa për të evidentuar moszotërimin e standardit nga kosovarët (një intervistë e dr. H. Bajramit, drejtor i Arkivit të Kosovës, gazeta “Rilindja”, 17 prill 1988) është i paqëlluar, sepse në secilin vend të botës, mund të gjesh pa fije vështrësie një funksionar shtetëror a një “doktor shkence” që s’e njeh standardin e gjuhë së tij.

Këtë “ilustrim” të pagoditur të Pipës e ka potencuar edhe Rexhep Ismajli, i cili mendon se “në frymën e vërejtjes që bënte A. Pipa për gjuhën e H. Bajramit, mund të bëhen diskutime të gjera lidhur me gjuhën e përdorur në Kosovë. E vërteta, duke qenë shqiptarët e Jugosllavisë përgjithësisht në një nivel tjetër zhvillimi në raport me të tjerët në atë shtet, edhe standardi gjuhësor në përdorimet publike, kulturore e letrare detyrimisht ishte tjetër”<sup>12</sup>.

Edhe sugjerimi i A. Pipës që “kosovarët” duhet të ndiqnin shembullin e Pjetër

<sup>10</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 25.

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, fq. 227.

Bogdanit, duke përshtatur për vete “një gjuhë me mbështetje në të folmen e Shkodrës”, duket i pazbatueshëm, pasi që distanca kohore e ka bërë të veten, ndaj gjuha e Bogdanit s’mund të jetë model i “gjuhës së kosovarëve”, sepse, vështruar edhe nga aspekti sociolinguistik, gjuha, mbi të gjitha, është *mjet komunikimi*. Vështirë të mendosh që dy milionë shqiptarë të Kosovës (dhe të viseve të tjera të ish-federatës) mund të “dresohen” lehtë, sa t’i përshtaten atij varianti që propozon Pipa.

Sidoqoftë, mllëfin e madh Pipa e ka ndaj mënyrës se si u realizua eliminimi i gegërishtes letrare në procesin e ShNJL-së dhe ndaj Androkli Kostallarit.

“Komunizmi shqiptar, është më së shumti dukuri e jugut shqiptar. Dhe kështu ndodhi, që çlirimi i vendit prej pushtesit të huaj mbaroi me ngadhënjimin e Jugut mbi Veriun antikomunist. Imponimi i toskërishtes mbi gegërishten, ishte pasqyrim i hegjemonisë politiko-ushtarake, pasi ngadhënjimitarët, jo rrallë, u kanë imponuar gjuhën e vet të mundurve”<sup>13</sup>, shkruan Pipa, për të cilin GjNJL-ja është një përzjerje marriste, e përgatitur sipas recetës së Stalinit.

Marrizmi ishte një drejtim ideologjik e metodologjik, që e sundoi linguistikën sovjetike që në vitet e para pas të revolucionit bolshevik (1917). Krijues i këtij drejtimi ishte Nikola Jakovljeviç Marri (1867 -1934), i cili “në vitin 1924 u deklarua si mbrojtës i marksizmit në lingusitikë”<sup>14</sup>. Në thelb të bindjeve të Marrit qëndron teza se nuk ekzistojnë gjuhët e kombeve, por vetëm e gjuhët e klasave shoqërore. Marri insistonte se “gjuhët në evolucionin e tyre ecin nëpër stadime të caktuara zhvillimi, nga shkalla e ulët e zhvillimit kah e larta”, ndërsa “ekziston, pra, një rend i qartë hierarkik ndërmjet gjuhëve: duke marrë parasysh shkallën e arritur të zhvillimit, disa janë të rangut të lartë e disa të ulët”<sup>15</sup>.

Pipa beson se “fati e deshi mirë Xhuvanin, që e shpëtoi prej poshtërimit të nënshkrimit për sanksionimin e GjNJL-së”. Kur u shtrua për diskutim *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1951) që propozonte të dy variantet (gegërisht edhe toskërisht), i hartuar prej Xhuvanit, Cipos e Çabejt në dy konferencat e thirrura prej Partisë, me qëllim të promovimit të prirjes njëvariantëshe (toskërishtes), Xhuvani e mbroji dyvariantëshin duke cituar Stalinin: “Marksizmi nuk pranon shpërthime të gjuhës”, si dhe duke argumentuar se “gegërishtja, siç dihet mirë, është shkruar prej autorësh të famshëm prej kohësh të vjetra, ka një letërsi të gjerë, flitet prej një pjese të madhe të popullit dhe nuk është e lehtë të hidhet tutje si rrobë e vjetër, ose të çohet në muze, siç janë shprehur disa”<sup>16</sup>.

<sup>13</sup> A. Pipa, vep. e cit., fq. 26.

<sup>14</sup> Milka Iviq, *Drejtmet në lingusitikë*, “Rilindja, Prishtinë, 1977, fq. 117.

<sup>15</sup> M. Iviq, vep. e cit., fq. 116.

<sup>16</sup> Aleksandër Xhuvani, *Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe*, Buletin për shkencat shoqërore (Instituti i Shkencave), IV, 1952, fq. 70.

Vrulli i Kostallarit për të bërë ndryshime të përnjëhershme e shpie atë pavetëdijshëm në teorinë stadiale të Marrit, në teorinë e “shpërthimit të papritur në zhvillimin e gjuhës”, që bie ndesh me “mësimet” e Stalinit, i cili sugjeronte se zhvillimi i gjuhës duhet të ishte si “një shuarje e ngadalshme elementëve të cilësisë së vjetër, së bashku me grumbullimin e ngadalshëm të elementëve të cilësisë së re”<sup>17</sup>.

Stalini “këshillonte” se nevojitej “një periudhe kohore” për kalimin nga gjendja e cilësisë së vjetër, në gjendjen e cilësisë së re, nga gjuha e mundur, në gjuhën ngadhënjimtare. Këtu, plotësisht me të drejtë, Arshi Pipa vëren lajthitjen, apo më mirë me thanë hilen e A. Kostallarit, i cili, në një rën anë himnizon Stalinin, ndërsa, në anën tjetër, shtyn përpara me hov tipik marrist përmbysjen e gegërishtes letrare për një periudhë që nuk zgjati më shumë se pesë-gjashtë vjet. E, vetë Stalini, babai shpirtëror e ideologjik i Kostallarit, një kohë kaq të shkurtër për ndryshimet/përzierjet në gjuhë e cilësonte si “një periudhë qesharakisht e shkurtër për eliminimin e një gjuhe ekzistuese dhe ndërtimin e një gjuhe të re kombëtare”<sup>18</sup>.

Së këndejmi, s’ke si të mos pohosh se Kostallari nuk ndoqi në mënyrë besnike asnjërin drejtëm, por mori sa nga marrizmi, sa nga stalinizmi, varësisht çka i shkonte përshtati në rrethana të caktuara. Ndaj, ai del jo veç stalinist, po edhe marrist. Për më tepër, një makiavelist, i cili për të arritur qëllimin, për të kryer detyrën nuk zgjedh mjete. Ndaj, Pipa vlerëson se ShNJL është një përzierje e paparimtë dy teorish kundërthënëse, një përzierje që është marriste në thelb, por e gatuar sipas një recete staliniane.

---

<sup>17</sup> Sipas A. Pipa, vep. e cit., fq. 184.

<sup>18</sup> Sipas A. Pipa, vep. e cit., fq. 184.



Naser PAJAZITI

## NDIKIMI IDEOLOGJIK NË ÇËSHTJE TË DREJTSHKRIMIT E TË SHPJEGIMIT TË TERMAVE RELIGJIOZË

### Abstrakt

Në këtë kumtesë kemi trajtuar trajtuar ndikimin që ka ushtruar ideologjia komuniste në çështjen e drejtshkrimit e të shpjegimit kuptimor të termave religjiozë në fjalorët drejtshkrimorë dhe shpjegues të gjuhës shqipe. Këtu kemi përmbledh terma e fjalë që u takojnë konfesioneve të ndryshme fetare, pasqyrimi i të cilave nëpër veprat e përmendura është bërë drejtpërdrejt nën ndikimin e ideologjisë marksiste të kohës. Duke e vënë në pah këtë të metë metodologjike të këtyre veprave, autori i kësaj kumtese e shtron të nevojshme që gabimet e tilla të korrigjohen dhe edhe këto fjalë e terma të trajtohen njëloj me fjalët dhe termat e tjerë të cilësdo fushë.

**Fjalët kyçe:** idelologjia, feja, leksiku, fjalorët, drejtshkrimi, shpjegimi.

Pasi gjuha standarde është produkt i një ndërhyrje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë, është e natyrshme që të pasqyrojë zhvillimin socio-ekonomik dhe socio-kulturor të asaj shoqëri ku krijohet standardi. Me rastin e standardizimit shqipes ndikuan drejtpërdrejt jo vetëm marrëdhëniet kulturor-ekonomike, por thellësisht edhe ato politike. Me ardhjen Partisë Komuniste në Shqipërinë e pasluftës, kur çdo gjë shihej në frymën e atmosferës partiake, këtij ndikimi nuk i ka shpëtuar as gjuha në të gjitha rrafshet e saj. Pra, zhvillimet e përgjithshme politike në shoqërinë shqiptare janë reflektuar thellë edhe në probleme gjuhësore, ndërsa ne këtu do të kufizohemi vetëm në *ndikimin që ka pasur ideologjia komuniste në çështje të drejtshkrimit e të shpjegimit të termave religjiozë*, ku do të trajtojmë ndikimin që ka ushtruar ideologjia komuniste në çështjen e drejtshkrimit e të shpjegimit kuptimor të termave religjiozë në fjalorët drejtshkrimorë dhe shpjegues të gjuhës shqipe, duke përfshirë në të terma e fjalë që u takojnë konfesioneve të ndryshme, pasqyrimi i të cilave nëpër veprat e përmendura është bërë drejtpërdrejt nën ndikimin e ideologjisë marksiste të kohës.

Termtat *religjiozë*, krahas termave të fushave të tjera, përbëjnë një kategori të

veçantë të leksikut special dhe si fushë është me interes të gjerë për leksikografinë e gjuhës shqipe (Hëna, 1995:304). Këta terma janë emërtime të nocioneve, sendeve, dukurive, shërbesave kryesore që kryhen gjatë veprimtarive fetare etj.

Feja në Shqipëri është ndaluar me ligj më 1967. Shqipëria u shpall vend ateist, prandaj ndalimi i fesë në Shqipëri është reflektuar drejtpërdrejt edhe në çështje gjuhësore, në mënyrë të veçantë ajo që ka të bëjë me terminologjinë që lidhet fushën e religjionit, si në aspekti e caktimit të rregullave të drejtshkrimit, po në mënyrë të veçantë në shpjegimin e fjalëve të kësaj sfere në frymën ateiste.

Ndikimi ideologjik në trajtimin e disa fjalëve të pasluftës në Shqipëri e në veçanti fjalori i 1980-s shpreh me theksimin e karakteristikës së tyre fetare, por edhe me formula e parafrazime që, në njëfarë shkalle, i paraqitnin ato si të vjetruara, madje edhe si jashtë normës letrare (Thomai, 1995: 313). Karakterizimi me shkurtesën fe. (fjalë ose shprehje fetare), e cila përmban një vlerësim objektiv në sistemin e përgjithshëm të karakterizimit të fjalëve sipas fushave të përdorimit, sipas vlerave stilistike etj., ka brenda edhe një vlerësim sipas kontekstit politiko-ideologjik të kohës, lidhur me gjykimin për fenë në përgjithësi, e kjo përforcohet ndonjëherë edhe me kufizimin kohor nëpërmjet shkurtesës *ijet*. (Fjalë a shprehje e vjetruar).

Kjo vërehet edhe sa i përket aspektit sasior të përfshirjes së këtij leksiku në fjalorët e gjuhës shqipe.

Fjalori shpjegues, i cili u botua në vitin 1980 në Tiranë dhe pastaj u ribotua në Prishtinë në vitin 1981, po edhe ai i vitit 1984, i botuar në Tiranë, në gjuhën standarde “shënon epokën e terrorit, të tmerrit, të diktaturës komuniste - ateiste, sepse shanin, fyenin, akuzonin, luftonin, mallkonin jo vetëm fenë, por edhe Kishën e Xhaminë, Hoxhën e Priftin, Biblën e Kuranin, madje edhe Zotin, Perëndinë, kurse e lavdëronin Partinë”<sup>1</sup>...!!!

Nga analizat e bëra nga ana sasiore del se në *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954) janë pasqyruar 600 terma fetarë, kurse në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1980) janë pasqyruar rreth 400 terma. Këtu vihet re një dukuri interesante: në *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954), megjithëse i tipit të vogël, janë pasqyruar më shumë termat fetarë se sa në fjalorin e *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1980) (Hëna, 305) që është i tipit të mesëm. Kjo shpjegohet, pa dyshim me ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë. Dihet se në vitet 70, kur u hartua “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, feja në Shqipëri tashmë ishte ndaluar. Kjo rrethanë

<sup>1</sup> <http://www.mesoislamin.com/index.php/ballina/burimet-islame/fjalori-dhe-terminologjia/item/261-terminologjia-islame-ne-gjuhen-shqipe>



ndikoi si në sasinë e fjalëve të botës fetare që u përfshinë në fjalorë, ashtu edhe në shpjegimin e vlerësimit të tyre ideologjik.

Nëse bëhet një krahasim ndërmjet fjalorëve të vitit 1954 dhe atij të vitit 1980 shihet qartë se fjalori i vitit 1954, edhe pse i tipit të vogël, ka të përfaqësuar më mirë terminologjinë që lidhet me religjionin. Pra, u tha se fjalori i 54-ës ka më shumë fjalë nga kjo sferë se ai i 81-tës. (Thomai, 1995: 312). Kjo lidhet edhe me faktin se feja në Shqipëri, në vitet 50, kur u hartua fjalori ende nuk ishte e ndaluar, ndërsa ajo u ndalua më vonë.

Në këta fjalorë gjejmë formulime për fjalë nga sfera e religjionit, parafrazime si: besimi i verbër, gjoja nga forca të mbinatyrshme; është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; botëkuptim idealist e reaksionar; armik i betuar i përparimit e i shkencës, përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; feja është opium për popullin, sipas parafytyrimeve fetare e mistike, e trilluar nga fetë e ndryshme, gjoja ka krijuar botën, vendet e ashtuquajtura «të shenjta» (në Mekë a në Jerusalem); sipas besimeve të kota, libër që përmban dogmat e fesë myslimane dhe legjenda të ndryshme mitike; gjoja për t'i pastruar nga mëkatet «të shenjta»; gjoja shpreh vullnetin hyjnor dhe parathotë atë që do të ngjasë më vonë (sipas besimeve mistike fetare) e shumë formulime të tjera. Për mënyrën e interpretimit ideologjik të leksikut religjioz në fjalorin e vitit 1980 po japim disa shembuj të ndryshëm.

FE/f. Besimi i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet gjoja nga forca të mbinatyrshme, hyjnore, i cili ka lindur qysh në kohë shumë të hershme dhe është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; tërësi dogmash që japin një botëkuptim fund e krye idealist e reaksionar, i cili është armik i betuar i përparimit e i shkencës, dhe përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; besimi te zoti. Feja e krishterë (ortodokse, katolike, myslimane). Origjina (përhapja) e fesë. Lufta kundër fesë. Ndërroi fenë. Mohoj (luftoj) fenë. Feja është opium për popullin.

ZOT I m. fet. Sipas parafytyrimeve fetare e mistike: qenia më e lartë e mbinatyrshme, e trilluar nga fetë e ndryshme, e cila gjoja ka krijuar botën, qëndron mbi të dhe drejton gjithçka; perëndi. S'ka zot. Nuk i lutemi me zotit.

AVDES m. fet. Riti i larjes së duarve, të fytyrës e të këmbëve, që bëjnë myslimanët para lutjeve në përputhje me dogmën fetare (në vendet ku vepron feja myslimane). Uji i avdesit. Merrnin avdes. Hoqën dorë nga avdesi.

HAJMALI f. vjet. Send i vogël, që e mbanin njerëzit me vete ose që u varej kafshëve, sepse, sipas besimeve të kota, gjoja kishte fuqi t'i shëronte nga sëmundjet, t'i mbronte nga rreziqet e fatkeqësitë, t'u sillte mbarësi etj. Varnin hajmali. E mbante si

hajmali. Hoxhët bënin hajmali. I hoqën hajmalitë

KURAN m. fet. Libër që përmban dogmat e fesë myslimane dhe legjenda të ndryshme mitike. Suret e kuranit.

XHENET m. 1. fet., vjet. Sipas dogmës së fesë myslimane dhe përfytyrimeve mistike: vend shumë i bukur, ku gjoja jetojnë në lumturi shpirtat e të vdekurve që nuk kanë bërë mëkate në të gjallë; kund. xhehenem. Xheneti e xhehenemi shkojnë bashkë. S'ka xhenet në atë jetë.

2. fig. bised. Vend i bukur dhe i begatë, vend ku mund të jetojë njeriu i lumtur, parajsë. Xhenet mbi dhe. E bënë xhenet. 3. përd. mb. bised. Që është vetë i qeshur, i gëzuar e gojëmbël dhe që u sjell gëzim edhe të tjerëve. Është djalë (njeri) xhenet. Ka marrë një grua xhenet.

KURBAN m. 1.fet. Bagëti që theret për bajram a për ditë fetare të shënuara të myslimanëve (në vendet ku vepron feja myslimane).

2. vjet. Bagëti që therej kur fillonte ndërtimi i një shtëpie, duke kujtuar, sipas besimeve të kota, se kjo do të sillte mbarësi. Kurhani i themeleve.

3. fig. bised. Fli, theror për një ideal të lartë; viktimë në një fatkeqësi natyrore (nga përmytja, nga tërmeti etj.). Shkoi kurban iku kot, vdiq kot. T'u bëfsha kurban! përk. i thuhet me dashuri zakonisht një fëmije. Kurban nëna (motra ...)! përk. t'u bëftë nëna (motra) kurban! \* M'u bëftë kurban mallk. përdoret kur shprehim mospëlqim për atë që bën a që thotë dikush, duke i dëshiruar të pësojë një të keqe; më marrtë të keqen! Dashi i kurbanit ai, të cilit i ngarkohet faj i të tjerëve, ai që vuan a ndëshkohet për fajin e të tjerëve. Shkoi si dash kurhani shkoi kot, pa faj, shkoi humbur.

MURG m. fet. Anëtar i një urdhri fetar, që rri në një manastir e bën një jetë prej asketi (në vendet ku vepron feja). Murg katolik (budist). Urdhër murgjish. Jetonte si murg.

2. fig. keq. Njeri i vetmuar, që bën një jetë të mbyllur; njeri i shkëputur nga jeta e gjallë.

3. përd. mb. fig. (zakon. përpara emrit) bised. I mjerë, i shkretë, i zi. Murgu baba! Murgu plak! Murgu ai! E pësoi murgu djalë! \* Murgu i natës mit. plak shpirtkeq që besohet se jetonte duke bredhur natën për të dënuar njerëzit, për të bërë dëme etj. (sipas besëtytnive).

KUNGIM m. fet. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KUNGOJ, KUNGOHEM. Dita e kungimit. 2. Rit fetar që bëhet zakonisht në kishë, ku prifti u jep besimtarëve me lugë vere me copa meshe ose oste, gjoja për t'i pastruar nga mëkatet; buka dhe vera që u jep prifti besimtarëve ortodoksë gjatë këtij riti (në vendet ku vepron feja e krishterë). Kupa e kungimit. Mori kungimin.

KRISHTLINDJE f. kryes. fet. Një nga festat kryesore të të krishterëve, e cila, sipas dogmave të fesë, njihet si dita e lindjes së Krishtit dhe bie më 25 dhjetor (në

vendet ku vepron feja e krishterë). Nuk i festojmë më krishtlindjet.

APOSTULL m. 1. fet. Secili nga dymbëdhjetë nxënësit e Krishtit, që predikuan dogmat e tij sipas mitologjisë së krishterë; libër fetar, ku tregohet veprimtaria e tyre. Veprat e apostujve.

2. fig. libr. Mbrojtës dhe përhapës i zjarritë i një ideje, i një doktrine etj. Apostull i lirisë (i së vërtetës). Apostull i idesë kombëtare.

HAXHI m. fet. Titull që u jepet besimtarëve myslimanë ose të krishterë, të cilët shtegtojnë në vendet e ashtuquajtura «të shenjta» (në Mekë a në Jerusalem); ai që ka shtegtuar në vendet e ashtuquajtura «të shenjta» dhe ka marrë këtë titull (në vendet ku vepron feja). U bë haxhi.

HAXHILLËK m. fet. Shtegtim që bëhet nga besimtarët myslimanë e të krishterë në vendet e ashtuquajtura «të shenjta» (në Mekë a në Jerusalem); lutja fetare që bëhet me këtë rast (në vendet ku vepron feja). Shkoi për haxhillëk. U kthye nga haxhillëku.

PROFET m.1. fet. I dërguar i perëndisë, që vjen të përhapë një fe, që gjoja shpreh vullnetin hyjnor dhe parathotë atë që do të ngjasë më vonë (sipas besimeve mistike fetare).

2. fig. Ai që parathotë a paralajmëron diçka që do të ndodhë në të ardhmen.

PROFETIK mb. libr. 1. fet. Që ka të bëjë me profetin si i dërguar i perëndisë (sipas besimeve mistike fetare).

2. Që parashikon dhe paralajmëron diçka që do të ndodhë në të ardhmen; që ka natyrën a karakterin e një profecie. Fjalë profetike.

Fryma ateiste në Shqipërinë komuniste nuk ka lënë pa u reflektuar edhe në vendosjen e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Në “*Drejtshkrimin e gjuhës shqipe*”, faqe 153 thuhet:

“Shkruhen me shkronjë të madhe pjesët përbërëse të emërtime,ve të festave kombëtare e ndërkombëtare: 28 Nëntori, 29 Nëntori, 11 Janari, 8 Marsi ose Tetë Marsi, 1 Maji ose Një Maji, 24 Maji, 7 Qershori,10 Korriku, 7 Nëntori, 8 Nëntori ose Tetë Nëntori, Dita e Aviacionit, Dita e Mësuesit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, Viti i Ri etj.” (Drejtshkrimi, 1973: 153-154)

Ndërsa më poshtë jepet shpjegimi ku thuhet:

Emrat e festave fetare shkruhen me shkronjë të vogël: *bajrami, kërsbëndellat, nata e mirë, pashkët, e premija e zezë, ramazan, ujët e bekuar* etj.

Ndërsa në faqen 146 (Drejtshkrimi, 1973: 146) thuhet: “Shkruhen me shkronjë të madhe emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare, si edhe ata të figurave e të tregimeve popullore: *Adami, Apoloni, Buda, Eva, Muhameti* etj. (por shkruhen me shkronjë të vogël emrat e përgjithshëm të sferave të mësipërme si *allah*,

*engjell, perëndi” etj.*

Për fund mund të themi se pasqyrim i terminologjisë fetare në fjalorët e gjuhës shqipe dhe e shpjegimi, parafrazimi që i bëhet këtij leksiku, kryekreje në frymën ateiste, tregon më së miri gjendjen e Shqipërisë së asaj kohe dhe ndikimin që ka pasur ideologjia komuniste në krijimin e standardit të shqipes dhe në vendosjen e rregullave të këtij standardi.

Duke i pasur parasysh këtë të metë metodologjike të këtyre veprave është e nevojshme që gabimet e tilla të korrigjohen dhe këto fjalë e terma të trajtohen njëllë me fjalët dhe termat e tjerë të cilësdo fushë, ashtu që terminologjia nga fusha e religjionit në fjalorët tanë të gjejë vend të merituar, ndërsa fjalët e shprehjet e kësaj sfere të trajtohen e të shpjegohen ashtu si në të gjithë fjalorët e popujve të civilizuar të botës.

### **Bibliografia:**

1. Grup autorësh (1981) *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
2. Grup autorësh (1984) *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, ASHSH, Tiranë.
3. Thomai, Jani (1995) *Terminologjia Islame në leksikografinë shqiptare*, Feja, kultura dhe tradita në Islame ndër shqiptarë, Prishtinë.
4. Pasho, Hëna (1995) *Termet fetarë në sistemin e termave të pasqyruar në fjalorët shpjegues të shqipes*, Feja, kultura dhe tradita në Islame ndër shqiptarë, Prishtinë.
5. Grup autorësh (1973) *Drejtshkrimi i gjuhë shqipe*, ASHSH, Tiranë.
6. <http://www.mesoislam.com/index.php/ballina/burimet-islame/fjalori-dhe-terminologjia/item/261-terminologjia-islame-ne-gjuhen-shqipe>.

**Elda RESMJA MOLLA**

## **ROLI I KISHËS KATOLIKE NË HISTORINË KULTURORE E GJUHËSORE TË SHEKUJVE XVI-XVIII**

### **Abstrakt**

Gjatë punimit synohet të hidhet dritë mbi rolin dhe kontributet e Kishës Katolike në zhvillimin kulturor gjatë shekujve XVI-XVIII. Kishte kaluar një shekull nga pushtimi osman duke sjellë ndryshime në ekonomi, kulturë dhe fe. Popullsia shqiptare dhe sidomos ajo e krishterë përballej me një kulturë të re, atë islame, e cila gjithnjë e më shumë po fitonte terren. Përballë kësaj situatë institucionet e larta fetare filluan të reagonin dhe të ndërmerrnin reforma për të mbrojtur besimin e krishterë. Siç dihet, gjatë kësaj kohe zhvillimi kulturor e arsimor në Shqipëri kryhej nën sundimin ideologjik fetar. Edhe pse tri besimet fetare u shërbenin ineresave të tyre, përsëri roli që luajtën në zhvillimin kulturor të vendit që i madh. Në shekullin XVI, në vitin 1555 kemi librin e parë shqip, i cili do të pasohej nga libra të tjerë, duke i hapur rrugën letërsisë së vjetër shqipe, me përmbajtje fetare. Kjo u arrit falë lejimit të përdorimit të shqipes në librat dhe shërbesat fetare, botimin e veprave shkencore e fetare. Gjithashtu është për t'u përmendur dhe hapja e disa shkollave për shkollimin e klerit katolik, ku mësohej shqipja. Të gjitha këto qenë përpjekje serioze për të ruajtur e mbrojtur jo vetëm fenë, por dhe zakonet, gjuhën, duke u shndërruar në pengesë për politikën asimiluese të pushtimit osman.

Fjalët kyçe: *asimilim, botime, ideologji, kleri shqiptar, tekste të vjetra.*

***"Katolikët shqiptarë janë shkak që u mbajt gjallë gjer më sot kombësia jonë." Faik Konica.***

Shekujt IX-XV karakterizohen nga luftrat dhe konflikte të vazhdueshme, të cilat kishin ngadalësuar duke i çuar deri në shkatërrim dhe ato pak arritje të brishta ekonomike, shoqërore, kulturore e fetare. Kjo periudhë përkon me fuqizimin e shteteve teokratike ortodokse dhe mbizotërimin e politikave përkatëse. Është koha kur si gjuhë kishtarë, mbizotëronte gjuha greke e më pas ajo sllave e vjetër. Siç

shprehet dhe studiuesi R.Ismajli, “gjuha e ortodoksisë si gjuhë e shenjtë u shndërrua njëkohësisht në gjuhë me simbolikë etnike (me vonë nacionale). Duke pasur monopolin e gjuhës së shenjtë, greqishtja dhe sllavishtja u bënë mjeti më i përshtatshëm për sundimet e kohës, për të zënë në grackë popujt aloglotikë”. Kjo dukuri lidhet me faktin se, si rezultat i pushtimeve të gjata, humbjeve të mëdha të vlerave materiale, dhe ato pak shkrime që mund të ekzistonin u zhdukën<sup>1</sup>. Kjo për faktin se ato qenë thjesht dorëshkrime, të shkruara në pak kopje, duke qenë se shtypshkronja e Gutenbergut u shpik vetëm në vitin 1440. E pra, në këto kushte nuk mund të bëhej fjalë për shkrime e aq më pak të ruheshin këto shkrime apo dhe të flitej për letërsi në gjuhët vendase.

Si për të mos mjaftuar kjo gjendje e rëndë e kulturës shqiptare, në mes të shekullit XV Shqipëria u pushtua nga perandoria osmane, duke ndërprerë zhvillimin e brishtë të arritur me vështirësi. Megjithatë, këtu mund të ndërhyhet duke shprehur një qëndrim të kohëve të fundit të studiuesve, të ndryshëm nga ai i mbajtur tradicionalisht në tekste mësimore, lidhur me këtë çështje. Sipas tyre zhvillimi kulturor ishte ndërprerë shumë kohë para pushtimit osman, pikërisht gjatë periudhës së pushtimit bizantin që i paraprin atij osman. Kjo është një nga çështjet që meriton vëmendje dhe diskutim.

Nisur nga rrethanat jo të favorshme kishtarë, në kohën kur në Shqipëri sundonte një klimë e rëndë politike kulturore e fetare, kur katolicizmi rrezikohej seriozisht dhe nga islamizmi, feja e pushtuesve të rinj, kthimi i katolikëve shqiptarë në ortodoksë slavë e grekë, gjendja e rrënuar e kishave, mungesa e klerikëve të arsimuar, e vetmja rrugë për të dalë nga kjo situatë qe procesi i shqiptarizimit të Kishës Katolike. Aty rreth shekullit XVI ra në sy tendenca e Vatikanit për ndryshime të rrënjësishme të veprimtarisë fetare dhe ideologjike në botën shqiptare, duke ndërmarrë një varg masash e reformash, të cilat do të ndryshonin jetën kulturore e shoqërore të shqiptarëve. Kleri Katolik ndryshe nga besimet e tjera, ndoqi rrugën e tolerancës, gjë që nuk çoi në pengesë të zhvillimit të kulturës së kultivuar, por përkundrazi dha një kontribut të çmuar në këtë fushë. Siç pohohet me të drejtë nga studiuesit, Kisha Katolike ishte e lidhur ngushtë me traditën kombëtare, dinte të respektonte ritet dhe zakonet e shqiptarëve.

### **Lëvrimi i shqipes dhe botimi i teksteve në gjuhën shqipe.**

Në këto kohë propagandimi i fesë katolike në Shqipëri ishte lënë në dorë të

<sup>1</sup> Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1959, f.181. Aty M.Domi shkruan: *U dogjën biblioteka, dorëshkrime dhe akte. Me këto u zhdukën dhe momentet e shkrimit shqip të shekullit XIV-XV e më përpara*”

klerikëve të huaj të cilët nuk njihnin shqipen duke krijuar një klimë jo të favorshme. Janë të njohura nga studime<sup>2</sup> mbi këtë periudhë, grindjet midis klerikëve vendas dhe të huaj lidhur mbi këtë çështje. Mosmarrëveshjet vinin pikë së pari pikërisht nga fakti se ishin vetë besimtarët që kërkonin klerikë shqiptarë për kryerjen e riteve të ndryshme fetare.

Hap i rëndësishëm në këtë drejtim dhe që lidhej drejtpërdrejt me kulturën shqiptare ishte zëvendësimi i latinishtes me gjuhët kombëtare, dukuri që ndodhi dhe në shumë vende të tjera të Ballkanit Gjuha vendase shihej si mjet i rëndësishëm për përhapjen e fesë. Në Shqipëri kisha lejoi përdorimin e gjuhës shqipe në shërbesa dhe botimin e librave fetarë dhe shkencorë. Kështu të parët që shkruan gjuhën shqipe qenë priftërinjtë katolikë, zotërues të kulturës perëndimore. Si rezultat, dhe shkrimet e shqipes së shekullit XVI –XVIII qenë me karakter fetar ose didaktik. U përkthyen vepra me përmbajtje fetare, në funksion të ushtrimit të fesë dhe riteve të saj, sidomos katekizma nga italishtja ose latinishtja. Kjo letërsi u zhvillua kryesisht në Shqipërinë e Veriut, duke ndihmuar në lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare në bazë të gegërishtes veriore.

Përpjekjet e para për kryerjen e riteve dhe predikimeve fetare në gjuhën shqipe i përkasin shekullit XV, më saktë viti 1462. Në qarkoren e kryepeshkopit të Durrësit, Pal Engjëlli, gjejmë fjalinë: “*Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit*” dhe kjo do të përdorej në rastet kur nuk ishte i mundur pagëzimi i fëmijëve në kishë. Ky është dokumenti i parë në gjuhën shqipe.

Ngjarja kryesore në historinë kulturore e gjuhësore do t'i përkasë mesit të shekullit XVI, kohë kur zë fill letërsia e vjetër shqipe. Nismëtari i kësaj epoke të ndritur është prifti shqiptar Gjon Buzuku, i cili shkruan Mesharin, librin e parë të shkruar në gjuhën shqipe. At Gjon Buzuku në parathënien e “Mesharit” të tij thotë se e ka shkruar këtë vepër në shqip “nga dashnia për gjuhën tonë”. Ky libër dhe të tjerë që e pasuan, nuk ishin thjesht libra me përmbajtje fetare, por në to vërehet dhe dashuria dhe interesimi për vendin e të parëve. Me të drejtë Çabej thekson: “Veprat e të gjithë autorëve të vjetër janë fryt i dy faktorëve: i vullnetit të autoritetit kishtar dhe i dëshirës për t'i ardhur në ndihmë atdheut”<sup>3</sup>

Por shekulli pasardhës do të ishte më i mbarë lidhur me veprimtarinë e klerit katolik. Vepra e Buzukut do të ndiqej nga libra të tjerë, kryesisht përkthime tekstesh fetare, shkruar po nga klerikë shqiptarë, të cilët së bashku do të krijonin traditën e shkrimit të librave në gjuhën shqipe. Autori i parë është Pjetër Budi, i cili brenda një

---

<sup>2</sup> I.Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëllimi I, f. 17-35

<sup>3</sup> Eqrem Çabej, “Gjon Buzuku”, në *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1977, f.25.

kohe të shkurtër boton tre librat e tij: “Doktrina e Kërshtenë”, “Rituali Roman” dhe “Pasqyra e t’Rrëfyemit”. Më tej tradita e shkrimit të shqipes vijon me Frang Bardhin dhe fjalorin e tij latinisht- shqip. Shekulli XVII vazhdon të jetë i begatë me botime dhe këtë herë vjen “Çeta e profetëve” e klerikut vendas Pjetër Bogdanit, libër që njohu disa botime dhe kjo falë përmbytjes jo vetëm fetare, por dhe shkencore. Në historinë e shkrimit të shqipes gjatë shekullit XVIII, ndonëse vërehet zbehje e veprimtarisë fetare, vend të rëndësishëm zë botimi shqip e latinisht i akteve të mbledhjes së klerit katolik shqiptar, i njohur si Kuvendi i Arbënit (1706).<sup>4</sup> Teksti i Kuvendit të Arbënit, për rëndësinë që pati u ribotua disa herë duke njohur disa botime të mëvona, si në gjuhën shqipe ashtu dhe në atë latine. Sipas disa dokumenteve që përmend Malaj, arkipeshkvi i Tivarit ka kërkuar një herë 200 kopje në gjuhën shqipe dhe 150 në gjuhën latine dhe një herë tjetër 200 kopje në gjuhën latine, 200 në gjuhën shqipe. Dokumentet përmendin një kërkesë për librat shqiptarë si dhe studentët e Shën Pjetrit në Montorio dhe të Shën Bonaventurës në Isola të Romës.<sup>5</sup>

Botimet shqip në shekullin XVIII vijojnë me veprën e Françesko da Leçes “*Vëzhgime gramatikore për gjuhën shqipe*”(1716) dhe katekizmin e përkthyer nga Gjon Nikollë Kazazi, “*Përmbledhje e shkurtër e doktrinës së krishterë*”, botuar në Romë 1743. Vitit 1746 i përkasin Pesë letra shqip të Jozef Skiroit, Arqipeshkëv i Durrësit dhe Vikar Apostolik i Himarës në Arbëri.

Ndoshta me të drejtë studiues të shumtë konsiderojnë veprën *Cuneus prophetarum* të Bogdanit, si vepra më e plotë e shqipes së shekullit XVII duke kontribuar ndjeshëm në konsolidimin dhe stabilizimin e shkrimit të shqipes. Për këtë arsye, me Bogdanin, studiuesit vendosin kufirin e ndarjes së historisë së shkrimit shqip. Sipas Rizës<sup>6</sup>, autorët më të vjetër dhe që ndihmuan në lëvrimin e shqipes janë: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Lekë Matrënga, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani, pra me vitin 1685.

<sup>4</sup> S. Mansaku, në “*Kuvendi i Arbënit*” në historinë kulturore e gjubësore shqiptare, Kuvendi i Arbënit 300-vjetori, Lezhë, 2007, f.106, tekstin e Kuvendit të Arbënit e sheh si një hallkë të rëndësishme të historisë kulturore dhe gjuhësore që lidh fundin e mesjetës shqiptare me fillimet e Rilindjes Kombëtare. I të njëjtit mendim duket se është dhe studiuesi K.Topalli, i cili e konsideron këtë tekst si urë lidhëse ndërmjet shqipes së vjetër dhe së re. Sh. Demiraj<sup>4</sup> pohon, se përkthyesi i tekstit të Kuvendit është ndikuar shumë nga gjuha e shkrimtarëve të Veriut të shekullit XVII, si nga gjuha e Budit dhe veçanërisht nga ajo e Bogdanit. Për një ndikim të tillë të fuqishëm, sipas Demirajt, dëshmojnë përdorimi i të njëjtit alfabet, shenjimi i zanoreve të gjata me të njëjtën mënyrë, d.m.th me dyfishimin e shkronjave etj.

<sup>5</sup> Malaj, Vinçenc P: *Kuvendi i Arbënit, Concilio Nazionale Albanese del 1703*. Botimi i dytë. Ulqin -Tuz, 1999. Përkthim nga Tonin Zadeja, f. 155

<sup>6</sup> S.Riza, *Pesë autorët më të vjetër të shqipes*, Tiranë 1966



Sipas R.Ismajlit<sup>7</sup> ky kufi duhet të shtyhet duke përfshirë dhe veprat *Kuendi i Arbënit* (1706), *Osservazioni grammaticali della lingua albanese* e da Lecces (1716), Dorëshkrimi i Grottaferratës (1710), *Doktrina e Kërshtenë* e Gjon Kazazit (1743) dhe mbase edhe në botimin e dytë të Kuvendit të Arbënit (1868) të botuar nga Engjëll Radoja<sup>8</sup>. Më tej Ismajli vijon me arsyet që e çojnë atë në këtë përfundim. Sipas Ismajlit:

1. Shkrimi i shqipes ka kryesisht të njëtin funksion në të gjitha tekstet.
2. Alfabeti bazë, madje dhe plotësimet, në kod janë të njëjta në të gjitha këto tekste;
3. E gjithë kjo traditë zhvillohet në kontinuitet, prandaj dhe grafia e ortografia vjen gjithnjë duke u përsosur;
4. Gjuha e këtyre teksteve është kryesisht gegërishtja;
5. Këto tekste shërbenin ose në praktikën fetare, ose në mësimin e shqipes për këto qëllime;

Të gjithë këta autorë të vjetër i bashkonte formimi kulturor latin- italian, duke qenë se shumica qenë priftërinj dhe kishin studiuar në Itali. Në themel të veprave të tyre qëndron alfabeti latin mbështetur në grafinë italiane dhe një numër i konsiderueshëm të fjalëve me burim latin e italian, sidomos të natyrës fetare. Por, ajo që është më e rëndësishmja dhe që i bashkon është fakti se tekstet e vjetra, nuk i shërbejnë vetëm historisë së gjuhës, por mbi të gjitha historisë së popullit shqiptar. Disa studiues, duke paraqitur versionin e tyre ideologjik mendojnë se gjuha dhe kultura shqipe do të kishte humbur nëse nuk do të ishte lëvruar gjatë shekujve XVI-XVII, nga autorët e vjetër të Veriut.

Për fat të keq, veprimtaria e Kishës katolike në Shqipëri nuk ishte e shtrirë kudo, megjithatë librat shqip dhe mësimi i shqipes vijoi vrullshëm falë interesimit të Klerit Katolik, dhe tek Arbëreshët e Italisë, të cilët hapën shkolla. Mjafton të përmendim Kolegjin Shën Adriano, në Shën Demetrio Corone, në Kalabri, duke luajtur rol në mësimin e shqipes si dhe në përhapjen e kulturës shqiptare. Figura të shquara të arbëreshëve të Italisë gjatë shekullit XVIII janë Jul Variboba (1724-1788), me veprën “Gjella e Shën Mërisë virgjër”, Nikollë Brankati, Nikollë Filia, Nikollë Keta, Nil Katalani, Teodor Kavalioti etj.

Si përfundim, mund të themi se gjithë veprat e letërsisë së shkruar, duke

---

<sup>7</sup> R.Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuendit të Arbënit* (1706), Prishtinë, 1985. f.73-74

<sup>8</sup> Bëhet fjalë për botimin e dytë të Kuvendit të Arbënit.

përrjashtuar prodhimin letrar të humanistëve, kishin përmbajtje të theksuar fetare, pasi e gjithë kjo letërsi u zhvillua në kohën kur kleri kishte në dorë zhvillimin e kulturës dhe të arsimit. Pavarësisht rrethanave jo të favorshme, mund të themi se Shqipëria, në shekujt XV – XVIII, njohu një shkallë të caktuar zhvillimi kulturor, dhe pse kryhej nën ndikimin e klerit.

### Shkollat e para në gjuhën shqipe u hapën nga klerikët katolikë

Njëkohësisht, një hap tjetër i ndërmarrë nga kleri në dobi të zhvillimit të kulturës shqiptare, ishte dhe hapja e shkollave, ku për nevojat e predikimit, klerikëve të ardhshëm u mësohej dhe gjuha shqipe. Shkolla e parë shqiptare është themeluar më 1584 nga klerikë katolikë në Stubllë (afër Gjilanit- fshat i Malësisë së Karadakut) i njohur si Kolegji i Shën Lukës në Kosovë. Një shkollë e tillë u ngrit në Kurbinit të Krujës me kërkesë të një prelati të asaj kohe, Gjon Koleshi, i cili kur ishte në Romë në 1625, u shkruante eprorëve të tij se do të duhej të ngrihej një shkollë në Shqipëri, që të mësonin shkrim e këndim. Pas shumë mundimesh e pengesash shkolla shqipe e Kurbinit u hap në vitin 1632 nga Gjon Koleshi.

Rrethit të Lezhës i përkasin dy nga shkollat e para të shqipes. Në çerekun e dytë të shekullit XVII erdhi në Shqipëri një ekip misionarësh françeskanë që ngriti në 1638 në fshatin Pedhanë, afër lumit Mat, një shkollë fillore për fëmijë nga 8-10 vjeç. Një vit më vonë në Blinisht, Zadrimë, nga priftërinjtë e Troshanit u ngrit një shkollë e mesme “*gymnasium*” ku mësonin rreth 50 nxënës. Mësimet zhvilloheshin në gjuhën e vendit (*vernacula lingua*). Për këto shkolla flitet dhe në aktet e Kuvendit të Arbënit, të botuara në 1706 në Romë në një tekst të vetëm, ku ai u rekomandohet shkollave të Kurbinit e të Lezhës, sigurisht edhe për mësimin e latinishtes me anë të shqipes. Në vitin 1698 At Filip Shkodra hap shkollë në familjen Kamsi, në Shkoder. Në vitin 1622 u krijua institucioni “De Propaganda Fide” në Romë. Për përgatitjen e klerikëve shqiptarë u ngritën kolegje si ai i Fermos (1633), shkolla e Montorinos në Romë etj. Fat i madh për kombin dhe kulturën shqiptare që dhe ardhja në krye të Kishës Katolike e Papë Klementi XI, origjina e të cilit ishte nga një familje e njohur në Itali, - familja e Albanëve, me origjinë shqiptare.<sup>9</sup> Nuk është e rastit që pikërisht gjatë kësaj kohe, papa themelon Kolegjin Arbëresh në Shën Demetrio Korone të Kalabrisë, hap katedrën e gjuhës shqipe në kuvendin e Shën Bartolomeut në Romë, ku ka dhënë mësim Françesko Maria da Leçe, autori i gramatikës së parë shqipe, vë

<sup>9</sup> Për më shumë mbi origjinën dhe veprimtarinë e papës Klementi XI shih Vincenz Malaj, vep.cit. f. 41-43. Një tjetër libër me rëndësi, me të dhëna të rëndësishme, rreth Papës dhe Kuvendit të Arbënit, është dhe ai i Engjëll Sedajt, *Papa Shqiptar Klementi XI – Albani dhe Kuvendi i Arbënit*. Prishtinë. 1988.

kontakte të ngushta me Gjergj Guxetën, arbëreshin e njohur siçilian të kohës dhe themeluesin e kolegjit arbëresh të Palermos.<sup>10</sup>

### **Kontribut drejt marrëdhënieve të mira dhe mirëkuptimit midis shqiptarëve.**

Për vlera kombëtare të rëndësishme të veprimtarisë së klerit katolik dëshmojnë dhe marrëdhëniet e e tij me popullsinë vendase. Kleri katolik gjithmonë ka ndihmuar dhe është treguar e kujdesshme në realizimin e bashkëpunimit dhe bashkimit të shqiptarëve, veçanërisht në marrëdhëniet e katolikëve me shqiptarët myslimanë. Harmonia dhe bashkëjetesa mes shqiptarësh qofshin me besime të ndryshme, gjë që karakterizon dhe sot e kësaj dite popullin shqiptar, ka ekzistuar dhe atëherë, duke u shndërruar në faktor stabiliteti në vend. Sipas kryepeshkopit të Arbnit, Mark Skura<sup>11</sup> “*Skizmatikët grekë...janë më kundërshtarë të katolikëve se sa myslimanët*”, ata shiheshin si armiq dhe veprimtaria e klerit katolik nuk përputhej me politikat asimiluese të klerit ortodoks. Apo siç shkruan dhe misionari Italian Kerubino në 1638: “shqiptarët festojnë me njëri-tjetrin ndër morte, ndër kremtime dhe kur bëjnë dasma”<sup>12</sup>

Vizitorët apostolikë, peshkopët, misionarët si njohës të thellë të jetës së popullit shqiptar, zakoneve, mënyrën e jetesës apo të veshjes, besimit të tyre, veseve apo dhe vyrtyteve të tij dinin t’i përshtateshin realitetit shqiptar. Historiani Kasem Biçoku<sup>13</sup> shkruan: “Klerikët katolikë treguan tolerancë ndaj rasteve të formimit të familjeve me anëtarë të besimeve të ndryshme, kur besimtarët ndërthurnin ritet kishtarë me ritet e vjetra pagane. Por jo vetëm kaq. Ka pasur gjithashtu raste kur klerikët kanë banuar në shtëpitë e myslimanëve shqiptarë, kur myslimanët kanë ndihmuar materialisht Kishën Katolike si dhe kur të krishterët kanë ndihmuar materialisht për ngritjen e monumenteve të kultit islamik. Marrëdhënie të mira ka pasur dhe ndërmjet drejtuesve vendorë shqiptarë dhe të krishterëve, të cilët gëzonin më shumë të drejta. Një shembull i mirë në këtë rast është Vinçenc Zmajeviç, prifti dhe intelektual kroat që drejtoi punimet e Kuvendit të Arbënit, ngjarjes më të shënuar në historinë kishtarë. Si njohës i mirë i realitetit shqiptar ky ka ndihmuar në zgjidhjen

---

<sup>11</sup> I.Zamputi, *Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëllimi I, f. 235.

<sup>12</sup> I.Zamputi, *vep.cit.*, II, f. 107.

<sup>13</sup> K.Biçoku, *Fryma shqiptare e kishës katolike*, Kuvendi i Arbënit-300 vjetori. Përmbledhje e kumtesave të mbajtura me rsatin e 300 vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të arbënit, ngjarje me rëndësi në historinë kishtarë të Kishës Katolike Lezhë, 2007, f. 44, 46

e konflikteve dhe problemeve të shumta të kohës.<sup>14</sup>

Me të drejtë Ismajli shkruan<sup>15</sup>: “Kleri shqiptar, sado i paktë në numër që ishte dhe sado i pashkolluar që ishte, nuk e ndante funksionin dhe detyrën e tij si prift nga detyrimet e tjera sociale e kombëtare të popullit, po përkundrazi, të gjithë veprimtarinë e tij e përshtkont eme elemente të tilla. Ai do të merrej në radhë të parë me çështje sociale e ideologjike të drejtuara nga nevojat dhe interes e popullsisë së vendit.” Binomi “fe dhe atdhë” që në themel të gjithë veprimtarisë së klerit shqiptar. Atdhetarizmi dëshmohet qartë në përpjekjet për lëvrimin e gjuhës shqipe, botimin e teksteve në këtë gjuhë duke krijuar traditën e shkrimit, e cila do të ndiqej dhe nga autorë të mëvonshëm, në ndihmesën e dhënë për zhvillimin e kulturës dhe arsimit në Shqipëri, në mbrojtjen e traditave të popullit shqiptar. Të gjitha këto vlera i njihen klerikëve shqiptarë të kohës, veprimtaria dhe kontributi i të cilëve duhet vlerësuar maksimalisht, duke nxjerrë në dritë studime e dokumente të reja.

### **Bibliografia:**

1. Buzuku, Gjon: *Meshari i I. II* Tiranë, 1968
2. Çabej, Eqrem: *Studime gjubësore III,IV,VI*, Prishtinë, 1976. 1977.
3. Fida, Artan: *Rreth gramatikës së F. Maria Da Leçes*, Studime albanologjike, 2000/1.
4. Historia e letërsisë shqiptare, I, 1959
5. Historia e letërsisë shqiptare, I, 1971
6. Historia e letërsisë shqiptare, 1983
7. Ismajli, Rexhep: *Gjuba shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë, 1985.
8. *Kuvendi i Arbënit 1703*. Prishtinë 2004 (Përmbledhje të kumtesave të konferencës së Mynihut, 2003
9. *Kuvendi i Arbënit 300 – vjetori*, Lezhë, 2007 (Përmbledhje të kumtesave në Lezhë, 2003).
10. Malaj, Vinçenc P: *Kuvendi i Arbënit, Concilio Nazionale Albanese del 1703*. Botimi i dytë, Ulqin -Tuz, 1999. Përkthim i Tonin Zadesë.
11. Selman Riza: *Pesë autorët më të vjetër të gjubës shqipe*, Tiranë, 1966
12. Sedaj. Engjëll: *Papa Shqiptar Klementi XI –Albani dhe Kuvend i Arbënit*. Prishtinë, 1988

---

<sup>14</sup> Për më shumë mbi jetën dhe veprimtarinë e tij në Shqipëri, shih Rexhep Ismajli, vep.cit. dhe V. Malaj, vep.cit.

<sup>15</sup> Vep. cit. f.25

13. Zamputi, Injac: *Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike shoqërore e politike të vendit tonë në shekullin e XVII –të*, BUSHSH, Tiranë, 1957, nr.1  
*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII, vëllimi I.*



**Sadije REXHEPI**

## **GJUHA NË SHËRBIM TË IDEOLOGJISË**

Gjuha e çdo populli luan rol vendimtar në emancipimin e tij arsimor, edukativ, kulturor, shkencor dhe në përgjithësi civilizues. Gjuha mund të konceptohet si mjet komunikimi i shoqërisë për të shkëmbyer informata të ndryshme, të cilat i transmeton shoqëria. Krijimi i një strukture shoqërore, i një jete të përbashkët shoqërore nuk është e mundur pa gjuhë. Sipas Schmidt-it (1972: 91) vetëm në bazë të informacionit, komunikimit dhe veprimit intersubjektiv mund të lindin dhe të përkrahen struktura shoqërore rekurrente, përkohësisht të qëndrueshme dhe refleksive.<sup>1</sup> Gjuha dhe shoqëria e kushtëzojnë njëra tjetrën. Ato gjithnjë na shfaqen në një simbiozë. Gjuha është në shërbim të ideologjisë, si mjet për realizimin e misionit të saj. Sipas van Dijk (1998) gjuha është e lidhur ngushtë me bindjet, idetë dhe ideologjitë. Ideologjia është tërësi e ideve, pikëpamjeve, bindjeve shoqërore, në bazë të të cilave njerëzit i përcaktojnë besimet dhe veprimet e tyre. Ideologjia si ide, si teori është harku politik, program veprues i shtresës udhëheqëse të një shoqërie. E tërë veprimtaria politike qoftë ajo e rrëfim-referimit, e vendimmarrjes ose e dialogimit shprehet përmes gjuhës. Gjuha nuk është statike, ajo nuk duhet të shihet si një tërësi e pandryshueshme, por si një pjesë përbërëse e një realiteti komunikues gjuhësor, e cila i përshtatet gjendjes aktuale të një shoqërie, e cila ndryshon së bashku me zhvillimin e shoqërisë.

Shtrohet pyetja se si bëhet gjuha e ideologjizuar. Gjuha shërben për komunikim dhe është instrument i grupeve të caktuara për të përhapur ideologjitë e tyre. Grupet shoqërore janë grupe të cilat e kanë *ndjenjën ne* dhe *të tjerët*, me të cilat shënohen bazat për emocionalitet të përbashkët. Grupet e caktuara komunikojnë me pjesëtarët e grupit me gjuhën, me të cilën i diferencen të tjerët që nuk bëjnë pjesë në atë grup. Kjo e bën gjuhën gjuhë ideologjike. Me gjuhë automatikisht barten normat shoqërore të një shoqërie, individit pa e vërejtur i merr idetë e një shoqërie dhe i futë në njohuritë e tij të përgjithshme. Këtë e thekson Van Dijk (1998), sipas të cilit pavarësisht se a janë të vetëdijshëm dhe a dijnë për ideologji, te disa individë më shumë e disa më pak,

---

<sup>1</sup> Krh. Schmidt, S.J. 1972, 91 f, cit. në Erich Straßner, *Ideologie - SPRACHE - Politik. Grundfragen ihres Zusammenhangs*, Tübingen, 1987, 16

ideologjia e caktuar ekziston.

Gjuha është një instrument për ushtrimin e pushtetit. Kjo bëhet përmes normave të parashtruara që ofrohen si modele të sjelljes. (Straßner 1997: 20) Në këtë mënyrë çdo grup i shoqërisë ndërton një përdorim specifik të gjuhës, sepse në mënyrë të veçantë barten norma të ndryshme për gjëra të njëjta. Kështu, gjuha jo vetëm që ndihmon zhvillimin e një shoqërie me normat dhe rregullat e saj, por ajo mbështetet dhe shpërndanë në të njëjtën kohë këto standarde.

Çdo njohuri dhe përvojë është e varur nga gjuha, sepse gjuha është mjete me të cilën ne e shprehim mendimin tonë për botën. Njerëzit në komunikim të ndërsjellë mund të shkëmbejnë njohuri në botë vetëm me ndihmën e mjeteve gjuhësore, kështu që gjuha e bën realitetin rreth së cilës ne kuptohemi. Por, shpesh bëhet pyetja se a ekziston lidhja e ideologjisë me "të vërtetën". Gjuha ndonjëherë nuk ndikohet dhe nuk ndryshon vetëm nga e vërteta, por ajo shpesh bëhet vetë fuqi për ndryshimin e së vërtetës. Ideologjia përkufizohet edhe si "vetëdije e gabuar", që e mbulon apo e fsheh të vërtetën. Në këtë kuptim koncepti ideologji ka kuptim negativ, por nuk është e thënë që ideologjitë të jenë patjetër negative, por sistemeve politike që do t'u referohem këtu iu mbizotëron një ideologji negative, sunduese. Gjuha është e lidhur edhe me njohuritë paraprake. Pa njohuri të përgjithshme nuk mund të dijmë për një çështje se a është e vërtetë apo jo. Pra, gjuha është ajo që na tregon vërtetësinë apo jo për një çështje, sepse ajo është e lidhur me njohuritë e mëparshme, pikëpamjet kulturore, pritjet.

Linguisti Paul Kroskrity (2010, 2005) thekson që ideologjitë nga një temë marginale bëhen tema kryesore. Brenda gjuhësisë së aplikuar Kroskrity (2005: 4)<sup>2</sup> insiston që ideologjitë duhet të shihen gjithmonë si të shumfishta, në të cilat veprojnë njëkohësisht dimensione të ndryshme. Për të shtjelluar këto dimensione ai propozon katër rrafshe që e mbulojnë njëra tjetrën:

1. Ideologjitë gjuhësore paraqesin pikëpamje mbi gjuhën dhe diskursin, të cilat janë të konstruara në interes të një grupi të caktuar shoqëror ose kulturor. Çka duket brenda një grupi të jetë e vërtetë, moralisht e drejtë, estetike, shpesh është e lidhur me interesat politike-ekonomike. Gjuha shërben si fushë, mbi të cilën ndiqen, mbrohen dhe legjitimohen vlerat dhe interesat.
2. Ideologjitë gjuhësore mund të konceptohen si të shumfishta, sepse edhe brenda një grupi sociokulturor pjesëtarë të ndryshëm shoqërorë, si klasë, gjini, ose elita mund të sjellin pespektiva të ndryshme mbi gjuhën, të cilat shpesh bëhen indikatorë për pjesmarrësit e grupit.

<sup>2</sup> Kroskrity, Paul (2005:4) cit. në Busch, Brigitta: Mehrsprachigkeit. (2013: 84), Wien



3. Deri në cilën shkallë ideologjitë gjuhësore janë të qarta varet në njërën anë nga secili pjesëtar i grupit, në anën tjetër varet nga vendi, në të cilën prodhohen dhe komentohen ideologjitë. Sa më e diskutueshme të jetë ideologjia gjuhësore, aq më shumë hyn në vetëdije, ndërsa të tillat, të cilat në masë të madhe janë të padiskutueshme, “neutrale” dhe dominuese, vijnë në shprehje para së gjithash në praktikatat e brendshme gjuhësore. Më shumë se sa në hapësirat familjare, ku ideologjitë gjuhësore prodhohen si implicite, në institucione si gjykata ose shkolla, ku gjuha bëhet mjet i sjelljes, këto hyjnë në vetëdije jo vetëm në mënyrë implicite, por pa u vërejtur edhe në atë eksplicite. (krh. po aty cit. f. 85)
4. Ideologjitë gjuhësore ndërmjetësojnë në mes të strukturave shoqërore dhe mënyrës së të folurit. Me ndihmën e ideologjive folësit i lidhin përvojat e tyre sociokulturore me resurset e gjuhës dhe të diskursit për të kuptuar dhe përmbushur lidhjet shoqërore, duke prodhuar një udhëzues indeksikal (deiktik) në mes të formave të caktuara dhe llojeve të caktuara të përdorimit të gjuhës. (po aty f. 86).

Pra, këto janë disa dimensione që ka një gjuhë e ideologjizuar.

Gjuhën ideologjike e gjejmë në mënyrë të theksuar në **botën politike**, ngase gjuha shpie në strategjitë politike dhe ky edhe është objekti i një ideologjie; për të përhapur idetë e tyre në shoqëri, për ushtrimin e pushtetit. Në veçanti në të gjitha sistemet shoqërore, të kaluara dhe të tashme gjuha është në shërbim të shtresave sunduese. Ku vjen në lojë fuqia, ideologjia i cakton rregullat e lojës. Gjuha është për këtë instrumenti kryesor.

Ideologjitë më ekstreme të shek. XX siç ishte ideologjia fashiste italiane e udhëhequr nga Musolini, e cila propagandonte madhështinë e popullit italian dhe të drejtën e tij për pushimin e territoreve dhe popujve përreth e më gjerë, ideologjia e nacionalsocializmit gjerman e udhëhequr nga Hitleri, e cila frymëzimin e kishte në madhështinë dhe fuqinë e popullit gjerman dhe në idetë Niçiane që më i fuqishmi duhet të triumfojë, por edhe në teorinë e Darvinit mbi seleksionimin natyror dhe shumë intelektualëve e filozofëve gjerman si Gëte, Hegeli, etj. që propagandonin nevojën e kthimit të namit e të madhështisë së racës ariane, pastaj ajo e komunizmit sovjetik e prirë nga Lenini e Stalini, e cila propagandonte diktaturën e proletariatit, e cila rrëshqiste gjithnjë e më tepër në diktaturë ndaj proletariatit, dhe së fundi ideologjia fashizoide e nacionalizmit serb e udhëhequr nga Millosheviqi, i cili vendin e shndërroi në arenë konfliktesh ndërnacionale, ku Serbia hartoi programin e saj me një gjuhë të sofistikuar të ideologjisë nacionalshoveniste, e përdornin gjuhën ideologjike për të arritur qëllimet e tyre. Në Shqipërinë komuniste ishte ndërtuar një sistem piramide i komanduar nga lartë, që në mënyrë strikte e kontrollonte jetën shoqërore që

obligativisht duhet të funksiononte në frymën e ideologjisë. Nuk lejohej asnjë liri e mendimit ndryshe. Të gjitha fushat e jetës ishin vënë nën kontrollin ideologjik. Mendimet ndryshe denoheshin në mënyrë drakonike dhe ato u bënë tabu. Kjo i bllokoi të gjitha forcat krijuese dhe Shqipëria mbeti oaza më e pazhvilluar e Evropës gjatë kohës së socializmit dogmatik. Të gjitha këto sisteme armën më të fuqishme për fuqizimin e pushtetit të tyre e kishin gjuhën e ideologjizuar, gjuhën e manipulimit kolektiv të masave. Duke prezantuar parajsën, ato popujve iu dhuruan ferrin. E arrinin këtë përmes një sistemi të sofistikuar informativ duke përjashtuar çdo mendim e ide ndryshe, me qëllim që individi si subjekt të shndërrohet në objekt manipulimi kolektiv.

Drejtperdrejtë në përhapjen e gjuhës ideologjike ndikojnë **mediat**, në të cilat gjejmë një përdorim shumë të madh të saj. Me ndryshimet në botën politike, ideologjike, por edhe ekonomike në shoqëri futen në përdorim edhe fjalë apo shprehje të reja ideologjike, pra paraqiten ndryshime në leksik. Këto shprehje ideologjike mund të përdoren në një periudhë të caktuar, sidomos në media, aq shumë, sa që sapo ta ndëgjojmë një shprehje të tillë, menjëherë i referohemi një periudhe të caktuar qoftë politike apo ekonomike. Por, jo vetëm që mund të paraqiten fjalë apo shprehje ideologjike, por në një periudhë të caktuar në gjuhë mund të paraqiten edhe ndryshime stilistike. Këto ndryshime më së shumti dalin nga diskutet e strukturës superiore dhe me përsëritjen e tyre, ato gjejnë një përdorim më të gjerë jo vetëm në media, por edhe në literaturë në përgjithësi. Pra, ideologjia është e lidhur ngushtë me një grup shoqëror, me kohën dhe me vendin ku përdoret ajo dhe mënyra më e lehtë për përhapjen e saj në masë janë mediat, p.sh. me *Murin e Berlinit* menjëherë i referohemi kohës kur ka qenë muri, i referohemi vendit, por edhe sistemit politik në atë vend dhe në atë kohë. Njësoj është edhe nëse ndëgjojmë diç për një person të caktuar, si p.sh. për *kohën e Enverit* apo *shaxhit Enver*, apo për *kohën e Hitlerit*.

Nëse bëhet një analizë e diskursit të gjuhës politike Ekkehard (2010) paraqet tri grupe shprehjesh ideologjike. Paraqiten pothuaj të njëjtat shprehje, pra janë fjalët kyqe që përdoren në ato diskurse, si p.sh. *qëndrueshmëria, stabiliteti*, etj.

Fjalët udhëheqëse (prijëse) janë shprehje me karakter integrues dhe me efekt propagandues, të cilat përdoren nga vepruesit politik për të fituar mundësisht sa më shumë ithtarë për çështje, ide ose qëndrime të vlerësuara pozitive, si p.sh. *liri, të ardhme të sigurtë, barazji shoqërore*, etj.

Në anën tjetër përdoren edhe shprehje stigmatizuese për të ulur pikëpamjet dhe veprimtaritë politike të të tjerëve përmes emërtimeve pejorative dhe për të ngritur grupin e vet politik. (po aty) Me këto shprehje që përdoren në diskutin e tyre, mundohen ta bindin opinionin se pala tjetër që nuk bën pjesë në grupin e tyre ka një qëllim negativ, si p.sh. *politika në kurriz të të dobët*. Kjo e mbështetë faktin që në fushën e diskutit gjuha e ideologjizuar ka shprehje të veçanta dominuese pozitive, por edhe

stigmatizuese, të cilat kanë karakter integrues dhe propagandues.

Gjuhën ideologjike mund ta gjejmë edhe në **fjalorë** të ndryshëm, p.sh. raste ekstreme kemi gjatë nacionalsocializmit në Gjermani, ku në vitin 1933 dolën shumë fjalorë siç ishin “Das ABC des Nationalsozialismus” apo “Politisches ABC des neuen Reiches”. Edhe në fjalorin Stilduden<sup>3</sup> të vitit 1934 ose 1938 mund të gjinden shumë shembuj të nacinalsocializmit, përmes të cilit bëhej propagandë, p.sh. po ta kërkojmë fjalën *takim* gjejmë spjegimin *një takim Hitlerian* - "Treffen - ein T. der Hitlerjugend" (545), ose nëse kërkojmë fjalën *këmishë* ndër të tjera gjejmë *këmisha ngjyrë kafe e nacinalsocialistëve* - "Hemd - das braune Hemd der Nationalsozialisten" (234), nëse kërkojmë fjalën *e kaftë* gjejmë *këmisha e kaftë është veshja ushtarake e nacinalsocialistëve* - "braun - das braune Hemd ist das Ehrenkleid der Nationalsozialisten" (234), apo te *lidh (vermählen)* gjejmë fjalinë *Nacionalsocializmi e lidh nacionalizmin dhe socializmin* - "vermählen - der Nationalsozialismus hat Nationalismus und Sozialismus miteinander vermählt" (596). Fjala *ndëgjoj* shpjegohet ndër të tjera me shembullin *nga brohoritjet e kuptoj që Führer-i ka ardhur* – “hören - aus dem Jubel höre ich, daß der Führer eingetroffen ist" (248), apo te fjala *festoj* gjejmë *Führer-i u festua furishëm* - "feiern - der Führer wurde stürmisch gefeiert" (161), ndërsa në fjalorin e vitit 1956 kjo fjalë u zhvesh nga nacizmi ose u literarizua në: *poeti u festua furishëm* - "der Dichter wurde stürmisch gefeiert". (shih Kohlmayer, 2014: 4) Nacizmi shihet edhe te shjegimi i fjalës *i huaj*, i cili në Stilduden është *identifikoj dikë si të huaj të bezdisshëm* - "Ausländer" lautet: "jemand als lästigen Ausländer ausweisen" (57).

Në fjalor, si element ideologjik është edhe urdhërorja, si p.sh. te folja *gedenken (mbaj mend, kujtohu)* gjejmë thirrje në formën *mbaj mend që je gjerman*” - "gedenken - Gedenke, daß du ein Deutscher bist!" (188).

Si indentifikues të solidaritetit janë edhe shembujt me *ne* dhe *nderoj*, si *Führer-i ynë i nderuar* - "verehren - unser verehrter Führer" (586). (po aty f. 5).

Edhe në gjuhën shqipe në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 të akademisë së shkencave të RSP të Shqipërisë kemi po ashtu shpjegime të fjalëve me ngjyrimë ideologjike, p.sh. nëse kërkojmë fjalën *urdhër* përveç tjerash gjejmë edhe shpjegimet si *Urdhri “Ylli Partizan”*. *Urdhri “Për mbrojtjen e Atdheut Socialist”*. *Urdhri “Flamuri i Kuq i Punës”* (f. 2091). Te fjala *prijës/e-ja* kemi shembullin *prijësja jonë – Partia e Punës*. (f. 1546). Te fjala *parti* vetëm shënohen shkurt shembujt si *Parti politike*. *Parti borgjeze*. *Parti demokratike (konservatore, republikane)*. *Parti fashiste*. *Parti revizioniste* (1372),

<sup>3</sup> *Der Große Duden. Stilwörterbuch der deutschen Sprache. Eine Sammlung der richtigen und der gebräuchlichen Ausdrücke und Redewendungen*, bearbeitet in den Fachschriftleitungen des Bibliographischen Instituts unter Mitwirkung von Dr. Otto Basler. Bibliographisches Institut AG.: Leipzig 1934.

*Der Große Duden. Stilwörterbuch der deutschen Sprache.* (...) 2.,3., verbesserte Auflage. Leipzig 1938.

ndërsa për partinë komuniste jepen me dhjetëra rreshta sqarime. Apo fjala *punëtor*, -i në një rën anë ka këtë shpjegim: 1. *në shoqërinë socialiste: ai që bën vazhdimisht punë drejtpërdrejt në prodhim (në industri, në ndërtim, në transport, në shpërndarje e në shërbime të ndryshme, ku përdoret fuqia e krabut dhe prona i përket gjithë popullit) dhe është pjesëtarë i klasës punëtore, e cila përbën forcën udhëheqëse të diktaturës së proletariatit shqiptarë.* Ndërsa në anën tjetër 2. *Në vendet kapitaliste e revizioniste: ai që punon me mëditje dhe shfrytëzohet e shtypet nga borgjezia, ai që është i zhveshur nga pronësia mbi mjetet e prodhimit dhe që nuk zotëron asgjë tjetër veç fuqisë së tij të krabut, të cilën është i detyruar t'ia shes kapitalistit për të siguruar mjetet e jetesës; proletar. p.sh. punëtor me mëditje. Grevat e punëtorëve. Pronari pushoi punëtorët nga puna. (f. 1517).* Për fjalën *shok* përveç tjerash kemi edhe shpjegimin ideologjik: *Anëtar i Partisë së Punës së Shqipërisë, anëtar i organizatave të masave në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, anëtar i një partie a i një organizate marksiste-leniniste; pjesëtar i një kolektivi punonjës në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë a shtetas i saj;[...] fjalë që përdorim përpara emrave të përgjithshëm a të veçantë të punonjësve, kur flasim zyrtarisht për ta. Shoku Enver. [...] Shokët e partive komuniste-leniniste. Shoku oficer! Shoku ushtar! (f. 1883).* Po ashtu te fjala *xhaxha* gjejmë ndër të tjera edhe shembullin *Xhaxhi Enver*. (f. 2197)

Këtu shihet që edhe në sqarimin e fjalëve të thjeshta, të rastësishme, pa kërkuar me qëllim fjalë me predispozita ideologjike, kemi shpjegime me elemente ideologjike, dhe pasi fjalori me shpjegimet e tij është një pasqyrë e kodifikimit të një gjuhe mund të ketë ndikim të madh në shoqëri.

Edhe në **literaturë shkollore e universitare** mund të gjejmë shumë shembuj të përdorimit të gjuhës ideologjike. Si shembull mund të marrim sitemin komunist në Shqipëri, ku gjatë asaj kohe janë ndërruar edhe planprogramet dhe metodat e mësimin dhe kanë bërë shumë që të përhapet sa më shumë ideologjia e tyre komuniste edhe ndër nxënës e studentë, por edhe sot gjatë shpjegimit të historisë së asaj kohe hasim në shprehje apo fjalë ideologjike që i përshtateshin atij sistemi. Për ilustrim këtu mirret libri i historisë së klasës së 10-të, në të cilën përshkruhen edhe ideologjitë marksiste-leniniste të Bashkimit sovjetik, ideologjitë nacionalsocialiste të Hitlerit, por edhe ideologjitë komuniste të Enver Hoxhës. Nëse ndalemi pak te përdorimi i gjuhës ideologjike gjatë përshkrimit të sistemit komunist në Shqipëri, hasim në shprehjet si p.sh. *masat për shpronësimin e qytetarëve vendas dhe kthimit të mjeteve të prodhimit në pronë shtetërore socialiste.* Në vitet 1945-46 u zbatua *reforma agrare*. Formalisht toka iu dha fshatarëve me tapi, por vetëm në përdorim, sepse pronari i vërtetë i saj *ishte shteti*. (f. 185) Për zhvillimin e fshatit u ndoq modeli sovjetik i *kolkhozëve* (kooperativa kolektive). *Kooperativat bujqësore* u krijuan përmes *kolektivizmit të ekonomisë private*. Kolektivizmi në buqësi çoi në likuidimin e pronës private në fshat dhe vendosjen e marrëdhënieve të *ekonomisë së centralizuar socialiste*.

Këtu theksohet po ashtu që botimi i teksteve për studime univesitare, si

“Historia e Shqipërisë” dhe “Historia e letërsisë shqipe” ishin përpjekja e parë për të dhënë në bazë *metodologjinë marksiste-leniniste*, një paraqitje të historisë politike, shoqërore e kulturore të vendit. (f. 187) Në vitet e 60-ta ishte arritur mjaft mirë në fushën e arsimit, por sipas udhëheqjes së PPSH shkolla ende nuk i kryente si duhet funksionet e saj edukative në kuptimin e formimit të nxënësve me ideologjinë socialiste. Ishte kjo arsyeja që në Kongresin e saj të Pestë (1966), krahas të tjerash, u dha orientimi për “*revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës*”. Në këtë kuadër u shpall luftë dhe konsiderohen të *vjetruara e konservatore shumë nga metodat dhe format pedagogjike të shkollës së mëparshme*. Gjithashtu u rishikuan dokumentacionet shkollore, programet dhe tekstat, me synim spastrimin e tyre nga pikëpamjet e huaja *për ideologjinë marksiste-leniniste*. (f. 187) Sipas kësaj reforme, në shkollë do t’i jepej përparësi anës ideologjike, “formimit dhe edukimit të gjithanshëm ideologjik e politik të nxënësve, studentëve dhe gjithë punonjësve që mësonin në shkollë”. Përveç kësaj, në programet shkollore u futën edhe *puna prodhuese dhe edukimi ushtarak*. Në këtë mënyrë, rritej vëllimi i lëndëve politike dhe formimit ideologjik e ushtarak në dëm të njohurive nga shkencat e tjera. (f.188)

Në këtë kohë edhe letërsia dhe artet duhej të përshkoheshin krejtësisht nga ideologjia marksiste-leniniste dhe “*nga një frymë e shëndosbë kombëtare*.” (f. 189) Shprehja “*shfaqje të huaja moderniste*” përdorej për shumë vepra që hidheshin, sepse ato konsideroheshin si të pavlefshme për sistemin.

## Përfundime

Gjuha dhe ideologjia kanë marrëdhënie reciproke. Çdo njohuri dhe përvojë është e varur nga gjuha, sepse gjuha është mjeti me të cilën ne e shprehim mendimin tonë për botën. Njerëzit në komunikim të ndërsjellë mund të shkëmbejnë njohuri në botë vetëm me ndihmën e mjeteve gjuhësore, kështu që gjuha e bën realitetin rreth së cilës ne kuptohemi. Gjuha ideologjike ka një përdorim të gjerë dhe paraqiten forma të ndryshme, të cilat ndikojnë në përhapjen e saj. Në diskurs të çdo sistemi ideologjik gjejmë fjalët kyçe, shprehjet udhëheqëse dhe ato stigmatizuese, të cilat janë të dukshme, të cilat janë të konstruara në interes të një grupi të caktuar shoqëror ose kulturor, me të cilat edhe mund të identifikohet një grup i shoqërisë, një vend apo një sistem politik, p.sh. edhe për Gjermaninë edhe për Shqipërinë janë shprehjet e caktuara që janë ndëgjuar apo edhe pas shumë vitesh i ndëgjojmë dhe menjëherë i referohemi kohës së nacionalsocializmit, përkatësisht socializmit, pra, janë shprehje karakteristike për atë kohë, për atë vend dhe atë sistem politik.

Përveç veprave të ndryshme artistike, shkencore, letrare, shkollore, fjalorëve etj. rol të rëndësishëm në përhapjen e ideologjive politike luajnë edhe mediat, të cilat në

sisteme të ndryshme manipulative, siç ishin ato të shek. XX, të cilat u theksuan më lartë, ishin të cenzuruara dhe aty kritikuar nuk zinin vend, por shndërroheshin thjeshtë në tabu. Këtu roli i mediave nuk mund të ishte kritikues, por vetëm propagandues.

Krejt në fund mund të theksohet edhe një herë, që gjuha ideologjike, përmes mediave, veprave të ndryshme, fjalimeve propagandistike, institucioneve që e propagandojnë krijojnë gjuhën specifike në rrafshin e diskursit dhe atë e gjejmë në kohë të ndryshme, në vende të ndryshme, në shtresa të ndryshme të shoqërisë, por edhe në sisteme të ndryshme politike dhe kjo nuk është statike, por me ndryshimet në shoqëri ndryshon edhe ajo.

### **Bibliografia:**

1. Busch, Brigitta: Mehrsprachigkeit. Wien, 2013
2. Der Große Duden. Stilwörterbuch der deutschen Sprache. Eine Sammlung der richtigen und der gebräuchlichen Ausdrücke und Redewendungen, bearbeitet in den Fachschrifteleitungen des Bibliographischen Instituts unter Mitwirkung von Dr. Otto Basler. Bibliographisches Institut AG.: Leipzig 1934.
3. Der Große Duden. Stilwörterbuch der deutschen Sprache. (...) 2.,3., verbesserte Auflage. Leipzig 1938.
4. Der Große Duden. Band 2. Stilwörterbuch der deutschen Sprache. Vierte Auflage, neu bearbeitet von Paul Grebe und Gerhart Streitberg mit der Fachschrifteleitung des Bibliographischen Instituts. Mannheim 1956
5. Felder, Ekkehard: Ideologie und Sprache. Erschienen in: Online-Dossier zum Thema „Sprache und Politik“ der Bundeszentrale für politische Bildung. Online-Publikation:  
[http://www.bpb.de/themen/I6N3HM,0,Sprache\\_und\\_Politik.html](http://www.bpb.de/themen/I6N3HM,0,Sprache_und_Politik.html)
6. Felder, Ekkehard, Diskursanalyse von politischer Sprache:  
<http://www.bpb.de/politik/grundfragen/sprache-und-politik/42740/diskursanalyse?p=all>, publikuar më 15.10.2010
7. Haensel, Carl/ Strahl, Richard: Politisches ABC des neuen Reichs: Schlag- und Stichwörterbuch für den deutschen Volksgenossen, Engelhorn, Stuttgart 1933
8. Kohlmayer, Rainer: Ideologie im Wörterbuch: Kontinuitäten und Wandlungen im STILDUDEN von 1934 bis 1963, përpunuar më 26.06.2014 e publikuar online: [http://www.rainer-kohlmayer.de/downloads/files/ideo\\_wb.pdf](http://www.rainer-kohlmayer.de/downloads/files/ideo_wb.pdf)

9. Munishi, Shkumbin: Gjuha dhe ideologjia, Filologji 18, UP, Prishtinë 2011
10. Rosten, Curt: Das ABC des Nationalsozialismus, Schmidt, 1933
11. Rexhepi, Fehmi, Demaj, Frashër: Historia 10, Libri shkollor, Botimi I gjashtë I korrigjuar, Prishtinë 2013
12. Schmitz-Berning, Cornelia: Sprache und Sprachlenkung im Nationalsozialismus e publikuar nga Bundeszentrale für politische Bildung (bpb), Bonn 2010, e publikuar online:  
<http://www.bpb.de/politik/grundfragen/sprache-und-politik/42752/sprache-zur-ns-zeit?p=all>,
13. Straßner, Erich: Ideologie - SPRACHE - Politik. Grundfragen ihres Zusammenhangs. Tübingen, 1987
14. Van Dijk, Teun A.: Political discourse and ideology, e publikuar online:  
<http://englishdepartmentcocody.n.e.f.unblog.fr/files/2010/11/politicaldiscourseandideology.pdf>
15. Van Dijk, Teun A.: Ideology and discourse analysis, në Journal of Political Ideologies (2006), 11(2), 115-140 në internet:  
<http://www.discourses.org/OldArticles/Ideology%20and%20discourse%20analysis.pdf>
16. Van Dijk, Teun A.: Ideology: A multidisciplinary approach. London, England UK, Sage Publications, 1998





Zamira SHKRELI

## IDEOLOGJIZIMI NË TEKSTET E GJUHËS SHQIPE PARA VITEVE '90

Ashtu sikurse çdo institucion tjetër shtetëror i para viteve '90, edhe sistemi arsimor nuk i shpëtoi dot ideologjisë. Këtë e dëshmon edhe ky citat i shkëputur nga librat e atyre viteve:

*“Formimi i brezit të ri me botëkuptimin marksist-leninist revolucionar, me dashurinë e thellë për Partinë dhe shokun Enver Hoxha, me patriotizmin socialist dhe internacionalizmin proletar, me tiparet dhe vërtetet moralopolitike komuniste, përbëjnë një fushë të rëndësishme të vecantë në punën edukative të shkollës”<sup>1</sup>*

Nga rreshtat e mësipërm kuptojmë që edhe shkolla si çdo sferë tjetër e jetës në atë kohë ishte e veshur me ideologjizëm e nuk mund të shkëputej në asnjëfarë mënyre nga kjo e fundit.

Po me librat shkollorë çfarë ndodhte? Edhe ato nuk i kishin shpëtuar rrymës së kohës. Ishin veshur këmbë e krye me ideologjizëm.

Tekstet e gjuhës shqipe, për vetë qëllimin e tyre, si tekste të mirëfilltë që shërbejnë për formim gjuhësor, kanë pasqyruar ecurinë e zhvillimit e të pasurimit strukturor e funksional të shqipes gjithnjë në përshtatje me moshën.

Por periudha e para viteve '90 karakterizohet nga një dukuri e veçantë, imponimi ideologjik edhe përmes teksteve shkollore, sepse marrja e njohurive nuk konceptohej dot pa futjen e ideologjizmit. Prandaj, dhe ne u nxitëm nga ky fakt, për të shfletuar faqet e këtyre librave, duke marrë shkas edhe nga tema bosht e këtij seminari, që sot kujton ideologjizmin e atyre viteve të pasqyruar kudo, në shkollë shoqëri e çdo gjë që kishte të bënte me jetën.

Analiza që jemi munduar t'i bëjmë këtyre teksteve pas në periudhe të gjatë, të harruar në raftet e bibliotekave, të mbuluar nga pluhuri i kohës, do të mbështetet më tepër tek shembujt që transmetojnë ideologjizmin e asaj kohe, pa lënë mënjanë edhe pasqyrën e organizimit të këtyre të fundit. Autorët e këtyre teksteve që i përkasin vitit 1983 si ribotim i pestë nga botimi i parë i botimit, 1978 janë gjuhëtarët B. Beci dhe E. Hysa, T. Llogami, N. Sallaku, të cilët punuan nga klasa 2-4. Këto tekste janë

---

<sup>1</sup> Musa Kraja, “Probleme të forcimit të punës edukative në shkollë”, SHBLSH, Tiranë, 1981, f.5

ndërthurur mjaft bukur e kuptueshëm për moshën. Ata përmbajnë në programin e tyre gramatikë të ndërthurur me drejtshkrim, ku një pjesë të madhe tek gramatika e zë morfologjia, pra, përvetësimi i njohurive gramatikore, me rregulla e përkufizime, dhe me vërejtje drejtshkrimore, si kusht i domosdoshëm i mësimin të drejtshkrimit në klasat përkatëse. Gjatë këtyre viteve të para të shkollimit i kushtohet rëndësi të nxëniet e pjesëve të ligjëratës, e më pas preken disiplina të tjera të gjuhës që shtjellohen më pak.

Por, ajo që më tepër bie në sy, në tekstet e gjuhës që në arsimimin fillor të asaj kohe, ishte fryma ideologjike që hasej në thuajse çdo faqe të librit të gjuhës. Pra, fëmijët edukoheshin që herët me ideologjinë e Partisë në pushtet të atyre viteve. Tekstet e gjuhës përmbajnë pjesë të tilla, që tek nxënësit të mund të edukohet dashuria për Partinë, shokun Enver, atdheun. Gjithashtu ndeshim edhe fjalë e grupe fjalësh të përsëritura pothuajse në çdo faqe të librave të klasave 2-3-4, në copëza me njohuri nga natyra, vjersha, përralla, aktivitete të ndryshme të fëmijëve në përshtatje me moshën dhe aftësitë përceptuese të tyre, si: *klasën punëtore, fshatarsinë, vullnetarët, kooperativistët* etj.

Brumosja e fëmijëve e të rinjve, që përmbliidhej në atë periudhë me fjalën *brezi i ri*, me dashurinë për Partinë, shokun Enver, marksisëm-leninizmin ndeshet mjaft qartë edhe në libra të kohës, në të cilin theksohen fjalët e E. Hoxhës drejtuar këtij brezit në Kongresin e 7:

*“Roli edukues i shkollës për formimin e gjithanshëm komunist të brezit të ri, do të forcohet sa më shumë që rinia të përfshihen në luftën klasore për zhvillimin e revolucionit dhe për zgjidhjen e problemeve konkrete të ndërtimit socialist të vendit”<sup>2</sup>.*

Fokusi i kumtit tonë është një analizë e librit të **Gjuhës Shqipe 2**, për të kuptuar sesi transmetoheshin njohuri gjuhësore ndërthurur me ato idologjike. Tema e parë e librit lidhet me gramatikën fjalinë ku vendin kryesor, por pa lënë mënjanë edhe drejtshkrimin, *pika, pikëpyetja, përdorimi i shkronjës së madhe*, të gjitha këto të pasqyruara me dialogje të shkurtër të përshtatur për moshën dhe me përkufizimet përkatëse, për elementet gjuhësor të përmendura më lart. Gjithashtu teksti përmban ushtrimet përkatëse për gjithsecilin element gjuhësor, në mënyrë që të vegjëlit të dijnë të punojnë me shembujt e librit.

*Po si pasqyrohet ideologjizmi në këtë libër?* Pothuajse në çdo pjesë të re të libri hasen fjalë e shprehje që të bëjnë të mendosh, se pa to nuk mund të jetohej në këtë vend.

Mësimi 2 në libër, ka të bëjë me fjalët që tregojnë njerëz, kafshë e sende. Pjesëza e trajtuar në libër përmban fjalën *kooperativës* – fq.8 , fjalë aq e hapur dhe e

<sup>2</sup> Musa Kraja, “Probleme të forcimit të punës edukative në shkollë”, SHBLSH, Tiranë, 1981, f.5.

njohur për kohën.

Më pas ndeshim në një pjesë diktimi grupin e fjalëve po aq të përdorur në atë kohe - *stërvitje ushtarake*- f. 10. që konsiderohej si njohje e fëmijëve me fjalët që kanë mësuar gjatë përvetësimit të abetares.

Fjalë e shprehje të shkëputura nga ushtrime apo pjesë të librit mësimor të bëjnë të mendosh sesa e vështirë ka qenë puna e hartuesve, mësuesve por jo më pak edhe e nxënësve. - *Shpëtimi takohet me partizanët, yllin , partizanë, luftoj për liri, luftoj me guxim, luftoj kundër armikut. f.13*

Tek diktimi ndeshim : *Nxënësit punuan pa u lodhur arat e kooperativës-* f.19. Organizimi i orëve mësimore në lëndën e gjuhës shqipe ishte konceptuar në mënyrë të tillë që nxënësi të njihet me lëndën e re me konceptet e reja gjuhësore, ti vendoste ato në praktikë mbi bazën e ushtrimeve por të ushtrohej edhe me diktim, duke përfutur fjalë e shprehje të padëguara në mënyrë që të praktikonte edhe drejtshkrimin e fjalëve mbi bazën e rregullave që mëson.

Nxënësit njiheshin me pjesët e ligjëratës dhe kategoritë gramatikore të tyre si: Emri - emra njerëzish dhe qytetesh (që përcaktojnë emrat e përvetësimit që fëmijët do të ndeshin në temat e mëvonshme ) - duke u ndërthurur me drejtshkrimin, më pas kalonin tek kategoritë gramatikore gjinia dhe numri.

Organizimi i librit pasohej më tej me foljen dhe drejtshkrim e tyre që në klasën e dytë njihet vetëm me kohën, por autorët kishin menduar të bënin edhe lidhjen e emrit me foljen.

Mbiemri – gjinia dhe numri si kategori gramatikore dhe në fund të tekstit janë vendosur numërorët dhe drejtshkrimi i tyre. Ky ishte në mënyrë të përmbledhur organizimi i librit të klasës së dytë.

Përkufizimet që shoqërojnë çdo mësim të gramatikës dhe drejtshkrimi bëjnë që nxënësit të njihen me rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe, dhe të përfutur njohuritë gjuhësore të moshës.

Por, ajo që na intereson janë shembujt e përdorur në libër të cilët janë të shpeshtë e me fjalë të përsëritura pjesë pas pjesë, por gjithnjë fjalë që kanë të bëjnë me ideologjizmin e kohës që për moshën që ne po trajtojmë, mendoj se nuk i hynte në punë, por ishte kërkesë e kohës për hartuesit e teksteve. Tekstet ishin hartuar në mënyrë të tillë që nëpërmjet drejtshkrimit të arrihej përvetësimi i normës letrare të asaj kohe, shqipja standart sot. Në lidhje me normën letrare të asaj kohe që arrihej përmes përvetësimit të gjuhës shkruhej: *“Në fushën e shkollës, ngulitja e normës letrare përbën një kërkesë aktuale të rëndësishme, që e shton forcimin e boshtit ideologjik, jo vetëm duke u nisur nga pikëpamja politike e ideologjike, por edhe nga zgjidhja e detyrave të karakterit praktik,*

*që sbtroi revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës.”<sup>3</sup>*

Shembujt fillojnë e bëhen të pranishëm nga njëri mësim tek tjetri duke përbushur kështu synimet e kohës. Ushtrimet dhe diktimet ishin të pasur me fjalë e shprehje si p.sh

Ushtrim i 6 –fq. 34 shkëpusim fjalinë: *Ata kanë ardhur për të punuar në kombinatin metalurgjik “Çeliku i Partisë”.*

Diktim- fq.37 *Partizanët luftuan trimërisht.*

Ushtrimi 1 –fq.41 ndeshim fjalët e shprehjet - *Muzëut të Luftës, -dëshmori, Batalioni ynë u bashkua me brigadën –fq 42. Pra, përmes këtyre shembujve mbaheshin gjallë kujtimet e luftës dhe ushqehet tek ky popull që në fëmijëri të hershme përgatitja për luftë me armikun që në të vërtetë nuk ekzistonte.*

Kjo tabelë paraqet disa shembuj të shkëputur nga tekstet:

<b>Fjalë</b>	<b>Shprehje</b>	<b>Fjali</b>
<i>Kooperativistët</i> Fq. 51	<i>xhaxhi Enverit ush.5.</i> –fq.71.	<i>Luftoja për lirinë e atdheut tim/ ush. 4 - fq. 45</i>
<i>Partizanët fq.64</i>	<i>popullit e Partisë</i> ush.5- fq.80.	<i>Iliri një pionier nga malësia, ishte në klasën e dytë./</i> ush.6 –fq.45
<i>vullnetarëve</i> ush.5- fq.120	<i>Shoku komandant</i> ush.5- fq.120	<i>Atdheu ynë është i bukur- fq. 47</i>
	<i>Çeliku i Partisë fq.34</i>	<i>Gjysbi po lexon gazetën “Zëri i popullit “. – fq.49.</i>
		<i>Po lexoj një vjershë për Partinë. / ush. 7, fq.65</i>

Përveç grupeve të fjaleve e fjalive kushtuar Partisë e xhaxhit Enver ndeshim edhe vjersha me tematika të tilla:

*Një varg të ri po thur unë sot*

*E vargje pa mbarim do të thur cdo mot.*

*Për ty o e shtrenjta nënë Parti,*

*Gjithnjë do të shkruaj plot dashuri. / ush.7 –fq. 120*

Vjershë tjetër shkëputur nga libri e cila i kushtohet përsëri Partisë dhe të “mirave” që i sillte ajo popullit shqiptar të atyre viteve:

*Shkuan kohët e zymta të pishës*

*Të territ të tymit të zj,*

<sup>3</sup>Anton Çefa, “Mësuesit dhe norma letrare”, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Norma Letrare Kombëtare dhe Kultura e gjuhës, Tiranë 1973, f.274.

*Sot drita e bardhë e Partisë*

*U fut në çdo fshat e shtëpi / ush.2-fq. 128.*

Fëmijët ushqeheshin dashje pa dashje nëpërmjet librit të gjuhës me atdhedashurinë, por pa lënë mënjanë edhe dashurinë për Partinë e Enverin. Moshë e fëmijëve që përballeshin me këtë tekst shkollor ishte jo më e madhe se 7-8 vjeç, por ideologjia hidhte rrënjë herët tek ky popull, që u rrit e u ushqye me dashurinë për dije e arsim, por asnjëherë nuk lanë mënjanë elementet ideologjike të kohës, që ishin të paevitueshëm në asnjë moment, në jetën e çdo njeriu sado i vogël në moshë të ishte ai.

**Libri Gjuha 3** ishte i konceptuar me strukturë pothuajse të njëjtë me librin e klasës së dytë por, normalisht njohuritë zgjeroheshin dhe vështirësoheshin gjithnjë në përshtatje me moshën.

Ky libër hapet me rubrikën: Ndarja e fjalëve në rrokje cdoherë duke u ndërthurur me drejtshkrimin.

Që në mësimin e parë vërehen ndikimi ideologjik i pasqyruar në libër përmes një vjershe:

*Sa i bukur dhe i begatshëm është vendi ynë!*

*Partia na mëson ta duam dhe ta mbrojmë.*

Nëpërmjet kësaj vjershe të shkurtër për Partinë fëmijët mësonin ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe rregullat përkatëse.

Teksti pasohej me përsëritje të elementeve gramatikorë që fëmijët kishin mësuar në klasën e dytë, dallimin e pjesëve të ligjëratës emra- mbiemra –folje.

Këndvështruar nga pikëpamja gjuhësore fëmijët përmes tekstit kalonin nga një disiplinë e gjuhës në tjetrën, duke u ndërthurur me mjaft kujdes e vëmendje nga hartuesit e librave, të cilët duhet të ishin mjaft të vëmendshëm sa të mos kalonin pa përmendur “*fjalët magjike*”, të cilat i ndeshim në mjaft ushtrime e tekste të shkurtra.

Njohuritë e fëmijëve zgjerohen me një disiplinë tjetër gjuhësore, fonetikën duke njohur rrokjen e theksuar dhe zanoren e theksuar.

Në ushtrimin e mëposhtëm, vjersha për fatosa spikat për ndërthurje mjaft të goditur të përfimit të dijeve gjuhësore të gërshetuara me mjaft mjeshtëri me ideologji. Fatosat, që në atë periudhë përfshiheshin fëmijët e moshës nga 6 – 8 vjeç, ishin brezi i parë shkollor që ushqeheshin përveç dijes edhe me dashurinë për Partinë.

*Në kopshtin e shkollës*

*fatosat e vegjël*

*Me krabë të lehtë*

*barërat po shkulin*

*Fatosat në skuadër*

*vajzat me lopata*

*Punojnë si bletë*

*djemtë belin ngulin Ush.4 fq. 9*

Më pas gjatë shfletimit të librit të gjuhës ndeshemi me një fjalë tjetër mjaft e njohur dhe e përdorur në atë kohë për fëmijët e ciklit 8-vjeçar. Pra bëhet fjalë për *pionierët*.

*Udhëbëqësja e pionierëve, Flutura, u dha revistën "Fatosi".* Ush1.3- fq.9

Gjatë kalimit në dorë të këtyre librave shkollorë vërejtëm se ishte e pamundur që njëri nga 9 ushtrimet e përfshira për përvetësimin e emrave të përgjithshëm e të përvëcëm të mos kenë fjalë e shprehje që kanë të bëjnë me elementete paevitueshme të kohës.

Si p.sh. Ush1. –fq.15

*Kooperativistët dhe punonjës nga qyteti janë shpërndarë nëpër arë për të mbledhur bukën e re.*

Tek rubrika *drejtshtkrim* ndeshemi që në ushtrimin e parë me fjalët: *Parti, ushtri, liri* etj.

Ndërsa ush.3, po në të njëjtën faqe përfshihet i gjithi nga rryma e kohës, pra haset përdorimi i padiskutueshëm i fjalëve, duke u vënë kështu si qëllim i punës së fëmijëve të moshës 8 vjec, që në fakt duhet të mësonin trajtën e shquar të emrave femërore, të ngulitnin gjithashtu edhe fjalë e shprehje të tilla, që duhet të ishin patjetër pjesë e leksikut të tyre.

Ushtrimi vazhdon me vendosjen në trajtën e shquar të emrave në kllapa dhe një prej tyre është pikërisht emri (Parti). Shembulli:

*Në ballë të luftës për çlirimin e vendit ishte Partia.* Kjo fjali ndiqet nga një tjetër frazë mjaft domethënëse për kohën . *Tani ajo udhëbeq popullin për ndërtimin e socializmit.* fq. 18

Hartimet e këtyre teksteve ishin aq të vështira, sa që nga përcjellja e faqeve të këtij libri vërejtëm se 1 në 20 faqe i mungonin "*fjalët e arta*" të kohës. Pra, 19 prej tyre kishin brenda tyre ideologji, një faqe jo. Edhe metodistët e kohës shpreheshin kështu në lidhje me përmirësimet e librave shkollor: "*Përmirësimet e tyre të herëpashershme, sipas mësimëve të Partisë për shkollën, krabas anës më të ngritur ideoshkencore e metodike, kanë sjellë në të një gjuhë më të pasur, më të pastër e më të përpunuar, mbështetur në normat e shqipes së sotme*".<sup>4</sup>

Por, megjithatë problemet e përvetësimit të gjuhës zinin vendin që u takonte në ato vite, duke iu dhënë rëndësia e duhur nga studiues të kohës që theksonin: "*Elementet e gjuhës që takon fëmija në shkollën vijnë duke u shtuar nga viti në vit: shtohen fjalë të panjobura, shprehje të reja, terma të veçantë sipas disiplinave të ndryshme mësimore*"<sup>5</sup>

Por, qëllimi ynë vazhdon të jetë pasqyrimi i shembujve me përmbajtje ideologjike, që nuk është aspak e vështirë vjelja e tyre. Sapo hedh sytë nga njëra faqe në tjetrën faktet nuk mungojnë si p.sh paragrafi i fundit i tekstit në të cilin fëmijët duhet të dallojnë mbiemrat e nyjshëm nga ato të panyjshëm jepet një fjali e tillë: *I këndoi Partisë së dashur, që na solli këto ditë kaq të bukura.* fq .20.

---

<sup>4</sup> S.Pepa, N.Goga, "Disa vërejtje për tekstet e gjuhës shqipe dhe leximit letrar", Gjuha jonë, Tiranë, 2/1989, f.60.

<sup>5</sup> Kolë Koci, "Probleme të mësimin të gjuhës shqipe", Sh.B.L.Sh. Tiranë, 1987, f.105.

Jemi munduar të pasqyrojmë fjalët e shprehjet që përmbanin ato fletë libri, duke nxjerrë në pah, ato të cilat më tepër të vrasin veshin sot, se në atë kohë ishin bërë pjesë e domodoshme e jetës.

Element tjetër mjaft i rëndësishëm që vihet re është edhe ruajtja atdheut nga armiqtë.

Kjo ndeshet në shumë shembuj të librit si p.sh në diktim II- fq. 47.

*Populli ynë është trim punëtor e liridashës. Vendi ynë është i paprekshëm dhe i pathyeshëm. Kushdo që do të guxojë të prekë sadopak kufijtë tanë , do të shkatërrohet.*

Shembulli tjetër po me të njëjtën tematikë mbrojtja e kufijve nga armiku:

*Petriti është kufitar i zgjuar, i shkathët e trim. Edhe Genci e Agroni janë kufitarë të zgjuar, të shkathët dhe trima. Ata ruajnë kufijtë e atdheut.* Fq.50

Po ashtu, lufta e popullit shqiptar është edhe kjo një pjesë e pandashme, duke ushqyer kështu dashurinë për atdheun por pa harruar Partinë. Shembujt e librit mbajnë të gjallë edhe kujtimet e luftës Nacionalçlirimtare, duke u mbështetur gjithnjë tek lidhjet e luftës me Partinë, si :

*Megjithëse ishte 13-vjecar, ai kishte trup të zhvilluar dhe ishte mjaft i fortë. Të dy me Palin po ecnin në një rrugicë të errët. Makina e shkrimit u duhej patjetër shokëve të Partisë.* Fq.

*Partizanët marsbonin drejt vendit të caktuar. Me ta ishte dhe Beni partizani i vogël. Në kokë mbanin kapelen me yll të kuq . Kur po arrinin, ata panë shumë armiq në luginë. U dha shenja e sulmit. Partizanët luftuan si luanë. Në krye të cetës printe komandanti. Beni luftonte pranë tij.* Ush. 1- fq.82

Duke qënë gjithnjë në të njëjtën linjë, ushtrimi 10 nëpërmjet kërkesës i vë detyrë nxënësve, përshkrimin e ngjarjeve të luftës, të cilën mendoj se ata e kishin jo shumë të vështirë ta përshkruanin nga trajtesat e tepërta që përmbanin tekstet e tyre : Dhe kërkesa e librit është kjo:

*Tregoni një ngjarje nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.*

Po përveç luftës nacionalçlirimtare , nuk duhej harruar dhe kontributi i Partisë , në mënyrë që të plotësonin kërkesat e librit.

Ky element gjendet edhe në copëzë diktimi në të cilën jepen momente të shkurtra të luftës, në mënyrë që fëmijët të kishin informacionin e duhur për kohën që se kishin jetuar dot.

*Unë banoja në një shtëpi të ulët, që ishte e futur thellë në një rrugicë. Policia fashiste më kërkonte. Në këtë shtëpi rrija disa orë të ditës. Pastaj dilja veshur me pantallona të bekuosura , me kapele e syze dielli, që të mos më njihnin spiunët. Shkoja në shtëpinë e Mitit dhe shkruanim artikujt vjersha për gazetën e Partisë.*

Sikurse e cilësuam edhe më lart vjershat ishin pjesë e pandashme e librit por, pjesa më e madhe e tyre i kushtoheshin Partisë dhe Enverit .Nga vargjet e vjeshës së mëposhtme do të vërejmë se si autorët e tyre kanë ndërthurur mjaft bukur interesat e

moshës femënore me fjalët e kohës të cilat nuk duheshin harruar. Vargjet transmetojnë tek të vegjëlit dashurinë e madhe për aktorët e kohës si p.sh. Ush.1-fq.59.

<i>Unë fatose jam akoma</i>	<i>ndaj mësoj, punoj, kalitem</i>
<i>Këto duar janë të njomë</i>	<i>bijë besnike që të rritem.</i>
<i>Por me ato kam qëndisur</i>	<i>Unë e vogël jam akoma,</i>
<i>yllin e ndritur të Partisë.</i>	<i>Këto duar janë të njoma,</i>
<i>Ty, Parti, sa shumë të dua!</i>	<i>Por kjo zemër rreh përherë</i>
<i>Nënë e diell je për mua,</i>	<i>për Partinë, xhaxhin Enver.</i>

Ajo çka na tërhoqi vëmendjen tek lexonin vjershën ishte fakti që nga 46 leksema që përmbanin vargjet e saj, 6 prej tyre ishin ideologji. Pra, kaq shumë depërtonte kjo ideologji sa në një vjershë për fëmijë duhej të përsëriteshin 6 herë fjalët Parti, Enver.

Rubrika fjalë e shprehje ishte mjaft e hasur në tekst dhe kishte si qëllim pasurimin e leksikut të fëmijëve me fjalë e shprehje të reja, duke i ndarë ato edhe në pjesët e ligjëratës që kishin mësuar në mënyrë që të forcojnë dijet.

Por, ajo çka vihet re, zakonisht në këtë rubrikë të tekteve e gjuhës është prania e fjalëve të përsëritura nga njëri ushtrim tek tjetri, difekt që kuptohet qartë se vinte si detyrë e kohës që hartuesit e tekteve kishin në pasqyrimin medoemos të fjalëve e grupeve të tilla fjalësh. Por, parë me syrin e sotëm ky fenomen ulte nivelin e tekstit duke e rënduar atë me përsëritje të herëpashershme të fjalëve.

Sintagmat e përdorura nga njëra klase tek tjetra zgjerohen, duke arritur kështu edhe qëllimin kryesor që duhet të kishin në rrallë të parë librat e gjuhës, transmetimin e njohurive gjuhësore tek fëmijët. Këta zgjerimin njohuritë duke gjetur gjithnjë në libër pothuajse të njëtat fjalë apo shprehje por të përshtatura me moshën. Pra ky qëllim, depërtimi i ideologjisë, duhej arritur nëpërmjet shembujve të tillë, vjelë nga librat e kl. 2-4.

Pra, tani i kemi sjellë këto fjalë si pjesë e të tre teksteve së bashku parë nga një nivel në tjetrin sesi zgjerohen ato.

*kooperativë- kooperativist- kooperativiste-kooperativën e tyre- kryetare e kooperativës.*

Më pas vazhdojmë me: *Parti- nënë Parti- Çeliku i Partisë- mësimet e Partisë-Partisë së dashur- shokëve të Partisë –Partinë e popullin- nën udhëbeqjen e Partisë- Partia Komuniste.*

*Pionier- pionier i dalluar- pionier nga malësia-udhëbeqësja e pionierëve- pionierët e qytetit tonë.*

*Enver- Xhaxhi Enver- shoku Enver-Parti Enver- shoku Enver Hoxha.*

Këto fakte tregojnë që hartuesit e teksteve ishin të detyruar të përdornin të njëjtat shembuj, për marrjen dhe zgjerimin e njohurive gjuhësore tek fëmijët.

Udhëzimet e Partisë dhe xhaxhit Enver, duhet të ishin të ngulitur thellë në mendjen e fëmijëve dhe këto e shprehin qartë shembuj të tjerë të shkëputur nga libri i



gjuhës 3:

*Ne do të mësojmë si na këshillon xhaxhi Enveri. Kurrë s' do të mungojmë në shkollë. Do të bëjmë gjithë detyrat që na ngarkojnë. Klasa jonë do të shkëlqejë nga pastërtia. Ne do të sbtrojmë me kalldrëm edhe një copë rrugë. Diktim I, fq.75.*

Edhe gjuhëtarët kanë qenë të detyruar të paktën të shkruajnë se futja e kësaj ideologjie është pozitive për shoqërinë shqiptare.

Prandaj, në harmoni me atë që pasqyronin tekstet duhet të ishin edhe mendimet e studiuesve të mëdhenj të gjuhës shqipe siç ishte Xhuvani, i cili në një artikull kushtuar çështjeve të gjuhës në shkolla, vërehen notat ideologjike në mbyllje të artikullit: *“Qysh se u mëkëmb Pushteti Popullor , qysh u shpall Republika jonë popullore, një frymë e re hyni në arësimin e kulturën tonë; arësimi e kultura jonë, idealistike në kohë të kalueme, u banë nacionale nga forma e socialiste nga mbrendia. Tue ndjekë këtë drejtim të mbarë shkolla jonë po bahet palestra e edukatës dhe e kulturës së gjithë popullit.”*<sup>6</sup>

Përshendetjet e xhaxhit Enver transmetoheshin në çdo festë e për çdo moshë. Në një pjesë të shkëputur nga libri jepet mesazhi drejtuar pionierëve me rastin e vitit të Ri.

*Përsbëndetjen e xhaxhi Enverit, drejtuar pionierëve me rastin e Vitit të Ri e lexuan të gjithë. Ne, pasi lexuam fjalët e ngrobta të xhaxhi Enverit, premtuam se do të punojmë edhe më shumë për të dalë me përfundime të shkëlqyera. Atë e lexoi edhe Lindita e vogël. Fjalët e xhaxhi Enverit ia mbushën zemrën me gëzim. Fq. 126*

Mësimet e fundit të librit të gjuhës 3 përmbajnë brenda vetes një disiplinë tjetër të gjuhës, atë të sintaksës. Kryefjala dhe kallëzuesi janë pasqyruar në libër, bashkë me pjesët plotësuese të tyre. Edhe në faqet e fundit të librit nuk mungojnë shembujt .

Ne do të shkëpusim vetëm pak prej tyre duke menduar se qëllimi i kësaj teme po arrihet. Shembujt janë të shumtë, por po japim vetëm 2-3 tipikë

*Pas dërrimit, Partia u dha tokë fshatarëve. Më vonë, ata bashkuan tokat dhe formuan kooperativën e tyre. Ush.2- fq.128*

*Heroina e Punës Socialiste ishte një grua e re , e fortë dhe e qeshur. Kishte veshur rroba pune ë thjeshta....Ush.4- fq.141.*

#### **Libri Gjuha 4**

Tek libri gjuha 4 njohuritë gjuhësore fillojnë e vështirësohen. Fjalët ,shprehjet e fjalitë janë më të zgjeruara. Në dallim nga librat që trajtuam më lart këtu ndeshim dy lloje ushtrimesh me shkrim e me gojë, përveçse pjesëve teorike që trajton teksti. Pra struktura ruan pothuajse të njëjtën formë me tekstet e lartpërmendura , por me

<sup>6</sup> A. Xhuvani, ”Mbi disa çështje të gjuhës në shkollat tona”, Vepra II, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1990, f.325.

ndryshime të vogla. Edhe këtu nuk mungojnë pjesët me përmbatje ideologjike, kuptohet të përshtatshme për moshën. Marrim një shembull të shkëputur që në faqet e para:

*Pionierët e qytetit tonë morën një nismë revolucionare.* Ush. 2-fq. 9

*...Për Partinë e popullin dubet të japim edhe jetën.* Ush. 1-fq. 20

*...U ktheva se nuk mu duk njeri i keq, pastaj ajo ishte lagje e varfër dhe të gjithë ishin me Partinë.* Ush.3-fq.20.

*- E ka shkruar Partia Komuniste, - i thashë dhe ia lexova.*

*- Edhe unë jam me Partinë- dhe më ra krabëve me dashuri.* Ush.4-fq.20

Tre shembujt që lartpërmendëm janë shkëputur nga tre ushtrime të njëpasnjëshëm, pra vetëm në një fletë të librit, fjala Parti hasej në cdo ushtrim që fëmijët duhej të zgjidhnin gjatë një ore mësimi gjuhë shqipe. Ky fakt tregon se sa më tepër rritej mosha e fëmijëve, aq më shumë duhej të dëgjonin e të dinin për Partinë. Edhe nqs emri *Parti* nuk përmendej kishte mjaft fjalë e shprehje të cilat ishin pjesë e pandashme e këtyre teksteve si *kolektivishtarak, shtab*, të cilat të conin direkt e tek ideologjizmat e kohës.

*Ti rilinde kur rilindi Shqipëria. Ti rilinde nga rrebeshi i luftës, nga gjaku u dëshmorëve që ranë për lirinë e atdheut , nga djersa e punëtorëve që po të ndërtojnë nën udhëheqjen e Partisë.* Diktim- fq.48.

Ky fragment është shkëputur nga një pjesë diktimi, ku nxënësit duhej të provonin dijet e tyre në lidhje me fjalët e grupet e fjalëve që kishin mësuar. Ky ishte edhe qëllimi i diktimit, por domosdoshmëri duhej të ishte edhe fjala Parti që fëmijët e asaj kohe e kishin mësuar përmendsh, dhe nuk besoj se gabonin në shkrimin e saj.

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm ishte ylli me pesë cepa , të cilit i ishin kushtuar vjersha të shumta e një ndër to është kjo vjershë e shkëputur nga libri:

*Sot Majlinda e vogël* *ngribet lapidari*

*Lule mban në dorë* *lart te një kodrinë*

*Përmbi lapidar* *ylli me pesë cepa*

*Do ti vërë kurorë.* *Seç i vetëtin.* Ush. 3 – fq. 57

Një fjali tjetër e shkëputur nga ushtrimet e tekstit:

*...Sepse në krye të popullit dhe të Partisë prin gjithnjë flamurtari i ditëve të stubishme dhe prijësi i ditëve të lumtura, sboku Enver Hoxha.* Ush.5-fq82.

Mendoj, se s'do të kishte fjali më të goditur për të mbyllur kërkimin nëpër faqet e librit, prandaj edhe vendosëm që me lozhet që i drejtoheshin prijësit të kohës t'i japim fund shembujve të bollshëm, që na u ofruan faqet e këtyre teksteve. Si përfundim shpreh mirënjohjen time për hartuesit e këtyre librave shkollorë, që përveç aparatit shkencor që ishte trajtuar me mjaft kujdes e profesionalizëm, duhet të tregonin kujdes edhe për ideologjizmat e përdorur në tekst. Gjithashtu nuk mund të lë

pa përmendur edhe sakrificën e pashoq të brezave të tërë shqiptarësh, të cilët me dëshirë apo pa dëshirë u ushqyen me këto terma e formula , që sot zor se ti beson ky brez i ri, e as i çon ndër mend e i kupton. Megjithatë kjo ishte jeta që duhej të jetoj populli shqiptar për dekada të tëra., dhe këto ishin fjalët e fjalitë që duhej të dëgjonte ai në çdo çast te jetës së tij.

### **Bibliografia:**

1. Çefa A., “*Mësuesit dhe norma letrare*”, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Norma Letrare Kombëtare dhe Kultura e gjuhës, Tiranë 1973.
2. Koci K., “*Probleme të mësimit të gjuhës shqipe*”, Sh.B.L.Sh. Tiranë, 1987.
3. Kraja M., “*Probleme të forcimit të punës edukative në shkollë*”, SHBLSH, Tiranë, 1981.
4. Pepa S., Goga N., “*Disa vërejtje për tekstet e gjuhës shqipe dhe leximit letrar*”, Gjuha jonë, Tiranë, 2/1989.
5. Xhuvani, A., “*Mbi disa çështje të gjuhës në shkollat tona*”, Vepra II, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1990.

### ***Tekse mësimorë të shfrytëzuar:***

1. *Gjuha shqipe 2*, B. Beci E. Hysa, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, Rishtypje, 1985.
2. *Gjuha shqipe 3*, B. Beci, T. Llogani, Shtypshkronja “Mihal Duro, Tiranë, Riboti i V, 1983.
3. *Gjuha Shqipe 4*, B. Beci, N. Sallaku, Rishtypje, 1985.



## **PËRMBAJTJA**

Sedat KUÇI, dekan i Fakultetit të Filologjisë  
FJALA PËRSHËNDETËSE NË HAPJEN E PUNIMEVE  
TË SEMINARIT XXXIII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,  
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE..... 7

**LIGJËRATA..... 9**

Dalina KALLULLI  
ASPEKTE TË SINTAKSËS SË SHQIPES DHE RËNDËSIA E TYRE PËR  
GJUHËSINË TEORIKE ..... 11

Shkumbin MUNISHI  
ZHDUKJA E DYGJUHËSISË SHQIP-SERBISHT NË KOSOVË ..... 25

Francesco ALTIMARI  
NAPOLI, VATËR E RËNDËSISHME E RILINDJES ARBËRESHE DHE  
SHQIPTARE (SHEK. XVIII-XIX) ..... 59

**REFERIME ..... 91**

Isak SHEMA  
KULTURA LETRARE BASHKËKOHORE ..... 93

Muhamet HAMITI  
ARDHJA DHE IKJA E BARBARËVE NË LETËRSINË E CAVAFY-T, J.M.  
COETZEE-S DHE HAMITIT ..... 103

Arben HOXHA  
EPISTEMOLOGJIA LETRARE DHE ETIKA: TIPOLOGJIA E RAPORTIT TË  
TYRE ..... 115

Anna KAPITANOVA

NEVOJA PËR NJË GJUHË TË NJËSUAR – PIKËNISJA E BASHKIMIT  
KOMBËTAR TE SHQIPTARËT ..... 121

Aleksandër NOVIK  
PERSONAZHET MITOLOGJIKE NDËR SHQIPTARËT E DEVOLLIT:  
PARALELE ME TRADITËN E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS  
(EKSPEDITAT 2011-2014) ..... 125

Martin SUROVČÁK  
AUTOBIOGRAFIA SHQIP E JAN URBAN JARNIKUT ..... 131

Denis ERMOLIN  
DUKE E LEXUAR QYTETIN SI LIBËR: GJUHA E HARTAVE DHE  
IDENTITETI..... 141

Iliaz REXHA  
SHTRIRJA DHE SLLAVIZIMI I VLLAZËRIVE ALBANE MESJETARE,  
BURMAZI DHE MATARUGA NË AREALIN E TREKËNDËSHIT TË  
KUFIJVE TË BOSNJËS E HERCEGOVINËS, MALIT TË ZI DHE SERBISË  
(SIPAS DY DEFTERËVE TË SANXHAKUT TË HERCEGOVINËS TË SHEK.  
XV) ..... 147

Isa MEMSHI  
GJUHA ARABE DHE KODET E MËDHA, ME THEKS TË VEÇANTË  
KUR’ANI..... 157

Arsim CANOLLI  
AS “KUSHTETUTË” AS “PRIMITIVIZËM”: FTESË NË STUDIME  
ANTROPOLOGJIKE MBI KANUNIN ..... 167

Arian KRASNIQI  
TEATRI NË KOSOVË DHE DRAMA SHQIPE SOT ..... 177

Emilia CONFORTI, Aljula JUBANI BENGU  
SHKRIMTARË DHE STUDIUES ITALIANË PËR ROMANIN “LA SETE  
PIETRIFICATA” TË ANTON NIKË BERISHËS ..... 185

Anton PANÇEV

GJUHA SHQIPE DHE IDENTITETI SHQIPTAR NË FILLIM TË SHEKULLIT XX SIPAS BURIMEVE BULLGARE.....	197
Sala AHMETAJ FUNKSIONI SINTAKSOR .....	205
Flutura ÇITAKU MOTIVIMI I TERMAVE TË GRAMATIKËS TRADICIONALE .....	213
Hava QYQALLA PJESORJA (PARTICIP), TEZAT RRETH TIPAVE TË PJESOREVE I.E. NË SHQIPEN E LASHTË (PROTOSHQIPEN) DHE RUAJTJES SË GJURMËVE NË SHQIPEN E SOTME.....	221
Merima KRIJEZI KONSTRUKSIONI I RRJEDHORES ME PARAFJALËN <i>SIPËR</i> NË GJUHËN SHQIPE DHE NUANCA E TIJ SEMANTIKE TE BARASVLERËSIT NË SERBISHT .....	225
Ariane EISSEN UN LECTEUR FRANÇAIS PEUT-IL COMPRENDRE KADARÉ ? .....	231
Avdi VISOKA PËRKTHIMET NGA SHQIPJA NË FRËNGJISHT .....	241
Naser MRASORI CVAJGU DHE SPASE MIDIS NDIKIMEVE, DALLIMEVE DHE NGJASHMËRIVE .....	249
Albulena BLAKAJ-GASHI PROMETEU, HIMN GJENIUT TË STURM UND DRANG-UT .....	261
Naim KRYEZIU ROLI KULTUROR E LETRAR I PËRKTHIMIT, SI EDHE DISA VEÇORI TË MJESHTËRISË SË PËRKTHIMIT TË PROZËS E TË POEZISË .....	273

Dije DEMIRI-FRANGU MODELE TË LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË.....	281
Antonio BELLUSCI LETËRSIA POPULLORE NË ARBËRORET E GREQISË.....	285
Vebi BEXHETI LIRIKA DERADIANE DHE AJO E LETËRISË GOJORE ARBËRESHE NË POEMËN “KËNGËT E MILOSAUT”.....	301
<b>I. SESIONI I GJUHËSISË.....</b>	<b>307</b>
Rrahman PAÇARIZI LEKSIKU MENTAL DHE IDEOLOGJIA NË FJALIMET PARAZGJEDHORE .....	309
Anila OMARI IDEJA KOMBËTARE NË THEMEL TË PËRPJEKJEVE PËR NJË GJUHË TË PËRBASHKËT LETRARE SHQIPE.....	325
Teuta ABRASHI GJUHËSIA SHQIPTARE DHE IDEOLOGJIA.....	335
Lindita TAHIRI, Vjosa HAMITI IDEOLOGJIA NË TEKSTET E HISTORISË TË SHKOLLAVE FILLORE NË KOSOVË.....	341
Sahadete LIMANI-BEQA POLISEMIA IDEOLOGJIKE E FJALËS „DEMOKRACI“ NË DISKURSIN POLITIK NË KOSOVË.....	349
Sazana ÇAPRIQI GJUHA, GJINIA, IDEOLOGJIA.....	375
Mimoza PRIKU NDIKIMI I IDEOLOGJISË GJINORE GJATË PROCESIT TË PËRKTHIMIT (RASTI I PËRKTHIMIT TË VIRGINIA WOOLF-IT NË SHQIP).....	381



Mimoza GJOKUTAJ, Irida HOTI ÇËSHTJE TË TRAJTIMIT GJUHËSISË SË ZBATUAR PARA DHE PAS VITEVE '90 NË GJUHËSINË SHQIPTARE .....	389
Julie KOLGJINI RE-ORIENTIMI I EKOLOGJISË SË GJUHËS NË KORNIZËN METROLINGUALE BASHKËKOHORE: SUGJERIM KRITIK PËR NDËRRIMIN E PARADIGMËS DREJT ZGJËRIMIT, TË BAZËS SË STANDARDIT TË PERBASHKËT TË SHQIPES.....	403
Mustafa IBRAHIMI IDEOLOGJIA DHE PURIZMI SI KONFLIKT GJUHËSOR GJATË PËRDORIMIT TË VARIETETEVE NË TERMINOLOGJINË KOMPJUTERIKE .....	419
Haki HYSENAJ NDIKIMI I IDEOLOGJISË NË VARIETETET E SHQIPTUARA TË SHQIPES .....	429
Maklena ÇABEJ FJALË TË HUAZUARA DHE TË FORMUARA ME SHTYSË IDEOLOGJIKE .....	441
Kledi SHEGANI VËSHTRIM KRAHASUES MBI SEMANTIKËN IDEOLOGJIKE TË FJALËVE NË FJALORËT E SHQIPES .....	445
Linditë SEJDIU-RUGOVA IDEOLOGJIA E SHPREHUR NËPËRMJET MODALITETIT NË STUDIMET PËR “PASTËRTINË E SHQIPES” .....	451
Aleksandr NOVIK, Rusana HRISTOVA-BEJLERI SHQIPTARËT E FSHATIT MANDRICA TË BULLGARISË: SHKENCA DHE IDEOLOGJIA .....	461
Mimoza KORE NDIKIME IDEOLOGJIKE NË ÇËSHTJE TË HISTORISË SË GJUHËS.....	469

Idriz METANI RRETH IDEOLOGJIZIMIT TË FJALËVE .....	477
Anila KANANAJ NDIKIME TË IDEOLOGJISË NË STUDIMET SINTAKSORE TË SHQIPES	485
Bardh RUGOVA IDEOLOGJIA E PRESKRIPTIVIZMIT NË GJUHËN SHQIPE.....	501
Aljula JUBANI-BENGU STUDIMET FONOLOGJIKE NË SHQIPËRI, NË KORNIZAT E IDEOLOGJISË MATERIALISTE .....	509
Bade BAJRAMI ROLI I GJUHËS NË TË KUPTUARIT E IDEOLOGJISË SË DISKURSEVE..	515
Milote SADIKU RRETH PËRDORIMIT TË METAFORAVE NË DISKURSIN POLITIK NË GAZETAT E PËRDITSHME TË KOSOVËS .....	525
Xhavit BEQIRI ARSHI PIPA PËR POLITIKËN E GJUHËS NË SHQIPËRINË SOCIALISTE.	535
Naser PAJAZITI ROLI I KISHËS KATOLIKE NË HISTORINË KULTURORE E GJUHËSORE TË SHEKUJVE XVI-XVIII .....	549
Sadije REXHEPI GJUHA NË SHËRBIM TË IDEOLOGJISË .....	559
Zamira SHKRELI IDEOLOGJIZIMI NË TEKSTET E GJUHËS SHQIPE PARA VITEVE ‘90 .....	569

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18(063)

821.18(063)

008(=18)(063)

Seminari XXXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare = The XXXIII internacional seminar for albanian language, literature and culture : Prishtinë, 18-30.08.2014 / kryeredaktor Bardh Rugova. – Prishtinë ; Tiranë : Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” : Fakulteti i Filologjisë ; Universiteti i Tiranës : Fakulteti Histori-Filologji, 2015. – libra. ; 24 cm.

[Libri] 1. – 586 f.

1.Rugova, Bardh

**ISBN 978-9951-00-173-1**

**ISBN 978-9951-00-174-8**

